



PROFLET E KOMUNITETEVE TË KOSOVËS

2010





PROFILET E KOMUNITETEVE TË KOSOVËS

Parathënie nga Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë
Parathënie e Komisionarit të Lartë të OSBE-së për
Pakica Kombëtare
Hyrje
Përmbajtja



Parathënie nga Kryesues i Misionit të OSBE-së në Kosovë

Lexues i nderuar,



Para jush keni edicionin e dytë të Profileve të Komuniteteve të Misionit të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë. Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të komuniteteve, si dhe monitorimi i veprimeve të institucioneve të Kosovës në pajtim me to, vazhdojnë të jetë aktivitete kyçe të Misionit të OSBE-së. Një nga sfidat për ndërtimin e paqes së qëndrueshme në Kosovë mbetet mungesa e të kuptuarit dhe njohjes së veçorive, nevojave dhe brengave dalluese të komuniteteve joshumicë nga ana e shoqërisë më të gjerë, institucioneve vendore dhe hisedarëve ndërkombëtarë. Në vitin 2009, për të kontribuar në rritjen e njohurisë së bashkëbiseduesve të vet, Misioni i OSBE-së i publikoi Profilet e para të Komuniteteve, ku ishin përmbledhur të dhënat demografike, sociale-ekonomike, politike dhe kulturore për serbët e Kosovës, turqit e Kosovës, boshnjakët e Kosovës, kroatët e Kosovës, malazetët e Kosovës, goranët, romët, ashkalitë, egjiptianët dhe shqiptarët e Kosovës (në komunat ku ata janë pakicë). Suksesi i edicionit të vitit 2009, që u prit shumë pozitivisht nga bashkëbiseduesit e Misionit të OSBE-së në Kosovë dhe jashtë saj, ka qenë motivuesi kryesor për edicionin e dytë.

Profilet e Komuniteteve të vitit 2010, duke u zgjeruar mbi të dhënat e mbledhura, ofrojnë një pasqyrë më gjithëpërfshirëse dhe më të hollësishme të sfidave që kanë ndikim në gëzimin e të drejtave nga ana e komuniteteve joshumicë të Kosovës. Një perspektivë më e fortë gjinore përvijohet nëpër tërë publikimin, edhe pse mungesa e të dhënave të zbërthyer sipas gjinisë që kanë institucionet mbetet pengesë për t'i paraqitur saktësisht përvojat dhe brengat dalluese të grave dhe vajzave të komuniteteve joshumicë. Këtë herë, Profilet e Komuniteteve janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe për t'u siguruar që ato të bëhen dokument referimi për homologët vendorë të Misionit të OSBE-së në Kosovë, si dhe për ta ofruar mundësinë për shoqërinë civile vendore që ta përdorë këtë vegël si platformë për avokim për të drejtat e komuniteteve. Për më tepër, ato do jenë në dispozicion në formë elektronike për ta garantuar shpërndarjen më të gjerë dhe, si rrjedhim, rritjen e njohurisë së një audience më të madhe për çështjet e të drejtave të komuniteteve.

Profilet e Komuniteteve të vitit 2010 nuk synojnë t'i emërtojnë apo t'i definojnë komunitetet, detyrë kjo veçanërisht e vështirë kur të merret parasysh natyra rrjedhëse e identitetit, por më shumë synojnë ta paraqesin rolin dhe situatën e tyre aktuale në shoqërinë e Kosovës. Dhjetë komunitetet e profilizuara në këtë publikim kanë për bazë vetë-identifikimin, një parim që është zbatuar gjatë tërë punës në terren të ekipeve të Misionit të OSBE-së dhe gjatë hartimit dhe editimit pasues të tekstit përfundimtar në selinë e Misionit të OSBE-së. Synimi i Profileve të Komuniteteve të vitit 2010 është që ta vazhdohet promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të të gjitha komuniteteve në Kosovë. Ato e përcjellin zërin e komuniteteve, përfaqësuesve të tyre dhe bashkëbiseduesve tjerë në terren në mënyrë që të ofrohet një pasqyrë sa më reale e situatës atje.

Përmes këtij publikimi, Misioni i OSBE-së ofron një kuptim dhe njohje të rritur të kontributit pozitiv që komunitetet e Kosovës e japin për shoqërinë, si dhe sfidat që kanë ndikim në gëzimin e të drejtave të tyre. Ne shpresojmë që ato do të mbesin burim relevant për partnerët tanë vendorë dhe ndërkombëtarë.

Ambasadori Werner Almhofer, Kryesues i Misionit

Parathënie e Komisionarit të Lartë të OSBE-së për
Pakica Kombëtare (KLPK) për Profilet e Komuniteteve të
Misionit të OSBE-së në Kosovë



Respektimi i të drejtave të komuniteteve etnike është faktor i rëndësishëm për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit. Këto të drejta përfshijnë pjesëmarrjen efektive në jetën publike, në veçanti në çështjet që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në to. Kjo kërkon si të kuptuarit e thellë të nevojave të komuniteteve të ndryshme etnike, ashtu edhe vullnetin politik për t'i përfshirë ato në proceset e vendimmarrjes. Në vitin 1999, në pajtim me mandatin e Komisionarit të Lartë për Pakica Kombëtare (KLPK) për parandalim të konfliktit, zyra ime i zhvilloi "Rekomandimet e Lundit për Pjesëmarrje Efektive të Pakicave Kombëtare në Jetën Publike", me qëllim që të qartësohet përmbajtja e të drejtave të pakicave në këtë fushë dhe, përfundimisht, të zbuten tensionet mes komuniteteve etnike.

Krahas të drejtave tjera të personave që u takojnë komuniteteve etnike, siç janë e drejta për arsimim në gjuhë amtare dhe të drejta të caktuara gjuhësore, e drejta për pjesëmarrje efektive në jetën kulturore, sociale, dhe ekonomike dhe në çështjet publike përbën bazën elementare për mbrojtjen, ruajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre. Njëkohësisht, pjesëmarrja efektive i fton komunitetet etnike që të kërkojnë zgjidhje për brengat e tyre përmes një qasjeje integruese. Integrimi i komuniteteve etnike – jo asimilimi me forcë, që është i ndaluar me standarde ndërkombëtare – është parakusht për një shoqëri paqësore, demokratike dhe përparimtare. Në këtë kontekst, integrimi me respekt ndaj larmisë është bërë një moto jozyrtare për punën time.

Duke i identifikuar dhe nënvizuar kushtet që kanë ndikim në komunitetet e ndryshme etnike të Kosovës, duke përfshirë këtu edhe komunitetin shqiptar të Kosovës aty ku nuk është shumicë në nivel komunal, edicioni i dytë i këtij publikimi na ndihmon që t'i kuptojmë më mirë ato. Ky nuk është parakusht vetëm për ta rritur pjesëmarrjen e të gjitha grupeve në shoqërinë e Kosovës, por edhe për ta ndërtuar besimin e tyre të ndërsjellë. Jam i bindur që këto Profile të Komuniteteve mund t'i ndihmojnë politikëbërësit dhe faktorët tjerë për t'i identifikuar masat e nevojshme që duhet të ndërmerren për ta përmirësuar situatën aktuale. Përkthimi i tyre në gjuhën shqipe dhe serbe me siguri do të kontribuojë dhe më tej për këtë qëllim.

Leximi i këtyre Profileve ndikuese do të jetë gjithashtu i dobishëm për të gjithë ata që kërkojnë qoftë pasqyrë të komuniteteve etnike të Kosovës, qoftë më shumë informata të hollësishme, duke përfshirë këtu perspektivat lokale dhe rajonale. Padyshim ato do të jenë të çmueshme për hisedarët ndërkombëtarë, siç janë anëtarët e Misioneve të OSBE-së, personeli i organizatave ndërkombëtare dhe përfaqësuesit e shteteve, dhe delegacionet vizituese.

Në fund, Profilet e Komuniteteve paraqesin një kontribut të rëndësishëm të Misionit të OSBE-së në Kosovë për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve të Kosovës dhe e vërtetojnë rolin ndikues që e luan Misioni në këtë drejtim.

Knut Vollebaek, Komisionar i Lartë i OSBE-së për Pakica Kombëtare

Profilet e Komuniteteve të Kosovës

Hyrje

Në pranverë të vitit 2007, Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (Misioni i OSBE-së) vendosi t'i hartojë profilet e tij të komuniteteve dhe filloi t'i vë në hartë të gjitha komunitetet e Kosovës. Në shtator të vitit 2009, kur u publikua edicioni i parë i Profileve të Komuniteteve, ishte hera e parë që një paraqitje e tillë gjithëpërfshirëse e situatës së komuniteteve joshumicë në Kosovë u përmbloodh në një publikim të vetëm. Suksesi i Profileve të Komuniteteve të vitit 2009, bashkë me reagimet e vlerësuara pozitivisht nga një numër i bashkëbiseduesve që kishin pranuar kopje, i dha shtytje OSBE-së që të përgatisë një azhurnim gjithëpërfshirës për vitin 2010. Ky edicion i Profileve të Komuniteteve ofron si vazhdimësi, ashtu edhe risi për lexuesin dhe, rrjedhimisht, mund të konsiderohet publikim në vete apo shtesë e edicionit të vitit 2009.

Duke e ruajtur strukturën e edicionit të parë, lexuesit i mundësohet të përcjellë progresin apo regresin në çështjet kyçe të identifikuara në vitin 2009 (p.sh. qasja në shërbime publike, siguria dhe liria e lëvizjes, kthimet dhe riintegrimi, etj.). Njëkohësisht, ka fokus të veçantë në zhvillimet e reja. Gjithashtu, është vazhduar me qasjen që përkon me natyrën përshkruese dhe faktike të vlerësimit. Prandaj, nuk janë përfshirë kurrfarë analizash apo rekomandimesh për t'i adresuar zbrazëtirat e identifikuara në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve. Për shembull, pjesa për sigurinë dhe lirinë e lëvizjes përfshin të gjitha incidentet e raportuara që kishin ndikim në komunitetet joshumicë pa spekulime për përkatësinë etnike të kryerësve të veprave penale apo motivet e tyre. Në vend të kësaj, raporti përqendrohet në ndikimin e incidenteve të sigurisë në gëzimin e të drejtave të komuniteteve të përfshira joshumicë dhe në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve, si dhe në përgjigjen e autoriteteve relevante ndaj tyre. Kjo qasje faktike dhe e paanshme siguron që Profilet e Komuniteteve të mbeten burim i dobishëm për të gjithë hisedarët përkatës, duke marrë parasysh perspektivat e tyre të ndryshme. Vëmendje e veçantë i është kushtuar paraqitjes së fakteve, përdorimit të gjuhës së respektueshme për të përshkruar çështje që mund të jenë kontestuese dhe përdorimit të terminologjisë së pranueshme për të gjithë. Në këtë mënyrë, Profilet e Komuniteteve mund të bëhen platformë për të gjithë hisedarët relevantë në Kosovë për t'i shqyrtuar brengat e komuniteteve joshumicë dhe për t'i diskutuar zgjidhjet e mundshme së bashku. Shumë sfida që ndikuan në humlumtimet e vitit 2009 janë të pranishme edhe tani. Për shembull, mbledhja e të dhënave të besueshme demografike për komunitetet e Kosovës vazhdon të bazohet në supozime të informuara të institucioneve, përfaqësuesve të komuniteteve dhe hisedarëve tjerë, kurse ende ka vështirësi për të gjetur të dhëna të sakta të zbrërthyer sipas komuniteteve dhe/apo gjinisë. Në rastet kur këto të dhëna janë në dispozicion, ato paraqiten ashtu në publikim. Në të kundërtën, zbrazëtirat e tilla kompensohen në mënyrën më të mirë të mundshme me vlerësimet cilësore të përfshira në pjesën narrative të Profileve të Komuniteteve.

Parimet themelore në bazë të të cilave u zhvillua dizajni dhe realizimi i Profileve të Komuniteteve mbesin të njëjta, duke përfshirë këtu natyrën pjesëmarrëse dhe përfshirëse të vlerësimit në terren, si dhe të drejtën fundamentale për vetë-identifikim si pjesëtar i një komuniteti. Profilet e komuniteteve nuk i definojnë komunitetet, por më parë i njohin ato, duke u mbështetur ekskluzivisht në vetë-identifikimin e personave të komuniteteve joshumicë në bazë të përkatësisë gjuhësore, etnike apo fetare. Me qëllim të identifikimit të komuniteteve dhe të brengave dhe nevojave specifike të tyre, Profilet e Komuniteteve mund t'i thjeshtojnë së tepërmi çështjet e ndërlikuara të identitetit shumështrësish dhe

t'i ngurtësojnë me shkujdes kufijtë e veçantë ndërmjet komuniteteve që, në realitet, janë fluidë. Për shembull, një person që mund ta identifikojë veten si shqiptar i Kosovës mund t'i takojë gjithashtu komunitetit që e flet gjuhën turke. Ngjashëm, vetë-identifikimi si shqiptar i Kosovës nuk duhet të barazohet me të qenit mysliman, pasi që disa janë, në fakt, të krishterë. Ndryshimi i vetë-identifikimit nuk është dukuri e rrallë në Kosovë dhe ndodh më së shpeshti ndërmjet serbëve dhe malazezëve të Kosovës ose ndërmjet romëve, ashkalive dhe egjiptianëve. Profilet e Komuniteteve e përshkruajnë situatën e komuniteteve që paraqesin pakicë numerike në nivel komunal. Prandaj, profili i komunitetit serb të Kosovës nuk e përfshin situatën në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës ose në komunat e Zvečan/Zveqanit, Leposavić/Leposaviqit dhe Zubin Potokut (në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica), komunën e Štrpce/Shtërpçës, komunën e zmadhuar rishtas të Novo Brdo/Novobërdës dhe komunat e themeluara rishtas të Ranilug/Ranillugut, Klokot/Kllokotit, Parteš/Parteshit (në rajonin e Gjilanit/Gnjilane), dhe Gračanica/Gračanicës (në rajonin e Prishtinës/Priština). Në anën tjetër, Profilet e Komuniteteve e trajtojnë situatën e komuniteteve tjera që përbëjnë pakicë numerike në komunat e Kosovës ku serbët janë shumicë, si p.sh. atë të komunitetit shqiptar të Kosovës. Në fund, tentimi për ta vlerësuar madhësinë e komuniteteve është paramenduar për ta pasqyruar praninë e tyre kuptimplotë në komunat ku ato jetojnë në mënyrë që të promovohet njohja e nevojave dhe brengave të tyre nga ana e hisedarëve përkatës.

Edicioni i vitit 2010 ka disa ndryshime në lidhje me formatin, shpërndarjen dhe përmbajtjen. Profilet e Komuniteteve janë përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe dhe janë në dispozicion në formë elektronike te publikimet në faqen e OSBE-së në internet www.osce.org/kosovo. Shpërndarja më e gjerë te bashkëbiseduesit vendorë, duke përfshirë këtu institucionet, shoqërinë civile dhe përfaqësuesit e komuniteteve, synon ta promovojë ndikimin e shtuar të publikimit në aspekt lokal dhe ndërkombëtar. Ky edicion shton Profilet të Komuniteteve të zberthyer në tërësi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, edhe pse në disa nga të dhënat të tri komunitetet janë paraqitur së bashku për shkak se shumë komuna i ruajnë si të tilla në dhënat e tyre statistikore. Përmbajtja e edicionit të këtij viti është pasuruar shumë me hollësi të shtuara dhe fokus në çështjet aktuale që kanë ndikim në gëzimin e të drejtave dhe lirive nga ana e komuniteteve joshumicë të Kosovës. Për shembull, Strategjia për Integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian, ndonëse e aprovuar në vitin 2008, filloi të zbatohet në vitin 2010 dhe në publikim është përfshirë çdo progres që e kanë arritur komunat dhe shoqëria civile. Njëlloj, është raportuar gjerësisht për situatën pas zgjedhjeve komunale të nëntorit të vitit 2009 dhe ndikimin e bartjes në rritje e sipër të kompetencave për pjesëmarrje të komuniteteve joshumicë nga niveli qendror në nivel lokal të qeverisjes. Rritja e numrit të riatdhësimeve me forcë të pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në Kosovë dhe sfidat me të cilat përballen komunat për t'iu përgjigjur nevojave të tyre specifike në mënyrë adekuate është një fokus i ri i pjesës së Profileve të Komuniteteve për kthimet dhe riintegrimin.

Publikimi i vitit 2010 është rezultat i shumë muajve të hulumtimeve mes korrikut të vitit 2009 dhe korrikut të vitit 2010 për t'i azhurnuar çështjet e nënvizuara në edicionin e vitit 2009 dhe për t'i hetuar të rejtat që janë paraqitur në ndërkohë. Përsëri, u zhvilluan intervista individuale ose grupe me komunitetet, përfaqësuesit e tyre, zyrtarët komunalë, pjesëtarët e shoqërisë civile dhe homologët ndërkombëtarë të Misionit të OSBE-së dhe u konsultuan meshkuj dhe femra nga të gjitha komunitetet dhe sferat e jetës në mënyrë që të përfshihen pikëpamjet e larmishme të komuniteteve të profilizuara. Publikimi përmbledh të dhënat demografike, si dhe paraqitjet narrative të situatës së komuniteteve joshumicë në fushat kyçe të jetës së tyre. Të dhënat përfshijnë supozimet e informuara të institucioneve dhe komuniteteve, derisa pjesët narrative ofrojnë përshkrime të fakteve në lidhje me qasjen në shërbime dhe gëzimin e të drejtave të komunitetit të profilizuar. Të dy kompletet e të dhënave e plotësojnë njëri-tjetrin, duke ofruar një bazë të shëndoshë për zhvillim dhe implementim të politikave dhe projekteve për institucionet e Kosovës, si dhe për hisedarët përkatës vendorë dhe ndërkombëtarë.

Profilet e Komuniteteve synojnë t'ua përcjellin një porosi konstruktive por të qartë të gjithë atyre me përgjegjësi, përkatësisht institucioneve të Kosovës dhe të Serbisë, bashkësisë ndërkombëtare, shoqërisë civile vendore dhe vetë komuniteteve, për barrierat që ekzistojnë në Kosovë dhe i pengojnë shumë persona për t'i gëzuar të drejtat e tyre. Derisa mund të nevojitet kohë për t'u arritur zgjidhja e konfliktit mes shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë, është me rëndësi parësore që gëzimi i të drejtave dhe lirive nga ana e komuniteteve të mos mbetet peng i kësaj. Përkundrazi, mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të të gjitha komuniteteve do të kontribuojë, në fakt, në ndërtimin e paqes së qëndrueshme. Misioni i OSBE-së shpreson që edicioni i Profileve të Komuniteteve i vitit 2010 do t'i frymëzojë të gjithë hisedarët përkatës të gjejnë zgjidhje kreative dhe afatgjata për çështjet dhe brengat që kanë ndikim në komunitetet joshumicë të Kosovës.

Përmbajtja



[Profili i Komunitetit Shqiptarët e Kosovës](#)

[Profili i Komunitetit Ashkali](#)

[Profili i Komunitetit Boshnjakët e Kosovës](#)

[Profili i Komunitetit Kroatët e Kosovës](#)

[Profili i Komunitetit Egjiptian](#)

[Profili i Komunitetit Goranët e Kosovës](#)

[Profili i Komunitetit Malazezët e Kosovës](#)

[Profili i Komunitetit Romë](#)

[Profili i Komunitetit Serbët e Kosovës](#)

[Profili i Komunitetit Turqit e Kosovës](#)

Profili i komunitetit SHQIPTARËT E KOSOVËS

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Historiku

Shqiptarët e Kosovës përbejnë popullsi pakicë në nëntë komuna të Kosovës¹: Štrpce/Shtërpçë, Novo Brdo/Novobërdë, Ranilug/Ranillug, dhe Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc në rajonin e Gjilanit/Gnjilane; Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok dhe Zvečan/Zveçan në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica; Gračanica/Graçanicë në rajonin e Prishtinës/Priština; dhe Mamuša/Mamushë/Mamuša në rajonin e Prizrenit. Shqiptarët e Kosovës gjithashtu përbejnë popullsi pakicë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës. Situata e komunitetit shqiptar të Kosovës dallon nga komuna në komunë - në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, ata gëzojnë liri të plotë të lëvizjes, kurse në komunat veriore të Leposavić/Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zvečan/Zveçanit, komuniteti shkon rrallë në lagjet ku serbët e Kosovës janë shumicë. Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunat e reja të Ranilug/Ranillugut, Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit dhe Gračanica/Graçanicës përballen me vështirësi për qasje në arsim në gjuhën shqipe dhe duhet të udhëtojnë në komunat fqinje për qasje në shërbime tjera publike. Shqiptarët e Kosovës janë kryesisht të besimit islam sunit dhe flasin dialektin gegë të gjuhës shqipe. Një numër i shqiptarëve të Kosovës janë të besimit të krishterë katolik.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, shqiptarët e Kosovës përbejnë 34.6% të gjithë popullsisë në komunën e Štrpce/Shtërpçës, ku jetojnë në nëntë vendbanime rurale. Në Novo Brdo/Novobërdë, ata arrijnë deri në 25.9% të popullsisë dhe jetojnë në njëzet vendbanime në tërë komunën. Në komunat e reja të Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit dhe Ranilug/Ranillugut, shqiptarët e Kosovës përbejnë 28% dhe 1.6% të. Ata jetojnë në fshatrat Klokot/Kllokot dhe Mogillë/Mogila në komunën e Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit dhe në fshatrat Crep/Crepana, Drenovce/Drenoc dhe në lagjen “Muhaxhiri” në fshatin Përlepnice/Prilepnica në komunën e Ranilug/Ranillugut. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, shqiptarët e Kosovës përbejnë rreth 7.1% të popullatës në komunën e Zubin Potokut dhe jetojnë në Çabër/Čabra. E tërë popullsia e fshatit ishte zhvendosur gjatë konfliktit të vitit 1999, por të gjithë janë kthyer prej atëherë. Afërsia me pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica tregon gjithashtu që shqiptarët e Kosovës të Zubin Potokut nuk janë aq të izoluar sa ata në komunat tjera në veri të Kosovës. Në komunën e Zvečan/Zveçanit, shqiptarët e Kosovës përbejnë rreth 2.3% të popullsisë popullatës dhe jetojnë në fshatrat dhe vendbanimet Lipë/Lipa, Boletini/Boljetin dhe Zhazhë/Žaža. Këto janë vendbanime me të ardhura të ulëta nga bujqësia që kanë qasje të drejtpërdrejtë në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, ndonëse rruga e paasfaltuar bëhet ndonjëherë e pakalueshme gjatë dimrit. Mungesa e zyrtarëve të zgjedhur shqiptarë të Kosovës për t'i përfaqësuar ata në komunë i kontribuon mendimit të shprehur të tyre që institucionet e Kosovës i kanë harruar dhe i kanë lënë pas dore. Në komunën e Leposavić/Leposaviqit, shqiptarët e Kosovës përbejnë mes 0.6-1.7% të popullsisë dhe jetojnë në fshatrat dhe vendbanimet Koshtovë/Košutovo, Bisticë/Bistrica dhe Cerajë/Ceranje. Këto vendbanime në vise të larta malore janë ndër komunitetet shqiptare të Kosovës më të varfra dhe më të izoluar. Në shifrat zyrtare figurojnë rreth 300 banorë, ndonëse vetëm rreth 100 persona jetojnë aty përherë, në përgjithësi ata që kanë më së paku në pikëpamje sociale-ekonomike. Të tjerët

Që nga botimi i profileve në vitin 2009, shqiptarët e Kosovës janë bërë pakicë numerike në komunat e reja të Ranilug/Ranillugut, Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit dhe Gračanica/Graçanicës.

Ndonëse është shumë herët të përcaktohet nëse institucionet e reja sigurojnë mbrojtje adekuate siç parashihet me ligj, treguesit hershëm sugjerojnë që qasja në arsim dhe shërbimet komunale në gjuhën e tyre amtare është problematike.

¹ Shih Shtojcën I të bashkëngjitur këtij profili për vendbanimet ku jeton komuniteti shqiptar i Kosovës.

Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në lagjet me përbërje të përzier etnike në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës kanë liri të kufizuar të lëvizjes dhe janë shpesh viktime të ngacmimeve dhe sulmeve nga serbët e Kosovës. serbët.

i shfrytëzojnë pronat e tyre kryesisht si shtëpi verore dhe e kalojnë pjesën tjetër të vitit në Mitrovicë/Mitrovica. Shqiptarët e Kosovës në këtë zonë janë komunitet me të ardhura të ulëta nga bujqësia që shfrytëzohen për të mbijetuar dhe bazohen shpesh në shkëmbim me familjet tjera. Liria e lëvizjes mbetet e kufizuar. Në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, shqiptarët e Kosovës banojnë në lagje të ndara ose vendbanime në qendër të qytetit, siç është Lagjja e Boshnjakëve, Tre Rrokaqiejt/Tri solitera², Mikronaselje/Kodra e Minatorëve, Suhadolli/Suvi Do dhe Lagjja e Doktorëve/Dolina Doktora³ në periferinë perëndimore të qytetit, duke përbërë rreth 16% të popullsisë së përgjithshme. Që nga trazirat e marsit 2004, Mitrovica/Mitrovica ka mbetur e tendosur në përgjithësi. Ndonëse një dhunë e përmasave të tilla nuk është parë prej atëherë, në lagjet me përbërje të përzier etnike ka shpesh përleshje dhe incidente ndëretnike. Liria e lëvizjes për shqiptarët e Kosovës mbetet e vështirë jashtë lagjeve të veta. Në komunën e re të Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština, shqiptarët e Kosovës jetojnë në vendbanimet Sušica/Sushicë, Kišnica/Kishnicë, Suvi Do/Suhadoll, Batuša/Batushë, Lepina/Lepi, Radevo/Radevë dhe Čaglavica/Çagllavicë dhe përbëjnë rreth 7.7% të popullatës. Shqiptarët e Kosovës në komunën e re të Gračanica/Graçanicës, ku shumicë janë serbët e Kosovës, shprehin brengat për lirinë e lëvizjes, qasjen në arsim në gjuhën amtare dhe pengesat gjuhësore që e pengojnë pjesëmarrjen në çështje komunale. Në komunën e Mamuša/Mamushës/Mamuša, në rajonin e Prizrenit, shqiptarët e Kosovës përbëjnë 5.4% të popullsisë së përgjithshme dhe kanë nivel të lartë të integritimit, pjesëmarrjes në çështje publike dhe bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Qasja në shërbime, veçanërisht në kujdesin shëndetësor primar për fshatrat Koshtovë/Košutovo, Bisticë/Bistrica dhe Cerajë/Ceranje në komunën e Leposavić/Leposaviqit;
- Pjesëmarrja në jetën publike në komunën e Gračanica/Graçanicës;
- Liria e lëvizjes në zonat ku shumicë janë serbët e Kosovës.

² Tre rrokaqiejt është emërtim lokal jozyrtar që përdoret për atë zonë.

³ Lagjja e Doktorëve është emërtim lokal jozyrtar që përdoret për atë zonë.



VENDBANIMI FIRAJË/FIRAJA NË KOMUNËN E ŠTRPCE/SHTËRPCËS NË RAJONIN E GJILANIT/GNJILANE. NJË SHITËS SHQIPTAR I KOSOVËS PRET KONSUMATORËT. SHITORET E VOGLA JANË BIZNESET E VETME TË KOMUNITETIT NË VENDBANIM.

1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Mungesa e mundësive për punësim mbetet brenga kryesore për shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunat ku përbëjnë pakicë numerike. Shqiptarët e Kosovës në komunën e Štrpce/Shtërpcës vazhdojnë të jetojnë në kushte të rënda, disa janë të punësuar në komunë, ndërsa një numër i kufizuar punon ende në biznese familjare. Në mënyrë të ngjashme, është raportuar dhe mbetet problematike shkalla e lartë e papunësisë në mesin e shqiptarëve të Kosovës, por edhe të tjerëve, në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës. Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunat e Zvečan/Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposavić/Leposaviq ende mbështeten në ekonomi të vogla bujqësore.

Shqiptarëve të Kosovës që jetojnë si pakicë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane u mungojnë vazhdimisht mundësitë për punësim, në kontekst të asaj që këto mundësi janë të kufizuara edhe për komunitetet tjera. Komunat e ndikuara veçanërisht nga kjo janë komunat e Štrpce/Shtërpcës, Novo Brdo/Novobërdës dhe komuna e re e Ranilug/Ranillugut, ku njerëzit varen nga ekonomi të vogla bujqësore dhe punë joforMashkull. Një numër i vogël i shqiptarëve të Kosovës të përfshirë në biznese familjare ose të punësuar në administratat komunale (duke përfshirë sektorët e arsimit dhe të shëndetësisë) gëzojnë standard pak më të mirë të jetës. Megjithatë, pjesa dërmuese e tyre jetojnë në kushte shumë të vështira. Komuna e re e Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit mund të konsiderohet si përjashtim i kësaj në rajon. Kjo komunë ofron mundësi punësimi përmes industrisë së ambalazhimit të ujit mineral dhe përmes të një numri të llixhave. Këto industri sigurojnë punësim për një numër të kufizuar të shqiptarëve të Kosovës të kësaj komune. Gratë më së shumti ndikohen nga papunësia dhe në këtë mënyrë varen në masë të madhe nga anëtarët meshkuj të familjeve të tyre.

Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës dhe në komunat e Zvečan/Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposavić/

Kushtet sociale-ekonomike dhe kushtet jetësore të shqiptarëve të Kosovës aty ku përbëjnë pakicë numerike në Kosovë mbeten sfiduese, me shkallë të lartë të papunësisë dhe shumë prej tyre kërkojnë mundësi punësimi në zonat ku shqiptarët e Kosovës janë shumicë.

Leposaviqit vazhdojnë të përballen me shkallë të lartë të papunësisë dhe të ardhura të ulëta dhe pjesa dërmuese e tyre ia sigurojnë vetes ekzistencën përmes ekonomive të vogla bujqësore dhe punës joformal si punëtorë krahu. Format tjera të të ardhurave përfshijnë ndihmën sociale nga Prishtina/Priština, ndërsa disa shqiptarë të Kosovës marrin pensione nga Beogradi. Remitancat nga diaspora shqiptare e Kosovës kanë shënuar rënie të madhe prej vitit 1999. Disa shqiptarë të Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës punojnë në tregun joformal me shumicë në Lagjen e Boshnjakëve, ku lulëzon biznesi dhe ndërveprimi ndërmjet komuniteteve.

Në komunën e re të Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština, shkalla e punësimit dhe gjendja socio-ekonomike e shqiptarëve të Kosovës dallon. Shumë shqiptarë të Kosovës e cekën që punësimi, në përgjithësi, është i kënaqshëm. Megjithatë, të tjerët, si ata që jetojnë në fshatin Suvi Do/Suhadoll, pohojnë që të vetmet mjete të mbijetesës i sigurojnë nga bujqësia, me vetëm një shqiptar të Kosovës të punësuar në sektorin e arsimit. Bujqësia mbetet burim i rëndësishëm i të ardhurave për shqiptarët e Kosovës në tërë komunën, ndërsa disa prej tyre kanë biznese ndërtimtarie. Miniera e Kishnicës/Kišnica përmendet gjithashtu si ofrues i mirë i mundësive të punësimit për komunitetin shqiptarë të Kosovës në rajon. Burimet tjera të të ardhurave janë pensionet, mirëqenia sociale dhe nga remitancat nga diaspora.

Në komunën e Mamuša/Mamushës/Mamuša, në rajonin e Prizrenit, shumica e shqiptarëve të Kosovës punojnë në bujqësi, me numër të kufizuar të të punësuarve në administratën komunale në fushën e arsimit dhe të shëndetësisë. Të tjerët kanë shkuar për të punuar jashtë vendit, kryesisht në shtetet e Evropës Perëndimore.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Siguria dhe liria e lëvizjes së shqiptarëve të Kosovës në komunat ku përbëjnë pakicë mbetet e përzier. Në pjesën veriore të rajonit të Mitrovica/Mitrovicës, ata përballen me sfida për lirinë e tyre të lëvizjes, ndërsa në rajonin e Gjilan/Gnjilane, ata mund të lëvizin lirshëm. Megjithatë, në komunën e re të Gračanica/Graçanicës, janë ngritur shqetësime lidhur me sigurinë dhe lirinë e lëvizjes.

Nuk ka pasur incidente serioze të sigurisë të motivuara etnikisht me ndikim në komunitetin shqiptar të Kosovës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane. Në nëntor 2009, anëtar i vetëm shqiptar i Kosovës i ekipit përgatitor komunal⁴ për Klokot/Kllokot-Vrbovac/Vërboc është kërcënuar dhe një mjet eksploziv është hedhur në automjetin e tij. Ky incident i izoluar, megjithatë, nuk ka pasur ndikim negativ mbi lirinë e lëvizjes që e gëzon ky komunitet në tërë rajonin, duke përfshirë qasjen e papenguar në vendet e punës, tregje, shërbime publike dhe sociale. Komuniteti shfrytëzon shërbimin e autobusit humanitar që qarkullon ndërmjet Štrpce/Shtërpçës dhe Prizrenit. Në komunat ku nuk janë shumicë, shqiptarët e Kosovës ndërveprojnë me komunitetet pa ndonjë problem të madh. Shqiptarët e Kosovës përfaqësohen në masë të mirë në Policinë e Kosovës. Për shembull, në stacionin policor të Štrpce/Shtërpçës, 34% të zyrtarëve janë

Në mars të vitit 2010, Policia e Kosovës dhe OSBE-ja nisën procesin e themelimit të komitetit të ri lokal për siguri publike në Llabjan/Labljan të komunës së Novo Brdo/Novobërdës, ku shumica e anëtarëve janë shqiptarë të Kosovës.

4 Ekipet përgatitore komunale (EPK-të) janë formuar në vitin 2009 nga qeveria e Kosovës për ta zhvilluar dhe zbatuar strategjinë e themelimit të komunave me shumicë serbe të Kosovës.

shqiptarë të Kosovës, në Novo Brdo/Novobërdë 33% janë shqiptarë të Kosovës, prej të cilëve 20% janë police. Nuk ka asnjë stacion policor në komunat e reja meqë nevojat e tyre për shërbime policore mbulohen ende nga stacionet ekzistuese në komunat ëmë. Komuniteti deklaroi që Policia e Kosovës iu adresohet nevojave të tyre për siguri në mënyrë adekuate. Për shembull, përkundër faktit që nuk është themeluar ndonjë stacion policor në Ranilug/Ranillug, reagimi i zyrtarëve nga stacioni i Kamenicës/Kamenica raportohet të jetë i menjëhershëm dhe efikas. Komitetet lokale për siguri publike janë themeluar dhe funksionojnë në komunat ku shqiptarët e Kosovës përbëjnë komunitetin joshumicë (Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, Llabjan/Labljane dhe Bostane/Bostan (komuna e Novo Brdo/Novobërdës) dhe në to marrin pjesë shqiptarët e Kosovës. Këshillat komunalë për siguri në bashkësi nuk janë themeluar në Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc dhe Ranilug/Ranillug. Në komunën e zgjeruar rishtas të Novo Brdo/Novobërdës, këshillat komunalë për siguri në bashkësi janë themeluar zyrtarisht por nuk funksionojnë, ndonëse shqiptarët e Kosovës marrin pjesë në këshill kur ai u mbledh në vitin 2009.

Siguria dhe liria e lëvizjes e shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në komunat me shumicë serbe të Kosovës si Zubin Potokut, Leposavić/Leposaviqit dhe Zvečan/Zveçanit të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica nuk ka ndryshuar shumë prej korrikut të vitit 2009. Incidentet e gjuajtjes me gurë të shërbimit të autobusit humanitar⁵, që transportonte shqiptarët e Kosovës nga fshatrat e Koshtovës/Košutovo, Bisticës/Bistrica dhe Cerajës/Ceranje (komuna e Leposavić/Leposaviqit) në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, më 14 maj 2010 dhe më 10 qershor 2010, ka ndikuar negativisht në perceptimet e sigurisë. Sipas përfaqësuesve të komunitetit, incidentet e këtij lloji ndodhin shpesh, por nuk raportohen gjithmonë në polici. Ata theksojnë që këto akte kryhen nga ekstremistët që nuk i përfaqësojnë qëndrimet e serbëve të Kosovës të pjesës veriore të Kosovës. Komuniteti ka qasje në dy linja transporti të autobusit humanitar që lidhin vendbanimet e pjesës veriore të Mitrovica/Mitrovicës me atë jugore. Ka një prani të konsiderueshme të Policisë së Kosovës në vendbanimet e shqiptarëve të Kosovës në veri. Janë hapur tri nënstacione policore në fshatrat shqiptare të Kosovës, në komunat e Zubin Potokut, Leposavić/Leposaviqit dhe Zvečan/Zveçanit dhe në to punojnë nëntë policë shqiptarë të Kosovës: në Lipe/Lipa (Zvečan/Zveçan) tre policë, në Košutovo/Koshutovë, Bistrica/Bisticë dhe Ceranja/Cerajë (KBC) (Leposavić/Leposaviq) dy policë dhe në Çabër/Čabra (Zubin Potok) tre policë dhe një police. Komitetet lokale për siguri publike janë themeluar në vendbanimet shqiptare të Kosovës Lipe/Lipë (komuna e Zvečan/Zveçanit) dhe Çabër/Čabra (në Zubin Potok) bashkë me nënstacionet. Në janar të vitit 2010, kanë filluar diskutimet ndërmjet Policisë së Kosovës dhe komunitetit lidhur me themelimin e komitetit lokal për siguri publike që do të mbulonte vendbanimet me shqiptarë të Kosovës dhe komunitete tjera joshumicë në pjesën veriore të komunës së Mitrovica/Mitrovicës.

Situata e sigurisë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës është përkeqësuar në përgjithësi në qershor 2009 me një numër të shtuar të incidenteve të sigurisë ndërmjet komuniteteve, ku përfshihen shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës si kryerës, ashtu edhe si viktima të supozuara. Incidentet janë raportuar në Tre Rrokaqiejt/Tri

Që kur shqiptarët e Kosovës filluan rindërtimin e shtëpive të tyre në Kroin e Vitakut/Brdjani në gusht të vitit 2009, konfrontimet me banorët serbë të Kosovës kanë ndikuar negativisht në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në këtë rajon.

Në prill të vitit 2010, të rinjtë serbë të Kosovës vendosën mbishkrime me emrin e organizatës nacionaliste serbe "Obraz" në shtëpinë e përfaqësuesit të komunitetit shqiptar të Kosovës në Mitrovica/Mitrovicën Veriore, në Lagjen e Boshnjakëve. Kjo shtëpi ka qenë shënjestër e sulmeve të vazhdueshme prej vitit 1999.

⁵ Shërbimet humanitare të transportit me autobus funksionojnë nëpër tërë Kosovën dhe lidhin zonat e banuara me popullsi joshumicë. Ky shërbim, fillimisht i organizuar nga UNHCR-ja, është administruar nga UNMIK-u deri në vitin 2007 kur i është bartur Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Kosovës.

Në qershor të vitit 2010, një numër i incidenteve të sigurisë ku përfshiheshin banda të rinjve shqiptarë dhe serbë të Kosovës në Mitrovica/Mitrovicën Veriore sollën deri te një reagim me vendosmëri nga autoritetet lokale dhe udhëheqësit e komuniteteve, duke përfshirë edhe thirrje të përbashkëta për të qenë të qetë dhe për ta dënuar dhunën ndëretnike nga serbët dhe shqiptarët e Kosovës nga lagjet me përbërje të përzier etnike.

Solitera, Mikronaselje/Kodrën e Minatorëve, Suhodoll/Suvi Do (të poshtëm dhe të epërm) dhe në Lagjen e Doktorëve/Dolina Doktora dhe në zonën prej Lagjes së Boshnjakëve deri te ura kryesore mbi lumin Ibër. Për shembull, më 22 nëntor 2009, një grup i të rinjve serbë të Kosovës e gjuajtën me gurë një grua shqiptare të Kosovës dhe fëmijën e saj derisa po ecnin në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës. Sulmet e grupeve serbe të Kosovës kundër shqiptarëve të Kosovës në këtë zonë janë të shpeshta dhe përfshijnë mbishkrimet fyese, ngacmimet verbale, gjuajtjet me gurë të personave dhe/ose automjeteve, sulmet, të shtënat e rastit dhe/ose vendosjen e mjeteve eksplozive në prona private. Arrestimet janë të rralla dhe shpesh përcillen me incidente reprezaljesh, duke i mbyllur të dy komunitetet në një qark dhune që policia nuk mund ta ndalojë. Gjatë mbledhjes për siguri, të mbajtur më 13 maj 2010 dhe të kryesuar nga Administrata e UNMIK në Mitrovicë (AUM), banorët vendorë u ankuan për gjendjen e sigurisë dhe kërkuan nga policia që të veprojë në mënyrë më të fuqishme për t'i parandaluar sulmet e të rinjve serbë të Kosovës kundër shqiptarëve të Kosovës. Kthimi i vazhdueshëm i shqiptarëve të Kosovës në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, në lagjen Brdjani/Kroi i Vitakut është përballur me përlëshje të përsëritura me banorët serbë të Kosovës. Një incident serioz ndodhi më 4 janar 2010, kur punëtorët ndërtimorë shqiptarë të Kosovës u sulmuan nga një grup prej 40 serbësh të Kosovës dhe u vu në zjarr automjeti i tyre. Udhëheqësit e komunitetit u ankuan për reagimin pasiv të Policisë së Kosovës, meqë autoritetet komunale bënë thirrje për vetëpërbajtje derisa lëshuan deklaratat që shpeshherë i kontribuonin politizimit të gjendjes.

Në komunën e re të Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti shqiptar i Kosovës ka shprehur shqetësime për lirinë e lëvizjes, ndonëse nuk është raportuar për ndonjë incident të madh të sigurisë. Komiteti komunal për siguri në bashkësi nuk është themeluar ende në Gračanica/Graçanicë. Megjithatë, komuniteti është i përfaqësuar mirë në Policinë e Kosovës me 23 policë shqiptarë të Kosovës (4 police dhe 19 policë) nga gjithsej 60. Shqiptarët e Kosovës kanë marrëdhënie të mira me policinë në komunë. Shqiptarët e Kosovës nuk përballeshin me probleme të sigurisë ose kufizime të lirisë së lëvizjes në komunën e Mamuša/Mamushës/Mamuša në rajonin e Prizrenit meqë janë integruar relativisht mirë. Një polic shqiptar i Kosovës (nga gjithsej tre) punon në nënstacionin policorë të Mamuša/Mamushës/Mamuša. Deri më sot, komuna nuk e ka themeluar ende këshillin komunal për siguri në bashkësi, ndërsa komiteti lokal për siguri publike është funksional dhe në të merr pjesë edhe një përfaqësues shqiptar i Kosovës.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Brengat rreth sigurisë, mungesa e mundësive sociale-ekonomike dhe pakënaqësia me klimën aktuale politike në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës mbeten faktorët kryesorë dekurajues për kthim për shumë të zhvendosur shqiptarë të Kosovës me origjinë nga pjesët veriore të Kosovës. Në kohën e publikimit të edicionit të profileve të vitit 2009, ishte vlerësuar që rreth 7,500 shqiptarë të Kosovës nga zonat me shumicë serbe të Kosovës në rajonet e Mitrovica/Mitrovicës dhe Gjilanit/Gnjilane mbeten të zhvendosur



SHTËPIA E NJË TË KTHYERI SHQIPTAR TË KOSOVËS NË GORNJA BITINJA/BITI TË EPËRME NË KOMUNËN E ŠTRPCE/ SHTËRPECËS.

brenda Kosovës.⁶ Ndërmjet viteve 2000 – 2008, vetëm rreth 734 të kthyer nga zhvendosjet brenda dhe jashtë vendit janë regjistruar nga UNHCR,⁷ duke përfshirë këtu kthime në shkallë të vogël në zonat me shumicë shqiptare të Kosovës siç janë Lagjja e Doktorëve/Dolina Doktora në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës. Nëse këto kthime janë të qëndrueshme dhe kanë rezultuar me zgjidhje të qëndrueshme për personat në fjalë, do varet nga siguria e jashtme dhe çështjet politike. Gjendja e sigurisë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës për momentin duket veçanërisht e brishtë, me një sërë incidentesh të raportuara në vitin 2009 dhe 2010, duke ndikuar në përgjithësi në lirinë e lëvizjes dhe në riintegrimin e të kthyerve.

Në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës është duke vazhduar rindërtimi i pronave të shqiptarëve të Kosovës në Lagjen e Doktorëve/Dolina Doktora dhe në vitin 2009, dhjetë familje të zhvendosura janë kthyer në shtëpitë e tyre të sapo rindërtuara. Për më tepër, në pranverën e vitit 2009, një numër i banorëve të dikurshëm shqiptarë të Kosovës kanë filluar rindërtimin e shtëpive të tyre të shkatërruara në lagjen Brdjani/Kroi i Vitakut. Një seri e protestave të dhunshme të banorëve serbë lokalë të Kosovës dhe incidente të sigurisë e shoqëruan rindërtimin e pronave që solli deri te ndërhyrja e pranisë ndërkombëtare. Deri më sot, janë kthyer 13 familje në shtëpitë e tyre të rindërtuara rishtazi. Në zonat tjera, siç është Mikronaselje/Kodra e Minatorëve, pronat e rindërtuara rishtas kanë mbetur të zbrazëta. Gjendja e brishtë e sigurisë dhe pakënaqësia me klimën aktuale politike në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës është dekurajuese për kthim për shumicën. Shumë zhvendosje nga fshatrat e komunitetit të Zvečan/Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposavić/Leposaviqit rezultojnë nga situata sociale-ekonomike, si dhe ajo e sigurisë. Pa zhvillim ekonomik ose mundësi punësimi, ka shumë pak gjasa për kthim në këto vendbanime.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, shqiptarët e Kosovës që jetojnë në fshatrat me përbërje të përzier etnike në komunën e Štrpce/Shtërpçës janë zhvendosur në komunën fqinje të Ferizaj/Uroševac gjatë konfliktit të vitit 1999. Një numër i konsiderueshëm i tyre janë vendosur në Ferizaj/Uroševac, edhe pse shtëpitë e tyre janë

Që nga mesi i vitit 2009, numri i të kthyerve shqiptarë të Kosovës në zonat me shumicë serbe të Kosovës ka mbetur i ulët. Vetëm 86 shqiptarë të Kosovës të kthyer janë regjistruar nga UNHCR-i në vitin 2009, ndërsa në periudhën janar-prill 2010 janë kthyer 55 persona të zhvendosur.¹

7 Po aty.
1 Po aty.

rindërtuar në vitet 2002/2003. Shumë prej tyre ndihen të lënë pas dore në aspekt social-ekonomik nga institucionet qendrore dhe janë larguar nga këto fshatra për në vendbanimet urbane ku shumicë përbëjnë shqiptarët e Kosovës. Katër familje shqiptare të Kosovës janë përfshirë në projektin për kthim (janë ndërtuar 22 shtëpi) në Novo Brdo/Novobërdë si komponent balancues për komunitetin pritës. Derisa mekanizmat lidhur me kthimin funksionojnë në komunat e Novo Brdo/Novobërdës dhe Štrpce/Shtërpçës, këto komuna janë në proces të rekrutimit të zyrtarëve komunalë për kthim. Nuk janë raportuar kthime me forcë të shqiptarëve të Kosovës në ndonjë komunë ku shumicë janë serbët e Kosovës. Nuk ka ndonjë aktivitet aktual lidhur me kthimin dhe nuk është raportuar ndonjë zhvendosje domethënëse e shqiptarëve të Kosovës në komunën e Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Prishtina e as në Mamuša/Mamushë/Mamuša, në rajonin e Prizrenit. Disa largime nga Mamuša/Mamushë/Mamuša janë motivuar nga situata ekonomike.

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Komuniteti shqiptar i Kosovës që jeton si pakicë në rajonet e Gjilanit/Gnjilane dhe Mitrovicës/Mitrovica nuk i pranon institucionet komunale që dolën nga zgjedhjet lokale serbe të majit 2008, si dhe nuk i shfrytëzon shërbimet e ofruara nga këto institucione. Megjithatë, që nga qershori 2009, janë vërejtur ndryshime në komunën e Štrpce/Shtërpçës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, ku shqiptarët e Kosovës gjithashtu shfrytëzojnë shërbimet mjekësore dhe shërbimet tjera të ofruara nga qendra shëndetësore në qytetin e Štrpce/Shtërpçës dhe nga ndërmarrja e shërbimeve publike, të dyja të drejtuara nga Serbia. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti shqiptar i Kosovës në Zvečan/Zveçan, Zubin Potok dhe Leposavić/Leposaviq mund të ketë qasje në institucionet e Kosovës vetëm përmes zyrave përkatëse komunale për komunitete që financohen nga institucionet e Kosovës dhe jo nga strukturat komunale të drejtuara nga Serbia. Në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, shqiptarët e Kosovës marrin pjesë dhe e shfrytëzojnë si Administratën e UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM) (aktualisht përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve komunale për pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës), ashtu edhe komunën e Mitrovicës/Mitrovica. Komuna i shërben vetëm pjesës jugore të Mitrovicës/Mitrovica, ndonëse disa lagje në pjesën veriore ku shumicë janë shqiptarët e Kosovës gjithashtu u qasen shërbimeve përmes institucioneve në pjesën jugore.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Qasja në shërbime komunale dhe shërbime publik mbetet problematike në përgjithësi për shqiptarët e Kosovës në komunat ku përbëjnë pakicë, megjithëse kjo gjendje është relativisht më e mirë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane. Për shembull, në komunën e Štrpce/Shtërpçës, shqiptarët e Kosovës gëzojnë qasje në shërbime

komunale dhe shërbime publike. Qasja në shërbime komunale realizohet përmes nën-zyrës komunale që funksionon në fshatin Drajkovce/Drekoc. Ndërmarrja lokale për shërbime publike, e drejtuar nga Serbia i ofron shërbime komunitetit shqiptar të Kosovës në Štrpce/Shtërpçë. Në mënyrë të ngjashme, nuk ka probleme të dukshme sa i përket qasjes në shërbime komunale dhe shërbime publike në Novo Brdo/Novobërdë. Çështjet ekzistuese lidhur me kanalizimin, ujin dhe transportin ndikojnë te të gjitha komunitetet. Komunitet e reja të Ranilug/Ranillugut dhe Klokot-Vrbovac/Klllokotit-Vërbocit nuk i kanë ende mjetet për të ofruar shërbime të plota publike, ndonëse mbledhja e mbeturinave dhe shërbimet publike siç është energjia elektrike janë në dispozicion. Megjithatë, përfaqësuesit e komunitetit konsiderojnë që nuk do të ketë probleme për qasjen e komunitetit joshumicë në këto shërbime kur ato të ofrohen të gjitha.

Situata është shumë më e ndërlikuar për shqiptarët e Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës. Shqiptarët e Kosovës nga komuna e Zubin Potokut, Leposavić/Leposaviqit dhe Zvečan/Zveçanit nuk i shfrytëzojnë shërbimet komunale të ofruara nga strukturat komunale të drejtuara nga Serbia. Ata kanë qasje në shërbime komunale përmes zyrës përkatëse komunale për komunitete, ku ata pajisen me dokumente personale. Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës mund t'i marrin dokumentet personale vetëm në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Komplikime të mëturjeshme paraqiten sa i përket qasjes në shërbime publike. Për shembull, në komunën e Zvečan/Zveçanit, dy fshatrat (Boletin/Boljetin dhe Zhazhë/Žaža) furnizohen me energji elektrike nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u), ndërsa të gjitha fshatrat dhe vendbanimet tjera furnizohen nga Elektroekonomia e Serbisë (EPS). Për më tepër, në nëntor të vitit 2009, EPS filloi me leximin e njësorëve në vendbanimet e izoluara në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës siç janë Mikronaselje/Kodra e Minatorëve, Tre Rrokaqejt dhe disa pjesë të Lagjes së Boshnjakëve. Megjithatë, teknikët e EPS-së nuk shkuan në fshatrat e banuara me shqiptarë në komunat e Zvečan/Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposavić/Leposaviqit. Është inkurajuese që ekziston një sistem funksional i furnizimit me ujë dhe energji rrymë. Për më tepër, në fshatin Çabër/Čabra, në komunën e Zubin Potokut dhe fshatrat Lipë/Lipa, Boletin/Boljetin dhe Zhazhë/Žaža, në komunën e Zvečan/Zveçanit, ka infrastrukturë rrugore dhe sistem të kanalizimit. Në vendbanimin Brdjani/Kroi i Vitakut në pjesën veriore të rajonit të Mitrovica/Mitrovicës është duke u vendosur sistemi i kanalizimit. Më parë, ky vendbanim nuk ka qenë i përfshirë në planin urbanistik. Nuk është në funksion sistemi i grumbullimit të mbeturinave. Në zonat tjera të pjesës veriore të Mitrovica/Mitrovicës funksionojnë sistemet e furnizimit me ujë, energji elektrike dhe për mbledhje të mbeturinave.

Në komunën e Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština, gjendja për komunitetin joshumicë shqiptar të Kosovës është problematike. Për shembull, në fshatin Batuse/Batushë, shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës nuk kanë tension të mjaftueshëm të rrymës për të punuar pajisjet elektrike. Për më tepër, i tërë fshati (jo vetëm komuniteti shqiptar i Kosovës) nuk është i lidhur në rrjetin e furnizimit me ujë, kështu që çdo shtëpi mbështetet në puset individuale. Rrjeti kryesor i furnizimit me ujë është ndërtuar në

Procesi i bartjes së kompetencave ka çuar në një vakum të ofrimit të shërbimeve meqë administratat e komunave të reja ishin të ngadalshme në vënien në funksion të shërbimeve.

Në Mitrovica/Mitrovicën Veriore, në lagjen Brdjani/Kroi i Vitakut, bashkëpunimi ndërmjet ndërmarrjeve publike të shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës të rrymës dhe ujit për t'i shërbyer komunitetit të kthyer është inkurajues. Kohëve të fundit, ndërmarrjet e shërbimeve publike kanë filluar të mbajnë takime të regullta nën patronatin e Administratës së UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM).

vitin 2006, por si duket nuk është testuar kurrë. Një prej pompave të vendosura atëherë është vjedhur dhe nuk është zëvendësuar kurrë. Gjithashtu, cilësia e ujit nuk është testuar asnjëherë dhe rrjeti sekondar i furnizimit me ujë që duhet të lidhë çdo shtëpi në sistemin kryesor nuk është ndërtuar kurrë. Mbledhja e mbeturinave mbetet gjithashtu një problem për shumicën e fshatrave me shqiptarë të Kosovës në këtë komunë të re. Shqiptarët e Kosovës në komunën e Mamuša/Mamushës/Mamuša, në rajonin e Prizrenit kanë qasje në të gjitha shërbimet komunale dhe shërbimet publike, duke përfshirë shërbimet e regjistrimit civil.

6. Qasja në shërbime dhe mirëqenie sociale

Shqiptarët e Kosovës që janë pakicë numerike në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica dhe Prishtinës/Priština qëzojnë qasje të kënaqshme në shërbime dhe mirëqenie sociale. Gjendja në Gjilan/Gnjilane mbetet njëloj e kënaqshme. Shqiptarët e Kosovës në Novo Brdo/Novobërdë dhe Štrpce/Shtërpçë, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane vazhdojnë të qëzojnë qasje të plotë në shërbime sociale. Në komunat e reja të Ranilug/Ranillugut dhe Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit, procesi në vazhdim i bartjes të kompetencave duket të mos ketë efekt negativ në komunitet. Shqiptarët e Kosovës kryesisht shfrytëzojnë qendrat për mirëqenie sociale për të marrë ndihma familjare, pensione dhe ndihma tjera. Komuniteti ka qasje në shërbimet e tilla, në qendrat për mirëqenie sociale të vendosura në ndërtesat komunale të Štrpce/Shtërpçës dhe/ose Novo Brdo/Novobërdës dhe një nën-zyre në fshatin Brod/Brod, në njërin prej fshatrave më të mëdha të banuar me shqiptarë të Kosovës, në komunën e Štrpce/Shtërpçës. Në Ranilug/Ranillug, asnjë prej 27 familjeve shqiptare të Kosovës nuk marrin shërbime të mirëqenie sociale, ndërsa në Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, përfutjesit shqiptarë të Kosovës janë ende në listën e qendrës për mirëqenie sociale të Vitisë/Vitina. Shqiptarët e Kosovës në veri të lumit Ibër pranojnë pagesa për mirëqenie sociale përmes bankave në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Përmirësimet në lirinë e lëvizjes ua mundësojnë shqiptarëve të Kosovës që të kenë qasje në mënyrë më të lirshme në shërbime të ndihmës sociale, duke u lejuar qasje më të mirë në institucionet përkatëse. Shqiptarët e Kosovës në komunat e Zvečan/Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposavić/Leposaviqit duhet të aplikojnë aktualisht për shërbime të mirëqenies sociale përmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që gjendet në zyrat përkatëse komunale për komunitete. Shqiptarët e Kosovës në pjesët tjera të Mitrovica/Mitrovicës veriore duhet të aplikojnë drejtpërdrejt në qendrën për punë sociale në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Duke pasur parasysh atë që zbatimi i procesit të bartjes së kompetencave është ende në fazën fillestare, komuna e Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština ende nuk ka kapacitete për të ofruar ndihmën dhe shërbimet e plota sociale për banorët e saj, duke përfshirë këtu edhe shqiptarët e Kosovës. Në Mamuša/Mamushë/Mamuša, në rajonin Prizrenit, shqiptarët e Kosovës kanë qasje në shërbime sociale pa u përballur me pengesa të caktuara. Sipas të dhënave të siguruar nga zyra për mirëqenie sociale në Prizren⁸, vetëm një familje shqiptare e Kosovës merr ndihmë sociale.

8 Zyra për mirëqenie sociale në Prizren ende e mbulon komunën e Mamuša/Mamushës/Mamuaa, përkundër faktit që është nënshkruar memorandumi i mirëkuptimit për bartjen e kompetencave.

7. Qasja në pronë dhe banim

Qasja në pronë dhe banim për shqiptarët e Kosovës në komunat me shumicë serbe të Kosovës dallon shumë, prej brengave serioze të raportuara në Mitrovicë/Mitrovica, deri te qasja e plotë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, Prishtinës/Priština dhe Prizrenit. Në Gjilan/Gnjilane, të gjitha shtëpitë e shqiptarëve të Kosovës të shkatërruara gjatë konfliktit të vitit 1999 janë rindërtuar dhe pronarët e zhvendosur kanë qasje të plotë në to. Megjithatë, kjo është në kontrast të plotë me gjendjen në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, ku pjesa dërmuese e shqiptarëve të Kosovës nuk mund të ketë qasje në pronat e tyre dhe kanë mbetur të vendosur përkohësisht në pjesën jugore. Ndihma e kërkuar nga Agjencia Kosovare të Pronës ende pengohet nga vështirësitë rreth kthimit të pronës në posedim në zonat veriore të ngarkuara politikisht. Megjithëse, më 21 tetor 2009, është nënshkruar një marrëveshje e mirëkuptimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Pronës dhe Policisë së Kosovës ku përcaktohen obligimet paraprake lidhur me ndihmën e policisë në ekzekutimin e dëbimeve të uzurpuesve të paligjshëm dhe kjo solli deri te realizimi i disa dëbimeve. Shqiptarët e Kosovës që dëshirojnë t'i rindërtojnë shtëpitë e tyre të shkatërruara në vendbanimin Brdjani/Kroi i Vitakut në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës duhet të aplikojnë për leje në komunën e Zvečan/Zveçanit sepse pronat e tyre janë në zonën kadastrale të kësaj administrate. Ata e kanë bërë këtë përmes Administratës së UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM) dhe kanë marrë përgjigje pozitive nga komuna e Zvečan/Zveçanit në katër prej gjashtëmbëdhjetë kërkesave, që paraqet shembull pozitiv të bashkëpunimit ndërmjet komunitetit shqiptar të Kosovës dhe komunës së drejtuar nga Serbia. Dymbëdhjetë kërkesat tjera nuk janë zgjidhur akoma për shkak të dokumentacionit jo të plotë. Në komunat e Leposavić/Leposaviqit, Zvečan/Zveçanit dhe Zubin Potokut, shqiptarët e Kosovës nuk kanë brenge të mëdha lidhur me pronë ose banim përveç gjendjes së mjerë të shtëpive të tyre dhe pamundësisë për të paguar meremetimin e tyre. Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunën e Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština ose në komunën ku shumicë janë turqit e Kosovës të Mamuša/Mamushës/Mamuša në rajonin e Prizrenit, gëzojnë qasje të barabartë dhe të plotë në pronë dhe banim.

8. Qasja në arsim

Nxënësit shqiptarë të Kosovës që jetojnë në komunat e vjetra ku janë komunitet pakicë vazhdojnë të kenë qasje të papenguar në arsim, edhe pse mungesa e transportit të subvencionuar e pengon qasjen në arsim në disa zona. Mirëpo, themelimi i komunave të reja dhe zgjerimi i të tjerave në vitin 2010, ku komuniteti shqiptar i Kosovës tani përbën pakicë, ka pasur ndikim negativ në qasjen e këtij komuniteti në arsim.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, shqiptarët e Kosovës në komunën e Štrpce/Shtërpçës kanë qasje të plotë në arsimim në gjuhën amtare.⁹ Fëmijët prej fshatrave të largëta të Kostanjevo/Kashtanjevës, Izance/Izhancit, Viča/Viçës dhe Drajkovce/Drajkocit përballen me vështirësi

Themelimi i komunave të reja ku shqiptarët e Kosovës përbëjnë pakicë ka pasur ndikim negativ në qasjen e komunitetit në arsim.

⁹ Janë tri shkolla fillore kryesore, tri paralele të shkollës fillore dhe një shkollë e mesme, që funksionojnë në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Shumica e shkollave janë rindërtuar dhe pajisur pas konfliktit të vitit 1999.

SHKOLLË FILLORE E SHQIPTARËVE TË KOSOVËS KU MËSIMI ZHVILLOHET NË KONTEJNERË NË VENDBANIMIN MIKRONASELJE/KODRA E MINATORËVE NË PJESËN VERIORE TË MITROVICËS/ MITROVICA, KU 18 DJEM DHE 13 VAJZA VIJOJNË MËSIMIN PREJ KLASËS SË PARË DERI NË TË NËNTËN.



të mëdha për qasje në arsimim. Nxënësit e klasës së gjashtë dhe të nëntë detyrohen të ecin për çdo ditë nga një deri në tri kilometra për të shkuar në shkollë në Firajë/Firaja, që është veçanërisht e vështirë gjatë sezonit të dimrit. Në Novo Brdo/Novobërdë, fëmijët e komunitetit shqiptar të Kosovës gëzojnë qasje të papenguar në arsim.¹⁰ Në komunën e re të Ranilug/Ranillugut, nuk ka shkollë që do t'i plotësonte nevojat e komunitetit shqiptar të Kosovës. Nxënësit shkojnë në shkollë ose në Kamenicë/Kamenica ose në Gjilan/Gnjilane. Nuk ka transport të organizuar në dispozicion për këta nxënës pasi që është vështirë të bëhet organizimi për një numër aq të vogël të fëmijëve. Në shkurt të vitit 2010, kuvendi komunal i Ranilug/Ranillugut dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë pranuan një kërkesë nga përfaqësuesit e komunitetit në komunë për mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit për fëmijë. Megjithatë, kurrfarë përgjigje nuk është marrë për këtë çështje. Përfundimisht, në komunën e re të Klokot-Vrbovac/Klokotit-Vërbocit, fëmijët shqiptarë të Kosovës vijnë në mësimin në shkollat fillore në fshatrat Mogills/Mogila dhe Klokot/Klllokot, por u duhet të udhëtojnë jashtë komunës për të vijuar arsimin e mesëm.¹¹

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, shqiptarët e Kosovës që jetojnë në tri komunat e pjesës veriore të Leposavić/Leposaviqit, Zvečan/Zveçanit dhe Zubin Potokut kanë në dispozicion vetëm objektet shkollore të arsimit fillor sipas kurrikulës në gjuhën shqipe. Në Boletin/Boljetin dhe Zhazhë/Žaža (Zvečan/Zveçan), 30 djem dhe 18 vajza vijnë në arsimimin fillor në gjuhën shqipe; në Bistricë/Bistrica (Leposavić/Leposaviq), gjashtë djem dhe 13 vajza; në Çabër/Čabra (Zubin Potok) 75 djem dhe 77 vajza; dhe në Mikronaselje/Kodrën e Minatorëve (pjesa veriore e Mitrovica/Mitrovicës) 18 djem dhe 13 vajza. Të gjithë, përfundimisht duhet të udhëtojnë në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica për të pasur qasje në arsimin e mesëm në gjuhën shqipe, ndërsa nuk parashihet ndonjë përgatitje për subvencionim ose mbështetje të transportit në komunat e drejtuara nga Serbia, ku këta nxënës jetojnë. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës nuk ka arritur të gjejë ende zgjidhje alternative dhe të qëndrueshme për transport falas ose të subvencionuar. Sipas drejtorëve të shkollave, nuk ka raste

10 Fëmijët nga fshatrat e zonave të reja kadastrale vazhdojnë, megjithatë, të shkojnë në shkollën e mesme në komunën e Gjilan/Gnjilane.

11 Si pasojë, fëmijët shkojnë në shkollën e Pozheranit/Pozaranje (Viti/Vitina).

të braktisjes së shkollimit në fshatrat ku shumicë janë shqiptarët e Kosovës në komunat e pjesës veriore të Kosovës. Në rajonin e Prishtinës/Priština, shkollimi për fëmijët shqiptarë të Kosovës nuk është brengë e komunës së re të Gračanica/Graçanicës. Mungesa e transportit mbetet pikë e kontestueshme, megjithatë, dhe fëmijët duhet të shkojnë në çerdhe të fëmijëve në komunën fqinje të Lipjanit/Lipljan.¹² Në rajonin e Prizrenit, komuniteti shqiptar i Kosovës ka qasje si në nivelin parashkollor, ashtu edhe në arsim fillor në gjuhën amtare në komunën e Mamuša/Mamushës/Mamuša. Megjithatë, nuk ka shkollë të mesme ku ofrohet mësim në gjuhën shqipe dhe nxënësit shqiptarë të Kosovës, pas përfundimit të shkollës fillore, duhet ta vazhdojnë arsimin e mesëm në Prizren. Një klasë e arsimit parashkollor për plotësimin e nevojave të komunitetit është formuar në vitin shkollor 2009/10.¹³

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Shqiptarët e Kosovës nuk ndihen të qetë për t'i shfrytëzuar shërbimet e financuara nga Serbia dhe shpeshherë udhëtojnë në zonat ku shumicë janë shqiptarët e Kosovës për të pasur qasje në to. Kjo gjë ndodh veçanërisht në rastet lidhur me qasjen në mjekësinë familjare dhe reproduktive, që ka ndikim veçanërisht te gratë shqiptare të Kosovës që jetojnë si pakicë.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, në zonat ku ky komunitet jeton si pakicë, ata mbështeten kryesisht në shërbimet e Kosovës që janë në dispozicion në komunat fqinje ku shumicë janë shqiptarët e Kosovës. Përrjashtim është Novo Brdo/Novobërda, ku kujdesi shëndetësor primar i financuar nga Kosova është në dispozicion në fshat, dhe Štrpce/Shtërpçëja, ku banorët shqiptarë të Kosovës gjithashtu shfrytëzojnë shërbimet e kujdesit shëndetësor primar të financuara nga Serbia. Në Novo Brdo/Novobërdë, strukturat shëndetësore nuk janë të kënaqshme, ndërsa shqiptarët e Kosovës duhet të udhëtojnë deri në spitalin e Gjilanit/Gnjilane në rast të emergjencave ose rasteve tjera serioze. Ata shfrytëzojnë shërbimet e kujdesit shëndetësor sekondar që i ofron komuna e Ferizajit/Uroševac, spitalin rajonal të Gjilanit/Gnjilane dhe Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës/Priština. Shqiptarëve të Kosovës që jetojnë në Klokot-Vrbovac/Klllokot-Vërboc u ofrohet kujdesi shëndetësor primar në qendrën kryesore të mjekësisë familjare në komunën e Vitisë/Vitina. Në Ranilug/Ranillug, ekziston vetëm një klinikë për kujdes shëndetësor e drejtuar nga Serbia. Sipas udhëheqësit të fshatit, shqiptarëve të Kosovës u duhet të udhëtojnë në Kamenicë/Kamenica për kujdes shëndetësor. Kujdesi preventiv i rregullt për shqiptarët e Kosovës në Štrpce/Shtërpçë, siç është programi për imunizim, ofrohet në institutin rajonal për shëndet publik në Ferizaj/Uroševac, të cilin komuniteti e preferon më shumë se qendrën e kujdesit shëndetësor të Štrpce/Shtërpçës të drejtuar nga Serbia. Një masë e kujdesit shëndetësor primar dhe sekondar ofrohet në Štrpce/Shtërpçë, ku përveç qendrës shëndetësore të drejtuar nga Serbia, janë edhe dy klinika shëndetësore në fshatin e përzier të Drajkovce/Drajkocit dhe në fshatin Brod/Brod të banuar me shqiptarë të Kosovës, ku ofrohet kujdes shëndetësorë primar për komunitetin.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, në klinikën Bistrica/Bistrica në Leposavić/Leposaviq, ka një infermiere, ndërsa mjeku kryen vizita dy herë në muaj. Në Çabër/Čabra dhe Zubin Potok, janë dy infermiere dhe mjeku kryen vizita dy herë në javë.

12 Komuniteti shqiptar i Kosovës e percepton mungesën e transportit si diskriminim dhe pohon që komuna e Gračanica/Graçanicës e kundërshton qëllimisht sigurimin e transportit për fëmijët në fshatrat e banuara me shqiptarë të Kosovës.

13 Mësimdhënësi i caktuar, megjithatë, nuk është buxhetuar dhe ndonjëherë i merr pagat me vonë.

Shqiptarët e Kosovës në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës shkojnë në pjesën jugore të saj për t'i shfrytëzuar shërbimet e qendrës shëndetësore dhe spitalit. Në qendrat e kujdesit shëndetësor të Kosovës në fshatrat ku shumicë janë shqiptarët e Kosovës si Zvečan/Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposavić/Leposaviqi ofrohen shërbime të kufizuara për qëndrim ditor. Për shembull, nuk ka asnjë infermiere në klinikën e Bisticës/Bistrica në komunën e Leposavić/Leposaviqi, ndërsa mjeku e viziton këtë klinikë dy herë në muaj. Në Çabër/Čabra në komunën e Zubin Potokut janë dy infermiere dhe mjeku realizon vizita dy herë në javë. Në Gračanica/Graçanicë në rajonin e Prishtinës/Priština, shqiptarët e Kosovës në përgjithësi preferojnë t'i qasen shërbimeve shëndetësore të Kosovës dhe shkojnë rrallë në spitale e mbështetura nga Serbia, përveç në raste të problemeve të rënda shëndetësore. Disa e vizitojnë shtëpinë rajonale të shëndetit në Gračanica/Graçanicë, të mbështetur nga Serbia, për shkak të afërsisë gjeografike me vendbanimet e tyre. Gratë shqiptare të Kosovës, në parim kanë qasje të plotë në shëndetin riprodhues. Megjithatë, për shkak të barrierave kulturore, ndodh të mos i shfrytëzojnë shërbimet e mbështetura nga Serbia. Në komunën ku shumicë janë turqit e Kosovës të Mamuša/Mamushës/Mamuša në rajonin e Prizrenit, komuniteti shqiptar i Kosovës ka qasje të barabartë në shërbime shëndetësore. Për momentin, katër shqiptarë të Kosovës punojnë në shtëpinë e shëndetit (ambulantën) të Mamuša/Mamushës/Mamuša, që ua mundëson atyre të flasin shqip me punëtorët shëndetësorë. Shtëpia e shëndetit, në anën tjetër, ka numër të vogël të personelit dhe përballat me mungesë të pajisjeve mjekësore që ka ndikim në ofrimin e shërbimeve për të gjitha komunitetet në Mamuša/Mamushë/Mamuša.

10. Qasja në drejtësi

Siç është raportuar në edicionin e profileve të vitit 2009, shqiptarët e Kosovës që jetojnë si pakicë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane vazhdojnë të kenë qasje të papenguar në drejtësi. Ata që jetojnë në komunat e reja të Ranilug/Ranillugut dhe Klokot-Vrbovac/Klllokotit-Vërbocit ende duhet të shkojnë në komunat fqinje të Kamenicës/Kamenica dhe Vitisë/Vitina për këtë. Komuna e Novo Brdo/Novobërdës është nën juridiksionin e gjykatës komunale të Prishtinës/Priština dhe komuniteti shqiptar i Kosovës ka qasje të plotë në gjykata dhe shërbime gjyqësore. Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në Štrpce/Shtërpçë kanë qasje të plotë në drejtësi meqë gjykata në Štrpce/Shtërpçë është nëndegë e gjykatës komunale të Ferizajit/Uroševac.

Gjendja në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës dhe komunat veriore është sfiduese prej shkurtit të vitit 2008, kur gjykata në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës e ndërpreu punën. Nuk funksionon kurrfarë gjykatë komunale ose për kundërvajtje në komunat veriore të Zubin Potokut dhe Leposavić/Leposaviqit. Gjykata e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica vazhdon të funksionojë me kapacitet të kufizuar në objektet e gjykatës komunale në Vushtrri/Vučitrn, ku aktualisht i mban seancat gjyqësore për paraburgim, konfirmon aktakuzat në rastet kur të pandehurit mbahen në paraburgim apo i nënshtrohen masave alternative për sigurinë e pranisë së tyre

në procedura. Gjykata e Qarkut gjithashtu lëshon vendime për rastet e shkurorëzimit dhe kërkesa për njohjen e aktgjykimeve të huaja. Për më tepër, ajo nxjerr vendime për rastet e ankesave civile. Gjykata komunale në Mitrovicë/Mitrovica (që mbulon pjesën veriore dhe jugore të Mitrovicës/Mitrovica dhe Zvečan/Zvečanin) gjithashtu vepron me kapacitet të kufizuar në Vushtrri/Vučitrn, ku merret me raste urgjente dhe ofron shërbime themelore juridike në masë miniMashkull. Prokuroria e qarkut kryen të gjitha punët, duke përfshirë ngritjen e aktakuzës dhe pjesëmarrjen në seancën e konfirmimit të saj. Prokurorët publik komunalë kryejnë të gjitha punët, ngritjen e aktakuzës dhe pjesëmarrjen në seancën e konfirmimit të saj dhe në gjykime. Në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk është evidentuar kurrfarë diskriminimi ose trajtimi i pabarabartë i shqiptarëve të Kosovës sa i përket qasjes në drejtësi dhe komuniteti nuk përballlet me kufizime për qasje në gjykatën komunale në Prishtinë/Priština, e cila vepron gjithashtu në Gračanica/Graçanicë. Në Mamuşa/Mamushë/Mamuša nuk ka institucione të drejtësisë, prandaj shqiptarët e Kosovës, si të gjithë banorët e komuniteteve tjera në komunë, kanë qasje në shërbime juridike në komunën e Prizrenit.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Në përgjithësi, komuniteti shqiptar i Kosovës si pakicë përfaqësohet plotësisht dhe në mënyrë të drejtë në organet vendimmarrëse, përveç në komunat e pjesës veriore ku mbeten të izoluar dhe kanë pak ose aspak përfaqësim në çështjet publike jashtë fshatrave të tyre. Në rajonin e Gjilan/Gnjilane, me themelimin e komunave të reja dhe ristrukturimin komunal pas zgjedhjeve të nëntorit 2009, kanë ndodhur ndryshime domethënëse që ndikojnë në pjesëmarrjen e shqiptarëve të Kosovës që jetojnë si pakicë, duke paraqitur si sfida, ashtu edhe mundësi të reja për pjesëmarrjen e tyre.

Komuniteti shqiptar i Kosovës që jeton si pakicë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, përfaqësohet tërësisht dhe në mënyrë të drejtë përmes zyrtarëve të zgjedhur në të gjitha organet vendimmarrëse, siç është kuvendi komunal dhe komitetet e tij, bordi i drejtorëve dhe administrata komunale. Komuniteti përfaqësohet në numër të mirë në të gjitha kuvendet e komunave ku ata përbëjnë pakicë, duke përfshirë këtu edhe komunën e re të Ranilug/Ranillugut. Ndonëse aty nuk jetojnë më shumë se 40 shqiptarë të Kosovës, komuniteti e ka siguruar pozitën e nënkryetarit të komunës për komunitete, drejtorit për ekonomi dhe financa dhe një post në shërbimin civil. Për më tepër, komuniteti shqiptar i Kosovës përfaqësohet përmes nënkryetarit të komunës për komunitete në të gjitha komunat ku ata përbëjnë pakicë dhe përmes zëvendëskryesuesit të kuvendit komunal për komunitete në Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc dhe `trpce/Shtërpçë. Në këtë të fundit, shqiptarët e Kosovës mbajnë dhjetë prej 19 ulëseve të zgjedhura të kuvendit komunal, tri prej shtatë pozitive të drejtorëve, nënkryetarit për komunitete, zëvendëskryesuesin e

Zgjedhjet lokale në nëntor të vitit 2009 e zhblllokuan situatën e kuvendit komunal dhe komiteteve të tij në `trpce/Shtërpçë. Më parë, kuvendi nuk mund ta formonte kuorumin për shkak të abstenimit të vazhdueshëm të një numri të pjesëtarëve serbë të Kosovës. Tani, kjo komunë funksionon për herë të parë prej viti 2007.

Në Štrpce/Shtërpçë, një grup i grave serbe dhe shqiptare të Kosovës të udhëhequra nga nënkryetari dhe mbështetur nga OSBE-ja, kanë themeluar një grup joformal të gruas, që ka për qëllim ta nxisë pjesëmarrjen e gruas në jetën publike dhe promovimin e barazisë gjinore.

kuvendit komunal për komunitete dhe pozitën e kryesuesit të zyrës komunale për komunitete. Në Novo Brdo/Novobërdë, kryetari, nënkryetari dhe gjashtë prej dhjetë drejtorëve janë shqiptarë të Kosovës. Komuniteti shqiptar i Kosovës gjithashtu përfaqësohet në komitetet komunale për komunitete në tërë rajonin. Megjithatë, këshillat komunale për siguri në bashkësi duhet të themelohen në komunat ku komuniteti përbën pakicën. Komuniteti shqiptar i Kosovës, në anën tjetër, merr pjesë në mbledhjet e komiteteve lokale për siguri publike, që mbahen në fshatin e banuar me serbë të Kosovës të Vrbovac/Vërbocit, në komunën e re të Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit. Gati të gjitha mediat në gjuhën shqipe që mbulojnë Kosovën janë në dispozicion në Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc, Novo Brdo/Novobërdë dhe Ranilug/Ranillug. Megjithatë, nuk është e vendosur ndonjë media lokale elektronike ose e shkruar dhe asnjëri prej tre transmetuesve që mbulojnë Kosovën (RTK, TV21, KTV) nuk e mbulojnë edhe komunën e Štrpce/Shtërpçës. Për më tepër, nuk ka në dispozicion TV lokale ose media të shkruara në gjuhën shqipe. Gratë janë relativisht aktive në komunitet në të gjitha komunat e përmendura; ato përbëjnë 37 për qind të deputetëve të kuvendit komunal dhe 33 për qind të anëtarëve në komitetet për komunitete.

Ka pjesëmarrje të ulët të shqiptarëve të Kosovës në çështjet publike jashtë fshatrave të tyre në komunat e pjesës veriore të Kosovës nga ana. Ata nga pjesa veriore e qytetit të Mitrovica/Mitrovicës marrin pjesë në përgjithësi në çështjet publike vetëm në pjesën jugore të qytetit. I vetmi përfaqësues shqiptar i Kosovës i zgjedhur¹⁴ në veri të lumit Ibër është zëvendëskryesuesi shtesë i kuvendit komunal të Zubin Potokut. Zëvendëskryesuesi shtesë e ruan një baraspeshë të ndjeshme në punën me kuvendin komunal të dalë nga zgjedhjet e organizuara nga Serbia në maj të vitit 2008, dhe siguron të drejtat e komunitetit shqiptar të Kosovës në fshatin Çabër/abra. Përveç kësaj, zyra komunale për komunitete përbën mekanizmin përfaqësues kryesor për komunitetin shqiptar të Kosovës në veri të lumit Ibër. Zyra komunale për komunitete i përgjigjet drejtpërdrejt ministrive kompetente dhe vepron e izoluar nga strukturat komunale të dala nga zgjedhjet lokale të organizuara nga Serbia në maj të vitit 2008. Lidhur me këtë dhe për faktin që personeli i zyrës komunale për komunitete perceptohet shpeshherë si shërbyes civil të rangut të ulët dhe jo zyrtarë të zgjedhur, shqiptarët e Kosovës ankohen rregullisht që zyra komunale për komunitete dështon t'i plotësojë nevojat e komiteteve. Komuniteti shqiptar i Kosovës në komunat e pjesës veriore ka qasje të kufizuara në mediat lokale elektronike dhe të shkruara në gjuhën shqipe. Mediat elektronike që e mbulojnë tërë Kosovën (RTK, RTV 21 dhe KTV) janë në dispozicion të shqiptarëve të Kosovës, të cilët jetojnë në fshatrat e Zubin Potokut, Zvečan/Zveçanit dhe pjesës veriore të Mitrovica/Mitrovicës. Në komunën e Leposavić/Leposaviqit, shqiptarët e Kosovës kanë qasje në media elektronike vetëm përmes lidhjes satelitore. Sa i përket mediave të shkruara, komuniteti ka qasje në gazeta, ndonëse me gjysmë ose deri në një ditë vonesë.

Në komunën e re të Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština, shqiptarët e Kosovës përfaqësohen me një anëtar në organin legjislativ dhe një në komitetin për komunitete, duke e

14 Zëvendëskryesuesi shtesë i kuvendit komunal është zgjedhur në zgjedhjet komunale në tetor të vitit 2002 sipas dispozitave të Rregullores së UNMIK-ut 2000/45.

pasqyruar praninë e tyre miniMashkull në komunë. Kryetari serb i Kosovës i komunës ka treguar qasje pozitive ndaj komunitetit, duke organizuar fushata informimi në fshatrat e banuara me shqiptarë të Kosovës. Përveç tri radio dhe TV stacioneve të mëdha (media elektronike të vendosura në Prishtinë/Priština) që transmetojnë në tërë Kosovën, mediat lokale nuk transmetojnë në gjuhën shqipe. Për më tepër, nuk ka asnjë media lokale të shkruar në gjuhën shqipe në Gračanica/Graçanicë. Në komunën me shumicë dërmuese turke të Kosovës të Mamu_a/Mamushës/Mamuaa në rajonin e Prizrenit, komuniteti shqiptar i Kosovës është i integruar dhe i përfaqësuar mirë. Komuniteti ka dy ulëse në kuvendin komunal dhe postin e nënkryetarit për komunitete. Ai përfaqësohet në komitetin komunal për komunitete dhe mban 23% të posteve të shërbimit civil në komunë.¹⁵ Komuniteti shqiptar i Kosovës ka qasje si në mediat elektronike, ashtu edhe në ato të shkruara në gjuhën e tyre amtare.

12. Përdorimi i gjuhës

Komuniteti shqiptar i Kosovës është i lirë në përgjithësi që të përdorë gjuhën e vet si privatisht ashtu edhe në publik në vendet ku përbën pakicë. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti shqiptar i Kosovës e përdor lirshëm gjuhën amtare në hapësirat publike, dyqane ose në qasje në shërbime komunale ose publike në të gjitha komunat ku përbëjnë pakicë. Këtu përfshihen komuna e `trpce/Shtërpçës dhe komuna e zgjeruar e Novo Brdo/Novobërdës dhe komunat e reja të Klokot-Vrbovac/Kllkotit-Vërbocit dhe Ranilug/Ranillugut. Për dallim, në komunat e pjesës veriore të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica, shqiptarët e Kosovës kanë liri të kufizuar të lëvizjes dhe përdorin gjuhën amtare vetëm në vendet e tyre të banimit. Komuniteti më parë udhëton në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica sesa të shfrytëzojë shërbimet e ofruara nga komunat veriore të drejtuara nga Serbia. Si rrjedhim, është vështirë të vlerësohet përdorimi i mundshëm i gjuhës shqipe në institucionet lokale dhe hapësirat publike.

Në komunën e re të Gračanica/Graçanicës në rajonin e Prishtinës/Priština, shqiptarët e Kosovës ndihen të lirë ta përdorin gjuhën e tyre haptas. Komuna, megjithatë, duhet të miratojë dispozita për ta siguruar përdorimin e gjuhës në takimet komunale dhe lëshimin e dokumenteve zyrtare në gjuhën shqipe. Komuna, ende nuk ka themeluar njësinë për përkthim. Shenjat topografike dhe të rrugëve janë si në gjuhën serbe ashtu edhe në atë shqipe. Logoja e komunës, në anën tjetër, është e shkruar vetëm me shkronjat cirilike dhe në të paraqitet manastiri i Gračanica/Graçanicës. Në rajonin e Prizrenit dhe më saktësisht, në komunën e banuar me shumicë turke të Kosovës të Mamu_a/Mamushës/Mamuaa, komuniteti shqiptar i Kosovës ndihet i lirë ta përdorë gjuhën shqipe në sferën private dhe publike. Dokumentet për publikun e gjerë lëshohen në të gjitha gjuhët zyrtare, siç janë pjesa dërmuese vendimeve komunale, ndonëse me pak vonesë.¹⁶ Gjithashtu, sigurohet përkthimi gjatë seancave publike. Megjithatë, pjesa dërmuese e mbishkrimeve publike janë vetëm në gjuhën turke dhe shqipe. Sidoqoftë, sigurimi i përkthimit në gjuhët tjera nga ajo turke është duke përparuar vazhdimisht.

Në komunën e re të Gračanica/Graçanicës, dygjuhësia respektohet në shenjat topografike dhe të rrugëve, por jo në logon që është me shkronja qirilike.

¹⁵ Në administratën komunale, pesë prej 33 shërbyesve civil të administratës komunale (15.5%); në sektorin e shëndetësisë, katër prej 16 shërbyesve civilë (25%); dhe në sektorin e arsimit, 12 prej 56 shërbyesve civilë (21%) janë shqiptarë të Kosovës.

¹⁶ Komuna punëson vetëm një përkthyes.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Në logon e komunës së re të Gračanica/Graçanicës paraqitet manastiri ortodoks me të njëjtin emër, për të cilin komuniteti shqiptar i Kosovës pohon që nuk e pasqyron identitetin e tij kulturor ose fetar.

Në përgjithësi, nuk ka probleme lidhur me gëzimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare për shqiptarët e Kosovës që jetojnë në komunat ku përbëjnë pakicë. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, në zonat ku shqiptarët e Kosovës janë komunitet joshumicë, nuk ka ndonjë objekt të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Shqiptarët e Kosovës janë të lirë ta shprehin besimin e tyre fetar dhe kulturor dhe t'i praktikojnë ceremonitë fetare. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, është një objekt i një rëndësie të veçantë për shqiptarët e Kosovës, i vendosur në komunën e Zvečan/Zveçanit. Një kullë është shndërruar në qendër memoriale për Isa Boletinin, luftëtar shqiptar i Kosovës i lirisë nga fshati Boletin/Boljetin, i cili fitoi lavdinë në luftën për pavarësinë e Shqipërisë në vitin 1912. Një objekt tjetër i rëndësishëm është xhamia e ndërtuar në vitin 1778 nga Otomanët që gjendet në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, i vetmi objekt i tillë në pjesën veriore dhe xhamia më e vjetër në rajon. Kjo xhami është shkatërruar në vitin 1999 dhe është bërë objekt diskutimi ndërmjet përfaqësuesve shqiptarë të Kosovës, të mbështetur nga Bashkësia Islame e Mitrovicës/Mitrovica, dhe përfaqësuesve të UNMIK-ut. Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM) ka treguar rishtas shenja konsiderate për lejimin e rindërtimit të saj, pasi që Bashkësia Islame ka dorëzuar kërkesën përmes përfaqësuesit shqiptar të Kosovës të Lagjes së Boshnjakëve. Paraqitësit e kërkesës janë në pritje të përgjigjes nga AUM.

Shqiptarët e Kosovës që jetojnë në Gračanica/Graçanicë në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk ndihen të sigurt për t'i festuar festat ose ceremonitë e tyre tradicionale kur duhet të shfaqen publikisht emblemat ose flamuri. Në komunë nuk ka ndonjë vend tjetër të rëndësishëm kulturore ose fetare të shqiptarëve të Kosovës. Komuniteti mund të ushtrojë dhe praktikojë lirshëm besimin e tyre fetar në komunën e Mamu_a/Mamushës/Mamuaa në rajonin e Prizrenit meqë janë të fesë islame sikur edhe popullsia shumicë turke. Nuk ka

VARREZA TË MYSLIMANËVE NË PJSËN VERIORE TË MITROVICËS/MITROVICA, KU JANË TË VARROSUR SHUMË SHQIPTARË TË KOSOVËS QË KISHIN JETUAR NË VERI. ATO I SHFRYTËZOJNË GJITHASHTU EDHE KOMUNITETET TJERA TË BESIMIT ISLAM, DUKE PËRFSHIRË KËTU EDHE BOSHNJAKËT E KOSOVËS.





“KULLA”, PËRKUJTIMORE PËR ISA BOLETININ, SHQIPTAR I KOSOVËS LUFTËTAR I LIRISË NGA FSHATI BOLETIN/BOLJETIN I KOMUNËS SË ZVEÇAN/ZVEÇANIT NË RAJONIN E MITROVICËS/MITROVICA, I NJOHUR PËR PËRFSHIRJEN E TIJ NË LUFTËN PËR PAVARËSI TË SHQIPËRISË NE VITIN 1912.

ndonjë objekt të rëndësishë së veçantë të trashëgimisë kulturore për shqiptarët e Kosovës në këtë zonë. Shqiptarët e Kosovës falen në xhamitë e njëjta si komuniteti turk i Kosovës dhe rom që jetojnë në Mamuša/Mamushë/Mamuša. Në këtë komunë, shqiptarët e Kosovës i festojnë lirshëm festat që lidhen me komunitetin.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës që jetojnë si pakicë numerike dhe komuniteteve shumicë dallojnë varësisht nga realiteti gjeografik dhe politik në atë vend. Në rajonet e Gjilanit/Gnjilane, Prishtinës/Priština dhe Prizrenit, marrëdhëniet janë të mira, ndërsa në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, këto marrëdhënie janë të tendosura.

Për shembull, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, përkundër mospajtit të shqiptarëve të Kosovës për bartje të kompetencave që i ktheu ata në pakicë numerike në komunat me shumicë serbe të Kosovës të Ranilug/Ranillugut, Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërbocit dhe Novo Brdo/Novobërdës, marrëdhëniet kanë mbetur të mira. Ekziston ndërveprim i shpeshtë ndërmjet komuniteteve në vende publike dhe bashkëpunim në sektorin e biznesit. Në `trpce/Shtërpçë, angazhimi i kryetarit serb të Kosovës të komunës të zgjedhur rishtas për t'i normalizuar veprimtaritë e komunës dhe për ta zhbllokuar situatën ndërmjet zyrtarëve shqiptarë të Kosovës dhe të strukturave të mbështetura nga Beogradi kanë kontribuar në përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve. Në Novo Brdo/Novobërdë, marrëdhëniet janë të mira, me ndërveprim ditor në vende publike dhe dialog të drejtpërdrejt ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Të dy komunat drejtohen dhe kanë personel si nga pala shqiptare, ashtu edhe nga ajo serbe, që ka efekt stabilizues shtesë. Shembujt e mirë të ndërveprimit për mirëqenien e të gjithëve janë tregu i gjelbër shumetnik dhe qendra e rrëshqitjes me ski në komunën e `trpce/Shtërpçës, si dhe këshillat ekzistues shumetnik të

Mbledhja e parë e komitetit për komunitete të komunës së KlokotVrbovac/ Kllokotit-Vërbocit është mbajtur më 4 qershor 2010, gjatë së cilës kryetari serb i Kosovës i komunës deklaroi mbështetjen e tij për zbatimin e nismave për t'i bërë bashkë të rinjtë serbë dhe shqiptarë të Kosovës të kësaj komune dhe për ta mbështetur bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve.

TRE RROKAQIEJT/TRI SOLITERA, LAGJE SHUMETNIKE NË PJSËN VERIORE TË MITROVICËS/MITROVICA KU SHQIPTARËT E KOSOVËS BANOJNË NË MESIN E KOMUNITETEVE TJERA DHE KANË MARRËDHËNIE TË MIRA ME TO PËRKUNDËR AFËRSISË SË LAGJES ME URËN KU NDODHIN SHPESHHERË ZËNKA NDËRMJET TË RINJVE SHQIPTARË TË KOSOVËS DHE SERBË TË KOSOVËS.



disa fshatrave më përbërje të përzier etnike në rajon, ku shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet tjera bashkëpunojnë përzemërsisht. Nismat e caktuara për mbështetjen e dialogut ndërmjet komuniteteve mbeten për t'u realizuar në administratat ekzistuese ose të porsaformuara të komunave.

Shembull i mirë i dialogut ndërmjet komuniteteve është Qendra për resurse e gruas në lagjen Mikronaselje/Kodra e Minatorëve në Mitrovica/Mitrovicën Veriore. Kjo qendër bashkon gratë shqiptare, serbe dhe të tjera të Kosovës për të vijuar trajnime profesionale dhe për të realizuar aktivitete të përbashkëta. Kjo qendër është mbështetur nga OSBE-ja gjatë viteve 2008 dhe 2009, dhe vazhdon të funksionojë në vitin 2010.

Në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës bashkëpunojnë në kuadër të parametrave institucionalë të Administratës së UNMIK-ut në Mitrovicës (AUM), dhe dialogu, si i tillë, mbahet në takime dhe forume të rregullta. Marrëdhëniet ndërmjet dy komuniteteve, megjithatë, mbeten të tendosura, me incidente gjithnjë më të shpeshta të sigurisë që i vendosin komunitetet në anë të kundërta. Në komunat e pjesës veriore të Leposavi /Leposaviqit, Zubin Potokut dhe Zvečan/Zveçanit, bashkëpunimi i kufizuar ndërmjet institucioneve të drejtuara nga Serbia dhe përfaqësuesve shqiptarë të Kosovës e pengon dialogun më të gjerë ndërmjet komuniteteve. Largësia fizike e vendbanimeve të banuara me shqiptarë të Kosovës dhe liria e kufizuar e lëvizjes nuk e lehtëson dialogun e drejtpërdrejtë ndërmjet komuniteteve. Në Gračanica/Graçanicë në rajonin e Prishtinës/Priština, procesi i bartjes së kompetencave duket të mos ketë pasur efekt negativ në marrëdhëniet ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Kryetari i porsazgjedhur serb i Kosovës i komunës angazhohet për t'iu qasur shqiptarëve të Kosovës, që është një tregues i mirë. Në Mamu_a/Mamushë/Mamuaa (rajoni i Prizrenit), dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet shqiptarëve të Kosovës, turqve të Kosovës dhe komuniteteve tjera në komunë është i mirë.

Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit



Tabela 1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti shqiptar i Kosovës
Gjilan/Gnjilane	Klokot-Vrbovac/ Kllokot-Vërboc	Klokot/Kllokot, Mogillë/Mogila
	Novo Brdo/ Novobërdë	Novo Brdo/Novobërdë, Vllasali/Vlasce, Bunjak/Bunjaci, Llabjan/Labljane, Koznic/Koznica (Lagjja Llabjan/Labljane), Baçëvisht/Baçevište (Lagjja Llabjan/Labljane), Izvor/Izvor, Zebince/Zebincë, Manišince/Manishincë, Bostane/Bostan, Bostane/Bostan (Lagjja Çuljkoc), Trnjiçevce/Tërniqec, Carevce/Carevc, Jasenovik/Jasenovik, Boljevce/Bolec, Kllobukar/Klobukar, Jasenovik/Jasenovik (Lagjja Tulare), Stanišor/Stanishor, Straža/Strazhë, Paralovo/Parallovë, Koretište/Koretishtë, Pasjak/Pasjak, Gornje Kusce/Kufcë e Epërme, Gornje Kusce/Kufcë e Epërme (Lagjja Melci/Melc), Mozgovo/Mozgovë, Gornji Makreš/Makresh i Epërm , Donji Makreš/Makresh i Ultë , Draganac/ Dragancë, Bušince/Bushincë, Tirince/Tirincë, Miganovce/Miganoc.
	Ranilug/ Ranillug	Crep/Crepana, Lagjja Dubovë/Dubova (fshati Drenovce/Drenoc), Lagjja Muhaxhiri (fshati Përlepnicë/Prilepnica)
	Štrpce/ Shtërpçë	Gornja Bitinja/Biti e Eperme, Donja Bitinja/Biti e Poshtme, Sušice/Sushicë, Viča/Viçë lžance/lzhacë, Drajkovce/Drajcoc, Firajë/Firaja, Brod/Brod, Koštanjevo/Kashtanjevë
Mitrovicë/Mitrovica	Leposaviç/ Leposaviq	Koshtovë/Košutovo, Bistricë/Bistrica, Cerajë/Ceranje
	North Mitrovicë/ Mitrovica	Bosniak Mahalla, Tre rrokaqiejt/Tri solitera (Three Towers), Mikronaselje/Kodra e Minatorëve, Suhadoll/Suvi Do dhe rrethina, Lagja e Doktorëve/Dolina Doktora (Doctors' Valley), Brdjani/Kroi i Vitaku, "7 Shtatori" , Vidimriq/Vidomirić, Gushac/Guševec, Vinarc i Epërm/Vinarce Gornje, Vinarc i Poshtëm/Vinarce Donje
	Zubin Potok	Çabër/Çabra
	Zvečan/ Zvečan	Lipë/Lipa, Boletin/Boljetin, Zhazhë/Žaža
Pristinë /Pristina	Gračanica/ Graçanicë	Gračanica/Graçanicë, Sušica/Sushicë, Kišnica/Kishnicë, Suvi Do/Suvi Dol, Batuse/Batushë, Lepina/Lepi, Radevo/Radevë, Čaglavica/Çagllavicë
Prizren	Mamuša/ Mamushë/ Mamuša	Mamuša/Mamushë/Mamuša

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë⁴

Rajoni	Burimi	(a) Numri gjithsej i popullsisë	(b) Komuniteti	(c) %
Gjilan/Gnjilane	Komuna Klokot/Kllokot ⁵			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 ⁶	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991 ⁷	-	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	4,850	1,350	28 %
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	-	-	-
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	4,850	1,350	28 %
	Komuna Novo Brdo/Novobërdë ⁸			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	4,984	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	4,611	1,895	41%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	8,000	2,200	27.5%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	7,500-8,000	2,000-2,200	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	8,018	2,000	24.9%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	7,700	2,000	25.9%

Gjilan/Gnjilane	Komuna Ranilug/Ranillug⁹			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	-	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	6,000	60	1%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	6,000	100	1.6 %
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	-	-	-
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	6,000	100	1.6%
	Komuna Štrpce/Shtërpçë			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	12,712	4,300	33.8 %
	3. Vlerësimi aktual i komunës	12,000	5,000	41.6%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	12,500	5,000	40 %
5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	13,600	4,500	33.08 %	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	13,000	4,500	34.6%	
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Leposavić/Leposaviq			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	16,906	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	16,395	951	5.8%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	19,000	67	0.4%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	19,000	300-350	1.8%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	18,600	200	1.1%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	17,000	300 (100 banorë të përhershëm)	1.7 % (0.6%)
	Komuna Mitrovicë/Mitrovica (north)			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	-	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës (tetor '07) UNMIK DCA ('06)	16,000-20,000	3,875	19%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	22,000	1,446 ¹⁰	6.6% ¹¹
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	20,000 ¹²	3,000 ¹³	15%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	20,000	3,200	16%
	Komuna Zubin Potok			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	8,666	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	8,479	2,079	24.5%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	14,900	1,690	11.3%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	14,000	1,400	10%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	14,900	800	5.4%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	14,000	1,000	7.1%
	Komuna Zvečan/Zveçan			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	8,675	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	10,030	1,934	19.3%
3. Vlerësimi aktual i komunës	17,000	590	3.5%	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	17,000	500-600	2.9-3.5%	
5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2008	17,000	350	2.1%	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren ¹³	17,000	400	2.3%	
Prishtinë/Prishtina	Komuna Gračanica/Graçanicë			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	-	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	-	-	-
	4. Communities Estimations	23,000 ¹⁵	1,770 ¹⁶	7.7%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE	-	-	-
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	-	-	-	
Prizren	Komuna Mamuşa/Mamushë/Mamuşa			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	-	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës (December 2009)	5,300	250	4.7%
	4. Communities Estimations	5,500	400	7.2%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE	5,500	250	4.5%
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	5,500	300	5.4%	

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijë të moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijë që vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijë që nuk vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Moshë pune – të punësuar (16-65)	Moshë pune – të papunë (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë
Gjilan/Gjiljane	Klokot/Killokot	Mashkull	-	-	-	-	-	-	
		Femër	-	-	-	-	-	-	
		Gjithsej	-	-	-	-	-	-	
	Novo Brdo/Novobërdë	Mashkull	-	-	-	-	377	-	
		Femër	-	-	-	-	242	-	
		Gjithsej	20	609	0	420	619	180	
	Ranilug/Ranillug	Mashkull	1	4	0	3	1	-	
		Femër	0	2	0	0	3	-	
		Gjithsej	1	6	0	3	4	-	
	Štrpce/Shtërpçë	Mashkull	25	362	0	35	710	-	
		Femër	20	332	1	79	705	-	
		Gjithsej	45	694	1	114 ¹⁷	1,415	208	
	Gjithsej rajonet		-	-	-	-	-	-	
Mitrovicë/Mitrovica	Leposavić/Leposaviq	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Northern Mitrovica/Mitrovicë	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Zubin Potok	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Zvečan/Zveçan	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Gjithsej rajonet								
Koment	Ekipi i OSBE-së për komunitete nuk ka mundur të gjejë të dhënat e zbërthyer statistikore. Ndonëse palë të ndryshme mund t'i kenë të dhënat e tilla ose vlerësimet e përafërta, nuk ka vullnet, në përgjithësi, për t'i bërë ato publike.								
Prishtinë/Prishtina	Gračanica/Graçanicë	Mashkull	-	125	-	-			
		Femër	-	99	-				
		Gjithsej	-	224	-	110	1,050	205	
	Gjithsej rajonet								
Koment	Shifrat nuk përfshijnë popullsinë që jeton në Çaglavica/Çaglavicë.								
Prizren	Mamuša/Mamushë/Mamuša	Mashkull	39						
		Femër	36						
		Gjithsej	75						
	Gjithsej rajonet								
	Koment	Zyra rajonale për punësim nuk posedon të dhëna të zbërthyer për punëkërkesit nga Mamuša/Mamushë/Mamuša, as edhe për shqiptarët e Kosovës ose turqit e Kosovës.							

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë ta përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i gruas).
4. Mediat e komunitetit (elektronike, shtyp).
5. Liderët/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët
7. Informata shtesë

Rajoni	Hisedarët kyçë të komunitetit	
Gjilan/Gnjiliane	Komuna Klokot/Klllokot	
	1	LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës – është e vetmja parti politike që e përfaqëson komunitetin shqiptar të Kosovës që ka marrë pjesë në zgjedhjet e fundit.
	2	Refik Halili, Nënkyetar për Komunitete Hasan Rashiti, Drejtor i Bujqësisë
	3	“Better future”, OJQ shumetnike me seli në Klokot/Klllokot (aktivitete me të rinj)
	4	Nuk ka media lokale në gjuhën shqipe
	5	Refik Halili, Nënkyetar për Komunitete
	6	
	7	
	Komuna Novo Brdo/Novobërdë	
	1	Subjektet politike shqiptare të Kosovës janë të pranishëm në kuvendin komunal PDK – Partia Demokratike e Kosovës; LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës; LDD - Lidhja Demokratike e Dardanisë; AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; AKR - Aleanca Kosova e Re.
	2	Pjesa dërmuese e stafit politik dhe shërbyesve civil janë nga komuniteti shqiptar të Kosovës
	3	Zëri i rinisë, Arbenita Llapashtica Aktivitete rinore, kampe rinore, aktivitete sportive – trajnime shumetnike, pajisje me fushata informimi, ngritje të vetëdijes në nivel lokal. Rrjeti i të rinjve, Fadil Llapashtica Rinia, zhvillimi rural, komunikim me komunitete, organizimi i aktiviteteve rinore, organizimi i logjistikës për trajnime dhe seminare që mbahen në Qendrën Turistike Rurale në Novobërdë/Novo, Menaxhimi i qendrës dhe ndërlidhjes ndërmjet familjeve nikoqire dhe turistëve që vijnë në Novo Brdo/Novobërdë. “Iliria”, Fatmire Llapashtica ose Salije Kllokoqi Të drejtat e grave dhe fëmijëve, angazhimi në arsim.
	4	
	5	
	6	
	7	
	Komuna Ranilug/Ranillug	
	1	
	2	Boban Aliti, Kryesues i Komitetit për Komunitete Bekim Rashiti, Anëtar i Komitetit për Komunitete
	3	
	4	
	5	Boban Aliti
	6	
	7	Koment: Komuniteti shqiptar i Kosovës është komunitet shumë i vogël numerikisht në komunën e themeluar rishtas të Ranilug/Ranillugut.
	Komuna Štrpce/Shtërpçë	
	1	PDK - Partia Demokratike e Kosovës LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës LDD - Lidhja Demokratike e Dardanisë AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës PSK - Partia Socialiste e Kosovës
	2	Beqir Fejzullahu – Nënkyetar i Komunës për Komunitete Hamdi Aliu – Zëvendëskryesues i Kuvendit Komunal Drejtorët e departamenteve komunale: Havzi Ahmeti – Administratë dhe Personel Menderes Hyseni – Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale Sinan Imeri – Financa, Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural Anëtarët e Kuvendit Komunal: Ali Halimi – Partia Socialiste e Kosovës (PSK) Xhemajl Hazizi - Partia Socialiste e Kosovës (PSK) Adifete Mulaku - Partia Socialiste e Kosovës (PSK) Hamdi Aliu – Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Bekim Avdiu - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Rifat Rrustemi - Partia Demokratike e Kosovës (PDK)

Gjilan/Gnjilane	2	Lumnije Hyseni - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Linditë Limani - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) Hamdi Haliti – Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) Shqipe Hyseni - Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)
	3	“Lisi” – OJQ lokale që merret kryesisht me të rinjtë. OJQ-ja njihet për organizimin e Përvjetorit të Ditës së Rinisë, që zakonisht mbahet në mes të shtatorit. “Paqja” – një tjetër OJQ e të rinjve, megjithëse më pak aktive. “Sharri” – Shoqatë që merret me mbrojtjen e mjedisit. Ata organizojnë aktivitete të vogla siç është Dita e Tokës. Në bashkëpunim me nxënësit, organizojnë pastrimin e rrugëve në Firajë/Firaja dhe Brod. “Tradita” – Shoqatë që merret me mbrojtjen e trashëgimisë kulturore; nuk është shumë aktive.
	4	Asnjë nga tre transmetuesit publikë që e mbulojnë tërë Kosovën (RTK, TV21, KTV) nuk e mbulon edhe komunën e Štrpce/Shtërpçës. Veç kësaj, nuk ka kurrfarë stacioni lokal televiziv apo shtyp në gjuhën shqipe në komunën e Štrpce/Shtërpçës.
	5	
	6	
	7	Koment: Përveç anëtarëve të zgjedhur të kuvendit komunal ose zyrtarëve të emëruar komunalë, komunitetin pohojnë ta përfaqësojnë edhe përfaqësuesit dhe këshillat e fshatrave. Këta këshilla kryesisht përbëhen nga aktivistët politik dhe anëtarët që kanë lidhje politike, dhe nuk zgjedhen drejtpërdrejt. Në fshatrat e banuara me shqiptarë të Kosovës, pjesa dërmuese e përfaqësuesve të fshatit dhe këshillave të fshatit janë nga PDK (Partia Demokratike e Kosovës).
	Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Leposavić/Leposaviq
1		PDK - Partia Demokratike e Kosovës LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AKR - Aleanca Kosova e Re
2		Haki Ymeri (Udhëheqës i zyrës komunale për komunitete) Ardita Hasani (AAK-kryetare e zgjedhur e Leposavić/Leposaviqit në zgjedhjet e 15 nëntor 2009)
3		Asnjë
4		Komuniteti shfrytëzon mediat në gjuhën shqipe që e mbulojnë tërë Kosovën.
5		Haki Ymeri (Udhëheqës i zyrës komunale për komunitete) Naser Bejtullahu (Përfaqësues i komunitetit, Koshtovë/Košutovo, Bistricë/Bistrica, Cerajë/Ceranje.
6		
7		
Komuna Mitrovicë/Mitrovica (Veri)		
1		PDK - Partia Demokratike e Kosovës LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës AAK -Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës AKR - Aleanca Kosova e Re Partitë tjera më të vogla. Të dhënat e veçanta për votuesit shqiptarë të Kosovës në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica për zgjedhjet e nëntorit të vitit 2009 nuk mund të ndahen nga ato të votuesve shqiptarë të Kosovës në pjesën jugore të saj.
2		Faruk Korenica (Administrata e Kombeve të Bashkuara – Këshilli Këshillëdhënës i Mitrovica/Mitrovicës)
3		OJQ “Mundësia” – fuqizimi financiar i grave dhe zhvillimi i biznesit (në tërë rajonin). OJQ “Shoqata e Biznesit për Gra” – aktivitete të grave në bashkëpunim me OJQ-në “Mundësia”; drejton qendrën rinore afër Lagjes së Boshnjakëve. OJQ “Sporti dhe jeta” Mikronaselje/Kodra e Minatorëve, aktivitete sportive dhe rinore ndërmjet komuniteteve.
4		Nuk ka media të veçanta për komunitetin - komuniteti shfrytëzon mediat në gjuhën shqipe që e mbulojnë tërë Kosovën.
5		Ahmet Rama, përfaqësues i komunitetit në Brdjani/Kroin e Vitakut Adem Mripa, përfaqësues i komunitetit në Lagjen e Boshnjakëve Driton Gërguri, përfaqësues i komunitetit në Mikronaselje./Kodrën e Minatorëve Adem Tolaj, përfaqësues i komunitetit në Tre Rrokaqiejt/Tri solitera (Three Towers) Musa Miftari, përfaqësues i komunitetit në in Lagjen e Doktorëve/Dolina Doktora (Doctor’s Valley) Afrim Ahmeti, përfaqësues i komunitetit në “7 Shtatori” Shefki Imeri, përfaqësues i komunitetit në Suhadoll/Suvi Do Avdi Hajdari, përfaqësues i komunitetit në Gushac/Guševec Musa Behrami, përfaqësues i komunitetit në Vidimriq/Vidomirić Kadri Hasani, përfaqësues i komunitetit në Vinarc të Epërm/Vinarce Gornje Shaqir Hasani, përfaqësues i komunitetit në Vinarc të Poshtëm/Vinarce Donje
6		
7		

Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Zubin Potok	
	1	PDK - Partia Demokratike e Kosovës LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës AKR - Aleanca Kosova e Re Zëvendës Kryetari Shtesë i Kuvendit Komunal (ZK-SHKK) është i LDK-së. PDK-ja gjithashtu gëzon pak mbështetje, ndonjëse ekziston besnikëri e fuqishme ndaj ZK-SHKK-së, i cili shërben aktualisht, për shkak të arritjeve të tij në vitet e kaluara.
	2	Agim Hasani (Zëvendës Kryetar Shtesë i Kuvendit Komunal) Qerkin Veseli (Udhëheqës i Zyrës Komonale për Komunitete)
	3	OJQ “Mundësia”, fuqizimi financiar i grave dhe zhvillimi i biznesit (në tërë rajonin). Qendra rinore, me seli në objektin e zyrës komunale për komunitete, duke realizuar aktivitetet si kurse për kompjuterë, gjuhë angleze, aktivitete vetëdijesimi për të drejtat e njeriut.
	4	Nuk ka media të veçanta për komunitetin – komuniteti shfrytëzon mediat në gjuhën shqipe që e mbulojnë tërë Kosovën,.
	5	Qerkin Veseli (Kryesues i Zyrës Komonale për Komunitete) Sefer Veseli (Përfaqësues i PDK-së)
	6	
	7	
	Komuna Zvečan/Zveçan¹⁸	
	1	PDK - Partia Demokratike e Kosovës; LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës; LDD - Lidhja Demokratike e Dardanisë;
	2	Florim Kelmendi (Udhëheqës i Zyrës Komonale për Komunitete)
	3	OJQ “Mundësia” fuqizimi financiar i grave dhe zhvillimi i biznesit (në tërë rajonin). OJQ “Sofra Shaljane” nga fshati Zhazhë/Žaža, të drejtat e grave, të drejta e fëmijëve, edukatë shëndetësore, zhvillimi ekonomik dhe bujqësor me një spektër të gjerë të aktiviteteve. OJQ “Kelmendi” nga fshati Lipë/Lipa me përqendrim në arsimim dhe aftësim profesional, OJQ “Kursimet Fshatare/ Dreni”, aktivitete bujqësore.
	4	Nuk ka media të veçanta për komunitetin - komuniteti shfrytëzon mediat në gjuhën shqipe që e mbulojnë tërë Kosovën.
	5	Florim Kelmendi (Kryesues i Zyrës Komonale për Komunitete) Kajtaž Peci, udhëheqës i fshatit Zhazhë/Žaža Xhevat Peci, udhëheqës i fshatit Boletin/Boljetin Agron Kelmendi, udhëheqës i fshatit Lipë/Lipa
6		
7		
Prishtinë/Prishtina	Komuna Gračanica/Graçanicë	
	1	PDK – Partia Demokratike e Kosovës, Zyra në fshatin Kishnicë/Kišnica LDD - Lidhja Demokratike e Dardanisë
	2	Agim Krasniqi – LDD, Zëvendës Kryesues për Komunitete
	3	Asnjë
	4	RTK, KTV, TV21, radiostacionet që mbulojnë Kosovën. Shtyp i rregullt në gjuhën shqipe vetëm në fshatin Suvi Do/Suhadoll.
	5	Lutfi Vehapi – udhëheqës i fshatit, fshati Suvi Do/Suhadoll Abdurrahman Krasniqi - LDD (fshati Sušica/Sushicë)
	7	
Prizren	Komuna Mamuša/Mamushë/Mamuša	
	1	PDK – Partia Demokratike e Kosovës AKR – Aleanca Kosova e Re
	2	Institucionet e Kosovës (niveli qendror): Nuk ka asnjë shqiptar të Kosovës që mban ndonjë post të lartë në institucionet e nivelit qendror. Institucionet e Kosovës (niveli lokal): Ganimete Sadiku, Nënkryetare për Komunitete. Halim Sadiku, anëtar i kuvendit komunal, PDK
	3	Nuk ka asnjë organizatë të shoqërisë civile që i përket komunitetit shqiptar të Kosovës.
	4	Nuk ka asnjë media lokale të komunitetit shqiptar të Kosovës.
	5	Halim Sadiku, kryetar i degës së PDK-së dhe anëtar i kuvendit komunal Ganimete Sadiku, Zëvendës Kryetare për Komunitete
	7	

- 1 Tre rrokaqejt/Tri solitera është emërtim lokal jozyrtar.
- 2 Lagjja e Doktorëve/Dolina Doktora është emërtim lokal jozyrtar.
- 3 Zona ndërmjet Tre rrokaqejve dhe Lagjes së Doktorëve.
- 4 Të dhënat e popullatës për seksionet 3, 4, 5 dhe 6 janë mbledhur nga Ekipet e OSBE-së në Terren, në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarët komunal në mars-prill 2010.
- 5 Komuna e Klokot-Vrbovac/Klokotit-Vërbocit është një prej tri komunave në rajonin e Gjilanit/Gnjilane.
- 6 Të dhënat nga regjistrimi i popullsisë së vitit 1981 nuk janë në dispozicion. Megjithatë, madje edhe po të ishin në dispozicion, nuk do të kishte shifra të kategorizuara, ngase në vitin 1981, territori i komunës së tashme të Štrpce/Shtërpçës ka qenë pjesë e komunës së Ferizajit/Uroševac. Komuna e Štrpce/Shtërpçës është themeluar në vitin 1987.
- 7 Të dhënat e mbledhura për regjistrimin e popullsisë të vitit 1991. Ky regjistrim i popullsisë kontestohet ngase është bojkotuar nga disa segmente të popullatës.
- 8 Komuna e Brdo/Novobërdës është njëra prej tri komunave komunave në rajonin e Gjilanit/Gnjilane.
- 9 Komuna e Ranilug/Ranillugut është një prej tri komunave në rajonin e Gjilanit/Gnjilane.
- 10 Ky numër vlen vetëm për shqiptarët e Kosovës që jetojnë në Lagjen e Boshnjakëve, Tre rrokaqejve dhe Mikronaselje/Kodrën e Minatorëve.
- 11 Po aty.
- 12 Shifrat për popullsinë e Mitrovicës/Mitrovica (si tërësi, apo për jug/veri) është shumë vështirë të sigurohen dhe i nënshtrohen shumë kundërshtimeve.
- 13 Po aty.
- 14 Vlerësimet aktuale përfshijnë përafërsisht 3,000 – 4,000 persona të zhvendosur që aktualisht jetojnë në komunën e Zvečan/Zveçanit.
- 15 Burimet: Zëvendëskryesuesi për komunitete dhe udhëheqësi i fshatit Suvi Do/Suhadoll.
- 16 Këto shifra tregojnë numrin e shqiptarëve të Kosovës në Gracanica/Graçanicë pa Caglavica/Çaglavicën. Vlerësimet për Caglavica/Çaglavicën janë mes 1,000 – 1,200 shqiptarë të Kosovës.
- 17 Këto shifra përfshijnë vetëm ata që janë të punësuar në sektorët e administratës komunale, arsimit dhe shëndetësisë. Nuk është përfshirë asnjë punëtor nga sektori privat (nuk ka të dhëna të sakta në dispozicion).
- 18 Po aty.



Profili i Komunitetit

ASHKALI

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Mohim i përgjegjesisë

Pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian identifikojnë veten si persona që u takojnë tri komuniteteve të veçanta dhe ata pranohen si të tillë nga korniza ligjore të Kosovës, institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë në Kosovë (OSBE) plotësisht pranon ekzistencën e tri komuniteteve të veçanta dhe në këtë publikim ka synuar të theksojë përvojat dhe karakteristikat e veçanta të tyre. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme të zbrërthyer për këto komunitete në disa komuna, disa pjesë të Aneksit për këtë profil përmbajnë shifrat që përfaqësojnë së bashku romët, ashkalitë dhe egjiptianët.

Historiku

Edhe pse ashkalitë janë një prej komuniteteve që tradicionalisht ka jetuar në Kosovë, regjistrimi i popullsisë më 1981 dhe 1991 nuk ka siguruar të dhëna të zbrërthyer për këtë komunitet. Për këtë arsye, nuk ka të dhëna zyrtare mbi numrin e ashkalive që jetojnë apo kanë jetuar në Kosovë. Vlerësimet aktuale tregojnë që rreth 12 000 pjesëtarë të komunitetit ashkali banojnë në Kosovë. Gjatë viteve 1980 dhe 1990, shumë pjesëtarë të komunitetit ashkali kanë migruar në Evropën Perëndimore në kërkim të vendeve të punës. Gjatë konfliktit të vitit 1999 dhe gjatë trazirave të marsit 2004, disa vendbanime të banuara me pjesëtarë të komunitetit ashkali ishin vënë në shënjestër dhe shumë banorë u shpërngulën nëpër vendet e rajonit dhe në Evropën Perëndimore. Pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë simbolet e tyre (flamurin), disa tradita dhe karakteristika kulturore të veçanta. Në përgjithësi, ata konsiderojnë gjuhën shqipe si gjuhë të tyre amtare, përderisa brezat më të vjetër shpesh herë flasin edhe gjuhën serbe. Pjesëtarët e komunitetit ashkali janë kryesisht të besimit mysliman dhe konsiderojnë që kanë prejardhjen nga Persia antike. Situata e tyre aktuale dhe historike karakterizohet nga mungesa e integritimit në shoqërinë kosovare. Për momentin, shumë pjesëtarë të komunitetit ashkali jetojnë në komunat në vijim: Ferizaj/Uroševac (rreth 2.3-2.4% të popullsisë së komunës) në rajonin e Gjilanit/Gnjilane; Mitrovicë/Mitrovica (0.3%), Skenderaj/Srbica (0.06%) dhe Vushtrri/Vučitrn (0.16%) në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje (9.7%), Lipjan/Lipljan (2.9%), Obiliq/Obilić (1%), Podujevë/Podujevo (0.6%), Prishtinë/Priština (0.1%), Gračanica/Graçanicë (0.25%) dhe Shtime/Štimlje (2.6%) në rajonin e Prishtinës/Priština. Në rajonin e Pejës/Peć dhe Prizrenit, nuk mund të sigurohen të dhënat e ndashme për komunitetin ashkali, apo për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian së bashku.

Ashkali celebrate their Memorial Day on 15 February.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Komuniteti ashkali është një ndër komunitetet më të cenueshme në Kosovë dhe shumë pjesëtarë jetojnë në varfëri të skajshme. Gratë dhe vajzat e komunitetit ashkali janë ndër grupet më të diskriminuara brenda këtij komuniteti.
- Në përgjithësi, niveli i ulët i arsimit dhe shkalla e lartë e braktisjes së shkollës, niveli i ulët i regjistrimit në shkollë të mesme apo arsim të lartë. Gratë ndikohen më së shumti.
- Mungesa e titujve pronësorë dhe dokumenteve të regjistrimit, përfshirë edhe dokumentet e gjendjes civile.

FËMIJËT ASHKALI KËRKOJNË COPA METALI NË FUNDËRRINAT E MIHJES SË KOMPLEKSIT TË TREPÇËS PËR T'I SHITUR. AKTIVITETET EKONOMIKE METALURGIKE DHE TË MIHJES KANË HISTORI TË GJATË NË KOMUNAT VERIORE TË MITROVICËS/MITROVICA DHE ZVEÇAN/ZVEÇANIT.



1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Për shkak të gjendjes së rëndë socio-ekonomike, nga e cila vuajnë shumë familje ashkali, dhe për shkak të pikëpamjes tradicionale për rolin e gruas, shumica e vajzave braktisin sistemin arsimor gjatë apo pas shkollës fillore. Kjo gjë pengon mundësitë e tyre për përvetësimin e kualifikimeve të domosdoshme, që si pasojë i vendos ato në disavantazh konkurrues kur futen në tregun e punës.

Gjendja socio-ekonomike e komunitetit ashkali mbetet e rëndë, me shkallë të lartë të papunësisë dhe të përjashtimit social në tërë Kosovën. Shkalla e lartë e braktisjes së shkollës çon në arsim të dobët dhe mungesë të përgjithshme të kualifikimeve arsimore dhe të aftësisë brenda komunitetit, që pengon qasjen e tyre në tregun e punës. Megjithatë, disa individë janë të vetëpunësuar dhe disa të tjerë janë të punësuar në shërbimin civil. Shumë familje të komunitetit ashkali mbështeten në ndihmën sociale dhe pensionet nga Kosova, edhe pse disa marrin ndihmë sociale nga Serbia, apo nga të dyja. Pensionet dhe ndihma sociale nga Kosova nuk janë të mjaftueshme për të siguruar kushte të denja jetese, posaçërisht për ata që jetojnë në familje të mëdha. Përveç kësaj, ligji përcakton kritere të rrepta për përfshirje në skemën e ndihmës sociale dhe shumë pjesëtarë të komunitetit ashkali, edhe pse të cenueshëm në aspektin social, janë shpesh të përjashtuar nga kjo skemë për shkak të mungesës së dokumenteve të gjendjes civile. Gratë nga komuniteti ashkali vazhdojnë të jenë grupi më i diskriminuar në shoqëri. Shkalla e braktisjes së shkollës nga nxënëset femra është krahasimisht më e madh se sa tek nxënësit meshkuj në komunitet. Martesa në moshë të re dhe angazhimi i tyre në punët e amvisërisë do të thotë që ato përballen me pengesa më të mëdha se sa meshkujt ashkali për qasje në tregun zyrtar të punës.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, shumica e pjesëtarëve të komunitetit ashkali janë të papunë apo kanë punë joforMeshkuj, siç janë mbledhja e kanaqeve apo puna sezonale. Rreth 30-40% janë të punësuar në mënyrë joforMeshkuj dhe fitojnë shumë pak duke punuar kështu. Rreth 255 familje mbështeten në ndihmë sociale, pensione apo ndonjë ndihmë nga të afërmit që jetojnë jashtë vendit. Shtatë pjesëtarë të komunitetit janë të punësuar në shërbimin civil komunal në Ferizaj/Uroševac, përfshirë dy që janë anëtarë të Kuvendit Komunal dhe nëntë në policinë e Kosovës. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, vlerësimet tregojnë që 90% e komunitetit është e papunë dhe ballafaqohet me probleme socio-ekonomike. Në komunën e Mitrovicës/Mitrovica së jugut, Vushtri/Vučitrn

dhe Skenderaj/Srbica, pjesëtarët e e komunitetit ashkali shpesh kërkojnë të punësohen në punë me të ardhura të vogla apo punë joprofessionale, që nuk është e mjaftueshme për të nxjerrë komunitetin nga varfëria. Megjithatë, disa pjesëtarë të komunitetit ashkali janë të punësuar në sektorin privat dhe publik, si roje të sigurisë, pastrues, mësues, zyrtarë policor, asistent teknik në spitalet lokale dhe punonjës komunal. Në komunën e Vushtrisë/Muçitrn, shumë pak pjesëtarë të komunitetit ashkali punojnë për ndonjë OJQ vendore apo ndërkombëtare.

Komuniteti ashkali në rajonin e Pejës/Peć është i vogël dhe shumica e pjesëtarëve mbesin të papunë. Ata pjesëtarë të komunitetit që janë punësuar në institucionet publike janë në vende pune të pakualifikuara. Në stacionin e policisë në Klinë/Klina, vetëm një pjesëtar i komunitetit ashkali punon si zyrtar policor. Në rajonin e Prishtinës/Priština, shumë pjesëtarë të komunitetit ashkali mbështeten në skemën e mirëqenies sociale ose të ardhurave nga puna sezonale dhe ajo joforMeshkuj. Burim tjetër i të ardhurave janë pensionet nga punësimi i mëhershëm në ndërmarrjet në pronësi publike të Serbisë, siç janë “Elektro Privreda Srbije”, apo ndonjë kompani tjetër publike. Të rinjtë e komunitetit ashkali në komunat e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Prishtinës/Priština dhe Podujevës/Podujevo kanë filluar të regjistrohen në kurset e trajnimit për aftësim profesional, që ofrohen nga OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, siç janë “Don Bosco” dhe “Qendra për Aftësim Profesional” në Prishtinë/Priština. Në rajonin e Prizrenit, sipas të dhënave të siguruar nga zyra rajonale për punësim, nga 58,605 (30,247 femra) punëkërkues 716 janë Ashkali (383 femra) të regjistruar. Megjithatë ky numër besohet të jetë më i madh për shkak se pjesëtarët e komunitetit ashkali mund të regjistrohen si pjesëtarë të ndonjë komuniteti tjetër apo edhe mund të mos regjistrohen fare. Zyra në fjalë siguron trajnim profesional në lëndët si administrimi i biznesit, teknologjia informative dhe automekanikë. Pas përfundimit të kursit, që zakonisht zgjatë 3 deri në 6 muaj, kandidatët marrin një certifikatë dhe zyra lehtëson qasjen në punësim. Dy pjesëtarë meshkuj të komunitetit ashkali kanë marrë pjesë në këtë skemë ndërmjet muajve janar – qershor 2010.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Gjendja e sigurisë për pjesëtarët e komunitetit ashkali mbetet e mirë, me pak incidente të raportuara. Ata gëzojnë lirinë e lëvizjes në tërë territorin e Kosovës. Në përgjithësi, lëvizshmëria më e madhe ka çuar në një qasje më të madhe në shërbimet publike dhe drejt integritit me komunitetin shumicë. Përfaqësimi në Policinë e Kosovës pengohet nga mungesa e kualifikimeve të duhura arsimore i pjesëtarëve të komunitetit, ndërsa pjesëmarrja në forumet e sigurisë në nivel komunal dhe lokal është po ashtu i kufizuar dhe ndërldhet me sfidat e përgjithshme për angazhimin e komunitetit në jetën publike.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pjesëtarët e komunitetit ashkali që banojnë kryesisht në komunën e Ferizajt/Uroševac, gëzojnë liri të lëvizjes dhe kanë shprehur besimin e tyre në Policinë e Kosovës. Megjithatë disa incidente të sigurisë vazhdojnë të prekin këtë komunitet. Për shembull, më 18 korrik 2009, tre meshkuj të komunitetit ashkali u sulmuan nga një grup i meshkujve shqiptarë në lagjen Dubravë/Dubrava të komunës së Ferizajt/Uroševac. Në muajin tetor të vitit 2009, persona të panjohur

Një nga shqetësimet kryesore të sigurisë, që ndikon tek gratë dhe femrat e komunitetit ashkali, mbetet dhuna në familje dhe në baza gjinore. Liria e tyre e lëvizjes kufizohet, duke qenë se shumë prej tyre kufizohen brenda shtëpisë dhe lagjes së ngushtë.

hodhën koktej molotovi brenda një shtëpie të familjes ashkali në qytetin e Ferizajt/Uroševac. Më 23 janar 2010, një pjesëtar i mitur mashkull i komunitetit ashkali u ther me thikë nga persona të panjohur në lagjen Sallahane/Salahane të qytetit të Ferizajt/Uroševac. Incidentet e tilla kanë minuar perceptimet e sigurisë të pjesëtarëve të komunitetit ashkali në rajon dhe nuk ka pasur asnjë reagim nga autoritetet komunale për këto incidente. Komuniteti është i përfaqësuar në Policinë e Kosovës me nëntë zyrtarë policorë meshkuj, që punojnë në stacionin e policisë në Ferizaj/Uroševac. Gjithashtu, pjesëtarët e komunitetit ashkali marrin pjesë në mbledhjet e këshillit komunal për siguri në bashkësi në këtë komunë. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, që nga muaji korrik 2009 nuk është raportuar asnjë incident i sigurisë kundër pjesëtarëve të komunitetit ashkali dhe komuniteti nuk ka shprehur asnjë shqetësim sa i përket lirisë së lëvizjes. Pjesëtarët e komunitetit ashkali, pa ndonjë problem, udhëtojnë me vetura private nga vendbanimi i tyre në fshatrat apo qytetet tjera të rajonit. Në qytetin e Mitrovicës/Mitrovica, pjesëtarët e komunitetit ashkali që jetojnë në të dy anët e lumit Ibër, udhëtojnë duke përdorur urat anësore ndërsa shmangin tërësisht urën kryesore nga frika se mund të vihen në shënjestër. Pjesëtarët e komunitetit ashkali, që jetojnë në komunat e Vushtrisë/Vučitrn dhe Leposavić/Leposaviqit, udhëtojnë lirshëm dhe po ashtu marrin pjesë në mbledhjet e organizuara rregullisht në Mitrovicë/Mitrovica. Vetëm dy pjesëtarë të komunitetit ashkali, meshkuj, punojnë si policë: njëri në Mitrovicë/Mitrovica dhe tjetri në Vushtri/Vučitrn. Në komunën e Vushtrisë/Vučitrn, këshilli komunal për siguri në bashkësi funksionon, ndërsa një përfaqësues i komunitetit ashkali merr pjesë rregullisht në mbledhjet e këshillit. Komuniteti nuk merr pjesë në mbledhjet për sigurinë, që organizohen nga Administrata e Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UAM) në Mitrovicë/Mitrovica.

Në rajonin e Pejës/Peć, pjesëtarët e komunitetit ashkali gëzojnë lirinë e lëvizjes dhe lëvizin nëpër rajon duke përdorur transportin privat dhe atë publik. Komuniteti nuk ka raportuar ndonjë incident të sigurisë. Marrëdhëniet e komunitetit me Policinë e Kosovë janë të mira ndërsa një polic, pjesëtar i komunitetit ashkali, punon në Klinë/Klina. Komuniteti është gjithashtu i përfaqësuar në këshillin komunal për siguri në bashkësi në komunën e Klinës/Klina, edhe pse ky këshill nuk është duke funksionuar që nga zgjedhjet komunale që janë mbajtur në nëntor të vitit 2009. Në rajonin e Prishtinës/Priština, pjesëtarët e komunitetit ashkali në përgjithësi gëzojnë lirinë e lëvizjes, përfshirë edhe shfrytëzimin e transportit publik. Është raportuar një numër i incidenteve të sigurisë. Më 26 mars, dhe prapë më 12 prill 2010, në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, janë thyer dritaret e katër shtëpive të rindërtuara për familjet e kthyer të pjesëtarëve të komunitetit ashkali në fshatin Nakaradë/Nakarade. Familjet në fjalë po ashtu kanë raportuar ngacmime nga fqinjët e tyre shqiptarë të Kosovës për të shitur pronat e tyre me çmim të ulët. Përveç kësaj, komuniteti është ndier i diskriminuar nga reagimi i Policisë së Kosovës, që kishte pohuar që këto familje kishin dëmtuar vetë shtëpitë e tyre. Më 7 mars 2010, një grua u plagos në qytetin e Lipjanit/Lipjan nga një plumb i shtënë brenda shtëpisë së saj. Sipas përfaqësuesit të komunitetit në zyrën komunale për komunitete, disa javë para incidentit familja në fjalë kishte marrë një letër kërcënuese nga persona të panjohur, që kishin kërkuar nga familja të largohet nga prona e saj. Këto incidente janë paraqitur në Policinë e Kosovës dhe rastet janë nën hetime. Katër pjesëtarë të komunitetit ashkali, meshkuj, punojnë si policë: dy në komunën e Podujevës/Podujevo dhe dy në

Lipjan/Lipljan. Komuniteti është i përfaqësuar në këshillin komunal për siguri në bashkësi në komunat vijuese: Lipjan/Lipljan, Fushë Kosovë/ Kosovo Polje, Podujevë/Podujevo, Prishtinë/Priština, Shtime/Štimlje dhe Obiliq/Obilić. Në rajonin e Prizrenit, që nga muaji korrik 2009 nuk është raportuar ndonjë incident serioz i sigurisë. Një pjesëtar i komunitetit ashkali, mashkull, punon në stacionin e policisë në Prizren por nuk ka përfaqësim të komunitetit në nivel më të lartë. Komuniteti ashkali është vetëm e përfaqësuar në këshillin komunal për siguri në bashkësi të komunës së Suharekës/Suva Reka.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Rreth dy të tretat e popullsisë së vlerësuar të banorëve romë, ashkali dhe egjiptian para lufte, që përbënin përreth 150 000 njerëz, janë zhvendosur gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Një numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit ashkali mbesin të zhvendosur në vendet e rajonit dhe shtetet e Evropës Perëndimore, ndërsa 635 ashkali mbesin të zhvendosur brenda Kosovës.¹ Pjesëtarët e komunitetit ashkali, që banojnë jashtë Kosovës, vazhdojnë të riatdhesohen me forcë. Procesi i kthimit vullnetar i pjesëtarëve të komunitetit ashkali është i ngadaltë, duke qenë se qëndrueshmëria e kthimit shpesh pengohet nga mungesa e punësimit dhe integrimin të dobët ekonomik të të kthyerve. Faktorët tjerë që ndikojnë negativisht kthimin dhe riintegrimin e këtij komuniteti janë: vështirësitë në riposedimin e pronës së tyre për shkak të mungesës së përgjithshme të dokumenteve personale dhe titujve të regjistruar të pronës; shqetësimet e sigurisë; mbështetja e pamjaftueshme nga donatorët dhe përfaqësimi i pamjaftueshëm në organet që kanë të bëjnë me kthimin në nivel komunal dhe qendror.

Në vitin 2009 dhe në fillim të vitit 2010, rreth 37 pjesëtarë të komunitetit ashkali janë kthyer vullnetarisht në shtëpitë e tyre në Komunën e Ferizajt/Uroševac të rajonit të Gjilanit/Gnjilane. Në kuadër të kornizës së projektit “Kthimi dhe Reintegrimi në Kosovë (i financuar nga Komisioni Evropian në partneritet me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, dhe i zbatuar nga Këshilli Danez për Refugjatë) dhe pas disa vizitave shko-dhe-informohu dhe shko-dhe-shih, katër familje ashkallike nga Ferizaj/Uroševac, që për momentin janë të zhvendosura në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, janë përzgjedhur për ndihmë në rindërtimin e shtëpive në vitin 2010. Vendimi është miratuar nga grupi punues komunal për kthim më 2010. Megjithatë, zbatimi i projektit ende është në pritje të ndarjes së tokës nga komuna, sepse përfituesit e projektit nuk kanë pasur pronë të tyre para zhvendosjes. Kthimi i detyrueshëm i pjesëtarëve të komunitetit ashkali mbetet një çështje sfiduese për komunat e rajonit, posaçërisht për komunën e Ferizajt/Uroševac, ku banon numri më i madh i pjesëtarëve të komunitetit ashkali në tërë Kosovën. Komuna mbetet e papërgatitur për të strehuar numrin në rritje të personave të riatdhesuar nga vendet e treta dhe rasteve të të caktuara të kthyerve u sigurohet vetëm një ndihmë simbolike humanitare nga agjencitë ndërkombëtare. Komuna nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të zbatuar Strategjinë për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar. Si zhvillim pozitiv mund të përmendet që më 31 mars 2010, Kryetari i Komunës së Ferizajt/Uroševac nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me OJQ “Projekti i të Drejtave Civile/Kosovë” për lirimin nga pagesa administrative dhe për mundësimin e qasjes më të lehtë në procedurat e

Sipas statistikave të UNHCR, viti 2009 ka shënuar rritje të kthimit vullnetar krahasuar me vitin 2008; 281 pjesëtarë të komunitetit ashkali dhe egjiptian janë kthyer më 2009 krahasuar me 195 të kthyer në vitin 2008.¹ Statistikat e UNHCR-së për kthimin tregojnë që 179 persona të zhvendosur, pjesëtarë të komunitetit ashkali dhe egjiptian, janë kthyer ndërmjet muajve janar dhe prill 2010.

Riatdhesimi i detyrueshëm i pjesëtarëve të komunitetit ashkali po vazhdon, duke qenë se 225 persona janë riatdhesuar nga vendet e treta (kryesisht nga vendet e Evropës Perëndimore) në Kosovë nga viti 2009 deri në muajin prill të vitit 2010.²

¹ Pasqyrë statistikore nga ZShM e UNHCR në Prishtinë/Priština ashtu si ishte fund të dhjetorit të vitit 2009.

¹ Pasqyrë statistikore nga ZShM e UNHCR në Prishtinë/Priština ashtu si ishte fund të dhjetorit të vitit 2009.

² Po aty.

Komunat mbajnë përgjegjësinë për riintegrimin e personave të kthyer me forcë, por mbesin të papërgatitura dhe u mungojnë fondet për t'i ndihmuar ashtu siç duhet personat e riadhesuar për tu riintegruar shoqërinë kosovare.

regjistrimit për pjesëtarët e komunitetit ashkali. Ky veprim duhet të rrisë qasjen e të kthyerve ashkali në shërbimet komunale, duke përkrahur kështu procesin e kthimit.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, disa pjesëtarë të komunitetit ashkali janë kthyer vullnetarisht në zonat urbane në Mitrovicën/Mitrovica e jugut dhe në Vushtrri/Vučitrn. Disa pjesëtarë të komunitetit ashkali janë kthyer në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn, prej nga ishin zhvendosur në vitin 2004. Aktualisht, nuk ka asnjë projekt të kthimit për pjesëtarët e komunitetit ashkali në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn, për shkak të mungesës së interesit nga komuniteti, komuna apo nga të dyja. Në vitin 2009, është organizuar një vizitë shko-dhe-informohu në bashkëpunim me UNHCR dhe Këshillin Danez për Refugjatët tek pjesëtarët e komunitetit ashkali në Suboticë. Megjithatë, deri më sot kjo gjë nuk ka rezultuar në ndonjë aktivitet tjetër. Siç raportohet, në vitin 2009 dy apo tre pjesëtarë të komunitetit ashkali janë kthyer me forcë në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn. Për shkak të mungesës së strehimit dhe mundësive, ata prapë kanë lëshuar vendin. Në vitin 2008 dhe 2009, disa familje ashklike janë kthyer në Mahallën rome në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica si pjesë e një projekti të organizuar të kthimit.² Disa pjesëtarë tjerë ende banojnë në kampet e kontaminuara me plumb, por këta do të përfitojnë nga zbatimi i Nismës Përkrahëse të Unionit Evropian për romët, ashkalitë dhe egjiptianët e Mitrovicës/Mitrovica (EU-MRSI) dhe Partneritetit Kosovar për Rivendosje të Qëndrueshme për Programin e Komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian (RESTART): programe që financohen nga Unioni Evropian, përkatësisht USAID. Qëllimi i programeve të tilla është mbyllja e kampeve Osterode and Česmin Lug në veri të Mitrovicës/Mitrovica dhe rivendosjen e banorëve në shtëpitë në Mahallën rome, ose nëse ka mundësi, në komunat përkatëse për ata që nuk janë banuar në mahallën rome para konfliktit.³ Përfundimisht, nga viti 2009 deri në maj 2010, janë organizuar vizita shko-dhe-shih për pjesëtarët e komunitetit ashkali të zhvendosur në Beograd në Staritërg/Stari Trg dhe Tunel i Parë/Prvi Tunel (Mitrovicë/Mitrovica e jugut). Përfaqësuesit e komunitetit ashkali marrin pjesë në grupet punuese komunale për kthim dhe në komisionin e komuniteteve në Mitrovicë/Mitrovica, Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica. Ashtu si edhe në rajonet tjerat, kthimi i detyrueshëm i pjesëtarëve të komunitetit ashkali nuk përballet mirë nga autoritetet dhe shumë persona të riadhesuar nuk marrin ndihma të mjaftueshme. Disa familje kanë mbetur pa shtëpi dhe ato janë strehuar nga të afërmit e tyre në vendbanimin “2 Korriku/Sitničko Naselje”, mahallën rome dhe kampin Osterodë. Disa pjesëtarë të komunitetit kanë marrë ndihma në artikuj ushqimor nga komuna e Mitrovicës/Mitrovica. Përveç ndihmës së lartcekur, asnjë nga komunat e rajonit nuk kanë zbatuar strategjitë aktuale për riintegrimin e personave të riadhesuar.

Në vitin 2009, rreth 10 pjesëtarë të komunitetit ashkali janë kthyer vullnetarisht në shtëpitë e tyre në komunat e Gjakovës/Đakovica dhe Klinës/Klina në rajonin e Pejës/Peć. Ky ishte kthimi i parë në komunën e Klinës/Klina që nga viti 2005. Të kthyerit kanë marrë paketën standarde të ndihmës nga UNHCR, që përbehet nga artikujt ushqimorë dhe jo-ushqimorë. Ata jetojnë në gjendje të vështirë dhe nuk marrin ndihmë të duhur nga komuna apo agjencitë ndërkombëtare. Në komunat e Gjakovës/Đakovica dhe Klinës/Klina, grupet komunale për kthim ende nuk janë themeluar. Në Gjakovë/Đakovica, komuna më në fund ka emëruar zyrtarin komunal për kthim, që është shqiptar i Kosovës, në

2 Pra, që nga viti 2007, në përgjithësi 127 familje nga disa vende të ndryshme, përfshirë Serbinë qendrore, Malin e Zi dhe kampet në veri të lumit Ibër, janë kthyer në gjashtë ndërtesa dhe në 36 shtëpi individuale, duke krijuar kështu gjithsej 54 njësi banimi.

3 Për më shumë hollësi, lexoni paragrafin për kthim në profilin e komunitetit rom.

maj të vitit 2010. Sa i përket mekanizmave tjerë, komuniteti ashkali përfaqësohet dobët në procesin e vendimmarrjes dhe në organet komunale për kthim. Vetëm një pjesëtar i komunitetit ashkali është anëtar i komisionit për komunitete në komunat e Gjakovës/Đakovica dhe Klinës/Klina. Në këtë të fundit, përfaqësuesi ashkali është zgjedhur kryesues i komisionit. Riatdhesimi i detyrueshëm i pjesëtarëve të komunitetit ashkali nga vendet e treta në Kosovë është duke vazhduar. Në nivel komunal nuk ka ndonjë mekanizëm të themeluar për t'i ndihmuar këta persona për riintegrimin e tyre në Kosovë.

Në vitin 2009 dhe në fillim të vitit 2010, në rajonin e Prishtinës/Priština 35 familje (130 ashkali) janë kthyer vullnetarisht në shtëpitë e tyre në komunat Shtime/Štimlje, Podujevë/Podujevo, Lipjan/Lipljan dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Ata ishin kryesisht të zhvendosur brenda rajonit. Shumica e këtyre familjeve të kthyer kanë marrë ndihmë individuale për rindërtimin e shtëpisë, nëpërmjet projekteve të ndryshme të financuara nga UNDP, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Këshilli Danez për Refugjatë. Në vitin 2009, 14 familje të kthyer kanë përfituar, në kuadër projektit “Kthimi dhe Reintegrimi në Kosovë I”, nga projektet për rindërtimin e shtëpive dhe gjenerimin e të ardhurave në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. 12 familje tjera të zhvendosura nga komuna e Obiliqit/Obilić janë përzgjedhur si përfituese të projektit “Kthimi dhe Reintegrimi në Kosovë II” dhe shumë shpejt do të marrin ndihma për strehim dhe gjenerim të ardhurave. UNHCR dhe Këshilli Danez për Refugjatë kanë mundësuar pesë vizita shko-dhe-shih në Obiliq/Obilić, një në Shtime/Štimlje, një tjetër në Prishtinë/Priština dhe dy në komunën e Lipjanit/Lipljan. Tetë vizita shko-dhe-informohu, përfshirë këtu përfaqësuesit komunalë nga Prishtina/Priština, Obiliq/Obilić dhe Fushë Kosova/Kosovo Polje, janë organizuar në vendet e rajonit. Disa familje ashkali ende banojnë në barrakat e ish-kampit në Plemetin/Plemetina të komunës së Obiliqit/Obilić: një kamp i përkohshëm i ndërtuar në korrik të vitit 1999 për të strehuar mijëra të zhvendosur të komuniteteve ashkali dhe romë. Në tetor të vitit 2009, Ministria e Shëndetësisë i kërkoi komunës të mbyllë barrakat e mbetura dhe të gjejë strehim tjetër për familjet në fjalë. Deri më sot, megjithatë, komuna nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të gjetur një zgjidhje të qëndrueshme për banorët. Në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit ashkali marrin pjesë në mbledhjet e grupit punues komunal për kthim dhe në organet që kanë të bëjnë me kthimin. Në komunat e rajonit po vazhdon kthimi i detyrueshëm, përfshirë këtu Fushë Kosovën/Kosovo Polje dhe Obiliqin/Obilić. Asnjë prej komunave në këtë rajon nuk kanë ndërmarrë ndonjë hap konkret për të zbatuar strategjitë aktuale për riintegrimin e personave të kthyer. Disa komuna, si ajo e Obiliqit/Obilić, kanë ndihmuar personat e riatdhesuar gjatë procedurave të regjistrimit civil dhe duke i njoftuar ata për skemën e mirëqenies sociale.

Gjatë viteve 2009 dhe 2010, në rajonin e Prizrenit janë kthyer 5 familje ashkali dhe 24 persona në komunat e Prizrenit, Suharekës/Suva Reka dhe Rahovecit/Orahovac. Në vitin 2009, dy familje ashkali, të zhvendosura nga Suhareka/Suva Reka në Mamuşa/Mamushë/Mamuša, janë kthyer në komunën e tyre përkatëse pas ndarjes së tokës komunale nga autoritet komunale të Suharekës/Suva Reka. Shtëpitë janë ndërtuar dhe mobiluar nëpërmjet programit të UNDP/SPARK. Gjatë periudhës së raportimit, asnjë vizitë shko-dhe-shih nuk është organizuar për pjesëtarët e komunitetit ashkali në rajonin e Prizrenit. Përfaqësimi dhe

pjesëmarrja e komunitetit ashkali në forumet dhe mekanizmat për kthim mbetet e dobët, duke qenë se vetëm tri pjesëtarë të komunitetit ashkali përfaqësohen në komisionet për komunitete të rajonit, që të gjitha në komunën e Suharekës/Suva Reka. Duket se kjo komunë është destinacioni kryesor për personat e riatdhesuar të komunitetit ashkali, por asnjë hap konkret nuk është ndërmarr për të adresuar këtë çështje.

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Pjesëtarët e komunitetit ashkali përdorin shërbimet dhe institucionet e drejtuara nga Kosova dhe Serbia, kur ato u vihen atyre në dispozicion në vendbanimet e tyre. Disa pjesëtarë të komunitetit ashkali në komunat e Fushës Kosova/Kosovo Polje, Graçanicës/Gračanica, Obiliqit/Obilić, dhe Lipjanit/Lipljan në rajonin e Prishtinës/Priština, dhe në komunat veriore Zubin Potok, Leposavić/Leposaviq, Zvečan/Zvečan dhe në veri të Mitrovicës/Mitrovica shfrytëzojnë institucionet shëndetësore dhe arsimore të drejtuara nga Serbia. Përveç kësaj, ish-punëtorët e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore ende marrin paga miniMeshkuj, ndihmë sociale dhe pensione nga Serbia. Në rajonet tjera, pjesëtarët e komunitetit ashkali priren të shfrytëzojnë institucionet, shërbimet dhe ndihmat kosovare.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Mungesa e regjistrimit apo regjistrimi i kufizuar vazhdon të jetë pengesa kryesore për qasje të barabartë të komunitetit në shërbime publike.

Pjesëtarët e komunitetit ashkali gëzojnë qasje në shërbimet komunale dhe shërbimet publike. Probleme kryesore mbeten regjistrimi civil, mbledhja e mbeturinave dhe mungesa e infrastrukturës në vendbanimet joforMeshkuj. Është shënuar përmirësim në furnizim me energji elektrike, duke marrë parasysh ndërprerjet e gjata nga marsi i vitit 2009 deri më sot, dhe duke marrë parasysh nënshkrimin eventual të marrëveshjeve kolektive ndërmjet disa komuniteteve dhe Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK) për të ngrirë borxhet dhe për pagimin e rregullt të faturave. Për shembull, disa përfaqësues të komunitetit ashkali në rajonet e Gjilanit/Gnjilane dhe Mitrovicës/Mitrovica, dhe ata që banojnë në qendrën sociale në Plementin/Plementina të rajonit të Prishtinës/Priština, kanë nënshkruar marrëveshjet me KEK-un për të lehtësuar regjistrimin dhe pagimin e një shume paushall prej 26 euro për shtëpi.

OJQ “Programi i të Drejtave Civile në Kosovë” i ofron përkrahje komunitetit për marrjen e dokumenteve të gjendjes civile.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë shprehur kënaqësinë me nivelin e qasjes në shërbimet komunale ku ata banojnë. Siç raportohet, ata marrin dokumentet personale dhe të kadastrit pa ndonjë pengesë të madhe. Shembull pozitiv është komuna e Ferizajt/Uroševac, ku nismat në dobi të komunitetit janë zbatuar në vitin 2010. Këto nisma përfshijnë ndërtimin e sistemit të ujësjellësit, asfjatimin e tri rrugëve dhe inaugurimin e qendrës së re shëndetësore në lagjen Sallahane/Salahane; drenazhin e bunarit në lagjen Halit Ibishi dhe përkrahjen e ndërtimit të qendrës sociale në lagjen Dubravë/Dubrava. Sa i përket furnizimit me energji elektrike, pjesëtarët e komunitetit ashkali vuajnë nga ndërprerjet dhe shkyçjet për shkak të pamundësisë së tyre



QENDRA PËR KOMUNITETE E NDËRTUAR RISHTAS NË VENDBANIMIN E ASHKALIVE "DUBRAVË/DUBRAVA" NË KOMUNËN E FERIZAJT/UROŠEVAC. KOMUNA PLANIFIKON TA KOMPLETEJË ZHVILLIMIN E INFRASTRUKTURËS DUKE NDËRTUAR EDHE NJË KOPSHT LOJËRASH DHE NJË SHKOLLË NË AFËRSI.

për të paguar këtë shërbim. Komuna e Mitrovicës/Mitrovica ka asfaltuar disa rrugë në vendbanimin e komunitetit ashkali "2 Korriku/Sitničko Naselje", duke përmirësuar kështu lëvizshmërinë dhe standardet e jetës në këtë vend. Mbledhja e mbeturinave nuk bëhet rregullisht dhe paraqet rrezik serioz për shëndetin e pjesëtarëve të komunitetit. Në komunën e Vushtrisë/Vučitrn, pjesëtarët e komunitetit ashkali ende kanë vështirësi në qasje në prona, shumë prej së cilave janë shkatërruar gjatë trazirave të marsit në vitin 2004. Infrastruktura dhe qasja në shërbimet kryesore, siç janë ndriçimi i rrugëve dhe menaxhimi i mbeturinave, duhet të përmirësohen. Komuniteti ashkali në komunën e Skenderajt/Srbica përbëhet nga dy familje të mëdha dhe këto familje nuk kanë ndonjë vështirësi në lidhje me shërbimet komunale apo publike.

Në rajonin e Pejës/Peć, pjesëtarët e komunitetit ashkali gëzojnë të njëjtën qasje në shërbimet publike si komunitetet tjera që jetojnë në këtë komunë, përfshirë edhe qasjen në regjistrimin civil. Megjithatë, një pjesë e konsiderueshme e këtij komuniteti nuk posedon ndonjë certifikatë të lindjes apo ndonjë dokument të gjendjes civile, gjë që parandalon ata nga gëzimi i të drejtave themelore siç janë qasja në shërbime sociale dhe në pronë. Sa i përket kanalizimit, furnizimit me ujë, energji elektrike dhe mbledhjen e mbeturinave, ka një dallim të madhe prej një komune në komunën tjetër. Përderisa në komunën e Gjakovës/Đakovica këto shërbime janë krijuar dhe janë funksionale, në komunën e Klinës/Klina fshatrat që banojnë nga pjesëtarët e komunitetit ashkali nuk kanë sistem funksional të kanalizimit. Edhe pse ata janë të lidhur me sistemin e furnizimit me ujë, siç raportohet ata nuk kanë ujë të pijshëm. Në rajonin e Prishtinës/Priština, të gjitha vendbanimet ku banojnë pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë qasje në shërbimet themelore publike, megjithëse gjendja e dobët e infrastrukturës çon në dështim të shpeshtë të shërbimeve. Në komunat e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Gračanica/Gračanicës dhe Obiliqit/Obilić, kompania publike përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave nuk i mbledh mbeturinat rregullisht dhe për këtë arsye një numër i madh i deponive të paligjshme janë krijuar në afërsi të këtyre vendbanimeve. Në rajonin e Prizrenit, pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë qasje në shërbimet komunale dhe ato publike. Në bazë të kërkesës nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorati komunal për Administratë – zyra e regjistrimit civil në komunat

Prizren dhe Suharekë/Suva Reka – më 13 prill 2010 zyrtarisht ftoi banorët e paregjistruar të komunitetit ashkali për të dorëzuar aplikacionet e tyre për regjistrim civil dhe i ka liruar ata nga pagesa e obligueshme administrative. Nisma ishte reagim ndaj rekomandimit të paraqitur në Strategjinë për Integrimin e Komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, për të mundësuar regjistrimin civil të këtyre komuniteteve. Për më shumë, zyrtari komunal për kthim në Suharekë/Suva Reka dhe kryesuesi i komisionit për komunitete kanë filluar një fushatë regjistrimi derë-më-derë, për të vërtetuar numrin e pjesëtarëve të komunitetit ashkali të paregjistruar dhe për të provuar sanimin e gjendjes aktuale.

6. Qasja në shërbime sociale

Në Prizren, 53 familje të komunitetit ashkali (248 persona) marrin ndihma sociale nga zyra rajonale për mirëqenie sociale. Në Suharekë/Suva Reka, 30 familje ashkali (169 persona) marrin ndihma sociale.

Gjendja nuk ka ndryshuar që nga viti 2009, duke qenë se shumica e popullsisë së komunitetit ashkali vazhdojnë të mbështeten gjerësisht në ndihmat e mirëqenies sociale. Në disa raste të caktuara, Departamenti për Mirëqenie Sociale i Kosovës ka vonuar sigurimin e ndihmës sociale mujore, por nuk është vërejtur asnjë veprim diskriminues. Megjithatë, është e qartë që ndikimi i ndihmës sociale për të zbutur varfërinë e pjesëtarëve të komunitetit ashkali është i kufizuar. Shumë prej tyre ankohen që skema nuk është edhe aq gjithëpërfshirëse sa për të ndihmuar më të varfrit, duke i lënë shumicën pa ndonjë përkrahje për shkak të kriterëve të rrepta për fitimin e së drejtës në ndihmë sociale. Edhe kur ndihma sociale sigurohet, ajo nuk është e mjaftueshme për të mbajtur një familje. Duket që gjendja është njëjtë e vështirë për femrat dhe meshkujt e komunitetit ashkali.

7. Qasja në pronë dhe banim

Deri më tani, personat e zhvendosur të komunitetit ashkali nga fshati Dashec/Dosevac, komuna Skenderaj/Srbica, nuk kanë pasur mundësinë e kthimit të pronave të tyre të shkatërruara në vitin 1999.

Pjesëtarët e komunitetit ashkali ballafaqohen me sfida për të gëzuar të drejtat e pronës dhe për të pasur qasje në pronë dhe po ashtu për të garantuar zotërimin e sigurt të saj. Faktorët që kontribuojnë në këtë gjë janë: mungesa e gjerë e dokumenteve përkatëse; shkatërrimi i dokumentacionit që dëshmon të drejtat e pronës; mosfunksionimi i zyrave komunale të kadastrit dhe keqkuptimi mbizotërues në komunitet sa u përket të drejtave të tyre të pronës. Shumë pjesëtarë të komunitetit ashkali nuk zotërojnë tokë, përderisa të tjerëve u mungojnë titujt e pronave dhe lejet e ndërtimit, apo edhe nuk kanë regjistruar

NDËRTESE E BANIMIT SOCIAL NË PLEMENTINË/PLEMENTINA TË KOMUNËS SË OBILIQIT/OBILIĆ, KU NË VITIN 2006 U RIVENDOSËN FAMILJE ROMË DHE ASHKALI QË DIKUR QËNDRONIN NË NJË KAMP PËR PERSONA TË ZHVENDOSUR NË AFËRSI. BANIMI I FAMILJEVE ASHKALI NË OBJEKTE VERTIKALE BANIMI SIÇ ËSHTË KY VAZHDON TË NGRITË BRENGA RRETH PËRSHTATSHMËRISË SË TIJ ME TRADITAT E KOMUNITETIT.



zyrtarisht transaksionet e pronës. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, shumë pjesëtarë të komunitetit ashkali banojnë në vendbanimet joforMeshkuj në komunën e Ferizajt/Uroševac. Më 31 mars 2010, komuna dhe OJQ “Programi i të Drejtave Civile në Kosovë” kanë nënshkruar një memorandum mirëkuptimi për të liruuar pjesëtarët e komunitetit ashkali nga pagesa e tatimeve komunale për regjistrimin e pronës së tyre. Më 26 shkurt 2010, Komuna e Kamenicës/Kamenica nënshkroi një marrëveshje të ngjashme. Shumë shtëpi të pjesëtarëve të komunitetit ashkali janë të vjetra dhe në gjendje të mjerueshme, posaçërisht në lagjen Dubravë/Dubrava të komunës së Ferizajt/Uroševac. Disa shtëpi në lagjet Halit Ibishi/Halit Ibiși dhe Sallahanë/Salahane, të dyja në komunën e Ferizajt/Uroševac, janë po ashtu në gjendje të keqe. Sistemi i ujësjellësit në Dubravë/Dubrava është i ndotur. Rreth 20 shtëpi në lagjet Halit Ibishi/Halit Ibiși dhe Sallahanë/Salahane nuk janë të kyçura në sistemet e ujësjellësit dhe kanalizimit dhe familjet jetojnë në kushte të pashëndetshme. Në Mitrovicë/Mitrovica, pjesëtarët e komunitetit ashkali që banojnë në vendbanimin “2 Korriku/Sitničko Naselje” kanë probleme në rikthimin e pronës dhe tokës së tyre të uzurpuar për shkak të mungesës së titullarëve të pronës. Në Vushtrri/Vučitrn, kufijtë kadastrale të shtëpive të pjesëtarëve të komunitetit ashkali, që janë shkatërruar gjatë luftës, është vështirë të gjinden dhe kjo gjë së bashku me shënimet kadastrale të pasakta ose jo të plota, ia vështirëson pjesëtarëve të komunitetit ashkali kërkesat për të drejtat e tyre pronësore. Kushtet e jetesës të komunitetit në përgjithësi janë të këqija. Në rajonin e Pejës/Peć, disa familje ashklike që jetojnë në Gjakovë/Đakovica kanë përfituar nga vendimi i Kuvendit Komunal, që ishte marrë në shtator të vitit 2008, për të ndarë tokën për banorët e lagjes “Ali Ibra/Kolonia”. Projekti, nëpërmjet së cilit synohet rregullimi i vendbanimeve joforMeshkuj, është në zbatim e sipër dhe pritet të përfundojë në vitin 2012.⁴

Edhe pse janë pesë vendbanime joforMeshkuj të mëdha në rajonin e Prishtinës/Priština, katër në Fushë-Kosovë/Kosovo-Polje dhe një në Podujevë/Podujevo, këto komuna ende priten të ndër marrin hapa për të rregulluar ato vendbanime. Për shkak të shqetësimeve të sigurisë për kthim në vendin e origjinës, disa familje ashkali kanë kërkuar dhe kanë marrë tokë komunale në lokacione të ndryshme, në të cilat tashmë ishin kthyer disa familje ashkali, si për shembull në Plemetin/Plemetina të komunës së Obiliqit/Obilić dhe në Magurë/Magura të komunës së Lipjanit/Lipljan. Megjithatë tri familje ende banojnë në ish-kampin e Plemetinës/Plemetina, që të gjitha nga komuna e Lipjanit/Lipljan. Përpjekjet për të mundësuar kthimin e tyre në Lipjan/Lipljan kanë dështuar dhe ata përfundimisht janë vendosur në fshatin Plemetin/Plemetina. Mungesa e sigurisë së zotërimit dhe dokumentacionit për pronën paraqesin një ndër shqetësimet kryesore për të drejtat pronësore të pjesëtarëve të komunitetit ashkali në rajonin e Prizrenit. Janë raportuar disa zhvillime pozitive në komunën e Suharekës/Suva Reka, ku dy familje ashkali, dhjetë vite pas zhvendosjes së tyre, kanë përfituar nga ndihma për rindërtimin e shtëpive në tokën komunale.

8. Qasja në arsim

Fëmijët ashkali ndikohen nga mungesa e regjistrimit dhe nivelit të lartë të braktisjes nga arsimi i obligueshëm. Për shkak të varfërisë, favorizimit të djemëve nga prindërit, punës së fëmijëve, martesave në moshë të



NJË VAJZË ASHKALI TE SHTËPIA E SAJ NË VENDBANIMIN JOFORMAL “DUBRAVË/DUBRAVA” NË KOMUNËN E FERIZAJT/UROŠEVAC, KU JETOJNË RRETH 1200 ASHKALI PA ZOTËRIM TË SIGURT TË PRONËS. PËR MË TEPËR, NUK KA KURRFARË PLANESH TË KOMUNËS PËR TA RREGULLUAR VENDBANIMIN APO PËR T’I PËRMIRËSUAR KUSHTET E JETËS PËR BANORËT E SAJ.

Në muajin mars të vitit 2010, Kryeministri i Kosovës u ka dërguar një letër komunave, duke i ftuar Kryetarët që të ndajnë tokën për të kthyerit dhe personat e zhvendosur, për përdorim afatgjatë deri në 99 vite dhe për të siguruar qasje afatgjate dhe të qëndrueshme në strehim.

⁴ Projekti ka filluar në shtator të vitit 2009, në bazë të memorandumit të mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Zyrës për Çështje të Komuniteteve, Komunës e Gjakovës/akovica, Caritas zviceran dhe përfaqësuesve të komunitetit. Për më shumë informata, lexoni kapitullin Qasja në pronë dhe banim të profilit të komunitetit egjiptian.

SHKOLLA "SELMAN RIZA" NË FUSHË KOSOVË/KOSOVO POLJE, KU NXËNËSIT SHQIPTARË TË KOSOVËS DHE ROMË E VIJOJNË MËSIMIN SË BASHKU SIPAS KURRIKULËS SË KOSOVËS.



Për shkak të varfërisë, favorizimit të djemve nga prindërit, punës së fëmijëve, martesave në moshë të hershme dhe për shkak se vajzat mbahen për të kryer punët e amvisërisë dhe për t'u kujdesur për vëllezërit dhe motrat më të rinj, një numër i madh i nxënësve femra të komunitetit ashkali braktisin shkollën.

hershme dhe për shkak se vajzat thirren për të kryer punët e amvisërisë dhe për tu përkujdesur për vëllezërit dhe motrat më të rinj, një numër i madh i nxënësve femra të komunitetit ashkali braktisin shkollën dhe në disa raste edhe para përfundimit të arsimit të obligueshëm. Faktorët tjerë që janë pamundësia financiare e familjes për të paguar kostot e arsimit, përfshirë edhe pagesën për libra shkollor dhe mjete tjera, veshmbathje, ushqim dhe transport, i kontribuojnë këtij problemi. Për shkak të pengesave të lartpërmendura financiare dhe bursave të pamjaftueshme, shumë pak nxënës të komunitetit ashkali mbarojnë arsimin e obligueshëm dhe vetëm disa arrijnë më vonë të regjistrohen në arsimin e mesëm dhe të lartë. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit ashkali flasin gjuhën shqipe si gjuhë të tyre të parë dhe për këtë arsye vijojnë kurrikulat shkollore të Kosovës në gjuhën shqipe. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka shpërndarë falas librat shkollor për studentët prej klasës së 1-rë deri në të 9-ën, për kurrikulat e Kosovës në gjuhën shqipe në vitin 2009. Kjo ka ndihmuar në pjesëmarrjen e vazhdueshme të nxënësve të komunitetit ashkali.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, asnjë shqetësim i veçantë nuk është paraqitur nga përfaqësuesit e komunitetit në lidhje me qasjen në arsim. Pjesëtarët e komunitetit ashkali gëzojnë qasje të plotë në kurrikulat shkollore të Kosovës në gjuhën shqipe dhe ndajnë të njëjtin objekt shkollor me nxënësit e komuniteteve tjera, që u mundëson atyre një shkallë të caktuar ndërveprimi ndërmjet tyre. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, nxënësit e komunitetit ashkali në përgjithësi vijojnë kurrikulën shkollore të Kosovës në gjuhën shqipe, përveç atyre që jetojnë në veriun e Mitrovicës/Mitrovica, që vijojnë kurrikulat shkollore të Serbisë. Në rajonin e Pejës/Peć, pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë qasje në kurrikulat shkollore të Kosovës dhe në disa raste janë organizuar ngjarje sportive dhe kulturore shumetnike për të promovuar dialogun ndërmjet komuniteteve në mes të nxënësve dhe mësuesve të komuniteteve të ndryshme. Për shembull, më 01 qershor 2010, shkollat "Zef Lush Marku" dhe "Mazllom Kpuska", që janë në afërsi të vendbanimeve joforMeshkuj Brekovc/Brekovac dhe "Kolonja" të komunës së Gjakovës/Đakovica, kanë organizuar një piknik për nxënësit me rastin e festimit të ditës ndërkombëtare të fëmijëve. Në qendrën për komunitete në vendbanimin joformal "Kolonja" të komunës së Gjakovës/Đakovica, OJQ "Christian Bethany Service" ofron arsim parashkollor, që përndryshe

nuk do të mund të sigurohej. Gjithashtu në komunën e Gjakovës/Đakovica, zyra komunale për komunitete ka organizuar një fushatë për ngritjen e vetëdijesimit për rëndësinë e arsimit në fillim të çdo viti, duke shënjestruar kështu pjesëtarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian edhe pse deri në tani nuk është shënuar ndonjë përmirësim i theksuar. Në komunën e Klinës/Klina, vetëm tetë nga 200 fëmijë të komunitetit ashkali janë regjistruar në arsimin fillor përderisa asnjë tjetër nuk ndjek arsimin e mesëm apo të lartë, për shkak të pengesave socio-ekonomike. Për të përmirësuar këtë situatë, drejtorët dhe mësuesit e shkollave kanë krijuar një komision, anëtarët e së cilit vizitojnë familjet ashkali për të nxitur regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Deri më sot, nisma ka rezultuar me kthimin e dy fëmijëve në shkollë në fshatin Budisavc/Budisavci. Komuna u ka siguruar këtyre familjeve pajisje shkollore falas.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, asnjë fëmijë i komunitetit ashkali nuk është regjistruar në shkollat e drejtuara nga institucionet e Kosovës, për shkak të mungesës së interesit të tyre dhe kufizimeve financiare. OJQ-të, si Balkan Sunflowers, kanë siguruar arsim parashkollor për disa pjesëtarë të komunitetit ashkali në komunën e Obiliqit/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Gračanica/Graçanicës. Rreth 1.300 nxënës të komunitetit ashkali vijojnë shkollat fillore sipas kurrikulës së Kosovës, në komunat ku komuniteti banon. Në rajonin e Prizrenit, shumica dërmuese e fëmijëve të moshës shkollore të komunitetit ashkali vijojnë kurrikulat e Kosovës në gjuhën shqipe, edhe pse disa nxënës vijojnë kurrikulat e Kosovës në gjuhën boshnjake apo turke. Për shkak se jo të gjithë librat shkollor, sipas kurrikulës kosovare, nuk janë aktualisht në dispozicion në gjuhën turke dhe boshnjake, këta nxënës ballafaqohen me pengesa më të mëdha se sa nxënësit që vijojnë mësimin në gjuhën shqipe dhe që marrin librat shkollor falas.

Në vitin 2007 dhe 2008, një mësues ashkali në komunën e Vushtrisë/Vučitrn të rajonit të Mitrovicës /Mitrovica, ka zbatuar një projekt, në bashkëpunim me Ministrinë kosovare për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, për të ndimuar të rinjtë ashkali për të mbaruar arsimin fillor dhe të mesëm. Mungesa e fondeve ka ndërprerë një nismë që ka pasur disa rezultate pozitive.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit ashkali gëzojnë qasje në objektet dhe shërbimet shëndetësore pa ndonjë vështirësi, edhe pse çmimi i barnave dhe mjekimit paraqet pengesë. Përrjashtimi i pjesëtarëve të komunitetit ashkali nga skema e ndihmës sociale, të cilët shpesh herë nuk përmbushin kriteret e rrepta të përcaktuara me ligj, edhe pse jetojnë në varfëri, pengon qasjen e atyre në këto shërbime. Për shkak të kushteve të rënda të jetës, pjesëtarët e komunitetit shpesh herë i ekspozohen ndaj helmimit dhe transmetimit të sëmundjeve. Shumica e pjesëtarëve të komunitetit ashkali kanë qasje në objektet dhe shërbimet e drejtuara nga Kosova. Disa pjesëtarë të komunitetit, që banojnë në rajonin e Prishtinës/Priština dhe në veriun e Mitrovica/Mitrovicës, shfrytëzojnë strukturat e drejtuara nga Serbia. Pjesëtarët e komunitetit ashkali në rajonin e Gjilanit/Gnjilane kanë qasje në objektet dhe shërbimet shëndetësore në Ferizaj/Uroševac dhe në Prishtinë/Priština. Edhe pse përballeshmëria financiare mbetet një sfidë për kujdes shëndetësor, fëmijët e komunitetit ashkali marrin vaksinat e obligueshme. Pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë po ashtu qasje në planifikimin familjar dhe shëndetin riprodhues. Pjesëtarët e komunitetit ashkali në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica udhëtojnë për në spitalin e Prishtinës/Priština apo edhe për në qendrën mjekësore në Mitrovicën/Mitrovica e jugut. Në komunën e Mitrovicës/Mitrovica së jugut, Vushtrisë/Vučitrn dhe Skenderajt/Srbica, ofrohet kujdesi shëndetësor falas për ata që

kanë të drejtë në ndihmat e mirëqenies sociale, edhe pse çmimi i barnave mbetet një pengesë kritike. Në anën tjetër, pjesëtarët e komunitetit ashkali që banojnë në kampet në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica pranojnë kujdes shëndetësor falas nga institucionet e drejtuara nga Serbia.

Në rajonin e Pejës/Peć, çështja e përballueshmërisë financiare dhe mungesa e vetëdijesimit në komunitet për çështjet shëndetësore mbesin pengesat kryesore për qasjen e plotë dhe të papenguar në kujdesin dhe shërbimin shëndetësor. Për shembull, mungesa e vetëdijesimit për shëndetin dhe higjienën, dhe po ashtu edhe për rëndësinë e vaksinimit, ndikon negativisht në mirëqenien e komunitetit. Edhe pse lindjet në shtëpi janë ende të zakonshme në këtë komunitet, dhe përkundër faktit që të dhënat zyrtare nuk mund të sigurohen nga qendrat e mjekësisë familjare në komunat e Klinës/Klina dhe Pejës/Peć, duket që shkalla e lindjes ka rënë dramatikisht që nga viti 2008. Grave që lindin në shtëpi zakonisht nuk u ofrohet përkrahje mjekësore. Në rajonin e Prishtinës/Priština, pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë qasje në qendrat e kujdesit shëndetësor në çdo komunë ku komuniteti jeton. Në shumicën e fshatrave të largëta ka edhe ambulanta, në të cilat kanë qasje pjesëtarët e komunitetit ashkali. Pjesëtarët e komunitetit ashkali, që posedojnë kartelat e shënimeve shëndetësore, kanë qasje në objektet e drejtuara nga Serbia në fshatrat me shumicë serbe të Kosovës të Laplje Selo/Llapllasellës, Çagllavicë/Čaglavica dhe Ugljare/Uglar, në komunën e porsaformuar të Gračanicës/Gračanica Komuna dhe në fshatin Lepina/Lepi të komunës së Lipjanit/Lipljan. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti nuk ka raportuar se ka ndonjë problem të veçantë sa i përket qasjes në shërbimet shëndetësore, përveç çështjes së përhapur të përballueshmërisë financiare. Pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë qasje në spitalin rajonal të Prizrenit dhe po ashtu në qendrën e mjekësisë familjare dhe në “ambulantat” që gjinden në Prizren, Mamuša/Mamushë/Mamuša, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka dhe Malishevë/Mališevo.

10. Qasja në drejtësi

Pjesëtarët e komunitetit ashkali kanë qasje në sistemin e drejtësisë të Kosovës dhe përfaqësuesit e komunitetit, nga të gjitha rajonet, nuk kanë paraqitur ndonjë ankesë të veçantë për trajtim apo sjellje diskriminuese. Ashtu siç është rasti me komunitetet tjera, edhe në komunitetin ashkali ka një mungesë të përgjithshme të njohurive për të drejtat e tyre, procedurat dhe mundësitë për ndihmë juridike falas. Po ashtu, gratë nuk gëzojnë qasje të plotë në sistemin e drejtësisë për shkak të strukturës mbizotëruese patriarkale të komunitetit. Përveç një pjesëtari të komunitetit ashkali që punon në Gjykatën Komunale për Kundërvajtje në Vushtrri/Vučitrn, asnjë pjesëtar tjetër i komunitetit nuk është i punësuar në sistemin e drejtësisë.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Komuniteti ashkali në përgjithësi nuk është mirë i përfaqësuar në jetën publike, edhe pse është pak më mirë i përfaqësuar në nivel komunal duke marrë parasysh fitoret modeste në zgjedhjet komunale në nëntor të vitit 2009. Tre pjesëtarë të komunitetit ashkali përfaqësojnë komunitetin në Kuvendin e Kosovës⁵, ndërsa dy ashkali kanë vende të rezervuara në

⁵ Komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian kanë katër ulëse të garantuara në Kuvendin e Kosovës. Në zgjedhjet e përgjithshme, të mbajtura në nëntor të vitit 2007, një romë, një egjiptian dhe tri pjesëtarë të komunitetit ashkali janë zgjedhur si deputetë në Kuvendin e Kosovës.

këshillin konsultativ për komunitete: një organ këshillues që vepron nën zyrën e Presidentit të Kosovës. Në zgjedhjet e vitit 2009, komuniteti ka fituar në Gjithsej tri ulëse në kuvendet komunale në tërë Kosovën, përkatësisht në komunat Ferizaj/Uroevac dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje edhe ku ka një prani të madhe të komunitetit. Duke marrë parasysh numrin e votuesve ashkali të regjistruar, një pjesëmarrje më e madhe e komunitetit do të siguronte komunitetit edhe një vend në kuvendin komunal të Lipjanit/Lipljan. Në përgjithësi, komuniteti nuk është i përfaqësuar në degën ekzekutive të komunave por ata janë të përfaqësuar në zyrat komunale për komunitete dhe komisionet komunale për komunitetet. Komuniteti ashkali është politikisht i përfaqësuar nga Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK).⁶ Faktorët që ndikojnë në pjesëmarrjen e ulët të komunitetit në çështjet publike janë: mungesa e kualifikimeve profesionale dhe arsimore, që minon vetëbesimin e përfaqësuesve të komunitetit për të angazhuar në mënyrë aktive në politikën komunale dhe mungesa e nismave nga komunat për të përkrahur dhe promovuar pjesëmarrjen e tyre. Gratë e komunitetit ashkali nuk marrin pjesë në sferën e çështjeve publike, duke qenë se tradita dhe kultura mbizotëruese e komunitetit favorizon rolin e tyre në shtëpi. Nuk ka media të shtypura apo transmetuese që mbulon çështjet specifike të komunitetit ashkali.

Komuniteti ashkali në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, që kryesisht banon në komunën e Ferizajt/Uroevac, është relativisht i përfaqësuar mirë në organet komunale. Shefi i zyrës komunale për komunitete, kryesuesi i komisionit për komunitete dhe dy anëtarë të kuvendit komunal janë pjesëtarë të komunitetit ashkali. Në përgjithësi, pjesëmarrja e tyre në degën legjislative është e kënaqshme por kryesisht sigurohet nëpërmjet zyrës komunale për komunitete. Pozita e zëvendës-kryesuesit të kuvendit komunal për komunitete, në komunën e Ferizaj/Uroevac, nuk zënë deri pas zgjedhje komunale në nëntor të vitit 2009. Zyra komunale për komunitete është e angazhuar në aktivitete të informimit të pjesëtarëve të komunitetit ashkali. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, pjesëtarët e komunitetit ashkali nuk janë të përfaqësuar në organet legjislative apo ekzekutive. Për këtë arsye, pjesëmarrja e komunitetit në çështjet publike ka çaluar. Për më shumë, asnjë pjesëtar i komunitetit ashkali nuk është i punësuar nga autoritetet komunale të rajonit. Megjithatë, komuniteti është i përfaqësuar në komisionet komunale për komunitete në komunat e Mitrovicës/Mitrovica, Skenderajt/Srbica dhe Vushtrisë/Vučitrn. Asnjë prej komunave të rajonit nuk ka ndërmarrë ndonjë përpjekje të veçantë për të inkurajuar pjesëmarrjen e mëtutjeshme të komunitetit në jetën komunale.

Në rajonin e Pejës/Peć, pjesëmarrja e kufizuar në çështjet publike e komunitetit ashkali pasqyrohet nga numri i tyre i vogël në rajon. Komuniteti nuk përfaqësohet në komisionet komunale të komunave Gjakovë/akovica dhe Klinë/Klina. Komuniteti rrallë herë merre pjesë në diskutimet publike të organizuara nga komuna, ndërsa përpjekjet e komunave të rajonit për të organizuar aktivitete informimi ose kanë munguar në tërësi ose kanë qenë të pamjaftueshme. Në rajonin e Prishtinës/Priatina, komuniteti ashkali nuk përfaqësohet në degën ekzekutive të komunave ku ata banojnë, por kanë një ulëse në kuvendin komunal të Fushë-Kosovë/Kosovo Polje dhe po ashtu disa pozita në zyrën komunale për komunitete në komunat e Fushë-Kosovës/Kosovo-Polje dhe Lipjanit/Lipljan. Gjithashtu, komuniteti është i përfaqësuar

Pjesëmarrja e komunitetit ashkali në çështjet publike mbetet e pamjaftueshme dhe mbështetet në punën dhe angazhimin e tyre në zyrat komunale për komunitetet dhe komisionet komunale për komunitete.

Një Plan i Veprimit është miratuar në muajin dhjetor të vitit 2009 me qëllim të zbatimit të Strategjisë për integrimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, që është miratuar në vitin 2008. Plani i Veprimit parasheh masa konkrete të cilat, ndër të tjera, synojnë të përmirësojnë pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë kosovare.

⁶ Në muajin shtator të vitit 2008, PDAK (Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës) është ndarë dhe është formuar Bashkimi Demokratik i Ashkalive (BDA), që më pas ka mbajtur një prej tri ulësive në Kuvendi. PDAK mbajti dy ulëset tjera. Në muajin prill të vitit 2010, të dy partitë janë ribashkuar.

në komisionet për komunitet të rajonit, përveç Prishtinës/Priatina dhe Gracanica/Graçanicës. Nuk organizohen aktivitete publike të informimit për të promovuar pjesëmarrjen e komunitetit. Komunikimi ndërmjet komunitetit dhe autoriteteve komunale bëhet nëpërmes udhëheqësve të komunitetit. Në rajonin e Prizrenit, pjesëmarrja e komunitetit ashkali në çështjet publike mbetet e dobët. Komuniteti është i përqendruar në komunat Prizren dhe Suharekë/Suva Reka, ku një pjesëtar i komunitetit ashkali punon si shërbyes civil dhe tri tjerë marrin pjesë në komitetin për komunitete në Suharekë/Suva Reka. Megjithatë, asnjë pjesëtar tjetër nuk mban ndonjë pozitë në degën legjislative apo në atë vendimmarrëse. Vetëm në disa raste të rralla autoritet komunale kanë ndërmarr ndonjë aktivitet të informimit, në përpjekje për të inkurajuar pjesëmarrjen e komunitetit ashkali në çështjet publike. Në vitin 2010 janë mbajtur mbledhjet e grupit punues për hartimin e planit lokal të veprimit të Prizrenit për Strategjinë e Integritimit të Komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian në Kosovë, që është në kuadër të projektit të Fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur. Përfaqësuesit e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian, organizatat lokale joqeveritare dhe organizatat ndërkombëtare kanë marrë pjesë, ndërsa zyrtarët komunal, që ishin ftuar, nuk kanë marrë pjesë në këto mbledhje.

12. Përdorimi i gjuhës

Gjuha amtare e komunitetit ashkali është gjuha shqipe, që lehtëson ndërveprimin me institucionet qendrore dhe lokale dhe ofruesit e shërbimeve. Mundësia e komunitetit që të komunikojë në gjuhën shqipe ka ndikim pozitiv në lirinë e tyre të lëvizjes. Komuniteti ka qasje në mediat e shtypura dhe të transmetuara, që janë në gjuhën shqipe. Siç raportohet, disa pjesëtarë të moshuar të komunitetit ashkali gjithashtu flasin dhe përdorin privatisht gjuhën serbe.

13. Trashëgimia kulturore

Komuniteti ashkali kryesisht i takon besimit myslimanë dhe në përgjithësi është i lirë të shpreh identitetin e tij kulturor, besimet fetare dhe zakonet.

PUNËT NDËRTIMORE NË XHAMINË E PARAQITUR PËR ASHKALITË NË LAGJEN "SALAHANE" NË FERIZAJ/UROŠEVAC JANË DUKE VAZHDUAR. KOMUNITETI FILLOI T'I MBLEDHË TË HOLLAT NË VITIN 2008 DHE PRITET QË DO TA KETË VENDIN E VET TË FALJES DERI NË FUND TË VITIT 2010.



Vendi më i vjetër i trashëgimisë kulturore në rajonin e Gjilanit/Gnjilane është varreza në fshatin Dubravë/Dubrava të Ferizajt/Uroaevac. Xhamia, që është afër varrezës, është ndërtuar në vitin 1989 dhe gati ekskluzivisht përdoret nga pjesëtarët e komunitetit ashkali dhe kjo mund të konsiderohet edhe si një vend i trashëgimisë kulturore. Veç kësaj, pjesëtarët e komunitetit ashkali në lagjen Sallahane/Salahane, në komunën e Ferizajt/Uroaevac, kanë ndërtuar xhaminë e re me fonde nga diaspora ashkallike. Në komunën e Gjakovës/akovica të rajonit të Pejës/Peć, janë dy xhami që përdoren shpesh nga komuniteti ashkali. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti përmend një varrezë të vjetër ashkallike në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn si shembull të trashëgimisë së tij kulturore. Megjithatë kjo varrezë është në gjendje të mjerueshme dhe ajo duhet të pastrohet dhe të vendosen rrethoja. Komuniteti feston Ditën Memoriale të Ashkalive më 15 shkurt: festë që është përcaktuar me Ligjin për Festat Zyrtare. Nuk është raportuar për ndonjë aktivitet të përkrahur nga komuna për të shënuar këtë festë në vitin 2010, gjë që nga disa përfaqësues të komunitetit ashkali është konsideruar si një tregues i mungesës së përgjithshme të interesit për komunitetin. Komuniteti feston Ditën Memoriale të Ashkalive më 15 shkurt, festë që është paraparë me Ligjin për Festat Zyrtare.

The community celebrates the Ashkali Memorial Day on 15 February, a date included in the Law on Official Holidays.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Ndërlidhja e komunitetit ashkali me shqiptarët e Kosovës vazhdon të përcaktojë marrëdhëniet e tyre me komunitetet tjera në Kosovë. Emërtuesit e përbashkët, si gjuha dhe feja, u kanë mundësuar pjesëtarëve të komunitetit ashkali afërsinë me fqinjët shqiptar të Kosovës dhe ky është një faktor pozitiv që ka kontribuar në marrëdhëniet aktuale fqinjësore. Megjithatë, marginalizimi i vazhdueshëm i komunitetit ashkali nënkupton se mungesa e angazhimit në proceset e dialogut institucional dhe forumet e tjera nuk ka edhe aq shumë të bëjë me konfliktin ndërmjet komuniteteve dhe më shumë me paragjykimet e përhapura dhe përjashtimin sociale. Në ato komuna ku komuniteti ashkali nuk është edhe aq mirë i përfaqësuar në organet komunale dhe shërbimin civil,



DREJTUESI I QENDRËS PËR KOMUNITETIN ASHKALI NË VENDBANIMIN "DUBRAVË/DUBRAVA" NË KOMUNËN E FERIZAJT/UROŠEVAC, KU TREGOHET FLAMURI I ASHKALIVE DHE AI I KOSOVËS SI SIMBOL PËR DËSHIRËN E KOMUNITETIT PËR T'U INTEGRUAR NË SHOQËRINË E KOSOVËS.

mundësitë për angazhim në nismat e dialogut ndërmjet komuniteteve janë të kufizuara. Gjithashtu, angazhimi i komunitetit ashkali në nismat e shoqërisë civile për dialog mbetet i kufizuar për shkak të numrit të vogël të vetë-organizimit të komunitetit. Roli i grave dhe vajzave të komunitetit ashkali në promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve mbetet i kufizuar për shkak të pjesëmarrjes së pamjaftueshme në jetën publike.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti ashkali është i përfaqësuar mirë në zyrën komunale për komunitete të Ferizajt/Uroaevac, që lehtëson dialogun zyrtar ndërmjet komuniteteve. Komunikimi i përditshëm i shërbyesve civil dhe përfaqësuesve të komunitetit ashkali me kolegët e tyre shqiptar të Kosovës, kontribuon në përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike. Përfaqësuesit e komunitetit ashkali dhe vetë komuniteti ftohen dhe marrin pjesë në ngjarjet publike të organizuara nga komuna, shkollat dhe institucionet tjera. Për më shumë, komuna mbështet festën zyrtare të komunitetit ashkali, që është më 15 shkurt, duke organizuar ngjarje për të shënuar këtë festë. Megjithatë shumë mosmarrëveshje me fqinjët shqiptar të Kosovës për çështje të ndryshme praktike, dhe trajtimi i dobët i fëmijëve ashkali në shkolla, nuk janë gjithmonë të diskutuara gjatë dialogut ndër-etnik. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, përfaqësuesit e komunitetit ashkali marrin pjesë aktivisht në nismat komunale dhe ato të shoqërisë civile për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve, siç janë ngjarjet sportive apo kulturore. Komuniteti ashkali është rregullisht i përfaqësuar në forumet e dialogut zyrtar, që adresojnë të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Edhe pse marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve janë të mira në tërë rajonin, ka një zemërim në rritje tek shqiptarët e Kosovës në qytetin e Mitrovicës/Mitrovica kundër të kthyerve të komunitetit ashkali në lagjen Roma Mahalla, të cilët kanë përfituar nga ndihma për rindërtimin e shtëpive dhe mbështetja tjetër. Komuna dhe organizata ndërkombëtare janë duke u munduar të adresojnë këtë problem, nëpërmjet promovimit të dialogut ndërmjet të kthyerve dhe të komuniteteve pritëse.

Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti ashkali ka marrëdhënie të mira dhe komunitetet tjera dhe rregullisht merr pjesë në aktivitetet shumetnike të organizuara nga komuna dhe shoqëria civile. Megjithatë në rajonin e Prishtinës/Priatina, ku komuniteti është më dobët i organizuar, pjesëmarrja e tyre në nismat komunale dhe të shoqërisë civile për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve është shumë i rrallë. Udhëheqësit e komunitetit pohojnë që aktivitete më të shumta të informimit nga autoritetet komunale, dhe përfaqësimi më i madh i komunitetit ashkali në institucionet komunale dhe forumet për komunitetet, do të rriste mundësitë për dialog zyrtar dhe marrëdhënie më të mira ndërmjet komuniteteve. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti ashkali është në përgjithësi i integruar mirë dhe ka marrëdhënie të mira me komunitetet tjera, dhe merr pjesë në nismat zyrtare dhe jozyrtare për dialog ndërmjet komuniteteve.

Shtojca¹

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit

* (Ju lutemi keni parasysh që fushat e zbrazëta dhe/ose të shënuara me – tregojnë që të dhënat nuk janë të besueshme ose nuk janë gjetur, ose “nuk zbatohen”, varësisht nga kategoria)



Tabela 1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti ashkali
Gjilan/ Grijllane	Ferizaj/ Uroševac	Dubravë/Dubrava, Halit Ibishi/Halit Ibiši, Koci Xoxe/Koce Xoxe, Sallahanë/Salahane
Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovicë/ Mitrovica	Vendbanimi joformal “Dy Korriku/Sitničko Naselje”
	Skenderaj/ Srbica	Kopiliq/Obilić,Runik/Rudnik
	Vushtrri/ Vuçitrn	Vushtrri/Vuçitrn, Bukosh/Bukoš, Stanovci i Poshtëm/Donje Stanovce
	Gjakovë/ Djakovica	Vendbanimi Kolonia, qyteti i Gjakovës/Đakovica
	Klinë/ Klina	Klinafc/Klinavac, Zajm/Zajmovo, Berkovë/Berkovo, Resnik/Resnik, Jashanicë/Jošanica dhe Grabanicë/Grabanica
Pristinë/ Prishtina	FushëKosovë/ Kosovo Polje	Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lismir/Dobri Dub, Henc/Ence, Bresje/Bresje
	Gračanica/ Gračanicë,	Çaglavica/Çagllavicë, Laplje Selo/Llapllasellë, Preoce/Preoc Ugljare/Uglar, Gushtericë e Ulët/ Donja Gušterica dhe Radevë/Radevo
	Lipjan/ Lipljan	Lipjan/Lipljan, Janjevë/ Janjevo, Sillovi/Slovinje, Gadime e Ulët/ Donje Gadimlje, Magurë/ Magura, Vrellë/Vrelo, Medvec/ Medvece, Dobrajë e Vogel/Mala Dobranja, Hallaq i Vogël/Mali Alaš, Konjuh/ Konjuh
	Obiliq/ Obilić	Obiliq/Obilić, zona e Azotikut, Obiliq i vjetër/Obilić, ndërtesat e banimit social I dhe II në Plemetin/ Plemetina, Caravodicë/Črkvena Vodica
	Podujevë/ Podujevo	Podujevë/Podujevo, Batllavë/Batlava, Orllan/Orlane, Peran/Perane, vendbanimet joforMeshkuj 1, 2 dhe 3 në Podujevë/Podujevo dhe Sfeqël/Svetlje
	Pristinë/ Priština	Pristinë/Priština, Vranjencë/Vranjevac, Dardania, Moravska, Emshir, Kolovicë/Kolovice, lagja e Spitalit, Muhaxher Mahalla and Lagja e Vreshtave dhe fshati Besi/Besinja
	Shtime/ Štimlje	Shtime/Štimlje, Davidoc/Davidovce, Gjurkoc/Đurkovce dhe Vojnoc/Vojinovce
Prizren	Malishevë/ Mališevo	Banjë/Banja, Kijevë/Kijevo
	Prizren	Caparc/Caparce, Krushë e Vogël/Mala Kruša, Landovicë/Landovica, Medvec/Medvece, Piranë/Pirane, Sërbicë e Ulët/Donja Srbica, Mëhalla Rome, Zojq/Zojic
	Rahovec/ Orahovac	Velika Hoça/Hoce e Madhe
	Suharekë/ Suva Reka	Gelanc/Geljance, Leshan/Lešane, Neprebisht/Neprebište, Reshtan/Reštane, Samadragjë/Samadrađe, Studenqan/Studenčane, Shirokë/Široko, Ternë/Trnje

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë²

	Burimi	Numri gjithsej i popullsisë	Komuniteti	%
Gjilan/Gnjilane	Komuna Ferizaj/Uroševac			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981 ³	100,144	1,813	1.8%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991 ⁴	113,668	2,068	1.8%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	160–170,000	3,823	2.3–2.4%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	160–170,000	3,823	2.3–2.4%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009 ⁵	160 – 170,000	3,758	2.3–2.4%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	160 – 170,000	3,820	2.3–2.4%
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Mitrovicë/Mitrovica			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	87,981	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	104,885	4,851	4.62%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	130,000	350	0.26%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	425	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	130,000	-	-
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	130,000	425	0.32%
	Komuna Skenderaj/Srbica			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	46,777	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	55,471	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	72,600	50	0.06%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	72,000	50	0.06%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	72,600	50	0.06%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	72,600	50	0.06%
	Komuna Vushtri/Vučitrn			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	65,512	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	80,644	2,108	2.61%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	102,600	150	0.15%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	100,000	168	0.16%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	102,600	-	-
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	102,600	168	0.16%
Pejë/Peć	Komuna Gjakovë/Đakovica			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	-	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	150,000	270	0.18%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	150,000	270	0.18%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	150,000	270	0.18%
	Komuna Klinë/Klina			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	54,539	906	1.6%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	52,266	1,278	2.4%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	55,000–58,000	200	0.18 -0.17%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	55,000	176	0.32%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	55,000	-	-
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	55,000	200	0.36%
Prishtinë/Prishtina	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	29,805	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	35,570	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	50,000	4,100	8.2%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	33,682	4,037	11.98%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	40,000	3,882	9.7%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	40,000	3,882	9.7%
	Komuna Gračanica/Graçanicë			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	-	-	-
3. Vlerësimi aktual i komunës	20,000	50	0.25%	

Prishtinë/Priština	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	20,000	50	0.25%	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	18,642	50	0.26%	
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	20,000	50	0.25%	
	Komuna Lipjan/Lipljane				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	57,705	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	69,451	-	-	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	76,000	1,526	2.00%	
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	69,115	2,226	2.93%	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	76,000	2,075	2.73%	
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	76,000	2,226	2.92%	
	Komuna Obiliq/Obilić				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	26,595	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	31,627	-	-	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	32,000	275	0.85%	
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	26,000	257	1.05%	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	30,000	325	1.08%	
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	30,000	325	1.08%	
	Komuna Podujevë/Podujevo				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	75,437	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	92,946	-	-	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	130,000	626	0.48%	
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	130,000	808	0.62%	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	130,000	626	0.48%	
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	130,000	806	0.62%	
	Komuna Prishtinë/Priština				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	148,656	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	199,654	-	-	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	500,000	485	0.096%	
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	500,000	500	0.096%	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	500,000	485	0.096%	
6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	500,000	485	0.096%		
Komuna Shtime/Štimlje					
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	19,952	-	-		
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	23,506	-	-		
3. Vlerësimi aktual i komunës	30,000	811	2.70%		
4. Vlerësimi aktual i komunitëve	30,000	760	2.53%		
5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	29,000	811	2.79%		
6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	29,000	760	2.62%		
Prizren	Komuna Malishevë/Mališevo				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	45,669	-	-	
	3. Municipal Estimations	65,000	68	0.1%	
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	-	-	-	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	65,000	-	-	
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	65,000	-	-	
	Komuna Prizren				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	134,526	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	175,413	3,963	2%	
	3. Municipal Estimations	240,000	5,322	2.2%	
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	-	-	-	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	240,000	-	-	
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	240,000	-	-	
	Komuna Rahovec/Orahovac				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	46,541	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	59,877	319	0.5%	
	3. Municipal Estimations	76,577	756	1%	
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	-	-	-	
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	76,577	-	-	
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	76,577	756	1%	

Prizren	Komuna Suharekë/Suva Reka			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	63,981	167	0.2%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	80,000	651	0.8%
	4. Vlerësimi aktual i komunitëve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunës, OSBE, 2009	80,000	-	-
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	80,000	-	-

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijët e moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijët që vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijët që nuk vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Moshë pune - të punësuar (16-65)	Moshë pune - të papunësuar (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë	
Gjilan/ Grijllane	Ferizaj/ Uroševac	Meshkuj	163	514		95		48	55	
		Femra	150	443		58		43	20	
		Gjithsej	313	957	25	153	2413	91	75	
	Gjithsej rajonal		313	957	25	153	2,413	91	75	
	Koment: OSBE-ja nuk ka arritur të marrë të gjitha informatat relevante nga autoritetet									
Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovicë/ Mitrovica	Meshkuj	32	49		20	89	7		
		Femra	19	56		9	80	14		
		Gjithsej	51	105		29	169	21		
	Skenderaj/ Srbica	Meshkuj	2	8		2	11	1		
		Femra	4	8		0	13	1		
		Gjithsej	6	16		2	24	2		
	Vushtrri/ Vuçitër	Meshkuj	22	13	6	24	27	4		
		Femra	24	11	5	0	59	8		
		Gjithsej	46	24	11	24	86	12		
	Gjithsej rajonal		88	148	6	39	281	31		
	Koment: OSBE-ja nuk ka arritur të marrë të gjitha informatat relevante nga autoritetet.									
	Gjakovë/ Đakovica	Gjakovë/ Đakovica	Meshkuj	17	10	10		75	20	
			Femra	13	5	15		75	30	
Gjithsej			30	15	25		150	50		
Klinë/Klina		Meshkuj		7						
		Femra		1						
		Gjithsej		8						
Gjithsej rajonal				23						
Koment: OSBE-ja nuk ka arritur të marrë të gjitha informatat relevante nga autoritetet.										
Prishtinë/Prishtina	Fushë Kosovë /Kosovo Polje	Meshkuj								
		Femra								
		Gjithsej	450	550	284	20	2,605	128		
	Gracanica/ Graçanicë	Meshkuj								
		Femra								
		Gjithsej	5	15	10	1	17	2		
	Lipjan/ Lipljan	Meshkuj								
		Femra								
		Gjithsej	250	450	140	10	1,216	160		
	Obiliq/ Obilić	Meshkuj								
		Femra								
		Gjithsej	35	50	20	4	132	16		
Podujevë/ Podujevo	Meshkuj									
	Femra									
	Gjithsej	70	100	30	6	440	162			

Prishtinë/Prishtina	Prishtinë/ Prishtina	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	25	60	30	4	346	20	
	Shtime/ Štimlje	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	30	100	20	15	565	30	
Gjithsej rajonal	8,623	865	1,325	534	60	5,321	518		
Koment: OSBE-ja nuk ka arritur të marrë të gjitha informatat relevante nga autoritetet.									
Prizren	Malishevë / Mališevo	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej							
	Prizren	Meshkuj					249		
		Femra					313		
		Gjithsej					562		
	Rahovec/ Orahovac	Meshkuj					59		
		Femra					54		
		Gjithsej					113		
	Suharekë/ Suva Reka	Meshkuj					25		
		Femra					16		
		Gjithsej					41		
	Gjithsej rajonal					753			
Koment: OSBE-ja nuk ka arritur të marrë të gjitha informatat relevante nga autoritetet.									

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin.
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj/femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë.

Gjiljan/Gnjilane	Komuna Ferizaj/Uroševac	
	1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
	2	Osman Emini, Kryetar i Këshillit Konsultativ për Komunitete Hyzri Hasani, Drejtor i Zyrës Komunale për Komunitete Rrahman Bajrami, Zyra Komunale për Komunitete Muzafer Ramadani, Zyra Komunale për Komunitete Basri Rexhepaj, Zyra Komunale për Komunitete Fatmir Aliu, Zyra Komunale për Komunitete Jajush Avdiu, Zyra Komunale për Komunitete Bahri Shabani, Zyra Komunale për Komunitete Rexhep Bajrami, anëtar i Kuvendit Komunal Asllan Kryeziu, anëtar i Kuvendit Komunal
	3	OJQ “Qendra e Komunitetit Ashkali” në Dubravë/Dubrava – mbulon çështjet në lidhje me arsimin, mësimin e gjuhës angleze, kurse për teknologji informative dhe trajnime profesionale. OJQ “Qendra për Zhvillimin dhe Integrimin e Komunitetit Ashkali” – mbulon çështje kryesisht në lidhje me arsimin. OJQ “Gezimi Ynë Rinor” – kryesisht merret me çështjet rinore. OJQ “Hëna e Plotë” – organizatë bamirëse, kryesisht merret me shpërndarjen e ndihmës humanitare. OJQ “Edona” – OJQ për të drejtat e grave, përfshirë edhe disa nisma për gjenerimin e të ardhurave. OJQ “Zeri i Popullit” – OJQ për ndërtimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore.
	4	Program televiziv një-orësh për komunitetet romë dhe ashkali, që financohet nga komuna, ka funksionuar vitin e kaluar por jo më.

Gjilan/Gnjilane	5	Rexhep Bajrami, kryesues lokal i Partisë Demokratike të Ashkalive të Kosovës (PDAK). Danush Ademi, kryesues i përgjithshëm i Bashkimit Demokratik të Ashkalive (BDA). Rrahman Bajrami, kryesues lokal i Bashkimit Demokratik të Ashkalive (BDA), aktualisht anëtar i kryesisë së degës të PDAK. Hazbi Kopili, OJQ "Shoqëria Demokratike" për të drejtat e njeriut Hafize Hajdin, OJQ "Edona" për të drejtat e grave Shani Kopili, OJQ "Zëri i Popullit" për ndërtim të kapaciteteve
	6	
	7	UNDP është duke financuar disa projekte dhe aktivitete për komunitetin ashkali në Ferizaj/Uroševac, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> Furnizimi me pajisje shkollore për dy klasat e shkollës parafillore "Tefik Çanga". Financimi i bursave për 29 nxënës të shkollave të mesme dhe 3 bursave për studentët universitar të komunitetit ashkali. Projekti për zhdukjen e analfabetizmit të pjesëtarëve të komunitetit ashkali. Furnizimi me pajisje dhe çanta shkollore i 100 nxënësve të shkollave fillore.
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Mitrovicë/Mitrovica	
	1	PDAK Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
	2	Milaim Ramadani, anëtar i komisionit për komunitete Një person është i punësuar si polic në Policinë e Kosovës.
	3	OJQ "Gratë ashkalike për Gratë ashkalike" përqendrohet në çështjet e grave por nuk është edhe shumë aktive. OJQ "PRAM", e drejtuar nga gratë ashkalike, përqendrohet në çështjet e rinisë ashkalike dhe për shumetnicitet, integrimi dhe aktivitete për ngritjen e vetëdijesimit rreth ambientit.
	4	
	5	Bashkim Krasniqi, udhëheqës i komunitetit në vendbanimin joformal Dy Korriku/Sitničko Naselje në Mitrovicë/Mitrovica
	6	
	7	
	Komuna Skenderaj/Srbica	
	1	Komuniteti pohon se nuk përfaqësohet nga ndonjë parti politike e veçantë
	2	Bekim Muharremi, anëtar i komisionit për komunitete
	3	
	4	
	5	Bekim Muharremi, përfaqësues i komunitetit në fshatin Runik/Rudnik
	6	
	7	
	Komuna Vushtrri/Vučitrn	
	1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
	2	Adem Hoti, anëtar i komisionit për komunitete
	3	
	4	
5	Shyqyri Quni, përfaqësues i komunitetit në Vushtrri/Vučitrn	
6		
7		
Pejë/Peć	Komuna Gjakovë/Đakovica	
	1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
	2	
	3	
	4	
	5	Nazmi Qafani, udhëheqës i komunitetit
	6	
	7	
	Komuna Klinë/Klina	
	1	Asnjë parti politike nuk vepron në Klinë/Klina.
	2	Një pjesëtar i komunitetit ashkali është i punësuar në Policinë e Kosovës.
	3	
	4	
	5	Gani Vrankaj, udhëheqës i komunitetit
6		
7		

Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje	
1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
2	Muhamet Arifi, Kryetar i Këshillit Konsultativ për Komunitete Qerim Gara, anëtar i kuvendit komunal Halil Qerimi, zyra komunale për komunitete Bajram Marolli, qendra komunale për mirëqenie sociale dhe anëtar i komisionit për komunitete
3	Qendra për Bashkëpunimin dhe Integrim "Fidan Lahu", pan-organizatë për grupet e komuniteteve që zbatojnë aktivitete në fushën e arsimit, ndihmës shëndetësore, dhe integritit të rinisë dhe grave. OJQ "Balkan Sunflowers Kosova", me aktivitete të përqendruara në arsimim. OJQ "Shëndet për të gjithë", me aktivitete për gra dhe fushata për ngritjen e vetëdijesimit në shëndetësi
4	
5	Qerim Gara, udhëheqës i komunitetit nga Fushë Kosova/Kosovo Polje Haxhere Gashi, përfaqësuese e grave në forume të ndryshme
6	
7	
Komuna Gračanica/Graçanicë	
1	
2	
3	
4	
5	
6	
7	Koment: nuk ka pjesëtarë të komunitetit ashkali në Graçanicë/ Gračanica
Komuna Lipjan/Lipljan	
1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
2	Fatmir Goliqi, zyra komunale për komunitete
3	OJQ "Asociacioni Rinor për të Drejtat e Njeriut", "Flaka", "Era", "Qendra Rinore në Lipjan/Lipljane", që kryesisht angazhohen në aktivitete për rininë dhe gratë.
4	
5	Lulzim Qerimi, kryetar i degës së partisë politike PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
6	
7	
Komuna Obiliq/Obilić	
1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
2	Bajrush Berisha, anëtar i komisionit për komunitete Një kërkesë e vazhdueshme e komunitetit ashkali është që të jetë i përfaqësuar në zyrën komunale për komunitete.
3	OJQ "Unioni Demokratik i Ashkalive të Kosovës"
4	
5	Bajrush Berisha, udhëheqës i komunitetit ashkali dhe kryetari degës së PDKA në Obiliq/Obilić
6	
7	
Komuna Podujevë/Podujevo	
1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
2	Shaban Ahmeti, kryesues i komisionit për komunitete dhe anëtar i PDAK-së
3	OJQ "Shpresa Demokratike" OJQ "Qëndrimi" OJQ "Një hap me ne", që përfaqëson komunitetet romë dhe ashkali, me fokus mbrojtjen e të drejtave të komunitetit, integrimin e grave dhe aktivitetet për gjenerimin e të ardhurave.
4	
5	Agim Hyseni, kryetar i OJQ lokale "Shpresa Demokratike"
6	
7	
Komuna Prishtinë/Priština	
1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
2	Idriz Berisha, anëtar i komisionit për komunitete
3	OJQ "Asociacioni i Ashkalive për Bashkëpunim" përqendrohet në mbrojtjen e të drejtave të komunitetit ashkali, integrimin e grave në shoqërinë civile, dhe organizon kurse të gjuhës angleze dhe trajnime profesionale.
4	

Prishtinë/Priština	5	Idriz Berisha, kryetar i degës së partisë politike. Avni Rama, udhëheqës i komunitetit në lagjen Kodra e Trimave/Vranjevac të Prishtinës/Priština.
	6	
	7	
	Komuna Shtime/Štimlje	
	1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
	2	Rahman Kadria, kryesues i komisionit për komunitete Ruzhdi Brahimi, anëtar i komisionit për komunitete
	3	OJQ ashkallike "Rrjeti Rinor i Ashkalive" ka një prani të gjerë në komunë dhe ka fituar një grant nga "CARE International". OJQ "Hapësira Rinore" që përbëhet nga të rinjtë shqiptar, romë dhe ashkali. Aktivitetet kryesore janë performansat artistike dhe mbështetja për integrimin e komunitetit. OJQ "Një hap me RAE" për ngritjen e vetëdijesimit të prindërve për arsimimin e fëmijëve.
	4	
	5	Shefki Osmani, udhëheqës i komunitetit në Shtime/Štimlje Rrahman Kadria, udhëheqës i komunitetit në fshatin Gjurkoc/Đurkovce
	6	
7		
Prizren	Komuna Prizren	
	1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
	2	
	3	OJQ "Iniciativa 6", që punon me komunitetet ashkali dhe romë OJQ "Durmish Asllano", që punon me komunitetet ashkali dhe romë
	4	
	5	
	6	
	7	
	Komuna Suharekë/Suva Reka	
	1	PDAK, Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës
	2	Bajram Tutaj, përfaqësues në këshillin komunal për siguri në bashkësi
	3	
	4	
	5	Agim Shabani, kryesues i komisionit për komunitete
	6	
7		

1 Të dhënat e zbrëthyer për komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian nuk janë të dispozicion në të gjitha komunat e Kosovës. Vlerësimet e popullsisë, të paraqitura në këtë Aneks, ofrojnë të dhëna të zbrëthyer kurdo që janë në dispozicion dhe përjashtimet janë të shënuara në mënyrë të qartë.

2 Të dhënat për popullsinë në pikat 3, 4, 5, dhe 6 janë mbledhur nga ekipet fushore të OSBE-së në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarët komunal gjatë muajve mars-prill 2010.

3 Vëreni që regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 ka përfshirë komunitetin romë por jo edhe atë ashkali dhe egjiptian, si kategori e një komuniteti të veçantë, dhe për këtë arsye të dhënat mund të përfshijnë komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane. Është gjithashtu e mundur që disa pjesëtarë të komunitetit ashkali janë regjistruar si pjesëtarë të komuniteteve tjera apo në kategorinë e të "tjerëve".

4 Vëreni që regjistrimi i popullsisë në vitin 1991 ka përfshirë komunitetin rom, por jo edhe atë ashkali dhe egjiptian, si kategori e një komuniteti të veçantë, dhe për këtë arsye të dhënat mund të përfshijnë komunitetet romë, ashkali dhe egjiptiane. Është gjithashtu e mundur që disa pjesëtarë të komunitetit ashkali janë regjistruar si pjesëtarë të komuniteteve tjera apo në kategorinë e të "tjerëve".

5 Profili komunal i vitit 2009 nuk ka siguruar të dhëna të zbrëthyer për komunitetin ashkali dhe prandaj këto shifra përfshijnë romët, ashkalitë dhe egjiptianët.



Profili i komunitetit BOSHNIKËT E KOSOVËS

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Historiku

Komuniteti boshnjak i Kosovës jeton kryesisht në rajonin e Prizrenit dhe Pejës/Peć, por në numër më të vogël jetojnë edhe në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, Mitrovicës/ Mitrovica dhe Prishtinës/Priština.¹ Ndonëse komuniteti boshnjak i Kosovës kryesisht nuk e ka prejardhjen nga Bosnja dhe Hercegovina, lidhja kulturore dhe fetare me at vend është e pranishme te ta. Komuniteti boshnjak i Kosovës kohë pas kohë përmendej si ‘myslimanët’ apo ‘sllavët myslimanë’, që besohet ta jenë konvertuar në fe islame gjatë kohës së Perandorisë Osmane, dhe që atëherë kanë zhvilluar një ndjenjë të identitetit të ndarë etnik. Në rajonin e Prizrenit, dhe veçanërisht në komunën e Dragashit/Dragaš, ndarja ndërmjet boshnjakëve të Kosovës dhe goranëve është poroze, meqë të dy komunitetet i kanë të përbashkëta disa karakteristika kyçe dhe tipari që më së shumti i dallon është lidhja politike, e shtjelluar më thellësisht në Pjesën 11.² Përgjithësisht, komuniteti boshnjak i Kosovës gëzon liri të lëvizjes dhe, ndryshe nga shumë komunitete tjera të Kosovës, ka arritur të jetojë së bashku dhe në paqe me shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës. Si myslimanë që e flasin gjuhën boshnjake, d.m.th. një gjuhë sllave të ngjashme me gjuhën serbe dhe kroate, komuniteti boshnjak i Kosovës ka gëzuar në përgjithësi lidhje të mira me komunitetin serb (p.sh. për arsye gjuhësore) dhe me komunitetin shqiptar të Kosovës (p.sh. për arsye fetare). Diaspora e boshnjakëve të Kosovës kontribuon në masë të madhe në ekonominë lokale dhe ka ndikim të konsiderueshëm në partitë politike të boshnjakëve të Kosovës dhe liderët e tyre.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane janë 30 familje të boshnjakëve të Kosovës që jetojnë në qytetin e Ferizajt /Uroševac në po atë komunë, që përbën 0.05% të popullatës. Në Mitrovicë/Mitrovica, komuniteti boshnjak i Kosovës është përgjithësisht i integruar mirë në popullatën shumicë, përfshirë këtu edhe me martesë të përziera ndërmjet boshnjakëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës. Në komunën Mitrovicës/Mitrovica, boshnjakët e Kosovës përbëjnë afro 1.1% të popullatës dhe përqendrimi më i madh i tyre është në lagjen e njohur si Mëhalla e Boshnjakëve dhe lagje të tjera në Mitrovicën/Mitrovicë veriore (me shumicë të serbëve të Kosovës). Ata gjithashtu jetojnë në numra më të vegjël në Mitrovicën/Mitrovica jugore (me shumicë të shqiptarëve të Kosovës). Në komunën e Leposavić/Leposaviqit, komuniteti boshnjak i Kosovës përbën 1.6% të gjithësej popullatës, me vendbanime në gjashtë fshatra me shumicë serbe dhe, në numër më të vogël, në katër fshatra tjerë.

Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti boshnjak i Kosovës jeton në vendbanime etnikisht të përziera, në shumicën e rasteve së bashku me shqiptarët e Kosovës. Boshnjakët e Kosovës përbëjnë 2.35% të popullatës në komunën e Pejës/Peć, duke banuar në qytetin e Pejës/Peć dhe disa fshatra. Në komunën e Istogut/Istok, ata përbëjnë 2.6-3.0% të popullatës, në dhjetë vendbanime. Në komunën e Deçanit/Dečani, ata përbëjnë afro 0.14% të popullatës dhe jetojnë në dy fshatra; një numër i vogël i tyre jeton në Gjakovë/Đakovica, ku përbën vetëm 0.02%³. Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti boshnjak i Kosovës jeton në mesin e shqiptarëve të Kosovës. Në komunën e

Komuniteti boshnjak i Kosovës ka pasur tradicionalisht lidhje të afërta me komunitetin shqiptar të Kosovës si dhe me komunitetin serb të Kosovës, duke ua dhënë një pozitë të privilegjuar në dinamikat etnike të Kosovës.

Ligji i zbatuar për festat shtetërore përcakton se prej vitit 2009, 28 shtatori do të festohet si ditë memoriale e boshnjakëve të Kosovës.

1 Për listën e plotë të të gjitha vendbanimeve të boshnjakëve të Kosovës, ju lutemi ta lexoni Shtojcën Tabela 1, Vendbanimet e Popullsisë.

2 Shih profilin e goranëve për më shumë informata.³ Prej vitit 2009, komuna e Gjakovës/akovica është në zonën e përgjegjësisë të Qendrës Rajonale të Pejës të OSBE-së. Prandaj, në këtë botim të dytë të Profileve, kjo komunë më nuk paraqitet si pjesë e rajonit të Prizrenit.

Prishtinës/Priština, ata përbëjnë afro 0.04% të popullatës dhe jetojnë të shpërndarë brenda dhe përreth qytetit. Në komunën e Obiliqit/Obilić, ata banojnë në qytet dhe në një fshat, duke përbërë 0.2% të popullatës. Në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, tri familje jetojnë në një lagje ku jetojnë të banuar kryesisht me ashkali, duke përbërë afro 0.03% të popullatës. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti i boshnjakëve të Kosovës përbën mbi 9% të popullatës në komunën e Prizrenit dhe jetojnë kryesisht në qytetin e Prizrenit dhe në luginën e Zhupës (në lindje të komunës); në komunën e Dragashit/Dragaš, nuk ka të dhëna të zbërthyer për ta bërë vlerësimin e përafërt të numrit të boshnjakëve të Kosovës, ndonëse disa pjesëtarë të komunitetit Goran e identifikojnë veten si Boshnjakë.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Një numër i madh i pjesëtarëve të komunitetit (posaçërisht të rinjtë) kanë migruar në shtetet e Evropës Perëndimore, si dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, Mal të Zi dhe Serbi.
- Përveç në Prizren dhe në Pejë/Peć, ku komuniteti është i pranishëm në masë të konsiderueshme, migrimi i boshnjakëve të Kosovës ka shkaktuar zvogëlim të numrit të tyre duke e rrezikuar qëndrueshmërinë e komunitetit.
- Mosnjohja e gjuhës shqipe nga shumica e boshnjakëve të Kosovës mbetet faktori vendimtar për ndjenjën e pasigurisë dhe masën e lirisë së lëvizjes që e ushtron komuniteti.
- Mosnjohja e diplomave të shkollave të mesme nga shtetet në rajon pengon qasjen në arsim të lartë në gjuhën amtare të komunitetit.
- Komuniteti ka pjesëmarrje të kufizuar në çështje publike në nivel qendror.

1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Në disa rajone, boshnjakët e Kosovës drejtojnë veprimtari private afariste dhe kanë situatë relativisht stabile sociale-ekonomike, gjersa në vende tjera, ata ndajnë mbështetjen e njëjtë të komuniteteve tjera në asistencë sociale.

Gjendja sociale-ekonomike e komunitetit boshnjak të Kosovës vazhdon të jetë e vështirë, me sfida në qasjen në punësim. Në disa vise ajo është pak më e mirë në krahasim me komunitetet tjera joshumicë, kryesisht për shkak të integritit në shoqërinë kosovare dhe rritjes së dygjuhësisë. Megjithatë, ka dallime në gjendjen sociale-ekonomike varësisht nga rajoni i Kosovës. Në të vërtetë, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, boshnjakët e Kosovës kryejnë veprimtari private të afarizmit. Përfaqësimi i tyre në sektorin publik është i ulët, ku janë të punësuar vetëm katër boshnjakë të Kosovës. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, boshnjakët e Kosovës janë prekur sikurse edhe komunitetet tjera nga mbyllja e komplekseve të minierave, siç është “Trepça”, të cilat ishin burimi kryesor i të ardhurave për të gjitha komunitetet në rajon. Gjendjen sociale-ekonomike e përcaktojnë mungesa e investimeve dhe papunësia. Më shumë boshnjakë të Kosovës janë të punësuar në veri sesa në jug, duke i kontribuar tendencës që komuniteti të qëndrojë në veri të lbrit. Në Leposaviq/Leoposaviq, pothuajse të gjitha objektet industriale janë mbyllur apo punojnë me kapacitete të zvogëluara, duke e shtuar shkallën e

papunësisë. Tensionet e vazhdueshme politike në rajon vazhdojnë të jenë pengesë për investime dhe zhvillimin potencial ekonomik, duke i prekur edhe boshnjakët e Kosovës sikurse komunitetet tjera.

Në rajonin e Pejës/Peć, nga radhët e boshnjakëve të Kosovës ka mjekë, inxhinierë, mësime dhënë, infermierë dhe shërbyes civilë të kualifikuar, por papunësia vazhdon ta prekë këtë komunitet. Femrat boshnjake e Kosovës të Kosovës mbesin veçanërisht në pozitë të pafavorshme meqë komuniteti ende e percepton kryesisht rolin e tyre si të kufizuar në kujdesin për shtëpinë dhe familjen. Shumë boshnjakë të Kosovës mbështeten në asistencë sociale, mbështetje financiare nga diaspora, aktivitete bujqësore dhe punë sezonale apo shitje të produkteve të tyre gjatë ditëve të tregut. Nga 30 boshnjakë të Kosovës me banim në komunën e Gjakovës/Đakovica, një është i punësuar në Policinë e Kosovës dhe një në sektorin e arsimit. Të gjithë të tjerët mbështeten në asistencë sociale. Në komunën e Deçanit/Dečane, vetëm tre nga 36 kanë punë me orar të plotë – një zyrtar komunal për komunitete, një shofer autobusi për shkollë dhe një polic. Dy meshkuj marrin pensione, dhe katër familje marrin asistencë sociale nga institucionet e Kosovës. Në vitin 2009, 17 boshnjakë të Kosovës janë regjistruar në zyrën e punësimit në Deçan/Dečane. Shumica e boshnjakëve të Kosovës në Istog/Istok janë bujq apo të punësuar në sistemin e arsimit, ku ka 21 mësime dhënë nga të cilët gjashtë janë meshkuj dhe 15 femra. Në administratën publike janë të punësuar tre meshkuj dhe tri femra si shërbyes civilë nga radhët e komunitetit boshnjak të Kosovës.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, janë tri femra boshnjake e Kosovës të Kosovës të punësuar në komunë. Veç kësaj, dy femra boshnjake e Kosovës të Kosovës punojnë në qendrën e mjekësisë familjare. Boshnjakët e tjerë të Kosovës zotërojnë biznese private dhe gjeneratat më të vjetra marrin pensione nga Qeveria e Kosovës. Në Prizren, ndonëse ka sfida për komunitet, gjendja me punësim është relativisht e mirë. Në komunën e Prizrenit, 24 boshnjakë të Kosovës, përfshirë këtu gjashtë femra, punojnë në administratën komunale. Brenda sektorit privat, shumë prej tyre kanë aktivitete vetanake tregtare apo janë të angazhuar në punë ndërtimore dhe sezonale në Mal të Zi. Boshnjakët e Kosovës që banojnë në Luginën e Zhupës



NJË BOSHNJAKE E KOSOVËS ME VESHJE TRADICIONALE DUKE BARTUR DRU NË AFËRSI TË VENDBANIMIT TË LARGËT MALOR GORNJE LJUBINJE/LUBINJË E EPËRME NË LUGINËN E ŽUPA/ZHUPËS (KOMUNA E PRIZRENIT).

janë muratorë të njohur. Disa prej tyre marrin mbështetje nga të afërmit që jetojnë në vendet e Evropës perëndimore. Në Dragash/ Dragaš, nga 110 shërbyes civilë që punojnë në administratën komunale, 36 janë boshnjakë të Kosovës. Ky numër përbën deri në 30% të administratës dhe përfshin edhe një grua. Sipas të dhënave të siguruara nga zyra rajonale për punësim, nga 58,605 (30,247 gra) persona të regjistruar si punëkërkues, 3651 (1772 gra) janë boshnjakë të Kosovës nga Prizreni, dhe 1322 (705 gra) janë boshnjakë të Kosovës nga Dragashi/Dragaš. Zyra rajonale e punësimit ofron trajnime profesionale, kryesisht për të rinjtë, nga tre deri në gjashtë muaj në administrim biznesi, informacion dhe teknologji, turizëm, si dhe trajnime për mekanikë veturash, kamerierë, banakierë dhe kuzhinierë. Ekziston një qendër e përhershme rajonale profesionale në Prizren dhe disa qendra mobile në Dragash/Dragaš. Pas përfundimit të kursit dhe pranimit të certifikatës, zyra rajonale për punësim lehtëson punësimin e mundshëm. Më 2009, gjashtë boshnjakë të Kosovës në Prizren dhe shtatë boshnjakë të Kosovës në Dragash/Dragaš kanë përfunduar njërin prej kurseve të ofruara. Në bashkëpunim me organizata të ndryshme ndërkombëtare, siç është UNDP-ja, zyra rajonale për punësim lehtëson punën si praktikant për punëkërkuesit me arsim të lartë me prioritet në komunitetet pakicë dhe femrat. Të gjithë boshnjakët e Kosovës të moshës mbi 65 vjeçe marrin pensione nga institucionet e Kosovës. Disa marrin pensione edhe nga institucionet e financuara nga Serbia në Kosovë.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Aktualisht janë 37 gra boshnjake e Kosovës që shërbejnë si zyrtare policore në Policinë e Kosovës.

Ndonëse komuniteti boshnjak i Kosovës vazhdon të gëzojë liri të lëvizjes në pesë rajone të Kosovës, një numër i madh i incidenteve të sigurisë janë raportuar në Mitrovicë/Mitrovica veriore dhe në komunën e Pejës/Peć. Si meshkujt, ashtu dhe femrat kanë qenë caqë të ngacmimeve dhe sulmeve të raportuara. Pjesëmarrja e komunitetit në forumet komunale të sigurisë ku mund të adresohen çështjet e tilla vazhdon të jetë e pamjaftueshme. Megjithatë, boshnjakët e Kosovës janë të përfaqësuar mirë në Policinë e Kosovës, me 185 policë dhe 37 police në tërë Kosovën, përndryshe prania e dytë për nga madhësia e komuniteteve joshqiptare në këtë shërbim.

Komuniteti boshnjak i Kosovës zihet kohë pas kohe në tensionet dhe dhunën ndërmjet komuniteteve që e karakterizon Mitrovicën/Mitrovica veriore.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, boshnjakët e Kosovës janë të integruar mirë në komunitetin shumicë, duke e njohur rrjedhshëm gjuhën shqipe që nga moshja e hershme dhe duke vazhduar veprimtaritë ditore të tyre pa shqetësime për sigurinë. Përgjithësisht, perceptimi i komunitetit boshnjak të Kosovës për Policinë e Kosovës është pozitiv. Ekziston vetëm një femër boshnjake e Kosovës e punësuar në Policinë e Kosovës në komunën e Gjilanit/Gnjilane. Në rajonin policor të Ferizajt/Uroševac, nuk fare ka boshnjakë të Kosovës në shërbimin policor. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, përkundër lidhjeve të komunitetit me shqiptarët dhe serbët e Kosovës dhe mundësisë së tyre për të lëvizur lirshëm nëpër sektorët veriorë dhe jugorë të komunës së Mitrovicës, komuniteti zihet nganjëherë në tensionet dhe dhunën e shpeshtë ndërmjet komuniteteve që e karakterizon atë zonë. Boshnjakët e Kosovës kanë qenë caqë të shqiptarëve të Kosovës dhe të serbëve të Kosovës në veri. Për shembull, në shtator 2009, persona të panjohur e kanë sulmuar një mashkull boshnjak i Kosovës. Në janar 2010, një boshnjak tjetër i Kosovës është

kërcënuar dhe ofenduar nga një serb i Kosovës për një kontest pronësor. Në mars 2010, një boshnjake e Kosovës ka raportuar se është ofenduar nga një shqiptar i cili më vonë u arrestua nga policia. Në prill 2010, një boshnjake e Kosovës tjetër e Kosovës pohoi që një shqiptarë e Kosovës e kërcënoi me vrasjen e të birit të saj nëse ata nuk ikin nga Mitrovica/Mitrovica e veriut. Në maj 2010, një boshnjak i Kosovës raportoi kërcënim nga ana e një serbi ndaj familjes së tij. Në qershor 2010, një boshnjake e Kosovës raportoi se ishte kërcënuar nga një shqiptar i Kosovës për ta detyruar atë që ta nënshkruajë një dokument për t'ia dorëzuar pronën e saj në Mitrovicën/Mitrovica e veriut. Nuk janë raportuar incidente të sigurisë që prekin boshnjakët e Kosovës me banim në komunën veriore të Leposavić/Leposaviqit, dhe komuniteti është në gjendje të lëvizë lirshëm brenda dhe jashtë vendbanimeve të tyre. Komuniteti boshnjak i Kosovës është i përfaqësuar mirë në Policinë e Kosovës në tërë rajonin me gjithsej 20 policë të stacionuar si në vijim: 11 në stacionin në jug të Mitrovicës/Mitrovica; katër në stacionin në veri të Mitrovicës/Mitrovica; dy në Zubin Potok; dy në Leposavić/Leposaviq; dhe, një në Vushtri/Vučitrn. Ky përfaqësim mund ta arsyetojë shkallën e lartë të besimit që komuniteti e ka shprehur për policinë.

Në rajonin e Pejës/Peć, boshnjakët e Kosovës gëzojnë një nivel të kënaqshëm të lirisë së lëvizjes dhe kanë ndërveprime të shpeshta me shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet tjera. Megjithatë, boshnjakët e Kosovës vazhdojnë të jenë cak i incidenteve të sigurisë. Në shtator 2009, në tri incidente të ndara, një mashkull boshnjak i Kosovës është sulmuar nga persona të panjohur me shufra metali; një tjetër është kërcënuar me anë të porosisë tekstuale; dhe, tre persona janë sulmuar nga disa persona të panjohur. Në tetor 2009, një çift boshnjak i Kosovës është sulmuar nga dy meshkuj shqiptarë të Kosovës, për shkak të një kontesti pronësor. Sulmuesit janë arrestuar më vonë. Në janar 2010, në qytetin e Pejës/Peć, një person i panjohur i ka dërguar porosi kërcënuese tekstuale një mashkulli boshnjak të Kosovës. Në mars 2010, një tjetër mashkull boshnjak i Kosovës është sulmuar dhe plaçkitur nga një mashkull shqiptar i Kosovës i cili më vonë është arrestuar dhe marrë në pyetje nga Policia e. Përsëri, në mars, një boshnjake e Kosovës nxënëse e shkollës së mesme teknike në Pejë/Peć është sulmuar nga dy nxënës bashkëmoshatarë shqiptarë. Në mars, prill dhe përsëri në korrik 2010, disa boshnjakë të Kosovës u sulmuan nga disa shqiptarë në qytetin e Pejës/Peć. Në maj 2010, një grup shqiptarësh janë arrestuar derisa sulmonin një mashkull boshnjak i Kosovës në qytetin e Gjakovës/Đakovica. Ndonëse shumica e incidenteve kanë përfunduar me arrestimin e kryerësve, nuk ka reagime komunale që dënojnë incidentet e ndodhur. Komuniteti boshnjak i Kosovës është i përfaqësuar në pesë nga tetë stacionet policore të rajonit të Pejës/Peć, me 48 zyrtarë policorë, përfshirë këtu 11 femra. Janë gjashtë policë boshnjakë të Kosovës në stacionin e Gjakovës/Đakovica; tre në Istog/Istok; dhe 31 në Pejë/Peć⁴. Veç kësaj, katër zyrtarë policorë boshnjakë të Kosovës janë zbankuar në selinë rajonale të Pejës/Peć, dy prej të cilëve në cilësi të zëvendës drejtorëve rajonalë. Boshnjakët e Kosovës kanë shprehur pakënaqësi me performancën e Policisë së Kosovës në rajon, ndonëse njësitë shumetnike të policisë në komunitet rregullisht patrollojnë në fshatrat e banuar me boshnjakë të

Boshnjakët e Kosovës kanë qenë cak i shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës që banojnë në veri.

Ndonëse autoritetet komunale kanë qenë relativisht proaktive në kontaktim me serbët e prekur nga incidentet e sigurisë në rajonin e Pejës/Peć, për boshnjakët e Kosovës, që po ashtu kanë qenë caqe, nuk ka pasur reagime të njëjta.

4 Njëzet boshnjakë janë të stacionuar në stacionin kryesor të Pejës/Peć; tetë në nënstacionin e Vitomiricës/Vitomirica; dhe tre në nënstacionin në Gorazdevac/Gorazhdevc.

Kosovës dhe gëzojnë mbështetjen dhe bashkëpunimin e komunitetit. Boshnjakët e Kosovës nuk marrin pjesë në tri këshillat aktivë komunalë të sigurisë në komunitet të Pejës/Peć, Gjakovës/Đakovica, apo Deçanit/Dečani. Përfaqësuesit e komunitetit kanë shprehur preferencën e tyre që boshnjakët e Kosovës të mos etiketohen si komunitet i veçantë dhe i zëshëm joshumicë, gjë që mund të shpjegojë mungesën e tyre nga mekanizmat e pjesëmarrjes së pakicës. Një grua boshnjake e Kosovës e përfaqësoi komunitetin në këtë të fundit deri në zgjedhjet e nëntorit të 2009. Në Istog/Istok, këshilli komunal për siguri në bashkësi nuk është aktiv. Nuk ka komitete lokale për siguri publike të themeluara në zonat e banuara me boshnjakë të Kosovës. Përfaqësimi i pamjaftueshëm i boshnjakëve të Kosovës në forumet e sigurisë të komunave në të cilat ata banojnë mund të shpjegojë mungesën e reagimit komunal për incidentet që prekin komunitetin.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, shumica e komunitetit boshnjak të Kosovës e flet rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe serbe, gjë që lehtëson lirinë e tyre të lëvizjes. Në polici shërbejnë tetë boshnjakë të Kosovës, gjashtë femra dhe dy meshkuj. Në këtë rajon nuk është raportuar asnjë incident i rëndësishëm që prek këtë komunitet. Komuniteti gëzon marrëdhënie të mira me Policinë e Kosovës. Gjendja e përgjithshme e sigurisë së komunitetit boshnjak të Kosovës në Prizren mbetet e qëndrueshme, pa incidente të rëndësishme të sigurisë të raportuara kohëve të fundit. Aftësia e komunitetit për ta folur gjuhën shqipe është faktor kyç që u mundëson atyre liri relativisht të mirë të lëvizjes. Megjithatë, gratë dhe vajzat boshnjake e Kosovës nga viset e largëta rurale shpeshherë udhëtojnë bashkë me shoqe tjera për shkak të perceptimit të pasigurisë. Komuniteti shpeshherë përdor transportim publik për në Prizren dhe nga Prizreni, gjersa disa prej tyre e shfrytëzojnë shërbimin humanitar me autobus që lidh fshatrat në Luginën e Zhupës me qytetin e Prizrenit. Në rajon janë gjithsej 54 policë dhe një police boshnjake, 39 prej të cilëve janë të stacionuar në stacionin kryesor të Prizrenit. Pozita më e lartë policore në rajon që e mban një boshnjak është zëvendëskomandant i stacionit në Prizren. Në këshillat komunalë për siguri në bashkësi në Prizren ka përfaqësim të boshnjakëve. Gjithashtu, komuniteti ka marrë pjesë në komitetin lokal për siguri publike që tani është kryesisht joaktiv, i themeluar në fshatin shumetnik të Mušnikovo/Mushnikovës (të banuar me shqiptarë, boshnjakë të Kosovës dhe serbë).

3. Kthimi dhe riintegrimi

Kthimet e boshnjakëve të Kosovës prej vitit 2008 mbesin të ulëta. UNHCR raporton një rritje të vogël në kthimet vullnetare nga 39 më 2008 në 43 më 2009.

Mungesa e përgjithshme e qëndrueshmërisë ekonomike, mbështetja e pamjaftueshme komunale dhe sfidat në qasje në sistem të arsimit për fëmijët e të kthyerve janë pengesat kryesore për kthimin dhe riintegrimin e numrit të vogël të personave të zhvendosur boshnjakë të Kosovës. Shumë boshnjakë të Kosovës janë detyruar të ikin nga Kosova gjatë dhe pas konfliktit për shkak të brengave të sigurisë, mungesës së mundësive ekonomike dhe vështirësive në qasjen në punësim. Kthimet kanë qenë të pakta. Një rritje e vogël e këtij numri është raportuar nga UNHCR-ja që nga viti 2008. Numri i të kthyerve me dhunë është ulur nga 55 në 2008 në 45 në vitin 2009, dhe vetëm 3 në çerekun e parë të vitit 2010.⁵ Nuk ka projekte të raportuara të kthimit dhe riintegrimin për komunitetin boshnjak të Kosovës në cilindo rajon të Kosovës.

⁵ Po aty.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, Mitrovicës/Mitrovica dhe Prishtinës/Priština, nuk ka kthime të konsiderueshme të boshnjakëve të cilët vazhdojnë të qëndrojnë në largim kryesisht për shkaqe ekonomike. Në rajonin e Pejës/Peć është raportuar se boshnjakët e kthyer të Kosovës janë kthyer jashtë projekteve të organizuara të kthimit të mbështetura nga institucionet dhe organizatat. Boshnjakët e kthyer të Kosovës kanë qenë në gjendje të rimarrin në posedim pronat e tyre pa vështirësi të theksuara, ndonëse janë raportuar incidente të sigurisë të lidhur me konteste pronësore (shih Pjesën 2 më lart). Rasti i vetëm i raportuar i kthimit me dhunë në rajon ka ndodhur në komunën e Istogut/Istok, ku, sipas zyrave komunale për kthim, pesë meshkuj boshnjakë të Kosovës janë riatdhesuar nga Luksemburgu dhe Suedia në fshatin Dobrushë/Dobrusha, tani ata banojnë me të afërmit e tyre. Në rajonin e Prizrenit, 13 boshnjakë të Kosovës janë kthyer vullnetarisht më 2009.⁶ Në mesin e të kthyerve në rajonin e Prizrenit, fëmijët e të kthyerve shpeshherë kanë vështirësi në integrim në sistemin arsimor për shkak të njohurisë së dobët të gjuhës së tyre amtare për shkak se kanë vijuar mësimin në gjuhë të huaj gjatë qëndrimit në zhvendosje.

Tanimë kanë ndodhur 29 kthime vullnetare në Kosovë, në çerkun e parë të vitit 2010, që është një trend inkurajues pozitiv.¹

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Vendi i banimit, disponueshmëria dhe qasja fizike janë të aspekte të rëndësishme për vendimet e boshnjakëve të Kosovës që t'i qasen institucioneve dhe shërbimeve të drejtuara nga Serbia, ndonëse dygjuhësia e shpeshtë e komunitetit nënkupton se ata janë në gjendje t'i qasen edhe institucioneve të Kosovës. Disa boshnjakë të Kosovës që dikur ishin të punësuar në ndërmarrje shoqërore edhe me tutje marrin pensione nga institucionet e drejtuara nga Serbia. Sipas përfaqësuesit të komunitetit në Mitrovicë/Mitrovica dhe Leposavić/Leposaviq, deri 100 boshnjakë të Kosovës punojnë në objekte shëndetësore dhe arsimore, si dhe në shërbimin civil të drejtuar nga Serbia. Megjithatë, pozitat e tyre janë përgjithësisht të nivelit të mesëm, derisa pozitat udhëheqëse i kanë serbët e Kosovës.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Boshnjakët e Kosovës gëzojnë nivel relativisht të mirë të qasjes në shërbimet komunale, varësisht nga disponueshmëria dhe lokacioni. Ka ende vështirësi, veçanërisht në lidhje me furnizimin me rrymë, sigurimin e ujit të pijshëm dhe sistemin funksional të kanalizimit. Në Mitrovicë/Mitrovica dhe Gjilan/Gnjilane, boshnjakët e Kosovës nuk kanë vështirësi në qasjen në shërbime komunale. Në Mitrovicë, ata kryesisht i qasen institucioneve dhe shërbimeve të drejtuara nga Serbia, gjersa në Gjilan i përdorin ato të ofruara nga qeveria e Kosovës. Në komunën e Pejës/Peć, komuniteti boshnjak i Kosovës edhe më tej përballet me probleme në lidhje me qasjen në shërbime komunale. Komuniteti është prekur nga shkyçjet kolektive nga furnizimi me energji elektrike ndonëse shumica e boshnjakëve paguajnë rregullisht faturat e tyre të rrymës. Në komunën e Deçanit/Dečane, nuk ka sisteme

6 Zyra e UNHCR e Shefit të Misionit, Pasqyrë statistikore e kthimeve vullnetare të pakicave në Kosovë 2000-2008 azhurnim përfshirë dhjetorin 2008. Informata për periudhën 2008-2009 të marra nga UNHCR dhe Ekipet në terren të OSBE-së

1 ZSHM UNHCR Prishtinë/Priština, Pasqyrë statistikore Azhurnim deri në fund të prillit 2010.

kryesore të kanalizimit në fshatrat ku ata jetojnë. Komuniteti është i obliguar të përdorë rezervuarë septikë dhe uji sigurohet nga pusët. Në zonat e banuara nga boshnjakët e Kosovës në Pejë/Peć, grumbullimi i mbeturinave nuk ofrohet në fshatrat Raushiq/Raušić, Treboviq/Trebović, Ozdrim/Ozrim, Tërstenik/Trstenik dhe Novosellë/Novoselo. Në Vitomirica/Vitomiricë dhe në qytetin e Pejës/Peć, kompania “Ambienti” mbledh mbeturinat vetëm nga rrugët kryesore.

Në Prizren, boshnjakët e Kosovës në Luginën e Zhupës gjatë dimrit 2009-2010 janë përballur me ndërprerje të mëdha të energjisë elektrike për shkak të rrjetit të vjetruar. Boshnjakët e Kosovës me banim në qytetin e Prizrenit janë më mirë, dhe gëzojnë qasje në energji të rregullt elektrike, furnizim me ujë dhe mbledhje të mbeturinave. Banorët në viset e largëta rurale kanë qasje jo të rregullt në këto shërbime. Banorët e fshatrave Reçane/Reçan, Mušnikovo/Mushnikovë dhe Gornje selo/Gornjasellë kanë refuzuar të paguajnë faturat për mbledhje të mbeturinave dhe vazhdojnë t'i hedhin ato në lumë. Ngjashëm me komunitetin goran,⁷ boshnjakët e Kosovës në Luginën e Zhupës është dashur të paguajnë tarifën mujore prej 3.50 Euro për Radiotelevizionin e Kosovës, ndonëse nuk ka mbulim me sinjal në këtë zonë. Tarifa është përfshirë në faturën e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK), ndërsa pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese në tetor 2009, kjo praktikë është ndërprerë.

6. Qasja në shërbime dhe mirëqenie sociale

Nuk ka ndryshime në lidhje me qasjen në shërbime sociale për boshnjakët e Kosovës. Zakonisht, boshnjakët e Kosovës gëzojnë qasje të papenguar në shërbime dhe mirëqenie sociale. Boshnjakët me banim në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica pranojnë përfitime dhe shërbime nga institucionet e drejtuara nga Serbia. Disa komuna, si Istogu/Istok në rajonin e Pejës, ofrojnë mbështetje ad hoc për familjet më të cenueshme. Në komunën e Prizrenit, 239 familje të boshnjakëve të Kosovës përfitojnë nga asistencë sociale, gjersa shumë të tjerë kanë aplikuar por nuk janë kualifikuar për të.

7. Qasja në pronë dhe banim

Boshnjakët e Kosovës gëzojnë qasje relativisht të mirë në pronë dhe banim. Është raportuar se në Pejë/Peć, të gjithë boshnjakët e Kosovës, shtëpitë e të cilëve janë uzurpuar pas konfliktit të 1999, kanë kthyer në posedim pronat e tyre dhe nuk kanë hasur në probleme të mëtejme. Megjithatë, janë raportuar incidente të kohëpaskohshme të sigurisë në komunën e Pejës/Peć në lidhje me konteste pronësore (shih pjesën 2 më lart). Ende ka vështirësi në lidhje me pabarazitë ndërmjet grave dhe burrave në të drejtën e tyre në trashëgimi. Zakonisht, gratë boshnjake e Kosovës edhe janë në pozitë të pafavorshme në shumë situata të trashëgimisë meqë ato pranojnë më pak sesa të afërmit e tyre meshkuj, përballen me probleme në regjistrimin e tokës në emrin e tyre, duhet të heqin dorë nga pjesa e tyre për të afërmit meshkuj. Të drejtat e tyre thjeshtë as nuk respektohen, as nuk pranohen.

⁷ Për më shumë hollësi, ju lutem shihni profilin e komunitetit goran, pjesa 5.



MËSUESJA SHQIPTARE E KOSOVËS MËSON NXËNËSIT BOSHNJAKË TË KOSOVËS NË GJUHËN SHQIPE NË SHKOLLËN "METO BAJRAKTARI" NË REÇANE/REÇAN, VENDBANIMIN MË TË MADH TË BOSHNJAKËVE TË KOSOVËS NË LUGINËN MALORE TË ŽUPA/ZHUPËS NË KOMUNËN E PRIZRENIT. SHKOLLA KA RRETH 350 NXËNËS, QË VIJOJNË MËSIMIN NË GJUHËN BOSHNJAKE SIPAS KURRIKULËS SË KOSOVËS.

8. Qasja në arsim

Arsimi në gjuhën boshnjake e Kosovës është në dispozicion në të gjitha rajonet e Kosovës, përveç në Gjilan/Gnjilane. Ndonëse ekziston planprogrami boshnjak për komunitetin, mungesa e teksteve shkollore vazhdon të pengojë të drejtën e komunitetit në arsimim në gjuhën amtare. Për shembull, shumica e teksteve shkollore të bazuara në planprogram për arsimin fillor dhe të mesëm, për klasat 6-9 nuk janë në dispozicion në gjuhën boshnjake. Nuk ka fare të tilla për arsimin e mesëm, klasat 10-13. Veç kësaj, arsimi i nxënësve të klasës së nëntë është ende i bazuar në versionin e mëhershëm të tekstit shkollor, ndonëse planprogrami është ndërruar. Për më tepër, nuk ka lëndë dhe libra përkatës të mjaftueshëm specifik për komunitetin, përgjithësisht cilësia e përkthimeve në gjuhën boshnjake e Kosovës është e dobët, dhe ka mungesë të përfaqësimit të komunitetit në menaxhimin e shkollës. Përkundër vendeve të rezervuara në Universitetin e Prishtinës dhe disponueshmërinë e kurseve të gjuhës boshnjake e Kosovës në Pejë/Peć dhe Prizren, qasja dhe shfrytëzimi i këtyre mundësive vazhdon të jetë i penguar nga njohuria e dobët e gjuhës shqipe e studentëve boshnjakë. Shumica e tyre vendosin të regjistrohen në Universitetin e Mitrovicës apo në universitetet tjera në rajon. Opsioni i fundit vazhdon të jetë problematik për shkak të mosnjohjes së diplomave arsimore të Kosovës gjetkë.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm në gjuhën boshnjake e Kosovës nuk është në dispozicion. Si rrjedhojë, komuniteti i vogël boshnjak në komunën e Ferizajt/Uroševac i qaset arsimin në gjuhën shqipe. Në pjesën jugore të komunës Mitrovicës/Mitrovica, boshnjakët e Kosovës vijnë në mësimin në shkolla filllore dhe të mesme sipas planprogramit të Kosovës. Këto institucione kanë punësuar mësimdhënës boshnjakë të Kosovës të cilët japin mësim në gjuhën boshnjake e Kosovës përkundër numrit të vogël të fëmijëve boshnjakë të Kosovës të regjistruar. Në pjesën veriore të komunës së Mitrovicës/Mitrovica dhe Leposavić/Leposaviq, boshnjakët e Kosovës vijnë në mësimin në shkolla me planprogram të Serbisë në gjuhën serbe. Në rajonin e Pejës/Peć, arsimi në gjuhën boshnjake e Kosovës përgjithësisht është në dispozicion në komunat ku jeton komuniteti.

Ndonëse arsimi në gjuhën boshnjake e Kosovës është përgjithësisht në dispozicion dhe është përpiluar planprogrami përkatës, mungesa e teksteve shkollore në gjuhën boshnjake e Kosovës e pengon gëzimin e të drejtave të tyre arsimore.

Në viset rurale, vajzat boshnjake e Kosovës shpeshherë braktisin shkollimin në moshë të hershme për shkak të traditës dhe pengesave socio-ekonomike. Shumë vajza detyrohen të martohen pas përfundimit të arsimin të obligueshëm.

Në Gjakovë/Đakovica, rreth 20 fëmijë boshnjakë të Kosovës janë të regjistruar në shkollat ku mësimi ofrohet në gjuhën shqipe. Në Pejë/Peć, janë 473 fëmijë boshnjakë të Kosovës të moshës shkollore që vijnë në mësimin në shtatë shkolla fillore të përziara (dy shkolla në qytetin e Pejës/Peć, gjersa fshatrat Vitimirica/Vitimiricë, Zloperk/Zlopek, Treboviq/Trebović, Orasje/Orašje dhe Novosellë/Novoselo, kanë nga një shkollë). Të gjithë vijnë në mësimin e mesëm në qytetin e Pejës/Peć. Në Istog/Istok, fëmijët e moshës 6 deri 15 vjeçe vijnë në mësimin e obligueshëm në shkollën shumëetnike në fshatin Dobrushë/Dobrushe, duke udhëtuar në komunën e Pejës/Peć për ta vazhduar mësimin e mëtejshëm. Në Deçan/Dečani, ku nuk ka në dispozicion mësim në gjuhën boshnjake, komuna transporton nxënësit e shkollës fillore për në Pejë/Peć, duke përfshirë dy fëmijë nga Rastavica dhe pesë të tjerë nga Prapaqani/Prapačane.

Përgjithësisht, nxënësit boshnjakë të Kosovës në Kosovë mësojnë shqip krahas gjuhës së tyre amtare dhe kanë ndërveprime të tëra me fëmijët e komuniteteve tjera.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, mësimi në gjuhën boshnjake e Kosovës ofrohet në komunën e Prishtinës/Priština, por jo edhe në Obiliq/Obilić apo Fushë Kosovë/Kosovo Polje ku po ashtu ka pjesëtarë të këtij komuniteti. Kjo ka shkakuar që fëmijët boshnjakë të Kosovës të regjistrohen në shkollat e drejtuara nga Serbia në ato komuna ku nuk është në dispozicion mësimi në gjuhën boshnjake. Janë 29 nxënës boshnjakë të Kosovës të regjistruar në klasat një deri nëntë në shkollën fillore “Naim Frashëri” në qytetin e Prishtinës/Priština që vijnë në mësimin në gjuhën boshnjake. 12 nxënës vijnë në mësimin në gjuhën shqipe në shkollën e mesme “Sami Frashëri” po ashtu në qytet. Në komunën e Obiliqit/Obilić, në shkollën fillore “Branko Radicevic” (me planprogram serb) vijnë në mësimin dy nxënës boshnjakë, gjersa një tjetër nxënës vijnë në mësimin në shqip në shkollën fillore “Pandeli Sotiri”. Tre fëmijë boshnjakë të Kosovës nga fshati Mazgit në komunën e Obiliqit/Obilić vijnë në mësimin në gjuhën boshnjake e Kosovës në qytetin e Prishtinës/Priština, gjersa dy të tjerë vijnë në mësimin me planprogramin në Obiliq/Obilić. Veç kësaj, tre nxënës boshnjakë të Kosovës vijnë në mësimin në gjuhën shqipe në Universitetin e Prishtinës. Në rajonin e Prizrenit, ka në dispozicion mësim fillor dhe të mesëm në gjuhën boshnjake e Kosovës në komunat e Dragashit/Dragaš dhe Prizrenit, gjersa në këtë të fundit ka edhe mësim parashkollor në gjuhën boshnjake e Kosovës për komunitetin. Në komunën e Dragashit/Dragaš, 145 nxënës vijnë në mësimin në gjuhën boshnjake e Kosovës që nga arsimi parashkollor deri në arsimin e mesëm të ulët (103 nxënës në Kruševë/Krushevë, 28 në Restelica/Restelicë, 12 në Brod dhe dy në Dragash/Dragaš), kurse 50 vijnë në mësimin e mesëm të lartë në qytetin e Dragashit/Dragaš. Ndonëse ka vajza boshnjake e Kosovës në mesin e 145 nxënësve që vijnë në mësimin e obligueshëm, asnjë nuk ka arritur deri te arsimi i mesëm i lartë. Në komunën e Prizrenit, janë 237 mësimdhënës boshnjakë të Kosovës dhe 3,091 nxënës boshnjakë të Kosovës në shkollat parashkollore, fillore dhe të mesme.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Komuniteti boshnjak i Kosovës nuk përballë me pengesa të mëdha në qasjen në shërbimet shëndetësore kudo në Kosovë, por ndan me komunitetet tjera vështirësitë në qasjen fizike në objektet

shëndetësore nga viset e largëta dhe cilësinë e dobët të shërbimit të ofruar. Në Mitrovicë/Mitrovica, boshnjakët mund t'i qasen qendrës shëndetësore në jug të Mitrovicës/Mitrovica, e cila ofron shërbime jashtëspitalore, kurse për kujdes spitalor duhet të udhëtohet për në spitalin e Prishtinës/Priština, apo spitalin rajonal dhe qendrën shëndetësore në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Infermiere boshnjake e Kosovës ka në të dy institucionet shëndetësore, si në veri ashtu edhe në jug. Në Leposavić/Leposaviq, boshnjakët e Kosovës në Vračevo/Vraçevë mbështeten në klinikën e vjetër të drejtuar nga Serbia për shërbime jashtëspitalore, si dhe në qendrën shëndetësore në qytetin e Leposavić/Leposaviqit që ofron shërbime të plota shëndetësore. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti boshnjak i Kosovës gëzon qasje të plotë në shërbime të shëndetësisë primare dhe sekondare të ofruara nga qendrat shëndetësore. Po ashtu, ata pranojnë edhe shërbime të shëndetësisë sekondare nga spitali rajonal në Ferizaj/Uroševac.

Komuniteti boshnjak i Kosovës gëzon qasje të mirë edhe në shërbime shëndetësore në rajonin e Pejës/Peć. Në komunën e Deçanit/Dečane, komuniteti boshnjak i Kosovës fiton shërbime të kujdesit shëndetësor primar nga qendrat shëndetësore dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor sekondar në spitalin rajonal të Pejës. Shqetësimi kryesor ka të bëjë me koston e ilaçeve. Në komunën e Pejës /Peć, boshnjakët e Kosovës kanë qasje në qendrat shëndetësore në qytetin e Pejës/Peć, në Baranë/Barane dhe Vitimirica/Vitimiricë. Një mjek boshnjak është ankuar për shkak të mungesës së stafit, veçanërisht në qendrat shëndetësore në Vitimirica/Vitimiricë dhe në lagjen Dardania/Brzenik. Në rajonin e Prizrenit, ka objekte shëndetësore në shumicën e fshatrave të banuara me boshnjakë të Kosovës në Luginën e Zhupës. Qendra kryesore shëndetësore e kësaj zone është në fshatin Reçane/Reçan dhe ka në staf dy mjekë të përgjithshëm dhe një stomatolog. Përveç një infermiereje në qendrën e kujdesit shëndetësor primar në Reçane/Reçan, të gjithë punonjësit në objektet e kujdesit shëndetësor në Luginën e Zhupës janë meshkuj, duke e kufizuar kështu qasjen në kujdesin shëndetësor për gratë që banojnë në këtë zonë rurale dhe pak më tradicionale të rajonit. Gratë shpeshherë preferojnë të vizitojnë mjeket në qytetin e Prizrenit, përkundër kostove më të larta mjekësore dhe të transportit. Më 2008 dhe 2009, një përpjekje për të ofruar shërbime gjinekologjike çdo dy javë, me kërkesë të grave të kësaj zone, nuk arriti të ofrojë interesim domethënës në komunitet, edhe pse ato i ofronte një mjekë. Shumë gra boshnjake e Kosovës vendosin që të udhëtojnë në qytetin e Prizrenit ku gëzojnë anonimitet më të madh dhe mund të kenë qasje në këto shërbime në mënyrë më diskrete. Ekziston vetëm një barnatore private në Reçane/Reçan ku njerëzit mund t'i blejnë ilaçet e nevojshme, ndonëse çmimet janë më të larta sesa në Prizren. Boshnjakët e Kosovës gjithashtu kanë qasje në strukturat shëndetësore të drejtuara nga Serbia që gjenden në Mušnikovo/Mušnikovë dhe Sredska/Sredskë. Boshnjakët e Kosovës i qasen spitalit rajonal, që ofron shërbime të shëndetësisë sekondare, duke përfshirë kujdesin për të sëmurë të shtrirë. Për probleme të rënda shëndetësore, ata udhëtojnë në Beograd ku ekzistojnë objekte më të mira dhe ku komuniteti mund të komunikojë më me lehtësi në gjuhën boshnjake e Kosovës për shkak të ngjashmërisë së saj me serbishten.

10. Qasja në drejtësi

Në rajonin e Gjilan/Gnjilane, komuniteti boshnjak i Kosovës ka qasje të plotë në gjykata dhe shërbime ligjore. Megjithatë, nuk ka boshnjakë të Kosovës të punësuar si gjyqtarë apo prokurorë në komunën e Ferizajt/Uroševac. Qasja në drejtësi mbetet problematike për komunitetin boshnjak në Mitrovicë/Mitrovica. Ky është problem edhe për komunitetet tjera për shkak të funksionimit të pjesshëm të gjykatave që nga shkurti 2008. Në komunën e Pejës/Peć, disa boshnjakë të Kosovës kanë raportuar se nuk kanë besim në agjencitë për zbatim të ligjit me argument që vendimet e gjykatave zvarriten dhe madje janë të njëanshëm. Në rajonin e Prishtinës/Priština, boshnjakët e Kosovës gëzojnë qasje të barabartë në gjykata dhe shërbime ligjore. Zyra e qarkut për ndihmë juridike që vepron në Prishtinë/Priština ofron ndihmë juridike pa pagesë në lëndë civile dhe administrative në gjuhën boshnjake e Kosovës për personat që nuk kanë mundësi financiare. Në Gjykatën për kundërvajtje është e punësuar një gjyqtare boshnjake. Në rajonin e Prizrenit, në gjykata, janë shtatë gjyqtarë boshnjakë të Kosovës dhe një prokuror boshnjak, ndërsa komuniteti gëzon qasje në gjykata dhe shërbime ligjore në mënyrë të krahasueshme me komunitetet tjera.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Çarjet e vazhdueshme brenda elitës politike të boshnjakëve vazhdon të ketë efekt negativ në pjesëmarrjen e komunitetit në rajonin e Prizrenit.

Komuniteti boshnjak i Kosovës është i përfaqësuar mjaft mirë në jetën publike krahasuar me komunitetet tjera joshqiptare. Në nivel qendror, komuniteti ka siguruar pesë ulëse në Kuvendin e Kosovës dhe pozitën e Zëvendësministrit të arsimit, shkencës dhe teknologjisë. Veç kësaj, tri vende janë të rezervuara për boshnjakët e Kosovës në Këshillin konsultativ për komunitete, që është organ këshillëdhënës në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës. Përkundër lobimit nga udhëheqësit e komunitetit, nuk janë themeluar komuna të reja me shumicë boshnjake e Kosovës brenda dhe përreth fshatrave Reçane/Recan (komuna e Prizrenit) dhe Vitomirica/Vitomiricë (komuna e Pejës/Peć). Megjithatë, kjo nuk ka pasur ndikim negativ në pjesëmarrjen e komunitetit në jetën publike në nivel lokal, e cila ekziston në të gjitha komunat

RADIOSTACIONI LOKAL I BOSHNJAKËVE TË KOSOVËS "HAYAT" NË VITOMICË/VITOMIRICA TË KOMUNËS SË PEJËS/PEĆ TRANSMETON PROGRAM NË GJUHËN BOSHNJAKE.



ku ata jetojnë. Gratë boshnjake e Kosovës janë relativisht mirë të përfaqësuar, duke pasur 40% (dy nga pesë vende të boshnjakëve të Kosovës) në Kuvendin e Kosovës, mbi 40% të pozitive në komitetet komunale të komuniteteve, por vetëm 22% në pozitat e kuvendet komunale që i mban komuniteti. Komuniteti ka pozita të spikatura në degët e legjislativit dhe ekzekutivit, si dhe vende në kuvendet e komunave me dendësi më të madhe banimi të boshnjakëve në Prizren, Pejë/Peć dhe Dragash/Dragaš. Komuniteti boshnjak i Kosovës është i përfaqësuar me anë të koalicionit VAKAT (Koalicija VAKAT), i cili mbështet integrimin e plotë të komunitetit në institucionet publike, bashkë me promovimin e identitetit boshnjak, si dhe arsimimin në gjuhën boshnjake e Kosovës në pajtim me planprogramin e Kosovës. Megjithatë, mungesa e bashkëpunimit ndërmjet VAKAT-it dhe partisë së goranëve GIG (Gradanska Inicijativa Gora/Inicijativa Qytetare Gora) ka sjellë më shumë vështirësi në emërimin e përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë, duke pasur ndikim negativ në pjesëmarrjen e të dy komuniteteve. Partia e goranëve është më mbështetëse e organeve komunale të drejtuara nga Serbia, me interes të shprehur për vijimin e mësimin në shkollat e drejtuara nga Serbia, për aq kohë sa nuk ka planprogram të Kosovës në gjuhën serbe.⁸ Radiotelevizioni i Kosovës (RTK) transmeton çdo ditë nga 15 minuta dhe një dokumentar njëorësh në javë në gjuhën boshnjake.

Në rajonin e Ferizajt/Uroševac në Gjilan/Gnjilane, komuniteti i vogël boshnjak nuk është i përfaqësuar në strukturat komunale. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, boshnjakët e Kosovës janë të punësuar në institucionet komunale në veri dhe jug të Mitrovicës/Mitrovica dhe komunën e Leposavić/Leposaviqit. Boshnjakët e Kosovës shërbejnë si politikanë, shërbyes civilë dhe aktivistë të komunitetit dhe zakonisht marrin pjesë në nismat për të mbledhur komunitetet në forume publike. Komuniteti boshnjak i Kosovës është i përfaqësuar në komitetin për komunitete të komunës në Mitrovicë/Mitrovica, i cili kryesohet nga një boshnjak. Dy boshnjakë të Kosovës tjerë punojnë në zyrën komunale për komunitete. Në Leposavić/Leposaviq, tre boshnjakë të Kosovës punojnë në komunë, ndonëse jo në pozita vendimmarrëse. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, nuk ka media specifike për komunitetin boshnjak të Kosovës dhe programet e vetme për ta i ofron RTK-ja, transmetuesi publik. Në Komunën e Pejës/Peć, nga 21 pozita të komuniteteve joshqiptare, dhjetë i takojnë boshnjakëve, përfshirë këtu tri femra. Dy meshkuj dhe një femër boshnjake e Kosovës kanë mandate në kuvendin komunal, postin e kryesuesit të zyrës komunale për komunitete dhe zëvendëskryesuesin e kuvendit komunal. Përfaqësuesit e komunitetit kanë shprehur interesim në rritjen e përfaqësimit të tyre në organet komunale. Komuna nuk ka realizuar aktivitete të mjaftueshme të kontaktimit me komunitetin, fakt që komuniteti e konsideron si të dëmshëm për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike. Boshnjakët e Kosovës janë të përfaqësuar edhe në komitetet për komunitete në të gjitha komunat në rajonet ku ata jetojnë. Gjithashtu, një boshnjak i Kosovës është në krye të zyrës komunale për komunitete në komunën e Istogut/Istok. Zyrat komunale për komunitete përgjithësisht kanë qenë aktive në organizimin e vizitave periodike të kontaktimit dhe informimit në viset rurale të banuara nga komuniteti, posaçërisht në Deçan/Deçane dhe Istog/Istok. Në rajonin e Pejës/Peć, boshnjakët e Kosovës mbështeten në radiostacionin lokal "Radio Peja", i cili transmeton një program ditor dhjetëminutësh

Në komunën e Pejës/Peć, partia boshnjake e Kosovës Demokracia në Veprim (SDA ka garuar pa sukses për postin e nënkryetarit të komunës për komunitete pas zgjedhjeve lokale të 2009, gjë që ka shkaktuar frustrim në komunitet. Partia ka parashtruar kërkesë pranë Gjykatës Kushtetuese për ta shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të emërimit të një egjiptiani të Kosovës në këtë pozitë.

⁸ Partia gjithashtu përkrah integrimin e plotë të komunitetit goran në shoqërinë gorane me identitet kombëtar goran, dhe gjuhën serbe si gjuhë amtare.

dhe program javor tridhjetëminutësh në gjuhën boshnjake e Kosovës dhe “Radio Hayat”, radiostacion publik që transmeton program në gjuhën boshnjake. Nuk ka media elektronike apo ndonjë gazetë për komunitetin.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, duke pasur parasysh numrin aktual të vogël të komunitetit boshnjak, niveli i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes është proporcional me madhësinë e komunitetit, me nga një përfaqësues në komitetet komunale për komunitete në Prishtinë/Priština dhe Obiliq/Obilić. Subjektet kryesore politike të boshnjakëve të Kosovës udhëhiqen nga zyrat qendrore në Prishtinë/Priština. Megjithatë, nuk ka organizata të shoqërisë civile nga komuniteti që janë aktive në rajon. Në komunën e Prizrenit, boshnjakët e Kosovës janë të përfaqësuar mirë në degën e legjislativit dhe të ekzekutivit. Tre nga 41 deputetët e kuvendit komunal, drejtori për kulturë, rini dhe sport, zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete dhe kryesuesi i zyrës komunale për komunitete, janë nga komuniteti boshnjak i Kosovës.⁹ Një grua boshnjake e Kosovës përfaqëson komunitetin në zyrën komunale për kthim, gjersa komuniteti është i përfaqësuar edhe në komitetin për politika dhe financa, komitetin për komunitete dhe disa komitete tjera. Edhe me këtë nivel të shtrirë të përfaqësimit, ekzistojnë aktivitete të pakta të informimit për komunitetin boshnjak. Më 2009, pranë zgjedhjeve lokale, kishte numër të vogël të aktiviteteve të informimit si në nivel qendror ashtu dhe në atë lokal që kishin për cak boshnjakët e Kosovës. Në komunën e Dragashit/Dragaš, komuniteti boshnjak i Kosovës është i përfaqësuar në degën ekzekutive përmes nënkryetarit të komunës për komunitete. Në degën legjislative, ai është i përfaqësuar nga dy anëtarë të kuvendit komunal dhe zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete. Në shërbimin civil, boshnjakët e Kosovës kanë pozitën e drejtorit të kadastrit, urbanizmit dhe planifikimit dhe drejtorit të inspektimit.¹⁰ Veç kësaj, komuniteti i ka dy përfaqësues në komitetin për komunitete.

12. Përdorimi i gjuhës

Gjuha boshnjake e Kosovës pranohet si gjuhë në përdorim zyrtar¹¹ në Pejë/Peć, Prizren, Istog/Istok dhe Dragash/Dragaa. Ligji për përdorimin e gjuhëve përcakton të drejtat gjuhësore të komuniteteve që përfitojnë nga ky status dhe obligimet specifike të komunave. Kjo përfshin të obligimin për të siguruar, me kërkesë, përkthim me gojë dhe me shkrim, shërbime komunale dhe dokumente në gjuhën boshnjake.

Boshnjakët e Kosovës në qytetin e Ferizajt/Uroaevac, (rajoni Gjilan/Gnjilane), flasin gjuhën boshnjake e Kosovës jo vetëm në sferën private, por ndihen gjithnjë e më të sigurt për ta folur në publik. Njohja e gjuhës shqipe te të rinjtë boshnjakë të Kosovës është e shkëlqyeshme. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, boshnjakët e Kosovës vazhdojnë ta përdorin gjuhën e tyre pa pengesa në publik, përfshirë në marrëdhëniet me autoritetet komunale në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica dhe në Leposavi/Leposaviq, ku shumica e banorëve flasin serbisht. Boshnjakët e Kosovës e përdorin gjuhën e tyre amtare lirshëm në vendet publike në të gjitha komunat e rajonit të Pejës/Peć, përveç në Gjakovë/Đakovica, ku numri i vogël i komunitetit dhe dëshira e boshnjakëve për t'u integruar nënkupton që ata

9 Dy subjektet kryesore politike kundërshtarë boshnjake, Koalicioni VAKAT dhe Partia e Re Demokratike e porsathemeluar (PRD) kanë hyrë në koalicion me Partinë Demokratike të Kosovës (PDK).

10 Partitë që njihen tipikisht si përfaqësuese të komunitet boshnjak kanë fituar tri vende në kuvendin komunal. Megjithatë, Partia Demokratike në Veprim (Stranka Demokratske Akcije, SDA), parti tipike boshnjake, përfaqësohet nga një deputet, i cili pohon se vepron në emër të goranëve dhe jo të komunitetit boshnjak.

11 Siç është saktësuar në Ligjin për përdorimin e gjuhëve, Ligji nr. 02/L-37, neni 2.4, Në ato komuna ku jeton një bashkësi, gjuha amtare e së cilës nuk është njëra nga gjuhët zyrtare në Kosovë dhe e cila përfaqëson më shumë se tre (3) përqind të popullatës së përgjithshme të komunës, gjuha e asaj bashkësie do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar.

preferojnë të flasin shqip në publik. Në komunën e Pejës/Peć, aktivitetet e informimit publik janë shpallur në gjuhën boshnjake e Kosovës dhe përkthimi me shkrim dhe me gojë është siguruar me kërkesë, ndonëse sasia dhe cilësia e dokumenteve të përkthyer nuk është e kënaqshme. Në komunën e Istogut/Istok, gjuha boshnjake e Kosovës është gjuhë në përdorim zyrtar. Në komunën e Deçanit/Dečani, boshnjakët e Kosovës mund t'i drejtohen dhe të marrin përgjigje nga zyrtarët komunalë në gjuhën e tyre. Meshkujt boshnjakë të Kosovës mundohen ta mësojnë gjuhën shqipe dhe të ndërveprojnë me komunitetin shumicë, ndërsa femrat e komunitetit nuk e flasin shqipen dhe janë më të izoluara si rezultat. Nuk janë vërejtur zhvillime të reja në Prishtinë/Priština, ku varësisht nga konteksti dhe bashkëbiseduesit – boshnjakët e Kosovës e përdorin gjuhën boshnjake e Kosovës apo shqipe në publik. Cilësia dhe sasia e dokumenteve të përkthyer në serbisht, të qasshme edhe për boshnjakët e Kosovës, nga ana e komunës është e pranueshme, ndonëse janë raportuar vështirësi në sigurimin e shërbimeve mjekësore në gjuhën amtare.

Në komunën e Prizrenit, statusi i gjuhës boshnjake e Kosovës si gjuhë zyrtare respektohet nga autoritetet. Shumica e shenjave publike vendosen në gjuhën boshnjake, si dhe shumica e dokumenteve zyrtare janë në dispozicion edhe në gjuhën amtare të këtij komuniteti. Përkthimi me gojë në gjuhën boshnjake e Kosovës gjithmonë ofrohet gjatë takimeve zyrtare të kuvendit komunal. Megjithatë, në vitin 2008, deputetët boshnjakë të Kosovës dhe turq kanë nisur një ankesë të përbashkët kundër komunës, duke pohuar se logoja nuk e pasqyronte larminë e komunës meqë në mënyrë të veçantë përjashtojë gjuha boshnjake e Kosovës dhe atë turke. Pas disa përpjekjeve të pasuksesshme për ta zgjidhur këtë çështje në nivel lokal dhe ministror, komuniteti paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila vendosi në favor të tyre me vendim të plotfuqishëm në mars të vitit 2010. Gjykata konstatoi se ka ekzistuar shkelje e të drejtave të komunitetit boshnjak për ruajtjen, mbajtjen dhe promovimin e identitetit të tyre, dhe e urdhëroi komunën që ta ndryshojë statusin dhe emblemën e saj brenda tre muajve nga dorëzimi i aktgjykimit, saktësisht deri më 18 qershor 2010. Dy ditë para skadimit të këtij afati, më 16 qershor 2010, Gjykata e miratoi kërkesën e komunës për të zgjatur afatin për zbatimin e vendimit për 90 ditë për t'i dhënë kuvendit komunal më shumë kohë për ta gjetur mënyrën për ta thyer bllokadën aktuale politike që e parandalonte zbatimin e vendimit. Gjatë kësaj kohe, mediat lokale dhe opinioni publik në komunë kishin reagime negative ndaj vendimit, duke pretenduar se logoja ishte përfshirëse dhe i akuzonin partitë politike të boshnjakëve dhe turqve për ndasi.

Më 4 qershor 2010, një takim i komitetit për komunitete në komunën e Deçanit/Dečani është mbajtur pa përkthim. Kështu, pjesëtari boshnjak nuk ishte në gjendje të merrte pjesë aktive në diskutime. Është me rëndësi të ceket se zyrtari komunal për kthim shërbeu si përkthyes për ta kompensuar këtë mangësi.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Nuk ka monumente të dallueshme kulturore apo fetare të boshnjakëve në Kosovë. Në Mitrovicë/Mitrovica, monumenti i vetëm i interesit është xhamia në fshatin Rvatska/Rëvatskë që u djeg deri në themel në vitin 1938. Në vitin 2005, me financime të jashtme, komuniteti filloi rindërtimin e xhamisë dhe ajo tani është përsëri në përdorim, ndonëse ende e papërfunduar. Në rajonin e Pejës/Peć, Imami i xhamisë në

“PELIVANI”, GARA TRADICIONALE E BOSHNJAKËVE TË KOSOVËS TË SPROVIMIT TË FORCËS NË GORNJE LJUBINJE/LUBINJË TË EPERMË NË LUGINËN E ŽUPA/ZHUPËS (KOMUNA E PRIZRENIT).



fshatin Dobrushë/Dobrusa, në Istog/Istok, është boshnjak i Kosovës. Veç kësaj, komuniteti ka provuar gjatë tre viteve të fundit që të organizojë një kuvend të boshnjakëve, duke i mbledhur boshnjakët e Kosovës që jetojnë brenda dhe jashtë saj. Megjithatë, ndarjet dhe mosmarrëveshjet brenda komunitetit e kanë pamundësuar realizimin e kësaj ideje. Trashëgimia kulturore e komunitetit është kryesisht e përfaqësuar përmes trashëgimisë së tyre fetare, të cilën ata e ndajnë me komunitetin tjetër mysliman në Kosovë. Dy ngjarjet më të rëndësishme fetare janë agjërimi në muajin e shenjtë të Ramazanit, i cili përfundon me festën Eid ul-Fitr dhe Eid ul-Adha, që festohet gati dy muaj më vonë. Boshnjakët e Kosovës e shënojnë 28 shtatorin si festë zyrtare të boshnjakëve të Kosovës në pajtim me Ligjin për festat zyrtare. Më 2009, përfaqësuesit e partive politike dhe shoqërisë civile kanë pranuar mbështetje në shënimin e kësaj dite përmes aktiviteteve të ndryshme kulturore, duke përfshirë festimin e përvjetorit të dhjetë të arsimit në gjuhën boshnjake e Kosovës në Kosovë.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Boshnjakët e Kosovës janë relativisht mirë të integruar në shoqërinë e Kosovës, dhe angazhohen shpeshherë në dialog të hapur me të gjitha komunitetet.

Boshnjakët e Kosovës vazhdojnë të kenë marrëdhënie të mira me komunitetin shumicë, si shqiptar, ashtu edhe serb, në ato komuna ku jetojnë. Kjo është pjesërisht për shkak të faktit që tiparet fetare dhe gjuhësore që komuniteti i ndan me shqiptarët, respektivisht serbët. Komuniteti boshnjak i Kosovës është relativisht mirë i integruar në shoqërinë kosovare dhe angazhohet në dialog të shpeshtë dhe të hapur me të gjitha komunitetet. Në komunën e Ferizajt/Uroaevac (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), nuk ka nisma komunale dhe/apo të shoqërisë civile për promovimin e dialogut ndërmjet komunitetit shumicë dhe komunitetit boshnjak të Kosovës, apo të pjesëmarrjes së tyre në çështjet publike. Komuniteti boshnjak i Kosovës në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica vazhdon të ketë marrëdhënie të mira me komunitetin shqiptar të Kosovës dhe atë serb të Kosovës në komunat ku jetojnë. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti është relativisht mirë i integruar dhe ndërvepron lirshëm me të gjitha komunitetet tjera. Megjithatë, gratë dhe vajzat në disa vise rurale nuk



KAFENE SHUMETNIKE NË MËHALLËN E BOSHNIKËVE NË PJESËN VERIORE TË MITROVICËS/MITROVICA, KU SHKOJNË BOSHNIKËT E KOSOVËS, SHQIPTARËT E KOSOVËS DHE SERBËT E KOSOVËS QË JETOJNË NË LAGJE DHE AFËR SAJ.

e njohin gjuhën shqipe në nivel të njëjtë, gjë që pengon pjesëmarrjen dhe ndërveprimin e tyre me shumicën. Boshnjakët e Kosovës nuk angazhohen në nismat për dialog ndërmjet komuniteteve të realizuara nga komunitet apo shoqëria civile në Deçan/Dečane, Pejë/Peć, apo Istog/Istok. Shumica e këtyre aktiviteteve të dialogut ndërmjet komuniteteve kanë për cak serbët në kuadër të projekteve të kthimit dhe riintegrit, ndonëse duhet të theksohet që komuniteti boshnjak i Kosovës ndihet kryesisht i integruar dhe ka raportuar të ketë shumë pak nevojë për aktivitete informimi të dedikuara për komunitetin.

Në rajonin e Prishtinës/Priatina, nuk janë organizuar nisma komunale apo të shoqërisë civile për promovim specifik të dialogut ndërmjet komuniteteve dhe pjesëmarrjen e boshnjakëve të Kosovës. Megjithatë, në rajonin e Prizrenit, komuniteti ka qenë më proaktiv në këtë angazhim. Në komunën e Prizrenit, komuniteti ka marrë pjesë aktive në aktivitetet e dialogut ndërmjet komuniteteve, të mbështetura nga komuna. OJQ-ja shumetnike Qendra për integrimin e komuniteteve etnike QIKE ka organizuar vazhdimisht tryeza të rumbullakëta mbi tema të ndryshme të interesit për komunitetet joshumicë, siç janë përdorimi i gjuhëve dhe arsimit të komuniteteve, kryesisht me pjesëmarrjen e boshnjakëve dhe turqve të Kosovës. Në qytetin e Prizrenit, boshnjakët e Kosovës bashkëpunojnë me turqit e Kosovës, romët, ashkallitë dhe egjiptianët për çështje të ndryshme me rëndësi për komunitetet joshumicë. Gjithashtu, anëtarët boshnjakë të Kosovës dhe turq të Kosovës të kuvendit komunal kanë bashkëpunim të mirë dhe shpeshherë kanë qëndrime të përbashkëta për çështje me rëndësi për të dy komunitetet. Në Dragash/Dragaš, shoqëria civile është po ashtu e përfshirë në tryeza të rumbullakëta dhe nisma tjera, kudo që ato të organizohen.



Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit



Tabela 1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti boshnjak i Kosovës
Gjilan/ Gnjilane	Ferizaj/Uroševac	Qyteti i Ferizajt/Uroševac
Mitrovicë/Mitrovica	Leposavić/Leposaviq	Vračevo/Vraçevë, Rvatska/Hrvatska, Gornji Kaljin/Kalin i Epërm, Donji Kaljin/Kalin i Ulët, Berberište/Berberishtë, Vrba/Vërb
	Mitrovicë/Mitrovica	Mahalla e boshnjakëve, pjesa veriore e Mitrovicë/Mitrovica
Pejë/Peć	Deçan/Deçane	Prapaqan/Prapaçane, Rastavicë/Rastavica
	Gjakovë/ Đakovica	Qyteti i Gjakovës/Đakovica
	Istog/Istok	Dobruša/Dobrushë, Banjë/Banja, Lubovë/Ljubovo, Baicë/Banjica, Kashicë/Kašica, Gjurakoc/Đurakovac, Veriq/Verić, Kovragë/Kovrage, Lukavac i Begut/Begov Lukavac, Prigodë/Prigoda
	Pejë/Peć	Qyteti i Pejës/Peć, Vitomiricë/Vitomirica, Poçestë/Počešće, Raushiq/Raušić, Treboviq/Trebović, Ozdrim/Ozrim, Tërstenik/Trstenik, Novosellë/Novo Selo
Prishtinë/ Priština	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	Qyteti i Fushë Kosovës/Kosovo Polje
	Obiliq/Obilić	Qyteti i Obiliqit/Obilić, fshati Mazgit/Mazgit dhe Plemetin/Plemetina ¹
	Prishtinë/ Priština	Qyteti i Prishtinës/Priština
Prizren	Dragaš/Dragash	Qyteti i Dragashit/Dragaš, Rapqë /Rapča, Kërstec/Krstac, Lubovishtë/Ljubovište, Leshtan/Lještane, Radesh/Radeša, Kukjan/Kukaljane, Dikancë/Dikance, Baçkë/Baçka, Brod/Brod, Mlikë/Mlike, Vranishtë/Vranište, Gllloboçicë/Gllloboçica, Orqushë/Orçuša, Zlipotok/Zlipotok, Krushevë/Kruševo, Restelicë/Restelica
	Prizren	Qyteti i Prizrenit, Donje Ljubinjë/Lubinjë e Poshtme, Drajçici/Drajçiq, Gornje Ljubinjë/Lubinjë e Eperme, Gornje Selo/Gornjasellë, Grnçare/Grnçar, Jablanica/Jabllanicë, Lokvica/Lokvicë, Lubizhdë/Ljubižda, Manastirica/Manastiricë, Mušnikovo/Mušnikovë, Nebregoshtë/Nebregoshtë, Novo Selo/Novosellë, Planjane/Pllanjan, Pousko/Pouskë, Reçane/Reçan, Skorobishtë/Skorobishtë

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë²

Gjilan/ Gnjilane	Burimi	Numri gjithsej i popullsisë	Komuniteti	%
	Komuna Ferizaj/Uroševac			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 ³	81,372	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	113,668	1,475	1.3%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	160-170,000	68	0.0004%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	160-170,000	68	0.0004%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	160-170,000	68	0.0004%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	160-170,000	68	0.0004%

Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Leposavić/Leposaviq			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	16,906	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	16,395	770	4.7%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	19,000	561	2.9%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	15,000	500	3.3%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	18,600	240	1.3%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	18,000	300	1.6%
	Komuna Mitrovicë/Mitrovica			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	87,981	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	104,885	5,205	5%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	130,000	850 (veri) 45 (jug)	0.7%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	20,000 (veri) 110,000 (jug)	1,000 (veri) 470 (jug)	1.1%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	110,000 (jug) 20,000 (veri)	2,000-3,000 (veri + jug)	1.5-2.3%
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	130,000	1,500	1.1%	
Pejë/Peć	Komuna Dečan/Dečane			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	40,640	217	0.53%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	49,000	248	0.50%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	-	50	-
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	60,000	50	0.08%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	40,000	-	-
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	35,000	50	0.14%
	Komuna Gjakovë/Đakovica			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	-	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	150,000	30	0.02%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	-	-	-
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	-	-	-
	Komuna Istog/Istok			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	50,104	3,545	7.0%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	57,261	4,070	7.1%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	56,000-64,000	1,507	2.6-2.3%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	50,000	1,317	2.6%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	56,000	1,650	2.9%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	56,000	1,500-1,700	2.6-3.0%
	Komuna Pejë/Peć			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	111,071	8,739	7.83%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	127,796	9,875	7.72%
3. Vlerësimi aktual i komunës	-	-	-	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	150,000	2,900	1.93%	
5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	170,000	-	-	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	140,000	3,300	2.35%	
Pristinë/Priština	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	29,805	1,274	4.3%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	35,570	1,678	4.7%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	3,000	40	0.1%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	40,000	20	0.1%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	40,000	40	0.1%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	40,000	12	0.03%
	Komuna Obiliq/Obilić			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	26,595	294	1.1%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	31,627	347	1.1%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	32,000	70	0.2%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	30,000	50	0.2%
5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	32,000	70	0.2%	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	30,000	45	0.2%	

Prishtinë/Priština	Komuna Prishtinë/Priština			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	148,656	2,727	1.8%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	199,654	3,427	1.7%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	500,000	150	0.03%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	500,000	150	0.03%
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	500,000	150	0.03%
Prizren	Komuna Dragaš/Dragash			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	35,054	15,922	45.42%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	38,914	16,112	41.40%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	40,000	11,037	27.59%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	-	-	-
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	-	-	-
	Komuna Prizren			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	134,526	16,343	12.15%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	178,723	19,243	10.77%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	240,000	21,975	9.16%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profilet e Komunave, OSBE, 2009	-	-	-
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	-	-	-

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijë të moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijë që vijnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijë që nuk vijnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Moshë pune – të punësuar (16-65)	Moshë pune – të papunë (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë
Gjilan/ Gnjilane	Ferizaj/ Uroševac	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej							
		Gjithsej në rajon							
Mitrovicë/Mitrovica	Leposavić/ Leposaviq	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej							
	Mitrovicë/ Mitrovica (northern)	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej							
	Mitrovicë/ Mitrovica (southern)	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej							
		Gjithsej në rajon							
Komente: OSBE-ja nuk ka mundur t'i sigurojë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.									
Pejë/Peć	Deçan/ Dečane	Meshkuj		7		2	17		
		Femra		5		1	18		
		Gjithsej		12		3	36		
	Gjakovë/ Đakovica	Meshkuj		1		1	11		
		Femra		2		1	14		
		Gjithsej		3		2	25		
	Istog/Istok	Meshkuj		163		14	180		
		Femra		82		18	120		
		Gjithsej		245		32	300	80	
	Pejë/Peć	Meshkuj		281		4	514		
Femra			261			1,069			
Gjithsej			542		4	1,581			
	Gjithsej në rajon		802		41	1,942	80		

Prizren	Dragaš/ Dragash	Meshkuj				617		
		Femra				705		
		Gjithsej		185		1,322		
	Prizren	Meshkuj				1,879		
		Femra				1,772		
		Gjithsej		2,332		3,651		
		Gjithsej në rajon				4,973		
Komente: OSBE-ja nuk ka mundur t'i sigurojë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.								
Prishtinë/Prishtina	Fushë Kosovë /Kosovo Polje	Meshkuj		4		2		
		Femra	2	2		1	1	
		Gjithsej	2	6		3	1	
	Obiliq/ Obilić	Meshkuj		2		10	8	2
		Femra	2	1		9	9	2
		Gjithsej	2	3		19	17	4
	Prishtinë/ Prishtina	Meshkuj		24				
		Femra		22				
		Gjithsej		46		164		20
		Gjithsej në rajon	4	55		202	40	25
	Komente: OSBE-ja nuk ka mundur t'i sigurojë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.							

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë

Rajoni	Hisedarët kyçë të komunitetit	
Gjilan/Gnjilane	Komuna Ferizaj/Uroševac	
	1	
	2	Nadie Shuturak, zyrtare komunale për komunitete dhe përfaqësuese boshnjake
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Leposavić/Leposaviq	
	1	SDA Stranka Demokratske Akcije (Partia e Demokracisë në Veprim) GIZ Građanska Inicijativa Zajedno (Inicijativa qytetare për komunitete)
	2	Ismet Islamović, kryesues i komitetit për komunitete
	3	
	4	Boshnjakët e Kosovës kanë qasje në mediat serbe
	5	
	6	
	7	
	Komuna Mitrovicë/Mitrovica	
	1	SDA Stranka Demokratske Akcije (Partia e Demokracisë në Veprim)
	2	Hajrudin Pirović, Përfaqësues boshnjak i Administratës së OKB-së në Bordin këshillëdhënës në Mitrovicë/Mitrovica
	3	
	4	Shumica e boshnjakëve të Kosovës qasen në mediat serbe, ndonëse folësit e shqipes i qasen edhe mediave shqiptare.
	5	Nedžat Ugljanin, përfaqësues i komunitetit, banor i Mahallës së boshnjakëve por aktiv në tërë rajonin
	6	
7		

Pejë/Peć	Komuna Istog/Istok	
	1	Partia e Demokracisë në Veprim (Stranka Demokratske Akcije, SDA). Koalicija "VAKAT" (Koalicioni "VAKAT") i përbërë nga: Partia Demokratike e Boshnjakëve (Demokratska stranka Bošnjaka, DSB) nga Prizren; Partia Demokratike e Vatinit (Demokratska stranka Vatan DSV) nga Dragashi/Dragaš; dhe Partia Boshnjake e Kosovës (BSK) nga Pejë/Peć. Partia për Ndryshim Demokratik (Stranka Demokratskih Promena, SDP)
	2	Rasim Mahmutović, kryesues i zyrës komunale për komunitete Alam Destanović, VAKAT Đule Batilović, (SDA)
	3	
	4	
	5	Đule Batilović - Dobrushë/Dobruša – përfaqësues i fshatit Mirsad Babačić Banjë/Banja-përfaqësues i fshatit
	6	
	7	
	Komuna Pejë/Peć	
	1	Partia e Demokracisë në Veprim (Stranka Demokratske Akcije, SDA) Koalicija "VAKAT" (Koalicioni "VAKAT") Partia për Ndryshim Demokratik (Stranka Demokratskih Promena, SDP)
	2	Fahrudin Međedović, zëvendëskryesues i kuvendit komunal Sabahudin Ciriković, kryesues i zyrës komunale për komunitete Džafer Gutić, koordinator për çështje arsimore të komunitetit joshumicë
	3	OJQ "Đerdan" OJQ "Salen"
	4	Radiostacion lokal "Hayat" në Vitomiricë/Vitomirica
	5	
	6	Klub futbollit Klub atletike
	7	
	Komuna Deçan/Dečane	
	1	
	2	Šaban Pejčinović, kryesues i zyrës komunale për komunitete
	3	OJQ "Jeta" përqendrohet në çështje të grave dhe përfshin pjesëtarët e komunitetit boshnjak
	4	Radiostacioni lokal "Hayat" në Vitomirica/Vitomiricë ka mbulim në fshatin Prapaqan/Prapaćane, dhe Rastavicë/Rastavica
	5	
	6	
	7	
	Komuna Gjakovë/ Đakovica	
	1	Ifeta Jakupi, Partia Boshnjake e Demokracisë në Veprim e Kosovës (Bošnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova, BSDAK)
	2	Ifeta Jakupi, anëtare e komitetit për komunitete
	3	
4		
5		
6		
7		
Prizren	Komuna Dragash/Dragaš⁴	
	1	Koalicija "VAKAT" (Koalicioni "VAKAT") i përbërë nga: 1. Partia Demokratike e Boshnjakëve (Demokratska Stranka Bosnjaka, DSB) nga Prizreni; 2. Partia Demokratike e Vatinit (Demokratska Stranka Vatan, DSV) nga Dragashi/Dragaš; 3. Partia Boshnjake e Kosovës (BSK) nga Peja/Peć. Partia Demokracia e Re (Nova Demokratska Stranka, NDS); Partia e Demokracisë në Veprim (Stranka Demokratske Akcije, SDA).
	2	Institucionet e Kosovës (niveli qendror): • Usmen Baldži, Zëvendësministër i arsimit, shkencës dhe teknologjisë • Sadik Idrizi, Deputet i Kuvendit të Kosovës Institucionet e Kosovës (niveli lokal): • Časip Kuši, zëvendëskryetar i komunës për komunitete • Šerif Aga, zëvendëskryesues i kuvendit komunal për komunitete; • Nuhija Tahirovci, drejtor për bujqësi • Šefik Fejza, drejtor për kadastër, urbanizëm dhe planifikim • Mehmet Hamza, kryesues i zyrës komunale për komunitete;

2	<ul style="list-style-type: none"> • Uzair Hamza, zyra komunale për komunitete, zyrtar për të drejta të njeriut. • Zinaida Elmazi, deputete e kuvendit komunal.
3	<p>OJQ "Vatan", ndihmë humanitare, arsim, çështje gjinore; OJQ "Memljeçet", kulturë dhe arsim; OJQ "Qendra për shoqëri civile", zhvillimi i shoqërisë civile; OJQ "Renesansa", kulturë, zhvillim rinor; OJQ "Biser", kulturë; OJQ "Našinec", kulturë, arsim OJQ "Koritnik", kthim, integrim, të drejta të pakicave, avokim OJQ "Stars", gra</p>
4	<p>"Alem", Revista e pavarur në gjuhën boshnjake Radio "Sharri", radiostacion në gjuhën shqipe me disa orë program në gjuhën boshnjake; Radio "Gora", radiostacion komercial/informativ në boshnjakisht www.info-ks.net, revistë informative në internet www.prizren-web.com/magazin, revistë në internet mbi boshnjakët e Zhupës/Zhupë, Podgorës, Prizrenit dhe Gorës, Dragashit/Dragaš.</p>
5	
6	
7	OJQ-të aktive në Dragash/Dragaš pohojnë që përfaqësojnë njëllëj komunitetet e boshnjakëve dhe goranëve.
Komuna Prizren	
1	<p>Koalicija "VAKAT" (Koalicioni "VAKAT") Partia Demokracia e Re (Nova demokratska stranka, NDS); Partia e Demokracisë në Veprim (Stranka demokratske akcije, SDA); Partia Boshnjake e Demokracisë në Veprim e Kosovës (Bošnjačka Stranka Demokratske Akcije Kosova, BSDAK).</p>
2	<p>Institucionet e Kosovës (niveli qendror):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Džezair Murati, Deputet i Kuvendit të Kosovës • Špresa Murati, Deputet i Kuvendit të Kosovës • Čemailj Smailji, Zëvendësministër për punë dhe mirëqenie sociale • Raif Elezi, Zëvendësministër për administrim të pushtetit lokal • Bajram Ljatifi, këshilltar i Ministrisë të mjedisit dhe planifikimit hapësinor; • Čerim Bajrami, anëtar i këshillit konsultativ për komunitete <p>Institucionet e Kosovës (niveli lokal):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Almir Saiti, Drejtor për kulturë, rini dhe sport • Čemailj Kurtiši, deputet i kuvendit komunal • Emilija Redžepi, deputet i kuvendit komunal • Oruč Karadolami, deputet i kuvendit komunal • Ajredin Alija, kryesues i zyrës komunale për komunitete. • Aćif Džaferi, zyrtar komunal për komunitete • Igbalka Fazlija, zyrtar komunal për kthim • Almir Saiti, drejtor për kulturë, rini dhe sport
3	<p>OJQ "Equality", çështje të grave OJQ "Eduikator", organizatë e mësimdhënësve që realizon aktivitete në mbështetje të arsimit OJQ "Katedra slobodnog uma", që merret me hulumtime të opinionit publik Asociacioni i nismave bashkëkohore, rrjet i organizatave joqeveritare boshnjake Asociacioni "Šarski behar" aktivitete kulturore Asociacioni "Podgorski biseri" aktivitete kulturore OJQ "Këshilli i Kongresit të Intelektualëve Boshnjakë", arsim, kulturë, pjesëmarrje OJQ "Sofra", zhvillim ekonomik, kulturë, punësim, pjesëmarrje OJQ "OZON", mbrojtje të mjedisit</p>
4	<p>"Alem", Revistë e pavarur në gjuhën boshnjake Radio "Omega 3", Radiostacion komercial në gjuhën boshnjake (mbulon shumicën e qytetit të Prizrenit) Radio "Astra", Radiostacion komercial në gjuhën boshnjake (mbulon shumicën e Luginës së Zhupës) Radio "Yeni Donem", program njëorësh në gjuhën boshnjake çdo ditë TV "Balkan", televizion shumetnik që mbulon çështjet në Ballkan dhe transmeton në mbarë Ballkanin. www.info-ks.net, revistë informative në internet www.prizren-web.com/magazin, revistë në internet që mbulon boshnjakët në Župa/Zhupë, Podgorë, Prizren dhe Gorë, Dragash/Dragaš.</p>
5	<p>Emir Abazi, udhëheqës fshati në Rečane/Rečan Alen Azari, udhëheqës fshati në Planjane/Pllanjan Đeljilj Demiri, udhëheqës fshati në Jablanica/Jabllanicë Usen Arifi, udhëheqës fshati në Pousko/Pouskë Arif Fazliji, udhëheqës fshati në Nebregošte/Nebregosht Idaim Karadži, udhëheqës fshati në Manastirica/Manastiricë Batijar Mustafi, udhëheqës fshati në Lokvica/Llokvicë</p>

Prizren	5	Bersim Dani, udhëheqës fshati në Gornje Ljabinje/Lubinjë e Epermë Ramadan Karadolami, udhëheqës fshati në Donje Ljabinje/Lubinjë të Poshtme Zaim Dilji, udhëheqës fshati në Mušnikovo/Mushnikovë Bajro Bajrami, udhëheqës fshati në Gornje selo/Gornjasellë Feim Iljijazi, udhëheqës fshati në Drajčići/Drajqiçi Nijazim Pajaziti, udhëheqës fshati në Grnçare/Gërncar Tefidin Mamuti, udhëheqës fshati në Novo Selo/Novosellë Acif Džaferi, udhëheqës fshati në Lubizhdë/Ljubizda
	6	
	7	
Prishtinë/Priština	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje	
	1	
	2	
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	
	Komuna Obiliq/Obilić	
	1	
	2	Institucionet e Kosovës (niveli qendror): • Muamera Mačkić, Ministria për komunitete dhe kthim Institucionet e Kosovës (niveli lokal): • Lejla Bošnjak, inspektor komunal • Ajša Gusinjac, zyrtar komunal • Mersida Balic-Lima, zyrtar asistent, departamenti për emergjenca dhe shërbime publike
	3	OJQ "Delvina" çështje të grave
	4	
	5	
	6	
	7	
	Komuna Prishtinë/Priština	
1	SDA, Partia e Demokracisë në Veprim (Stranka Demokratske Akcije), Numan Balić kryesues i partisë me zyra qendrore në Vitomiricë/Vitomirica. BSDAK, Partia Boshnjake e Demokracisë në Veprim e Kosovës/ Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova, Hilmo Kantić, Kryesues i degës së partisë në Prishtinë/Priština.	
2	Shefki Zeqiri, anëtar i komitetit për komunitete; Jasmina Omeragić-Berisha, zyrtar për arsim, koordinator për shkollat boshnjake në komunën e Prishtinës/Priština; Rešadije Rexhepagic, Ministria për komunitete dhe kthim	
3		
4	RTK, transmetues publik, 5 minuta lajme çdo mbrëmje në ora 18:10, program televiziv njëorësh "Mostovi" të premtave në ora 17:15,	
5	SDA (Branch) – Partia e Demokracisë në Veprim/Stranka Demokratske Akcije - Numan Balić, kryesues i partisë me zyra qendrore në Vitomiricë/Vitomirica.. BSDAK – Bosniac Partia e Demokracisë në Veprim e Kosovës/Bosnjacka Stranka Demokratske Akcije Kosova - Hilmo Kantić, Kryesues i degës së partisë në Prishtinë/Priština	
6	Shefki Zeqiri, anëtar i komitetit për komunitete; Jasmina Omeragić-Berisha, zyrtar për arsim, koordinator për shkollat boshnjake në komunën e Prishtinës/Priština; Rešadije Rexhepagic, Ministria për komunitete dhe kthim	
7		

1 Një familje jeton në një ndërtesë të banimit social në Plemetin/Plemetina.

2 Të dhënat e popullsisë për pjesët 3, 4, 5 dhe 6 janë grumbulluar nga Ekipet e OSBE-së në Terren në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarë komunalë në mars-prill 2010.

3 Në tërë Shtojcën, të dhënat për regjistrimet e përgjithshme të popullsisë për vitet 1981 dhe 1991 paraqesin goranët dhe boshnjakët e Kosovës së bashku.

4 OSBE-ja nuk ishte në gjendje të sigurojë të dhëna të zberthyer për komunitetin boshnjak të Kosovës në këtë komunë (shih Historikun e boshnjakëve të Kosovës, faqe 1). Megjithatë, zyrtarët e listuar e kanë identifikuar veten si boshnjakë të Kosovës. Ata të gjithë kanë lidhje me koalicionin "VAKAT".





Profili i Komunitetit

KROATËT E KOSOVËS

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Historiku

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës janë sllavë katolik që besohet se janë pasardhës të tregtarëve nga Dubrovniku, të cilët kanë ardhur në Kosovë në shekullin e 14-të. Feja edhe Kisha Katolike vendase ka luajtur një rol të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit të veçantë të pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës. Disa mijëra kroatë kanë jetuar në Komunën e Vitisë/Vitina (rajonin e Gjilanit/Gnjilane) dhe në Lipjan/Lipljan (rajoni i Prishtinës/Priština). Tani ka mbetur vetëm një numër i vogël i tyre. Shpërngulja e pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës ka ndodhur gjatë viteve 1990 dhe si rezultat i drejtpërdrejt i konfliktit në vitin 1999. Shumë prej tyre janë larguar për shkak të pasigurisë në rritje dhe mungesës së mundësive ekonomike në Kosovë, dhe gjithashtu si reagim ndaj paketës së stimujve për rilokim të ofruar nga qeveria e Kroacisë. Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës banojnë në fshatrat Letnicë/Letnica, Shashar/Šašare, Vërnavokoll/Vrnavokolo dhe Vërnez/Vrnez në komunën e Vitisë/Vitina (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), ku përbëjnë rreth 0.05% të popullatës. Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës po ashtu jetojnë në fshatin Janjevë/Janjevo të komunës së Lipjanit/Lipljan (rajoni i Prishtinës/Priština), ku përbëjnë rreth 0,29% të popullatës së komunës.

Ata që jetojnë ende në Kosovë janë duke bërë të pamundurën për të ruajtur identitetin e tyre etnik dhe traditat. Për shembull, në Janjevë/Janjevo, mallrat prodhohen në dyqanet e vogla duke përdorur metodat tradicionale nga paraardhësit e tyre. Për momentin, papunësia kronike ka shtyrë rininë të shpërngulet, duke lënë prapa një komunitet kroat të moshuar që jeton kryesisht i marginalizuar nga shoqëria dhe i neglizhuar nga institucionet kosovare. Në fshatin Janjevë/Janjevo, mesatarisht dy deri në tri familje shpërngulen çdo vit: një trend që kërcënon mbijetesën afatgjate të këtij komuniteti në zvogëlim e sipër.



Që nga viti 2009, disa familje, përfshirë 20 njerëz të rinj, kanë lëshuar fshatin Janjevë/Janjevo të Komunës së Lipjanit/Lipljan për në Kroaci në kërkim të mundësive më të mira për punësim.

KOSOVO CROAT NEIGHBOURHOOD OF JANJEVË/JANJEVO IN THE LIPJAN/LIPLJAN MUNICIPALITY (PRISHTINË/PRIŠTINA REGION). THE TOWN WAS A PROSPEROUS SETTLEMENT IN THE MIDDLE AGES, BUT NOW ITS RESIDENTS ARE AFFECTED BY THE HIGH LEVEL OF UNEMPLOYMENT AND NEGLECTED INFRASTRUCTURE.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Niveli i lartë i papunësisë dhe varësia në ndihmë sociale;
- Sigurimi dhe qasja fizike në shërbime, posaçërisht për pjesëtarët më të moshuar të komunitetit;
- Niveli i lartë i shpërnguljes, posaçërisht i rinisë;
- Mungesa e përfaqësimit politik të komunitetit në nivel të Kosovës, me pjesëmarrje të kufizuar në nivel lokal;
- Mungesa reale apo e perceptuar e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes jashtë lagjeve të afërta;
- Vendet kulturore të neglizhuara.



MULLI TRADICIONAL NË LETNICË/
LETNICA TË KOMUNËS SË VITISË/VITINA
NË RAJONIN E GJILANIT/GNJILANE
KU PRONARI I TIJ KROAT I KOSOVËS
PRODHON MIELL GRURI DHE MISRI.

1 .Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Një familje kroate e Kosovës ka një restorant në Lletnicë/Letnica, që nganjëherë siguron ushqim pa pagesë për pjesëtarët e komunitetit kroat, në gjendje të rëndë sociale, dhe të cilët jetojnë pa ndonjë mbështetje nga autoritet vendore apo ndonjë organizatë apo institucion tjetër.

Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike e komunitet kroat të Kosovës mbetet e pasigurt. Në rajon e Gjilanit/Gnjilane, shumica dërrmuese e pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës janë pensionistë, që përfitojnë ndihmë nga fondet pensionale dhe/ose mirëqenia sociale e Kroacisë, Kosovës dhe Serbisë. Shumica prej tyre i plotësojnë pensionet me aktivitete bujqësore dhe mbarështimin e bagëtive. Për më tepër, asnjë pjesëtar i komunitetit kroat të Kosovës nuk është i punësuar në institucionet e Republikës së Serbisë në Komunën e Vitisë/Vitina. Nganjëherë, ata përfitojnë nga ndihma humanitare e siguruar nga organizatat ndërkombëtare dhe Kisha Katolike. Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në rajonin e Prishtinës/Priştina kanë mungesë akute të mundësive të punësimit. Shumë pak njerëz kanë gjetur vend pune në shkollën filllore në Janjevë/Janjevo, përfshirë shtatë mësues shkolle, katër prej së cilave janë femra. Tregtia me artikulje, artizanate dhe aktivitete e bujqësisë dhe blegtorisë janë burimet tjera të të ardhurave për pjesëtarët e komunitetit kroat. Shumë pjesëtarë të komunitetit kroat të Kosovës jetojnë në kushte jashtëzakonisht të rënda.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, ka ndodhur vetëm një incident i sigurisë që kishte si cak pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës ndërmjet janarit dhe qershorit 2010. Një mashkull shqiptar i Kosovës fizikisht sulmoi një pjesëtar të komunitetit kroat të Kosovës në fshatin Shashar/Šašare të komunës së Vitisë/Vitina. Sulmuesi ishte arrestuar. Në vitin 2009, pati disa raste të ngacmimit fizik dhe verbal nga shqiptarë etnik të shpërngulur nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, që kanë uzurpuar pronat e zbrazëta të pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës në fshatin Letnicë/Letnica. Megjithatë, meqenëse uzurpimi i pronave të pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës nuk është ndalur, situata në fshat mbetet e tensionuar. Rastet e ngacmimit, frikësimit dhe sulmeve kundër komunitetit, që janë paraqitur në polici, ishin hetuar dhe në disa raste autorët e këtyre veprave ishin arrestuar, gjykuar dhe dënuar. Mirëpo sipas një përfaqësuesi të komunitetit, shumë raste të tilla nuk janë paraqitur. Komuniteti ndërvepron me fqinjët e tyre shqiptarë të Kosovës, dhe pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në përgjithësi janë të lirë të lëvizin brenda fshatit të tyre dhe në qytetin e Vitisë/Vitina. Mungesa e transportit publik që lidh vendbanimet e largëta me qytetin mbetet një pengesë për lirinë e tyre të lëvizjes. Komuniteti nuk mund të flasë lirshëm gjuhën e tij amtare në publik, për shkak se ka pasur raste të paraqitura kur pronarët e dyqaneve dhe shitësit e tregut ose kanë rritur çmimet ose kanë insistuar të flitet në gjuhën shqipe pasi janë drejtuar nga pjesëtarët e komunitetit kroat. Asnjë pjesëtar i komunitetit kroat të Kosovës nuk është i punësuar në Shërbimin Policor të Kosovës në stacionin e Viti/Vitina. Përkundrazi, dy shqiptarë të Kosovës, që kanë dokumente civile kroate, janë punësuar në Policinë e Kosovës si pjesëtarë të komunitetit kroat. Komuniteti kroat i Kosovës nuk është i përfaqësuar në këshillat komunal për siguri në bashkësi, edhe pse një përfaqësues i komunitetit kroat të Kosovës rregullisht merr pjesë në takimet mujore të këshillit lokal për siguri në bashkësi.

Gjendja e sigurisë për komunitetin kroat të Kosovës në Janjevë/Janjevo, në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk ka pësuar ndonjë ndryshim thelbësor që nga viti 2009. Rastet e vjedhjes të shtëpive të zbrazëta të pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës janë të

Katër zyrtarë policorë, dy femra dhe dy meshkuj, nga komuniteti kroat i Kosovës janë zbarkuar në tërë Kosovën.

Komiteti lokal për siguri publike është mbledhur më 3 qershor 2010 në fshatin Vrbovac/Vërboc, ku përfaqësuesit e komunitetit kroat të Kosovës nga Letnica/Letnica kanë ngritur çështjen e uzurpimit të pronave të pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës nga shqiptarët etnik, refugjatë nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë.



NJË KROAT I MOSHUAR I KOSOVËS QË KISHTE SHKUAR NË KROACI NË VITET E '90-TA NË KËRKIM TË PUNËSIMIT DHE U KTHYE NË LETNICË/LETNICA TË KOMUNËS SË VITISË/VITINA NË RAJONIN E GJILANIT/GNJILANE NË VITIN 2003. NDONËSE SHTËPIA E TIJ ËSHTË RINDËRTUAR, ASISTENCA SOCIALE MBETET I VETMI BURIM I TIJ I TË ARDHURAVE.

shpeshta dhe në shumicën e rasteve kryerësit e veprave nuk janë kapur. Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës kanë marrëdhënie të mira fqinjësore me komunitetin shqiptar, romë dhe turk të Kosovës që banojnë në fshat dhe ata lirshëm përdorin gjuhën e tyre në publik. Asnjë zyrtar policie i komunitetit kroat të Kosovës nuk punon në nënstacionin policor në in Janjevë/Janjevo por nënstacioni ka një përbërje shumetnike, përfshirë këtu edhe shtatë serbë të Kosovës. Këshilli lokal për siguri në bashkësi në Janjevë/Janjevo ka në përbërje komunitete të ndryshme, përfshirë edhe një pjesëtar të komunitetit kroat të Kosovës. Komuniteti kroat i Kosovës përfaqësohet në këshillin komunal për siguri në bashkësi të Lipjanit/Lipljan.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Shumë pjesëtarë të komunitetit kroat, që kanë lëshuar Kosovën gjatë viteve 1990 dhe gjatë konfliktit të vitit 1999, kanë vendosur për tu rivendosur apo për tu riintegruar në Kroaci, dhe kanë shumë pak vullnet për tu kthyer.

Shumë pjesëtarë të komunitetit kroat të Kosovës kanë lëshuar Kosovën si reagim ndaj paketës së stimuljeve të qeverisë së Kroacisë dhe kanë ikur për shkak të pasigurisë në rritje në Kosovë gjatë viteve 1990. Në komunën e Vitisë/Vitina, një numër i madh i pronave të pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës, përfshirë edhe tokën bujqësore, mbeten të uzurpuara nga shqiptarët e Kosovës dhe shqiptarët etnik nga ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Në përgjithësi, ka pasur më shumë largime se sa kthime. Për shembull, nuk është regjistruar asnjë kthim i pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës në Janjevë/Janjevo (komuna e Lipjanit/Lipljan, rajoni i Prishtinës/Priština) apo në Lletnicë/Letnica dhe në fshatrat e tjera të banuara me pjesëtarë të komunitetit kroat të Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina (rajoni i Gjilanit/Gnjilane). Prej 4,331 pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina, të regjistruar në regjistrimin e popullsisë më 1991, vetëm 40 kanë mbetur në vitin 2010. Në komunën e Lipjanit/Lipljan, përfaqësuesi i komunitetit kroat të Kosovës, i cili banon në Janjevë/Janjevo, ka paraqitur një listë të kthyerve potencial në grupin punues komunal për kthim në fund të prillit 2010. Prosesi i identifikimit të familjeve, që gëzojnë të drejtën e përfitimit të ndihmës, është duke vazhduar dhe është duke u zbatuar bashkërisht ndërmjet zyrtarit komunal për kthim dhe UNHCR.

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës vazhdojnë të përdorin strukturat shëndetësore dhe arsimore, të financuara nga Republika e Serbisë. Shërbimi shëndetësor pa pagesë, i siguruar nga këto institucione, vazhdon të jetë një stimul i fortë për pjesëtarët e cënueshëm të komunitetit kroat të Kosovës për të zgjedhur strukturat e financuara nga Republika e Serbisë në vend të sistemit të Kosovës. Në komunën e Vitisë/Vitina, (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), katër fshatra të banuara me pjesëtarë të komunitetit kroat të Kosovës shfrytëzojnë qendrën mjekësore të menaxhuar nga Republika e Serbisë në Lletnicë/Letnica, qendrat mjekësore në komunën fqinje të porsaformuar të Klokot-Vrbovac/Kllokotit-Vërboc, dhe spitalet në Gračanica/Graçanicë dhe Beograd. Femrat dhe meshkujt e komunitetit përfitojnë barabartë nga shërbimet mjekësore të financuara nga Republika e Serbisë. Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në Janjevë/Janjevo, në Prishtinë/Priština,

përdorin shërbimet mjekësore dhe arsimore të mbështetura nga Serbia. Shtatë mësues (dy janë punësuar në shtator 2009) të komunitetit kroat të Kosovës janë punësuar në shkollën fillore në Janjevë/Janjevo dhe ata financohen nga strukturat e Republikës së Serbisë. Asnjë pjesëtar i komunitetit kroat të Kosovës nuk punon në strukturat shëndetësore të financuara nga Republika e Serbisë. Disa pjesëtarë të moshuar të komunitetit kroat të Kosovës marrin pensione nga Republika e Serbisë.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Qasja fizike në shërbimet komunale vazhdon të jetë një sfidë për pjesëtarët e moshuar të komunitetit kroat të Kosovës, që jetojnë në zonat e largëta të Gjilanit/Gnjilane, (komuna e Vitisë/Vitina). Mungesa e transportit publik vazhdon të pengojë lëvizshmërinë dhe si pasojë qasjen në shërbimet komunale. Megjithatë, komuniteti përdor taksitë që janë financiarisht të përballueshëm për të shkuar deri në qytet. Komuniteti nuk ka pasur ndonjë problem të madh me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK) për furnizim me energji elektrike, meqenëse shumica gëzojnë të drejtën e ndihmës nga Qendra për Mirëqenie Sociale për t'i paguar faturat e tyre. Sistemi i ujësjellësit në fshatin Lletnicë/Letnica nuk mirëmbahet mirë dhe uji nuk është i pijshëm. Në fshatin Janjevë/Janjevo, rajoni i Prishtinës/Priština, sigurimi i shërbimeve publike, siç është mbledhja e mbeturinave dhe furnizimi me ujë, është i dobët për të gjitha komunitetet që jetojnë në fshat. Gjatë verës së vitit 2009, banorët janë përballur me reduktime të mëdha të ujit për shkak të mungesës së mirëmbajtjes së pompave të ujit. Gjithashtu, gjatë viteve 2009 dhe 2010, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës kishin vuajtur nga ndërprerjet e energjisë elektrike për shkak të mospagimit të faturave. Kjo çështje është zgjidhur në mars të vitit 2010, kur komuniteti, nëpërmjet udhëheqësit fetar, ka mbledhur paratë për të mbuluar shumën e faturës së fundit për energji elektrike dhe 10 përqind të borxheve të mëhershme, siç edhe ishte kërkuar nga KEK-u.

6. Qasja në shërbime të mirëqenies sociale

Pengesa kryesore për shumicën e popullsisë së moshuar të komunitetit kroat të Kosovës që ka të bëjë me qasjen në ndihma sociale vazhdon të jetë lëvizshmëria fizike, që pengon qasjen në shërbimet sociale. Në komunën e Vitisë/Vitina, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës gëzojnë qasje në pensionet mujore dhe ndihmën e mirëqenies sociale. Pjesëtarëve më të cënueshëm të këtij komuniteti u duhet përkujdesja në shtëpi, dhe meqenëse komuniteti përbëhet nga pjesëtarë të moshuar, nevoja për shërbime sociale vetëm sa do të rritet. Në Janjevë/Janjevo, disa autobusë që qarkullojnë gjatë një dite lidhin fshatrat me qytetin e Lipjanit/Lipljan, megjithatë lëvizshmëria e kufizuar fizike e personave të moshuar kufizon qasjen e tyre në shërbimet e mirëqenies sociale. Prifti vendas zakonisht siguron transportin për pjesëtarët e moshuar të komunitetit kroat të Kosovës për në qytetin e Lipjanit/Lipljan. Komuniteti kryesisht mbështetet në ndihmën financiare të siguruar nga Republika e Serbisë apo nga institucionet e Kosovës.

7. Qasja në pronë dhe banim

Në Janjevë/Janjevo janë rreth 700 shtëpi që u takojnë pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës. Përafërsisht 300 janë të banuara, 50 nga pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës dhe të tjerat nga shqiptarët e Kosovës, të cilët kanë arritur marrëveshje me pronarët e ligjshëm të zhvendosur.

Nuk ka pasur ndonjë ndryshim në gjendjen që nga viti 2009, duke qenë se pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në rajonin e Prishtinës/Priština vazhdojnë të gëzojnë qasje në pronë dhe banim ndërsa bashkëkombësit e tyre në Gjilan/Gnjilane ende ballafaqohen me vështirësi në kthimin e shtëpive të tyre, që janë uzurpuar në mënyrë joligjore. Në Janjevë/Janjevo (komuna e Lipjanit/Lipljan) janë rreth 700 shtëpi që u takojnë pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës, prej të cilave 300 janë të banuara, përafërsisht 50 shtëpi banohen nga pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës dhe të tjerat nga shqiptarët e Kosovës. Në disa raste, banorët shqiptarët të Kosovës kanë negociuar marrëveshje me pronarët kroatë të zhvendosur. Në fshatrat Lletnicë/Letnica, Shashar/Šašare, Vërnavokollë/Vrnavokolo dhe Vërnez/Vrnez (komuna e Vitisë/Vitina) përrreth 800 prona janë lënë të zbrazëta nga pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Vetëm 56 janë duke u administruar nga Agjencia Kosovare e Pronës ndërsa të tjerat janë duke u përdorur (toka bujqësore) apo uzurpuar (shtëpitë) në mënyrë të paligjshme. Disa shtëpi që janë të pabanueshme mbeten të zbrazëta. Disa nga uzurpuesit e paligjshëm janë shqiptarë të Kosovës, por shumica janë shqiptarë etnik që kanë ikur nga konflikti i vitit 2001 në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Ata janë vendosur në shtëpitë që u takojnë pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina dhe kanë filluar të shfrytëzojnë tokën e tyre bujqësore. Që nga ajo kohë, janë raportuar incidente të shpeshta të sigurisë që kanë ndodhur ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës dhe uzurpuesve të paligjshëm. Përkundër një fushate informimi nga Agjencia Kosovare e Pronës në Kroaci, për të inkurajuar pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës për të kërkuar të drejtën e pronës, komuniteti ka dështuar të përgjigjet. Përfaqësuesit e komunitetit kroat të Kosovës pohojnë që shumë pjesëtarë ose nuk janë të interesuar për tu kthyer, ose frikësohen që prona e tyre do të shkatërrohet nëse uzurpuesit e paligjshëm detyrohen të lëshojnë shtëpitë.

8. Qasja në arsim

Ata pak fëmijë të komunitetit kroat të Kosovës të moshës së shkollimit, që kanë mbetur në Kosovë, ndjekin sistemin arsimor të financuar nga Republika e Serbisë.

Nxënësit e shkollës fillore në Janjevë/Janjevo (rajoni i Prishtinës/Priština), në përgjithësi 24 djem dhe 26 vajza, ndjekin programin arsimor të Republikës së Serbisë në shkollën fillore shumetnike “Shtjefën Gjeqovi”, së bashku me nxënësit Romë dhe Boshnjakë të Kosovës. Ndër shtatë mësuesit kroatë të Kosovës janë edhe katër femra, që ligjërojnë së bashku me punonjësit serbë të Kosovës. Ndër të tjera lëndë, ata mbajnë tri orë në gjuhën kroate gjatë javës. Nxënësit kroatë në shkollën e mesme ndjekin programin arsimor të Republikës së Serbisë në komunën e Gračanica/Graçanicës, dhe në fshatrat Donja Gušterica/Guštericë e Ulët dhe Laplje Selo/Lapllasellë (Gračanica/Graçanicë). Tani për tani nuk ka asnjë fëmijë të moshës së shkollimit në komunën e Vitisë/Vitina, (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), ndërsa fëmiju i fundit i moshës së shkollimit në komunë ka shkuar në shkollën e financuar nga Republika e Serbisë në fshatin Vrbovac/Vërbovc. Universiteti në Mitrovicë ofron mësimdhënie në gjuhën Serbe për studentët kroatë, një prej së cilëve ndjek ligjëratat me bursën e siguruar nga komuna e Lipjanit/Lipljan.



NXËNËSIT KROATË TË KOSOVËS LUAJNË PINGPONG NË NJË TAVOLINË TË IMPROVIZUAR GJATË ORËS SË EDUKATËS FIZIKE NË JANJEVË/JANJEVO NË KOMUNËN E LIPJANIT/LIPLJAN (NË RAJONIN E PRISHTINËS/PRIŠTINA). NXËNËSIT KROATË TË KOSOVËS, BASHKË ME ATA ROMË DHE BOSHNJAKË TË KOSOVËS, E VIJOJNË MËSIMIN SIPAS KURRIKULËS SË REPUBLIKËS SË SERBISË NË NJË OBJEKT SHKOLLOR QË E NDAJNË ME NXËNËSIT SHQIPTARË TË KOSOVËS DHE TURQ TË KOSOVËS, TË CILËT ARSIMOHEN SIPAS KURRIKULËS SË KOSOVËS.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane kanë qasje në shërbimet shëndetësore, edhe pse një gjë e tillë pengohet nga lëvizshmëria e kufizuar e komunitetit të moshuar. Në komunën e Vitisë/Vitina, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës kryesisht shfrytëzojnë institucionet e financuara nga Republika e Serbisë për qasje në shërbimet shëndetësore. Në rast të kujdesit themelor shëndetësor, ata i drejtohen klinikës mjekësore në Lletnicë/Letnica, që funksionin sipas sistemit të Kosovës. Klinika më afërt mjekësore, e financuar nga Republika e Serbisë, gjendet në komunën fqinje të porsaformuar Klokot-Vrbovac/Kllokot-Vërboc. Për intervenime më të rënda mjekësore, ata shfrytëzojnë spitalet në Gračanica/Graçanicë dhe Prishtinë/Priština, dhe nëse është e domosdoshme, edhe atë në Beograd. Komuniteti, femrat dhe meshkujt, kanë sigurim shëndetësor dhe janë të kënaqur me cilësinë e kujdesit mjekësor të ofruar. Në rajonin e Prishtinës/Priština, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës vazhdojnë të përdorin shërbimet dhe qendrat mjekësore, që mbështeten nga Republika e Serbisë. Në hapësirat e farmacisë ngjitur me Kishën Katolike në Janjevë/Janjevo, së paku një herë në javë një mjek serb i Kosovës ofron ndihmë mjekësore pa pagesë për pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës. Sa i përket kujdesit mjekësor dytësor, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës përdorin shërbimet e mbështetura nga Republika e Serbisë, përfshirë këtu qendrat dhe spitalet në fshatrat Donja Gušterica/Gushtericë e Ulët, Gračanica/Graçanicë dhe Laplje Selo/Lapllasellë.

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në Janjevë/Janjevo ende përfitojnë nga kujdesi mjekësor, i siguruar nga Kisha Katolike.

10. Qasja në drejtësi

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës kanë qasje në gjykata dhe shërbimet juridike, edhe pse transportimi i personave të moshuar në gjykata paraqet një sfidë. Në Gjilan/Gnjilane, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës shfrytëzojnë shërbimet e avokatëve shqiptarë të Kosovës dhe gëzojnë qasje në Gjykatën Komunale në Viti/Vitina apo në Gjykatën e Qarkut në Gjilan/Gnjilane. Në Prishtinë/Priština, pjesëtarët

e komunitetit kroat të Kosovës kanë qasje në Gjykatën Komunale në Lipjan/Lipljan. Ekipi për Komunitete nuk është në dijeni të ndonjë rasti të paraqitur nga pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës në Gjykatën Komunale të Lipjanit.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Përfaqësimi dhe pjesëmarrja efektive në jetën publike e pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës mbetet e dobët, kryesisht për shkak numrit të vogël të tyre. Komuniteti nuk përfaqësohet në organet komunale ekzekutive dhe legjislativë ose në shërbimin civil të rajonit të Gjilanit/Gnjilane. Në Viti/Vitina janë ndërprerë, gjatë muajve janar dhe shkurt të vitit 2009, kontratat e vetëm dy shërbyesve civil kroatë të Kosovës që ishin të punësuar në administratën komunale. Në komunën Lipjanit/Lipljan (rajoni i Prishtinës/Priština) nuk është emëruar asnjë pjesëtar i komunitetit kroat të Kosovës në degën ekzekutive. Komuniteti përfaqësohet në këshillin komunal për siguri në bashkësi, edhe pse përfaqësuesi i komunitetit kroat të Kosovës shpesh herë nuk mund të marr pjesë mbledhjet e këshillit për shkak të mungesës së transportit. Deri në zgjedhjet komunale, që janë mbajtur në nëntor të vitit 2009, një grua kroate e Kosovës ka marrë pjesë në mbledhjet e komisionit për komunitetet. Edhe pse është rezervuar një vend për komunitetin, për momentin, ende nuk është emëruar një përfaqësues i komunitetit kroat të Kosovës. Ndërsa as komuna nuk është përfshirë në ndonjë aktivitet informimi për komunitetin, për të nxitur pjesëmarrjen e tyre në çështjet publike dhe për të tejkaluar izolimin e këtij komuniteti të vogël, të cenueshëm dhe të moshuar. Për më shumë, nuk ekziston ndonjë medie e shkruar apo transmetuese, qoftë publike apo private, në gjuhën kroate.

12. Përdorimi i gjuhës

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës lirshëm flasin gjuhën e tyre amtare në hapësirat publike e të dy komunave ku ata banojnë. Komuniteti përdor gjuhën zyrtare Serbe kur i drejtohen autoriteteve

KISHA KATOLIKE NË LETNICË/LETNICA
TË KOMUNËS SË VITISË/VITINA NË
RAJONIN E GJILANIT/GNJILANE DHE
DY KROATE TË KOSOVËS ME VESHJE
TRADICIONALE.



publike, dhe prandaj në disa raste hasin në vështirësi në lidhje me mungesën e përkthimit të duhur në të dy komunat ku komuniteti banon. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës, me banim në komunën e Vitisë/Vitina, në përgjithësi përdorin lirshëm gjuhën e tyre amtare në publik. Megjithatë, ekziston një frikë e perceptuar që ka të bëjë me hapësira të caktuara publike, ku komuniteti heziton të flasë haptazi në gjuhën kroate. Prandaj ata përzgjedhin dyqanet dhe kafenetë në të cilat shkojnë. Po ashtu, ka pasur raste kur komunikimi zyrtar nga komuna për pjesëtarët e komunitetit kroat është bërë vetëm në gjuhën shqipe. Sipas kërkesës, komuna ka lëshuar dokumentin e njëjtë në gjuhën serbe. Në rajonin e Prishtinës/Priština, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës, me banim në komunën e Lipjanit/Lipljane, nuk kanë hasur në probleme gjatë përdorimit të gjuhës së tyre amtare në publik apo gjatë ndërveprimit të tyre me autoritetet komunale.

Në përgjithësi, pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës përdorin lirshëm gjuhën e tyre amtare në shumicën e hapësirave publike. Megjithatë, komuniteti nuk ndihet plotësisht i lirë për të përdorur gjuhën amtare në të gjitha hapësirat publike.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës gëzojnë qasje në vendet fetare dhe të trashëgimisë kulturore dhe festojnë festat e tyre kulturore dhe fetare brenda vendbanimeve ku ata jetojnë. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, trashëgimia kulturore e pjesëtarëve të komunitetit kroat të Kosovës përfaqësohet nëpërmjet fesë së tyre, të cilën ata e ndajnë me komunitetin shqiptarë katolik të Kosovës. Pjesëtarët e komunitetit kroat të Kosovës Viti/Vitina marrin pjesë rregullisht në shërbesat Katolike në kishat e fshatrave Lletnicë/Letnica dhe Vrnakovolo/Vërnakovollë. Fshati Lletnicë/Letnica njihet për një festë fetare që mbahet më 15 gusht, ngritjen e Shën Mërisë, kur shumë katolikë por edhe të Krishterë Ortodoks dhe Myslimanë, nisen për pelegrinazh për të nderuar statujën e Zonjës së Zezë, që zbukuron Kishën në Letnicë/Letnica. Në rajonin e Prishtinës/Priština, objekti kryesor fetar është Kisha e Shën Nikollës në Janjevë/Janjevo. Komuniteti feston edhe festën fetare të “festës verore të Shën Nikollës” më 9 maj.



PAMJE E QYTETIT PIKTORESK TË JANJEVËS/JANJEVO NË KOMUNËN E LIPJANIT/LIPLJAN (NË RAJONIN E PRISHTINËS/PRIŠTINA), KU KROATËT E KOSOVËS KANË JETUAR TRADICIONALISHT NË HARMONI ME SHQIPTARËT E KOSOVËS, TURQIT E KOSOVËS, BOSHNJAKËT E KOSOVËS DHE ROMËT.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Në komunën e Vitisë/Vitina në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, dialogu zyrtar ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit kroat dhe atij shqiptar është i rrallë edhe pse ka marrëdhënie të mira personale ndërmjet fqinjëve të të dy komuniteteve. Deri më sot, nuk është mbajtur ndonjë forum i veçantë për marrëdhëniet ndërmjet komunitetit kroat dhe shqiptar. Megjithatë, përfaqësuesit e komunitetit kroat të Kosovës ndonjëherë marrin pjesë në forumet e dialogut të kryesuara nga serbët e Kosovë në fshatin Vërboc/Vrbovac. Në Janjevë/Janjevo (rajon i Prishtinës/Priština) marrëdhëniet ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit kroat dhe komuniteteve tjera janë të mira. Një pjesëtar i komunitetit kroat të Kosovës përfaqëson komunitetin dhe angazhohet në forumet formale të dialogut, siç janë komisioni lokal për siguri publike dhe këshilli komunal për siguri në bashkësi.

Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit

Tabela 1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti kroat i Kosovës
Gjilan/ Gnjilane	Viti/ Vitina	Viti/Vitina; fshatrat Lletnicë/Letnica, Shasarë/Šasare, Vërnavokollë/Vrnavokolo dhe Vërnez/Vrnez
Pristinë/ Pristina	Lipjan/ Lipljan	Janjevë/Janjevo village

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë¹

Rajoni	Burimi	Numri gjithsej i popullsisë	Komuniteti	%
Gjilan/ Gnjilane	Komuna Viti/Vitina			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	57,290	4,331	7.600 %
	3. Vlerësimet aktuale komunale	60,000	40	0.066 %
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	60,000	50	0.083 %
	5. Vlerësimet e Profilit Komunal të OSBE-së më 2009	59,000	60	0.010 %
6. Vlerësimet aktuale të Ekipeve të Terrenit të OSBE-së	60,000	40	0.050 %	
Pristinë/ Pristina	Komuna Lipjan/Lipljan			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	55,705	3,676	6.4%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991 ²	69,451	2,914	4.19 %
	3. Vlerësimet aktuale komunale	76,000	300	0.39%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	76,000	300	0.39%
	5. Vlerësimet e Profilit Komunal të OSBE-së më 2009	76,000	219	0.47%
6. Vlerësimet aktuale të Ekipeve të Terrenit të OSBE-së	76,000	219	0.47%	

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijët e moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijët që ndjekin arsimimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijët që nuk ndjekin arsimimin e obligueshëm (6-15)	Grup moshës e të punësuarve (16-65)	Grup-moshës e të papunësuarve (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë
Gjilan/ Gnjilane	Viti/Vitina	Meshkuj	0	0	0	0	3	15	
		Femra	0	0	0	0	2	20	
		Totali	0	0	0	0	5	35	
	Totali në rajon	50					5	35	
Pristinë/ Pristina	Lipjan/Lipljan	Meshkuj	8	24	0	8	38	18	
		Femra	13	26	0	8	53	23	
		Totali	21	50	0	16	91	41	
	Totali në rajon	219							
	Komente	Burimet përfshijnë përfaqësuesit e komunitetit dhe drejtorin kroat të shkollës fillore në fshatin Janjevë/Janjevo (komuna e Lipjanit/Lipljan).							

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë

Rajoni	Hisedarët kyçë të komunitetit	
Gjilan/Gnjilane	Komuna Viti/Vitina	
	1	LDK (Lidhja Demokratike e Kosovës) ³
	2	
	3	
	4	
	5	Froka Dokić, përfaqësues i komunitetit i zgjedhur nga shumica e pjesëtarëve të komunitetit kroat që jeton në këtë rajon
	6	
	7	
Pristinë/Priština	Komuna Lipjan/Lipljan	
	1	
	2	
	3	
	4	
	5	Don Mateo Palić, prift vendas, udhëheqës shpirtëror i komunitetit; Ivan Lovrić, drejtor i qendrës për komunitete
	6	
	7	Komente: Pjesëtarët e komunitetit kroat informuan OSBE-ën që OJQ-ja “Qendra Rinore” në Janjevë/Janjevo nuk është më aktive.

1 Të dhënat për popullsinë në pikat 3, 4, 5, dhe 6 janë mbledhur nga ekipet fushore të OSBE-së në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarët komunalë gjatë muajve mars-prill 2010.

2 Të dhënat e mbledhura në regjistrimin e popullsisë të vitit 1991 kundërshtohet, për shkak se ishte bojkotuar nga disa segmente të popullsisë.

3 Një pjesëtar i komunitetit kroat të Kosovës, nga LDK-ja dhe ish anëtar i kuvendit komunal, pretendon që përfaqëson politikisht komunitetin kroat të Kosovës.



Profili i komunitetit EGJIPTIAN

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Mohimi i përgjegjesisë

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e identifikojnë veten si persona që u takojnë tri komuniteteve të veçanta dhe pranohen si të tillë nga korniza ligjore e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë e njëj plotësisht ekzistencën e tri komuniteteve të veçanta dhe në këtë publikim ka synuar t'i theksojë përvojat dhe karakteristikat e veçanta të tyre. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme të zberthyer për këto komunitete në disa komuna, disa pjesë të Aneksit për këtë profil përmbajnë shifrat që paraqesin së bashku komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Historiku

Komuniteti egjiptian është në mesin e atyre që jetojnë tradicionalisht në Kosovë. Në fillim të viteve '70, komuniteti filloi ta deklarojë identitetin e vet si egjiptian, duke pohuar prejardhje nga Egjipti i Lashtë dhe nisi fushatën për t'u përpjekur për ta siguruar një kategori të ndarë për "Egipjkani" (egjiptianët) në regjistrimin e popullsisë në Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë. Komuniteti e identifikon gjuhën shqipe si amtare dhe kryesisht është i besimit islam. Gjatë konfliktit të vitit 1999, shumë nga ta u zhvendosën nëpër rajon dhe në Evropën Perëndimore. Ka shumë pak shembuj të projekteve për kthim të organizuar të dedikuara për këtë komunitet. Në disa raste, autoritetet kanë dështuar në promovimin dhe mbrojtjen e së drejtës për kthim të komunitetit egjiptian. Rastet e vendbanimeve joforMeshkuj Kristal dhe Rudesh/Rudeš i tregojnë më së miri vështirësitë me të cilat përballlet ky komunitet.¹

Egjiptianët e festojnë Ditën e egjiptianëve në Ballkan më 24 qershor.

Shumica e egjiptianëve jetojnë në pjesën perëndimore të Kosovës, në veçanti në rajonin e Pejës/Peć, në komunën e Deçanit/Dečani (ku përbëjnë përafërsisht 0.57% të popullsisë së komunës), Istogut/Istok (3.28%), Klinës/Klina (2.36%) dhe Gjakovës/Đakovica, ku rreth 700 egjiptianë jetojnë në vendbanimin joformal "Kolonja". Egjiptianët gjithashtu jetojnë në komunitat e Fushë Kosovës/Kosovo Polje (përafërsisht 0.3%) dhe Obiliqit/Obilić (0.2%) në rajonin e Prishtinës/Priština. Në rajonin e Prizrenit, të dhënat e zberthyer për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian nuk janë gjithmonë në dispozicion.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Egjiptianët janë një nga komunitetet më të cenueshme në Kosovë me një numër relativisht të madh të atyre që përballen me varfëri të skajshme. Femrat janë një nga grupet në pozitë më të pafavorshme në Kosovë.
- Mbrojtja e pamjaftueshme e së drejtës për pronë rezulton me numër të vogël të të kthyerve;
- Niveli i ulët i arsimimit në mesin e egjiptianëve, posaçërisht te femrat;
- Niveli i lartë i papunësisë dhe mungesa e përhapur e aftësive tjera në mesin e komunitetit e pengojnë qasjen në tregjet forMeshkuj të punës.

¹ Për më shumë hollësi, shih pjesën Qasja në pronë dhe banim

1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Gratë egjiptiane janë pothuajse plotësisht të angazhuar në tregun jozyrtar të punës, përkatësisht mbledhin materiale që riciklohen, pastrojnë apo kërkojnë lëmoshë. Në të njëjtën kohë, ato kryejnë punë amvisërie dhe kujdesen për fëmijët.

Komuniteti egjiptian mbetet një nga komunitetet më të cenueshme në Kosovë. Niveli i papunësisë vazhdon të jetë shumë i lartë dhe mundësitë për të konkurruar në tregun e punës janë të pakta. Komuniteti vazhdon të mbështetet në ndihmë sociale, kontribute nga të afërmit që jetojnë jashtë vendit dhe donacione nga agjencitë e ndihmës. Mungesa e përhapur e arsimimit formal ose profesional kontribuon në normën e lartë të papunësisë në mesin e egjiptianëve. Shumë fëmijë egjiptian nuk e ndjekin arsimin e mesëm ose të lartë. Edhe pse një numër i egjiptianëve janë të punësuar në sektorin publik, që ua mundëson të kenë të ardhura mujore, punët sezonale bujqësore dhe aktivitetet e vetë-punësimit janë ende format kryesore të punësimit për këtë komunitet. Në rajonin e Pejës/Peć, komunitat e Gjakovës/Đakovica, Istogut/Istok, dhe Klinës/Klina i kanë gjithsej tetë egjiptian të punësuar në zyrat komunale për komunitete. Një numër i panjohur i grave egjiptiane ofron shërbime pastrimi në ndërtesat komunale dhe institucionet tjera vendore. Pesë egjiptianë punojnë si mësimsdhënës në Gjakovë/Đakovica dhe Klinë/Klina; dy mjekë egjiptianë shërbejnë në qendrën kryesore të mjekësisë familjare në Gjakovë/Đakovica; dhe një egjiptian punon në spitalin e Klinës/Klina. Disa egjiptianë janë të punësuar në kompanitë e grumbullimit të mbeturinave në Gjakovë/Đakovica dhe Istog/Istok. Dy egjiptianë janë policë, një është doganier, një punon në burgun e Dubravës dhe një në Gjykatën komunale në Klinë/Klina. Të tjerët janë të punësuar në shitore të rrobave, punojnë si farkëtarë ose kanë ferma të vogla. Megjithatë, burimet më të rëndësishme të të ardhurave mbesin ndihmat sociale, punët e rastit në bujqësi dhe ndërtimtari, dërgesat nga diaspora dhe donacionet e kohëpaskohshme nga Kryqi i Kuq i Kosovës dhe KFOR-i.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, niveli i papunësisë i komunitetit egjiptian është i lartë. Në rajon nuk ka egjiptian të punësuar si shërbyes civil. Vetëm një është i punësuar në një shkollë fillore në Obiliq/Obilić për të kryer punë riparimi dhe mirëmbajtjeje. Mirëpo, një

EGJIPTIANËT NGA VENDBANIMI JOFORMAL "KOLONIA" NË KOMUNËN E GJAKOVËS/ĐAKOVICA (NË RAJONIN E PEJËS/PEĆ) DJEGIN GOMA PËR TA MARRË METALIN, NJË BURIM I SHPESHTË I TË ARDHURAVE PËR KOMUNITETIN.



numër në rritje e sipër i të rinjve nga ky komunitet po vijojnë kurse të zhvillimit të aftësive profesionale që ofrojnë OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare, siç janë “Don Bosco” dhe “Qendra për Aftësim Profesional” në Prishtinë/Priština, ku lëndët i vijojnë egjiptianët nga Fushë Kosova/Kosovo Polje. Burimi kryesor i të ardhurave për komunitetin mbeten punët sezonale të rasti në ndërtimtari dhe bujqësi dhe riciklimi i metaleve dhe materialeve tjera. Vetëm një egjiptian në rajon është mjek dhe punon në qendrën kryesore të mjekësisë në Fushë Kosovë/Kosovo Polje. Shumë familje egjiptiane mbështeten në sistemin e mirëqenies sociale, pensione, ndihmë sociale apo kompensim minimal të pagave nga ndërmarrjet e dikurshme shoqërore, siç është “Elektro Privreda Srbije”. Një numër i konsiderueshëm i egjiptianëve kanë familjarë të punësuar jashtë vendit dhe përkrahen financiarisht nga ata. Në kuptimin socio-ekonomik, gratë dhe vajzat egjiptiane janë më të cenueshme se burrat dhe djemtë në komunitetin e tyre. Kjo është si për shkak të statusit të ulët të tyre në familje, ashtu edhe për shkak të mundësive edhe më të pakta për ta përfunduar së paku arsimimin e obligueshëm. Në rajonin e Prizrenit, shumica e egjiptianëve varen nga mirëqenia sociale apo jetojnë në varfëri të skajshme pa kurrfarë asistence. Ata që janë të punësuar angazhohen në punë bujqësore joforMeshkuj dhe sezonale, biznese të vogla private apo vetë-punësim. Zyra rajonale për punësim nuk mban të dhëna specifike për komunitetin egjiptian. Megjithatë, kuptohet që niveli i papunësisë është mbi mesatare.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Situata e sigurisë e egjiptianëve është relativisht e mirë, me pak incidente të raportuara. Ata gëzojnë lirinë e lëvizjes në tërë Kosovën. Në përgjithësi, lëvizshmëria më e madhe ka çuar në rritje të qasjes në shërbimet publike dhe integrim me komunitetin shumicë. Megjithatë, përfaqësimi në policinë e Kosovës është i penguar për shkak të mungesës së kualifikimit adekuat arsimor në mesin e komunitetit. Pjesëmarrja në forume të sigurisë në nivel komunal dhe lokal është gjithashtu e kufizuar dhe e lidhur me sfidat e përgjithshme të angazhimit të komunitetit në jetën publike. Një nga shqetësimet kryesore që ndikojnë në sigurinë e grave dhe vajzave egjiptiane është dhuna në familje dhe në baza gjinore. Liria e tyre e lëvizjes është e cunguar nga mungesa e mbështetjes brenda dhe jashtë komuniteteve të tyre për pjesëmarrjen e tyre në jetën publike.

Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti egjiptian është i integruar mirë në jetën publike dhe gëzon liri të lëvizjes. Dy incidente të sigurisë janë raportuar në qytetet e Pejës/Peć dhe Gjakovës/Đakovica më 1 mars dhe më 8 maj 2010. Incidentet kishin të bëjnë me sulme fizike nga meshkuj shqiptarë që u arrestuan më vonë. Në rajon janë tre egjiptianë që punojnë si policë – një në stacionin policor në Istog/Istok, një në stacionin e Klinës/Klina dhe një në stacionin e Gjakovës/Đakovica. Policia e Kosovës i patrullon rregullisht zonat ku jeton komuniteti dhe situata e sigurisë përshkruhet si e qetë. Policia dhe komuniteti thonë që niveli i bashkëpunimit është i lartë. Një shembull i kohëve të fundit është takimi mes Policisë së Gjakovës/Đakovica dhe egjiptianëve nga vendbanimi joformal “Kolonja” në janar të vitit 2010, ku u shqyrtua situata e përgjithshme e sigurisë në vendbanim. Komuniteti

Lëvizja e lirë dhe e pavarur e femrave egjiptiane është ende e kufizuar. Ato nuk shihen shpesh të jenë vetëm në rrugë. Në vendet publike, veçanërisht jashtë vendbanimeve të tyre, ato zakonisht mund të shihen të shoqëruara me femra tjera, meshkuj apo fëmijë.

Një femër dhe gjashtë meshkuj egjiptianë punojnë si policë në tërë Kosovën.

përfaqësohet këshillin komunal për siguri në bashkësi në Gjakovë/Đakovica. Në rajon nuk ka linja humanitare të autobusëve enkas për komunitetin egjiptian. Komuniteti shfrytëzon transportin publik ose privat pa kurrfarë vështirësish, duke qenë të kufizuar vetëm nga shpenzimet. Në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk ka pasur incidente ku ishin të përfshirë egjiptianit gjatë periudhës për të cilën raportohet. Nuk ka egjiptianë të punësuar në policinë e Kosovës. Këshillat komunalë për siguri në bashkësi në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Prishtinë/Priština dhe Obiliq/Obilić kanë një përfaqësues egjiptian. Transporti publik është mjeti më i shfrytëzuar i transportit për komunitetin egjiptian. Megjithatë, për shkak të gjendjes financiare, qasja në transport publik është shumë e kufizuar. Në rajonin e Prizrenit, nuk ka pasur ndonjë incident të sigurisë që komuniteti ia ka raportuar policisë gjatë vitit të kaluar. Nuk ka egjiptianë të punësuar në policinë e Kosovës. Egjiptianët nuk përfaqësohen në këshillat komunalë për siguri në bashkësi në komunat ku jetojnë.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Sipas statistikave të UNHCR-së, në vitin 2009 është shënuar një rritje e kthimeve vullnetare në krahasim me vitin 2008: 281 ashkali dhe egjiptian u kthyen në vitin 2009, në krahasim me 195 në vitin 2008.¹

Shifrat e kthimit të UNHCR-së tregojnë 179 ashkali dhe egjiptianë të zhvendosur që janë kthyer mes janarit dhe prillit të vitit 2010.

Rreth dy të tretat e popullsisë së supozuar prej 150,000 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian para luftës janë zhvendosur gjatë ose pas konfliktit të vitit 1999. Në Kosovë mbesin 292 egjiptianë të zhvendosur, përafërsisht 1.5% të numrit të përgjithshëm të personave të zhvendosur brenda Kosovës.² Riatdhesimet me forcë të egjiptianëve në Kosovë ende nuk kanë përfunduar. Procesi i kthimit vullnetar të personave që i takojnë komunitetit egjiptian ka qenë i ngadalshëm dhe qëndrueshmëria e tij është penguar shpeshherë nga mungesa e mundësive të punësimit dhe integrimi i dobët ekonomik i të kthyerve. Faktorët tjerë që kanë ndikuar negativisht në kthim dhe riintegrim të këtij komuniteti përfshijnë, mes tjerash, vështirësitë për ta kthyer pronën në posedim për shkak të mungesës së përhapur të dokumenteve personale dhe titujve të regjistruar të pronësisë, çështjet e sigurisë, interesimin e pamjaftueshëm të donatorëve dhe përfaqësimin e pamjaftueshëm në organet e nivelit lokal dhe qendror që merren me kthim.

Në vitin 2009 dhe në fillim të vitit 2010, në rajonin e Pejës/Peć u zhvilluan një varg nismash të dedikuara në mënyrë specifike për kthim dhe riintegrim të komunitetit egjiptian. Në vitin 2009, vetëm pesë egjiptianë u kthyen në shtëpitë e tyre në komunën e Pejës/Peć kurse në fillim të vitit 2010 këtë e bënë 22 tjerë, përkatësisht pesë në Ljesane/Leshan, dy në qytetin e Pejës/Peć, gjashtë në Vitomirica/Vitomiricë dhe nëntë në Vragovac/Vragoc. Në Istog/Istok, në kuadër të projektit "Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë", të financuar bashkërisht nga Komisioni Evropian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe të zbatuar nga UNDP-ja, 16 familje egjiptiane nga Rudeshi/Rudeš u rivendosën në fshatin Serbobran/Srbobran në vitin 2009.³ Komuna e caktoi dhe ndau tokën për këtë vend alternativ. Megjithatë, në mënyrë që kthimi të jetë i qëndrueshëm, nevojitet ndihmë e mëtejshme për t'u zgjidhur problemet që kanë të bëjnë me vërshimin e vazhdueshëm të vendit të kthimit, furnizimin e amvisërive me ujë dhe energji elektrike, dhe për ta garantuar zotërimin e sigurt të pronës dhe qasjen në dokumente, arsim dhe mundësi të fitimit të të ardhurave për të kthyerit. Në Istog/Istok nuk ka pasur nisma apo projekte tjera për

2 Pasqyrë statistikore nga ZShM e UNHCR-së në Prishtinë/Priština Ashtu si ishte në fund të dhjetorit të vitit 2009.

3 Në vitin 2005, komuna kishte nisur një projekt të kthimit për 70 familje të zhvendosura egjiptiane nga Rudeshi/Rudea, vendbanimi i të cilave ishte shkatërruar në tërësi pas konfliktit të vitit 1999. Mirëpo, nisma për kthim u ndal në qershor të vitit 2008 kur vendbanimi i tyre u përfshi brenda zonës së mbrojtur të një objekti fetar në afërsi.

1 Pasqyrë statistikore nga ZShM e UNHCR-së në Prishtinë/Priština Ashtu si ishte në fund të dhjetorit të vitit 2009.

kthim të dedikuara për egjiptianit edhe pse të dhënat e UNHCR-së tregojnë që 36 egjiptianë janë kthyer në komunë në vitin 2010, kurse 51 në vitin 2009. Në Klinë/Klina, sipas të dhënave të UNHCR-së, vetëm dy egjiptianë u kthyen në vitin 2010, kurse asnjë në vitin 2009. Kjo mund të sqarohet përse nuk ka pasur kohëve të fundit ndonjë nismë apo projekt të dedikuar kthimi për komunitetin në këtë komunë. Disa familje egjiptiane janë kthyer në shtëpitë e tyre të rindërtuara në vendbanimin Brekoc/Brekovac në komunën e Gjakovës/Đakovica në kuadër të kornizës së Partneritetit të Qëndrueshëm për Ndhmën për Kthim të Pakicave në Kosovë⁴. Gjatë vitit 2009, ka pasur kthim spontan të një numri të familjeve egjiptiane nga qendra kolektive “Konik II” në Podgoricë, në Mal të Zi, në vendbanimin joformal “Kolonia” në komunën e Gjakovës/Đakovica, të cilat ende presin për ndonjë zgjidhje afatgjatë. Në Deçan/Dečane, vetëm disa familje egjiptiane janë kthyer në vitet 2009/2010, derisa komuna nuk ka ndërmarrë ndonjë iniciativë të rëndësishme për ta promovuar riintegrimin e tyre.

Përveç kësaj, gjatë vitit 2009 dhe në fillim të vitit 2010, u organizuar një sërë vizitash shko-dhe-shih (GSV)⁵ për egjiptianit që momentalisht janë të zhvendosur në Mal të Zi, nga ana e Këshillit Danez për Refugjatë dhe UNHCR-së në bashkëpunim me zyrtarët komunalë. U organizuan vizita në komunat e Klinës/Klina dhe Istogut/Istok dhe në vendbanimin “7 Shtatori”, si dhe fshatrat Vitomiricë/Vitomirica dhe Ozdrim/Ozrim në komunën e Pejës/Peć. Për më tepër, në komunën e Pejës/Peć, mes janarit dhe qershorit të vitit 2010, u organizuan tri vizita shko-dhe-shih nga Këshilli Danez për Refugjatë në shkurt (20 pjesëmarrës në fshatin Blagajë/Blagaje), mars (gjashtë në Pejë/Peć) dhe maj (40 në vendbanimin “7 Shtatori”), si pjesë të projekteve të financuara nga Bashkimi Evropian dhe Zyra e Popullsisë, Refugjatëve dhe Migrimit e SHBA-ve. Në shkurt, Këshilli Danez për Refugjatë organizoi një vizitë të suksesshme shko-dhe-informohu në Mal të Zi, në të cilën morën pjesë 95 persona. Zyrtarët komunalë të komunave të Deçanit/Dečane, Gjakovës/Đakovica and Klinës/Klina morën pjesë gjithashtu në vizitat shko-dhe-shih në Beran dhe Podgoricë të Malit të Zi për t'i informuar personat e zhvendosur rreth situatës së sigurisë, lirisë së lëvizjes, qasjes në shërbime publike dhe mundësive të strehimit dhe punësimit në vendin e tyre të origjinës. Megjithatë, përkundër shprehjes së interesimit, këto vizita ende nuk kanë rezultuar me ndonjë kthim të rëndësishëm. Në shumë raste, mungesa e dokumentacionit dhe titujve formalë të pronësisë ndikojnë negativisht në prospektet e kthimit të egjiptianëve të zhvendosur në shtëpitë e tyre. Komunat në rajon, veçanërisht Klina/Klina dhe Gjakova/Đakovica, ende nuk kanë krijuar një qasje gjithëpërfshirëse për ta siguruar zotërimin e sigurt të pronës, përfshirë këtu rregullimin e vendbanimeve forMeshkuj apo caktimin dhe ndarjen afatgjatë të tokës për të kthyerit. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e egjiptianëve në mekanizmat përkatës të kthimit pengohen nga fakti që shumë komuna nuk i kanë të themeluara apo nuk i mbajnë mbledhjet e rregullta të tyre. Për shembull, komunat e Gjakovës/Đakovica, Deçanit/Dečane, dhe Klinës/Klina nuk kanë grupe funksionale komunale për kthim. Komuna e Istogut/Istok e ka zëvendësuar këtë grup me të ashtuquajturën “task-forcë për stabilizim të të kthyerve”, që kryesohet nga zëvendës-kryesuesi egjiptian për komunitete. Përveç kësaj, komuna e Istogut/Istok është e vetmja që ka përfaqësues egjiptian në zyrën komunale për kthim.

Vazhdon riatdhesimi me forcë i pjesëtarëve të komunitetit egjiptian, ku 10 janë kthyer nga shtetet e treta (kryesisht nga ato të Evropës Perëndimore) në Kosovë prej vitit 2009 deri në prill të vitit 2010.¹

4 Programi i Partneritetit të qëndrueshëm për ndihmën për kthim të pakicave në Kosovë (SPARK) financohet nga qeveritë e Kosovës dhe Britanisë në vlerë prej 20 milionë dollarësh. Programi siguron një mekanizëm ombrellë të integruar për të ofruar spektër të plotë të ndihmës shumetnike për kthim individual apo spontan dhe kthim të organizuar grupor.

5 Vizitat shko-dhe-shih ua ofrojnë personave të zhvendosur mundësinë që të marrin informata personalisht për kushtet në vendin e tyre të origjinës dhe të komunikojnë e angazhohen drejtpërdrejt me komunitetin pritës që të mund ta marrin një vendim të informuar për kthim apo zgjidhje tjera të qëndrueshme. (Shih Doracakun e rishikuar për kthim të qëndrueshëm, UNMIK/IVPQ, korrik 2006).

¹ Po aty.

Nga rajonet tjera nuk është raportuar për ndonjë aktivitet, projekt apo nismë të rëndësishme për kthim të dedikuar për komunitetin egjiptian në vitin 2009 apo në fillim të vitit 2010. Në rajonin e Prishtinës/Priština, një familje e zhvendosur egjiptiane ka jetuar në barakat e mbetura të kampit të dikurshëm në Plemetinë/Plemetina prej vitit 1999. Familja është nga komuna e Lipjanit/Lipljan, mirëpo për shkaqe sigurie, siç e ka vlerësuar UNHCR-ja, mbetet në kamp. Në tetor të vitit 2009, Ministria e Shëndetësisë i udhëzoi autoritetet e komunës së Obiliqit/Obilić që ta gjejnë një zgjidhje afatgjatë për familjen në fjalë, pasi që ata po jetonin në kushte të tmerrshme sanitare. Në përgjithësi, përfaqësimi dhe pjesëmarrja e egjiptianëve në mekanizmat përkatës për kthim mbeten të dobëta dhe nuk ka ndonjë strategji specifike të hartuara për t'iu qasur egjiptianëve të zhvendosur dhe për ta nxitur kthimin e tyre apo për të gjetur zgjidhje tjera afatgjata. Sipas zyrtarëve komunalë për kthim, nuk ka pasur aktivitete të dedikuara për kthim për komunitetin egjiptian. Statistikat e UNHCR-së nuk i zbërthejnë të dhënat për komunitetet egjiptiane dhe ashkali që janë kthyer në rajonin e Prishtinës/Priština. Zyrtarët komunalë për kthim nuk kanë dijeni për riatdhesime me forcë të pjesëtarëve të komunitetit egjiptian gjatë vitit 2009 dhe fillimit të vitit. Nuk ka të dhëna specifike lidhur me zhvendosjen, kthimin apo riintegrimin e komunitetit në rajonin e Prizrenit.

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Me përjashtim të vetëm të atyre që mund të jenë duke marrë paga miniMeshkuj apo pensione nga ndërmarrjet publike ku ishin të punësuar para vitit 1999, komuniteti egjiptian në përgjithësi nuk i shfrytëzon strukturat e drejtuara nga Serbia.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Gjatë dy viteve të fundit, OJQ “Programi i të drejtave civile në Kosovë”, në bashkëpunim me UNHCR-në, ka kontribuar në lehtësimin e procedurave për t’i mundësuar komunitetit egjiptian qasjen në regjistrim civil. “Fushata e regjistrimit civil”, që ishte pjesë e programit, e ka rritur njohurinë e shumë egjiptianëve për procedurën e regjistrimit duke i bërë më të afërt me të.

Komuniteti egjiptian vazhdon të ketë qasje në shërbime komunale, por mbetet sfidë qasja në shërbime publike. Shumë egjiptianë nuk kanë certifikata të lindjes apo të regjistrimit civil, gjë që mund ta pengojë qasjen e plotë të komunitetit në shërbime sociale, siç janë asistencë për punësim, përkujdesja shëndetësore apo mirëqenia sociale. Në fshatin Pemishtë/Pemište të rajonit të Pejës/Peć, shumë gra dhe fëmijë egjiptianë ende nuk kanë dokumente të regjistrimit civil që ua pamundëson çfarëdo forme të mbrojtjes sociale në rastet e ndarjes, kujdestarisë së fëmijëve, trashëgimisë, mirëqenies sociale dhe përkujdesjes shëndetësore. Në maj të vitit 2010, zyra komunale për komunitete e Deçanit/Dečane e filloi një fushatë për regjistrim për t’u marrë me këtë çështje dhe për ta lehtësuar lëshimin e dokumenteve personale. Fshati ka probleme me grumbullimin e mbeturinave pasi që asnjë kompani publike nuk mori përsipër projektin e zbatuar në vitin 2009 nga një OJQ që mbledhte mbeturinat rregullisht. Një familjeje egjiptiane që jeton në kushte jashtëzakonisht të mjera në fshat i është mundësuar të shpenzojë falas 500 kilovatë

energji elektrike në muaj nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), ku shpenzimet mbulohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale. Familja ka jetuar pa energji elektrike për tri vite prej kur ishte kthyer në Kosovë. Në komunën e Klinës/Klina, sistemet e kanalizimit dhe të furnizimit me ujë nuk janë të mjaftueshëm ose mungojnë në tërësi. Shumica e fshatrave në të cilat jeton komuniteti egjiptian nuk janë të kyçura në rrjet të kanalizimit dhe përdorin gropa septike për t'i larguar ujërat e zeza. Përkundër asaj që sistemet e furnizimit me ujë janë instaluar në pothuajse çdo fshat, ato shpesh herë nuk funksionojnë si duhet dhe banorët mbështetet në burime të parregulluara të ujit. Ndërprerjet në furnizim me energji elektrike dhe mungesa e mbledhjes së mbeturinave për shkak të mospagesës gjithashtu ndikojnë në cilësinë e jetës së komunitetit egjiptian në rajonin e Pejës/Peć.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, mbetet problematik ofrimi i shërbimeve publike, siç është grumbullimi i mbeturinave, në zonat ku jeton komuniteti egjiptian. Janë raportuar raste në Fushë Kosovo/ Kosovo Polje dhe Obiliq/Obilić, ku kompania publike nuk i ka ofruar këto shërbime rregullisht dhe janë krijuar deponi të paligjshme. Egjiptianët që jetojnë në ndërtesat e banimit social në Plemetinë/ Plemetina të komunës së Obiliqit/Obilić nënshkruan një marrëveshje kolektive me KEK-un për t'i ngrirë borxhet e tyre me kusht të pagesës së rregullt të faturave, gjë që i mundësoi atyre të kyçen përsëri në rrjet. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti ka qasje në shërbime komunale dhe publike, por mospagesa e faturave vazhdon ta kufizojë qasjen e komunitetit në ujë dhe energji elektrike. Grumbullimi i mbeturinave ofrohet nga kontraktues privatë dhe ka raporte që kjo nuk bëhet rregullisht.

6. Qasja në shërbime sociale

Shumica e komunitetit egjiptian vazhdojnë të gëzojnë qasje të lirë në shërbime dhe mirëqenie sociale. Megjithatë, disa femra janë ankuar që këto shërbime nuk janë adekuate për t'i adresuar nevojat e tyre të veçanta. Në komunën e Gjakovës/Đakovica, disa egjiptianë e kanë ngritur çështjen e ndarjes jo të drejtë të ndihmës në mes komuniteteve të ndryshme. Përveç përkrahjes financiare, shërbimet tjera siç janë përkrahja kundër dhunës në familje, shërbimet familjare dhe asistencë në trajtimin e problemeve të të rinjve nuk shfrytëzohen zakonisht nga femrat egjiptiane. Në komunën e Klinës/Klina, në rajonin e Pejës/Peć, zyrtarët e vijuan një trajnim të specializuar që e ofroi Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në vitet 2009 dhe 2010 për ta rritur njohurinë e tyre mbi procedurat e skemës së ndihmës sociale dhe nevojave specifike të komuniteteve joshumicë. Prej atëherë është përmirësuar cilësia e qasjes, informimit dhe shërbimeve të tyre.

7. Qasja në pronë dhe banim

Përkundër asaj që shumë komuna kanë bërë hapa për ta adresuar këtë çështje, qasja në pronë dhe banim mbetet një nga sfidat më të mëdha të komunitetit egjiptian. Për shembull, mungesa e titujve të pronësisë e pengon kthimin e shumë të zhvendosurve në shtëpitë e

BANIM I TË KTHYERVE NË SERBOBRAN/
SRBOBRAN TË KOMUNËS SË ISTOGUT/
ISTOK (NË RAJONIN E PEJËS/PEĆ).
PËRKUNDËR MADHËSISË SË VOGËL DHE
MJETEVE E KUSHTEVE THEMELORE NË
SHTËPINË NË FOTO, BANIMI INDIVIDUAL
DHE ARAT NË AFËRSI OFROJNË
ZGJIDHJE MË TË PËRSHTATSHME
BANIMI PËR EGJIPTIANËT E
ZHVENDOSUR DHE TË CENUESHËM NË
SHOQËRI SESA PROJEKTET VERTIKALE
TË BANIMIT QË MUND TË GJENDEN
TJETËRKUND NË KOSOVË.



tyre. Për ata që tashmë jetojnë në Kosovë, ajo e pengon zotërimin e sigurt të pronës. Mungesa pothuajse e plotë e nismave që synojnë rregullimin e vendbanimeve joforMeshkuj i vënë egjiptianët dhe komunitetet tjera të cenueshme në një pozitë të pafavorshme. Dështimi i komunave për të hartuar dhe zbatuar planet urbanistike komunale vazhdon të ketë ndikim negativ te komuniteti egjiptian dhe komunitetet tjera. Cilësia e përgjithshme e banimit për komunitetin egjiptian është e dobët. Shumë vendbanime nuk kanë infrastrukturë themelore dhe nuk janë të lidhura në rrjetet e furnizimit me ujë dhe energji elektrike.

Çështjet që ndikojnë në gëzimin e të drejtave pronësore dhe banesore për egjiptianët përfshijnë: mungesën e një skeme të përgjithshme të banimit social për familjet e cenueshme dhe të kthyerit me forcë; mungesa e kompensimit për ata që i kanë humbur pronat e tyre dhe nuk dëshirojnë të kthehen; dhe uzurpimi i paligjshëm i pronës.

Shumë shembuj nga rajoni i Pejës/Peć i pasqyrojnë disa nga sfidat kryesore që ndikojnë në gëzimin e të drejtave pronësore dhe banesore të komunitetit egjiptian. Në vendbanimin joformal "Kristali" në Pejë/Peć jetonin më shumë se 100 egjiptianë dhe romë para se të shkatërrohej gjatë konfliktit të vitit 1999. Banorët e dikurshëm ikën, kryesisht në Mal të Zi. Ndryshimi i zonës nga ajo e banimit në zonë industriale në vitin 1993 ua pamundësoi egjiptianëve dhe romëve të zhvendosur që t'i rindërtojnë shtëpitë e tyre. Në anën tjetër, u toleruan ndërtime të paligjshme nga persona të komuniteteve tjera. Më vonë, në shtator të vitit 2000, zona u kthye në zonë afariste, duke e pamundësuar përsëri kthimin e personave të zhvendosur dhe rindërtimin e shtëpive të tyre. Nuk u dha kurrfarë kompensimi. Rreth 450 egjiptianë dhe romë jetojnë në vendbanimin joformal "7 Shtatori", gjithashtu në Pejë/Peć, në kushte të mjera banimi dhe mungesë të energjisë elektrike, ujit të pijshëm dhe sistemit funksional të ujërave të zeza. Edhe pse organizatat ndërkombëtare i përkrahin vizitat shko-dhe-shih dhe projektet për kthim në vendbanim, ende nuk ka plane për ta rregulluar atë apo për t'i përmirësuar kushtet e jetës për banorët. Rreth 70 familje egjiptiane dhe romë jetonin dikur në Rudesh/Rudeš të komunës së Istogut/Istok para se të shkatërrohej gjatë konfliktit të vitit 1999. Disa nga banorët provuan të kthehen dhe t'i rindërtojnë shtëpitë e tyre por progresi u ndal për shkak se lokacioni u përfshi në zonën e mbrojtur rreth Manastirit ortodoks serb të Goriçit në vitin 2008. Duhet të ceket që komuna e Istogut/Istok i kishte përkrahur përpjekjet e tyre para vitit 2008 duke kërkuar ndërrim toke me Manastirin e Goriçit, që do t'ua

mundësonte personave të zhvendosur që të ndërtojnë shtëpitë e tyre në Rudesh/Rudeš. Mirëpo, ky propozim nuk u aprovua kurrë nga Përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm i UNMIK-ut. Pasi që ishte caktuar zona e mbrojtur, u gjet një lokacion i tretë në fshatin Serbobran/Srbobran, rreth shtatë kilometra larg nga Rudeshi/Rudeš. Deri më tani, në shtëpitë e tyre të rindërtuara në Serbobran/Srbobran janë kthyer 18 familje egjiptiane me 80 anëtarë, duke nënshkruar marrëveshje qiraje për 10 vite me mundësi zgjatjeje. Të kthyerit egjiptianë janë ankuar për vonesa në ndërtim, cilësi të dobët të shtëpive, mungesë të ujit dhe energjisë elektrike, vërshime dhe mungesë të mundësive për integrim afatgjatë në mjedisin e ri. Supozohet që ata që kanë pasur prona në Rudesh/Rudeš mund t'i kthejnë ato nëse hiqen ndonjëherë kufizimet që kanë të bëjnë me zonën e mbrojtur. Në shtator të vitit 2008, kuvendi i komunës së Gjakovës/Đakovica ndau gati katër hektarë të tokës së komunës për t'i vendosur rreth 140 familje rome dhe egjiptiane që jetonin në tokën që i takonte një ndërmarrjeje të dikurshme shoqërore në vendbanimin joformal "Kolonia". Toka e ndarë është në kufi me vendin e tyre aktual të banimit. Projekti në vazhdim e sipër përfshin rregullimin e vendbanimit, duke përfshirë infrastrukturën adekuate dhe ndërtimin e 140 shtëpive. Nëse implementimi i projektit vazhdon si duhet, kjo do të shënonte një hap të madh në përmirësimin e kushteve të jetës së këtyre familjeve të cenushme.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, qasja në banim adekuat për komunitetin egjiptian mbetet sfidë. Komunitet nuk kanë zhvilluar ndonjë plan apo ndërmarrje hapa për t'i rregulluar vendbanimet ekzistuese joformale Meshkuj ku jeton komuniteti dhe brengat rreth sigurisë e kanë ndalur kthimin e të zhvendosurve egjiptianë në vendet e tyre të origjinës. Për disa janë gjetur zgjidhje alternative, siç ishte ndarja e tokës komunale në Plemetinë/Plemetina. Në rajonin e Prizrenit, egjiptianët që jetojnë në zona urbane, siç është qyteti i Prizrenit, kanë në përgjithësi qasje më të mirë në banim adekuat dhe siguri të zotërimit të pronës në krahasim me ata që jetojnë në zonat rurale apo jashtë-urbane. Sipas zyrtarëve komunalë, në rajon momentalisht nuk ka vendbanime joformale Meshkuj ku jeton ky komunitet.

8. Qasja në arsim

Egjiptianët që jetojnë në rajonet e Pejës/Peć, Prishtinës/Priština dhe Prizrenit arsimohen kryesisht sipas kurrikulës së Kosovës në gjuhën shqipe. Megjithatë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ende nuk ka zhvilluar ndonjë lëndë kombëtare për historinë, artin dhe kulturën e komunitetit. Edhe pse nuk është shënuar ndonjë pengesë formale Meshkuj për t'u qasur lokaleve mësimore, në komunitet ka ndikim përjashtimi social dhe varfëria që e pengon vijimin dhe rezultatet e fëmijëve në shkollë në mbarë Kosovën. Siç ndodh shpesh edhe te komunitetet tjera, nga kjo më së shumti vuajnë femrat. Në raste të rralla ndodh që familjet egjiptiane mund t'i blejnë tekstat themelore shkollë dhe mjetet tjera, duke rezultuar me numër të madh të braktisjes së shkollimit dhe zgjedhjes së shpeshtë që në shkollë të shkojnë vetëm djemtë. Fëmijët egjiptianë, për më tepër, regjistrohen shumë rrallë për arsimim parashkollor, kryesisht për shkak të mosinteresimit të prindërve dhe arsyeve financiare.

NJË VAJZË EGJIPTIANE NGA SERBOBRANI/SRBOBRAN I KOMUNËS SË ISTOGUT/ISTOK (NË RAJONIN E PEJËS/PEĆ). SHUMË FAMILJE EGJIPTIANE NUK MUND T'I PAGUAJNË TEKSTET DHE MATERIALET TJERA MËSIMORE. KJO REZULTON ME NUMËR TË MADH TË BRAKTISJES SË SHKOLLIMIT DHE ZGJEDHJES SË SHPESHTË QË TË ARSIMOHEN VETËM DJEMTË, NË DËM TË ARSIMIMIT TË VAJZAVE EGJIPTIANE.



Shumica dërmuese e nxënësve egjiptianë nuk e vazhdojnë arsimimin e tyre më tej se niveli i obligueshëm. Vetëm disa regjistrohen në universitet, përkundër kuotave ekzistuese të vendeve të rezervuara për egjiptianët dhe komunitetet tjera. Në Pejë/Peć, qasja në arsimim duket të jetë më e mirë se në rajonet tjera, pjesërisht për shkak të numrit më të madh të komunitetit. Aktivitetet parashkollore organizohen në qendrat e komunitetit në vendbanimin joformal "Kolonia" dhe fshatin Brekoc/Brekovac në komunën e Gjakovë/Đakovica. Gjithashtu, disa OJQ, siç janë "Bethany Christian Services" dhe "Samaritan's Purse", janë aktive në implementimin e reformave arsimore për ta përmirësuar vijimin e nxënësve egjiptianë në shkollë fillore. Komuna e Klinës/Klina është angazhuar në rritjen e interesimit të komunitetit për t'i regjistruar dhe mbajtur fëmijët në shkollë fillore duke siguruar transport falas për fëmijët egjiptianë. Në vitin 2011, komuna dëshiron të ofrojë këtë shërbim edhe për nxënësit e shkollave të mesme të komuniteteve joshumicë, përfshirë këtu edhe egjiptianët. Në komunën e Deçanit/Dečane, egjiptianët nuk i regjistrojnë fëmijët për arsimim parashkollor. Vetëm dy egjiptianë punojnë si mësime nga shkollat e Kosovës pas një trajnimit të specializuar që u ofrua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe OJQ-ja vendore "Qendra për Arsim e Kosovës". Shkollat e mesme janë larg nga vendbanimet dhe komuna nuk siguron transport për nxënësit. Prandaj, prindërit në përgjithësi nuk ndjehen rehat me atë që vajzat e tyre të ecin disa kilometra vetëm.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Komuniteti egjiptian zakonisht ka qasje në përkujdesje shëndetësore, edhe pse shpesh nuk mund t'i mbulojë shpenzimet e medikamenteve dhe shërbimeve. Për egjiptianët që jetojnë në zona të largëta është e vështirë dhe e shtrenjtë që të arrijnë te qendrat dhe shërbimet në zonat urbane. Lindjet në shtëpi në kushte të mjera higjienike dhe pa asistencë të mamive mbeten praktikë e përhapur te egjiptianët, posaçërisht për ata që nuk mund t'i mbulojnë shpenzimet e spitalit.

Mungesa e njohurisë, arsimimi i pamjaftueshëm shëndetësor dhe numri i vogël i mjekeve të specializuara janë disa pengesa tjera për qasjen në përkujdesje shëndetësore të femrave egjiptiane. Në përgjithësi, komuniteti egjiptian nuk shfrytëzon institucionet shëndetësore të drejtuara nga Serbia. Në komunën e Gjakovës/Đakovica në rajonin e Pejës/Peć, OJQ "Fondacioni për Shoqëri të Hapur" është duke e implementuar një pilot projekt për trajnimin e ndërmjetësuesve shëndetësorë nga komuniteti egjiptian. Projekti ka në punë tre persona që mbulojnë vendbanimet "Kolonja" dhe "Piskotë/Piskota" dhe fshatin Brekoc/Brekovac. Qëllimi i projektit është që, përmes zhvillimit të një qasjeje të ndjeshme ndaj kulturës, të përmirësohen ofrimi dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore për më të cenueshmit, përfshirë këtu qasjen te femrat në mënyrë që të përmirësohen përgjigjet në çështjet shëndetësore të femrës dhe familjes. Në komunën e Gjakovës/Đakovica janë dy mjekë të komunitetit egjiptian që punojnë në sektorin shëndetësor komunal.

Në komunën e Gjakovës/Đakovica, OJQ vendore "Fondacioni për Shoqëri të Hapur" është duke e implementuar një pilot projekt për trajnimin e ndërmjetësuesve shëndetësor nga komuniteti egjiptian për ta përmirësuar qasjen e komunitetit në shëndetësi.

10. Qasja në drejtësi

Qasja e egjiptianëve në gjykatë dhe shërbime ligjore është në nivel të kënaqshëm, edhe pse komuniteti ende përballlet me probleme lidhur me shpenzimet dhe mungesën e njohurisë për të drejtat e tyre dhe mjetet ligjore në dispozicion në rajonet e Pejës/Peć, Prishtinës/Priština dhe Prizrenit. Femrat egjiptiane, për shkak të patriarkatit që mbizotëron në komunitet, nuk janë shumë aktive në paraqitjen e kërkesave në gjykata. OJQ "Programi i regjistrimi civil në Kosovë" ofron ndihmë ligjore falas dhe këshillë për regjistrimin e statusit civil dhe qasjen në të drejta për komunitetet joshumicë, duke përfshirë këtu edhe komunitetin egjiptian. Komuniteti nuk përfaqësohet sa duhet në gjyqësi, pasi që ka vetëm një gjykatës në Gjykatën e qarkut në Pejë/Peć dhe një zyrtare administrative egjiptiane në Gjykatën komunale për kundërvajtje në Klinë/Klina.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Egjiptianët përfaqësohen në nivel qendror me vetëm një deputet në Kuvendin e Kosovës⁶, si dhe dy përfaqësues në këshillin konsultativ për komunitete, një trup këshillëdhënës që vepron në kuadër të Zyrës së Kryetarit të Kosovës. Pjesëmarrja e komunitetit egjiptian në çështje publike është më e mirë në nivel komunal. Zgjedhjet komunale në nëntor të vitit 2009 u konsideruan sukses për komunitetin egjiptian. Komuniteti mori nga një vend në kuvendet e komunës të Fushë Kosovës/Kosovo Polje, Gjakovës/Djakovica, Istogut/Istok dhe Pejës/Peć, ku jeton një numër relativisht i madh i egjiptianëve. Megjithatë, komuniteti ende nuk përfaqësohet në degën e ekzekutivit në komunat ku jeton. Përfaqësimi i kufizuar është deri diku rezultat i numrit të vogël të komunitetit. Njëkohësisht, mungesa e kualifikimeve profesionale dhe arsimore vazhdon ta dobësojë vetëbesimin e përfaqësuesve të komunitetit për t'u angazhuar në mënyrë aktive në politikat komunale. Femrat egjiptiane mbesin në veçanti jashtë sferës së çështjeve publike pasi që roli i tyre tradicional në shtëpi i kufizon mundësitë e tyre. Autoritetet komunale kanë dështuar në përgjithësi për t'u qasur egjiptianëve në mënyrë aktive

Pjesëmarrja e komunitetit egjiptian në çështje publike mbetet e vogël dhe mbështetet në punën dhe përfshirjen e tyre në zyrat komunale për komunitete dhe komitetet komunale për komunitete.

⁶ Kuvendi i Kosovës ka katër vende të rezervuara për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Në zgjedhjet e fundit të përgjithshme në nëntor të vitit 2007, në Kuvend u zgjodhën një pjesëtar i komunitetit rom, një i komunitetit egjiptian dhe tre të komunitetit ashkali.

Një Plan i veprimit është aprovuar në dhjetor të vitit 2009 për zbatimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovës, të miratuar në vitin 2008. Plani i veprimit prezanton masa konkrete që, mes tjerash, kanë për qëllim përmirësimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë e Kosovës.

për ta promovuar pjesëmarrjen e tyre apo për ta nxitur komunitetin që të regjistrohen për të votuar. Gjithashtu, ka pjesëmarrje të ulët të egjiptianëve në diskutimet publike të organizuara nga komunat ku ata jetojnë. Egjiptianët përfaqësohen në politikë nga Iniciativa e Re Demokratike për Kosovën (IRDK). Nuk ka media elektronike apo shtyp që i dedikohet veçanërisht komunitetit egjiptian.

Pjesëmarrja e komuniteti egjiptian në çështje publike në rajonin e Pejës/Peć është duke u rritur. Komuniteti mori tri vende në kuvende komunale në komunat e Gjakovës/Djakovica, Istogut/Istok dhe Pejës/Peć në zgjedhjet lokale të nëntorit të vitit 2009. Komuniteti ka një nënkryetar për komunitete në Pejë/Peć, nga një zëvendës-kryesues të kuvendit komunal në Gjakovë/Đakovica dhe Istog/Istok, kryesues të komitetit për komunitete në Istog/Istok, kryesues të zyrës për komunitete, një vend në komisionin për politikë dhe financa në Gjakovë/Đakovica dhe një zyrtar komunal për kthim në Istog/Istok. Përfaqësimi i komunitetit është siguruar edhe në zyrat komunale për komunitete në të gjitha komunat ku jetojnë, përkatësisht në Gjakovë/Đakovica (tre përfaqësues), Klinë/Klina (një), Pejë/Peć (një), dhe Istog/Istok (një). Ka disa shembuj të aktiviteteve të qasjes dhe informimit që i kanë organizuar autoritetet komunale. Komuna e Gjakovës/Đakovica angazhohet në mënyrë aktive për komunitetin në procesin e rivendosjes së vendbanimit joformal "Kolonja" (shih faqen 8 më lart). Zyrtarët komunalë të Klinës/Klina u bashkohen përfaqësuesve të komitetit për komunitete në vizitat e tyre të informimit në fshatrat e banuara me egjiptianë. Zyra komunale për komunitete e Istogut/Istok organizon vizita të rregullta informimi në vendbanimet e ndryshme ku jeton komuniteti. Shoqëria civile ka dhënë kontribut të konsiderueshëm duke përkrahur dhe promovuar aktivitete të ndryshme arsimore dhe rekreative që kishin për qëllim integrimin e komunitetit në shoqëri dhe përmirësimin e kushteve të tyre të jetës.

Pjesëmarrja e komunitetit egjiptian në çështjet publike në rajonin e Prishtinës/Priština është e ulët. Komuniteti ka marrë një vend në kuvendin komunal të Fushë Kosovës/Kosovo Polje në zgjedhjet lokale të nëntorit të vitit 2009. Komuniteti gjithashtu përfaqësohet në komitetet për komunitete në dy komuna ku janë të përqendruar, përkatësisht në Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Obiliq/Obilić. Megjithatë, nuk ka egjiptianë në degët e ekzekutivit në komunat ku jetojnë. Aktivitetet e qasjes dhe informimit për komunitetin që i kanë nisur komunat në rajon janë të rralla. Në rajonin e Prizrenit, pjesëmarrja e komunitetit në çështjet publike është mbetet e ulët. Komuniteti është i përqendruar në numër të vogël në Prizren dhe Rahovec/Orahovac, i mungon përfaqësimi në degët e ekzekutivit dhe legjislativit dhe nuk është i punësuar në shërbimin civil. Komitetet për komunitet që, sipas ligjit, do të duhej të kenë përfaqësim egjiptian në Prizren dhe Rahovec/Orahovac nuk janë themeluar ende, kurse aktivitetet e qasjes dhe informimit për ta nxitur pjesëmarrjen e komunitetit në jetën publike kanë qenë të rralla. Takime të grupit të punës janë mbajtur në Prizren në vitin 2010 për ta hartuar një "Plan veprimi lokal" për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, në kuadër të një projekti të implementuar nga OJQ-ja vendore "Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur". Në takime morën pjesë përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare, kurse nuk morën pjesë zyrtarët e ftuar komunalë.

12. Përdorimi i gjuhës

Gjuha shqipe është tradicionalisht gjuhë amtare e komunitetit egjiptian dhe e lehtëson komunikimin me institucionet. Fakti që egjiptianët e flasin gjuhën shqipe e lehtëson qasjen e tyre në shërbime dhe informata dhe kontribuon njëkohësisht në lirinë e lëvizjes. Komuniteti përcjell mediat elektronike dhe shtypin në gjuhën shqipe.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Egjiptianët janë kryesisht myslimanë dhe në përgjithësi të lirë për të shprehur identitetin, besimin fetar dhe traditat e tyre. Nuk ka vende të caktuara të mbrojtura me rëndësi fetare apo kulturore për këtë komunitet dhe autoritetet kompetente nuk kanë ndërmarrë aktivitete për t'i identifikuar vendet e tilla. Në komunën e Gjakovës/Đakovica në rajonin e Pejës/Peć, ku jetojnë shumica e egjiptianëve, gjenden dy xhami që frekuentohen ekskluzivisht nga komuniteti egjiptian. Në komunën e Deçanit/Dečane është një grup i egjiptianëve që i takon rendit mysliman Bektashi.

Tradicionalisht, egjiptianët e kremtojnë ditën e “Shën Gjergjit” duke u mbledhur në objekte fetare siç janë tyrbet dhe xhamitë.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Shoqërimi i komunitetit egjiptian me shqiptarët e ka definuar raportin e tij me komunitetet tjera të Kosovës para, gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Megjithatë, komuniteti vazhdon t'i nënshtrohet diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, kryesisht për shkak të paragjytimeve të përhapura kundër tyre që çojnë drejt lënies jashtë nga shoqëria. Në ato komuna ku egjiptianët janë të nën-përfaqësuar, mundësitë e angazhimit të tyre në nismat për dialog ndërmjet komuniteteve mbesin të kufizuara. Angazhimi i egjiptianëve në nismat për dialog të shoqërisë civile mbesin të kufizuara gjithashtu për shkak të organizimit të dobët të vetë komunitetit.

Komuniteti egjiptian e luan një rol të rëndësishëm në promovimin e tolerancës dhe dialogut ndërmjet komuniteteve në rajonin e Pejës/Peć. Marrëdhëniet ndëretnike me shqiptarët dhe komunitetet tjera janë të mira, përkundër asaj që përfaqësuesit e komunitetit egjiptian ankohen shpesh herë që më shumë vëmendje u jepet komuniteteve tjera në dëm të tyre. Përfaqësuesit e komunitetit dhe të shoqërisë civile marrin pjesë në të gjitha ngjarjet dhe aktivitetet shumetnike dhe ndërmjet komuniteteve në rajon. Për shembull, OJQ-ja shumetnike e grave “7 Shtatori” është duke promovuar nisma për dialog ndërmjet romëve, egjiptianëve dhe shqiptarëve në Pejë/Peć. Në Istog/Istok, OJQ-të “Vizioni 02” dhe “Iliria” organizuan turnirë futbollit dhe kampe verore me të rinj egjiptianë, boshnjakë dhe shqiptarë. Femrat egjiptiane nuk luajnë një rol aktiv në jetën sociale në shoqërinë më të gjerë të Kosovës dhe kryesisht mblidhen vetëm brenda komunitetit

PEŠË SHOKË, NJË SHQIPTAR I KOSOVËS DHE KATËR EGJIPTIANË, LUAJNË LOJËRA KOMPJUTERIKE NË NJË QENDËR PËR KOMUNITETE, TË UDHËHEQUR NGA NJË SHOQATË E GRUAS, NË LAGJEN E PËRZIER ETNIKE SHTATË SHTATORI/SEDMI SEPTEMBAR NË QYTETIN E PEJËS/PEÇ.



të vet. Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti egjiptian nuk është edhe aq aktiv sa i përket pjesëmarrjes në nismat e komunës për promovim të dialogut ndërmjet komuniteteve, kryesisht për shkak të marginalizimit dhe mungesës së organizimit të komunitetit. Përkundër zotimeve të komunës për t'iu qasur të gjitha komuniteteve dhe për t'i përfshirë ato, përfaqësuesit e egjiptianëve pohojnë që komuniteti është lënë pas dore. Megjithatë, komuniteti mban raporte me komunitetet tjera në rajon, posaçërisht me shqiptarët. Në rajonin e Prizrenit, egjiptianët vazhdojnë të jenë të integruar mirë dhe marrin pjesë në aktivitetet forMeshkuj dhe joforMeshkuj ndërmjet komuniteteve, derisa kanë marrëdhënie të mira me të gjitha komunitetet në komunat ku jetojnë.

Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit



Tabela 1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti egjiptian
Pejë/Peç	Deçan/ Deçane	Qyteti i Deçanit/Deçane, Dubovik/Dubovik, Pozharë/Požare, Strellc/Streoc, Glllogjan/Glođane, Irzniq/Irznić, Shaptej/Šaptej, Gramaqel/Gramaçel, Baballoq/Babaloc, Pemishte/Pemište.
	Gjakovë/ Đakovica	Rruga: "A.P. Tepelena", "A. Ibra", "S.Pozhegu"; "Mahalla Mulla Jusuf", vendbanimi joformal "Koloni/Kolonia", Brekoc/Brekovac, Hereq/Herec, Skivjan/Skivjane, Rogove/Rogovo, Jahoc/Jahoc, Janosh/Janos, Osek Hil/Osek Hilja, Bec/Bec, Vraniq/Vranic, Palabardh/Paljabarda, Bitesh/Bites, Novoselle e Poshtme/Donje Novo Selo, Planqor/Pljancor, Shishman/Sisman, Nec/Nec. Në qytet: Rruga Fehmi Agani, Rruga A.P.Tepelena, gjithashtu e njohur si Lagjja/Mahalla "Sefa", Rruga Ahmet Koronica, gjithashtu e njohur si Lagjja/Mahalla "Cabrat" Fshatrat: Brekoc/Brekovac, Koronicë/Korenica, Shishman/Šišman, Vraniq/Vranić, Bec/Bec, Jabllanicë/Jablanica, Novosell e Ultë/Donje Novo Selo, Janosh/Janoš, Palabardhë/Paljabarda, Rogovë/Rogovo, Osek Hilë/Osek Hilja, Skivjan/Skivjane, Hereq/Ereć, Planqor/Pljancor, Rakovinë/Rakovina, Ujz/Ujz, Jahoc/Jahoc, Bitesh /Biteš, Qerim/Ćerim, Vendbanimet: Dardania/Piskote, Lagjja/Mahalla Qyl (në qytet), Lagjja/Mahalla Jusufit (në qytet), Ali Ibraj, gjithashtu e njohur si Kolonia
	Istog/Istok	Suvi Lukavac/LLukavc i Thatë, Koš/Kosh, Shalinovicë/Šaljinovica, Kovragë/Kovrage, Banjë/Banja, Banjicë/Banjica, Carallukë/Črni Lug, Čerrcë/Črno, Dobrushë/Dobruša, Dragolevc/Dragoljevac, Drejë/Drenje, Dubovë/Dubove, Gjurakoc/Đurakovac, Istog/Istok, Koshicë/Košica, Kosh/Koš, Kovragë/Kovrage, LLukavc i Begut/Begov Lukavac, LLukavc i Thatë/Suvi Lukavac, Lubovë/Ljubovo, Mirshevinë/Mrševine, Oprashkë/Opraške, Prekallë/Prekale, Saradran/Staredvorane, Serbobran/Srbobran, Shalinovicë/Šalinovica, Tërshovina/Terševina, Tomoc/Tomonce, Veriq/Veriće, Zallq/Žać.
	Klinë/Klina	Binxhë/Binča, Bokshiq/Bokšić, Budisalc/Budisavci, Drenoc/Drenovac, Dresnik/Drnsnik, Jagodë/Jagoda, Krushevë e Madhe/Veliko Kruševo, Krushevë e Vogel/Malo Kruševo, Klinafc/Klinavac, Potërq i Epërm/Gornji Petrić, Rudicë/Rudice, Shtupel/Štupelj, Dollovë/Dolovo, Volljakë/Volujak, Zajm/Zajmovo, Berkovë/Berkovo, Resnik/Resnik, Jashanicë/Jošanica, Grabanicë/Grabanica, Klinë/Klina toën.
Pristinë/ Prishtina	FushëKosovë/ Kosovo Polje	Qyteti i Fushë Kosovës/Kosovo Polje
	Obiliq/ Obilić	Ndërtesat e banimit social I dhe II në Plemetinë/Plemetina dhe vendbanimi "Azotika" në qytetin e Obiliqit/Obilić
Prizren	Malishevë/ Mališevo	Banjë/Banja, Kijevë/Kijevo
	Prizren	Grazhdenik/Graždanik, Atmagjë/Atmađa, Sërbicë e Epërme/Gornja Srbica, Shpinadijë/Špinadija, Vllashnjë/Vlašnja
	Rahovec/ Orahovac	Upper Rahovec/Orahovac, Fortesë/Belacrkva, Krusha e Madhe/Velika Kruša, Bernjake/Brnjaca, Celinë/Celine, Hoçe e Vogël/Mala Hoça
	Suharekë/ Suva Reka	Gelanc/Geljance, Leshan/Lešane, Neprebisht/Neprebište, Reshtan/Reštane, Samadragjë/Samadrade, Studenqan/Studenćane, Shirokë/Široko, Ternë/Trnje

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë²

Pejë/Peç	Burimi	Gjithsej popullsi	Komuniteti	%
Pejë/Peç	Komuna Deçan/Deçane			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 ³	40,640	378	0.9%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991 ⁴	49,000	377	0.7%
	3. Vlerësimi i komunës	-	-	-
	4. Vlerësimi i komuniteteve	60,000	-	-
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave të OSBE-së, 2009 ⁵	40,000	382	0.95%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	35,000	200	0.57%
	Komuna Gjakovë/Đakovica			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	112,888	2,657	2.3%
	3. Vlerësimi i komunës	150,000	7,735	5.15%
	4. Vlerësimi i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave të OSBE-së, 2009	150,000	-	-
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	150,000	-	-
	Komuna Istog/Istok			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	50,104	987	1.9%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	57,261	1,346	2.3%
	3. Vlerësimi i komunës	56,00-64,000	2,000	3.57-3.12%
	4. Vlerësimi i komuniteteve	50,000	1,820	3.64%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave të OSBE-së, 2009	56,000	2,220	3.9%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	56,000	1,840	3.2%
	Komuna Klinë/Klina			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	54,539	906	1.6%
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	52,266	1,278	2.4%
3. Vlerësimi i komunës	55,000 – 58,000	1,200	0.18-0.17%	
4. Vlerësimi i komuniteteve	55,000	1,184	2.15%	
5. Vlerësimi nga profilet e komunave të OSBE-së, 2009	55,000	-	-	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	55,000	1,300	2.36%	
Pristinë/Priština	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	29,805	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	35,570	-	-
	3. Vlerësimi i komunës	50,000	-	-
	4. Vlerësimi i komuniteteve	33,682	115	0.34%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave të OSBE-së, 2009	40,000	200	0.50%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	40,000	115	0.28%
	Komuna Obiliq/Obilić			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	26,595	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	31,627	-	-
	3. Vlerësimi i komunës	32,000	-	-
	4. Vlerësimi i komuniteteve	26,000	53	0.20%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave të OSBE-së	30,000	53	0.18%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	30,000	53	0.18%

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijë të moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijë që vijnë në arsimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijë që nuk vijnë në arsimin e obligueshëm (6-15)	Moshë pune – të punësuar (16-65)	Moshë pune – të papunë (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë
Pejë/Peç	Deçan/Deçane	Meshkuj		15		10	58		
		Femra		16		1	84		
		Gjithsej		31		11	142		
	Gjakovë/Đakovica	Meshkuj	520	145	430	90	2,700	300	
		Femra	552	105	500	50	2,000	350	
		Gjithsej	1,072	250	930	140	4,700	650	
	Istog/Istok	Meshkuj		239		33	104		
		Femra		174		15	59		
		Gjithsej	172	413		48	163	123	
	Klinë/Klina	Meshkuj		334					
		Femra		147					
		Gjithsej		481					
	Gjithsej në rajon		1,244	1,144	930	199	5,005	773	
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i marrë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.									
Pristinë/Priştina	Fushë Kosovë /Kosovo Polje	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	10	20	7	2	74	2	
	Obiliq/Obilić	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	4	6	2	-	40	1	
Gjithsej në rajon	168	14	26	9	2	114	3		
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i marrë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.									

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë

Pejë/Pec	Komuna Deçan/Deçane	
	1	
	2	Sefadin Sadriaj, kryesues i komitetit për komunitete
	3	
	4	
	5	Qamil Hoti, lider i komunitetit në fshatin Pemishte/Pemište
	6	
	7	
	Komuna Gjakovë/Đakovica	
	1	IRDK Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
	2	Bislim Hoti, anëtar i kuvendit komunal (IRDK) Nexhib Qehaja, kryesues i zyrës komunale për komunitete Kapllan Krshi, zyra komunale për komunitete Bashkim Kurti, zyra komunale për komunitete
	3	OJQ "Prosperiteti " OJQ "Hamdi Vraniqi" OJQ "SHEK" OJQ "RAE" OJQ "BREVIS"
	4	
	5	Gezim Xaja, fshati Brekovc/Brekovac Nevruz Tafoshi, fshati Piskotë/Piskote Pamë Pamaj, fshati Skivjan/Skivjane Bajram Sylaj, fshati Planqor/Plancore Xhavit Dana, rruga Qabrati Skender Arbuzi, rruga Qerimi
	Komuna Istog/Istok	
	1	IRDK Iniciativa e Re Demokratike e Kosoves Fazli Stollaj, anëtar i kuvendit komunal
	2	Bajram Qelaj, kryesues i zyrës komunale për kthim Muhamed Maleshaj, asistent, zyra komunale për kthim
	3	OJQ "Vizioni 02", që përbëhet kryesisht nga të rinjtë romë dhe egjiptianë nga Istogu/Istok, përqendrohet/është e specializuar në projekte për fëmijë dhe projekte shumetnike të përkrahura financiarisht nga donatorë të ndryshëm.
	4	
	5	Fazli Stollaj, zëvendëskryesues për komunitete Bajram Qelaj, zyra komunale për kthim
	6	
	7	
	Komuna Klinë/Klina	
	1	
	2	Një egjiptian në komunë Një egjiptian në policinë e Kosovës Një egjiptian në gjykatën komunale Tre egjiptianë në sistemin e arsimit Një egjiptian në shërbimin e doganës (Pejë/Pec)
	3	
	4	
	5	Sahit Balijsa, lider komunal
6		
7		

Pristinë/Priština	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje	
	1	IRDK Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
	2	Bedri Mustafa, anëtar i kuvendit komunal dhe komitetit për komunitete
	3	OJQ Qendra për bashkëpunim dhe integrim "Fidan Lahu" mbledh organizata të shoqërisë civile të komuniteteve egjiptian dhe ashkali me aktivitete që përqendrohen në arsim, shëndetësi, rini dhe gra.
	4	
	5	Bedri Mustafa, lider i partisë IRDK për Fushë Kosovë/Kosovo Polje
	6	
	7	
	Komuna Obiliq/Obilić	
	1	IRDK Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
	2	
	3	
	4	
	5	Bajrush Berisha, lider i komunitet ashkali që përfaqëson edhe komunitetin egjiptian
6		
7		

1 Të dhënat e zbërthyer për secilin komunitet nuk janë konsistente në komunat e Kosovës. Vlerësimi i numrit të popullsisë në Aneksë ofron të dhëna të tilla sa herë që është e mundur dhe kjo është e shënuar qartë.

2 Të dhënat për popullsinë në pjesët 3, 4, 5 dhe 6 janë mbledhur nga ekipet e OSBE-së në terren në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarët komunalë në mars-prill 2010.

3 Ju lutemi të keni parasysh që regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 përfshinte vetëm komunitetin rom. Prandaj, të dhënat e ofruara mund të përfshijnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Gjithashtu, është e mundshme që disa egjiptianë u regjistruan si pjesëtarë të komuniteteve tjera ose nën kategorinë "të tjerë".

4 Ju lutemi të keni parasysh që regjistrimi i popullsisë në vitin 1991 përfshinte vetëm komunitetin rom. Prandaj, të dhënat e ofruara mund të përfshijnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Gjithashtu, është e mundshme që disa egjiptianë u regjistruan si pjesëtarë të komuniteteve tjera ose nën kategorinë "të tjerë".

5 Profilet e komunave të vitit 2009 nuk ofruan të dhëna të zbërthyer për komunitetin egjiptian, kështu që ky numër përfshin komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.



Profili i komunitetit GORANËT

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Historiku

Goranët janë komunitet i myslimanëve sllavë që kanë prejardhje dhe jetojnë kryesisht në komunën malore dhe më jugore të Kosovës të Dragashit/Dragaš (rajoni i Prizrenit) ku ata përbëjnë rreth 30 dhe 40% të popullatës. Komuniteti rrjedh dhe ka marrë emrin sipas zonës së Gorës, që është fjalë sllave dhe që domethënë mal/et. Goranët gjithashtu jetojnë në tri fshatra që kufizohen me ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe me nëntë fshatra, që kufizohen me Shqipërinë.

Goranët flasin gjuhën sllave, dialekt ky i afërt me gjuhën maqedonase. Gjuha e tyre nuk njihet si gjuhë zyrtare në asnjë komunë të Kosovës dhe nuk është paraqitur asnjë kërkesë e tillë për njohje nga ky komunitet. Ndërsa, pjesa dërmuese e goranëve pohojnë që gjuha e tyre amtare është “Našinski” (gjuha jonë), të tjerët pohojnë për gjuhën serbe dhe një numër i vogël për atë boshnjake, si gjuhë të tyre zyrtare.¹ Në kuadër të komunitetit, gjuha amtare e të cilëve është gjuha gorane, ka të atillë që identifikohen si goran dhe një numër i vogël që identifikohen si boshnjak.² Kjo ndarje është shkaktuar pjesërisht nga thellimi i ndarjes politike ndërmjet goranëve dhe boshnjakëve dhe ende mbetet si e tillë meqë veçoria kryesore dalluese ndërmjet tyre është ajo e përkatësisë politike.³ Festimi më i madh vjetor i komunitetit organizohet gjatë Gjurgjevdanit (Dita e Shën Gjergjit) më 5-6 maj.⁴

Që nga fillimi i të 50-tave të hershme, goranët kanë migruar në pjesët tjera të Kosovës, kryesisht për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike në zonën e Gorës dhe në mënyrë që të vazhdojnë arsimin e latë. Numri më i madh i gornavëve ka migruar në rajonin e Prishtinës/Priština, ku shumë prej tyre e cilësojnë veten boshnjak ose nuk e deklarojnë përkatësinë etnike. Ata jetojnë kryesisht në qytetin e Prishtinës/Priština, meqë nuk dihet përqindja e saktë e tyre për shkak të shkallës së lartë të integritimit të tyre me shumicën, ndërsa në Fushë Kosovë/Kosovo Polje ata përbëjnë përafërsisht 0.11% të popullatës së përgjithshme. Në komunën e posa themeluar të Gračanica/Graçanicës, ky komunitet përbën përafërsisht 0.47-0.58% të popullatës së përgjithshme dhe jeton në fshatin Uglar/Ugljare. Komuniteti goran në rajonin e Pejës/Peć është i pranishëm kryesisht në qytetin e Pejës/Peć, duke përfaqësuar rreth 0.10-0.14% të popullatës. Në rajonin e Prizrenit, ky komunitet jeton kryesisht në komunën e Dragashit/Dragaš, që arrin shifrën deri në 31.2% të popullatës. Në komunën e Prizrenit, nuk ekzistojnë të dhëna për popullatën e shpërndarë të këtij komuniteti.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Migrimi ekonomik;
- Qasja në edukim në gjuhën zyrtare serbe të zgjedhur;
- Konflikti politik që ndan komunitetin goran nga komuniteti boshnjak dhe shqiptar, duke ndikuar në pjesëmarrjen e tyre në jetën publike të komunës së Dragashit/Dragaš.

Ndërmjet viteve 1992 dhe 1999, komuniteti goran i ishte lënë komunë e veçantë (Gora), ku ata përbënin popullatën shumicë.

Sipas administratës së UNMIK-ut, Gora bashkohet me rajonin e populluar me shqiptarë të Opojës/Opolje për të formuar komunën aktuale të Dragashit/Dragaš.

Migrimi i vazhdueshëm i këtij komuniteti në shtetet e Evropës Perëndimore është brengë për qëndrueshmëri.

1 Deri në të 90-tat e hershme, referohej gjuha serbo-kroate. Tani, goranët i referohen gjuhës serbe, ndërsa boshnjakët nga zona e Gorës i referohen gjuhës boshnjake. Të dyja këto gjuhë janë adaptim vendor i gjuhës serbo-kroate.

2 Të dy grupet kanë karakteristika të caktuara, si të qenit mysliman, gjuha amtare e të cilëve është gjuhë sllave. Regjistrimi i fundit i popullsisë i vitit 1991 përfshinte kategoritë si goran dhe musliman, por jo boshnjak.

3 E shpjeguar më poshtë, në seksionin 11.

4 Ndryshe nga të krishterët katolik dhe ortodoks, dita e Shën Gjergjit nuk ka konotacion fetar për komunitetin gorn, por shënon fillimin e pranverës. Në qytetin e Prizrenit, fillimi i pranverës ose Karabashi shenjohet gjithashtu me 5-6 maj.

FAMILJA ABAZI, ME ORIGJINË NGA RAPQA/RAPÇA E KOMUNËS SË DRAGAŠ/DRAGASHIT NË RAJONIN E PRIZRENIT, KA FURRË NË QENDËR TË QYTETIT TË PEJËS/PEĆ QE TRI GJENERATA.



1. Punësimi dhe gjendja socio-ekonomike

Gjendja socio-ekonomike e komunitetit goran mbetet relativisht e mirë. Bizneset familjare siç janë ëmbëltoret ose shitoret e ushqimit të shpejtë janë burimi kryesor i të ardhurave të komunitetit. Disa janë të punësuar në sektorin publik. Në komunën e Pejës/Peć, një numër i familjeve gorane kanë biznese private, ndërsa disa të tjerë janë të punësuar në sektorin publik. Për shembull, një goran është i punësuar në objektin e shkollës publike dhe tjetri është i punësuar në Postë dhe Telekomunikacionin e Kosovës (PTK), zyra në qytetin e Pejës/Peć. Megjithatë, për pjesën më të madhe, papunësia është shumë e lartë në mesin e goranëve, të cilët jetojnë në këtë rajon. Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti goran pohon të përballët me diskriminim kur kërkojnë punë në institucionet e Kosovës ose sektorin privat për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Prandaj, ata shpeshherë deklarohen si shqiptarë dhe shfrytëzojnë përparësinë e zotërimit të gjuhës shqipe. Megjithatë, janë dy goran që punojnë si shërbyes civil në komunën e sapo formuar të Gračanica/Gračanicës. Tradicionalisht, komuniteti goran drejton biznese familjare, ndërsa llojet tjera dominuese të punësimit të tyre në rajon përfshijnë bujqësinë dhe punët sezonale ose joforMashkull. Disa goranë janë të punësuar në strukturat administrativo-komunale dhe arsimore të Serbisë. Burimet tjera të të ardhurave për komunitetin goran në rajonin e Prishtinës/Priština janë pensionet dhe mirëqenia sociale nga sistemi i Kosovës dhe i Serbisë si dhe remitancat nga diaspora. Në rajonin e Prizrenit, burimi kryesor i të ardhurave për goranët rrjedh nga bizneset familjare, që u lejon atyre standard të moderuar të jetesës. Si një ndër komunat më të pazhvilluara në Kosovë, komuna e Dragashit/Dragaš në veçanti ka mungesë të mundësive për punësim. Gratë gorane janë të goditura rëndë si rrjedhim i mungesës së kualifikimit përkatës, meqë shumë vajza nuk e vijnë arsimin e mesëm dhe/ose atë universitar. Mungesa e transportit adekuat publik nga kjo komunë rurale në qendrat urbane, ku mundësitë e punësimit mund të jenë më të mëdha, e

pengon edhe më tutje qasjen e barabartë në tregun e punës. Një numër i familjeve sigurojnë të ardhura nga veprimtaritë bujqësore, zakonisht nga blegtoria ose bletaria. Të ardhurat gjithashtu i sigurojnë nga remitanca e diasporës dhe format e ndryshme të asistencës financiare nga institucionet e Republikës së Serbisë, që përfshijnë pagat për ata, të cilët punojnë në arsim, pagat miniMashkull për ish punëtorët e institucioneve shtetërore si dhe format e ndryshme të ndihmës sociale.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Siguria dhe liria e lëvizjes së komunitetit goran në Kosovë mbetet stabile me disa incidente të vogla të raportuara dhe liri të papenguar të lëvizjes në përgjithësi. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti është i integruar mirë. Ata flasin rrjedhshëm gjuhën shqipe, që ua lehtëson ndërveprimin e tyre me institucionet dhe popullatën. Vetëm një zyrtar policor goran është i angazhuar në stacionin policor rajonal të Pejës/Peć. Ky komunitet nuk përfaqësohet në këshillin komunal për siguri në bashkësi në komunën e Pejës/Peć. Gjithashtu, në rajonin e Prishtinës/Priština, ky komunitet është i integruar mirë dhe nuk ka ndonjë brengë rreth sigurisë, ku shpeshherë shfrytëzohet transporti publik dhe ka liri të papenguar të lëvizjes. Nuk ka asnjë zyrtar policor goran në rajon dhe komuniteti nuk përfaqësohet në këshillat komunale për siguri në bashkësi. Përfaqësuesit e komunitetit tregojnë që ka bashkëpunim të mirë ndërmjet komunitetit dhe Policisë së Kosovës.

Në rajonin e Prizrenit, gjendja e sigurisë për komunitetin goran është e mirë në përgjithësi, ndonëse është raportuar për një incident të rëndësishëm në korrik të vitit 2009. Më 20 korrik, në djalë goran bashkë me babanë janë fyer nga një grup i madh shqiptarësh të mbledhur në një festë në qytetin e Dragashit/Dragaš. Pas incidentit, tri partitë politike të komunitetit joshumicë, Koalicioni "VAKAT", Nisma e të Rinjve të Gorës (GIG) dhe Partia e Veprimit Demokratik (SDA) bënë një deklaratë të përbashkët ku dënuan fyerjen, meqë kjo shënjestronte komunitetin goran në Dragash/Dragaš. Komuna,

Sipas Policisë së Kosovës në Dragash/Dragaš, brenga kryesore e komunitetit goran vazhdon të jetë vjedhja e bagëtisë nga kryesit që kalojnë kufirin nga Shqipëria.

Janë dy femra dhe tridhjetë e tetë meshkuj zyrtar policor të angazhuar në tërë Kosovën.



NJË GORANE E MOSHUAR DUKE PRERË DRU NË QYTETIN E DRAGAŠ/DRAGASHIT, KU DIMRAT E FTOHTË E RËNDOJNË EDHE MË TEJ STANDARDIN E ULËT TË JETËS TË NJË PJESE TË MADHE TË KOMUNITETIT.

megjithëkëtë, nuk ka reaguuar. Policia e Kosovës nuk e ka marrë këtë si krim i motivuar etnik dhe nuk ka zbatuar ndonjë qasje informative shtesë të komuniteti goran. Incidenti duket të mos ketë pasur ndikim negativ në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Goranët gëzojnë të drejtën e plotë të lëvizjes në vendin e origjinës dhe në qytetin e Prizrenit dhe udhëtojnë në të gjitha qytetet e mëdha të Kosovës përmes transportit privat ose publik. Megjithatë, ata, me njohje të kufizuar të gjuhës shqipe, ngurrojnë të udhëtojnë në zonat rurale të banuara me shqiptarë. Në rajonin e Prizrenit, prej 743 zyrtarëve policorë, 18 janë goranë. Prej gjithsej 64 zyrtarëve policorë që punojnë në stacionin policor të Dragashit/Dragaš, 15 janë goranë. Veç kësaj, në Stacionin Policor të Prizrenit, prej 210 zyrtarëve policorë në atë stacion, tre janë goran. Të gjithë zyrtarët policor në rajonin e Prizrenit janë meshkuj. Posti më i lartë në rajon, që mbahet nga zyrtari policor goran është posti i Zëvendës Komandantit të Stacionit Policor në Dragash/Dragaš. Dy goranë janë anëtarë të këshillit komunal për siguri në bashkësi në Dragash/Dragaš, ndërsa komuniteti merr pjesë dhe përbën pjesën dërmuese të këshillit lokal për siguri publike të fshatit të banuar me goranë dhe boshnjakë, fshati Kruševë/Krushevë. Mirëpo, forumet e sigurisë nuk mbahen rregullisht.



NJË EKIP I POLICISË SË KOSOVËS NË FSHATIN KRUSHEVË/KRUŠEVO TË KOMUNËS SË DRAGAŠ/DRAGASHIT, KU NJË POLIC SHQIPTAR I KOSOVËS DHE EPRORI I TIJ GORAN PATRULLOJNË SË BASHKU.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Ndërmjet viteve 2000 dhe 2009, UNHCR-i ka regjistruar gjithsej 1,035 të kthyer, persona goran të zhvendosur.

Mungesa e qasjes në punësim, mjetet e jetesës dhe sfida lidhur me zgjidhjen e sistemit arsimor mbeten pengesat kryesore për kthim të qëndrueshëm dhe riintegrim të personave goran të zhvendosur. Brengat rreth sigurisë dhe paqartësia për realizimin afatgjatë ekonomik dhe social i ka detyruar shumë goranë të largohen nga Kosova gjatë dhe pas konfliktit në vitin 1999. Pjesa dërmuese kanë shkuar në Beograd dhe në rajon. Të tjerët kanë migruar në vendet jashtë rajonit, kryesisht në Evropën Qendrore. Këto familje janë kthyer kryesisht në komunën e Dragashit/Dragaš dhe i është siguruar rindërtimi i shtëpive dhe ndihma për gjenerimin e të ardhurave si dhe artikuj ushqimor dhe jo ushqimor nga organizata të ndryshme ndërkombëtare. Sipas

Komisionerit të Lartë për Refugjatë të Kombeve të Bashkuara (UNHCR-it), shifrat për vitin 2009 nuk tregojnë ndonjë rritje të madhe të numrit të kthimeve krahasuar me vitin 2008; në vitin 2009 janë kthyer 90 individë përkundër vitit 2008 që janë kthyer 85.⁵ Shifrat e kthimit për janar-prill 2010 tregojnë që 37 të zhvendosur goranë janë kthyer nga rajoni këtë vit, në mënyrë spontane ose duke u ndihmuar. Nuk ka raporte zyrtare për zhvendosjen e goranëve në rajonin e Pejës/Pec gjatë ose pas konfliktit 1999 dhe ky komunitet nuk konsiderohet grup potencial për kthim. Megjithatë, sipas burimeve të komunitetit, në vitin 2009 një numër i familjeve shkuan në Bosnjë e Hercegovinë, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe shtetet e Evropës Perëndimore për të kërkuar mundësi punësimi. Edhe pse, nuk mund të merren shifra të sakta, pjesa dërmuese e komunitetit goran në rajonin e Prishtinës/Priština u larguan në rajone të ndryshme në Serbi, në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe në vendet tjera evropiane, madje edhe në Australi. Veç kësaj, një numër i konsiderueshëm i goranëve shkuan në Gračanica/Gračanicë. Goranët e zhvendosur në rajonin e Prishtinës/Priština nuk marrin pjesë në asnjë organ komunal për kthim ose forume dhe nuk marrin asnjë ndihmë.

Sipas zyrtarit komunal për kthim të komunës së Dragashit/Dragaš, në rajonin e Prizrenit ka përfunduar rindërtimi i tetë shtëpive të goranëve gjatë vitit 2009 nga Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP), ndërsa UNHCR-i dhe Këshilli Danez për Refugjatë ka siguruar materialet për rindërtim dhe riparimin e 19 shtëpive shtesë. Për më tepër, në vitin 2009, 27 të kthyer goran kanë pranuar donacione në artikuj ushqimor dhe mobile nga UNHCR-i. Ata gjithashtu kanë pranuar mbështetje financiare në shkallë të ultë për gjenerim të të ardhurave dhe mjete, të dhuruara nga Mercy Corps dhe Këshilli Danez për Refugjatë. Përfaqësuesit e personave të zhvendosur goran nuk marrin pjesë në grupin punues komunal për kthim në Dragash/Dragaš, ndër të tjera për shkak të vetë organizimit të dobët në vendet e tyre të zhvendosjes. Rrjedhimisht, ka mungesë komunikimi ndërmjet autoriteteve të komunës së origjinës dhe personave të zhvendosur. Përkundër faktit, që zyrtari komunal për komunitete i përket komunitetit goran, goranët e zhvendosur nuk janë përfshirë në hartimin e strategjisë komunale për kthim ose ndonjë aktivitet tjetër për kthim i udhëhequr nga komuna. Megjithatë, në fund të vitit 2009, zyrtari komunal për kthim ka marrë pjesë në vizitën shko-dhe-informohu në Beograd, ku i ka ikurajoi 30 goran të zhvendosur për tu kthyer, duke i informuar për ndihmën që kanë në dispozicion. Strategjia komunale për kthim e Dragashit/Dragaš për vitin 2010 parasheh ndërtimin e 10 shtëpive, riparimin e 20 shtëpive, 30 projekte biznesi dhe projekte të ndryshme të infrastrukturës me përqendrim tek të kthyerit. Të gjitha këto do të financohen nga organizata ndërkombëtare, qeveria e Kosovës, komuna e Dragashit/Dragaš dhe banorët. Goranët vazhdojnë të kthehen me dhunë, kryesisht nga Evropa Perëndimore. Megjithatë, shumica e tyre nuk duan të regjistrohen në zyrën komunale për komunitete, ngase nuk mund të marrin asnjë ndihmë dhe shumë prej tyre mendojnë të largohen përsëri për vendet e Evropës Perëndimore. Goranët e riatdhesuar pranojnë pak ndihmë dhe pjesa më e madhe e ndihmës sigurohet nga agjencia ndërkombëtare, meqë komuna nuk ka fonde të ndara për ata. Strategjia për Riintegrim të Personave të Riatdhesuar nuk është duke u zbatuar në Dragash/Dragaš.

Sipas të dhënave të zyrës komunale për komunitete, në vitin 2009 dhe në fillim të vitit 2010, 22 familje (46 anëtarë të familjes) janë kthyer me forcë në komunën e Dragashit/Dragaš.

Një prej problemeve kryesore që përballen goranët e riatdhesuar është mungesa e mundësive për punësim në Dragash/Dragaš. Të tjerët sfidohen me mungesën e zgjidhjes së sistemit arsimor për fëmijët e tyre.

5 Zyra e Shefit të Misionit të UNHCR-it në Prishtinë/Priština Azhurnuar në fund të prillit 2009.

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Komuniteti i shfrytëzon edhe shërbimet e mbështetura nga Serbia edhe shërbimet e institucioneve të Kosovës, ndonëse ofrimi falas i kujdesit shëndetësor nga i pari vazhdon të jetë nxitje për shërbimet e Kosovës. Në rajonin e Pejës/Peć, goranët mbështeten në shërbimet shëndetësore dhe arsimore të ofrohen vetëm nga institucionet e Kosovës. Në Prishtinë/Priština, ky komunitet i shfrytëzon shërbimet si nga institucionet e drejtuara nga Serbia ashtu edhe ato të Kosovës. Disa goran pranojnë paga miniMashkull nga kompanitë në pronësi publike, ku ata punonin para konfliktit të vitit 1999, përveç ndihmës sociale dhe pensioneve që i marrin nga Beogradi. Në Prizren, komuniteti gjithashtu shfrytëzon dy sistemet, atë të Kosovës dhe të drejtuar nga Serbia. Në Dragash/Dragaš, komuniteti mbështetet shumë në të ardhurat që ia jep Serbia. Shërbimet shëndetësore e arsimore të financuara nga Serbia administrohen nga komuna e Gorës, që mbështetet nga Republika e Serbisë, e cila, ndonëse nuk është në gjendje të ofrojë mjaft investime infrastrukturore të nevojshme- ushtron ndikim të madh politik mbi zgjidhjet e komunitetit sa i përket integritet të pjesës dërmuese të popullsisë (Shih më poshtë pjesën 14).

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Nuk është jo e zakonshme për goranët që të regjistrohen njëkohësisht në institucionet e kosovare dhe serbe në mënyrë që të përfitojnë nga shërbimet e ofruara nga të dy sistemet.

Komuniteti vazhdon t'i shfrytëzojë shërbimet komunale dhe shërbimet publike të ofruara nga institucionet e Kosovës dhe të Serbisë. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti goran ka qasje në shërbime të siguruara nga institucionet e Kosovës, ngjashëm me popullatën shqiptare, për shkak të shkallës së lartë të integritet të tyre dhe rrjedhshmërisë së tyre në gjuhën shqipe. Ata kanë qasje të lirë në objektet arsimore dhe shëndetësore si dhe në shërbimet publike dhe komunale. Ndonëse, shërbimet janë në dispozicion për komunitetin në gjuhën serbe, komuniteti priret ta përdorë gjuhën shqipe në ndërveprim me institucionet e Kosovës. Në rajonin e Prishtinës/Priština, të gjitha vendbanimet ku jeton ky komunitet ka qasje në shërbimet themelore publike. Komuniteti goran mund të ketë qasje potenciale në shërbimet e ofruara nga institucionet e Kosovës, megjithatë pjesa dërmuese e tyre zgjedhin qendrat dhe shërbimet e financuara nga Serbia. Goranët në Gračanica/Graçanicë dhe Fushë Kosovë/Kosovo Polje kanë përfitur nga marrëveshjet kolektive të ofruara nga Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u) për komunitetet joshumicë, të cilët i kanë rritur borxhet.

Në rajonin e Prizrenit, komuniteti goran ka qasje në të gjitha shërbimet e ofruara nga institucionet e Kosovës. Vendbanimet e banuara me goranë kanë sistem funksional të kanalizimit dhe ujit, për të cilat nuk paguajnë, meqenëse këto sisteme mirëmbahen nga vetë fshatarët. Në shumicën e fshatrave, këto sisteme, veçanërisht sistemi i furnizimit me ujë janë rindërtuar viteve të fundit. Sistemet e parindërtuara janë të vjetra por ende funksionale. Rrjeti elektrik në këtë zonë është

funksional por ka nevojë për riparim. Në disa fshatra, tensioni i rrymës është shumë më i ultë se normalja. Punët në rrjetin elektrik janë kryer vetëm në disa fshatra. Përkundër disa pilot projekteve në të kaluarën, nuk kryhen shërbimet për grumbullimin e mbeturinave në fshatrat e banuara me goran në komunën e Dragashit/Dragaš, kjo raportohet sepse komuniteti nuk ka ndërmend të paguaj për to. Komuniteti goran gjithashtu ndikohet nga ndërprerjet e rrymës për shkak të borxheve të grumbulluara ndaj KEK-ut, meqenëse komuniteti refuzonte t'i paguajë faturat e rrymës që përmbanin tarifën prej 3.50 euro për transmetuesin publik të Radio Televizionit të Kosovës (RTK), meqë nuk e mbulon këtë zonë të lartë malore⁶.

Komuna e Dragashit/Dragaš dhe KEK-u kanë arritur marrëveshje verbale në janar të vitit 2010 për ngrirjen përkohshme të faturave të rrymës të grumbulluara me vite të tëra. Sipas kësaj marrëveshjeje, çdo vendbanim në komunë duhet të dorëzojë listën e të gjithë konsumuesve të regjistruar të rrymës, sasinë përkatëse të borxhit të grumbulluar nga secili konsumatorë dhe nënshkrimet e tyre, duke kërkuar lirin nga borxhet. Të gjitha këto informata duhet të përdoren për paraqitjen e rastit në gjykatë, që të lirohen këta goran nga borxhet e mëparshme. Për sigurimin e tërë kësaj, të gjithë njerëzit janë përfshirë në këtë listë, zyra vendore e KEK-ut duhej të ia dorëzonte zyrës komunale për komunitete emrat e të gjithë shfrytëzuesve të rrymës, si bazë për grumbullimin e nënshkrimeve. Megjithatë, drejtori vendor i KEK-ut në Dragash/Dragaš vazhdimisht dështonte ta dorëzonte këtë listë përkundër kërkesave të përsëritura të zyrës komunale për komunitete, dhe në këtë mënyrë bënte parandalimin e grumbullimit të nënshkrimeve dhe paraqitjen e rastit.

6. Qasja në shërbime dhe mirëqenie sociale

Komuniteti goran vazhdon të përfitojë nga ndihma e ofruar si nga institucionet e Kosovës ashtu edhe nga ato të drejtuara nga Serbia. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti goran gëzon qasjen e njëjtë si shqiptarët në të gjitha shërbimet sociale të ofruara nga institucionet e Kosovës. Megjithatë, duke e pasur parasysh nivelin e punësimit në sektorin privat dhe/ose pronësinë e bizneseve private të shkallës së ultë, vetëm një pjesë e vogël e komunitetit aplikon dhe/ose përfiton nga sistemi i mirëqenies sociale. Në rajonin e Prishtinës/Prishtina, komuniteti vazhdon të gëzojë qasje në shërbime dhe ndihma si nga institucionet e Kosovës ashtu edhe nga ato të Serbisë. E njëjta gjë është e vërtetë edhe për rajonin e Prizrenit, ku në komunën e Dragashit/Dragaš, gjithsej 326 familje gorane pranojnë ndihmë nga institucionet e Serbisë dhe 109 pranojnë ndihmë sociale nga institucionet e Kosovës. Veç kësaj, familjet, fëmijët e të cilave vijnë shkollimin në përputhje me kurrikulat e Serbisë marrin shtesa për fëmijë. Të moshuarit dhe gratë pa përkujdesje përballen me më shumë vështirësi për qasje në shërbime sociale se goranët tjerë, për shkak të nivelit të ulët arsimor në përgjithësi, vështirësitë lidhur me udhëtimin në qytetin e Dragashit/Dragaš nga fshatrat ose pamundësisë së tyre që t'i kuptojnë si duhet kriteret dhe procedurat e aplikuara për ndihmë sociale.

Komuniteti goran në Dragash/Dragaš ka refuzuar për ca kohë të paguajë faturat e rrymës meqë përfshinin tarifën 3.50 euro për transmetuesin e radio televizionit të Kosovës (RTK-në) pasi që nuk kishte transmetim në këtë zonë të lartë malore.

Një numër i goranëve në rajonin e Prizrenit e perceptojnë përjashtimin e tyre nga asistencë sociale si diskriminim etnik në bazë të afritë së tyre me institucionet e drejtuara nga Serbia. Qendra për punë sociale thotë, që kriteret e përzgjedhjes zbatohen në mënyrë të drejtë pavarësisht nga anëtarësia e komunitetit.

⁶ Gjykata kushtetuese në tetor 2009 i rekomandoi Kuvendit të Kosovës të shqyrtojë dispozitën ligjore sipas të cilit tarifa për shërbimin e transmetimit publik inkasohet përmes faturave të rrymës. Kjo praktikë është ndërprerë dhe komuniteti ka rifilluar pagesat.

7. Qasja në pronë dhe banim

Shumë prona private dhe komerciale në pronësi të komunitetit goran janë uzurpuar që nga konflikti i vitit 1999. Komuniteti kishte të drejtë vetëm të dorëzojë kërkesat e tyre për riposedim të pronës së paluajtshme Agjencisë Kosovare të Pronës, në mars të vitit 2006. Ky afat skadoi në dhjetor të vitit 2007. Në rajonin e Pejës/Peć dhe Prishtinës/Priština, komuniteti goran në përgjithësi gëzon qasjen në pronë dhe/ose banim pa u përballur me asnjë pengesë ose diskriminim, ndonëse udhëheqësit e komunitetit kanë raportuar për raste të uzurpimeve ilegale të pronave private dhe komerciale. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti gëzon qasje dhe shfrytëzim të papenguar të pronës së tyre private dhe komerciale, edhe pse mbi njëqind prona komerciale në pronësi të goranëve nga Dragashi/Dragaš mbeten të uzurpuara ilegalisht në rajonet tjera të Kosovës. Sipas zyrës komunale për komunitete në Dragash/Dragaš, janë parashtruar një numër i kërkesave për riposedim, parashtruesve të kërkesave u janë dhënë numra të rasteve, por shumica prej tyre kanë mbetur të pazgjidhura. Komuniteti goran brengoset gjithashtu që privatizimi i ndërmarrjes në pronësi shoqërore Sharrprodhimi/Šarproizvodi në Dragash/Dragaš do të ndalojë kullotjen e bagëtisë, e cila ndonëse sipas zakonisht, mbetet një burim i rëndësishëm i të ardhurave për komunitetin. Pjesa dërmuese e këtyre kullotave është në pronësi të ndërmarrjes dhe privatizimi i saj nuk do ta lejojë komunitetin të përfitojë nga këto burime natyrore. Në bazë të nismës së zyrës komunale për komunitete, kuvendi komunal i Dragashit/Dragaš ka miratuar vendimin në gusht të vitit 2009, për të rikthyer pronësinë e kësaj prone. Vendimi është rikonfirmuar në maj të vitit 2010, përkundër kërkesës së Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal për shqyrtimin e këtij vendimi.

8. Qasja në arsim

Pjesa dërmuese e komunitetit që jeton në komunën e Dragashit/Dragaš identifikohet si goran dhe vijojnë sistemin arsimor të financuar nga Serbia. Ata, të cilët identifikohen si boshnjak vijojnë sistemin arsimor të Kosovës në gjuhën boshnjake.

Shumica e goranëve në komunën e Dragashit/Dragaš preferojnë t'i regjistrujnë fëmijët e tyre në shkollat e drejtuara nga Serbia, ku ligjërohet në gjuhën serbe. Kurrikulat në gjuhën serbe, tekstet shkollore dhe arsimi nuk janë akoma në dispozicion në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës. Për më tepër, kjo situatë u mundëson nxënësve më shumë opsione për qasje në studime universitare për shkak të cilësisë më të mirë në përgjithësi të sistemit arsimor serb. Shumica e fëmijëve goranë jetojnë dhe mësojnë në komunën e Dragashit/Dragaš, që ndodhet në rajonin e Prizrenit. Ata janë bërë gjithnjë e më shumë subjekt i betejës eskaluese për autoritet, që mbizotëron ndërmjet dy sistemeve shkollore të zhvilluara në Kosovë, veçanërisht shtytja nga institucionet e Kosovës për t'i integruar nxënësit goran dhe personelin mësimdhënës në sistemin arsimor të Kosovës.

Në rajonin e Pejës/Peć dhe Prishtinës/Priština, studentët goran, për shkak të numrit të tyre të vogël në përgjithësi, integrohen në sistemin arsimor të Kosovës, ose në gjuhën boshnjake, ku ekzistojnë këto orë, ose më rrallë në gjuhën shqipe. Fëmijët parashkollor dhe klasat prej klasës së parë deri në klasën e katërt, veç disa përjashtimeve, kanë qasje në sistemin arsimor serb, në fshatrat e tyre ku jetojnë.⁷ Ata që



NXËNËSIT GORANË VIJOJNË MËSIMIN NË SHKOLLËN FILLORE "5 TETORI" NË GLOBOÇICË/GLOBOÇICA SIPAS KURRIKULËS SË REPUBLIKËS SË SERBISË.

vijojnë klasën e pestë deri në klasën e nëntë, shkojnë në shkollë të përbashkët me fshatrat fqinje, ndërsa ka një shkollë në fshatin Mlike/Mlikë që ofron arsimin e mesëm në gjuhën serbe. Disa fëmijë goranë, megjithatë më mirë zgjedhin që të vijojnë arsimin e mesëm sipas kurrikulës së Kosovës në gjuhën boshnjake në qytetin e Dragashit/Dragaš. Nxënësit goranë të shkollës së mesme dhe disa nxënës të shkollës fillore mbështeten në shërbimet e transportit të ofruara komuna e Gorës e që mbështetet nga Republika e Serbisë dhe nga qeveria serbe. Studentët goranë zgjedhin të vijojnë arsimin terciar në Universitetin e Mitrovicës/Mitrovicës Veriore ose në rajon. Shumë vajza gorane nuk e vazhdojnë shkollimin përveç arsimit të detyrueshëm si rezultat i dominimit të traditave të komunitetit, kushteve të rënda ekonomike dhe lirisë së kufizuar të lëvizjes për shkak të mungesës së transportit. Në komunën e Prizrenit, shumica e nxënësve goranë e vijojnë arsimin në gjuhën boshnjake dhe në disa raste në gjuhën turke ose shqipe. Kjo ndodh për shkak të mungesës së arsimit në gjuhën serbe, por gjithashtu bazohet edhe në zgjidhjen e prindit. Mësimdhënësit dhe nxënësit goranë në shkollën fillore Fetah Sylejmani/Nebojaa Jerkovic në qytetin e Dragashit/Dragaš vazhdojnë të vijojnë shkollimin sipas kurrikulave serbe në godinat rurale, që nga shkuarja e tyre në shkollat e mëparshme në vitin 2008 pas një përpjekjeje të autoriteteve komunale për t'i integruar në sistemin e Kosovës. Përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të OSBE-së për të lehtësuar zgjidhje të qëndrueshme në bazë të drejtave, autoritetet komunale të Dragashit dhe udhëheqësia shkollës me kurrikula serbe nuk ia kanë dalë ende të arrijnë marrëveshje në kombinimin e dy sistemeve arsimore në objektet e shkollës fillore Fetah Sylejmani/Nebojaa Jerkovic.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Komuniteti goranë gëzon qasje në shërbimet shëndetësore që ofrohen nga institucionet e Kosovës dhe në ato të financuara nga Serbia. Në qytetin e Pejës/Peć, goranët mbështeten në shërbimet shëndetësore publike, që ofrohen nga institucionet e Kosovës dhe të folurit e rrjedhshëm në gjuhën shqipe ia lehtëson qasjen e plotë të tyre në

⁷ Nxënësit nga qyteti i Dragashit/Dragaš dhe Zlipotok/Zlipotokut duhet të vijojnë shkollën në fshatrat fqinje të Ljuboviate/Lubevishtës dhe Globoçica/Glloboçicës.

këto shërbime. Në rajonin e Prishtinës, komuniteti goran zakonisht i qaset institucioneve të drejtuara nga Serbia, për të cilat shërbime janë regjistruar në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje dhe Gračanica/Graçanicës. Ky shërbim është falas. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti goran ndihet i lirë t'i shfrytëzojë shërbimet mjekësore të Kosovës në Dragash/Dragaš dhe Prizren. Mungesa e shkathtësisë për gjuhë shqipe perceptohet nga shumë goran si detyrim për shfrytëzimin e spitaleve në Prishtinë/Priština. Goranët, të cilët pranojnë ndihmë sociale, lirohen nga pagesa për shërbime shëndetësore në Dragash/Dragaš. Të moshuarit dhe gratë pa përkujdesje nga komuniteti mund të kenë vështirësi për qasje në qendrat shëndetësore ngase nevojitet transporti për qasje në qendrat shëndetësore që ndodhen larg nga fshatrat. Megjithatë, qendra kryesore shëndetësore në Dragash/Dragaš i përgjigjet thirrjeve të banorëve dhe dërgon ambulancën apo mjekun me kërkesën e tyre. Është vetëm një gjinekolog në dispozicion, në qendrën kryesore shëndetësore të Dragashit/Dragaš, i cili nuk i viziton qendrat shëndetësore në terren.

10. Qasja në drejtësi

Komuniteti vazhdon të gëzojë qasjen e papenguar në gjykata dhe shërbime juridike. Në rajonin e Pejës/Peć, nuk ka shumë brenga të paraqitura nga ana e komunitetit sa i përket qasjes në drejtësi, ndonëse nuk ka asnjë goran që punon në sistemin e drejtësisë në rajon. Në rajonin e Prishtinës/Priština, goranët kanë qasje në drejtësi, ndonëse vetëdijesimi i kufizuar i tyre për të drejtat dhe procedurat e pengojnë aftësinë e tyre që t'i qasen drejtësisë në mënyrë të barabartë. Zotërimi i gjuhës shqipe ua lehtëson këtë qasje, ndonëse komuniteti nuk përfaqësohet në gjyqësi. Zakonisht, ata shfrytëzojnë shërbimet juridike falas që ofron gjykata. Ankesat lidhur me kohëzgjatjen e procedurave dhe zbatimin e ngadalshëm të vendimeve janë bërë, të cilat i ndajnë me komunitetet tjera. Në rajonin e Prizrenit, gjykata komunale e Dragashit/Dragaš siguron përkthimin në gjuhën serbe për komunitetin goran. Gjykata komunale në Dragash/Dragaš ka punësuar pesë goran anëtarë të personelit mbështetës dhe dy goran, anëtarë të personelit janë punësuar në gjykatën për kundërvajtje.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Nisma e qytetarëve të Gorës (GIG) përfaqëson vetëm interesat politike të goranëve. Megjithatë, shumë goran gjithashtu e mbështesin dhe figurojnë lartë në radhët e Partisë Boshnjake për Veprim Demokratik (SDA) dhe në Partinë Demokratike Vatan, që është pjesë e koalicionit boshnjak (VAKAT).

Komuniteti goran përfaqësohet me dy deputetë në Kuvendin e Kosovës. Nisma e Qytetarëve të Gorës (GIG) ka një ulëse, ndërsa deputeti tjetër goran i Kuvendit përfaqëson interesat e komunitetit përmes Partisë Boshnjake për Veprim Demokratik (SDA). Veç kësaj, të dy përfaqësuesit goran janë emëruar në këshillin konsultativ të komunitetit, një organ këshillëdhënës që vepron nën mandatin e Presidentit të Kosovës. Disa shërbyes civil janë punësuar në ministritë e Kosovës. Kjo pasqyrë në nivelin lokal është e shumëllojshme. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti goran nuk përfaqësohet në degët ekzekutive ose legjislative, as nuk është i punësuar në shërbimin civil të komunës. Ndryshe nga kolegët e tyre në Prizren, ata janë mbajtur larg nga pjesëmarrja publike, politike dhe qytetare. Nuk ka media elektronike ose të shkruara të veçanta për komunitetin goran në këtë rajon. Në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk ka përfaqësim

të goranëve në degët legjislative ose ekzekutive të komunave, ku banon ky komunitet. Një goran është i punësuar si sekretar i kuvendit komunal në Gračanica/Graçanicë. Komuna e posa themeluar nuk ka realizuar aktivitete informative, duke shënjestruar veçanërisht goranët si dhe komuniteti nuk është i angazhuar në mënyrë aktive në nismat e shoqërisë civile për shkak të numrit të vogël dhe vetorganizimit të tyre. Nuk ka ndonjë media të veçantë elektronike ose të shkruar në dispozicion në këtë rajon.

Komuniteti goran luan një rol relativisht aktiv në jetën publike të komunave të Prizrenit dhe Dragashit/Dragaš, në rajonin e Prizrenit. Në Dragash/Dragaš, dy goran janë zgjedhur në kuvendin komunal prej 27 ulëseve dhe tre marrin pjesë në komisionin për komunitete, që përbëhet prej nëntë anëtarëve. VAKAT-i, partia më e madhe joshumicë, së cilës i përkasin disa goran, është partner koalicioni i qeverisë komunale të udhëhequr nga Partia Demokratike e Kosovës(PDK). Megjithëse, vetëm pjesëtarët boshnjakë kanë pozita të rëndësishme ekzekutive. Një boshnjak, gjithashtu është emëruar si zëvendës kryesues i kuvendit komunal për komunitete dhe tjetri si zëvendës kryetar për komunitete, si rezultat i marrëveshjes së arritur ndërmjet goranëve dhe boshnjakëve. Zyra komunale për komunitete përfshin një goran, ndërsa është edhe një goran tjetër i punësuar në zyrën komunale për kthim. Komuniteti ka shprehur kënaqësinë për të dy mekanizmat për mbrojtjen e komunitetit. Për më tepër, komuniteti goran dhe boshnjak përbëjnë 32 për qind të shërbyesve komunal. Megjithëse, përfaqësohet vetëm një femër gorane, fakt ky që i atribuohet mungesës së interesimit të grave të këtij komuniteti. Komuna rrallëherë organizon aktivitete informative për komunitetin ose mban konsultime publike, si dhe nuk e mbështetë pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile të komunitetit në çështjet publike. Aktivitetet informative publike zakonisht organizohen nga zyrtarët komunal për komunitete, dike iu adresuar publikut përmes radios. Komunitetet mund të informohen vetëm përmes radio stacioneve. Radio Gora , e themeluar në vitin 2007, rishtazi është zgjeruar duke mbuluar tërë zonën e Gorës. Ajo transmeton programe, duke përfshirë informatat nga Radio Evropa e Lirë, në gjuhët zyrtare të komunës. Radio Bambusi operon vetëm në Restelica/Restelicë, fshat i banuar me goran dhe boshnjak dhe programet mbulojnë vetëm lajmet lokale. Të dy radiostacionet financohen kryesisht (80%) nga donatorët, ndërsa tarifat e reklamimit kontribuojnë deri në 20% të fondeve të përgjithshme. Radio stacioni në pronësi të shqiptarit nga Dragashi/Dragaš gjithashtu transmeton program në gjuhën e komunitetit në baza ditore. Komuniteti goran në komunën e Prizrenit shoqërohet gjerësisht me atë, që komuniteti boshnjak atje është aktiv në çështjet publike, dhe përfaqësohet mirë si në degët legjislative ashtu edhe në atë ekzekutive.

12. Përdorimi i gjuhës

Komuniteti goran e flet dialektin sllav Naainski privatisht, ndërsa në sferën publike ata e përdorin ose gjuhën shqipe, serbe ose boshnjake, varësisht nga rajoni dhe/ose komuna ku ata jetojnë. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti goran vazhdon të përdorë gjuhën boshnjake⁸ në publik, dialekti Naainski përdoret privatisht,

Goranët në Dragash/Dragaš pranojnë vetëm transmetim medial privat apo publik përmes radios, meqë zona e lartë malore nuk mbulohet ende nga Radio televizioni i Kosovës (RTK-ja) korporata e transmetimit publik¹.

Në kuadër të fushës së projektit rajonal të OSBE-së “Transparenca e shtuar në komunat e rajonit të Prizrenit , zyrtarët komunal të Dragashit/Dragaš kryen vizita në terren në tri fshatra të banuara me goran.

⁸ Sipas përfaqësuesve të komunitetit goran të intervistuar nga OSBE-ja, komuniteti goran në qytetin e Pejës/Peć është i afërt me komunitetin boshnjak dhe ndajnë brengat dhe përvojat e njëjta lidhur me përdorimin e gjuhës.

¹ Shih lartë seksionin 5.

Në rajonet e Prizrenit dhe Pejës/Peć ku komuniteti shoqërohet ngushtësisht me boshnjakët, goranët, gjithashtu përdorin gjuhën boshnjake. Të dyja këto komunitete ndajnë brengat dhe përvojat e përbashkëta sa i përket përdorimit të gjuhës.

ndërsa, gjuhën shqipe e përdorin në të folur në ndërveprimet e tyre me komunitetin shqiptar, veçanërisht në korrespondencë me institucionet. Studentët goran, një numër i vogël i të cilëve jetojnë në rajonin e Prishtinës/Priština janë në përgjithësi të integruar në sistemin arsimor të Kosovës dhe vijojnë shkollimin në gjuhën shqipe, vetëm disa prej tyre vijojnë mësimet në gjuhën boshnjake. Në komunën e Dragashit/Dragaš, në rajonin e Prizrenit, përveç dy gjuhëve zyrtare (gjuhës shqipe dhe serbe), gjuha boshnjake është gjuhë zyrtare në nivel komunal, gjë e cila rregullohet edhe me statutin komunal. Shumica e dokumenteve komunale, duke përfshirë vendimet, rregulloret dhe procesverbalet e mbledhjeve të komunës, hartohen dhe mbledhjet mbahen si në gjuhën shqipe ashtu edhe në atë serbe dhe/ose boshnjake. Për më tepër, në komunën e njëjtë, mbishkrimet zyrtare të vendosura jashtë dhe brenda ndërtesës komunale janë në të gjitha gjuhët zyrtare si parashihen me ligj⁹. Megjithatë, zyra komunale për komunitete është e mendimit që gjuha serbe dhe boshnjake, veçanërisht në dokumentet e shkruara dhe informim publik respektohet më pak nga institucionet publike siç janë Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK-ja) dhe Korporata Energjetike e Kosovës (KEK-u). Veç kësaj, në komunë shpeshherë përkthehen dobët dokumentet në gjuhën serbe dhe/ose boshnjake si dhe emërat goran vazhdojnë të shkruhen gabimisht në alfabetin shqip. Për më tepër, pjesa dërmuese e korrespondencës zyrtare të nivelit qendror dërguar administratës komunale është vetëm në gjuhën shqipe.



KREMTIMI MË I MADH VJETOR I KOMUNITETIT GORAN ORGANIZOHET GJATË DITËS SË SHËN GJERGJIT MË 5-6 MAJ. DITA E SHËN GJERGJIT NUK KA NDOJË KONOTACION FETAR PËR KOMUNITETIN, POR NË VEND TË KËSAJ E SHËNON FILLIMIN E PRANVERËS. KËTU, GORANET PARAQITEN ME VESHJE TRADICIONALE GJATË KREMTIMIT NË QYTETIN E DRAGAŠ/DRAGASHIT.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Trashëgimia kulturore e komunitetit goran përfaqësohet përmes trashëgimisë së tyre kulturore. Meqenëse, komuniteti goran është i besimit musliman, në shumicën e rasteve komuniteti ka veçoritë e njëjta fetare dhe përdorin të njëjtat objekte si komuniteti shqiptar. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti goran gëzon lirinë fetare dhe qasje të papenguar në xhamitë vendore. Sidoqoftë, komuniteti

⁹ Ligji i Kuvendit të Kosovës nr. 02/L-37 për përdorimin e gjuhëve, i shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/51, më 20 tetor 2006.

parapëlqen të udhëtojë në rajonin e Gorës në Prizren për të festuar festat e tyre tradicionale. Në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk ka asnjë objekt historik apo fetar të një rëndësie të veçantë për komunitetin goran. Goranët e rajonit shpeshherë zgjedhin të shkojnë në xhamitë në luginën e Zupa/Zhupës në rajonin e Prizrenit meqë Imamët e flasin dialektin Naainski . Veç kësaj, ata shënojnë disa ngjarje ortodokse siç janë: Krishtlindjet, Pashkët dhe Shën Gjergji, ndonëse pa ndonjë konotacion të fuqishëm fetar. Ky i fundit njihet dhe është përfshirë në kornizën ligjore të Kosovës si festë zyrtare e komunitetit. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti goran organizon ngjarje të kulturë së tyre tradicionale, zakonisht në formë të tubimeve publike me rastin e Shën Gjergjit.

Festa më e madhe tradicionale vjetore e këtij komuniteti organizohet gjatë Shën Gjergjit (Dita e Shën Gjergjit), më 5-6 maj.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Goranët vazhdojnë të gëzojnë marrëdhënie të mira me komunitetet tjera dhe janë të integruar mirë. Për shembull, në rajonin e Pejës/Peć, bizneset private në pronësi të goranëve shpeshherë vizitohen nga të gjitha komunitetet që jetojnë në rajon. Të folurit e rrjedhshëm në gjuhën shqipe ua lehtëson goranëve dialogun ndërmjet komuniteteve. Në rajonin e Prishtinës/Priština, ndonëse udhëheqësit e komunitetit goran pohojnë që etniciteti i tyre nuk pranohet mirë nga shumica, komuniteti ndërvepron me shqiptarët. Komuniteti në përgjithësi nuk është i angazhuar në mënyrë proaktive në jetën politike, e cila ndikon negativisht në pjesëmarrjen e tyre në forumat e dialogut zyrtar. Në rajonin e Prizrenit, ndonëse marrëdhëniet ndërmjet goranëve dhe komuniteteve tjera janë në përgjithësi janë të mira, ndërveprimi ndërmjet përfaqësuesve politik të goranëve, shqiptarëve dhe boshnjakëve në Dragash/Dragaš mbetet i tendosur. Përfshirja e komunitetit goran me strukturat e drejtuara nga Serbia në Dragash/Dragaš ndikon negativisht në marrëdhëniet me banorët e komunitetit shqiptar të komunës. OJQ-të gorane kanë marrë pjesë në aktivitetet e organizuara nga komuna, duke përfshirë shoqërinë civile shqiptare dhe boshnjake, por përpjekjet për t'i sjellur së bashku fëmijët e komuniteteve në aktivitetet sportive dhe kulturore kanë dështuar të tërheqin pjesëmarrjen e fëmijëve goran, të cilët shkojnë në shkollat e komunës të drejtuara nga Serbia.



Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit



Tabela 1: Population Settlements

Rajoni	Komuna	Vendbanimet e banuara nga komuniteti goran
Pejë/Peć	Pejë/Peć	Qyteti i Pejës/Peć
Prishtinë/ Prishtina ¹	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	Fushë Kosovë/Kosovo Polje
	Gračanica/Gračanicë	Gračanica/Gračanicë, Uglar/Ugljare
	Gillogovc/Glogovac	Qyteti i Gillogovcit/Glogovac
	Prishtinë/ Prishtina	Prishtinë/Priština
Prizren ²	Dragash/Dragaš	Qyteti i Dragashit/Dragaš, Rapqë e Epërme/Gornja Rapça, Rapqë e Poshtme /Donja Rapça, Kërstec e Epërme /Gornji Krstac, Kërstec e Poshtme/Donji Krstac, Lubovishtë/ Ljubovište, Leshtan/Lještane, Radesh/Radeša, Kukjan/ Kukuljane, Dikancë/Dikance, Baçkë/Baçka, Brod/Brod, Mlikë/Mlike, Vranishtë/Vranište, Gilloboçicë/Globočica, Orqushë/ Orçuša, Zlipotok/Zlipotok, Krushevë/Kruševo, Restelicë/Restelica

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë³

Rajoni	Burimi	Numri gjithsej i popullsisë	Komuniteti	%
Pejë/Peć	Komuna Pejë/Peć			
	1. Regjistrimi i popullsisë 1981	111,071	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë 1991 ⁴	127,796	-	-
	3. Vlerësimet aktuale komunale	150,000	150-200	0.1-0.13%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	140,000	160-200	0.10-0.14%
	5. Vlerësimet e OSBE-së për Profilin Komunal 2008	170,000	-	-
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	140,000	150-200	0.10-0.14%
	7. Koment:	Gjatë regjistrimit të popullsisë të viteve 1981 dhe 1991, komuniteti goran është deklaruar si mysliman ose jugosllavë.		
Prishtinë/Priština	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje			
	1. Regjistrimi i popullsisë 1981	29,805	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë 1991	35,570	-	-
	3. Vlerësimet aktuale komunale	50,000	40	0.08%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	34,000	40	0.11%
	5. Vlerësimet e OSBE-së për Profilin Komunal 2008	40,000	45	0.11%
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	40,000	45	0.13%
	7. Koment:			
	Komuna Graçanica/Gračanicë			
	1. Regjistrimi i popullsisë 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë 1991	-	-	-
	3. Vlerësimet aktuale komunale	20,000	85	0.425%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	20,000	105	0.525%
	5. Vlerësimet e OSBE-së për Profilin Komunal 2008	-	80-100	0.04-0.05%
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	18,000	85-105	0.47% 0.58%
	7. Koment:			
	Komuna Gillogovc/Glogovac			
	1. Regjistrimi i popullsisë 1981	39,141	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë 1991	53,618	56	-
	3. Vlerësimet aktuale komunale	72,000	0	0.0%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	72,000	0	0.00%
	5. Vlerësimet e OSBE-së për Profilin Komunal 2008	72,000	12	0.01%
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	72,000	0	0.00%
	7. Koment:			
	Komuna Prishtinë/Priština⁵			
	1. Regjistrimi i popullsisë 1981	148,656	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë 1991	199,654	-	-
	3. Vlerësimet aktuale komunale	500,000	-	-
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	500,000	-	-
	5. Vlerësimet e OSBE-së për Profilin Komunal 2008	500,000	-	-
6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	500,000	-	-	
7. Koment:	Ndonëse OSBE-ja ka gjetur që ka familje gorane që jetojnë në qytetin e Prishtinës/Priština, është vështirë të sigurohet numri i saktë i tyre për shkak të mospjesëmarrjes publike dhe mospërfaqësimit në jetën publike.			
Prizren	Komuna Dragash/Dragaš			
	1. Regjistrimi i popullsisë 1981	35,054	15,922	45.4%
	2. Regjistrimi i popullsisë 1991	38,914	16,112	41.4%
	3. Vlerësimet aktuale komunale	33,837	11,037	32.6%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	32,000	10,000	31.2%
	5. Vlerësimet e OSBE-së për Profilin Komunal 2008	41,000	13,000	31.7%
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	32,000	10,000	31.2%

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë⁵

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijët e moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijët të cilët e vijnë shkollimin e detyrueshëm (6-15)	Fëmijët të cilët nuk vijnë shkollimin e detyrueshëm (6-15)	Grup moshë e personave të punësuar (16-65)	Grupmosha e personave të papunësuar (16-65)	Të moshuarit (65+)	Të tjerët
Pejë/Peç	Pejë/Peç	Mashkull	20	12		25	25	15	
		Femër	10	7		15	30	13	
		Gjithsej	30	19		40	55	28	
	Gjithsej rajonet								
Koment:	Sipas anketave, banorët goranë në Pejë/Peç kanë përafërsisht 30 fëmijë, të cilët vijnë arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhën boshnjake dhe shqipe.								
Prishtinë/Priština	Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Gračanica/ Graçanicë	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Glllogovc/ Glogovac	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Prishtinë /Priština	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej							
	Gjithsej rajonet	130-150							
Koment:	OSBE-ja nuk ka mundur t'i zbërthejë më tutje të dhënat.								
Prizren	Dragash/ Dragaš	Mashkull							
		Femër							
		Gjithsej		1,300		540	7,300	1350	109
	Gjithsej rajonet		1,300		540	7,300	1350	109	
Koment:	Të dhënat janë mbledhur nga burime të ndryshme, duke përfshirë zyrtarët komunal dhe përfaqësuesit e komunitetit dhe përfshihen si goranët ashtu edhe boshnjakët, meqë nuk kemi qasje në të dhënat e zbërthyera.								

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë

Rajoni	Hisedarët kyçë të komunitetit	
Pejë/Peç	Komuna Pejë/Peç	
	1	
	2	
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	Koment : Komuniteti nuk angazhohet aktivisht në jetën publike.
Prishtinë/Priština	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje	
	1	
	2	
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	Koment : Komuniteti nuk angazhohet aktivisht në jetën publike.
	Komuna Gračanica/Graçanicë	
	1	
	2	
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	Koment : Komuniteti nuk angazhohet aktivisht në jetën publike.
	Komuna Glogovac/Glogovac	
	1	
	2	
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	Koment : Komuniteti nuk angazhohet aktivisht në jetën publike.
	Komuna Prishtinë/Priština	
	1	
	2	
	3	
4		
5		
6		
7	Koment : Komuniteti nuk angazhohet aktivisht në jetën publike.	

Prizren	Komuna Dragash/Dragaš	
	1	Nisma e Qytetarëve të Gorës (Gradjanska Inicijativa Gore – GIG); Partia Demokratike Vatan (Demokratska Stranka Vatan - DSV), anëtar i koalicionit të Vakrat-it; Partia për Veprim Demokratik (Stranka Demokratske Akcije – SDA); Partia e Re Demokratike (Nova Demokratska Stranka – NDS); Partia Socialdemokrate e Gorës (Socijaldemokratska Stranka Gore - SDSG); Grupi i qytetarëve “Alija Abdi” (Grupa Gradjana “Alija Abdi”) – subjekt politik i dalur nga zgjedhjet serbe të 11 majit.
	2	Murselj Halilji, Deputet i Kuvendit të Kosovës (GIG); Vezira Emruš, Deputete e Kuvendit të Kosovës nga Prizreni (SDA); Veis Šerifi, Këshilli Konsultativ për Komunitete, Zyra e President të Kosovës; Eljem Seferi, Zëvendës Komandant i Stacionit Policor; Deir Jelmazi, Deputet në Kuvendin Komunal; Nihad Osmani, Deputet në Kuvendin Komunal; Vezaip Kajkuš, Zyrtar Komunal për Kthim; Urmet Emini, Zyra komunale për komunitete; Abdulrezak Mehmeti, kryesues i sektorit komunal për bujqësi; Strukturat e dalura nga zgjedhjet serbe të 11 majit: Alija Abdi, Kryetar i Komunës së Gorës.
	3	“Organizata e Gorës për të Rinj” (Omladinska Organizacija Gore), rini, kulturë, sport; “Ekologjia Njerëzore e Dragashit/Dragaš” (HED), ekologji , rini, kulturë, sport; “Vatan”, kthim, kulturë; “Organizata e Krushevës/Krushevo për të rinj”, rini, kulturë, sport; “Stars”, rini, gra, edukim, kulturë; “Nisma Demokratike e Gorës” (DIG), zhvillim, demokratizim, ndihmë humanitare; “Biser”, kulturë; “Šara”, bujqësi; “Atlantik klub” ndihmë humanitare.
	4	Radio “Bambus”, radio komerciale/informative në gjuhën gorane (mbulon vetëm fshatin Restelica/Restelicë), pronar Nesim Hodza; Radio “Gora”, radio komerciale/informative në gjuhën serbe/boshnjake (mbulon të gjitha fshatrat në zonën e Gorës), pronar Nuhija Tairovci; Radio “Sharri”, radio komerciale në gjuhën shqipe me pak program në gjuhën serbe/boshnjake.
	5	Iso Mutaš, Kryesues i Këshillit Lokal për Siguri në Bashkësi në fshatin Krushevo/Krushevë; Për shkak të mos deklaramit të përkatësisë etnike (ndarja ndërmjet boshnjakëve dhe goranëve) dhe ndjeshmërisë, parapëlqejmë që të mos e përfshijmë këtu listën e plotë të udhëheqësve të komunitetit dhe fshatrave. Megjithatë, lista e plotë e këtyre udhëheqësve mund të jepet për qëllime të veçanta.
	6	
7	Koment : OJQ-të aktive në Dragash/Dragaš pohojnë të përfaqësojnë dhe të përfshihen në realizimin e projekteve për tërë komunitetin jo shumicë, pavarësisht nëse deklarohen si goran ose boshnjak. Veç kësaj, anëtarët e VAKAT-it në institucionet komunale, të cilët deklarohen si boshnjak, në parim përfaqësojnë tërë komunitetin jo shumicë në Dragash/Dragaš.	

1 Pjesëtarët e komunitetit goran gjithashtu përfaqësohen në vendbanimet tjera në rajon. Megjithatë, duke e pasur parasysh përfaqësimin e ultë ose inekzistent politik të popullatës gorane në rajon, OSBE-ja nuk ka pasur mundësi t'i identifikojë dhe t'i dallojë nga popullata boshnjake. Qëndrimi i përgjithshëm i komunitetit në rajonin e Prishtinës/Priština është që të identifikohen me komunitetin boshnjak.

2 Meqenëse ndarja ndërmjet boshnjakëve dhe goranëve si në komunën e Prizrenit ashtu edhe në atë të Dragashit/Dragaš është më tepër politike, është shumë vështirë të dallohen këto komunitete. Goranët që jetojnë në qytetin e Prizrenit e konsiderojnë veten si boshnjak dhe vijojnë arsimin në gjuhën boshnjake në sistemin arsimor të Kosovës. Boshnjakët që jetojnë në komunën e Dragashit/Dragaš identifikohen si pjesëtar të komunitetit goran dhe vijojnë sistemin arsimor të mbështetur nga Serbia.

3 Të dhënat për popullatën për seksionet 3, 4, 5 dhe 6 janë mbledhur nga Ekipet e OSBE-së në terren, në konsultim me përfaqësuesit e komuniteteve dhe zyrtarët komunal në muajt mars-prill 2010.

4 Të dhënat e mbledhura me rastin e regjistrimit të popullsisë së vitit 1991 kontestohen, meqenëse është bojkotuar nga disa segmente të popullatës.

5 Janë përfshirë të gjitha komunat, ku mund të gjendet komuniteti goran, ndonëse OSBE-ja nuk ka mundur të sigurojë dhe përkitazi t'i përfshijë informatat e zërthyer sipas kategorive.



Profili i komunitetit MALAZEZËT E KOSOVËS

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Historiku

Malazezët e Kosovës janë Sllavë të Jugut, me origjinë nga Mali i Zi.¹ Prania e tyre në Kosovë është shtuar dukshëm pas luftërave ballkanike të viteve të hershme të shekullit 20. Malazezët e Kosovës janë identifikuar në rajonet e Pejës/Peć dhe Prishtinës/Priština. Feja e tyre është kryesisht krishtere ortodokse, flasin gjuhën Malazeze dhe janë të përqendruar kryesisht në komunat jugore të Kosovës që janë në kufi me Malin e Zi. Malazezët janë njohur si një nga kombet themeluese të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, dhe janë përfshirë si komunitet i ndarë në të dy regjistrimet e popullatës si në atë të vitit 1981 ashtu edhe atë të vitit 1991. Në vitin 1991, gati gjysma e afërsisht 19000 malazezëve të regjistruar në Kosovë kanë banuar në rajonin e Pejës/Peć. Komuniteti malazez në Kosovë ka shënuar zvogëlim të numrit në masë të madhe në dekadat e fundit për shkak të problemeve të sigurisë dhe atyre socio-ekonomike. Para dhe veçanërisht pas vitit 1999, (si gjatë ashtu dhe pas konfliktit), shumica e tyre emigruan apo ishin të zhvendosur Brenda rajonit. Sot, kanë mbetur vetëm disa qindra, ndonëse udhëheqësia e tyre e zëshme ka siguruar njohje nga institucionet e Kosovës dhe përfaqësim deri në një masë në organet konsultative.

Malazezët dhe serbët, si në Kosovë ashtu edhe në gjetiu, e ndajnë një histori të ngjashme, dhe shumë nga çështjet që e kanë prekur njërin komunitet e kanë prekur edhe komunitetin tjetër. Malazezët krishterë ortodoks dhe serbët krishterë ortodoks ndajnë shumë tipare kulturore, gjuhësore, fetare, dhe tradicionale. Zhvillimi i identitetit të ndarë malazez bazohet kryesisht në arsye historike (disa pjesë të Malit të Zi janë pushtuar nga Perandoria Osmane), arsye gjeografike (largësia), dhe më vonë njohja nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë e identitetit të tyre të ndarë dhe marrja në konsideratë e territorit të tij si një nga republikat e saj. Të gjitha këto tipare kanë kontribuar në zhvillimin e identitetit të ndarë etnik dhe gjeografik të Malazezëve, që pikën kulmore e arriti me pavarësinë e shtetit në vitin 2007.

Gjersa udhëheqësia politike malazeze e Kosovës fuqimisht avokon se nuk janë të asocuar me Serbet e Kosovës, realiteti në terren është më i ndërlikuar. Në njërin anë, shumë individë që i përkasin komunitetit malazez të Kosovës mundoheshin të mos binin në sy gjatë viteve të 1990-ta dhe pas konfliktit të vitit 1999. Në anën tjetër, shumë nga ta ende ngurrojnë që vetë-identifikohen publikisht si Malazezë të Kosovës, veçanërisht në zonat ku ata janë të integruar në komunitetin Serb të Kosovës, dhe ku përfitojnë nga institucionet e financuara nga Republika e Serbisë. Mirëpo gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2009 në Kosovë shumë nga ta publikisht u identifikuan si Malazez të Kosovës në mënyrë që të garonin si kandidatë në të dy partitë politike të malazezëve të Kosovës.

Në rajonin e Pejës/Peć, malazezët e Kosovës banojnë në komunën e Istogut/Istok (ku ata përbëjnë afërsisht 0.19% të popullatës së përgjithshme në fshatrat e si Serbobran/Srbobran, Shalinovicë/

Shumë malazez të Kosovës ende pohojnë se kanë përkatësi të njëjtë etnike me serbët e Kosovës, dhe që shprehja malazez i referohet më tepër origjinës gjeografike se sa identitetit të tyre etnik.

Qeveria e Kosovës e ka nisur procesin e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë të vitit 2008 me qëllim të garantimit të njohjes zyrtare të komunitetit malazez në Kosovë.

Në komunën e Deçanit/Deçane përkundër pranisë së 600 pjesëtarëve para konfliktit, janë vetëm tre malazezë Kosovar që aktualisht jetojnë në qytet.

¹ Në këtë profil, personat e referuar si malazez janë ata që vetë ose stërgjyshërit e të cilëve kanë prejardhje nga Mali i Zi, dhe të cilët përveç kësaj edhe e identifikojnë vetën si malazez. Në vetë Malin e Zi, shprehja malazez është duke u përdorur gjithnjë e më tepër por jo për të treguar aspektin etnik. Për shembull, shumë boshnjak dhe shqiptar nga Mali i Zi gjithashtu e konsiderojnë vetën si malazez, duke iu referuar kështu vendit të origjinës dhe së voni edhe të shtetësisë së tyre. Në të njëjtën kohë, ata e konsiderojnë vetën si boshnjak ose shqiptar në aspektin etnik. Mirëpo në kontekstin e Kosovës, duhet të ceket që shumë sllav etnik që janë me origjinë nga Mali i Zi e identifikojnë vetën si serb. Rasti i njëjtë me këtë është edhe në Mal të Zi ku rreth 30% e popullatës deklarohen si serb etnik.

Šaljinovica, Osojane/Osojan, Dobrushë/Dobruša, Sushicë/Sušica, dhe Zallq/Žać), Klinë/Klina (0.003%, ku ata jetojnë në qytet), Pejë/Peć (0.004 to 0.02%, që gjithashtu banojnë në qytet dhe në Goraždevac/Gorazhdec, Siga/Sigë dhe Brestovikë/Brestovik), dhe në Deçan/Dečane². Në rajonin e Prishtinës/Priština, ata banojnë në komunën e Prishtinës/Priština, Lipjanit/Lipljan, Fushë Kosovës/Kosovo Polje, dhe Obiliqit/Obilić.³ Në Obiliq/Obilić, ata janë kryesisht të koncentruar në qytet në vendbanimin Shkolla Qendër dhe në fshatrat si Caravodice/Crkvena Vodica dhe Plemetinë/Plemetina. Ata kryesisht i ndajnë vendbanimet e tyre me popullatën serbe në Kosovë. Nuk ka asnjë vend të rajonin e Prishtinës/Priština ku malazezët e Kosovës jetojnë ndaraz si një grup tjetër.



NJË MALAZEZ I KOSOVËS NGA LUGU/LJUG I KOMUNËS SË ISTOGUT/ISTOK DUKE E TREGUAR FOTON E KATRAGJYSHIT TË TIJ, NJË KRYEFAMILJAR I RËNDËSISHËM MALAZEZ.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Njohja e dallimeve të komunitetit mungon në nivel komunal, gjë që shpie në mungesë të iniciativave nga autoritetet komunale për këtë komunitet.
- Mungesa e përfaqësimit në institucionet Kosovare, përfshirë vendet e rezervuara në Kuvendin e Kosovës.
- Uzurpimet (apo shfrytëzimi i paligjshëm) i tokës bujqësore, apo pronave komerciale që janë në pronësi të malazezëve të Kosovës.

1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Malazezët e Kosovës përballen me sfida të ngjashme me ato të serbëve të Kosovës, përfshirë mundësitë e kufizuara për punësim, liria e kufizuar e lëvizjes dhe njohja e dobët e gjuhës shqipe, gjëra këto që kontribuojnë në gjendjen e dobët socio-ekonomike. Komuniteti i malazezëve të Kosovës që jeton në rajonin e Pejës/Peć në përgjithësi është më tepër i përfshirë në sektorin publik dhe privat. Aktualisht, një grua malazeze e Kosovës është e

² Përçindjet përfshijnë vlerësime të OSBE-së në bazë të konsultimeve me komunitetin.

³ OSBE nuk ka qenë në gjendje që të pranojë vlerësimet për numrin e pjesëtarëve të komunitetit në këtë rajon. Një grup i vogël në komunën e Podujevës/Podujevo e kanë identifikuar vetën si malazez të Kosovës në vitin 2009, por tani thonë se janë serb.

punësuar në Komunën e Pejës/Peć si nëpunëse e zyrës për komunitete, derisa një tjetër është e punësuar në zyrën komunale për komunitete në Osojan/Osojane në komunën e Istogut/Istok. Në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk ka ndonjë të dhënë specifike lidhur me llojet e punësimit apo nivelin e papunësisë tek malazezët e Kosovës. Komuniteti pranon ndihmë sociale nga Serbia dhe pagë miniMeshkuj që buron nga punësimi i tyre pra vitit 1999 në ndërmarrjet shtetërore. Disa kanë edhe qasje në shërbimet që ofrohen nga institucionet e Kosovës.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Komuniteti malazez i Kosovës ndanë në masë të madhe brengat e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes së komunitetit serb në Kosovë, ndonëse nuk është raportuar ndonjë incident që e ka për cak këtë komunitet. Mirëpo, paraqitja e shoqatave të malazezëve të Kosovës dhe partive politike së bashku me mesazhet e tyre për pranim nga institucionet e Kosovës e ka ndihmuar komunitetin që ta gdhendin një identitet tjetër në jetën publike dhe t i ridefinojnë marrëdhëniet e tyre me komunitetet tjera.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Nuk ka shifra të sakta lidhur me kthimin dhe riintegrimin e komunitetit malazez në Kosovë. UNHCR dhe agjencitë tjera që kanë të bëjnë me kthim nuk mbajnë të dhëna të ndara, gjë që e vështirëson vlerësimin e nevojave të komunitetit kur kemi të bëjmë me kthim dhe riintegrim, dhe për identifikimin e numrit të atyre që janë zhvendosur apo kthyer. Sidoqoftë, është e drejtë të thuhet që komuniteti malazez i Kosovës i ka brengat e ngjashme sikur komuniteti serb i Kosovës, përfshirë sigurinë, lirinë e lëvizjes dhe qasjen në shërbimet themelore. Ky trend mbetet i njëjtë edhe në vitin 2010 në krahasim me vitin 2009. Sipas një punonjësi serb të zyrës komunale për komunitete në komunën e Deçan/Dečani, rajonin e Pejës/Peć, tre malazez të Kosovës gjatë konfliktit të vitit 1999, janë kthyer në mënyrë spontane në këtë zonë gjatë viteve 2008-2009. Ata kanë pranuar ndihmë nga OJQ ndërkombëtare për rindërtimin dhe renovimin e pronave të tyre. Para konfliktit, malazezët e Kosovës kanë jetuar në fshatrat e Baballoqit/Babaloc dhe Rastavicës/Rastavica në komunën e Deçanit/Dečane. Sipas të dhënave të ofruara nga OJQ Ognjište, me seli në Podgoricë, këta malazezë të Kosovës janë zhvendosur në Mal të Zi, ku 746 nga ta janë tani të regjistruar zyrtarisht si persona të zhvendosur nga Kosova. Në maj të vitit 2010, zyrtari për kthim në komunën e Deçanit/Dečane ka raportuar që UNHCR i ka dorëzuar katër kërkesa për kthim në komunë, që janë bërë nga serbë dhe malazezë të Kosovës me origjinë nga zonat si Deçani/Dečane, Rastavica/Rastavica, Prapaqani/Papracane dhe Dashinoci/Dašinovac. Ata aktualisht janë të zhvendosur në Mal të Zi. Në rajonin e Prishtinës/Priština shumica e malazezëve të Kosovës janë zhvendosur në shtetet në rajon, derisa nuk është vërejtur asnjë rast i projekteve specifike kthimit për këtë komunitet.

4. Institucionet dhe shënimet e financuara nga Serbia

Komuniteti malazez i Kosovës përdor kryesisht institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia dhe shërbimet, në veçanti përfitimet sociale dhe pensionet, derisa kanë qasje edhe në shërbimet publike të Kosovës dhe disa shërbime komunale.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Malazezët e Kosovës, ashtu sikur komuniteti serb i Kosovës, kanë qasje në shërbimet komunale dhe publike përmes zyrës komunale për komunitete. Në rajonin e Pejës/Peć malazezët e Kosovës ballafaqohen me sfida në qasjen në shërbimet publike me ndërprerje të shpeshtë të ujit dhe mbledhje të parregullt apo jo-ekzistente të plehrave. Mirëpo, në rajonin e Prishtinës/Priština komuniteti gëzon qasje në to. Malazezët e Kosovës në maj të vitit 2009 kanë nënshkruar marrëveshje kolektive me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK), dhe që nga atëherë i kanë shmangur shkyçjet e gjata.

6. Qasja në shërbime të mirëqenies sociale

Malazezët e Kosovës kryesisht kanë qasje në ndihmë sociale dhe pranojnë pensione nga institucionet e financuara nga Republika e Serbisë. Mirëpo, në disa fusha, ata kanë qasje edhe në shërbimet e ofruara nga institucionet e Kosovës, si rasti i Goraždevac/Gorazhdecit në komunën e Pejës/Peć, ku krijimi i nënzyrës komunale për komunitete e ka shtuar qasjen në shërbime për këtë komunitet.

7. Qasja në pronë dhe banim

Shumë malazezëve të Kosovës iu është dashur të ikin pas konfliktit të vitit 1999 dhe si rrjedhojë, shtëpitë dhe pronat e tyre ishin uzurpuar. Malazezët e Kosovës përballen me pengesa në qasjen në pronat e tyre në Pejë/Peć. Në vitin 2007, Agjencia Kosovare e Pronës ua ka njohur të drejtën në pronë 746 malazezëve të Kosovës në fshatin Baballoq/Babaloc në komunën e Deçanit/Deçane. Ata ende vazhdojnë të jetojnë të zhvendosur. Kërkesa për pjesëmarrje në vizita 6 shko dhe shiko⁴ është dorëzuar në vitin 2008 por nuk është trajtuar nga Komuna. Përveç kësaj, përfaqësuesit e komunitetit janë ankuar që institucionet nuk kanë ndërmarrë hapa konkretë për të ndaluar kullotjen e paligjshme të bagëtive në tokat e tyre. Në rajonin e Prishtinës/Priština, malazezët e Kosovës gëzojnë qasje në pronë dhe banim, dhe nuk ka pasur raportim të ndonjë rasti të praktikave diskriminuese.

4 Vizitat shko e shiko u ofrojnë personave të zhvendosur mundësinë për të mbledhur informata të dorës së parë për kushtet në vendin e tyre të origjinës dhe që drejtpërsë-drejti të ndërveprojnë dhe të angazhohen me komunitetin pritës për të marrë vendime të informuara për kthimin apo për zgjidhje tjera të qëndrueshme (shih UNMIK/IPVQ Doracaku i Reviduar për Kthim të Qëndrueshëm, qershor 2006).

8. Qasja në arsim

Arsimimi nuk ofrohet në gjuhën malazeze, dhe historia dhe kultura malazeze nuk përfshihen në kurrikulë. Fëmijët e moshës shkollore të komunitetit malazez të Kosovës nga rajonet e Pejës/Peç dhe Prishtinës/Priština vijojnë sistemin e me kurrikulë serbe dhe vijojnë mësimin në gjuhën serbe. Sa i përket qasjes së tyre në arsimin e lartë në gjuhën e tyre amtare, mundësitë e vetme janë Universiteti në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, apo universitetet në Mal të Zi. Ashtu siç është rasti me serbet e Kosovës, largësitë e mëdha deri te institucionet e arsimit të lartë dhe brengat për lirinë e lëvizjes nënkuptojnë që më pak nxënës e vazhdojnë arsimin e lartë.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Komuniteti malazez i Kosovës në përgjithësi ka qasje në shërbimet shëndetësore që ofrohen nga institucionet e financuara nga Republika e Serbisë. Mirëpo, në komunën e Klinës/Klina në rajonin e Pejës/Peç për shkak të mungesës së strukturave për shëndetin riprodhues dhe shëndetin e femrës, femrat malazeze të Kosovës janë lënë pa ndihmë dhe iu duhet të udhëtojnë deri në spitale në veri të Mitrovicës/ Mitrovica për kujdes prindëror dhe lindje të fëmijëve. Komuniteti malazez i Kosovës në rajonin e Prishtinës/Priština, në pjesën më të madhe shfrytëzon shërbimet shëndetësore të mbështetura nga Serbia, siç janë ato që ofrohen në Gračanica/Graçanicë, Čaglavica/Çagllavicë, Laplje Selo/Llapllasellë dhe Ugljare/Ugljar.

10. Qasja në drejtësi

Malazezët e Kosovës kanë qasje si në gjykatat e Kosovës, ashtu edhe në strukturat gjyqësore që udhëhiqen nga Serbia, varësisht nga qasshmëria dhe natyra e çështjes që kërkon shërbime juridike apo gjyqësore. Në rajonin e Pejës/Peç malazezët e Kosovës i përdorin gjykatat e Kosovës. Themelimi i zyrës ndërlidhëse në fshatin e Gora~devac/Gorazhdevcit në komunën e Pejës/Peç e ka lehtësuar qasjen e komunitetit në drejtësi. Pozita e zyrtarit ndërlidhës është aktualisht e lirë, dhe vonesat në procesin e rekrutimit po ndikojnë negativisht në qasjen e komunitetit në shërbimet juridike dhe gjyqësore. Malazezët e Kosovës në rajonin e Prishtinës/Priština kanë qasje si në shërbimet e gjykatave Kosovare ashtu edhe ato të strukturave gjyqësore të Serbisë. Që nga marsi 2010, komuniteti gjithashtu ka përfituar nga shërbimet e zyrës së sapo hapur të Komisionit për Ndihmë Juridike të Kosovës në Gračanica/Graçanicë. Ky komision financohet nga fondet publike dhe një agjenci e mbështetur nga UNDP-ja që ofron ndihmë juridike falas për personat që nuk kanë mundësi të paguajnë vetë në çështjet e së drejtës civile dhe administrative.

SNEŽANA KARADŽIĆ, PËRFAQËSUESE MALAZEZE E KOSOVËS E EMËRUAR RISHTAS NË KËSHILLIN KONSULTATIV PËR KOMUNITETE, NJË FORUM I FORMUAR NË KUADËR TË ZYRËS SË PRESIDENTIT KU MBLIDHEN PËRFAQËSUESIT E TË GJITHA KOMUNITETEVE JOSHQIPTARE NË KOSOVË.



11. Pjesëmarrja në çështje publike

Me krijimin e Shoqatës së parë të Malazezëve të Kosovës në vitin 2008, komuniteti malazez i Kosovës ka themeluar praninë politike për të ngritur zërin e tyre. Në vitin 2009, Qeveria e Kosovës e ka njohur kërkesën e Shoqatës së Malazezëve të Kosovës për pjesëmarrje të shtuar në çështjen e komunitetit. Që nga atëherë, një malazez kosovar është përzgjedhur të jetë pjesë e Këshillit Konsultativ të Komuniteteve, organ ky këshillëdhënës që vepron nën zyrën e Kryetarit të Kosovës. Në maj 2010 qeveria e Kosovës ka filluar procedurën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të vitit 2008 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë për njohjen e komunitetit malazez të Kosovës. Përveç kësaj, janë themeluar dy parti politike në vitin 2009 dhe një tjetër në vitin 2010 për të përfaqësuar interesat e komunitetit malazez të Kosovës, Partia Demokratike Malazeze (CDS), Partia Popullore e Malazezëve (CNS), Partia Liberale e Malazezëve (CLS). Dy të parat të cilat garuan në zgjedhjet lokale të nëntorit të vitit 2009; e fituan një ulëse në kuvendin komunal. Komuniteti malazez i Kosovës nuk është i përfaqësuar as në nivel ministror, e as ulëse të rezervuar në Kuvendin e Kosovës. Komuniteti malazez i Kosovës mbështetet në mediat elektronike në gjuhën serbe, që janë lehtësisht të qasshme në këto komuna ku banon komuniteti. Mediat e shkruara janë në dispozicion në zonat e populluara me serb të Kosovës. Vizitat në terren kur të ndërmerren për komunitetin malazez të Kosovës, zakonisht bëhen nga zyrat komunale për komunitete.

Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti malazez i Kosovës ka themeluar një degë të Shoqatës së Malazezëve të Kosovës me qëllim të avokimit për të drejtat e tyre. Partia Popullore e Malazezëve (CNS) ka paraqitur kërkesë për pjesëmarrje në komitetin për komunitete në komunën e Pejës/Peć. Në Istog/Istok, një grua malazeze përfaqëson komunitetin në zyrën komunale për komunitete. Në rajonin e Prishtinës/Priština, Partia Demokratike

Malazeze (CDS) arriti që të fitojë një ulëse në Kuvendin Komunal Fushë Kosovë/Kosovo. Një malazez i Kosovës gjithashtu mbanë një post të zëvendës kryetarit për komunitete në Obiliq/Obilić. Mirëpo, ai pohon që e përfaqëson edhe komunitetin malazez edhe atë serb të Kosovës dhe vetëidentifikohet me të dy komunitetet. Komuniteti gjithashtu përfaqësohet edhe në komitetet për komunitete në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Lipjan/Lipljan dhe Obiliq/Obilić. Ata që kanë origjinë malazeze e që marrin pjesë në çështjet publike shpeshherë identifikohen edhe si malazezë edhe si serbë të Kosovës, duke theksuar edhe një herë afërsinë e të dy komuniteteve. Për më tepër, katër malazezë të Kosovës janë të punësuar si shërbyes civilë në komunën e Fushë-Kosovës/Kosovo Polje.

12. Përdorimi i gjuhës

Komuniteti malazez i Kosovës në përgjithësi ka mundësi që të përdorë gjuhën e vet në publik, ndonëse përdorimi i gjuhës serbe nga ta në ndërvprimin e tyre me komunat nënkupton që ata përjetojnë të njëjtat probleme si serbët e Kosovës për shkak të mungesës së kapaciteteve të përkthimit të përshtatshëm të dokumenteve dhe përkthimit gojor.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Malazezët e Kosovës zakonisht e ndajnë shumicën e trashëgimisë së tyre kulturore dhe fetare me komunitetin serb. Nuk është bërë asnjë përpjekje për ndarje nga Kisha Ortodokse Serbe në Kosovë, siç ka qenë rasti në Mal të Zi. Malazezët e Kosovës gëzojnë lirinë e ushtrimit të fesë dhe festojnë festat fetare në të njëjtat vende si Serbët e Kosovës.⁵

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Marrëdhëniet e komunitetit malazez të Kosovës me komunitetet tjera përkufizohen me afërsinë e tyre me serbët e Kosovës. Në të njëjtën kohë, qëndrimi i Malit të Zi ndaj Kosovës ka ndikuar pozitivisht në marrëdhëniet me komunitetin shumicë. Si në rajonin e Pejës/Peć ashtu edhe atë të Prishtinës/Priština, ku banon ky komunitet, ngurrimi nga institucionet komunale për t i njohur malazezët e Kosovës si komunitet i veçantë dhe i ndarë nga komuniteti serb i Kosovës nënkupton se nuk është sajuar asnjë iniciative specifike në terren për t i integruar ata. Mbetet të shihet nëse, dhe në çfarë mënyrë do të ndikojnë përpjekjet aktuale nga partitë politike malazeze për pranimin e njohjes zyrtare në nivel qendror në marrëdhëniet e malazezëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera si në nivel komunal ashtu edhe atë bazik.

⁵ Për një listë gjithëpërfshirëse të vendeve religjioze ortodokse, ju lutem referojuni pjesës për trashëgiminë dhe liritë fetare dhe kulturore të komunitetit serb të Kosovës.



Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit



Tabela 1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti malazez i Kosovës ¹
Pejë/Peć	Deçan/Dečane	Qyteti i Deçanit/Dečane
	Istog/Istok	Serbobran/Srbobran, Shalinovicë/Šaljinovica, Osojane/Osojan, Dobrushë/Dobruša Sushicë/Sušica dhe Zallq/Žać
	Klinë/Klina	Qyteti i Klinës/Klina
	Pejë/Peć	Qyteti i Pejës/Peć, Goraždevac/Gorazhdec, Siga/Sigë dhe Brestovik/Brestovik
rihtëinë / Priştina	Obiliq/Obilić	Qyteti i Obiliqit/Obilić (Vendbanimi “Shkolla në Qendër”), Caravodice/Crkvena Vodica dhe Plemetin/Plemetina
	Gračanica/Gračanicë	Suvi Do/Suhadoll, Čaglavica/Çagllavicë
	Fushë Kosovë/Kosovo Polje	Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Kuzmin
	Lipjan/Lipljan	Qyteti i Lipjanit, Staro Gracko/ Grackë e Vjetër

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë²

Rajoni	Burimi	Numri gjithsej i popullsisë	Community	%
Pejë/Peć	Komuna of Deçan/Dečane			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	40,640	898	2.2%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991 ³	49,000	674	1.37%
	3. Vlerësimet aktuale në komunë	-	-	-
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	60,000	3	0.005%-
	5. Profili komunal i OSBE-së vlerësimet për vitin 2009	40,000	-	-
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	37,000	-	-
	7. Komente:			
	Komuna of Istog/Istok			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	50,104	1,856	3.7%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	57,261	1,302	2.27%
	3. Vlerësimet aktuale në komunë	56,000 – 64,000	48	0.85-0.75%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	50,000	N/A	-
	5. Profili komunal i OSBE-së vlerësimet për vitin 2009	56,000	N/A	-
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	56,000	110	0.19%
	7. Komente:	Informatat e ofruara nga zyrtari nën-komunal dhe përfaqësuesi i fshatit Osojane/Osojan dhe Zallq/Žać.		
	Komuna of Klinë/Klina			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	54,539	973	1.78%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	52,266	621	1.18%
	3. Vlerësimet aktuale në komunë	55,000 – 58,000	8	0.014-0.013%
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	55,000	-	-
5. OSCE Municipal Profile 2008 Estimations	55,000	-	-	
6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	55,000	2	0.003%	
7. Komente:	Sipas zyrtarit komunal për komunitete në komunën e Klinës/Klina ka pasur familje me përkatësi Malazeze që kanë ikur pas konfliktit të vitit 1999. kurse tani ka mbetur vetëm një familje.			

Pejë/Peć	Komuna of Pejë/Peć			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	111,071	9,796	8.81%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	127,796	6,960	5.54%
	3. Vlerësimet aktuale në komunë	150,000	-	-
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	140,000	20	0.01%
	5. Profili komunal i OSBE-së vlerësimet për vitin 2009	170,000	-	-
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	140,000	*6-30	0.004 - 0.02%
7. Komente:	*Ka pasur shifra të sakta dhe vlerësimet janë bazuar në anëtarësinë në Shoqatën e Malazezëve të Kosovës.			
Prishtinë/Priština	Rajoni Prishtinë/Priština			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	338,198	7,353	0.46%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	429,248	5,975	0.72%
	3. Vlerësimet aktuale në komunë	788,000	-	-
	4. Vlerësimet aktuale të komuniteteve	768,000	4,000 – 5,000	0.65%
	5. OSCE Municipal Profile 200 Estimations	770,000	-	-
	6. Vlerësimet aktuale të ekipeve të OSBE-së në terren	770,000	*Nuk ka mundur të bëhet asnjë vlerësim	-
7. Komente:	*Shoqata e Malazezëve të Kosovës ka vlerësuar që ka afërsisht 8,000 anëtarë.			

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë⁴

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijët e moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijët që vijnë arsimin e detyrueshëm (6-15)	Fëmijët që nuk vijnë arsimin e detyrueshëm (6-15)	Të punësuar të moshës së punës (16-65)	Të papunësuar të moshës së punës (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë
Pejë/Peć		Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej							
	Gjithsej në nivel rajonal								
Komente: The OSCE was unable to obtain all the data from the relevant authorities.									
Prishtinë/Priština		Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej							
	Gjithsej në nivel rajonal								
Komente: The OSCE was unable to obtain all the data from the relevant authorities.									

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë

Rajoni	Hisedarët kyçë të komunitetit
Pejë/Peć	Informata për rajonin
	1 Sipas përfaqësuesit të komuniteteve në qytetin e Pejës/Peć, Malazetët e Kosovës janë në proces të krijimit të partisë së tyre. Në komunën e Deçanit/Deçane Partia Popullore e Malazeze është aktive. Kryetar i kësaj partie është një femër serbe anëtare e Zyrës Komunale për Komunitete.
	2 Verica Lazović, Pejë/Peć zyra komunale për komunitete
	3 Verica Lazović, që është raportuar se i përket Shoqatës së malazetëve të Kosovës (UDCK)
	4 N/A
	5 Verica Lazović e konsideron veten si aktiviste e komunitetit në Pejë/Peć
	6
	7
Prishtinë/Priština	Informata për rajonin
	1 Partia Demokratike Malazeze (CDS), Partia Popullore e Malazetëve (NCPK), Partia Liberale Malazeze
	2 Radoman Doderović, deputet komunal, kryesues i komitetit për komunitete, Fushë Kosovë /Kosovo Polje
	3 Shoqata e Malazetëve të Kosovës (UDCK)
	4 Asnjëri
	5 Slobodan Vujičić, kryetar i Shoqatës së Malazetëve të Kosovës Nebojša Radulović, nënkryetar i shoqatës së Malazetëve të Kosovës Snežana Karadžić, anëtare e Shoqatës së Malazetëve të Kosovës
	6
	7

1 Në komunat e Deçanit/Deçane (rajoni i Pejës/Peć), Lipjan/Lipljan, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, dhe Prishtinë/Priština (rajoni i Prishtinës/Priština) Malazetët e Kosovës jetojnë së bashku me komunitetin serb, por nuk është identifikuar ndonjë vendbanim/lagje specifike për shkak të vështirësive në dallimin ndërmjet dy komuniteteve.

2 Të dhënat e popullatës për pjesët 3, 4, 5, dhe 6 janë mbledhur nga ekipet e OSBE-së në terren në konsultim me përfaqësuesit e komuniteteve dhe zyrtarët komunal në shtator të vitit 2008.

3 Ju lutem t'i keni para sysh pjesët e popullatës që e bojkotuan këtë regjistrim, prandaj të dhënat e mbledhura nga ai kontestohen nga disa komunitete.

4 OSBE nuk ka mundur të marrë të dhëna të ndara për këtë komunitet.



Profili i komunitetit ROMËT

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Mohim i përgjegjesisë

Pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e identifikojnë veten si persona që u takojnë tri komuniteteve të veçanta dhe pranohen si të tillë nga korniza ligjore e Kosovës, institucionet e Kosovës dhe organizatat ndërkombëtare. Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë e pranon plotësisht ekzistencën e tri komuniteteve të veçanta dhe në këtë publikim ka synuar t'i theksojë përvojat dhe karakteristikat e veçanta të tyre. Megjithatë, për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme të zberthyera për këto komunitete në disa komuna, disa pjesë të Aneksit për këtë profil përmbajnë shifra që paraqesin së bashku komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Historiku

Romët janë një nga komunitetet që jetojnë tradicionalisht në Kosovë. Besohet se ata vijnë nga India, nga ku u larguan mes shekullit 8 dhe 10. Ata filluan të vendosen në Kosovë në mesin e shekullit të 14. Gjuha e tyre amtare është gjuha rome, me dialekte të ndryshme të saj që mund të gjinden në Kosovë. Shumica e romëve flasin gjuhë të ndryshme, mes të cilave gjuhen serbe, gjuhën shqipe apo që të dyja. Që nga Kongresi i parë i romëve i vitit 1971 i mbajtur në Londër, komuniteti rom përdor simbolet e veta (flamurin dhe himnin “Gelem, Gelem”). Shumë romë në Kosovë janë të besimit islam; disa janë të krishterë ortodoksë. Krenimi kryesor si i romëve myslimanë ashtu dhe atyre ortodoks në Kosovë është Shën Gjergji/Đurđevdan (Turqisht: Hidirlez) më 6 maj.¹ Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 1991, 45,745 persona janë deklaruar si pjesëtarë të komunitetit rom në Kosovë², ndonëse nuk dihet se sa romë janë të regjistruar nën kategori të tjera etnike. Besohet gjerësisht se të dhënat nga ky regjistrim nuk janë të besueshme dhe se numri i romëve në Kosovë është shumë më i lartë. Vlerësohet se deri para konfliktit të vitit 1999³ në Kosovë ka pasur deri në 150,000 pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Sot, besohet se numri i tyre në Kosovë është 34,000⁴. Shumë romë kanë emigruar nga Kosova në Evropën Perëndimore në vitet e 80-ta dhe 90-ta për arsye ekonomike, ndërsa një numër i madh u largua pas konfliktit të vitit 1999.

Komuniteti rom është një grup i cënueshëm në Kosovë, të cilit i mungon integrimi efikas në jetën arsimore, sociale, ekonomike dhe politike. Para konfliktit, njerëzit që i përkisnin komunitetit rom jetonin kudo nëpër Kosovë qoftë në vendbanime shumëetnike ose në lagje të banuara kryesisht me romë. Mes vitit 1999 dhe 2004, shumë vendbanime u shkatërruan dhe vetëm disa projekte kontribuan në rindërtimin e plotë apo të pjesshëm të tyre. Shembulli më i rëndësishëm është vendbanimi “Fabrička”, ose “Mëhalla e Romëve” në Komunën Mitrovicë/Mitrovica ku dikur jetonin 8,000 romë. Ajo konsiderohej si vendbanimi më i madh në Kosovë dhe një nga më të mëdhenjtë në Ballkan. Deri më tani, përafërsisht 600 romë janë kthyer dhe kanë përfituar nga rindërtimet. Aktualisht, një numër i konsiderueshëm i romëve jeton në komuna të Ferizajt/Uroševac

Strategjia e qeverisë së Kosovës e vitit 2008 për Integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë adreson një gamë të gjerë të problemeve që prekin komunitetin rom, duke përfshirë diskriminimin, mungesën për qasje në shërbime kyçe dhe ushtrimin e kufizuar të të drejtave themelore, siç janë arsimimi, banimi, kthimi dhe rikthimi i pronës.

1 Për romët të Krishterë Ortodoksë, Sveti urev (Shën Gjergji), kalorësi i drejtë i cili luftoi kundër dragoit, është një i shenjtë mbrojtës i rëndësishëm. Ekuivalenti në fenë islame hidirlez është një bashkim i h1zir dhe elias. Besohet se takimi ndërmjet të shenjtëve mbrojtës Hizirt dhe profetit Ilias në shekullin 9 para Krishtit shënoi fillimin e pranverës. Më parë, kjo ishte një kremtë e festuar gjerësisht në Turqi, ndërsa tani festohet kryesisht nga romët. Aktualisht, për romët në Kosovë dhe në tërë Ballkanin, kjo është një festë pranverore për ta mirëpritur verën dhe për të pasur fat dhe prosperitet. Krahas origjinës së saj fetare dhe rituale, kremta është e rëndësishme për promovimin e kontaktit social ndërmjet grupeve të ndryshme.

2 Të dhënat e popullsisë sipas etnive në Kosovë para konfliktit në vitin 1999 kontestohen, meqë regjistrimi i vitit 1991 ishte shumë i politizuar dhe ka qenë i bojkotuar.

3 Shih Këshilli i Evropës Doku. 11289 Rev. 24 maj 2007: Situata e refugjatëve dhe personave të zhvendosur për një kohë të gjatë në Evropën Juglindore. Raporti për Komisionin për Migrim, Refugjatë dhe Popullsi, Asambleja Parlamentare. Ju lutemi vëreni që për shkak të mungesës së të dhënave të besueshme, nuk është e mundur që të ofrohen të dhëna të veçanta për secilin prej tre komuniteteve.

4 UNHCR Kosovë, Zyra e Kryesuesit të Misionit, Fushata e regjistrimit civil e Njësisë për Mbrojtje që i dedikohet komunitetit RAE në Kosovë. Plani i Veprimit, korrik 2006, faqe 1.

Meqë romët përbëjnë 10% të popullsisë të komunës së re të Gračanica/Graçanicë, ky është i vetmi vend ku gjuha rome e arrin pragun e nevojshëm prej 5% për të qenë gjuhë zyrtare. Në kohën kur po shkruhej ky dokument, komuniteti ende ishte duke e konsideruar mundësinë e parashtrimit të kërkesës zyrtare për njohjen e gjuhës rome si zyrtare.

Flamuri ndërkombëtar i romëve: Një rrotë e kuqe me tokën dhe qiellin në sfond

(përafërsisht 0.015% e numrit të përgjithshëm të popullsisë në komunë), Gjilanit/Gnjilane (përafërsisht 0.3%), Kamenicës/Kamenica (përafërsisht 0.76%), Novobërdë/Novo Brdo (përafërsisht 1.5%), dhe Štrpce/Shtërpçës (0.2%) në rajonin e Gjilanit/Gnjilane; në Mitrovicë/Mitrovica (0.6%), Vushtrri/Vučitrn (0.2%) dhe Leposavić/Leposaviq (1%) në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica; në Gjakovë/Đakovica (0.43%), në Deçan/Dečani (0.1%), në Istog/Istok (0.03%), në Klinë/Klina (0.4%); në Pejë/Peć (nuk dihet për qindja), në rajonin e Pejës/Peć; dhe në Gračanica/Graçanicë (10%),⁵ Lipjan/Lipljane (0.5%), Fushë Kosovë/Kosovo Polje (1.9%), Obiliq/Obilić (2.3%), Podujevë/Podujevo (0.08%), Prishtinë/Priština (0.054%), dhe Shtime/Štimlje (0.03%) në rajonin e Prishtinës/Priština. Në rajonin e Prizrenit nuk ka në dispozicion të dhëna të veçanta konsistente për komunitetin rom. Megjithatë, qyteti i Prizrenit ka një komunitet rom të fuqishëm dhe të vjetër, i cili është i njohur për jetën e pasur dhe aktive kulturore.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Komuniteti rom është ndër më të cenuarit në Kosovë, me shumë romë që jetojnë në varfëri të skajshme. Brenda komunitetit, femrat janë në pozitë më të pafavorshme.
- Një numri relativisht të madh të romëve u mungon regjistrimi i lindjes, civil apo i vendbanimit duke ua pamundësuar atyre gëzimin e të drejtave themelore.
- Mungesa e integritetit efektiv në sektorin e arsimit (regjistrimi i ulët në shkollat fillore dhe shkollë të lartë të braktisjes së shkollës tek femrat, si dhe shkollë e ulët e nxënësve që e përfundojnë shkollën e mesme apo të lartë).
- Shkollë e lartë e papunësisë dhe përfaqësim i pamjaftueshëm në organet publike në të gjitha nivelet.
- Mungesa e titujve të regjistruar të pronës ose provave të pronësisë e pengon respektimin e plotë të së drejtës së tyre në rripodimin dhe kthimin e pronës.
- Problemet lidhur me qasjen në shërbime (shërbime shëndetësore, sociale, komunale dhe publike).

FARKATAR ROM NË QYTETIN E PRIZRENIT.



⁵ Gračanica/Graçanicë është në mesin e komunave të reja dhe ka praninë më të lartë të romëve në Kosovë.



NJË VAJZË ROME NË KAMPIN E PERSONAVE TË ZHVENDOSUR NË LEPOSAVIĆ/LEPOSAVIQ, NË RAJONIN E MITROVICËS/MITROVICA, SHTYP KANOÇET PËR TA SHITUR METALIN.

1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Gjendja sociale-ekonomike e komunitetit rom dhe qasja e tij në punësim mbeten sfida të mëdha. Në shumë raste, arsimimi i kufizuar dhe mungesa aftësive të mësuara ua kanë pamundësuar romëve punësimin. Gjithashtu, duket se kompanitë private dhe institucionet lokale ngurrojnë t'i punësojnë romët, duke i lënë shumë individë dhe familje të mbështeten në asistencë sociale dhe pensione që paguhen ose nga institucionet e Kosovës, autoritetet serbe apo nga të dyja. Këto shuma janë të pamjaftueshme për ta lehtësuar varfërinë e skajshme të komunitetit. Ligji përcakton kritere strikte për përfshirje në skemën e asistencës sociale dhe shumë romë, ndonëse të cenueshëm në aspektin social, nuk i përmbushin ato. Disa romë angazhohen në punë sezonale, për shembull në ndërtimtari dhe bujqësi. Megjithatë, llojet më të rëndomta të punësimit janë punët joforMeshkuj siç është mbledhja e hekurishteve, apo aktivitete pastrimi që paguhen pak. Një numër shumë i kufizuar i romëve është i punësuar si shërbyes civil në institucionet e Kosës apo në ato të udhëhequra nga Serbia dhe përfaqësohen në sektorin e punësimit publik ose në ish ndërmarrjet shoqërore. Femrat rome janë në mesin e grupeve në pozitë më të pafavorshme në Kosovë dhe vetëm disa prej tyre janë të angazhuara në mënyrë aktive në tregun formal të punës. Për arsye të specifikave kulturore të komunitetit, siç janë mbizotërimi i martesave të hershme dhe shkalla e lartë e femrave që braktisin shkollimin, femrat rome kanë më pak kualifikime dhe aftësi për t'u punësuar se sa meshkujt.

Në Gjilan/Gnjilane, shumica e romëve janë të papunë ose kanë punë joforMeshkuj dhe sipas vlerësimit të përfaqësuesve të komunitetit shumica e tyre ballafaqohet me vështirësi sociale-ekonomike. e njëjta mund të thuhet edhe për rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, ku punësimi joformal dhe i përkohshëm janë burime kryesore të të ardhurave për romët që banojnë në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, Leposavić/Leposaviq dhe Priluzhje/Prelluzhë. Një shkollë fillore në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, që punon sipas kurrikulës

së Serbisë, ka të punësuar një rom si mësues të gjuhës rome si për fëmijët romët ashtu dhe për ata serbë. Vetëm dy femra rome kanë vende forMeshkuj pune; njëra në Komunën e Mitrovicës/Mitrovica dhe tjetra në një organizatë joqeveritare (OJQ). Në rajonin e Pejë/Peć, romët kryesisht punojnë si zejtarë dhe bujq, në veçanti ata që jetojnë në fshatrat Zahaq/Zahać dhe Firajë/Firaje. Të tjerët tregtojnë me rroba të përdorura, hekurishte dhe artizanate në tregje të rajonit. Vetëm një rom është i punësuar në shërbimin civil në burgun e Dubravës, derisa një tjetër është i punësuar në sektorin privat në njëren prej kompanive të telekomunikacionit. Në rajonin e Prishtinës/Priština, shumë romë jetojnë nga mjetet që i marrin nga skema e mirëqenies sociale. Burime tjera të të ardhurave apo asistencës sigurohen nga institucionet e drejtuara nga Serbia në formë të pensioneve ose pagave miniMeshkuj nga ndërmarrjet publike të Serbisë ku ishin të punësuar, siç është “Elektro Privreda Srbije”. Në rajonin e Prizrenit, sipas të dhënave të siguruara nga zyra rajonale për punësim, vetëm 1058 romë (505 femra) janë të regjistruar. Megjithatë, besohet që përqindja është më e lartë, meqë ka mundësi që shumë njerëz nuk e kanë deklaruar se i përkasin komunitetit rom apo nuk janë regjistruar fare. Në Prizren, zyra rajonale për punësim ofron, mes të tjerave, trajnime profesionale për admistrimin të biznesit, teknologji informative dhe automekanikë. Pas përfundimit të kursit, kandidatët marrin një certifikatë dhe zyra ua lehtëson punësimin. Që nga janari 2010 e deri në kohën kur është shkruar ky dokumenti, dhjetë romë (duke përfshirë katër femra) kanë vijuar kursin.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Në Policinë e Kosovës punojnë 17 policë romë (dy femra dhe 15 meshkuj).

Situata e sigurisë e komunitetit rom lidhet në masë të madhe me afërsinë e perceptuar të tyre me komunitetin serb, me të cilët i ndajnë brengat e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes. Përfaqësimi më i madh në Policinë e Kosovës vështirësohet nga mungesa e kualifikimeve adekuate arsimore në mesin e komunitetit, ndërsa pjesëmarrja në forume të sigurisë në nivele komunale dhe lokale është gjithashtu i kufizuar dhe lidhet me sfidat e përgjithshme të angazhimit të komunitetit në jetën publike. Një nga brengat kryesore të sigurisë që prek gratë dhe vajzat rome vazhdon të jetë dhuna në familje dhe në baza gjinore. dhe familjare.

Në korrik 2009, tre sulme nga shqiptarët kundër romëve në vendbanimin Abdullah Presheva/Abdula Preševo në Gjilan/Gnjilane i ngriti tensionet ndërmjet komuniteteve, e që me sa duket nuk ka pasur ndikim në marrëdhëniet afatgjata të komuniteteve.

Situata e sigurisë e komunitetit rom në rajonin e Gjilanit/Gnjilane është në përgjithësi e mirë, ku përfaqësuesit në të gjitha komunat ku jetojnë shprehin kënaqësinë e tyre për disponueshmërinë dhe përgjigjen e Policisë së Kosovës ndaj nevojave të tyre. Megjithatë, është vetëm një rom i punësuar në Policinë e Kosovës në stacionin policor të Novo Brdo/Novobërdës. Në përgjithësi, romët kanë liri të lëvizjes kudo në rajon, duke shfrytëzuar transportin publik apo privat. Komuniteti nganjëherë përdor katër shërbime të transportit humanitar me autobus që i lidhin vendbanimet dhe qytetet në rajon të banuara me romë dhe serbë. Niveli i përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së romëve në këshillat komunalë për siguri në bashkësi nuk është i kënaqshëm, me përfaqësim vetëm në Gjilan/Gnjilane dhe Novo Brdo/Novobërdë dhe pa përfaqësim në Ferizaj/Uroševac dhe Kamenicë/Kamenica. Në Štrpce/Shtërpce këshilli nuk është themeluar ende. Megjithatë, edhe në ato komuna ku marrin pjesë në punën e këshillave, përfaqësuesit

romë nuk janë aktivë në adresimin e brengave të komunitetit, ose nuk shkojnë rregullisht në takime. Këshillat lokale për siguri në bashkësi ekzistojnë në Abdullah Presheva/Abdula Preševo (Gjilan/Gnjilane), Berivojcë/Bervivojce (Kamenicë/Kamenica) dhe Bostan/Bostane (Novo Brdo/Novobërdë) dhe në to marrin pjesë përfaqësuesit romë, me përjashtim të Štrpce/Shtërpçës, ku nuk është themeluar një i tillë.

Komuniteti rom në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica gëzon siguri dhe liri të lëvizjes relativisht të mirë, me vetëm një incident të madh të raportuar në 8 dhjetor 2009, kur një shqiptar ka sulmuar fizikisht një rom në pjesën veriore të Mitrovicë/Mitrovica. Romët udhëtojnë pa problem dhe shfrytëzojnë kryesisht transportin privat. Romët që jetojnë në komunat e Priluzje/Prelluzhës, Vushtrrisë/Vučitrn dhe në Leposavić/Leposaviq udhëtojnë lirshëm dhe marrin pjesë rregullisht në takimet në Mitrovicë/Mitrovica. Nuk ka asnjë policë romë në rajon. Marrëdhëniet ndërmjet Policisë së Kosovës dhe komunitetit në pjesën jugore të Mitrovicë/Mitrovica janë të mira. Ato pësuan një rënie në shkurt 2010 pas intervenimit të policisë në Mëhallën e Romëve si përgjigje ndaj një kontesti rreth aktiviteteve të shpërndarjes së ndihmave nga një OJQ. Një zënkë mes disa romëve dhe policisë rezultoi me arrestimin e dy banorëve të Mëhallës së Romëve, të cilët më vonë u liruan pa u ngritur ndonjë akuzë kundër tyre. Komuniteti pohoi se policia kishte intervenuar duke përdorur forcë të tepruar, por nuk u ngritën akuza kundër policëve të përfshirë. Në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn ekziston këshilli komunal për siguri në bashkësi, por komuniteti rom nuk është i përfaqësuar. Një komitet lokal për siguri publike ishte themeluar në Priluzje/Prelluzhë dhe kishte pjesëmarrje të romëve, por ai nuk funksionon më. Komuniteti nuk merr pjesë në takimet e sigurisë të Administratës së UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM).

Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti raportoi vetëm një incident të sigurisë më 26 shkurt 2010, kur një rom u sulmua fizikisht nga një sulmues i panjohur. Megjithatë, komuniteti në përgjithësi gëzon liri të lëvizjes, duke i shfrytëzuar mjetet publike dhe private të transportit në vend të shërbimeve humanitare me autobus që janë në dispozicion në disa zona. Dy romë janë të punësuar si policë në stacionin policor në Pejë/Peć, ndërsa tre të tjerë shërbejnë në Forcën e Sigurisë të Kosovës (FSK). Komuniteti i beson dhe e lëvdon performancën e njësisë të policisë në bashkësi në tërë rajonin. Komuniteti rom përfaqësohet në këshillat komunale për siguri në bashkësi në Pejë/Peć dhe në zyrën komunale për komunitete në Klinë/Klina. Në komitetin lokal për siguri publike të fshatit Dresnik/Dršnik me popullsi të përzier shqiptare dhe rome, këta të fundit nuk janë të përfaqësuar. Në rajonin e Prishtinës/Priština, romët nuk kanë raportuar ndonjë incident të madh të sigurisë dhe komuniteti lëvizë lirshëm kudo në rajon. Romët kanë qasje në transport publik, që është edhe mënyra më zakonshme e transportit që shfrytëzojnë, derisa disa të tjerë shfrytëzojnë shërbimin e transportit humanitar me autobus nga komuna e Obiliqit/Obilić në komunën e Gračanica/Graçanicës dhe anasjelltas. Nuk ka asnjë rom në rajon që punon në policinë e Kosovës. Komuniteti përfaqësohet rregullisht në këshillat komunale të sigurisë në Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Shtime/Štimlje. Përfaqësuesi rom i këshillit komunal për siguri në bashkësi në Lipjan/Lipljane nuk ka marrë pjesë në takimin e parë dhe të vetmin të tij

Incidentet u raportuan në media dhe morën vëmendjen e akterëve ndërkombëtarë. Përgjigjet nga autoritetet komunale dhe policia u konsideruan efikase dhe thelbësore për rikthimin e besimit të komunitetit të prekur.

Fermat rome janë të prekura rëndë nga dhuna në familje, por shpesh nuk i raportojnë incidentet në Policinë e Kosovës duke iu frikësuar diskriminimit dhe ndëshkimit të mundshëm brenda komunitetit të tyre.

Në komunën e Deçanit/Dečane në rajonin e Pejës/Peć, shumë romë nuk janë të regjistruar zyrtarisht, duke i lënë kështu veçanërisht femrat dhe fëmijët të cenueshëm nga shfrytëzimi dhe abuzimi.

gjatë këtij viti. Në Obiliq/Obilić, një rom është në listën e anëtarëve, ndonëse këshilli nuk është takuar ende. Romët marrin pjesë në komitetin lokal për siguri publike të Janjevës/Janjevo në komunën e Lipjanit/Lipljan.

Në rajonin e Prizrenit, komuniteti nuk ka raportuar asnjë incident të madh të sigurisë gjatë viteve 2009 dhe 2010. Romët kanë liri të mirë të lëvizjes, duke shfrytëzuar kryesisht shërbimin e transportit humanitar me autobus që lidhë komunat e Rahovecit/Orahovac dhe Zvečanit/Zvečan ku jetojnë serbët dhe romët. Katër romë (tre meshkuj dhe një femër) punojnë si policë në rajonin e Prizrenit, që përbën gjysmën e numrit të policëve romë që punonin atje vitin e kaluar. Komandanti rajonal i Policisë së Kosovës e sqaron një ulje të tillë të madhe në numrin e punonjësve romë me ristrukturimin e fundit të policisë, një zhvillim që është perceptuar negativisht nga komuniteti dhe që mund të ketë ndikim në perceptimin e sigurisë dhe besimin në polici. Nuk ka asnjë zyrtar policor të lartë rom të punësuar në rajon. Një rom e përfaqëson komunitetin në Këshillin komunal për siguri në bashkësi në Prizren.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Sipas statistikave të Komisionarit të Lartë të KB për Refugjatë (UNHCR), në vitin 2009 është shënuar një rritje e kthimeve vullnetare në krahasim me vitin 2008, me 214 romë të kthyer në vitin 2009 krahasuar me 86 romë të kthyer në vitin 2008.¹

Procesi i kthimit vullnetar të personave që i përkasin komunitetit rom vazhdon të jetë problematik, ku qëndrueshmëria shpeshherë vështirësohet nga mungesa e mundësive të punësimit dhe integritit të dobët ekonomik të të kthyerve. Faktorë tjerë që ndikojnë negativisht në kthimin dhe riintegrimin e këtij komuniteti janë: vështirësitë për ta kthyer pronën në posedim për shkak të mungesës së përhapur të titujve të regjistruar të pronësisë dhe dokumenteve personale; brengat e sigurisë, interesimit të pamjaftueshëm të donatorëve; dhe përfaqësimi i pamjaftueshëm në organet që kanë të bëjnë me kthimin në nivel lokal dhe qendror. Ashtu siç është raportuar në edicionin e vitit 2009 të Profileve të Komuniteteve, përafërsisht dy të tretat e popullsisë së komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian që vlerësohet të ketë qenë 150,000 para luftës u zhvendos gjatë dhe pas konfliktit të vitit 1999. Siç raportohet, 666 romë mbeten të zhvendosur në Kosovë, që përbën pak më shumë se 3 për qind të numrit të përgjithshëm të personave të zhvendosur brenda Kosovës.⁶ Riatdhesimet me forcë të anëtarëve të komunitetit rom në Kosovë vazhdojnë.

6 Pasqyrë e përgjithshme statistikore e Zyrës së Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë/Priatina Përditësimi i bërë në fund të dhjetorit 2009.

7 Familjet jetonin në prona shoqërore në lagjen Qenar Qeshme/Čener Česma në Gjilan/Gnjilane dhe tani janë të zhvendosur në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

8 Nga 24 familje rome që jetonin në fshat deri në vitin 1999, 18 prej tyre kanë shprehur interesim për t'u kthyer.

9 Gjashtë familje rome, aktualisht të zhvendosura në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, janë të interesuara të kthehen në lagjen Abdullah Presheva/Abdula Preaev ku kanë jetuar deri në vitin 1999.

1 Pasqyrë e përgjithshme statistikore e Zyrës së Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë/Priatina Përditësimi i bërë në fund të dhjetorit 2009.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, gjatë 2009 dhe 2010, janë zbatuar disa nisma që i dedikohen komunitetit rom . Pas kthimit të 48 familjeve rome në lagjet Abdullah Presheva/Abdula Preševo dhe Ivo Lola Ribar në 2004 dhe 2007, interesimi i romëve për t'u kthyer në komunën e Gjilanit/Gnjilane është rritur. Në vitin 2009, komuna ka ndarë tokë komunale në lagjen Gllama/Glama për t'i akomoduar gjashtë familje të zhvendosura rome.⁷ UNHCR dhe Ministria për Kthim dhe Komunitete i ka mbështetur financiarisht rindërtimet. Për më tepër, zyrtarët komunalë kanë marrë pjesë në disa vizita shko-dhe-shih në fshatin Përlepnicë/Prilepnica⁸ dhe qytetin e Gjilanit/Gnjilane.⁹ Zyrtari komunal për kthim e ka shqyrtuar strategjinë komunale për kthim të vitit 2009 dhe e ka hartuar strategjinë për vitin 2010, që parasheh vazhdimin dhe finalizimin e projekteve të kthimit nga viti

2009. Megjithatë, grupi komunal punues për kthim nuk është takuar ende që nga muaji prill 2009. Gjatë vitit 2009 apo edhe në fillim të vitit 2010, në komunat e Kamenicës/Kamenica dhe Ferizajt/Uroševac nuk janë realizuar nisma ose projekte të rëndësishme që lidhen me kthimin dhe interesimi individual nga radhët e romëve për kthim duket i ultë. Aktualisht zyrtari komunal për kthim është duke u shqyrtuar një projekt për kthim të organizuar në fshatin Oraovica/Rahovicë. Asnjë nga 10 familjet rome nga Hogoshti/Ogošte nuk është kthyer ende, por sipas një përfaqësuesi rom në Kamenicë/Kamenica, disa e kanë shprehur interesimin e tyre për t'u kthyer, derisa të tjerët janë të interesuar që të vendosen në fshatin Berivojcë/Berivojce. Grupi punues komunal i Ferizajt/Uroševac takohet rregullisht dhe ka punuar në strategjinë komunale për kthim për vitin 2010. Gjatë 2009 dhe në fillim të vitit 2010, tre familje rome nga qyteti i Ferizajt/Uroševac, aktualisht të zhvendosura, kanë treguar interesim për t'u kthyer dhe për këtë janë duke u planifikuar vizita shko-dhe-informohu dhe shko-dhe-shih. Në Novo Brdo/Novobërdë, shumica e romëve kanë qëndruar në komunë dhe për këtë arsye nuk janë të përfshirë në aktivitetet dhe projektet lidhur me kthimin. Riatdhesimi me forcë i romëve vazhdon dhe mbetet një nga sfidat për komunat në rajon, në veçanti për Ferizajn/Uroševac. Komunat në rajonin e Gjilanit/Gnjilane janë të vetëdijshme për Strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, por ende nuk kanë marrë hapa konkrete për ta implementuar atë. Personat e riatdhesuar shpesh mbesin pa kurrfarë asistence nga autoritetet komunale.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, një numër i romëve janë kthyer vullnetarisht në zonat urbane në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Si pjesë e projektit të kthimit të organizuar, 23 familje janë kthyer vullnetarisht në vitin 2008 dhe 25 në vitin 2009 në Mëhallën Rome në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica.¹⁰ Bashkimi Evropian – Iniciativa për Përkrahjen e romëve, ashkalive dhe egjiptianëve në Mitrovicë/Mitrovica (EU-MRSI) dhe Programi partneriteti kosovar për rivendosjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian (RESTART), i financuar nga Komisioni Evropian dhe USAID, synojnë mbylljen e kampeve Osterode dhe Cesmin Lug në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, që janë të kontaminuara me plumb, dhe t'i vendosin shumicën e banorëve në shtëpitë në Mëhallën e Romëve. Këto programe nuk janë projekte kthimi në vetvete, ndonëse shumë banorë të kampeve janë të zhvendosur nga Mëhalla e Romëve Qëllimi i projektit është që banorët e kampeve të vendosen në një mjedis më të sigurt. Toka ku po bëhet ndërtimi nuk ka qenë pjesë e Mëhallës para konfliktit të vitit 1999. Më tutje, banorët e kampeve që vijnë nga komunat e ndryshme gjithashtu kanë mundësinë për të t'u rilokuar aty. Shtëpitë pritet të përfundohen në vitin 2010, por përfituesit ende nuk janë përcaktuar. Përkundër trysnisë së ushtruar ndaj romëve që t'i braktisin kampet dhe të zhvendosen, sfidat kryesore në zhvillimin dhe implementimin e projektit përfshijnë sigurimin e ndarjes afatgjate të tokës nga komuna për projektin, sigurimi i përkujdesjes së duhur mjekësore për banorët e kampit që vuajnë nga helmimi me plumb, si dhe mungesa e përfshirjes së komunitetit. Të gjitha këto elemente kanë çuar në mungesë të bashkëpunimit ndërmjet organizatorëve të projektit dhe komunitetit rom dhe mosvullnetit të komuniteteve pritëse shqiptare dhe rome për t'i pranuar përfituesit që nuk janë nga Mëhalla e Romëve. Për banorët e kampit të Leposavić/Leposaviq



2000. LAGJJA MËHALLA E ROMËVE NË PJESËN JUGORE TË QYTETIT TË MITROVICËS/MITROVICA, ISHTE SHKATËRRUAR NË TËRËSI GJATË KONFLIKTIT TË VITIT 1999, DUKE I ZHVENDOSUR RRETH 8000 ROMË DHE ASHKALI.

Shifrat e UNHCR-së për kthim tregojnë për kthimin e 50 romëve të zhvendosur janë kthyer mes janarit dhe prillit 2010. Mes vitit 2009 dhe muajit prill të vitit 2010, përafërsisht, 209 romë të riatdhesuar me forcë nga vendet e treta, kryesisht nga vendet e Evropës Perëndimore, u kthyen në Kosovë.¹

¹⁰ Që nga viti 2007, gjithsej 127 familje nga lokacione të ndryshme, përfshirë këtu nga Serbia qendrore, Mali i Zi dhe kampet në veri të lumit Ibër, janë kthyer në gjashtë blloqe të ndërtesave dhe 36 shtëpi individuale, duke siguruar kështu gjithsej 54 njësi.

¹ Po aty.

Komunat e kanë përgjegjësinë për riintegrimin e të kthyerve me forcë, por shumica mbesin të papërgatitura dhe u mungojnë fonde për t'i asistuar në mënyrë adekuate të riatdhesuarit në riintegrimin e tyre në shoqërinë e Kosovës.

ende nuk është gjendur një zgjidhje. Megjithatë, në vitin 2009 dhe muajin maj 2010, u organizuan vizita shko-dhe-shih për në Staritërg/ Stari Trg dhe Tuneli i Parë/Prvi Tunnel në pjesën jugore të Mitrovicës/ Mitrovica për romët e zhvendosur në Beograd. Riatdhesimi me forcë i romëve të Kosovës nëpër komunat e rajonit vazhdon ende. Pas arritjes në aeroportin e Prishtinës/Priština, një numër i familjeve u strehuan përkohësisht dhe më pas gjetën akomodim afatshkurtër tek të afërmit në Mëhallën e Romëve dhe në kampet në Osterode dhe Leposavić/Leposaviq. Në mënyrë që të parandalohen ardhjet tjera në kampet në pjesën veriore të Mitrovicës/ Mitrovica duhet të gjendet një zgjidhje e përhershme e banimit për këta dhe të raste tjera. Në mënyrë të ngjashme, në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn personat e riatdhesuar me forcë në vitin 2009 dhe 2010 kanë pranuar vetëm ndihmë simbolike. Deri më tani, asnjë nga komunat në rajon nuk i ka implementuar strategjitë ekzistuese për riintegrimin e personave të riatdhesuar, e as nuk ka ndarë buxhet të veçantë për ta ndihmuar këtë grup të veçantë për t'u riintegruar në Kosovë.

Në rajonin e Pejës/Pec, disa familje rome janë kthyer në shtëpitë e tyre në komuna të ndryshme gjatë vitit 2009 dhe 2010. Sipas të dhënave të UNHCR-së, 23 romë u kthyen në rajon dhe 34 individë u kthyen para muajit prill 2010¹¹. Në komunën e Istogut/Istok, dy familje rome u kthyen në fshatin Srbobran/Serbobran në kuadër të projektit “Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë” të financuar nga Komisioni Evropian dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe të zbatuar nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP). Në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria nevojitet ndihmë e mëtejshme për t'u përballur me problemet e vazhdueshme që lidhen me vërshimin e vazhdueshëm të vendit të kthimit dhe furnizimit joadekuat me ujë dhe energji elektrike nëpër amvisëri, si dhe për të siguruar zotërimin e sigurt të pronës dhe qasje në dokumente, arsimim dhe mundësi të gjenerimit të të ardhurave për të kthyerit. Në vitin 2009, në kuadër të projektit për kthim “Partneriteti i Qëndrueshëm i Ndhmës për Kthimin e Minoriteteve në Kosovë”¹², disa familje rome janë kthyer nga Qendra Kolektive “Konik II” në Podgoricë, Mali i Zi, në vendbanimin joformal të Brekocit/Brekovac në komunën e Gjakovës/Đakovica.

2008. RINDËRTIMI I LAGJES SË SHKATËRRUAR MËHALLA E ROMVËE NË PJESËN JUGORE TË QYTETIT TË MITROVICËS/MITROVICA FILLOI NË VITIN 2006. PREJ VITIT 2007, GJITHSEJ 127 FAMILJE NGA VENDE TË NDRYSHME TË RAJONIT DHE KAMPET NË VERI TË IBRIT JANË KTHYER NË GJASHTË BLOQE BANESASH DHE 36 SHTËPI INDIVIDUALE, SIPAS REALIZIMIT TË PROJEKTIT QË E FINANCUAN BASHKIMI EVROPIAN DHE USAID-I.

11 Pasqyrë e përgjithshme statistikore e Zyrës së Shefit të Misionit të UNHCR-së në Prishtinë/Priština Përditësimi i bërë në fund të prillit 2010.

12 Programi Partneriteti i Qëndrueshme i Ndhmës për Kthimin e Minoriteteve në Kosovë (SPARK) financohet nga institucionet e Kosovës dhe Qeveria Britanike deri në shumë prej 20 milion dollarë. Programi siguron një mekanizëm të të integruar ombrellë për t'ua ofruar spektrin e plotë të ndihmës shumëtrike kthimeve individuale, spontane apo të organizuara grupore.



Që nga viti 2010, pesë romë janë kthyer në komunën e Pejës/Peć, dhjetë në Trebovic/Treboviq, nëntë në Vitomirica/Vitomiricë dhe dhjetë në Gjakovë/Đakovica. Në komunën e Pejës/Peć, një punonjës i zyrës komunale për komunitete merr pjesë aktive në grupin komunal punues për kthim, duke avokuar për pjesëmarrje më të madhe të personave të zhvendosur dhe përfaqësuesve të fshatit në zhvillimin e strategjisë komunale për kthim dhe aktivitetet e lidhura me kthim. Për romët e zhvendosur nga lagja tërësisht e shkatërruar e “Kristali” dhe nga fshati Trebovic/Treboviq në komunën e Pejës/Peć ende nuk është gjetur një zgjidhje e qëndrueshme. Në komunën e Deçanit/Dečane ka më pak se 40 romë që kanë mbetur. Sipas zyrtarëve komunalë, bashkësia ndërkombëtare është më shumë e fokusuar në kthimin e serbëve se sa në kthimin e romëve, prandaj fondet që e mbështesin kthimin e këtyre të fundit janë të kufizuara. Gjatë dy viteve të kaluara, komuna e Klinës/Klina nuk ka miratuar asnjë projekt-propozim për kthim të romëve të zhvendosur dhe nuk ka zbatuar ndonjë projekt të rëndësishëm që lidhet me kthimin.

Në mes vitit 2009 dhe vitit 2010, në bashkëpunim me zyrtarët komunalë, Këshilli Danez për Refugjatë dhe UNHCR kanë organizuar një seri vizitash shko-dhe-shih që kishin për synim romët aktualisht të zhvendosur në pjesë të ndryshme të Malit të Zi. Zonat e mbuluara përfshinin Klinën/Klina, Serbobranin/Srbobran në komunën e Istogut/Istok, vendbanimin “7 Shtatori/7 Septembar”, si dhe fshatrat Vitomirica/Vitomiricën dhe Ozdrim/Ozrim në komunën e Pejës/Peć. Zyrtarët komunalë nga komuna e Deçanit/Dečane dhe e Gjakovës/Đakovica¹³ morën pjesë gjithashtu në disa vizita shko-dhe-informo në Berane dhe Podgoricë për t'i informuar personat e zhvendosur rreth situatës së sigurisë, lirisë së lëvizjes, qasjes në shërbime publike, qasje në banim dhe mundësi sociale-ekonomike në vendet e tyre të origjinës. Komunitat në rajon, duke përfshirë Klinën/Klina dhe Gjakovën/Đakovica, ende nuk kanë zhvilluar qasje gjithëpërfshirëse për të siguruar zotërimin e sigurt të pronës, përfshi këtu rregullimin e vendbanimeve joforMeshkuj ose ndarjen afatgjate të tokës për të kthyerit. Riatdhesimet me forcë të romëve nga vendet perëndimore vazhdojnë dhe nuk ka mekanizma në nivel komunal që t'i asistojnë këta persona në riintegrimin e tyre, përfshirë këtu banimin e përkohshëm apo të përhershëm.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, një numër i familjeve rome janë kthyer në mënyrë spontane në komuna të ndryshme. Në komunën e Prishtinës/Priština, një familje rome ka përfituar nga ndihma për rindërtim të vendit të banimit nga UNHCR në lagjen “Divanjoll” në qytet, derisa në ish lagjen “Moravska” kanë mbetur vetëm tre nga dhjetë familjet e kthyer më parë në këtë vendbanim. Shtatë familjet tjera janë vendosur në Gračanica/Gračanicë ku jetojnë me të afërmit e tyre. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, projekti “Kthimi dhe Riintegrimi në Kosovë I” përfshinte rindërtimin e shtëpive për dy familje rome. Me ndihmën e UNDP-së, tri familje rome nga kampet në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, një familje e zhvendosur në ish republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe një familje e zhvendosur në Novi Sad janë kthyer në Lipjan/Lipljan në mënyrë spontane. Gjithashtu, shtatë familje rome janë kthyer në Obiliq/Obilić. Disa familje kanë mbetur në barakat e kampit të mëparshëm Plemetinë/Plemetina duke jetuar në kushte të pasigurta. Në tetor 2009, Ministria

13 Që nga viti 2009, komuna e Gjakovës/Đakovica është në fushën e përgjegjësisë të Qendrës Rajonale të OSBE-së në Pejë/Peć, prandaj këtë vit është përfshirë në profil për këtë rajon.

e Shëndetësisë i kërkoi komunës që t'i mbyll barakat e mbetura dhe t'ju gjejë familjeve në fjalë një zgjidhje alternative të banimit. Deri më tani, komuna nuk ka marrë asnjë hap për të gjetur zgjidhje të qëndrueshme. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e komunitetit rom në forumet që lidhen me kthimin vazhdon të jetë e dobët në tërë rajonin dhe nuk kishte konsultime të duhura gjatë zhvillimit të strategjive komunale për kthim në 2009 dhe 2010. Në rajonin e Prishtinës/Priština, Këshilli Danez për Refugjatë i ka lehtësuar vizitat shko-dhe-shih në komunat e Obiliqit/Obilić, Lipjanit/Lipljan, Shtimes/Štimlje dhe Prishtinës/Priština dhe vizitat shko-dhe-informo ku kanë qenë të përfshirë zyrtarët komunalë nga Prishtina/Priština, Obiliqi/Obilić dhe Fushë Kosova/Kosovo Polje. Riatdhesimet me forcë nga vendet perëndimore në komunat e rajonit vazhdojnë. Megjithatë, asnjë nga komunat nuk ka bërë angazhime konkrete për t'i implementuar strategjitë ekzistuese për riintegrimin e personave të riatdhesuar, e as që i kanë ndarë fondet e nevojshme për t'i ndihmuar ata.

Në rajonin e Prizrenit, tetë familje rome janë kthyer në komunën e Prizrenit dhe të Rahovecit/Orahovac në mes vitit 2009 dhe fillimit të vitit 2010. Përfaqësimi dhe pjesëmarrja e komunitetit në forumet lidhur me kthimin është shumë e dobët. Përfaqësuesit e romëve të zhvendosur nuk janë përfshirë në zhvillimin e strategjive komunale për kthim në vitin 2009 dhe 2010, dhe as tani nuk janë të përfaqësuar në mekanizmat e kthimit. Komuna e Prizrenit nuk e fton përfaqësuesin e komunitetit rom në mbledhjet e grupit të punës për kthim, duke pohuar se nuk ka të kthyer të mundshëm nga ky komunitet. Gjatë periudhës për të cilën raportohet, nuk ka pasur projekte të mëdha të kthimit, vizita shko-dhe-shih ose vizita shko-dhe-informo që cak të veçantë kanë pasur komunitetin rom. Komuniteti pohon se grupi punues përqendrohet vetëm në kthimin e serbëve. Në Rahovec/Orahovac, romët marrin pjesë në takimet e grupit komunal të punës. Riatdhesimet me forcë nga vendet e treta në komunat e rajonit vazhdojnë, dhe vetëm komuna e Suharekë/Suva Reka në të kaluarën ka ndarë një për qind të buxhetit të saj vjetor për riintegrimin e personave të riatdhesuar. Përndryshe, nuk janë marrë kurrfarë nismash për regjistrimin civil apo të banimit për ta lehtësuar riintegrimin e personave të riatdhesuar. Destinacioni kryesor i romëve të riatdhesuar është Prizreni. Aty jetojnë shumë romë dhe mundësitë për integrim janë më të mëdha se në komunat tjera.

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Romët u qasen institucioneve të Kosovës dhe institucioneve të drejtuara nga Serbia, varësisht nga vendi ku jetojnë dhe disponueshmëria e shërbimeve. Në mënyrë specifike, romët që jetojnë më veri të lumit Ibër u qasen pothuajse ekskluzivisht shërbimeve të ofruara nga Serbia, derisa ata që jetojnë në jug të lumit Ibër i shfrytëzojnë ato në komunat e Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdës Štrpce/Shtërpçës, Vushtrrisë/Vučitrn, Gračanica/Graçanicës, Obiliqit/Obilić, Lipjanit/Lipljan, Deçanit/Dečane, Gjakovës/Đakovica dhe Rahovecit/Orahovac. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, situata nuk ka ndryshuar shumë

dhe komuniteti rom kryesisht varet nga institucionet e drejtuara nga Serbia për sa i përket arsimimit, sigurimit të ndihmës sociale, pensioneve dhe përkujdesjes shëndetësore. Në mënyrë të ngjashme, në Mitrovicë/Mitrovica, fëmijët romë nga Mëhalla e Romëve dhe nga kampet Cesmin Lug dhe Osterode në pjesën veriore të qytetit dhe fëmijët romë nga kampi i Leposavić/Leposaviqit i vijnë mësimet në shkolla sipas kurrikulës së Serbisë. Veç kësaj, të kthyerit në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica përdorin sistemin arsimor të institucioneve të Kosovës ose atë të drejtuar nga Serbia. Trendi në rajonin e Prishtinës/Priština nuk ndryshon shumë situata në rajonet tjera. Njerëzit iu qasen shërbimeve të ofruara institucionet e drejtuara nga Serbia kryesisht për përkujdesje shëndetësore, regjistrim civil, arsimim, mirëqenie sociale dhe pensione. Situata në rajonin e Prizrenit dallon pak: romët i shfrytëzojnë shkollat dhe objektet shëndetësore të drejtuara nga Serbia vetëm në Rahovecin e epërm/Orahovac dhe Velika Hoča/Hoçë e Madhe.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Qasja e komunitetit në shërbime komunale vazhdon të jetë sfidë kudo në Kosovë. Brengat kryesore përfshijnë pamundësinë për t'i mbuluar shpenzimet administrative dhe të shërbimeve publike, mungesën e dokumenteve të nevojshme personale dhe njohuria e kufizuar për institucionet relevante dhe zyrat ku romët mund t'i drejtojnë brenga e tyre. Pas nënshkrimit të marrëveshje kolektive me Korporatën Energjetike të Kosovë (KEK) për t'i ngrirë borxhet dhe për fillimin e pagesës së rregullt të faturave nga amvisëritë rome, furnizimi me energji elektrike është përmirësuar në përgjithësi. Megjithatë, në disa raste çkyçjet kolektive kanë vazhduar dhe pagesa e borxhit të mbetur, që duhet bërë dikur, vazhdon të jetë brengë. Komuniteti nuk ka ngritur ankesa të mëdha lidhur me qasjen në ujë, derisa mbledhja jo e rregullt e mbeturinave paraqet rrezik shëndetësor për komunitetin. Procesi i rregullimit të vendbanimeve joformeshkuj nuk ka avancuar, ndonëse ka disa projekte në zhvillim e sipër.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, qasja në shërbimet administrative komunale, duke përfshirë edhe shërbimet e regjistrimit civil, vazhdon të jetë e kënaqshme. Shumica e romëve e flasin së paku njërin nga gjuhët zyrtare, gjegjësisht gjuhën shqipe ose serbe, gjë që e lehtëson shumë qasjen. Për më tepër, në Kamenicë/ Kamenica, Gjilan/Gnjilane dhe Ferizaj/Uroševac, ka romë të punësuar në zyrën komunale për komunitete që e lehtëson qasjen e komunitetit në shërbime. Përpyekjet për t'i rregulluar pagesat e KEK-ut që nga viti 2009 e kanë përmirësuar furnizimin me energji elektrike dhe shtëpitë që e paguajnë atë nuk përballesh me çkyçje të mëdha. Kudo në rajon, komuniteti rom ka qasje në shërbime të ujit, kanalizimit dhe të mbledhjes së mbeturinave, aty ku është e mundur, në mënyrë të barabartë me komunitetet tjera. Në mënyrë të ngjashme, në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, qasja në shërbime dhe shërbime publike është mjaft e kënaqshme, Megjithatë, mbledhja joadekuate e mbeturinave ka ndikim te komuniteti kudo në rajon, duke paraqitur rrezik serioz për shëndet. Që nga viti 2007, banorët e mëhallës së romëve i kanë akumuluar borxhet e tyre dhe, në

Ndonëse qasja në shërbime komunale në përgjithësi vlerësohet si e kënaqshme, institucionet duhet t'i shtojnë angazhimet e tyre për ta përkrahur regjistrimin civil dhe qasjen e plotë në dokumente personale.

Nënshkrimi i kontratave kolektive në mes KEK dhe komunitetit e ka përmirësuar qasjen në furnizim me energji elektrike. Megjithatë, disa fshatra mbetën të çkyçura për disa javë gjatë dimrit. Nevojiten angazhime shtesë për ato vendbanime që ende nuk kanë nënshkruar marrëveshje, dhe për shlyerjen e borxheve të vjetra, duke i pasur parasysht kushtet e rënda ekonomike në të cilat jeton komuniteti.

Siç pohohet, pas ankesave të shqiptarëve në Plemetinë/ Plemetina lidhur me sasinë e mbeturinave të pambledhura, komuna shpenzoi 20,000 euro nga buxheti i zyrës komunale për komunitete për ta ndërtuar një mur që rrethon dy ndërtesat për banim social ku jetojnë kryesisht romët. Zyrtarët komunalë e arsyetuan një ndarje të tillë si masë sigurie për fëmijët. Përkritazi me mbledhjen e mbeturinave brenda murit, nuk është raportuar ndonjë përmirësim.

kohën kur po shkruhej ky dokument, përfaqësuesit e komunitetit ishin duke biseduar me KEK-un dhe komunën e Mitrovicës/Mitrovica për mënyrat e shlyerjes së borxhit dhe rregullimit të furnizimit.

Në rajonin e Pejës/Peć, brenga kryesore ka të bëjë me regjistrimin civil për arsye të hezitimit të komunitetit për t'u regjistruar, mungesa e përhapur e vetëdijesimit rreth procesit dhe mungesa e dokumenteve të nevojshme. Rezultatet e fushatave për regjistrim civil të komunitetit nuk kanë qenë të kënaqshme, ndonëse kanë pasur përkrahjen e komunave të Deçanit/Dečane, Istogut/Istok dhe Klinës/Klina. Lidhja me kanalizim, ujësjellës, energji elektrike dhe mbledhjen e mbeturinave vazhdon të jetë problematike në komunat e Deçanit/Dečane, Istogut/Istok, Klinës/Klina dhe Pejës/Peć. Në veçanti, vendbanimet joforMeshkuj në Pejë/Peć ende nuk kanë sisteme adekuate të ujësjellësit dhe kanalizimit. Faturat e papaguara të energjisë elektrike të ujësjellësit rajonal "Hidrodrini" rezultoi me çkyçje të shpeshta të pompave të ujit, që i lanë shumë banorë pa ujë të pijshëm. Megjithatë, në kohën kur po shkruhej ky dokument, KEK-u dhe "Hidrodrini" me ndihmën e OSBE-së arritën marrëveshje për t'i rivendosur shërbimet në disa lokacione. Çkyçja e fundit e energjisë elektrike në muajin mars 2010 në vendbanimin "7 Shtatori/7 Septembar" zgjati tri javë. Performanca e dobët e kompanisë përgjegjëse për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave në vendbanimet joforMeshkuj i ka detyruar banorët që të organizohen për t'i pasur kushtet themelore higjienike. Ndonëse qasja e përgjithshme në shërbime administrative komunale në rajonin e Prishtinës/Priština vazhdon të jetë e kënaqshme, shumë romë nuk mund t'i paguajnë pagesat për dokumentet personale. Në mënyrë që të zgjidhet kjo çështje, në vitin 2010 kuvendet komunale të Obiliqit/Obilić dhe Shtimes/Štimlje i kanë liruar romët e cenueshëm nga pagesa e pagesave komunale për sigurimin e dokumenteve të nevojshme për të aplikuar për ndihmë sociale.¹⁴ Vendbanimet e romëve në Prishtinë/Priština kanë qasje në shërbimet themelore komunale por mbledhja e mbeturinave mbetet problem. Në Fushë Kosovo/Kosovo Polje, Gračanica/Graçanicë dhe Obiliq/Obilić, kompania publike përgjegjëse nuk ofron shërbime të rregullta. Prandaj, në afërsi të zonave ku banon komuniteti rom formohen deponi të paligjshme të mbeturinave. Në rajonin e Prizrenit, sigurimi i ujit dhe energjisë elektrike e reflekton situatën e rajoneve tjera. Mbledhja e mbeturinave duket të jetë më pak problematike, ndonëse në disa raste pagesat janë të larta dhe mospagesa e tyre shpesh rezultojnë me sigurimin jo të rregullt të shërbimeve. Në prill 2010, në përpjekje për ta implementuar Strategjinë për integrimin e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian komuna e Prizrenit dhe e Suharekës/Suva Reka i ftuan romët që nuk kishin dokumente të regjistrimit civil që t'i drejtohen zyrrave komunale për t'u pajisur me dokumente personale pa pagesë. Veç kësaj, zyrtari komunal për kthim dhe kryesuesi i komitetit për komunitete në Suharekë/Suva Reka filloi një fushatë vetëdijesimi derë-më-derë në vendbanimet ku jeton komuniteti rom.

6. Qasja në shërbime sociale

Komuniteti rom vazhdon të mbështetet në masë të madhe në ndihmën sociale të siguruar nga qendrat e Kosovës për mirëqenie sociale, ose nga institucionet e drejtuara nga Serbia, kur ekziston

¹⁴ Sipas ligjit, njerëzit e përfshirë në skemën për ndihmë sociale duhet t'i paraqesin dokumentet e tyre personale çdo gjashtë muaj në mënyrë që t'ju vazhdohet ndihma.

një mundësi e tillë. Mungesa e dokumenteve të regjistrimit civil vazhdon të jetë pengesa kryesore për qasje në shërbime sociale. Përfaqësuesit e komunitetit rom ankohen se skema e Kosovës nuk është gjithëpërfshirëse sa duhet për t'i përfshirë të gjithë skamnorët, duke e lënë shumicën e tyre pa përkrahje për shkak të kriterëve strikte për të përfituar. Lloji i ndihmës sociale që jepet më së shumti është pagesa për familje në shumë prej 40 dhe 60 euro në muaj.

Ndikimi i skemave të mirëqenies sociale në zbutjen e varfërisë së skajshme në mesin e komunitetit rom është i pamjaftueshëm dhe ndihma nuk i arrin më të cenueshmit

7. Qasja në pronë dhe banim

Problemet që lidhen me qasjen në pronë dhe banim vazhdojnë të jenë ndër çështjet më serioze për komunitetin rom. Mungesa e dokumenteve adekuate, shkatërrimi gjatë konfliktit i dokumenteve që dëshmojnë të drejtat mbi pronësinë, mosfunksionimi i shpeshtë i zyrave komunale të kadastrit dhe konceptimi i gabuar i përgjithshëm në mesin e komunitetit për të drejtat pronësore janë disa nga faktorët që ia parandalojnë kthimin e posedimit mbi pronën atyre që i kanë humbur ato. Për shumë romë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, statusi ligjor i pronave të tyre mbetet i pazgjidhur. Situata është veçanërisht e vështirë në lagjen Abdullah Presheva/Abdulla Preševo, ku vetëm rreth 10% të familjeve romë i gëzojnë plotësisht të drejtat e tyre pronësore. Për më tepër, përafërsisht 60 shtëpi janë të uzurpuara në mënyrë të paligjshme dhe 19 përfitues të mëparshëm nga faza e dytë¹⁵ e projektit të kthimit SPARK vazhdojnë të përballen me vështirësi në regjistrimin e shtëpive të rindërtuara. Familjet romë në komunat e Novo Brdo/Novobërdës, Kamenicë/Kamenica dhe Štrpce/ Shtërpçës në përgjithësi kanë qasje në ujë të pijshëm, energji elektrike, kanalizim dhe rrugë të asfaltuara. Megjithatë, kushtet e jetesës janë shpesh joadekuate për shkak të kushteve higjienike. Rindërtimi i shtëpive të të kthyerve në Mëhallën Rome në pjesën jugore të Mitrovicës/ Mitrovica vazhdon. OJQ-ja Norwegian Church Aid i ka finalizuar dy ndërtesa banimi shtesë në korrik 2009, dhe 25 familje kanë hyrë në ato me një kontratë qiraje për 99 vjet. Dy programe shtesë, të financuara nga USAID dhe Komisioni Evropian, janë duke u zbatuar dhe synojnë që banorët e kampeve në veri të kontaminuara me plumb të rilokohen më afër Mëhallës së Romëve. Qëllimi është që të ndërtohen deri në 140 shtëpi ku do të vendosen të gjithë banorët e kampeve të kontaminuara me plumb. Megjithatë ende nuk ka një plan komunal që rregullon tërë Mëhallën.

Qasja në pronë dhe banim për komunitetin rom vazhdon të jetë pengesa më e madhe për integrimin e mirëfilltë në shoqëri dhe mundësinë për të jetuar në kushte adekuate.

Në rajonin e Pejës/Peć, çështja e pronës vazhdon të jetë një nga pengesat kryesore për integrimin e romëve. Rastet më serioze gjenden në vendbanimet “Kristali” në Pejë/Peć, Rudesh/Rudeš në Istog/Istok dhe “Ali Ibra/Kolonia” në Gjakovë/Đakovica.¹⁶ Mungesa e projekteve që synojnë rregullimin e vendbanime joforMeshkuj paraqet sfida përkitazi me të drejtën për kthim. Për shembull, banorët e mëparshëm të “Kristali”, të cilët janë aktualisht të zhvendosur, ende nuk mund të kthehen në vendin e tyre të origjinës dhe ta kthejnë në posedim pronën e tyre. Megjithatë, në kohën kur është hartuar ky dokument, komuna e Pejës/Peć ishte duke e hartuar planin rregullues urbanistik për vendbanimet “Kristali” dhe “7 Shtatori” që parashihte konsultime publike dhe pjesëmarrjen e komuniteteve të prekura. Kthimi në Rudesh/Rudeš vazhdon të jetë sfidues për romët e zhvendosur që nga përfshirja e vendbanimit brenda zonës

15 SPARK është një program që e ka për cak kthimin e organizuar dhe vullnetarë të financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe qeveria e Britanisë, zbatuar nga UNDP.

16 Rajoni i Pejës/Peć ka gjithsej 75 vendbanime ku jetojnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.

Mungesa e projekteve dhe politikave qeveritare që kanë për synim rregullimin e vendbanimeve joforMeshkuj të mëparshme apo të tanishme e rrezikon të drejtën për kthim të atyre që janë ende të zhvendosur dhe të drejtën për pronë dhe zotërim të sigurt të saj për ata që janë në Kosovë.

Fëmijët romë vazhdojnë të kenë probleme për ta nisur dhe përfunduar shkollimin. Arsytet përfshijnë përjashtimin social, varfërinë dhe stereotipizimin kulturor që i prekin shumë familje rome. Kjo vlen veçanërisht për vajzat rome.

së mbrojtur rreth Manastirit ortodoks serb të Gorioçit. Disa familje kanë pranuar ndërrimin e tokës dhe tani jetojnë në fshatin Srbobran/Serbobran.¹⁷ Procesi i rregullimit të vendbanimit “Ali Ibra/Kolonia” filloi pas nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit në shtator 2009.¹⁸ Në rajonin e Prishtinës/Priština, asnjë nga komunat nuk kanë zhvilluar plane urbanistike që mëtojnë rregullimin e vendbanimeve joforMeshkuj dhe nuk ka kurrfarë nisma lidhur me kthimin e pronës apo kompensimin. Implementimi i projekteve të banimit social në “Plemetinë/Plementina” në komunë të Obiliqit/Obilić, Magurë/Magura në Lipjan/Lipljane dhe Malishevë/Mališevo, ka treguar që në mënyrë që të sigurohet qëndrueshmëria duhet të eksplorohehen dhe miratohen zgjidhje të duhura kulturore duke përfshirë banimin dhe kushte adekuate të jetesës. Në Prizren, komuniteti rom jeton në kushte të këqija të jetesës dhe pa infrastrukturë adekuate, që janë tipike për zonat rurale dhe nënurbane ku komuniteti banon tradicionalisht.

8. Qasja në arsim

Ndonëse nuk ka pengesa forMeshkuj për integrimin e komunitetit në shkollat me kurrikulë të Kosovës ose të Serbisë, regjistrimi në shkolla dhe vijimi i mësimin nga nxënësit romë vazhdon të jetë problem. Rastet e braktisjeve të hershme të shkollimit, veçanërisht në mesin e vajzave, vazhdojnë. Ndonëse familjet që marrin ndihma sociale kanë të drejtë në shkollim parashkollor pa pagesë, shumë fëmijë romë nuk e shfrytëzojnë këtë shërbim. Faktorët e rëndomtë që e pengojnë qasjen e plotë të tyre në arsimim vazhdojnë të jenë përjashtimi social, shkalla e lartë e varfërisë dhe traditat kulturore që rezultojnë gëzim të pabarabartë të të drejtave për arsimim nga fëmijët romë. Për më tepër, të kthyerit romë shpesh përballen me vështirësi në regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë për shkak të mungesës së regjistrimit civil ose vështirësive në marrjen e dokumenteve që pranohen nga institucionet e Kosovës gjatë kohës sa janë të zhvendosur. Vajzat vazhdojnë të jenë kategoria më e cenueshme brenda komunitetit. Ato shpesh detyrohen të martohen në moshë të re dhe të bëjnë punë shtëpiake që nga fëmijëria, si dhe largohen madje edhe nga shkollimi i detyrueshëm. Ndonëse Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës siguron tekste shkollore për të gjitha lëndët nga klasa e parë e deri në klasën e nëntë në tërë Kosovën, vetëm disa fëmijë romë përfitojnë nga kjo nismë meqë shumica prej tyre e arsimohen sipas kurrikulës së Serbisë. Në shkollat që punojnë sipas kurrikulës së Serbisë në komunat e Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica, Mitrovicës/Mitrovicë, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, dhe Lipjanit/Lipljan, ofrohen orë mësimi në gjuhën rome. Në qershor 2010, Ministria e Arsimit e Kosovës miratoi një kurrikulë në gjuhën rome me qëllim të implementimit të saj në shtator 2010.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, fëmijët romë në përgjithësi i vijnë shkollat që punojnë sipas kurrikulës së Serbisë në komunat e Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica, Novo Brdo/Novobërdës dhe Štrpce/Shtërpçës. Në Ferizaj/Uroševac, ata e vijnë mësimin në shkollat sipas kurrikulës së Kosovës. Në shkollën fillore “Vuk Karadžić” në Gjilan/Gnjilane dhe në shkollën fillore në Berivojcë/Berivojce në Kamenicë/Kamenica, fëmijët romë mbajnë orë mësimi në gjuhën rome dy herë në javë. Problemet që ndërlidhen me përfundimin e

¹⁷ Kjo i prek kryesisht anëtarët e komunitetit egjiptian, të cilët kanë qenë të zhvendosur në Mal të Zi. Për më tepër informata, shih kapitullin për qasjen në pronë dhe banim të komunitetit egjiptian. ¹⁸ Dokumenti u nënshkrua më 24 shtator 2009 nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, zyra për çështje të komuniteteve, komuna e Gjakovës/akovica, Caritas-i i Zvicrës dhe një përfaqësues i komunitetit.



NJË VAJZË ROME DUKE E VIJUAR MËSIMIN BASHKË ME NXËNËSIT SERBË TË KOSOVËS NË SHKOLLËN E DREJTUAR NGA SERBIA NË FSHATIN VRBOVAC/VËRBOC TË KOMUNËS SË THEMELUAR RISHTAS TË KLOKOT/ KLOKOTIT.

shkollimit të detyrueshëm dhe rrjedhimisht qasjes në shkollim të mesëm vazhdojnë. Vetëm 34 fëmijë romë i vijojnë mësimet sipas kurrikulës së Kosovës në shkollën e mesme dhe vetëm gjashtë, nga të cilët një është femër, e vijojnë shkollimin e lartë në rajonin e Gjilanit/Gnjilane. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti rom ka qasje në objektet parashkollore, të arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm të lartë. Qasja fizike në objektet shkollore nuk konsiderohet problematike. Megjithatë, problemet vazhdojnë në Mëhallën e Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, ku 64 fëmijë duhet të udhëtojnë çdo ditë për në shkollë në pjesën veriore të qytetit dhe komuna nuk u siguron transport. Fëmijët romë i vijojnë mësimet kryesisht në shkollat e drejtuara nga Serbia në Leposavić/Leposaviq, pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës dhe Priluzje/Prilluzhë (Vushtrri/Vučitrn). Pas kthimit të tyre në Mëhallën e Romëve, 43 fëmijë janë regjistruar në shkollat me kurrikulë të Kosovë, por vetëm tre prej tyre i ndjekin mësimet rregullisht. Shkalla e braktisjes së hershme të shkollimit dhe e mosregjistrimit vazhdojnë të jenë të larta dhe, ashtu si në rajonet tjera, vajzat ndikohen në veçanti nga kjo.

Në rajonin e Pejës/Peć, romët përballen me pengesa të ngjashme me ato të komunitetit në rajonet tjera, me shkallë të ulët të shkollimit dhe përjashtim nga shoqëria. Mungesa e objekteve arsimore të drejtuara nga Serbia në zonat e rajonit të banuara nga romët ndikon negativisht në qasjen dhe gëzimin e komunitetit të të drejtave arsimore. Komunitet nuk tregojnë angazhim të mirëfilltë për të promovuar vijimin e shkollimit për romët, me përjashtim të Pejës/Peć ku është caktuar një anëtarë romë i zyrës komunale për komunitete për të promovuar vijimin e shkollimit në mesin e komunitetit. Rezultatet nuk janë të dukshme ende. Në komunat e Deçanit/Dečane, Klinës/Klina dhe Istogut/Istok, romët nuk vijojnë arsimin parashkollorë, ndonëse shumica e fëmijëve e vijojnë shkollimin e detyrueshëm në shkollat shumetnike në Kosovë. Në rajonin e Prishtinës/Priština, shumica e fëmijëve romë e vijojnë mësimin parashkollor në institucionet e drejtuara nga Serbia, meqë shumica e tyre e flasin gjuhën Serbe. Disa nxënës i vijojnë mësimet në gjuhën shqipe në Obiliq/Obilić, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Podujevë/Podujevo sipas kurrikulës së Kosovës. Veç kësaj, në Ugljare/Ugljare, komuna e Gračanica/

Graçanicës, dhe në Janjevë/Janjevo, komuna e Lipjanit/Lipljan, nxënësve romë që i vijojnë mësimet në shkollat e drejtuara nga Serbia u mbahen orë mësimi në gjuhën rome dy herë në javë. Shpesh, kushtet shumë të rënda të jetesës të këtij komuniteti e kufizojnë qasjen e plotë dhe të papenguar në objekte parashkollore. Disa fëmijë nga Obiliqi/Obilić, Fushë Kosova/Kosovo Polje dhe Gračanica/Graçanicë marrin ndihmë financiare nga OJQ-të për të blerë rroba dhe materiale shkollore. Ata që jetojnë në ndërtesën për banim social në Magura/Magure e kanë problem kryesor atë që nuk sigurohet transporti për në shkollat e drejtuara nga Serbia në Lipjan/Lipljan, kështu nuk mund të shkojnë atje rregullisht. Në rajonin Prishtinë/Priština, ka 37 nxënës romë që i vijojnë mësimet e shkollës së mesme në institucione të drejtuara nga Serbia në Gračanica/Graçanicë dhe Obiliq/Obilić. Asnjë prej tyre nuk e vijon shkollimin e lartë në institucionet e Kosovës, ndonëse ka 75 vende të rezervuara për komunitetet joshumicë në Universitetin e Prishtinës/Priština. Në rajonin e Prizrenit, shumica e fëmijëve romë i vijojnë mësimet në gjuhën shqipe sipas kurrikulës së Kosovës, ndonëse ka raste kur romët i vijojnë mësimet sipas kurrikulës së Kosovës në gjuhën turke ose boshnjake. Veç kësaj, tre fëmijë romë i vijojnë mësimet në shkollën fillore të drejtuar nga Serbia në Velika Hoča/Hoçë e Madhe dhe pesë fëmijë romë i ndjekin mësimet në shkollën fillore të drejtuar nga Serbia në Rahovec të Epërm/Orahovac. Shumë familje rome nuk kanë mundësi t'i blejnë tekstet shkollore dhe materialet e nevojshme, që e vështirëson vazhdimin e shkollimit edhe më shumë. Ata që i vijojnë mësimet në gjuhën boshnjake dhe në atë turke nuk i kanë marrë të gjitha tekstet shkollore që sigurohen pa pagesë, sepse disa libra nuk janë në dispozicion ose janë duke u shtypur.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Në mars të vitit 2009, Komisionari për të Drejta të Njeriut i Këshillit të Evropës theksoi që situata e personave të zhvendosur në kampin Osterode në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës është “një katastrofë humanitare e natyrës më të rëndë” dhe u bëri thirrje urgjente “të gjithë atyre me përgjegjësi për të siguruar që familjet e prekura mund të shkojnë pa vonesë në një mjedis të sigurt dhe që trajtimi përkatës mjekësor t’u ofrohet të gjithë të helmuarve”.

Në përgjithësi, komuniteti rom ka qasje në përkujdesje primare dhe sekondare shëndetësore dhe zgjedhin që t’i drejtohen sistemit të Kosovës ose atij të financuar nga Serbia, varësisht nga disponueshmëria, pozita gjeografike dhe shpenzimet. Shumë romë nuk mund t’i paguajnë operacionet dhe medikamentet e shtrenjta në sektorin shëndetësor privat. Sistemi shëndetësor i Kosovës ofron trajtim mjekësor pa pagesë në raste specifike që mbulohen sipas skemës së ndihmës sociale. Megjithatë, kriteret për përfshirje në atë janë mjaft strikte dhe një numër i madh i individëve të cenusëm nuk mund të përfitojnë nga ajo. Për dallim nga kjo, çdo person që ka librezë shëndetësore mund të shfrytëzojë shërbimet pa pagesë në institucionet shëndetësore të drejtuara nga Serbia. Femrat rome mbesin në pozitë veçanërisht të pafavorshme, me mungesë të përhapur të njohurisë për çështjet shëndetësore dhe barrierave kulturore që e pamundësojnë qasjen e tyre të papenguar në përkujdesje shëndetësore. Për më tepër, autoritetet kanë pasur shumë pak nisma për t’i adresuar çështjet siç janë shëndeti riprodhues dhe lindjet në shtëpi dhe OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare i kanë zëvendësuar shpeshherë institucionet e Kosovës në ofrimin e trajnimeve dhe ngritjen e njohurisë në mesin e komunitetit.

Në Gjilan/Gnjilane dhe Ferizaj/Uroševac, komuniteti rom ka qasje në përkujdesje primare dhe sekondare shëndetësore. Romët nga Štrpce/Shtërpca dhe Novo Brdo/Novobërda udhetojnë për në Gračanica/Graçanicë ose në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës për të marrë shërbime sekondare shëndetësore. Romët nga Kamenica/Kamenica gjithashtu shfrytëzojnë institucionet e financuara nga Serbia për përkujdesje sekondare shëndetësore. Fëmijët romë në rajonin e Gjilanit në përgjithësi i marrin vaksinat e detyrueshme. Në Mitrovicë/Mitrovica, helmimi me plumb i romëve që jetojnë në kampet në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica mbetet problem serioz për komunitetin. Romët që jetojnë në kampet në Cesmin Lug dhe Osterode më nivel të lartë të kontaminimit me plumb, të helmuarit në kampin në Leposavić/Leposaviq dhe të kthyerit në Mëhallë të Romëve nga kampet në korrik të vitit 2009 ende nuk kanë marrë trajtimin përkatës mjekësor. Romët që jetojnë në komunat veriore në përgjithësi e shfrytëzojnë përkujdesjen shëndetësore pa pagesë në spitalet dhe qendrat e mjekësisë të drejtuara nga Serbia në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica. Komuniteti në Mëhallën e Romëve ka qasje në qendrën e mjekësisë së drejtuar nga Kosova që është rindërtuar në lagje në kuadër të një procesi në vazhdim e sipër për kthim. Megjithatë, ka vështirësi në kuptim të mungesës së medikamenteve dhe numrit të kufizuar të punonjësve mjekësorë. Romët në Priluzje/Prelluzhë në komunën e Vushtrisë/Vučitrn e shfrytëzojnë qendrën e mjekësisë në fshat, të financuar nga Serbia.

Në Pejë/Peć, romët zakonisht shfrytëzojnë spitalet rajonale në Pejë/Peć dhe Gjakovë/Đakovica dhe qendrat e mjekësisë të drejtuara nga Kosova në fshatrat ku jeton komuniteti. Romët që jetojnë në Deçan/Dečane dhe Klinë/Klina përballen me vështirësi për qasje në përkujdesjen adekuate shëndetësore për shkak të përjashtimit social, lirisë së kufizuar së lëvizjes, perceptimit të pasigurisë dhe varfërisë së skajshme. Qendra e mjekësisë në lagjen “Fidanishte/Institut” në Pejë/Peć është një nga vendet ku shumica e komunitetit rom shkon për ekzaminime mjekësore. Qendra ka dy infermiere që u ofrojnë grave këshilla për shëndetin riprodhues. Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti rom ka qasje në shërbimet shëndetësore në dispozicion, duke i parapëlqyer institucionet e drejtuara nga Serbia. Mbyllja e qendrës së mjekësisë në komunën e Lipjanit/Lipljan në mars të vitit 2010 pati ndikim të madh në banorët romë. Ata shfrytëzojnë momentalisht qendrat e mjekësisë në Laplje Selo/Lapllasellë ose Gračanica/Graçanicë, edhe pse shpenzimet e transportit paraqesin një vështirësi shtesë për më të cenueshmit. Me përkrahje të Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsi dhe në bashkëpunim me qendrën komunale për mjekësi familjare, OJQ “Shëndet për të gjithë” ofron punëtori për edukatë shëndetësore, duke përfshirë shëndetin riprodhues dhe sëmundjet e transmetuara seksualisht. Punëtoritë mbahen në komunat e Lipjanit/Lipljan dhe Fushë Kosovës/Kosovo Polje. Derisa romët në Prizren shfrytëzojnë shërbimet e përkujdesjes shëndetësore primare dhe sekondare në institucionet e drejtuara nga Kosova, ata që jetojnë në Rahovecin/Orahovac e Epërm shfrytëzojnë përkujdesjen shëndetësore sekondare – duke përfshirë shërbimet e shëndetit riprodhues – që e ofrojnë institucionet serbe. Pamundësia e qasjes fizike për ata që jetojnë nga zonat rurale dhe pamundësia e më të cenueshmëve për t’i mbuluar shpenzimet mjekësore paraqesin pengesa kryesore për komunitetin rom për ta realizuar të drejtën

Një raport i kohës së fundit thekson që, edhe pse në Mëhallën e Romëve ka nivel të lartë të kontaminimit me plumb, koncentrimi i plumbit është në përgjithësi më i ulët se në pjesët tjera të qytetit dhe tejet më i ulët se në kampe.¹

Në komunën e Pejës/Peć, zyra komunale për komunitete e përkrah komunitetin për qasje në sistemin e drejtësisë.



PJESË E KOMPLEKSIT TË TREPÇËS. AKTIVITETET EKONOMIKE METALURGIJE DHE TË MIHJES KANË HISTORI TË GJATË NË KOMUNAT VERIORE TË MITROVICËS/MITROVICA DHE ZVEÇAN/ZVEÇANIT. PREJ VITIT 1999, BANORËT E TRI KAMPEVE TË REFUGJATËVE, KRYESISHT ROMËT, I JANË EKSPOZUAR NË MASË TË MADHE PLUMBIT QË E PËRMBAN DHEU NGA INDUSTRIËTË E MËDHA TË MIHJES DHE SHKRIRJES.

¹ Shih faqen 36 të Raportit Fluvio Nr. 2010/02/66, Vlerësim gjeokimik i dheut në Mëhallën e Romëve, Mitrovicë, Kosovë: implikimet e zhvendosem e propozuar të familjeve që jetojnë momentalisht në kampet Osterode dhe Cesmin Lug (Institut i Gjeografisë dhe Shkencave Tokësore, Universiteti i Uellsit, Aberystwyth) të datës 11 mars 2010.

Mjekët dhe infermieret e theksojnë nevojën thelbësore për fushata informimi dhe trajnime për shëndetin riprodhues për femrat rome. Për shkak të disa faktorëve, femrat rome nuk kanë qasje në shërbimet përkatëse të përkujdesjes shëndetësore. Si rrjedhim, kjo ka ndikim të konsiderueshëm në gratë, fëmijët dhe gjeneratat e ardhshme.

për shëndet. Romët kanë qasje në spitalet dhe qendrat e mjekësisë rajonale në komunat e Prizrenit, Mamuša/Mamushës/Mamuša, Rahovecit/Orahovac, Suharekës/Suva Reka dhe Malishevës/Mališevo. OJQ "Fondacioni Kosovar i Shëndetësisë" ka ofruar rishtas trajnime për romët me qëllim të rritjes së njohurisë së komunitetit për çështje shëndetësore. Pastaj, me përkrahje të OSBE-së, ata që morën pjesë në trajnime organizuan aktivitete pasuese, siç ishin seminarët për shëndet riprodhues, përkujdesje për të porsalindurit, ushqyerjen me gji, përdorimin e mjeteve kontraceptive, efektet negative të konsumimit të drogës dhe sëmundjet e transmetuara seksualisht, që ishin të dedikuara kryesisht për femrat rome.

10. Qasja në drejtësi

Në Prizren, një prokuror rom punon në Prokurorinë e Qarkut..

Romët kanë në përgjithësi qasje forMeshkuj në drejtësi, edhe pse ka mungesë të përgjithshme të njohurisë në mesin e komunitetit për të drejtat e tyre, procedurat dhe mundësisë për të marrë ndihmë ligjore pa pagesë. Komuniteti gjithashtu ka shprehur brenga lidhur me kohëzgjatjen e hetimeve dhe gjykimeve, që njëkohësisht prekin të gjitha komunitetet. Mangësitë janë veçanërisht të dukshme në lidhje me kushtet e femrave rome. Struktura mbizotëruese e patriarkatit në komunitet, niveli i ulët i arsimimit dhe mosnjohja e sistemit të drejtësisë duket t'i kufizojnë të drejtat e gruas, që mund të ndikojë në mbrojtjen e tyre në rastet e dhunë në familje.

Në Gjilan/Gnjilane, përfaqësuesit romë nuk ngritën ndonjë çështje lidhur me qasjen në gjykatë dhe shërbime juridike, duke përfshirë këtu mundësinë e paraqitjes së rasteve në gjykatë. Komuniteti vazhdimisht nis dhe vijon procedura civile, siç janë trashëgimia apo shkurorëzimi, pa ndonjë pengesë specifike. Në komunat veriore të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica, mbesin probleme lidhur me qasjen në drejtësi për shkak të mosfunksionimit të vazhdueshëm të gjykatave komunale dhe atyre për kundërvajtje. Gjykata komunale në Mitrovicë/Mitrovica gjithashtu funksionon me kapacitet të kufizuar në Vushtrri/Vučitrn. Ajo merret me një numër të vogël të rasteve urgjente dhe ofron shërbime miniMeshkuj juridike. Në këtë situatë, të gjitha komunitetet e rajonit të Mitrovicës/Mitrovica mbeten pa qasje të plotë në drejtësi. Zyra komunale për komunitete në Pejë/Peć ofron përkrahje për romët për t'i parashtruar kërkesa policisë apo gjykatës dhe promovon rritjen e njohurisë së komunitetit për shërbimet e ndihmës juridike pa pagesë. Përfaqësuesit e komunitetit nuk raportuan për ndonjë rast të diskriminimit. Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti nuk raportoi gjithashtu për ndonjë ndjenjë diskriminimi në lidhje me qasjen në drejtësi. Në veçanti, besohet që gjykatësit marrin vendime të drejta pa marrë parasysh komunitetin, megjithëse raportohet që romët nganjëherë i tërheqin akuzat kundër komuniteteve tjera për shkak të frikës nga hakmarrja. Në rajonin e Prizrenit, nuk ka problem lidhur me qasjen në drejtësi dhe qasja në gjykata dhe shërbime juridike është e papenguar. Grupet e cënueshme dhe në pozitë të pafavorshme, duke përfshirë këtu romët, përfitojnë nga shërbimet e ndihmës juridike që ofron Komisioni për Ndihmë Juridike, një agjenci e financuar me fonde publike dhe e përkrahur nga UNDP-ja, që ofron ndihmë juridike pa pagesë në çështjet juridike administrative dhe kontestimore. Një prokuror rom

punon në Prokurorinë e qarkut në Prizren. Një gjykatës dhe një procesmbajtës në Gjykatën për kundërvajtje në Prizren janë romë, kurse një tjetër punon si roje në Gjykatën e qarkut në Prizren. Një avokat rom ushtron veprimtarinë e tij në qytetin e Prizrenit.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Romët përfaqësohen në nivel qendror me vetëm një deputet në Kuvend të Kosovës që mban një vend të rezervuar për komunitete, dhe dy përfaqësues në këshillin këshillëdhënës për komunitete, një organ që vepron në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës. Pjesëmarrja e romëve në çështje publike është pak më e mirë në nivel komunal, por e pamjaftueshme edhe aty. Zgjedhjet komunale të vitit 2009, ku një rom u zgjodh në një kuvend komunal dhe asnjë nuk u emërua në degë të ekzekutivit, nuk sollën ndonjë ndryshim të rëndësishëm për komunitetin rom. Edhe atje ku ai e përbën një pjesë të konsiderueshme të popullsisë, siç është komuna e Gračanica/Graçanicës, dalja e ulët në votime e ka lënë pa përfaqësim. Faktorët që ndikuan në pjesëmarrjen e tyre përfshijnë mungesën e kualifikimeve profesionale dhe arsimore që e zvogëlojnë vetëbesimin e përfaqësuesve të komunitetit për t'u angazhuar në mënyrë aktive në politikën komunale. Autoritetet komunale nuk kanë qenë aq aktive për t'u qasur komunitetit për ta promovuar pjesëmarrjen e tyre në proces zgjedhor dhe regjistrim të votuesve. Mirëpo, as vetë komuniteti nuk organizohet në mënyrë efektive për ta promovuar angazhimin e vet. Për shembull, komuniteti shpeshherë nuk merr pjesë në diskutimet publike që i organizojnë komunitat. Femrat rome mungojnë veçanërisht në sferën e çështjeve publike, pasi që martesat e hershme, shtatzënitë e njëpasnjëshme, niveli i lartë i braktisjes së shkollimit dhe analfabetizmi mbesin pengesat kryesore për pjesëmarrjen e femrave rome. Komuniteti rom ka qasje, edhe pse të kufizuara, në transmetime publike dhe shtyp në gjuhën e tyre amtare gati në tërë Kosovën. Radio Televizioni i Kosovës e transmeton një emision njëorësh javor "Yekhipe" në gjuhën rome, të përgatitur nga gazetarët romë, që ofron lajme dhe shtjellon tema aktuale me rëndësi për komunitetin rom në Kosovë. Me publikimin e revistës "Yekhipe", OJQ vendore Sakuntal nisi shtypin e vetëm në gjuhën rome që mbulon tërë Kosovën.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pak romë mbajnë poste komunale dhe ato kufizohen kryesisht në zyrat komunale për komunitete. Për shembull, një është i punësuar në zyrën komunale për komunitete në Kamenicë/Kamenica, një në Gjilan/Gnjilane, dhe dy në Ferizaj/Uroševac. Romët marrin pjesë në komitetin për komunitete në Kamenicë/Kamenica dhe Novo Brdo/Novobërdë. Parashihet që përfaqësim të ketë edhe në Gjilan/Gnjilane, mirëpo, deri në kohën kur është shkruar kjo, komuniteti ende nuk e kishte caktuar përfaqësuesin e vet. Edhe pse komunitat përkrahin ngjarje të ndryshme kulturore të komunitetit rom, janë të rralla aktivitetet e qasjes dhe informimit të tij. Radiostacionet kryesore në komunitat e Kamenicës/Kamenica dhe Novo Brdo/Novobërdës transmetojnë një emision njëorësh në gjuhën rome çdo ditë. Në Mitrovicë/Mitrovica, komuniteti mungon pothuajse në tërësi në pjesëmarrjen në çështje publike. Vetëm një femër rome nga kampi Cesmin Lug

Pjesëmarrja e komunitetit rom në çështje publike mbetet e vogël dhe nënkupton kryesisht punën dhe përfshirjen e tyre në zyrat komunale për komunitete dhe komitetet komunale për komunitete.

Plani i veprimit për implementimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian u miratua në dhjetor të vitit 2009. Ai ofron masa konkrete që kanë për qëllim përmirësimin e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në shoqërinë e Kosovës.

Komuniteti rom përfaqësohet në politikë nga Partia Rome e Bashkuar e Kosovës dhe Durdevdan/Ederlezi në komunën e Gračanica/ Graçanicës.

në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës është e punësuar nga autoritetet komunale në rajon, përkatësisht në zyrën komunale për komunitete në Mitrovicë/Mitrovica¹⁹. Asnjë komunë në rajon nuk ka ndonjë angazhim të veçantë për ta nxitur përfshirjen e mëtejshme të komunitetit në jetën publike. Romët marrin pjesë në forumet komunale të dedikuara për t'i adresuar çështjet e komunitetit, siç janë komiteti për komunitete, grupi punues komunal për kthim dhe këshilli komunal për siguri në bashkësi. Megjithatë, komiteti për komunitete i Mitrovicës/Mitrovica nuk ka ndonjë anëtar rom, siç kërkohet me ligjin në fuqi. Shtypi dhe mediat elektronike në gjuhën rome nuk janë në dispozicion përveç transmetimeve javore të Radio Televizionit të Kosovës.

Në rajonin e Pejës/Peć, komunitetit gjithashtu i mungon përfaqësimi në degët e legjislativit dhe ekzekutivit. I vetmi rom që e punëson komuna e Pejës/Peć është pastrues. Format e përfaqësimit vijnë të shumtën nga prania e komunitetit në komitetet komunale për komunitete dhe përfaqësuesit jozyrtar të komunitetit. Femrat rome janë zakonisht shumë më pak të përfaqësuara dhe janë të pranishme vetëm në komitetin për komunitete në Pejë/Peć dhe në komitetin për komunitete dhe këshillin komunal për siguri në bashkësi në Deçan/Dečane. Shumica e komunave, me përjashtim të Deçanit/Dečane dhe Gjakovës/Đakovica, angazhohen me intensitet të ndryshëm në aktivitete qasjeje dhe informimi në vendbanimet e komunitetit rom, mirëpo nismat e tilla shpeshherë nuk i adresojnë brengat specifike të komunitetit. Romët nuk kanë qasje në mediat elektronike të veçanta për komunitete, por kanë qasje në transmetimet publike dhe shtyp në gjuhën amtare që mbulojnë tërë Kosovën. Në rajonin e Prishtinës/Priština, poste komunale mbajnë vetëm tre romë, nga një zyrat komunale për komunitete në Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Obiliq/Obilić dhe një si zyrtar për të drejta të njeriut në komunën e Gračanica/Graçanicës. Nuk ka përfaqësim të romëve në organet legjislative apo vendimmarrëse. Komunitat në këtë rajon gjithashtu nuk i qasen komunitetit në mënyrë adekuate për ta promovuar pjesëmarrjen e tij në çështje publike dhe komuniteti merr pjesë rrallë në debatet publike që i organizojnë komunitat ku ata jetojnë. Vetëm romëve që jetojnë në komunën e Gračanica/Graçanicës me shumicë serbe u ofrohet një program ditor në gjuhën rome në radiostacionet e drejtuara nga serbët.

Në rajonin e Prizrenit, një rom është zgjedhur në Kuvendin komunal të Prizrenit në nëntor të vitit 2009, kurse një tjetër në komunën e Mamuša/Mamushës/Mamuša nuk arriti të rizgjidhej. Ata pak romë që mbajnë poste në komunë punojnë kryesisht në zyrat komunale për komunitete në të gjitha komunitatet përveç Mamuša/Mamushës/Mamuša. Zyrat komunale për komunitete ende nuk janë themeluar plotësisht në komunitatet e Malishevës/Mališevo, Prizrenit dhe Rahovecit/Orahovac. Sipas ligjit në fuqi, ato duhet të sigurojnë përfaqësim të romëve. Nga një rom punon në shërbimet e mirëmbajtjes së ndërtesës së komunave të Rahovecit/Orahovac dhe Mamuša/Mamushës/Mamuša. Në komunën e Prizrenit, ka romë të punësuar mirëpo mungojnë të dhënat e zberthyer. Ata mbesin të kategorizuar brenda një grupi më të madh të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në aspekt lokal, mediat rome janë të përqendruara në komunën e Prizrenit dhe përkrahen kryesisht

¹⁹ Pagën e saj e siguron UNMIK-u, ashtu si është e rregulluar prej vitit 2003 për ta përkrahur angazhimin e banorëve të kampit në çështje komunale.

nga donatorët ndërkombëtarë. Për shembull, radiostacioni rom "Kosovo Romano Avaz" u themelua në vitin 2007 me përkrahje të Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur dhe të qeverisë së SHBA-ve. Kjo e fundit i ka ndarë rreth 500,000 euro për implementimin e një plani lokal të veprimit për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Një grup prej pesë OJQ-ve lokale u bashkuan për t'i monitoruar aktivitetet dhe obligimet institucionale në lidhje me implementimin e përgjithshëm të Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, egjiptian dhe ashkali të qeverisë së Kosovës. Gjatë tërë gjysmës së parë të vitit 2010 janë mbajtur takime të grupit punues për ta hartuar planin lokal të veprimit, në të cilat, përkundër ftesave, nuk morën pjesë zyrtarët komunalë.

12. Përdorimi i gjuhës

Gjuha amtare e komunitetit rom është gjuha rome. Megjithatë, shumica e romëve e flasin edhe gjuhën shqipe ose serbe, varësisht nga vendi ku jetojnë. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, romët e përdorin gjuhën e tyre amtare në jetë private, kurse atë shqipe apo serbe për të komunikuar me pjesëtarët e komuniteteve tjera dhe institucionet lokale. Në Ferizaj/Uroševac, komuniteti rom jeton kryesisht në zonat ku flitet gjuha shqipe dhe arsimohet në shkollat me kurrikulë të Kosovës në gjuhën shqipe. Në Štrpce/Shtërpçë, Novo Brdo/Novobërdë, Gjilan/Gnjilane dhe Kamenicë/Kamenica, romët arsimohen në shkollat me kurrikulë të Serbisë në gjuhën serbe. Në Štrpce/Shtërpçë, Gjilan/Gnjilane dhe Kamenicë/Kamenica, romët, me shumë pak përjashtime, preferojnë ta përdorin gjuhën serbe në komunikimin e tyre me zyrtarët, kurse në Novo Brdo/Novobërdë dhe Ferizaj/Uroševac, gjuha e preferuar është ajo shqipe. Sa i përket mediave në gjuhën rome, ka emisione të përditshme në radiostacionin shumëtnik privat "Radio Kamenica" në komunën e Kamenicës/Kamenica dhe radiostacionin lokal "Zëri i rinisë" në komunën e Novo Brdo/Novobërdës. Një emision i përditshëm 30-minutësh transmetohet nga një stacion televiziv lokal në Ferizaj/Uroševac, me përkrahje të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.

Gjuha rome nuk e ka statusin e gjuhës në përdorim zyrtar në asnjë komunë të Kosovës. Prandaj, romët nuk kanë mundësi t'u drejtohen institucioneve në gjuhën amtare.



FËMIJËT ROMË NË ORË MËSIMI TË GJUHËS ROME NË SHKOLLËN "VUK KARADŽIĆ", TË DREJTUAR NGA SERBIA, NË LAGJEN "IVO LOLA RIBAR" TË QYTETIT TË GJILANIT/GNJILANE.

Në korrik të vitit 2009, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) i propozoi në mënyrë joforMeshkuj zyrtarëve të nivelit qendror një kërkesë për njohjen e gjuhës rome si gjuhë që “flitet tradicionalisht” në komunën e Prizreni. Njohja e tillë do t’ia mundësonte komunitetit që të ketë përkthim dhe interpretim me kërkesë. Megjithatë, propozimi ende nuk i është dorëzuar komunës në mënyrë forMeshkuj.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, romët që jetojnë në zonat me shumicë serbe e përdorin gjuhën serbe dhe kanë qasje në institucionet të drejtuara nga Serbia dhe shërbime, informata dhe dokumente në atë gjuhë. Vetëm një shkollë në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës ofron orë mësimi të gjuhës rome për nxënësit romë dhe serbë. Sa i përket qasjes në informata në gjuhën rome, stacioni televiziv lokal “TV Most” transmeton gjysmë ore në javë. Radiostacioni lokal “Radio Kontakt Plus” gjithashtu transmeton emisione herë pas here. Romët që jetojnë në zonat me shumicë shqiptare në komunat në jug e përdorin në përgjithësi gjuhën shqipe në ndërveprimet e tyre me institucionet dhe komunitetin shumicë. Në rajonin e Pejës/Peć, komuniteti rom e flet rrjedhshëm gjuhën shqipe dhe komunikon pa ndonjë problem me institucionet lokale. Megjithatë, numri i pjesëtarëve të komunitetit rom që e flasin gjuhën rome është duke u zvogëluar dalëngadalë për shkak të mungesës së mësuesve të gjuhës rome. Për më tepër, komuniteti rom ka qasje të kufizuar në shtyp dhe media elektronike private dhe publike në gjuhën rome pasi që në dispozicion është vetëm shërbimi televiziv dhe revista “Yekhipe” të përgatitura në Prizren. Në komunën e Gjakovës/Đakovica, romët e përdorin gjuhën romë kur komunikojnë me njëri-tjetrin, por atë shqipe kur komunikojnë me institucionet. Në komunën e Deçanit/Dečane, komuniteti përdor kryesisht gjuhën shqipe si në jetë private, ashtu edhe në atë publike, pasi që gjuhën rome e flasin zakonisht vetëm më të moshuarit e komunitetit. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti rom e përdor gjuhën rome vetëm në sferën private, kurse shumica e përdorin gjuhën shqipe në jetën publike. Megjithatë, komuniteti rom nga zonat me shumicë serbe të Rahovecit/Orahovac të Epërm dhe Velika Hoça/Hoçës së Madhe e përdorin gjuhën serbe. Komuniteti në rajonin e Prizrenit është shumë aktiv në promovimin e kulturës rome, me ngjarje të shpeshta kulturore dhe literaturë të botuar në gjuhën rome. Një rom i dalluar nga Prizreni ka përkthyer shumë libra në gjuhën rome. Edhe pse komuniteti rom në komunën e Prizrenit nuk e kalon pragun e nevojshëm (3%) që gjuha rome të njihet si gjuhë në përdorim zyrtar, kjo gjuhë është folur tradicionalisht në komunë. Në korrik të vitit 2009, Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) e diskutoi në mënyrë joforMeshkuj mundësinë e paraqitjes së kërkesës për këtë njohje me zyrtarët e nivelit qendror. Megjithatë, kurrfarë hapa nuk janë ndërmarrë për ta bërë atë forMeshkuj.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Nuk ka trashëgimi të dalluar kulturore apo fetare rome në Kosovë. Nuk ka vende të caktuara të mbrojtura me rëndësi fetare apo kulturore apo plane për të ndërmarrë aktivitete për t’i identifikuar vendet e tilla në të ardhmen e afërt. Shumica e komunitetit rom janë myslimanë, me afinitet ndaj rendeve Dervish dhe Bektashi. Disa përcaktohen si të krishterë ortodoksë. Komuniteti rom ka qasje të papenguar në xhami, teqe,²⁰ varreza dhe kisha ortodokse. Festimet kryesore fetare mbahen në Ditën e Shën Gjergjit/Đurđevdan më 6 maj. Në Mëhallën e Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica ishte një teqe e një Shehu të Dervishëve që luante një

20 Teqeja është vend ku ruhet arkivoli i shehut apo i udhëheqësve fetarë, zakonisht i ndonjërit nga themeluesit e teqesë, dhe njëkohësisht faltore për myslimanët Sufi Shia (dervishët).



INSTRUMENT TRADICIONAL ROM.

rol të rëndësishëm në kohezionin social të komunitetit, por u shkatërrua në vitin 1999 dhe momentalisht nuk ka ndonjë nismë për ta rindërtuar atë.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Marrëdhëniet ndërmjet komunitetit rom dhe komuniteteve tjera vazhdon t'i definojë afërsia gjuhësore dhe shpeshherë gjeografike e komunitetit me serbët. Nga marginalizimi i vazhdueshëm që e përjetojnë romët nënkuptohet që mungesa e angazhimit në proceset dhe forumet institucionale apo të nivelit bazë për dialog ka të bëjë më shumë me paragjykimet e përhapura dhe përjashtimin social sesa me konfliktin ndërmjet komuniteteve. Në ato komuna ku romët nuk përfaqësohen sa duhet, mbetin të kufizuara mundësitë për t'u angazhuar në nismat për dialog ndërmjet komuniteteve. Angazhimi i tyre në nismat e shoqërisë civile për dialog gjithashtu kufizohet për shkak të vetorganizimit të dobët të komunitetit. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pjesëmarrja e komunitetit rom në forumet komunale për dialog mbetet e ulët, edhe pse marrëdhëniet me komunitetet tjera janë relativisht të mira. Shumica e romëve janë të integruar relativisht mirë në zonat me shumicë shqiptare apo serbe. Momentalisht, nuk ka nisma apo dialog në zhvillim e sipër ndërmjet komuniteteve, si dhe nuk ka ndonjë angazhim të autoriteteve komunale në rajon në aktivitete qasjeje dhe informimi për komunitetin rom. Në rajonin e Mitrovicës, nuk ka shumë nisma komunale për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve që përfshijnë komunitetin rom. Megjithatë, komuniteti merr pjesë në përgjithësi nëpër forume bashkë me komunitete tjera kur diskutohen çështjet e të drejtave të komuniteteve joshumicë. Përkundër asaj që romët kanë marrëdhënie të mira me komunitete tjera, përkrahja që hisedarët vendorë dhe ndërkombëtarë ia ofruan të kthyerve romë në Mëhallën e Romëve në pjesën jugore të Mitrovicës ka shkaktuar indinjatë në mesin e shqiptarëve. Komuna dhe organizatat ndërkombëtare janë në përpjekje që ta zgjidhin këtë problem përmes promovimit të dialogut ndërmjet të kthyerve dhe komuniteteve pritëse.

Në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, marrëdhëniet ndërmjet komunitetit rom në Mëhallën e Romëve dhe komunitetit ashkali në vendbanimin Dy Korriku janë të tensionuara për shkak të garës së supozuar nga ata për pjesëmarrje në aftësimet profesionale që ofrohen si pjesë e projektit "Hoteli Industrial".

Një projekt i implementuar nga OJQ shumetnike e gruas "7 Shtatori" për promovimin e dialogut ndërmjet komuniteteve rom, egjiptian dhe shqiptar u tregua i suksesshëm pasi që pas përfundimit të projektit, femrat vazhdojnë të mblidhen dhe të diskutojnë tema të ndryshme.

Në rajonin e Pejë/Peć, nuk ka ndonjë nismë komunale për promovim të marrëdhënieve dhe dialogut ndërmjet komuniteteve në përgjithësi, e as ndonjë në veçanti për komunitetin rom. Shumica e nismave për dialog ndërmjet komuniteteve vijnë nga shoqëria civile. Marrëdhëniet mes romëve dhe komuniteteve tjera dallojnë në masë të madhe në rajon. Për shembull, në komunën e Gjakovës/Đakovica, komuniteti ndërvepron kryesisht me egjiptianë, ashkali dhe shqiptarë. Në komunën e Deçanit/Dečane, ndërveprimet janë më të rralla dhe përfaqësuesit e romëve kanë shprehur brenga rreth mospranimit të tyre nga komuniteti shumicë. Në Istog/Istok dhe Klinë/Klina, komuniteti rom merr pjesë në të gjitha aktivitetet që promovojnë dialogun ndërmjet komuniteteve dhe ka marrëdhënie të mira me shqiptarët dhe serbët. Në Istog/Istok ka edhe pjesëmarrje më të madhe të femrave. Në rajonin e Prishtinës/Priština, komunitetin rom e prek në përgjithësi mungesa e angazhimit aktiv në forumet e ndryshme komunale që merren me çështjet e dialogut ndërmjet komuniteteve. Margjinalizimi i përhapur nënkupton që ndërveprimi me komunitetet tjera, duke e përfshirë atë shumicë, nuk është në nivel të kënaqshëm. Vetorganizimi i dobët dhe mungesa e përfaqësimit efikas në organet komunale gjithashtu i pakëson mundësitë e angazhimit në dialog formal. Si shembull pozitiv, në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, përfaqësuesit e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e kanë themeluar një grup fokusi me mandat për t'i identifikuar nevojat e komunitetit për qëllim të zhvillimit të planit lokal të veprimit për implementimin e Strategjisë për integrimin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti rom është i integruar mirë në përgjithësi dhe merr pjesë në aktivitetet forMeshkuj dhe joforMeshkuj ndërmjet komuniteteve. Në përgjithësi, komuniteti ka marrëdhënie të mira me shqiptarët dhe komunitetet tjera.

Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit

Tabela 1: Population Settlements

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti rom
Gjilan/Gnjilane	Ferizaj/ Uroševac	Vendbanimi Sallahane/Salahane, Halit Ibishi/Halit Ibiši
	Gjilan/ Gnjilane	Vendbanimi Abdullah Presheva/Abdulla Preševo, vendbanimi Ivo Lola Ribar
	Novobërdë/ NovoBrdo	Bostan/Bostane
	Kamenicë/ Kamenica	Berivojcë/Berivojce, Boscë/Bosce, qyteti i Kamenicës/Kamenica, Leshtar/Lještar
	Štrpce/ Shtërpçë	Qyteti i Štrpce/Shtërpçës, Brevce/Beroc, Gotovuša/Gotovushë
Mitrovicë/Mitrovica	Leposaviç/ Leposaviq	Kampi Leposaviç, Lešak/Leshak
	Mitrovicë/ Mitrovica	Mëhalla e Romëve (jug) Kampi Osterode (veri) Kampi Česmin Lug (veri)
	Vushtrri/ Vuçitrn	Priluzhje/Prilluzhë
Pejë/Peç	Deçan/Deçane	Qyteti i Deçanit/Deçane, Shaptej/Šaptej, Irzniq/Irzniç
	Gjakovë/ Djakovica	Qyteti i Gjakovës/Đakovica (lagjja Qabrati, lagjja Mulla Jusuf, lagjja Dardani/Piskot), Rogovë/Rogovo, Jahoc/Jahoc, Brekoc/Brekovac, Janosh/Janoš, Bec, Vraniq/Vraniç, Palabardhë/Paljabarda, Bitesh/Biteš, Kodrali/Kodralija, Netic/Netic, Novosellë e Poshtme/Donje Novo Selo, Skivjan/Skivjane, Planqor/Pljançor, Dujakë/Dujak, Hereq/Ereç, Osek Hilë/Osek Hilja, Shishman/Šišman, Nec/Nec, Korenicë/Korenica
	Istog/Istok	Suvi Lukavac/Llukavc i Thatë, Koš/Kosh, Shalinovicë/Šaljinovica, Kovragë/Kovrage, Banjë/Banja, Banjicë/Banjica, Carallukë/Crni Lug, Cerrcë/Crno, Dobrushë/Dobruša, Dragolevc/Dragoljevac, Drejë/Drenje, Dubovë/Dubove, Gjurakoc/Đurakovac, qyteti i Istogut/Istok, Koshicë/Košica, Kosh/Koš, Kovragë/Kovrage, Llukavc i Begut/Begov Lukavac, Llukavc i Thatë/Suvi Lukavac, Lubovë/Ljubovo, Mirshevinë/Mrševine, Oprashkë/Opraške, Prekalë/Prekale, Staradran/Staredvorane, Serbobran/Srbobran, Shalinovicë/Šalinovica, Tërshovina/Terševina, Tomoc/Tomonce, Veriq/Veriçe, Zallq/Žać
	Pejë/Peç	Qyteti i Pejës/Pec (lagja 7 Shtatori, lagjja Dardania 3/Brženik 3) Firajë/Firaje, Glllogjan/Glođane, Katundi i Ri /Novo Sello, Kristali, Lubeniq/Ljubeniç, Nakëll/Naklo, Qungur/Ćungur, Raushiq/Rašić, Rosujë/Rosuje, Ruhot/Ruhot, Vitomiricë /Vitimirica
Pristinë/ Prishtina	FushëKosovë/ Kosovo Polje	Fushë Kosovë/Kosovo Polje, qendra e qytetit, Ugljare/Uglar, Kuzmin/Kuzmin, Bresje/Bresje
	Gračanica/ Graçanicë	Çaglavica/Çagllavicë, Laplje Selo/Lapllasellë, Preoce/Preoc Ugljare/Uglar, Gushtericë e Ulët/ Donja Gušterica dhe Radevë/Radevo
	Lipjan/ Lipljan	Qyteti i Lipjanit/Lipljan, fshatrat Janjevë/Janjevo, Magurë/Magura, Dobrajë e Vogël/Mala Dobranja, Gushtericë e Ulët/ Donja Gušterica, Skulanevo/Skullan, Lepina/Lepi, Dobratin/Dobrotin dhe Livade/Livagjë
	Obiliq/ Obilić	Obiliq/Obilić, ndërtesat e banimit social I dhe II në Plemetinë/Plemetina dhe fshati
	Podujevë/ Podujevo	Qyteti i Podujevës/Podujevo (vendbanimi nr. II)
	Pristinë/ Prishtina	Vendbanimi Moravska në qytet
	Shtime/ Štimlje	Qyteti i Shtimes/Štimlje
	Malishevë/ Mališevo	Banjë/Banja, Kijevë/Kijevo

Prizren	Mamushë/ Mamuša/ Mamuša	Mamushë/Mamuša/Mamuša
	Prizren	Terzi mëhalla, Jeni mëhalla, Curt mëhalla, Jeta e re, Bazhdarhana/Bazhdarana, Arbana
	Rahovec/ Orahovac	Rahoveci/Orahovac i epërm
	Suharekë/ Suva Reka	Gelanc/Geljance, Leshan/Lešane, Neprebisht/Neprebište, Reshtan/Reštane, Samadragjë/Samadrade, Studenqan/Studençane, Shirokë/Široko, Tërnje/Trnje

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë¹

Gjilan/Gnjilane	Burimi	Numri i gjithsej i popullsisë	Komuniteti	%	
	Komuna Ferizaj/Uroševac				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981 ¹	81,372	1,813	1.8%	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991 ^{2,3}	113,668	2,068	1.8%	
	3. Vlerësimi i komunës	160 – 170,000	258	0.015 – 0.016%	
	4. Vlerësimi i komuniteteve	160 – 170,000	258	0.015 – 0.016%	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009 ⁴	160 – 170,000	260	0.015 – 0.016%	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	160 – 170,000	260	0.015 – 0.016%	
Komuna Gjilan/Gnjilane					
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	84,085	5,000	5.9%	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	103,675	4,500	4.34%	
	3. Vlerësimi i komunës	130,000	410	0.3%	
	4. Vlerësimi i komuniteteve	130,000	500	0.38%	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	130,000	410	0.30%	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	130,000	450	0.30%	
Komuna Kamenicë/Kamenica					
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	48,320	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	52,152	986	1.89%	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	50,000	473	0.9%	
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	49,000	500	1%	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	63,000	500	0.79%	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	49,000	473	0.9%	
Komuna Novo Brdo/Novobërdë					
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	4,984	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	4,611	47	1%	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	6,000	98	1.6%	
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	65	-	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	3,900	10 families	-	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	6,000	65	1%	
Komuna Štrpce/Shtërpçë					
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/15	-	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	12,712	101	0.8%	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	11,145	26	0.23%	
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	13,600	26	0.19%	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	13,600	26	0.19%	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	13,600	26	0.19%	
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Mitrovicë/Mitrovica				
		1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	87,981	-	-
		2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	104,885	4,851	4.62%
		3. Vlerësimi aktual i komunës	130,000	500	0.38%
		4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	1,230	-
		5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	130,000	-	-
		6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	130,000	1,230	0.94%
	Komuna Vushtrri/Vučitrn				
		1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	65,512	-	-
		2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	80,644	2,108	2.61%

Mitrovicë/Mitrovica	3. Vlerësimi aktual i komunës	102,600	250	0.24%	
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	260	-	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	102,600	-	-	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	102,600	260	0.25%	
	Komuna Leposavić/Leposaviq				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	16,906	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	16,395	194	1.18%	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	19,000	250	1.31%	
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	220	-	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	18,600	-	-	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	18,600	220	1.18%	
	Pejë/Peć	Komuna Deçan/Dečane			
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		40,640	378	0.93%	
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		49,000	377	0.77%	
3. Vlerësimi aktual i komunës		-	-	-	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve		60,000	-	-	
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009		40,000	382	0.95%	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete		35,000	35	0.1%	
Komuna Gjakovë/Đakovica					
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		-	-	-	
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		112,888	2,657	2.3%	
3. Vlerësimi aktual i komunës		150,000	650	0.43%	
4. Vlerësimi i komuniteteve		-	-	-	
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009		150,000	-	-	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete		150,000	-	-	
Komuna Istog/Istok					
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		50,104	987	1.95%	
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		57,261	1,346	2.3%	
3. Vlerësimi aktual i komunës		56,000-64,000	30	0.05-0.04%	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve		50,000	1,820	3.64%	
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009		56,000	35	0.06	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete		56,000	20	0.03	
Komuna Klinë/Klina					
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		54,539	906	1.66%	
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		52,266	1,278	2.4%	
3. Vlerësimi aktual i komunës		55,000 – 58,000	100	0.18 – 0.17%	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve		55,000	100	0.18%	
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009		55,000	100	0.18%	
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete		55,000	220	0.4%	
Komuna Pejë/Peć					
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		111,071	4,431	3.9%	
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	111,071	4,442	3.9%		
3. Vlerësimi aktual i komunës	-	-	-		
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	1,500	-	-		
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	170,000	-	-		
6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	140,000	-	-		
Pristinë/Priština	Komuna Gračanica/Gračanice				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	-	-	-	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	18,642	2,000	10.72%	
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	20,000	2,200	11%	
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	20,000	2,000	10%	
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	20,000	2,000	10%	
	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje				
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	29,805	2,381	8.0%	
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	35,570	3,473	9.76%	
	3. Vlerësimi aktual i komunës	40,000	783	1.95%	
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	33,682	783	2.32%	
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	40,000	1,075	2.68%		
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	40,000	783	1.9%		

Prishtinë/Priština	Komuna Lipjan/Lipljan			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	57,705	1,625	2.8%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	69,451	1,673	2.4%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	76,000	380	0.50%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	76,000	380	0.50%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	76,000	350	0.44%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	76,000	380	0.50%
	Komuna Obiliq/Obilić			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	26,595	2711	10.2%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	31,627	3956	12.5%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	32,000	566	1.76%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	26,000	684	2.63%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	32,000	566	1.76%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	30,000	684	2.28%
	Komuna Podujevë/Podujevo			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	75,437	320	0.42%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	92,946	387	0.41%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	130,000	108	0.08%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	130,000	108	0.08%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	130,000	108	0.08%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	130,000	108	0.08%
	Komuna Prishtinë/Priština			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	148,656	6,095	4.10%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	199,654	6,706	3.35%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	500,000	30	0.006%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	500,000	25	0.005%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	500,000	25	0.005%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	50,000	25	0.005%
	Komuna Shtime/Štimlje			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	19,952	99	0.49%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	23,506	265	1.12%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	29,000	10	0.03%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	30,000	50	0.17%
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	29,000	10	0.03%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	29,000	10	0.03%
	Prizren	Komuna Malishevë/Mališevo		
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		-	-	-
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		45,669	-	-
3. Vlerësimi aktual i komunës		65,000	65	0.1%
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve		-	-	-
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009		65,000	65	0.1%
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren		65,000	65	0.1%
Komuna Mamushë/Mamuša/Mamuša				
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		-	-	-
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		-	-	-
3. Vlerësimi aktual i komunës		5,300	85	1.6%
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve		-	-	-
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009		5,300	85	1.6%
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren		5,300	85	1.6%
Komuna Prizren				
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		-	-	-
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		175,413	3,963	2%
3. Vlerësimi aktual i komunës		240,000	5,322	2.2%
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve		-	-	-
5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009		240,000	5,300	2.1%
6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren		240,000	5,300	2.1%
Komuna Rahovec/Orahovac				
1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981		-	-	-
2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991		59,942	319	0.5%

Prizren	3. Vlerësimi aktual i komunës	76,577	756	1
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	76,577	550	1.3%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	76,577	756	0.5%
	Komuna Suharekë/Suva Reka			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981/1991	63,980	167	0.2%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	80,000	651	0.8%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga profilet e komunave, OSBE, 2009	80,000	641	0.8%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve të OSBE-së në terren	80,000	651	0.8%

Tabela 3: Population Estimates by Category

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijë të moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijë që vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijë që nuk vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Moshë pune – të punësuar (16-65)	Moshë pune – të punësuar (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë
Gjilan/Gnjilane	Ferizaj/ Uroševac	Meshkuj	11			11			
		Femra	13			10			
		Gjithsej	24	47	11	21	101	12	8
	Gjilan/ Gnjilane	Meshkuj	5	38	13	9	200	5	
		Femra	4	20	7	3	170	7	
		Gjithsej	9	58	20	12	370	12	
	Kamenicë/ Kamenica	Meshkuj	10	50	6	5		3	
		Femra	10	28	4			7	
		Gjithsej	20	78	10	5	350	10	
	Novo Brdo/ Novobërdë	Meshkuj		5		3	32	1	
		Femra		5			30	2	
		Gjithsej		10	5	3	62	3	
	Štrpce/ Shtërpçë	Meshkuj	4	1		1	8	2	1
Femra			1			5	3	2	
Gjithsej		4	2		1	13	5	3	
Gjithsej në rajon		577	195	46	42	896	42	11	
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i marrë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.									
Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovicë/ Mitrovica	Meshkuj	170	74	26	91	90	8	
		Femra	138	64	31	21	98	13	
		Gjithsej	308	138	57	112	188	21	
	Vushtrri/ Vuçitrn	Meshkuj	19	30	3	13	60	2	
		Femra	15	25	5	0	57	5	
		Gjithsej	34	55	8	13	117	7	
	Leposaviç/ Leposaviq	Meshkuj	22	13	6	24	27	4	
		Femra	24	11	5	0	59	8	
		Gjithsej	46	24	11	24	86	12	
	Gjithsej në rajon		388	217	76	149	391	40	
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i marrë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.									
Pejë/Peç	Deçan/ Deçane	Meshkuj	10			4	1		
		Femra	13			5	2		
		Gjithsej	23			9	3		
	Gjakovë/ Đakovica	Meshkuj	75	60	20	15	130	45	
		Femra	75	40	50	5	100	35	
		Gjithsej	150	100	70	20	230	80	
	Istog/Istok	Meshkuj				1			
		Femra							
		Gjithsej				1			

Pejë/Peç	Pejë/Peç	Meshkuj		102			402		
		Femra		94			266		
		Gjithsej		196			668		
	Klinë/Klina	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej		25					
	Gjithsej në rajon		173	321	70	30	901	80	23
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i marrë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.									
Pristinë/Priština	Fushë Kosovë /Kosovo Polje	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	70	70	50	4	564	25	
	Lipjan/ Lipljan	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	40	40	40		240	20	
	Obiliq/ Obilić	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	80	60	30	4	495	15	
	Podujevë/ Podujevo	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	20	15	5		58	10	
	Pristinë/ Priština	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	2		5		12	1	
	Shtime/ Štimlje	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	2	2	1		5		
	Graçanica/ Graçanicë	Meshkuj							
		Femra							
		Gjithsej	240	300	100	15	1,305	40	
Gjithsej në rajon		454	487	231	23	2679	111		
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i marrë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.									
Prizren	Prizren	Meshkuj					525		
		Femra					471		
		Gjithsej					996		
	Rahovec/ Orahovac	Meshkuj					27		
		Femra					34		
		Gjithsej					61		
	Suharekë/ Suva Reka	Meshkuj					1		
		Femra							
		Gjithsej					1		
	Gjithsej në rajon						1,058		
	Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i marrë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.								

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë

Komuna Ferizaj/Uroševac	
1	Mehmet Jashari, kryetar lokal i Partisë Rome të Bashkuar të Kosovës
2	Sali Jashari, zyra komunale për komunitete Mehmet Jashari, zyra komunale për komunitete Xhemajl Jashari, anëtar i komitetit për komunitete
3	OJQ "Integrimi i romëve", që merret me çështje të arsimit dhe aktivitete kulturore të romëve OJQ "Radio 5" përqendrohet në çështje të rinjve.
4	Një emision televiziv 30 minutësh (TV "Tema" lokale) për komunitetin rom i financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim
5	Mehmet Jashari, lider i komitetit Gëzim Dema, udhëheqës i OJQ "Roma Integration"
6	
7	
Komuna Gjilan/Gnjilane	
1	SRS (Srpska Radikalna Stranka) DSS (Demokratska Stranka Srbije) DS (Demokratska Stranka) G17 Plus NS (Nova Srbija) SPS (Socijalistička Partija Srbije)
2	Elez Kurteši, zyra komunale për komunitete
3	OJQ Gratë për Gratë, Shpresa Agushi OJQ Shukra Drom, Galip Iseni (çështje të romëve) Abdullah Presheva/Abdula Preševo, qendër për komunitete
4	
5	Galip Iseni, përfaqësues i romëve Elez Kurteši, zëvendës përfaqësues i romëve Shpresa Agushi
6	
7	
Komuna Kamenicë/Kamenica	
1	Građanska Inicijativa za Promene (GIZAP) Srpska Radikalna Stranka (SRS) Demokratska Stranka Srbije (DSS) Nova Srbija (NS) Socijalistička Partija Srbije (SPS) Demokratska Stranka (DS) G17 Plus
2	Dragiša Savić, zëvendës kryesues për komunitete Bajrush Kryesiu, zyra komunale për komunitete Safet Ahmeti, anëtar i komitetit për komunitete Elez Kryesiu, vëzhgues në kuvendin komunal
3	OJQ " Posuzo Djivdipe" (çështjet e të drejtave të njeriut të komunitetit rom) OJQ "Jekhipe/Jedinstvo"(çështjet e të drejtave të njeriut të komunitetit rom)
4	"Radio KAMENICA", radiostacion shumetnik që transmeton programe në gjuhën shqipe, serbe dhe rome. Në komunën e Kamenicë/Kamenica nuk ka shtyp.
5	Ramiz Kryesiu Bajrush Kryesiu Safet Ahmeti
6	
7	Koment: Dy OJQ-të nuk janë të regjistruara te institucionet e Kosovës. Megjithatë, sipas përfaqësuesve të romëve, ato funksionojnë ende.
Komuna Novobërdë/NovoBrdo	
1	Nuk ka entitete politike nga komuniteti rom. Gjatë zgjedhjeve më 11 maj 2008, një entitet politik e kishte një rom në listën e vet, mirëpo ky person nuk u emërua nga entiteti politik pas rezultateve të votimeve.
2	Naser Jashari, anëtar i komitetit për komunitete

Gjilan//Gnjilane	3	
	4	Nuk ka media për komunitetin rom. Radiostacioni lokal "Zëri i rinisë" ka një emision njëorësh muzikor në gjuhën rome.
	5	Naser Jashari, lider i komunitetit
	6	
	7	
	Komuna Štrpce/Shtërpçë	
	1	-
	2	-
	3	-
	4	-
	5	-
	6	-
	7	Koment: Ky komunitet nuk përfaqësohet momentalisht në asnjë institucion apo organizatë të shoqërisë civile
	Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Leposavić/Leposaviq
1		Komuniteti nuk ndihet i përfaqësuar nga ndonjë parti specifike politike.
2		Asnjë pjesëtar i komunitetit nuk e përfaqëson atë në institucionet komunale.
3		OJQ "Qendra e romëve dhe ashkalive për dokumentacion"
4		
5		Skender Gušani, udhëheqës i komunitetit në kampin në Leposavić/Leposaviq dhe përfaqësues i komunitetit rom në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica.
6		
7		
Komuna Mitrovicë/Mitrovica		
1		Nuk ka parti politike që e përfaqësojnë këtë komunitet në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Në pjesën veriore të Mitrovica/Mitrovicës, komuniteti ka lidhje me Srpska Radikalna Stranka dhe Demokratska Stranka Srbije.
2		Elizabeta Bajrami, zyrat komunale për komunitete Čazim Gušani, anëtar i grupit punues komunal për kthim dhe komitetit për komunitete
3		OJQ "Qendra e romëve dhe ashkalive për dokumentacion" avokon për çështje të komunitetit dhe ndihmon ndërtimin e kapaciteteve për pjesëtarët e komunitetit. OJQ "Gruaja rome për gratë rome" me bazë në Mëhallën e Romëve dhe fokus në gratë rome. Aktivitetet kryesore janë ndërtimi i kapaciteteve dhe punëtoritë e trajnimit për gratë rome. OJQ "E Jona Mit", shoqëri e formuar rishtas në Mëhallën e Romëve me fokus në projekte ndëretnike për rini.
4		TV Most dhe Radio Kontakt Plus kanë emisione në gjuhën rome mirëpo nuk ka ndonjë media të mirëfilltë të komunitetit.
5		Čazim Gušani, udhëheqës i komunitetit në Mëhallën e Romëve Habib Hajdini, udhëheqës i komunitetit në kampin Osterode Latif Masurica, udhëheqës i komunitetit në kampin Česmin Lug Flamur Krasniqi, përfaqësues i pjesëtarëve të komunitetit që nuk janë nga Mëhalla e Romëve.
6		
7		
Komuna Vushtri/Vučitrn		
1		
2		Ferki Emini, anëtar i komitetit të komuniteteve
3		OJQ "Ylberi" dhe "Anglunipe" përqendrohen në projektet e zhvillimit të punësimit, me bazë në Priluzje/Prilluzhë. Gratë përfaqësohen në të dy organizatat.
4		Përfaqësuesit e komunitetit bashkëpunojnë me "TV Most" in Mitrovica/Mitrovicë dhe Radio Kontakt Plus in Mitrovicë/Mitrovica për emisionin e radios në gjuhën rome.
5	Seljatin Emini, përfaqësues i komunitetit në Priluzje/Prelluzhë	
6		
7		
Pejë/Peć	Komuna Dečan/Dečane	
	1	
	2	Gjeve Belaj, anëtar i komitetit për komunitete dhe këshillit komunal për siguri në bashkësi
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	

Pejë/Pec	Komuna Gjakovë/Đakovica	
	1	Partia Rome e Bashkuar e Kosovës PREBK
	2	Arif Cermjani, anëtar i komitetit për komunitete
	3	
	4	
	5	Arif Cermjani, udhëheqës i komitetit
	6	
	7	
	Komuna Istog/Istok	
	1	
	2	Një zyrtar rom në burgun e Dubravës.
	3	OJQ "Visioni 02" që përbëhet kryesisht nga të rinjtë egjiptianë dhe romë nga Istogu/Istok dhe implementojnë projekte shumetnike dhe për të rinjtë.
	4	
	5	
	Komuna Klinë/Klina	
	1	
	2	Një rom në administratën komunale Një rom në një kompani komunikimi
	3	
	4	Transmetuesi publik RTK
	5	Agim Gashi, zyra komunale për komunitete
	6	Nexhmedin Gashi, anëtar i komitetit për komunitete
	7	
	Komuna Pejë/Pec	
	1	PREBK Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
	2	Gani Toska, zyra komunale për komunitete
	3	Qendra për komunitete në lagjen 7 Shtatori
4	-	
5	-	
6		
7		
Pristinë/Pristina	Komuna Gračanica/Graçanicë	
	1	Komuniteti rom mori pjesë në zgjedhjet e fundit me Asociacionin e Romëve
	2	Sebastian Serifović, zyrtar për të drejta të njeriut, gjini dhe komunitete Simbad Latifi, anëtar i komiteteve për komunitete
	3	Qendra për komunitete e romëve në Gračanica/Graçanicë bashkon organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fusha të ngjashme, përkrahësish arsim dhe asistencë shëndetësore, integrim të rinisë dhe grave dhe aktivitete tjera. Gazmend Salijević, përfaqësues shoqëror civil romë në rajonin e Prishtinës/Pristina Mirsade Butić, përfaqësues i komunitetit rom në fshatin Livade/Livagjë Rama Bajram, përfaqësues i komunitetit rom në fshatin Donja Gušterica/Gushtericë e Ulët Idriz Mehmeti, përfaqësues i komunitetit rom në fshatin Lepina/Lepi
	4	Transmetuesi publik RTK
	5	Hamit Serifović, lider i komunitetit
	6	
	7	
	Komuna Shtime/Štimlje	
	1	Komuniteti rom nuk është i përfshirë në ndonjë parti politike.
	2	Artan Demiri, anëtar i komitetit për komunitete
	3	OJQ "Hapësira rinore" me të rinj shqiptarë, romë dhe ashkali. Aktivitetet kryesore janë performancat artistike dhe përkrahja për integrim të komunitetit. OJQ "Një hap me RAE", aktivitete promovimi të prindërit në lidhje me për edukim të fëmijëve
	4	
	5	Artan Demiri, lider i komunitetit
	6	
	7	

Komuna Prizren	
1	PREBK Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
2	Haxhi Zylfi Merxha (PREBK), Deputet në Kuvend të Kosovës Albert Kinolli (PREBK), anëtar i Komisionit Qendror Zgjedhor dhe anëtar i komitetit për komunitete Islam Elshani, zyra komunale për komunitete Gyzele Shaljani, anëtare e kuvendit komunal të Prizrenit (përfaqëson LDK-në)
3	OJQ "Iniciativa 6", Osman Osmani OJQ "Romani Baht", Kujtim Pacaku OJQ "Folea", znj. Gjyzele Shaljani OJQ "Sakuntala", Ibrahim Elshani OJQ "Rom", Haxhi Zylfi Merxha OJQ "Centro Romani Gjuvelengji", Znj. Emsale Merxholari OJQ "SHEK", Petrit Llugaxhia OJQ "Durmish Asllano", përfaqësues Nexhip Menekshe
4	Radio rome "Romano Avazo" Revista rome "Yekhipë" Emisioni i përjavshëm televiziv 30-minutësh "Yekhipë", e transmeton RTK-ja http://rroma.courriers.info
5	Haxhi Zylfi Merxha, (PREBK) Znj. Gjyzele Shaljani, anëtare e kuvendit komunal të Prizrenit, përfaqëson LDK-në Osman Osmani, lider i komunitetit nga qyteti i Prizrenit dhe anëtar i OJQ Iniciativa 6 Nexhip Menekshe, lider i komunitetit nga qyteti i Prizrenit dhe anëtar i OJQ Durmish Asllano
6	
7	
Komuna Malishevë/Mališevo	
1	Naser Malisheve, përfaqësues i komunitetit rom
2	
3	
4	
5	
6	
7	
Komuna Mamushë/Mamuša/Mamuša	
1	
2	
3	
4	
5	Dashurije Berisha, anëtarë e dikurshme e kuvendit komunal të Mamushës/Mamuša/Mamuša
6	
7	
Komuna Rahovec/Orahovac	
1	PREBK Partia Rome e Bashkuar e Kosovës IRDK Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës
2	Leonart Mazreku, aktivist i rinisë rome
3	OJQ "Gratë për gratë"
4	
5	
6	
7	
Komuna Suharekë/Suva Reka	
1	PREBK Partia Rome e Bashkuar e Kosovës
2	
3	
4	
5	
6	
7	

1 Të dhënat e zbërthyerë për secilin komunitet nuk janë konsistente në komunat e Kosovës. Vlerësimi i numrit të popullsisë në Anekse ofron të dhëna të tilla sa herë që është e mundur dhe kjo është e shënuar qartë.

2 Të dhënat për popullsinë në pjesët 3, 4, 5 dhe 6 janë mbledhur nga ekipet e OSBE-së në terren në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit dhe zyrtarët komunalë në mars-prill 2010.

3 Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 nuk ka mbledhur të dhëna të veçanta as për komunitetet ashkali dhe egjiptian. Kategoria e vetme për t'u deklaruar ishte "romë". Prandaj, të dhënat e ofruara mund të përfshijnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në një kategori. Gjithashtu, është e mundshme që disa romë janë regjistruar si pjesëtarë të komuniteteve tjera ose nën kategorinë "të tjerë".

4 Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 nuk ka mbledhur të dhëna të veçanta as për komunitetet ashkali dhe egjiptian. Kategoria e vetme për t'u deklaruar ishte "Romë". Prandaj, të dhënat e ofruara mund të përfshijnë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në një kategori. Gjithashtu, është e mundshme që disa romë janë regjistruar si pjesëtarë të komuniteteve tjera ose nën kategorinë "të tjerë".

5 Të dhënat e mbledhura në regjistrimin e vitit 1991 kontestohen për shkak se disa segmente të popullsisë e bojkotuan atë.

6 Profilët e komunave të vitit 2009 nuk ofruan të dhëna të zbërthyerë për komunitetin rom, kështu që ky numër përfshin pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

7 Komuna e Štrpce/Shtërpçës nuk është themeluar deri në vitin 1987. Para kësaj, ky territor ishte pjesë e komunës së Ferizajt/Uroševac.

8 Shtator, 2008.

9 Pasi që mungojnë të dhënat, është e pamundshme të llogaritet një numër i besueshëm për këtë kategori.

10 Zëvendëskryesuesi aktual për komunitete është i kësaj iniciative politike.

11 Nuk u fituan vende në kuvendin komunal.



Profil i Komunitetit SERBËT E KOSOVËS

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Historiku

Serbët e Kosovës banojnë në të gjitha rajonet e Kosovës¹ dhe përbëjnë komunitetin e dytë më të madh. Serbët e Kosovës janë të krishterë ortodoks dhe shumica e familjeve kremtojnë një ditë të veçantë të vitit, të ashtuquajturën “slava”² që mban emrin e një shenjtori të cilit edhe i kushtohet kjo festë. Lidhjet me Kishën Ortodokse Serbe janë shumë të fuqishme. Roli dhe ndikimi i komunitetit serb të Kosovës në jetën politike dhe socio-ekonomike të Kosovës ka ndryshuar dukshëm gjatë këtyre 50 viteve të fundit. Prej një roli udhëheqës gjatë viteve të hershme të Republikës Socialiste Federative e Jugosllavisë, kur serbët e Kosovës i kanë mbajtur postet kryesore në administratën e atëhershme krahinore, e deri më sot kur ndikimi i komunitetit është kryesisht i kufizuar në komunat ku ata përbëjnë shumicën numerike.³ Pas konfliktit të vitit 1999, pothuajse në të gjitha komunat ku jetojnë serbët e Kosovës, komuniteti themeloi institucionet lokale të qeverisjes dhe të shërbimeve me mbështetjen financiare të Republikës së Serbisë. Ndryshimet e fundit në spektrin e qeverisjes lokale të Kosovës kanë filluar të kenë ndikim në këto struktura. Më 17 qershor 2010, qeveria e Serbisë filloi të zëvendësojë kuvendet komunale, të krijuara në bazë të zgjedhjeve serbe të 11 majit 2008, me koordinatorët e komunave Deçan/Dečane, Ferizaj/Uroševac, Gjakovë/Đakovica, Klinë/Klina, Podujevë/Podujevo, Prizren dhe Suharekë/Suva Reka. Prania e institucioneve të drejtuara nga Serbia në këto komuna, të pabanuara apo pak të banuara me serbë të Kosovës, ka qenë kryesisht simbolike.

Serbët e Kosovës përbëjnë shumicën numerike në nëntë komuna të Kosovës. Para zgjedhjeve lokale të mbajtura në nëntor të vitit 2009, komuniteti ishte shumicë në Štrpce/Shtërpce (rajoni i Gjilanit/Gnjilane), në Leposavić/Leposaviq, Zubin Potok, Zvečan/Zveçan dhe në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës/Mitrovica (rajoni i Mitrovicës/Mitrovica). Pas këtyre zgjedhjeve, janë krijuar komunat e reja me shumicë serbe të Kosovës në Ranilug/Ranillug dhe Klokot/Kllokot, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, dhe në Gračanica/Graçanicë të rajonit të Prishtinës/Priština. Kjo po ashtu ka çuar edhe në zgjerimin e komunës së Novo Brdo/Novobërdë (rajoni i Gjilanit/Gnjilane) ku serbët e Kosovës tani përbëjnë shumicën numerike. Përveç kësaj, komuna e re e Parteš/Parteshit (rajoni i Gjilanit/Gnjilane) është themeluar në qershor të vitit 2010. Pagat, pensionet dhe ndihma sociale në përgjithësi më të larta, që sigurohen nga institucionet e drejtuara nga Serbia, do të thotë se këto me gjasë do mbesin veçori e qeverisjes lokale të Kosovës edhe për një kohë të caktuar.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti serb i Kosovës përbën pakicë numerike në komunën e Ferizajt/Uroševac (serbët e Kosovës përbëjnë përafërsisht 0.036% të popullsisë së përgjithshme të komunës), në komunën e Vitisë/Vitina (0.52%), në Gjilan/Gnjilane (6.1%), dhe në Kamenicë/Kamenica (10.2%). Numri i serbëve të Kosovës në komunën e Kamenicës/Kamenica dhe atë të Vitisë/Vitina ka rënë për shkak të themelimit të dy komunave të reja me shumicë serbe të Kosovës (Ranilug/Ranillug, përkatësisht Klokot/Kllokot) brenda territoreve të tyre përkatëse. Këto përqindje nuk e pasqyrojnë numrin e lartë të serbëve të Kosovës të zhvendosur pas konfliktit të vitit 1999. Serbët e Kosovës që jetojnë në pjesën lindore të rajonit (“Anamorava/Kosovsko pomoravlje”) janë në kuptimin kulturor, administrativ dhe

Procesi, në vazhdim e sipër, i transferimit të kompetencave ka çuar në krijimin e katër komunave dhe zgjerimin e një komune. Kjo gjë rrit numrin e komunave me shumicë serbe të Kosovës nga katër në nëntë komuna, duke i dhënë kështu komunitetit një rol më të madh në qeverisjen lokale.

1 Shih Tabelën 1: vendbanimet e popullsisë, të Shtojcës 1 për listën e vendbanimeve ku jetojnë serbët e Kosovës.

2 Slava (në alfabetin cirilik: слава), po ashtu e njohur edhe si krsna slava (крсна слава) dhe krsno ime (крсно име, që do të thotë emër i pagëzuar) është traditë krishtere ortodokse e kremtimit ritual, respektimit dhe ritit të shenjtorit të familjes përkatëse. Familja kremton sllavën çdo vit në ditën e festës së shenjtorit. Slava kryesisht ka të bëjë me serbët dhe ata e konsiderojnë atë si kremtimin e tyre më të rëndësishëm.

3 Fokusi i këtij Profili është adresimi i përvojave, çështjeve dhe shqetësimeve të komunitetit serb të Kosovës në ato komuna ku ata nuk përbëjnë popullsinë shumicë. Komuna e Shtërpces/Štrpce është përfshirë në pjesën përshkruese të këtij profili për shkak të rrethanave të saja të veçanta, d.m.th., për shkak se është e rrethuar nga komuna me shumicë shqiptare të Kosovës.

Gjatë trazirave të marsit në vitin 2004, serbët e Kosovës të fshatit Svinjarë/Svinjare në pjesën jugore të Mitrovicës /Mitrovica janë evakuuar në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica dhe në Zvečan/Zvečan, ku shumica prej tyre ende banojnë në kushte të rënda. Pronat e tyre janë plaçkitur dhe djegur, dhe përkundër rindërtimit të tyre shqetësimet rreth sigurisë kanë parandaluar kthimin e qëndrueshëm.

Rajoni i Pejës/Peć është prekur rëndë nga konflikti i viteve 1998-1999, me një numër të madh të personave të zhvendosur nga të gjitha komunitetet para, gjatë dhe menjëherë pas konfliktit. Kthimi i pjesëtarëve serb të Kosovës në vendbanimet urbane ka hasur në vështirësi, duke qenë se vetëm pak persona janë kthyer në qytetin e Pejës/Peć.

logjistik të lidhur me qytetin e Gjilanit/Gnjilane, ndërsa serbët e Kosovës në pjesën perëndimore të rajonit (Štrpce/Shtërpçë dhe Ferizaj/Uroševac) janë kryesisht të lidhur me qytetin e Prishtinës/Priština dhe atë të Prizrenit. Kjo gjë ka krijuar larmi në dialektet dhe zakonet lokale. Marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në rajonin e Gjilanit/Gnjilane janë të qëndrueshme dhe pak më të mira se sa në pjesët tjera të Kosovës, ndonëse ende mbesin të ulëta.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti serb i Kosovës banon në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, ku përbëjnë përafërsisht 3.4% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, në komunën e Skenderajt/Srbica, ku afërsisht përbën 0.4%, ndërsa një numër i vogël banon në vendbanimet urbane dhe rurale në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Para konfliktit të vitit 1999, rreth 4 000 – 4 500 serbë të Kosovës kanë jetuar në pjesën jugore të qytetit të Mitrovicës/Mitrovica. Shumica prej tyre ishin zhvendosur gjatë dhe pas konfliktit në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës/Mitrovica dhe në Serbinë qendrore. Në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, serbët e Kosovës jetojnë në fshatrat Priluzhje/Prelluzhë, Gojbulja/Gojbulë, Grace/Gracë dhe Banjskë/Banjska, ku mungesa reale apo e perceptuar e lirisë së lëvizjes vazhdon të ndikojë qasjen në shërbime. Shkalla e papunësisë është e lartë dhe infrastruktura është e dobët, me kufizime të furnizimit me ujë për shumicën e shtëpive. Numri më i madh i serbëve të Kosovës është në Priluzhje/Prelluzhë, ku ata bashkëjetojnë me disa pjesëtarë të komunitetit rom. Në komunën e Skenderajt/Srbica, përafërsisht 30 serbë të Kosovës jetojnë në Suvo Grlo/Syrganë, Banje/Bajë, dhe në Manastirin Ortodoks Serb të Deviçit, ku ata përbëjnë një komunitet shumë të izoluar që përjeton kufizim të lirisë së lëvizjes për shkak të shqetësimeve të sigurisë dhe mungesës së transportit.

Rajoni i Pejës/Peć është pjesë e zonës perëndimore të Kosovës. Serbët i referohen kësaj pjesë si “Metohija”, që do të thotë “toka e Kishës”, duke dëshmuar kështu rëndësinë fetare të rajonit për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës. Dy vendet më të rëndësishme kulturore dhe fetare të trashëgimisë ortodokse serbe, Patriarkana e Pejës/Peć dhe Manastiri i Deçanit, janë në këtë rajon. Patriarku i Kishës Ortodokse Serbe është gjithashtu Kryepeshkopi i Pejës/Peć. Serbët e Kosovës jetojnë në pesë nga gjashtë komunat: Pejë/Peć, Deçan/Dečane, Istog/Istok, Klinë/Klina dhe Gjakovë/Đakovica. Në komunën e Pejës/Peć, serbët e Kosovës përbëjnë afërsisht 0.7% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, me numrin më të madh të komunitetit në fshatin e Gorazhdevac/Gorazhdevcit. Ky fshat është qendra e jetës së komunitetit në rajon, ku jetojnë 850-900 serbë të Kosovës dhe disa malazezë të Kosovës. Në komunën e Deçanit/Dečane, serbët e Kosovës kanë qenë të pranishëm në numër më të vogël para konfliktit, kryesisht në qytet dhe gjithashtu në disa fshatra. Sot ata përbëjnë afërsisht 0.1% të numrit të përgjithshëm të popullsisë të komunës. Në komunën e Istogut/Istok, serbët e Kosovës përbëjnë prej 2.3% deri në 3% të numrit të përgjithshëm të popullsisë. Para konfliktit, shumë pjesëtarë të komunitetit kanë banuar në lagjen “Ljug” të qytetit Istog/Istok, që është shkatërruar gjatë konfliktit dhe tani aty kanë mbetur vetëm 50 serbë të Kosovës. Qendra e jetës e serbëve të Kosovës është zhvendosur në Osojane/Osojan, vendi më i madh i kthimit dhe bazë e shërbimeve të siguruar nga Republika e Serbisë për komunitetin. Në komunën e Klinës/Klina, serbët e Kosovës

përbëjnë afërsisht 1.9% të numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe kryesisht banojnë në veri, që kufizohet me vendbanimet e banuara me serbë të Kosovës të komunës së Istogut/Istok. Përqindja më e madhe e popullsisë që nga botimi i Profileve të vitit 2009 pasqyron numrin në rritje të të kthyerve në këtë rajon.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës përbëjnë pakicën në katër nga shtatë komunat: Prishtinë/Priština (afërsisht 0.4-0.5% e numrit të përgjithshëm të popullsisë), Fushë Kosovë/Kosovo Polje (1.6-2%), Lipjan/Lipljane (2.63%) dhe Obiliq/Obilić (10%). Themelimi i komunës së re të Graçanicës/Gračanica, me shumicë serbësh të Kosovës, ka ulur numrin e serbëve të Kosovës në tri komuna: Prishtinë/Priština, Fushë Kosovë/Kosovo Polje dhe Lipjan/Lipljane, ndërsa nuk ka ndikuar në numrin e tyre në komunën e Obiliqit/Obilić. Serbët e Kosovës po ashtu banojnë në një vendbanim të njohur si “pjesa veriore rurale e Prishtinës/Priština”, ndërsa vetëm disa pjesëtarë kanë mbetur në qytetin e Prishtinës/Priština. Monumenti më i rëndësishëm fetar është Manastiri Serb Ortodoks në Graçanicë/ Gračanica, që gjithashtu është selia e Kryepeshkopit. Në Podujevë/Podujevo, përkatësisht në fshatin Metergoc/Medregovac, është një komunitet i vogël i serbëve të Kosovës, i përbërë nga disa persona të moshuar, që jeton në afërsi të kufirit me Serbinë dhe njëri prej tyre merr pjesë në komitetin për komunitete dhe këshillin komunal për siguri në bashkësi në Podujevë/Podujevo.

Në rajonin e Prizrenit, serbët e Kosovës jetojnë në dy komuna. Në Prizren, ku ata përbëjnë përafërsisht 0.07% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, ata kryesisht banojnë në fshatrat rurale të Luginës së Zhupës/Župa dhe të Rahovecit/Orahovac. Në këtë të fundit, ata përbëjnë afërsisht 1.3% të numrit të përgjithshëm të popullsisë dhe kryesisht banojnë në pjesën e epërme të qytetit të Rahovecit/Orahovac dhe në fshatin Velika Hoča/Hoçë e Madhe. Para konfliktit të vitit 1999, ishin nëntë vendbanime me popullsi të përzier nga serbët e Kosovës dhe shqiptarët e Kosovës në komunën e Rahovecit/Orahovac. Komuniteti serb i Kosovës ka qenë pjesë përbërëse e traditave shumë-kulturore dhe tolerante të Prizrenit dhe ky qytet mbetet një qendër e rëndësishme historike dhe kulturore për komunitetin. Shumë vende të trashëgimisë kulturore dhe fetare, që janë të rëndësishme së veçantë për serbët e Kosovës dhe që janë të mbrojtura me ligjin e zbatueshëm për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, gjenden në këtë rajon. Numri i serbëve të Kosovës në Prizren është zvogëluar pak prej muajit qershor 2009 për shkak të moshës gjithnjë më të vjetër të komunitetit dhe largimeve të vazhdueshme.

Përafërsisht 35-40% e serbëve të Kosovës, që jetojnë në komunën e porsaformuar të Graçanicës/ Gračanica, janë të ri gjë që e bën komunitetin më të qëndrueshëm se sa në rajonet tjera të Kosovës, ku kryesisht kanë mbetur të vjetrit.

Në komunën e Shtimes/Štimlje, nga një popullsi prej 950 persona të komunitetit serb të Kosovës para lufte dhe pas zhvendosjes së 26 personave tjerë të mbetur gjatë trazirave të marsit në vitin 2004, aktualisht kanë mbetur 33 pacientë nga Kosova dhe jashtë saj në qendrën e kujdesit mental në qytet, që janë izoluar dhe kanë shumë pak kontakte me familjet e tyre.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Pjesëmarrja e kufizuar në institucionet e Kosovës, posaçërisht në institucionet qendrore;
- Mungesa reale apo e perceptuar e sigurisë dhe liria e kufizuar e lëvizjes në disa rajone;
- Mungesa e besimit në Policinë e Kosovës;
- Numri i vogël i të kthyerve për shkak të kontesteve të pazgjdhura pronësore, për shkak të mungesës së qëndrueshmërisë ekonomike dhe perceptimeve të sigurisë;

- Uzurpimi i (shfrytëzimi i paligjshëm) i tokës bujqësore në pronësi të serbëve të Kosovës;
- Mungesa e mirëmbajtjes së duhur të varrezave dhe vendeve tjera fetare ortodokse;
- Mbrojtja e pamjaftueshme e vendeve të trashëgimisë kulturore dhe fetare, që nuk përfshihen nga ligji i zbatueshëm për Zonat e Veçanta të Mbrojtura;
- Mungesa e mundësive të qëndrueshme ekonomike dhe varshmëria nga ndihma prej burimeve të ndryshme.



SERBËT E KOSOVËS NË HOÇË TË MADHE/VELIKA HOČA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT/ORAHOVAC (NË RAJONIN E PRIZRENIT) DUKE PRODHUAR RAKI.

1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës vazhdojnë të mbështeten në ndihmat sociale, bujqësore dhe të mirëqenies, që sigurohen nga Beogradi për mbijetesën e tyre.

Para konfliktit të vitit 1999, shumë serbë të Kosovës kanë punuar në sektorin publik dhe në ndërmarrjet në pronësi shoqërore. Sot, shumë prej tyre janë të papunë apo të punësuar në mënyrë joforMeshkuj. Shumë serbë të Kosovës, të cilët zyrtarisht janë të punësuar, punojnë për institucionet e drejtuara dhe ofruesit e shërbimeve nga Serbia, ndërsa të tjerët fitojnë apo i plotësojnë të ardhurat e tyre nëpërmjet blegtorisë dhe bizneseve të vogla, siç janë restorantet dhe dyqanet. Numri i serbëve të Kosovës që janë në listat e pagave të institucioneve komunale, të policisë dhe të kompanive publike është rritur për shkak të zbutjes së përgjithshme të bojkotit ndaj institucioneve të Kosovës. Organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare vendore dhe kontingjentet e KFOR-it, që veprojnë në Kosovë, kanë të punësuar një numër të konsiderueshëm të serbëve të Kosovës. Përkundër shkallës së lartë të papunësisë, serbët e Kosovës janë në situatë relativisht më të mirë se komunitetet tjera për shkak të subvencioneve që marrin nga Beogradi, institucionet e Kosovës dhe donatorët ndërkombëtar, në formën e pensioneve, mirëqenies sociale dhe donacioneve. Perspektiva e komunitetit për t'u integruar, posaçërisht në mesin e të rinjve të cilët rrallë kanë njohuri të gjuhës shqipe, mbetet e ulët.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, gjendja e papunësisë mbetet shqetësimi kryesor për serbët e Kosovës. Ata ende mbështeten në të ardhurat që i fitojnë nga puna në institucionet arsimore dhe shëndetësore të

drejtuara nga Serbia dhe nga strukturat komunale që kanë dalë si rezultat i zgjedhjeve lokale të Serbisë, që janë mbajtur më 11 maj. Shumë familje serbe të Kosovës mbështeten në pensionet dhe përkrahjen e mirëqenies sociale të siguruar nga Beogradi. Shumë gra serbe të Kosovës që nuk kanë qenë të punësuar në sektorin publik para konfliktit të vitit 1999 nuk e gëzojnë të drejtën e pensionit apo të rrogës bazë që e gëzojnë ish punonjësit e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore të Serbisë. Shumica e serbëve të Kosovës që i kanë bojkotuar institucionet e Kosovës pas shkurtit të vitit 2008, janë kthyer në punë. Prandaj, pagat nga buxheti i Kosovës janë bërë një burim i rëndësishëm i të ardhurave për komunitetin. Shumë familje serbe të Kosovës fitojnë apo i plotësojnë të ardhurat e tyre nga blegtoria apo aritja e bagëtisë, ndonëse mundësia për të tregtuar me produktet e tyre është e kufizuar. Megjithatë, tregjet e përziera në qendër të Gjilanit/Gnjilane dhe Kamenicës/Kamenica sigurojnë një mundësi për serbët e Kosovës dhe komunitetet tjera që të tregtojnë me produktet e tyre. Një grup i vogël i serbëve të Kosovës në komunën e Ferizajt/Uroševac nuk kanë mundësi ta sigurojnë mbijetesën në këtë mënyrë për shkak se toka e lërueshme është e uzurpuar. Në Kamenicë/Kamenica dhe Štrpce/Shtërpçë dhe në një masë më të vogël në komunat tjera, serbët e Kosovës po ashtu i gjenerojnë të ardhurat e tyre nga bizneset e vogla private siç janë dyqanet dhe restorantet.

Në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn dhe atë të Skenderajt/Srbica, të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica, gjendja sociale-ekonomike serbëve të Kosovës mbetet e rëndë. Shumë banorë janë të papunë dhe mbështeten në ndihma sociale, paga miniMeshkuj që burojnë nga punësimi i mëhershëm publik apo pensionet nga institucionet e drejtuara nga Serbia. Që nga viti 1999, shumë të rinj, qoftë të paarsimuar apo me diploma universitare, kanë pasur pak ose aspak perspektivë punësimi në rajon. Shumë prej tyre e kanë braktisur Kosovën përgjithmonë apo kanë kërkuar punë sezonale. Në Priluzhje/Prelluzhë, fshati më i madh me popullsi serbe të Kosovës në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, janë disa dyqane private dhe kafiteri që ofrojnë punësim për të rinjt. Në shumicën e rasteve, ato nuk janë të licencuara edhe pse komuna ka ndërmarr hapa për të inkurajuar pronarët që të regjistrojnë bizneset e tyre. Në Grace/Gracë, disa banorë janë të angazhuar në blegtori të vogla dhe kryesisht i shesin produktet e tyre në tregjet në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Banorët e tjerë janë punësuar në institucionet e drejtuara nga Serbia. Një numër i serbëve të Kosovës që banojnë në fshatra punojnë për administratën komunale të Kosovës.

Profesioni kryesor i serbëve të Kosovës në rajonin e Pejës/Peć është bujqësia. Disa prej tyre i shesin produktet e tyre bujqësore në tregjet lokale në Klinë/Klina dhe Mitrovicë/Mitrovica. Ata që nuk merren me bujqësi janë kryesisht të punësuar në institucionet e drejtuara nga Serbia, posaçërisht në sistemin arsimor. Për shembull, 50 pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës punojnë në shkollën fillore dhe të mesme që gjinden në Goraždevac/Gorazhdec, përkatësisht në Sigë/Siga. Vetëm dy pjesëtarë të komunitetit serb janë të punësuar në institucionet e Kosovës në Istog/Istok. Në Pejë/Peć, dhjetë serbë të Kosovës punojnë aktualisht për institucionet e Kosovës. Megjithatë, papunësia mbetet një shqetësim i madh për shumë pjesëtarë të komunitetit dhe shumica nuk mund të gjejnë një vend pune. Në

Themelimi i komunave të reja me shumicë serbe, në rajonin e Gjilanit/Gnjilane dhe të Prishtinës/Priština, ka rritur numrin e serbëve të Kosovës në listat e pagave të institucioneve të Kosovës.

Të dhënat e pavërtetuara tregojnë që në rajonin e Mitrovicës /Mitrovica meshkujt janë më të prekur se sa femrat nga gjendja ekonomike. Femrat janë më aktive në kërkimin e punës, nganjëherë duke u bërë shtylla e vetme e familjes dhe duke punuar në institucionet e Kosovës, siç janë zyrat komunale për komunitete, shkollat apo si motra në qendrat mjekësore.

Në komunën e Deçanit/Dečane, Kisha Ortodokse Serbe ofron punë sezonale ose punë të përkohshme për meshkujt serb dhe shqiptar të Kosovës, në fushën e bujqësisë, ndërtimit dhe transportit.

Po ashtu në Deçan/Deçane, një grua serbe e Kosovës punon si këshilltare për zyrtarët komunal për komunitete, duke u bërë kështu pjesëtarja e vetme dhe e parë e komunitetit serb të Kosovës që është punësuar si shërbyes civil në komunë që nga viti 1999.



OJQ SERBE PËR TË DREJTAT E GRUAS "BRIGA" NË GORAŽDEVAC/ GORAZHDEVAC. NË KUADËR TË AKTIVITETEVE TË TYRE, GRATË SERBE TË KOSOVËS MBLIDHEN PËR TË PUNUAR VESHJE TRADICIONALE QË PASTAJ SHITEN TE SHITËSIT LOKALË.

komunën e Deçanit/Deçane, një nga faktorët kryesor që pengon kthimin dhe riintegrimin e suksesshëm të serbëve të Kosovës janë vështirësitë në qasjen në punësim dhe mundësitë për krijimin e të ardhurave. Ka shumë pak mundësi që serbët e Kosovës suksesshëm të menaxhojnë bizneset e tyre në komunë, për shkak të mungesës së një tregu mikpritës. Meshkujt dhe femrat nga radhët e komunitet serb të Kosovës janë të prekur nga mungesa e mundësive të punësimin. Nga pesë femra të cilat janë kthyer në Deçan/Deçane në vitin 2008, dhe që kanë kërkuar një vend pune, vetëm një është punësuar si zyrtare për zyrën komunale për komunitete dhe atë në bazë të kontratës afat-shkurtër. Kjo grua, e cila është pjesëtarja e parë dhe e vetme e komunitetit serb të Kosovës që është punësuar në komunën e Deçanit/Deçane që nga viti 1999, ka punuar në komunë vullnetarisht deri në qershor të vitit 2010, pa mbrojtje ligjore dhe sociale që buron nga kontrata e punës. Priftërinjtë e Manastirit të Deçanit të Kishës Ortodokse Serbe kanë zhvilluar aktivitete të vogla tregtare për përkrahjen e vëllazërisë së tyre, siç janë prodhimi dhe marketingu i verës dhe djathit të tyre dhe shitja e qirinjve dhe suvenireve fetare për vizitorët që vizitojnë Manastirin. Murgjit dhe punëtorët sezonalë kryejnë edhe aktivitete prodhuese, siç janë bujqësia dhe mbajtja e bletëve, por produktet e tyre zakonisht përdoren për konsumim të brendshëm. Një burim i rëndësishëm i të ardhurave për serbët e Kosovës janë pensionet dhe ndihmat e mirëqenies sociale nga institucionet e drejtuara nga Serbia, si dhe deri në një masë ato nga Kosova. Të kthyerit në Zallq/Žac dhe Dragolevc/Dragolevac në komunën e Istogut/Istok përkrahen me ndihma humanitare dhe nuk kanë asnjë mjet punësimi. Disa prej tyre janë të vetëpunësuar dhe merren me aktivitete tregtare në shtëpi apo dyqane dhe u sheshin mallra një numri të kufizuar të klientëve. Dhënia me qira e pronave të tyre për aktivitete tregtare është po ashtu një burim i dobishëm i të ardhurave.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti serb i Kosovës mbështetet kryesisht në institucionet e drejtuara nga Serbia, ku shumica punojnë si mësimdhënës, drejtor shkolle, motra dhe mjekë. Të tjerët marrin paga miniMeshkuj nga ish ndërmarrjet në pronësi shoqërore apo pensione. Disa pjesëtarë të moshuar të komunitetit serb të Kosovës i marrin gjithashtu pensionet nga buxheti i Kosovës. Shumë serbë të Kosovës janë të punësuar si shërbyes civil dhe gjinden në listat e pagave të institucioneve të Kosovës, siç janë zyrtarët komunal për komunitete, anëtarët e komitetit për komunitete, policët dhe mësimdhënësit. Shumica e mësimdhënësve dhe punëtorëve shëndetësor marrin paga nga Beogradi dhe Prishtina/Priština, meqenëse ata janë njëkohësisht të punësuar në të dy sektorët publikë. Shumë serbë të Kosovës janë të punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK). Disa pjesëtarë të moshuar të komunitetit serb mbështeten në bujqësi, si një formë e të ardhurave, por vetëm sezonalisht dhe atë për t'i përmbushur nevojat e tyre. Në rajonin e Prizrenit, si në vendet tjera të Kosovës, papunësia është e përhapur mes pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës. Shumica janë të punësuar në administratën lokale të Kosovës dhe në institucionet e drejtuara nga Serbia, posaçërisht në arsim, shëndetësi, gjykata, polici dhe administratë komunale. Pjesëtarët e komunitetit serb në Kosovë në komunën e Rahovecit/Orahovac dhe në Luginën e Župa/Zhupës (Prizren) marrin ndihma sociale dhe pensione nga institucionet e drejtuara nga Serbia dhe

buxheti i Kosovës. Për mirëmbajtjen e hapësirës së Kishës së Shën Gjergjit dhe të Seminarit Ortodoks në qytetin e Prizrenit, Kisha Ortodokse Serbe ka punësuar katër pjesëtarë të komunitetit serb të Kosovës. Sa i përket biznesit privat, vetëm disa serbë të Kosovës janë të angazhuar në prodhimin e verës dhe rakisë vendore.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës vazhdojnë të jenë cak i incidenteve kundër personave, pronës dhe vendeve të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Kjo gjë minon sigurinë dhe lirinë e tyre të lëvizjes, gjë që e pengon qasjen e tyre në shërbime dhe në gëzimin e të drejtave themelore. Përdhosja e përsëritur e varrezave ortodokse të serbëve të Kosovës përbën një trend shqetësues, ku gjatë vitit 2009-2010 ka pasur raportime nga e tërë Kosova për disa incidente. Reagimi i institucioneve qendrore dhe komunale dhe të Policisë së Kosovës, pas incidenteve me cak pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës, është përmirësuar që nga viti i kaluar. Dënimi publik i incidenteve dhe aktivitetet e sensibilizimit tek personat e prekur janë shpeshtuar. Marrëdhëniet ndëretnike vazhdojnë të jenë të minuara në ato komuna ku nuk ka pasur reagime të tilla të drejtpërdrejta apo kur ato janë më pak domethënëse. Në disa vendbanime duket që gratë serbe të Kosovës gëzojnë më shumë liri të lëvizjes brenda dhe jashtë komunitetit të tyre se sa gratë tjera nga radhët e komuniteteve joshumicë. Duket që ato kanë më pak frikë se sa meshkujt serbë të Kosovës se do jenë cak i dhunës ndëretnike. Femrat nga komuniteti serb i Kosovës janë më mirë të përfaqësuara në Policinë e Kosovës se sa komunitetet e tjera joshqiptare.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane është shënuar një ngritje e lehtë në numrin dhe ashpërsinë e incidenteve që nga 2008-2009. Në gusht të vitit 2009, një çift i moshuar serb i Kosovës është vrarë në shtëpinë e tyre në fshatin Parteš/Partesh; hetimet vazhdojnë dhe ende nuk ka ndonjë arrestim.⁴ Në shtator të vitit 2009, një mashkull serb i Kosovës është rrahur nga dy shqiptarë të Kosovës në oborrin e shtëpisë së tij në fshatin Parallovë/Paralovo (komuna e Novo Brdo/Novobërdës). Incidenti i mëhershëm është dënuar nga autoritetet lokale nëpërmjet një deklarate të bërë në një mbledhje të këshillit komunal për siguri në bashkësi dhe të vendosur në ueb faqen komunale. Incidenti i fundit është dënuar nga zyra komunale për komunitete, që është përcjellur nga vizita e nënkryetarit të komunës për komunitete tek familja në fjalë. Në tetor të vitit 2009, një mjet shpërthyes ishte hedhur në pronat e pjesëtarëve të komunitetit serb të Kosovës në Cërnica/Cernica (Gjilan/Gnjilane) dhe njëra prej shtëpive ishte e një zrytari të lartë që punon në strukturat e drejtuara nga Serbia në një fshat të përzier etnikisht. Sipas viktimës ky ishte sulmi i shtatë kundër pronës së tij që nga viti 1999. Në të njëjtin muaj, një familje serbe e Kosovës është plaçkitur dhe sulmuar në shtëpinë e tyre në Klokot/Kllokot. Mbishkrimet "UÇK" (Ushtria Çlirimtare e Kosovës) janë shfaqur në shatërvanin që gjendet në qendër të fshatit serb Koretište/Koretishtë.⁵ Në dhjetor të vitit 2009, një femër e moshuar nga komuniteti serb i Kosovës është sulmuar dhe plaçkitur në shtëpinë e saj në Draganac/Draganacë (Gjilan/Gnjilane). Policia ka kapur dy meshkuj shqiptarë të Kosovës të dyshuar dhe lënda gjyqësore është në procedurë. Në shkurt të vitit 2010 është

Përdhosja e varrit të një serbi të Kosovës në qytetin e Gjilanit/Gnjilane, në shkurt të vitit 2010, ka pasur një ndikim të madh në komunitetin. Që nga ajo kohë, familja e të personit të vdekur ka transferuar eshtrat në një varrezë që gjendet në një rajon me shumicë serbesh të Kosovës.

Njëqind e dyzet e tetë (148) femra serbe dhe gjashtëqind e pesëdhjetë e nëntë meshkuj serb Kosovo Serb janë pjesëtarë të Policisë së Kosovës.

4 Në kohën e incidentit Komuna e Gjilanit/Gnjilane, kurse që nga qershori i vitit 2010 në komunën e porsaformuar të Parteš/Parteshit.

5 Në kohën e incidentit Komuna e Gjilanit/Gnjilane, tani pjesë e komunës së zgjeruar të Novo Brdo/Novobërdës.

Më 2009-2010, pjesëtarët e Policisë së Kosovës nga komuniteti serb i Kosovës, që janë zbarkuar në veri të Mitrovica/Mitrovicës, janë ngacmuar dhe kanë marr kërcënime duke u quajtur “tradhtarë” dhe nga ata është kërkuar të japin dorëheqje nga policia.

përdhosur varri i pjesëtarit të parë serb të Kosovës që është varrosur në varrezat ortodokse serbe në qytetin e Gjilanit/Gnjilane që nga viti 1999. Komuna e Gjilan/Gnjilane dhe Qeveria e Kosovës kanë dënuar incidentin nëpërmjet mediave dhe kanë vizituar vendin dhe familjen e prekur. Gjatë kohës së shkrimit të këtij dokumenti hetimet vazhdonin dhe nuk ishte arrestuar askush. Përdhosjet e tjera të varrezave ortodokse në rajon përfshijnë edhe dy incidente të raportuara në Binçë/Binaç (Viti/Vitina) në gusht të vitit 2009, që janë dënuar menjëherë nga kryetari. Një incident tjetër ka ndodhur në Talinoc i Muhaxherëve/Muhadžer Talinovac (Ferizaj/Uroševac) në shtator të vitit 2009 dhe nuk ka pasur asnjë reagim nga autoritetet komunale. Në mars të vitit 2010, një mashkull serb i Kosovës është sulmuar gjatë kohës kur ishte duke vozitur nëpër fshatin Parallovë/Paralovo (Novo Brdo/Novobërdë). Kryetari e dënoi incidentin vetëm disa ditë më vonë. Në prill të vitit 2010, tre meshkuj shqiptarë të Kosovës ishin arrestuar për shkak se e kishin ngacmuar një femër serbe të Kosovës në Gjilan/Gnjilane në lidhje me një borxh të papaguar. Incidente të tilla të sigurisë kanë një ndikim negativ në lirinë e lëvizjes të serbëve të Kosovës. Kjo situatë përkeqësohet edhe më shumë me gjuajtjen e gurëve në drejtim të automjeteve të tyre gjatë udhëtimit nëpër vendbanimet me shumicë shqiptarësh të Kosovës.

Policia e Kosovës dhe KFOR-i ende patrullojnë rregullisht në vendbanimet dhe rreth vendbanimeve të banuara me serbë të Kosovës, si në Štrpce/Shtërpçë apo në fshatrat që banojnë nga të kthyerit serbë të Kosovës në komunën e Ferizajt/Uroševac. Zyrtarët policorë nga komuniteti serb i Kosovës janë të pranishëm në të gjitha stacionet e Policisë së Kosovës në rajon, përveç në Ferizaj/Uroševac. Një e treta e numrit të përgjithshëm të zyrtarëve policorë në stacionin e policisë në Viti/Vitina janë serbë të Kosovës (vetëm një është femër). Pritet që disa prej tyre do të vendosen në stacionet e policisë që do hapen në komunën e re të Klokot/Killokotit. Serbët e Kosovës që jetojnë në Viti/Vitina frikësohen se do mbesin pa përfaqësim në polici dhe që kjo mund të ndikojë negativisht në sigurinë e tyre. Megjithatë, pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane nuk kanë besim në Policinë e Kosovës dhe si faktor e theksojnë numrin e vogël të rasteve të zgjidhura që kanë pasur prapavijë etnike. Kjo pastaj çon në mosparaqitjen e incidenteve më të vogla në polici.

SERBËT E KOSOVËS DUKE HIPUR NË NJË AUTOBUS HUMANITAR NË PJSËN VERIORE TË MITROVICËS/MITROVICA. KY SHËRBIM OFRON TRANSPORT PËR MIJËRA SERBË TË KOSOVËS DHE KOMUNITETE TJERA NËPËR TËRË KOSOVËN. PROJEKTI QË DREJTOHEJ NGA UNHCR-JA IU DORËZUA DIKUR AUTORITETEVE TË KOSOVËS, QË MOMENTALISHT I OFROJNË KËTO SHËRBIME DUKE KONTRAKTUAR KOMPANI PRIVATE, DUKE PËRFSHIRË KËTU KOMPANI TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS.



Pjesëtarët e komunitetit rrallë përdorin transportin publik për të udhëtuar jashtë vendbanimeve të tyre, duke u mbështetur kështu më shumë në transport privat, taksi dhe shërbimin humanitar të transportit me autobusë. Ky i fundit përfshin shtatë linja që funksionojnë në Kamenicë/Kamenica, Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane dhe Viti/Vitina, ku lidhen vendbanimet rurale me serbë të Kosovës me qendrat e qytetit në rajon dhe rreth tij. Komuniteti është i kënaqur me shërbimet që ofrohen. Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës marrin pjesë në punën e këshillave komunale për siguri në bashkësi. Megjithatë, në shumicën e komunave ky organ funksionon nën mesatare. Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës marrin pjesë në mënyrë aktive në punën e këshillit komunal për siguri në bashkësi në Ferizaj/Uroševac dhe Gjilan/Gnjilane. Përkthimi sigurohet gjatë mbledhjeve dhe komuniteti ka mundësinë për t'i shprehur shqetësimet dhe qëndrimet e tij në lidhje me temat që diskutohen. Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës marrin pjesë në mbledhjet e komitetet lokale për siguri publike në qytetin e Vitisë/Vitina, fshatin Smirë/Smira (Viti/Vitina); Vrbovac/Vërboc (Klokot/Kllokot), Parteš/Partesh, Livoçi i Epërm/Gornji Livoč (Gjilan/Gnjilane); Berivojcë/Berivojce, Muqivercë/Mučiverce, Shipashnicë/Šipašnica dhe Karaçevë/Karačevo (Kamenicë/Kamenica); dhe Llabjan/Labjane dhe Bostane/Bostan (Novo Brdo/Novobërdë). Në disa raste nuk është siguruar përkthimi në gjuhën serbe, duke penguar kështu pjesëmarrjen e komunitetit në këto mbledhje.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, përkeqësimi i situatës së sigurisë që nga mesi i vitit 2009 në veri të Mitrovicës/Mitrovica i ka ngritur tensionet. Është raportuar për numër të shtuar të incidenteve të sigurisë ndërmjet komuniteteve ku shqiptarët dhe serbët e Kosovës janë paraqitur si kryerës ashtu edhe si viktima. Për shembull, në mars të vitit 2010 një serb i Kosovës, përndryshe polic jashtë orarit të punës, dhe bashkëshortja e tij janë sulmuar fizikisht nga katër shqiptarë të Kosovës në afërsi të lagjes Tre Rrokaqiejt/Tri solitera në veri të Mitrovicës/Mitrovica ku jetojnë shqiptar dhe atij boshnjak. Në ato komuna ku pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës përbëjnë pakicën, kanë qenë të shpeshtuara incidentet që kanë pasur cak pronën e tyre. Janë raportuar vjedhje dhe uzurpim i tokës dhe pronës së pabanuar së të kthyerve në Svinjarë/Svinjare, komuna e Mitrovicës/Mitrovica, mes muajve janar-shkurt të vitit 2010, që ka çuar

Që nga prilli i vitit 2010, antenat e operatorit të palicensuar Serb të telefonisë mobile janë shkyçur nga Autoriteti Rregullativ i Telekomunikacionit i Kosovës, duke vështirësuar kështu komunikimin për mijëra pjesëtarë të komunitetit serb, përfshirë atë të policisë dhe shërbimeve emergjente.



VARREZAT E QYTETIT TË GJILANIT/GNJILANE, KU GJENDEN PËRAFËRSISHT 200 VARRE NË GJENDJE JASHTËZAKONISHT TË KEQE PËR SHKAK TË MOSKUJDESIT DHE AKTEVE TË KOHËPASKOHSHME VANDALE. VARRIMI I PARË NDONJËHERË I NJË SERBI TË KOSOVËS KËTU U BË NË SHKURT TË VITIT 2010 MIRËPO VARRI U PËRDHOS DHE TË MBETURAT MORTORE, ME KËRKESË TË FAMILJES, U ZHVARROSËN DHE U BARTËN NË VARREZAT ORTODOKSE SERBE NË FSHATIN KORETIŠTE/KORETISHTË NË AFËRSI.

Në Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica dhe Pejë/Peć, shërbimet e telefonisë mobile janë rivendosur pjesërisht nëpërmjet sinjalit të përforcuar nga antenat në Serbi. Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës në Prizren dhe më Prishtinë/Priština kanë filluar të përdorin operatorët e telefonisë mobile të Kosovës.

në shtimin e pranisë së policisë në këtë vendbanim. Në shkurt të vitit 2010, një autobus i linjës humanitare që lëvizte nga fshati Osojan/Osojane në komunën e Istogut/Istok (rajoni i Pejës/Peć) për në veri të Mitrovicës/Mitrovica e që transportonte 50 udhëtarë të komunitetit serb të Kosovës u gjuajt me gurë nga nxënësit derisa kalonte në vendbanimin me popullsi shqiptare të Kosovës të Runikut/Rudnik në komunën e Skenderajt/Srbica. Si reagim, njësia policore e komunitetit në Skenderaj/Srbica organizoi mbledhje me drejtorin e shkollës përkatëse, disa mësime nxënës dhe këshillin e prindërve. Një plan për rritjen e numrit të patrullimeve është duke u zbatuar në këtë vendbanim. Në mars të vitit 2010, dritaret e ndërtesës në hapësirat e Kishës Ortodokse të Shën Elisë në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn janë dëmtuar. Policia e Kosovës identifikoi kryerësit e veprës si disa të rinj të shkollës në afërsi dhe organizoi takime me drejtorinë e shkollës për të ndaluar incidentet. Po ashtu në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, më mars të vitit 2010, një serb i Kosovës me banim në Gojbulja/Gojbulë ka raportuar ngacmim nga disa të rinj shqiptarë të Kosovës nga fshati fqinjë Miroq/Mitroçe dhe vjedhje të pajisjeve bujqësore. Policia e Kosovës ka sensibilizuar komunitetin dhe ka intensifikuar patrullimet. Komuniteti ka shprehur mungesën e besimit në polici dhe aftësinë e tyre për të adresuar nevojat e tyre të sigurisë. Komuniteti e ka perceptuar incidentin si përpjekje të ngacmimit. Komuna ka dështuar që në mënyrë efektive të sensibilizojë komunitetin. Në maj të vitit 2010 në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, përkatësisht në fshatin Shtitaricë/Štitarica, nga persona të panjohur janë thyer dritaret e një shtëpie të një pjesëtari të komunitetit serb të Kosovës. Për dallim me këto incidentet, serbët e Kosovës në fshatrat Banja/Bajë dhe Suvo Grlo/Syriganë, të komunës së Skenderajt/Srbica, nuk kanë shfaqur ndonjë shqetësim në lidhje me lirinë e lëvizjes dhe kanë theksuar gjendjen e përmirësuar të sigurisë në komunë. Në tërë rajonin e Mitrovicës/Mitrovica jugore, pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës kanë liri të kufizuar të lëvizjes jashtë vendbanimeve të tyre dhe mbështeten në autobusin humanitar apo mjetet private të transportimit për t'iu qasur shërbimeve në veri të Mitrovicës/Mitrovica.

Në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn, autobusi për transport humanitar lidh Grace/Gracën, Gojbulja/Gojbulën dhe Banjskën/Banjska me pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica. Në fshatrat Banja/Bajë dhe Suvo Grlo/Syriganë, në komunën e Skenderajt/Srbica nuk funksionon asnjë autobus për shërbim humanitar dhe banorët mbështeten vetëm në mjetet private të transportit. Përkundër një shkalle të mosbesimit të komunitetit, marrëdhëniet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe policëve të Kosovës janë të kënaqshme dhe zyrtarët serbë të Kosovës përfaqësohen në pjesën dërmuese të stacioneve në rajon. Janë dy nënstacione policore të Kosovës në zonat e banuara me serbë, në pjesën jugore të rajonit të Mitrovicës/Mitrovica, njëri në Priluzhje/Prelluzhë (Vushtrri/Vučitrn) dhe tjetri në Suvo Grlo/Syriganë (Skenderaj/Srbica). I pari ka 14 policë serbë të Kosovës, ndërsa i dyti ka vetëm një. Nuk ka përfaqësim të serbëve të Kosovës në polici në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica. Një numër i zyrtarëve, të cilët kanë punuar në nënstacionin e Svinjarës/Svinjare janë rivendosur në stacionin e pjesës veriore të Mitrovicës/Mitrovica. Nënstacioni vazhdon të veprojë vetëm me policë shqiptarë të Kosovës⁶. Funksionimi i këshillit komunal për siguri në bashkësi me pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës vepron vetëm në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn. Serbët e Kosovës

6 Nga shkurti 2008, Policët serbë të Kosovës kishin ndërprerë shërbimin e tyre në jug të lumit Ibër dhe u paraqitën në punë në pjesën veriore të Kosovës. Lëvizja e tyre në stacionet policore në veri të Kosovës asnjëherë nuk u miratua zyrtarisht nga policia e Kosovës.

përfaqësohen nga kryesuesi i zyrës komunale për komunitete. Në komunat e Skenderajt/Srbica dhe Mitrovicës/Mitrovica, janë themeluar këshillat komunale për siguri në bashkësi por ato nuk funksionojnë. Në Priluzje/Prelluzhë (Vushtri/Vučitrn) komiteti lokal për siguri publike është themeluar në vitin 2006, por nuk ka funksionuar asnjëherë. Në vitin 2009, komiteti lokal për siguri publike në Suvo Grlo/Syrganë dhe Banja/Bajë është themeluar përsëri. Ai përbëhet prej shtatë anëtarëve, prej të cilëve tre janë serbë të Kosovës, përfaqësues të dy fshatrave; njëri është polic serb i Kosovës.

Në rajonin e Pejës/Peć, sulmet kundër pronës së serbëve të Kosovës dhe kundër tyre personalisht filluan në fillim të vitit 2010, me ndikim në perceptimet e sigurisë dhe lirisë së lëvizjes. Në komunën e Deçanit/Dečane, incidentet e sulmeve lidhur me kontestet pronësore janë raportuar nga serbët e zhvendosur, me rastin e vizitës së vendbanimeve të tyre të uzurpuara. Murgjit e manastirit të Visoki Dečani kanë liri të kufizuar të lëvizjes. Ndonëse, ata ndonjëherë udhëtojnë pa përcjellje në automjetet e tyre private përmes qytetit të Deçanit/Dečane, ata lëvizin lirshëm vetëm në disa pjesë të zonës së veçantë përreth manastirit, i cili patullohet nga trupat e KFOR-it. Katër murgesha të moshuara, janë 24 orë nën kujdestarinë e policisë në kishën ortodokse të Virgjëreshës së Shenjtë në komunën e Gjakovës/Đakovica. Ato përcillen kudo që udhëtojnë jashtë kësaj zone. Në komunën e Klinës/Klina, gjendja e sigurisë ka shënuar përmirësim deri në njëfarë mase dhe serbët e Kosovës ndihen më të sigurtë të shkojnë në shitoret dhe tregjet lokale. Ndonëse, ata mundohen të mos bien në sy në vende publike. Në korrik të vitit 2009, një i kthyer serb i Kosovës është sulmuar nga një sulmues i panjohur, derisa punonte në arën e tij afër Grabac/Grapcit (Klinë/Klina). Kryetari i komunës dhe policia e kanë dënuar këtë akt dhe kanë pohuar që duhet të ndërmerren masa për siguri shtesë dhe fitim të besimit. Ata gjithashtu e kanë vizituar këtë familje. Protestuesit shqiptarë të Kosovës kanë hedhur gurë në pelegrinët serbë, të cilët shkonin në kishën ortodokse të Virgjëreshës së Shenjtë në Gjakovë/Đakovica, për të festuar lumturimin ortodoks, më 28 gusht 2009 dhe kësaj veprimi ka kaluar pa u dënuar. Në tetor të vitit 2009, dy shtëpi serbe të zbrazëta janë djegur në komunën e Istogut/Istok dhe Pejës/Peć. Në qytetin e Klinës/Klina, shtëpia e një serbi tjetër është plaçkitur dhe shtëpia tjetër është gjuajtur me gurë, në nëntor të vitit 2009.

Varrezat e serbëve të Kosovës janë përdhosur për herë të tretë në Vidëje/Vidanje (Klinë/Klina) në nëntor të vitit 2009, pasi që komuna kishte rregulluar dëmin e shkaktuar më parë. Në të njëjtin fshat, janë shpërthyer dy herë gomat e automjeteve të serbëve të Kosovës, ndërmjet periudhës kohore janar dhe mars 2010. Gjithashtu, ndërmjet periudhës janar - mars 2010, shtëpia në Klinë/Klina që i përkiste një çifti serbë të moshuar të Kosovës, është gjuajtur me gurë tre ditë. Komuna ka dënuar incidentin dhe ka financuar të gjitha riparimet. Policia ka kapur kryerësit shqiptarë të Kosovës të kësaj vepre dhe policia e komunitetit ka zhvilluar aktivitete informimi në familjen, e cila ishte cak i sulmeve. Gjatë të njëjtës periudhë kohore, në polici nuk janë raportuar vjedhjet e pronave të zbrazëta të serbëve të Kosovës të zhvendosur në Belo Polje/Bellopojë afër qytetit të Pejës/Peć dhe nuk është bërë ndonjë reagim i veçantë nga ana e komunës. Një shtëpi e zbrazët në fshatin Gremnik/Grebniq (Klinë/Klina) ku ka të

Pelegrinët serb të Kosovës udhëtojnë përmes Deçanit/Dečane me transport privat, ndonjëherë natën për të marr pjesë, për shembull, meshën e të enjtes mbrëma në Manastir dhe zakonisht nuk ka ndonjë incident. Megjithatë, shenjat e trafikut drejt Manastirit janë dëmtuar vazhdimisht.

Dy shqiptarë të Kosovës kanë ngacmuar, sulmuar dhe kërcënuar qëllimisht një të kthyer serb të Kosovës në Osojane/Osojan dhe Zallq/Žac në komunën e Istogut/Isto. Ata janë arrestuar, akuzuar dhe janë në pritje të gjyqimit. Ata kanë bërë kundërvajtje në disa rast, duke shkaktuar kështu humbjen e besimit të komunitetit në sundimin e ligjit.

kthyer serbë të Kosovës, i është vënë zjarri nga kryerës të panjohur. Një prej incidenteve më të rënda të sigurisë në rajon ka ndodhur në shkurt të vitit 2010, kur një i kthyer serb i Kosovës është sulmuar nga një shqiptarë i Kosovës, derisa po kthehej nga fshati i pëzier etnikisht i Zallqit/Žac në fshatin me serbë të Kosovës të Osojane/Osojanit. Autoritetet e niveli lokal dhe qendror e kanë dënuar incidentin dhe kanë kryer aktivitete informimi me komunitetin. Kryesitë kanë vazhduar t'i ngacmojnë dhe sulmojnë një grup të të kthyerve spontan në Zallq/Žac me mbështetjen dhe pjesëmarrjen e banorëve tjerë shqiptarë të Kosovës. Hedhja me gurë në tenda, të shtënat dhe ngacmimet kanë vazhduar edhe në kohën e shkruarjes së raportit, në qershor të vitit 2010 dhe dukej se kjo gjë do të vazhdonte ende. Bashkësia ndërkombëtare dhe autoritetet lokale kanë dënuar incidentet dhe kanë zhvilluar aktivitete intenzive informimi për ata që e kanë pësuar. Prania e përhershme e KFOR-it dhe policisë aty, kanë dështuar që t'i ndalojnë këto sulme. Në maj 2010, autobusi që drejtohej nga një serb i Kosovës është gjuajtur me gurë në fshatin Shtupel/Štupelj nga dy shqiptarë të Kosovës, të cilët janë kapur nga policia. Në qershor të vitit 2010, tri shtëpi të serbëve të Kosovës janë plaçkitur në fshatin Berkovë/Berkovo village. Që të dy incidentet kanë ndodhur në komunën e Klinës/Klina.

Serbët e Kosovës në rajon janë të kënaqur në përgjithësi me punën e Policisë së Kosovës. Komuniteti përfaqësohet me pesë zyrtarë policorë në nënstacione e Gorazdevac/Gorazhdevcit, një në nënstacionin e Vitomirica/Vitomiricës dhe një në stacionin e Pejës/Peć, të gjithë meshkuj. Njësitë e policisë në komunitet janë shumë aktive në komunat e Istogut/Istok dhe Klinës/Klina. Pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në këshillat komunale për siguri në bashkësi dhe komitetet lokale për siguri publike në rajon është e ndryshme. Në Istog/Istok, këshilli komunal për siguri në bashkësi funksionon dhe i është bërë ftesë edhe serbëve të Kosovës. Megjithatë, komuniteti ka dështuar të marrë pjesë. Aty nuk është themeluar asnjë këshill lokal për siguri në publik. Në Pejë/Peć, këshilli komunal për siguri në bashkësi është aktiv dhe kemi një pjesëmarrje të mirë të komunitetit, me përfaqësues serbë të Kosovës nga Siga/Siga, Brestovik/Brestoviku dhe Levosha/Ljevoša, të cilët takohen rregullisht dhe angazhohen në mënyrë efikase. Komitetet lokale për siguri publike janë themeluar në Levoshë/Ljevoša dhe bashkëpunimi i tyre me këshillin komunal për siguri në bashkësi në Pejë/Peć është i mirë. Në komunën e Deçanit/Dečane, këshilli komunal për siguri në bashkësi funksionon pa pjesëmarrjen e murgjëve ortodoks serbë, të cilët jetojnë në manastirin e Visoki Dečani dhe pa pjesëmarrjen e komunitetit të vogël të serbëve të Kosovës. Në komunën e Klinës/Klina nuk ka këshilla komunale për siguri në bashkësi. Ndonëse, në prill të vitit 2010 dy komitete lokale të reja për siguri publike janë themeluar në fshatrat Dresnik/Dršnik dhe Dolc/Dollac (Klinë/Klina). Këto forume janë përceptuar pozitivisht nga komuniteti. Serbët e Kosovës në rajon, shfrytëzojnë tre autobusë të transportit humanitar, i cili lidh vendbanimet e tyre në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica dhe komunën e Zvečan/Zveçanit. Shërbimi me autobus lokal sigurohet nga zyra komunale për komunitete në komunën e Klinës/Klina, që lidh vendbanimet serbe me ndërtesat e administratës publike. Linjat janë të rregullta dhe komuniteti nuk ka shprehur ndonjë brengë për funksionimin e tyre. Një prej shërbimeve të transportit është gjuajtur me gurë, në rastin kur po udhëtonte përmes fshatrave të banuara me shqiptarë të Kosovës në komunën e Skenderajit/Srbica, në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh të gjendjes së serbëve të Kosovës. Vazhdojnë të ndodhin incidente të sigurisë, duke minuar kështu sigurinë dhe lirinë e lëvizjes së komunitetit. Këto përfshijnë ngacmimin e tri serbëve të Kosovës nga shqiptarët e Kosovës në qytetin e Lipjanit/Lipljane. Në qershor të vitit 2009, policia ka reaguar menjëherë dhe ka kapur pesë të dyshuar, ndërsa komuna e ka dënua incidentin. Në shtator 2009, janë dëmtuar gurët e varreve në varrezat e serbëve të Kosovës në fshatin Vrellë/Vrelo (Lipjan/Lipljan), gjë që është dënua nga kryetari i komunës përmes shtypit lokal. Ndërsa, në nëntor 2009, është përdhosur një varrezë tjetër serbe në Gornja Brnjica/Bërnice të Epërme (Prishtinë/Priština) dhe nuk ka pasur reagim nga ana e autoriteteve. Përsëri, në janar 2010, janë vandalizuar dy varreza ortodokse në Llapnasellë/Laplje (Gračanica/Graçanicë) dhe në fshatin Lismir/Dobri Dub (Fushë Kosovë/Kosovo Polje). Për të mëparshmen nuk kishte ndonjë reagim nga zyrtarët komunal, ndërsa për të fundit është diskutuar gjatë mbledhjes komunale, ku kryesuesi i kuvendit komunal ka shprehur keqardhjen e tij për incidentin. Megjithatë, nuk është lëshuar asnjë deklaratë zyrtare për ta dënua këtë akt. Në dhjetor 2009, një grua serbe e Kosovës është ngacmuar seksualisht nga një mashkull shqiptarë i Kosovës, i cili është kapur më vonë në Slivovë/Slivovo (Prishtinë/Priština). Në mars të vitit 2010, varrezat ortodokse në fshatin Rubovc/Rubovce, (Lipjan/Lipljan) janë përdhosur, akt ky, i cili është dënua nga kryetari i komunës dhe është diskutuar me komunitetin gjatë takimit me Policinë e Kosovës. Gjithashtu, në mars 2010, një serb i moshuar i Kosovës është sulmuar fizikisht dhe plaçkitur në fshatin etnikisht të përzier të Çaglavica/Çagllavicës (Gračanica/Graçanicë), me asnjë reagim zyrtar ose aktivitet informimi nga ana e komunës. Në prill të vitit 2010, është hedhur gurë në shtëpinë dhe xhamat e automjetit të familjes serbe të Kosovës në Kishnicë/Kišnica (Gračanica/Graçanicë). Përsëri, nuk ka pasur asnjë reagim nga autoritetet komunale.

Serbët e Kosovës në rajonin e Prishtinës/Priština nuk marrin pjesë në këshillat komunale për siguri në bashkësi ose në këshillat lokale për siguri në publik, të themeluara në zonat ku ata jetojnë. Kjo do t'i kontribuonte mungesës së reagimit nga ana e autoriteteve për nevojat e tyre për siguri. Përceptimet e komunitetit për policinë në rajon janë në përgjithësi të mira. Zyrtarët serbë të Kosovës në rajon janë të angazhuar në komunat e Fushë Kosovës/Kosovo Polje (shtatë meshkuj dhe një femër), Lipjanit/Lipljane (22 meshkuj dhe dy femra; plus në nënstacionin e Janjevës/Janjevo janë pesë meshkuj dhe dy femra), Obiliqit/Obilić (tetë meshkuj dhe një femër), Prishtinës/Priština (në nënstacionin qendror, në pjesën jugore dhe dhe veriore – 14 meshkuj dhe dy femra) dhe Gračanica/Graçanicës (34 meshkuj dhe dy femra). Në drejtorinë rajonale të Prishtinës/Priština, janë dy zyrtare femra dhe tre zyrtarë meshkuj. Komuniteti shfrytëzon shërbimin e transportit humanitar, që lidh vendbanimet e serbëve të Kosovës në kuadër të rajonit me vendbanimet tjera serbe të Kosovës në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica. Megjithatë, dy prej katër rrugëve kanë pushuar së funksionuari në baza të rregullta. Shfrytëzuesit ankohen për joseriozitetin dhe cilësinë e dobët të shërbimeve të këtyre dy të tjerave. Kalimi i kompetencave nga niveli qendror i pushtetit në atë lokal ka ndikuar në sigurimin e transportit të financuar nga komuna për komunitetet joshumicë në rajon. Komuna

Mbrojtësi i viktimave në Pejë/Peć ka thënë që shumë gra serbe të Kosovës janë viktime të dhunës familjare. Fatkeqësisht, ato nuk i raportojnë rastet në Polici ose në ndonjë institucion relevant për zbatimin e ligjit.

Në korrik të vitit 2009, udhëheqësi serb i Kosovës i fshatit Kishnicë/Kišnica në Gračanica/Graçanicë njoftoi për përceptimin e komunitetit të tij, që incidentet e shpeshta të sigurisë në atë zonë i bëjnë presion atyre që të largohen nga Kosova.

e Prishtinës/Priština ka ndërprerë shërbimet, që transportonin serbët e Kosovës nga “Yu Building”, qyteti i Prishtinës/Priština në qytetin e Gračanica/Graçanicës, me arsyetimin, që komuna e posa themeluar e Gračanica/Graçanicës duhet t'i mbulojë mirëmbajtjen dhe shpenzimet operacionale. Për dallim, autoritetet lokale të Lipjanit/Lipljan dhe Gračanica/Graçanicës kanë demonstruar pragmatizëm, duke u pajtuar për t'i ndarë shpenzimet operacionale për shërbimin e transportimit të studentëve serbë të Kosovës, të cilët udhëtojnë nga Lipjani/Lipljan në qytetin e Gračanica/Graçanicës.

Në rajonin e Prizrenit, nuk është raportuar për asnjë incident të sigurisë, që do të kishte ndikim tek serbët e Kosovës, ndërmjet periudhës kohore korrik 2009 dhe qershor 2010, ndonëse prona private dhe vendet fetare vazhdojnë të jenë cak. Komuniteti përcepton, që plaçkitjet e vazhdueshme dhe zjarrvëniet në pronat e tyre janë rezultat i shërbimeve policore jo të duhura. Në tetor të vitit 2009, është vandalizuar varreza serbe, në fshatin Mushtishtë/Mušutište (Suharekë/Suva Reka) nga dy shqiptarë të Kosovës, të cilët, më vonë janë kapur. Kryetari i komunës, udhëheqësi shqiptar i Kosovës i fshatit dhe policia e kanë dënuar incidentin. Aktivitetet për kthim, të cilat janë duke u realizuar në fshat, nuk janë ndikuar shumë nga incidenti. Në nëntor dhe dhjetor të vitit 2009, dy shtëpive të banuara me serbë të Kosovës, në qytetin e Prizrenit, i është vënë zjarri nga persona të panjohur dhe nuk ka pasur asnjë ragim nga autoritetet komunale. Përsëri, në nëntor 2009, mbishkrimi “Kosova AKSH” (Armata Kombëtare Shqiptare) është spërkatur në murin e manastirit ortodoks serb në Zoqishtë/Zočište, në Rahovec/Orahovac. Vëllazëria lokale e kishës ortodokse serbe kanë ngritur brengat e tyre, duke pohuar që mbishkrimi kishte për synim aktin e kërcënimit. Në janar të vitit 2010, persona të panjohur kanë dëmtuar dyert dhe dritaret e qendrës shëndetësore, shkollës dhe shtëpisë së të kthyerit serb në fshatin Novakë/Novak (Prizren). Katër të rinj shqiptarë të Kosovës janë mbajtur në paraburgim lidhur me këtë rast, të cilët i janë qasur udhëheqësit serb të Kosovës të fshatit së bashku me prindërit e tyre për të kërkuar falje për incidentin. Në shkurt të vitit 2010, është dëmtuar shtëpia e një serbi në qytetin e Rahovecit/Orahovac. Në maj të vitit 2010, në qytetin e Prizrenit, janë vënë në zjarr dy shtëpi. Përkundër incidenteve të raportuara, liria e lëvizjes në rajonin e Prizrenit është e kënaqshme dhe serbët e Kosovës nga lugina e Župa/Zhupës dhe fshati Novakë/Novak e vizitojnë qytetin e Prizrenit në baza ditore. Megjithatë, serbët e Kosovës në komunën e Rahovecit/Orahovac kanë përceptime më të këqija të sigurisë se serbët e Kosovës në pjesët tjera. Ekzistojnë tri shërbime të transportit që lidhin vendbanimet serbe në rajon dhe jashtë tij, duke përfshirë Štrpce/Shtërpçën në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, Gračanica/Graçanicën në Prishtinë/Priština dhe pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica. Vetëm dy zyrtarë policorë serbë të Kosovës shërbejnë në stacionin policor të Rahovecit/Orahovac dhe janë të angazhuar në fshatin serb të Kosovës të Velika Hoča/Hoçës së Madhe. Asnjëri prej tyre nuk mban post të lartë policor në këtë stacion. Serbët nuk marrin pjesë në këshillin komunal për siguri në bashkësi të Prizrenit. Në Rahovec/Orahovac, ky këshill nuk funksionon dhe nuk është takuar që nga viti 2008. Komuniteti nuk merr pjesë më në komitetin lokal për siguri publike në Mushnikovë/Mušnikovo, i cili është shumë pasiv.



KONTEJNERË KU BANOJNË SERBËT E KOSOVËS E ZHVENDOSUR BRENDË VENDIT NË PADALIËTE/PADALISHTË NË KOMUNËN E THEMELUAR RISHTAS TË GRAÇANICA/GRAÇANICËS. SHUMICA E FAMILJEVE JANË TË CENUESHME DHE VAREN NGA ASISTENCA HUMANITARE E KOMISARIATIT PËR REFUGJATË TË SERBISË. SHUMË NGA TA PËRBALLEN ME VËSHTRËSI NË QASJE NË SHËRBIME PUBLIKE PËR SHKAK TË MUNGESËS SË DOKUMENTEVE. NË KËTË QENDËR KOLEKTIVE, 22 FAMILJE SERBE TË KOSOVËS (46 PERSONA) JETOJNË NË KONTEJNERË. TË GJITHË NGA TA KANË MBETUR PA SHTËPI APO KANË IKUR NGA TO GJATË TRAZIRAVE TË MARSIT TË VITIT 2004.

3. Kthimi dhe riintegrimi

Vlerësimet tregojnë që rreth 200,000 persona, pjesa dërmuese e të cilëve janë serb, janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre, kryesisht menjëherë pas konfliktit 1999.⁷ Sipas vlerësimeve të UNHCR-së, vetëm 8,656 serb janë kthyer vullnetarisht në shtëpitë e tyre të para konfliktit nga zhvendosja brenda dhe jashtë vendit, që nga viti 2000.⁸ Qasja e kufizuar në pronë, procedurat e vonuara të rikthimit të pronës, mungesa e mundësive ekonomike dhe ndjenja e përgjithshme e pasigurisë në mesin e të zhvendosurve, vazhdojnë të jenë pengesat kryesore për kthim të qëndrueshëm. UNHCR-ja më tutje raporton, që ndërmjet viteve 2008 dhe 2010, gjithsej 61 serb janë kthyer me forcë në Kosovë.⁹

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, UNHCR-ja raporton që janë të zhvendosur 1,175 serb.¹⁰ Një numër i madh i serbëve të Kosovës jetojnë të zhvendosur jashtë rajonit, duke qenë se janë larguar menjëherë pas konfliktit të vitit 1999. Tani, ka rënie të shkallës së largimit të komunitetit serb të Kosovës. Edhe sot e kësaj dite, shumë nga ta largohen çdo vit për shkak të pasigurisë ekonomike në Kosovë dhe perceptimeve të tyre për një të ardhme më të qëndrueshme jashtë Kosovës. Viteve të fundit, numri i kthyerve ka ndryshuar, nga 231 në vitin 2008, në 439 në vitin 2009 dhe 310 në pesë muajt e parë të vitit 2010¹¹ ku përfshihet kthimi në vendin e origjinës dhe në zonat e rajonit, ku jeton komuniteti serb i Kosovës. Për shembull, 22 familjeve serbe të zhvendosura nga fshati Klobukar/Kllobukar në komunën e Novo Brdo/Novobërdës, iu është rindërtuar shtëpia në lokacion të ri, afër vendit të mëparshëm. Projekti i kthimit të organizuar, që është financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe realizuar nga OJQ-ja Sveti Nikolla, ka shënuar kthimin e familjeve në korrik të vitit 2009. Si pjesë e projektit për kthim të realizuar nga UNDP-ja, nënët familje serbe janë kthyer në fshatin Softaj/Softović në komunën e Ferizajit/Uroševac, në prill të vitit 2010. Në të dy rastet, megjithatë, të kthyerit janë përballur me probleme, që rrezikojnë riintegrimin e tyre të qëndrueshëm. Në rastin e parë, të kthyerit ankoheshin për mangësitë në shtëpitë e ndërtuara, mungesën e ujit të pijshëm, ndaljen e rrymës, vonesat në lansimin e komponentës së gjenerimit të të ardhurave dhe mungesën

Sipas vlerësimeve të UNHCR-it, vetëm 8,656 serb janë kthyer vullnetarisht në shtëpitë e tyre para konfliktit, nga zhvendosja brenda dhe jashtë vendit që nga viti 2000.

7 Vlerësimet radhiten prej 65,000 (Nisma Evropiane për Stabilitet) deri në 230,000 persona të zhvendosur (Qeveria Serbe). UNHCR-ja shfrytëzon shifrat zyrtare të qeverisë dhe bën thirrje për azhurnim të regjistrimit të personave të zhvendosur shih <http://www.internal-displacement.org>. Sipas statistikave të UNHCR-it (prill 2010), vlerësohet që 10,297 serbë të Kosovës mbeten të zhvendosur brenda Kosovës.

8 Pasqyra statistikore e ZKM-së së UNHCR-it, Prishtinë/Priatina (Azhurnuar në fund të prillit 2010).

9 Po aty.

10 Po aty.

11 Pasqyra statistikore e ZKM-së së UNHCR-it (Azhurnuar në fund të majit 2010).

Të kthyerit në Klobukar/Kllobukar në komunën e Novo Brdo/Novobërdës nuk kanë siguri të zotërimit të pronës. Asnjëri prej përfituesve të projektit për kthim nuk ka nënshkruar kontratë me partnerin implemetues për të siguruar të drejtën e shfrytëzimit të shtëpive dhe tokës, në të cilën janë kthyer.

e sigurisë së zotërimit të pronës. Për shkak të mungesës së fondeve, komuna ka kërkuar mbështetje nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, në vitin 2009; megjithatë ka mbetur pezull. Për momentin, janë përafërsisht 15 të kthyer, që jetojnë në fshat, por mendojnë të largohen përsëri për shkak të kushteve joadekuate të jetesës. Në rastin e dytë, të kthyerit u larguan nga Softaj/Softoviç dhe u kthyen në vendin ku kishin qenë të zhvendosur, për shkak të mungesës së ujit në shtëpinë e re të sapo ndërtuar. Tani, përfaqësuesit e të kthyerve janë duke kërkuar zgjidhje për furnizim me ujë përmes kontakteve me komunën dhe organizatat ndërkombëtare.

Që nga mesi i vitit 2009 në komunën e Vitisë/Vitina, zyrtarët komunal për kthim kanë regjistruar 33 të kthyer në mënyrë spontane, të cilët janë kthyer kryesisht në fshatin Klokot/Kllokot, që tani është pjesë e komunës së Klokot/Kllokotit, e themeluar rishtazi. Ka pasur një rast të kthimit urban në qytetin e Vitisë/Vitina. Në komunën e Novo Brdo/Novobërdës, serbët janë kthyer në mënyrë spontane në vende të ndryshme të origjinës, kryesisht në fshatrat Izvor, Zebincë/Zebince, Bostane/Bostan, Klobukar/Kllobukar dhe Jasenovik. Për më tepër, në kuadër të Projektit për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë (KRK¹²) faza I, janë rindërtuar 13 shtëpi për familjet serbe në fshatrat Gornje Kusce/Kufcë e Epërme¹³, Pasjane/Pasjan dhe Parteš/Partesh. Faza e dytë në vazhdim e Projektit KRK I i ka për cak familjet serbe, që kanë prejardhjen prej fshatit Zhegër/Žegra, të cilët kanë kërkuar të kthehen nga vendet e zhvendosura. Kuvendi komunal i Gjilanit/Gnjilane ka miratuar ndarjen e tokës së komunës në fshatin Donja Budriga/Budrigë e Poshtme për rindërtimin e shtëpive për gjashtë familje nga ky grup. Dy kërkesa tjera për tokën komunale në fshatrat Donja Budriga/Budrigë e Poshtme dhe Pasjane/Pasjan nuk kanë marrë miratimin ende. Veç kësaj, tri shtëpi për familjet e zhvendosura nga Zhegra/Žegra do të rindërtohen në tokën që tanimë i përket përfituesve të fshatrave Gornje Kusce/Kufcë e Epërme, Parteš/Partesh, Pasjane/Pasjan. Për më tepër, nën kornizën e Projektit për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë (KRK) faza II, janë organizuar disa vizita shko dhe shiko në Ferizaj/Uroševac. E vetmja komunë në rajon, që nuk ka përjetuar zhvendosje të serbëve të Kosovës është Štrpce/Shtërpca. Megjithatë, një numër i madh i popullatës së personave të zhvendosur brenda vendit, prej të cilëve përafërsisht 800 janë serb dhe 14 serb të Kroacisë, janë ende të vendosur në katër qendra kolektive në komunë.

Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica vazhdon të strehojë pjesën dërmuese të personave të zhvendosur brenda Kosovës. Në të njëjtën kohë, një numër i madh i serbëve të Kosovës nga rajoni mbeten të zhvendosur jashtë Kosovës. Vetëm disa serb janë kthyer në vendet e origjinës, që nga botimi i profileve në vitin 2009, kryesisht në komunat e Vushtrrisë/Vučitrn dhe Skenderajit/Srbica. Në vitet 2009 dhe 2010, ka filluar zbatimin e projektit të financuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, në fshatrat e komunës së Vushtrrisë/Vučitrn, kryesisht në Dalak/Doljak dhe Shitaricë/Stitarica. Projekti përfshinte ndërtimin e 15 shtëpive, 13 për familje serbe dhe dy për familjet shqiptare në gjendje të vështirë sociale. Është ndërtuar gjithashtu sistemi i ujit dhe i kanalizimit. Dorëzimi i çelësave është bërë në maj të vitit 2010. Në vitin 2009, UNDP-ja ka financuar ndërtimin e katër shtëpive për familjet e kthyer në fshatrat serbe të Grace/Gracës dhe Priluzje/Prelluzhës, në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn. Janë organizuar disa vizita shko dhe

12 Projekti për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë i (KRKI) është nismë e përbashkët e financuar nga Komisioni Evropian në partneritet me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe UNDP-në, i cili ka për synim mbështetjen e kthimit të qëndrueshëm të refugjatëve dhe personave të zhvendosur përmes përfshirjes së shtuar të qeverisë dhe akterëve joqeveritarë në nivelin qendror dhe komunal. Projekti është duke u zbatuar në katër komuna: Istog/Istok, Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Pejë/Peć, dhe Gjilan/Gnjilane gjatë periudhës kohore prej 21 muajve.

13 Fshati është në komunën e Novo Brdo/Novobërdës. Rindërtimi ka filluar para zgjedhjeve të nëntorit 2009.

shiko në vitin 2009, në disa lokacione në Vushtrri/Vučitrn, por nuk janë realizuar aktivitete përcjellëse me serbët e Kosovës e zhvendosur nga Samodrezha/Samodreža dhe Pantina/Pantina në këtë komunë. Në komunën e Skenderajit/Srbica, UNDP-ja është duke rindërtuar një shtëpi në fshatin Banja/Bajë për një familje serbe, që është kthyer në vitin 2007. Mercy Corps gjithashtu ka siguruar makineri bujqësore për komunitetin serb të Kosovës në Banja/Bajë dhe Suvo Grlo/Syrganë. Zbatimi i projektit për kthim në fshatin Runik/Rudnik nuk është realizuar ende për shkak të mungesës së burimeve financiare, përkundër përkushtimit të fortë të të zhvendosurve për t'u kthyer. Në nëntor të vitit 2009, është organizuar vizita shko dhe informohu për personat e zhvendosur në Runik/Rudnik. Ata brengoseshin për mospranimin e informatave të mjaftueshme lidhur me statusin e projekt propozimit dhe përkushtimit të institucioneve relevante për ta mundësuar kthimin e tyre. Është organizuar vizita shko dhe shiko për 14 familje serbe në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica, më 6 tetor 2009. Në prill të vitit 2010, është organizuar një vizitë tjetër shko dhe shiko në fshatrat Stantërg/Stari Trg dhe Tunel i Parë/Prvi Tunel për nëntë serb, aktualisht të zhvendosur në qytetet e ndryshme në Serbi. Në pranverën e vitit 2009, mundësia e kthimit të shqiptarëve të Kosovës në Brdjani/Kroi i Vitakut ktheu pak vëmendjen në projektin e lënë pas dore të Svinjarës/Svinjare, ku që nga trazirat e marsit të vitit 2004 kur u zhvendos e tërë popullata e fshatit, ka vetëm një të kthyer serb. Kur filloi rindërtimi i Brdjani/Kroit të Vitakut, përfaqësuesit e serbëve të Kosovës insistuan që çdo kthim në pjesën veriore të jetë reciprok me pjesën jugore. Në qershor të vitit 2009, komuna e Mitrovicës/Mitrovica filloi financimin e linjës ditore të transportit ndërmjet Mali Zvečan/Zveçanit të Vogël dhe Svinjarës/Svinjare për t'ua mundësuar të zhvendosurve vizitat në pronat e tyre. Megjithatë, më 16 nëntor 2009, kompania e autobusëve pushoi së ofruari transportin, ku sipas raportimeve, kjo ka ndodhur për shkak që komuna nuk e ka paguar asnjëherë këtë shërbim. Përfundimisht është raportuar për disa serb të kthyer me forcë në rajon, për shembull në Priluzje/Prelluzhë, në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn. Komunitat mbeten të paafat që t'i ndihmojnë të kthyerit për shkak mungesës së burimeve.

Në rajonin e Pejës/Peć jetojnë 48 serb të zhvendosur brenda vendit. Numri i kthimeve në rajon është mjaft i madh, me aktivitete të kthimit, që zënë vend në shumicën e komunave. Në komunën e Istogut/Istok, sipas zyrtarit komunal për kthim, janë kthyer 92 familje serbe gjatë vitit 2009 dhe në gjysmën e parë të vitit 2010, me 18 familje serbe që janë kthyer vetë, në fshatin Sinajë/Sinaje. Tridhjetë familje nga një numër fshatrash në komunë janë mbështetur në kuadër të kornizës së programit të fundit për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë, që është realizuar nga UNDP-ja. Për më tepër, ka pasur kthime spontane vullnetare në fshatrat Dragolevc i Eperm/Gornji Dragolevac, Polanë/Poljane dhe Muzhevinë/Muževina. Disa të kthyerve në mënyrë spontane, iu është ofruar ndihmë nga UNHCR-ja dhe akterët tjerë. Në fshatin Zallq/Žac, 20 deri 30 kryefamiljarë serb janë kthyer spontanisht, në mars të vitit 2010 dhe aktualisht jetojnë në tenda të siguruara nga UNHCR-ja. Në fund të muajit maj në vitin 2010, sipas zyrtarit komunal për komunitete, komunës i janë parashtruar 117 kërkesa për ndihmë për t'u kthyer në fshatin Zallq/Žac. Rindërtimi i shtëpive në fshat, do të financohet nga Ministria për Kthim dhe Komunitete. Gjatë vitit 2010, ka pasur një numër incidentesh, duke përfshirë ngacmime dhe fyerje ndaj

Më shumë se dhjetë vite pas konfliktit, akoma nuk ka ndonjë zgjidhje afatgjatë dhe të dukshme për serbët e zhvendosur të Kosovës në qendrat kolektive në komunën e Štrpce/Shtërpçës. Deri më tani, të gjithë e kanë humbur shpresën për kthim të qëndrueshëm.

UNHCR- i vlerëson që janë 7,002 serbë të zhvendosur në komunitat e pjesës veriore të Mitrovicës/Mitrovica, Zubin Potokut, Leposavić/Leposaviq dhe Zvečan/Zveçanit prej vendeve tjera në Kosovë.¹

¹ Pasqyra statistikore e ZKM-së së UNHCR-it (Azhurnuar në fund të dhjetorit 2009).

Komuna e Klinës/Klina po bëhet njëra prej komunave më aktive në rajonin e Pejës/Peć në mbështetjen dhe lehtësimin e kthimit. Numri i të kthyerve është shtuar prej vitit në vit. Që nga viti 2005, ndërmjet 500-1,000 serbë nga 6,000 sa ishte numri i përgjithshëm i popullatës para konfliktit, janë kthyer në baza të përhershme ose të përkohshme.

Vendbanimet me numër më të madh të të kthyerve serbë janë qyteti i Klinës/Klina me rreth 100 familje, që pasohen nga Videja/Vidanje dhe Dresniku/Drnsnik, me më shumë se 60 të kthyer, duke përfshirë fëmijët që vijnë shkollimin.

tre të kthyerve nga komuniteti lokal shqiptar, ku përfshihen gjuajtje me gurë, të shtëna dhe sulme fizike. Komuniteti pranues supozon që, ka kriminel të luftës në mesin e të kthyerve.¹⁴ Në muajt e parë të vitit 2010, komuna e Klinës/Klina ka numëruar rreth 30 të kthyer të ri, kryesisht të përqendruar në Berkovë/Berkovo, një prej vendeve më të suksesshme të kthimit. Nga 60 familje që jetonin në Berkovë/Berkovo në vitin 1999, tanimë janë kthyer 33 kryefamiljarë. Për më tepër, janë rindërtuar 52 shtëpi në Dresnik/Drnsnik, 30 në Klinafç/Klinavac, 54 në Videjë/Vidanje, 28 në Grapç/Grabac, 44 në Binxhë/Biça dhe një numër më i vogël i shtëpive në fshatrat Dollc/Dolac, Grebnik/Grebnik, Leskoc/Leskovac, Petriq i Ultë/Donji Petrić, Pogragjë/Pograde dhe Stupel/Stupelj. Në fshatrat Dollc/Dolac, Grebnik/Grebnik në qytetin e Klinës/Klina, 12 familje, katër familje dhe një familje, respektivisht janë kthyer rishtazi, në kuadër të kornizës së Projektit për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë, që zbatohet nga Këshilli Danez për Refugjatë.

Në komunën e Pejës/Peć, përfaqësuesit e fshatrave serbe dhe personave të zhvendosur marrin pjesë rregullisht në grupet punuese komunale në takimet për çështjet e kthimit. Ata kanë paraqitur brengat për kontestet pronësore, procesin e përzgjedhjes së përfituesve për projektet e kthimit dhe hartimin e strategjisë komunale për kthim. Komuna e Pejës/Peć, është njëra prej katër komunave që ka përfituar nga Projekti për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë, faza I, e realizuar nga UNDP-ja. Lokacionet e kthimit përfshijnë Vitomiricën/Vitomirica, vendbanimin joformal të Llazoviqit/Lazović, Belo Polje/Bellopojës dhe qytetit të Pejës/Peć, si dhe fshatrat Nakëll/Naklo dhe Maja e Zezë/Crni Vrh. Vetëm një grua serbe jeton përherë në Deçan/Dečane, ndërsa katër të tjera vijnë kohë pas kohe dhe qëndrojnë për kohë të shkurtë në qytet. Kthimi i tyre më së shumti është penguar nga mungesa e qasjes në pronën e tyre, që është riuzyruar pas dëbimit të parë të ekzekutuar nga Agjencia Kosovare e Pronës. Në dy vitet e fundit janë realizuar disa vizita shko dhe shiko, për të kthyerit e mundshëm serb, që është mbështetur nga Këshilli Danez për Refugjatë dhe UNDP-ja. Në fund të vitit 2009, zyrtari komunal për kthim i Deçanit/Dečane ka udhëhequr vizitën shko dhe informohu në Mal të Zi, për të diskutuar çështjet lidhur me kthimin, me serbët e Kosovës dhe malazezët e Kosovës. Si rezultat, në vitin 2001, në zyrën komunale për kthim të Deçanit/Dečane janë dorëzuar 13 kërkesa të reja nga serbët e Kosovës, që aktualisht janë të zhvendosur në Mal të Zi. Gjithashtu janë realizuar edhe vizita shko dhe informohu nga komuna e Istogut/Istok në lokacione të ndryshme të Serbisë. Vizitat shko dhe shiko për personat e zhvendosur zënë vend rregullisht në komunat e Klinës/Klina dhe Istogut/Istok; një numër më i vogël i këtyre vizitave është organizuar në Pejë/Peć dhe Deçan/Dečane. Këto kryesisht janë organizuar nga Këshilli Danez për Refugjatë. Nuk është raportuar për ndonjë kthim me forcë në rajonin e Pejës/Peć, përveç për një familje në komunën e Pejës/Peć, e cila është kthyer me forcë nga Suedia. Familja jeton në Goraždevac/Gorazhdevc, ku është e strehuar në shtëpinë e të afërmeve. Deri më sot, nuk ka marrë asnjë ndihmë nga komuna.

Rreth 1,960 serb mbeten të zhvendosur në rajonin e Prishtinës/Priština, kryesisht të përqendruar në Gračanica/Graçanicë dhe fshatrat përreth, në pjesën jugore të Prishtinës/Priština.¹⁵ Dy qendra kolektive ofrojnë strehim për personat e zhvendosur në Gračanica/Graçanicë, të cilët në shumicën e rasteve jetojnë në kushte shumë të rënda. Pjesa

14 Për më shumë informata luteni të shihni seksionin për siguri të profilit të serbëve të Kosovës.

15 Po aty.

dërmuese e familjeve në këto qendra kolektive janë të cënueshën, dhe mbështeten në ndihmën e Sekretariatit Serb për Refugjatë. Shumica kanë vështirësi në qasjen në shërbime publike për shkak të mungesës së dokumenteve. Nuk ka pasur ndonjë ngritje të dukshme në numrin e të kthyerve gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ku ka pasur disa persona të zhvendosur, që janë kthyer në zonat e banuara me serb, në komunën e Prishtinës/Priština, Obiliqit/Obilić, Lipjanit/Lipljan dhe Fushë Kosovës/Kosovo Polje, në mënyrë spontane ose të organizuar. Për shembull, që nga qershori 2009, gjashtë familje janë regjistruar si të kthyer në mënyrë spontane dhe kanë marrë ndihmë në banim në Obiliq/Obilić; dy në Lipjan/Lipljan; dhe dy në Prishtinë/Priština. Ndërmjet qershorit 2009 dhe qershorit 2010, vizita shko dhe shiko, e ndihmuar nga Këshilli Danez për Refugjatë dhe UNHRC-i është realizuar në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, ndërsa pesë vizita shko dhe informohu nga Obiliq/Obilić në vende të ndryshme të Serbisë, janë ndihmuar nga organizatat e njëjta. Në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, gjatë vitit 2009, sipas Projektit për Kthim dhe Riintegrim në Kosovë I, i bashkëfinancuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Komisioni Evropian, një familje serbe u kthye në komunë dhe pesë të tjera janë duke pritur derisa t'u rindërtohen shtëpitë. Në vitin 2010, në kuadër të kornizës së projektit për kthim në fshatin Laplje Selo/Llapjeselle, në Gračanica/Graçanicë, Ministria për Komunitete dhe Kthim ia ka dorëzuar çelësat e banesave 33 familjeve serbe, duke përfshirë këtu 19 familje të zhvendosura jashtë Kosovës dhe 14 familje të zhvendosura në Kosovë. Priten edhe 27 familje të vendosen në bllokun e apartamenteve. Në komunën e Obiliqit/Obilić, dymbëdhjetë persona të zhvendosur të përkatësisë serbe janë përzgjedhur në kuadër të Projektit për Kthim dhe Riintegrim, faza II, i bashkëfinancuar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Komisioni Evropian, që realizohet nga Këshilli Danez për Refugjatë. Në komunat tjera të rajonit, siç janë Podujeva/Podujevo dhe Shtimja/Štimlje, procesi i kthimit nuk është duke ecur përpara, për shkak të një sërë faktorësh. Këtu përfshihen mungesa e dialogut ndëretnik ndërmjet komunitetit të zhvendosur dhe komunës, mungesa e vetëdijesimit publik për procesin e kthimit, mungesa e fondeve adekuate, mungesa e interesimit për kthim dhe përkushtimi i pamjaftueshëm i një pjese të zyrtarëve të lartë komunal ndaj procesit të kthimit.

Në rajonin e Prizrenit, pjesa dërmuese e të kthyerve serb ka qenë në komunat e Prizrenit dhe Rahovecit/Orahovac. Numri i të kthyerve serb është duke pësuar rënie, në vitin 2009 janë regjistruar vetëm 13 kthime. Deri më sot, vetëm dy të kthyer serb janë regjistruar në vitin 2010. Janë 112 serb të zhvendosur, të cilët jetojnë në rajonin e Prizrenit¹⁶, shumica e të cilëve janë të vendosur në pjesën e epërme të qytetit të Rahovecit/Orahovac. Shumica e personave të zhvendosur, më parë jetonin në pjesën e poshtme të qytetit dhe tani janë zhvendosur në pronat, që i përkasin familjarëve të afërm në pjesën e epërme, e cila ishte dhe akoma është e populluar kryesisht me serb. Megjithatë, janë disa raste ku njerëzit paguajnë qira ose janë të vendosur përkohësisht në shtëpitë e zbrazëta, që janë në pronësi të personave të cilët ende janë të zhvendosur jashtë Kosovës. Disa të zhvendosur serb janë vendosur gjithashtu me arranzhime private në luginën e Župa/Zhupës, në komunën e Prizrenit. Serbët e Kosovës përfaqësohen në tri grupe punuese komunale për kthim, kryesisht në Prizren, Suharekë/Suva Reka dhe Rahovec/Orahovac. Në vitin 2009, strategjitë komunale

Në qershor të vitit 2010, tri familje serbe u kthyen në mënyrë spontane në Prizren dhe kishin mundësi të kenë qasje në pronat e tyre pa ndonjë problem. Kjo shënon një hap pozitiv drejtë rivendosjes së karakterit shumetnik të këtij qyteti.

Rindërtimi i dhjetë shtëpive, që i përkasin serbëve të Kosovës të dëbuar nga lagjja historike "Potkaljaja/Nënkajaja" në qendër të qytetit të Prizren, gjatë trazirave të marsit 2004, do të fillojë para fundit të vitit 2010. Financimi do të bëhet nga Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe qeveria britanike.

16 Pasqyra statistikore e ZKM-së së UNHCR-it (Azhurnuar në fund të majit 2010).

për kthim janë miratuar dhe zbatuar në të gjitha komunat e rajonit të Prizrenit (përveç në Mamuşa/Mamushë/Mamuša), me pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës të zhvendosur në Prizren, Suharekë/Suva Reka dhe Rahovec/Orahovac. Komuniteti serb i Kosovës në Prizren nuk është prekur nga kthimi me forcë prej vendeve të treta.

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Mbetet të shihet se çfarë ndikimi do të ketë në themelimin e komunave të reja me shumicë serbe në rajonin e Gjilanit/Gnjilane dhe Prishtinës /Priština, masa dhe ndikimi i institucioneve të udhëhequra nga Serbia dhe shërbimet në këto zona.

Pas zhvillimeve politike të shkurtit 2008, komuniteti serb i Kosovës u tërhoq nga institucionet e Kosovës dhe jetës publike, duke ndryshuar trendin e nëntë viteve të mëparshme, gjatë të cilave serbët e Kosovës kishin filluar ngadalë të merrnin pjesë në institucionet e Kosovës. Institucionet e udhëhequra nga Serbia fituan edhe më shumë ndikim sa i përket qeverisjes lokale dhe ofrimit të shërbimeve.¹⁷ Në disa rajone, prania e institucioneve të udhëhequra nga Serbia është simbolike. Në rajonet tjera, ata ofrojnë shumicën e shërbimeve të qeverisjes lokale dhe shërbimeve të kërkuara nga komuniteti serb i Kosovës, duke përfshirë administratën, arsimin dhe shëndetësinë. Gjendja mbetet kryesisht e pandryshuar që nga viti 2009. Megjithatë, procesi i tanishëm i transferimit të kompetencave dhe themelimit të komunave të reja në zonat me shumicë serbe tanimë e ka zvogëluar ndikimin e tyre. Si përgjigje, qeveria e Serbisë ka filluar t'i binarizojë dhe rishtrukturojë institucionet dhe ofrimin e shërbimeve të veta në Kosovë.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti serb i Kosovës mbetet shumë i varur në shërbimet e ofruara nga institucionet që udhëhiqen nga Serbia. Administratat dhe kuvendet komunale që kanë dalë nga zgjedhjet lokale serbe të 11 majit 2008, janë funksionale në shumicën e komunave në rajon dhe janë të qasshme për të gjithë serbët e Kosovës në rajon. Një përjashtim është komuniteti i vogël i kthyer serb në komunën e Ferizajit/Uroševac, ku institucionet e udhëhequra nga Serbia nuk janë në dispozicion. Banorët atje duhet të udhëtojnë në komunën e Gračanica/Gračanicës dhe Štrpce/Shtërpçës për të pasur qasje në shërbime. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti serb i Kosovës mbështetet shumë në ndihmën sociale që vie nga Beogradi. Në rajonin e Prizrenit, janë themeluar institucione dhe shërbime të udhëhequra nga Serbia, por veprojnë në shkallë më të ultë për shkak të numrit të vogël të komunitetit serb të Kosovës. Ka një strukturë komunale, që udhëhiqet nga Serbia, e që vepron në qytetin e Štrpce/Shtërpçës. Strukturat legjislative dhe ekzekutive të udhëhequra nga Serbia si dhe shërbimet shëndetësore dhe arsimore ekzistojnë në komunën e Orahovac/Rahovecit. Kuvendi komunal i udhëhequr nga Serbia, në Orahovac/Rahovec mban takime të rregullta.

Në rajonin e Pejës/Peć, mbizotërimi dhe efikasiteti i institucioneve dhe shërbimeve të udhëhequra nga Serbia është rritur. Për komunat e Deçanit/Dečane dhe Gjakovës/Đakovica, shërbimet e tilla ndodhen jashtë komunave dhe/ose Kosovës. Megjithatë, ekzistojnë administratat lokale të udhëhequra nga Serbia me seli në Osojane/Osojan (që i shërben komunës së Istogut/Istok), dhe Klinë/Klina e Goraždevac/Gorazhdevc (që i shërben komunës së Pejës/Peć). Këto shërbime kanë pasur ndikim të madh në qëndrueshmërinë

17 Për vlerësim të hollësishëm të shërbimeve të ofruara nga institucionet e udhëhequra nga Serbia, luteni të shihni Qasjen në Seksionet e Shërbimeve, veçanërisht ato që mbulojnë shërbimet sociale (6), arsimore (8), shëndetësore (9) dhe të drejtësisë (10). Ju lutem referohuni raportit të OSBE-së 22 Strukturat paralele në Kosovë (2003), http://www.osce.org/documents/mik/2003/10/698_en.pdf dhe raportit 22 Strukturat paralele në Kosovë (2006-2007), http://www.osce.org/documents/mik/2007/04/23925_en.pdf.

e kthimit të serbëve të Kosovës në rajon dhe i ofrojnë shërbime pjesës dërmuese të serbëve të Kosovës që jetojnë atje. Në të tri fushat, institucionet e udhëhequra nga Serbia, janë punëdhënësit më të mëdhenjë gjithashtu. Në rajonin e Prishtinës/Priština, shumica e komunitetit serb të Kosovës gjithashtu varet nga institucionet e udhëhequra nga Serbia për ofrimin e shërbimeve, për mbështetjen financiare dhe për mundësitë e punësimit.

5. Qasja në shërbime komunale dhe publike

Në përgjithësi, janë shënuar disa përmirësime në mundësinë e serbëve të Kosovës për të pasur qasje në shërbimet e Kosovës në disa rajone, veçanërisht në ato ku janë themeluar komunat me shumicë serbe. Në rajonet tjera, duket të ketë pasur rënie të kësaj qasjeje. Në të gjitha rajonet, ofrimi i shërbimeve publike siç janë uji i pijshëm, grumbullimi i mbeturinave dhe kanalizimi në rastin më të mirë mbetet sporadik kurse në rastin më të keq nuk ekziston fare. Gjendja e furnizimit me rrymë ka shënuar përmirësim vitin e kaluar, ku të gjitha komunitetet serbe nëpër tërë Kosovën kanë nënshkruar marrëveshje kolektive me Korporatën Energjetike të Kosovës (KEK-un), për të bërë pagesa të rregullta si shkëmbim për ngrirjen e borxheve të ndërmarrjes. Kjo ndodhi gjatë dimrit, në fillim të vitit 2009, kur kishte ndërprerje të gjata të rrymës me javë të tëra, që ndikoi si në fshatrat shqiptare ashtu edhe ato serbe. Mirëpo, çështjet si lartësia e borxhit në fshatrat serbe dhe refuzimi i disa serbëve të Kosovës për t'i lejuar punëtorët e KEK-ut që ta lexojnë orën e rrymës, nënkupton që ky komunitet është prekur veçanërisht sa i përket kohëzgjatjes së ndërprerjeve të rrymës dhe gjetjes së zgjidhjeve të suksesshme për ta. Marrëdhëniet me KEK-un janë të përziera, ku ka raportime të serbëve të Kosovës, të cilët janë fyer verbalisht nga zyrtarët e KEK-ut në komunat e Gjilanit/Gnjilane dhe Pejës/Peć (shih pjesën 2 më lartë) ndërsa, në rastet e tjera, komuniteti raporton për ngritje të bashkëpunimit me këta zyrtarë.

Në Gjilan/Gnjilane, komuniteti serb i Kosovës ka qasje të papenguar në shërbimet komunale në të dy sistemet, në atë të udhëhequr nga Kosova dhe atë të udhëhequr nga Serbia. Megjithatë, shërbimet e ofruara nga autoritetet komunale nuk shfrytëzohen shpesh nga komuniteti serb i Kosovës. Situata në lidhje me rrymën është përmirësuar që nga viti 2009. Serbët e Kosovës përballen me shkyçje më të pakta, qëkur i kanë rregulluar pagesat ndaj KEK-ut. Megjithatë, në maj të vitit 2010, fshati i përzier i Livoçit të Epërm/Gornji Livoč në komunën e Gjilanit/Gnjilane ka vuajtur nga shkyçjet kolektive që zgjatnin për katër ditë për shkak të mospagesës së faturave, ndonëse shumica e komunitetit serb të Kosovës i kishte paguar rrymën. Në mënyrë të ngjashme, komuniteti shqiptar nuk i kishte paguar borxhet dhe rryma iu është kyçur vetëm atëherë kur ishin paguar të gjitha borxhet. Për më tepër, është arritur një zgjidhje e pjesërishtme për familjet serbe me probleme sociale dhe personat e zhvendosur, të cilët jetojnë në qendrat kolektive në komunat e Štrpce/Shtërpçës dhe Gjilanit/Gnjilane¹⁸ Ata kanë jetuar nën kërcënim të pandërprerë të shkyçjes për shkak të faturave të papaguara që nga marsi 2009. Në maj të vitit 2010, Ministria për Komunitete dhe Kthim përfundimisht

Serbët e Kosovës i qasen shërbimeve komunale dhe shërbimeve publike përmes kombinimit të institucioneve të udhëhequra nga Serbia dhe institucioneve të Kosovës. Zgjedhja e ofruesve të shërbimit bazohet në nevoja dhe pragmatizëm, veçanërisht në lidhje me afërsinë, disponueshmësinë dhe koston.

18 Për informata më të hollësishme për gjendjen në qendra mund të referoheni raportit të OSBE-së, Në kërkim të zgjidhjeve të qëndrueshme për të zhvendosurit në qendrat kolektive në komunën e Štrpce/Shtërpçës, mars 2010, http://www.osce.org/documents/mik/2010/04/43384_en.pdf.

Fushata e Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK-u) për mbledhje e borxheve përmes Shkycjeve kolektive, ka rënduar serbët e Kosovës, të cilët kishin refuzuar të paguajnë faturat e tyre, pjesërisht për arsye financiare, por gjithashtu edhe për arsye politike. KEK-u ofroi një zgjidhje me kompromis për ngrirjen e përkohshme të borxheve dhe rikycjen e atyre, të cilët nënshkruajnë marrëveshjen me përkushtimin për pagesën e faturave të tyre rregullisht.

Në Klinë/Klina, pompa elektrike e ndërmarrjes rajonale të ujit është shkyçur nga Korporata Energjetike e Kosovës në shkurt të vitit 2010, për shkak të borxheve të shumta. Kjo gjë i ka lënë pa ujë të pijshëm serbët e Kosovës dhe komunitetet tjera me muaj të tërë. Si zgjidhje të përkohshme, KFOR-i dhe kompania "gjetën mënyra alternative që të rimbushin rezervuarët e fshatit me ujë".

Në fshatrat BeloPolje/Bellopojë, Ljevoša/Levoshtë dhe Brestovik/Brestovik, në komunën e Pejës/Peć, të kthyerit serb kanë organizuar sistemin e tyre të grumbullimit të mbeturinave.

vendosi të mbulojë deri në 400 kilovat për muaj, për secilën familje që jetonte në qendra kolektive deri në fund të vitit 2010. Kjo shumë nuk do të jetë e mjaftueshme gjatë sezonës së dimrit për familjet që ngrohen me rrymë. Në disa fshatra ekzistojnë sistemet e ujit dhe kanalizimit. Në fshatrat tjera, fshatarët shfrytëzojnë ujin e puseve dhe gropat septike. Në vendet e kthimit në Softaj/Softovic dhe Pojate/Pojatishte, në komunën e Ferizajit/Uroševac, të gjitha komunitetet kanë vuajtur nga mungesa e ujit të pijshëm për katër muaj dhe sipas raportimeve, kjo ka ndodh për shkak të mospagesës së faturave të ujit. Shërbimet për grumbullimin e mbeturinave ekzistojnë në shumë zona, por shumë fshatra ende e ruajnë traditën e mënyrës së tyre "joforMeshkuj" të hedhjes së mbeturinave, që e ndotë ujin dhe mjedisin.

Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, qasja e serbëve të Kosovës në shfrytëzimin e shërbimeve komunale është shtuar. Për shembull, në zyrën komunale për komunitete në Priluzje/Prelluzhë gjendet edhe dega e zyrës komunale të Vushtrisë/Vučitrn për regjistrim civil. Kjo degë është rihapur në qershor të vitit 2009, si rezultat i numrit të shtuar të serbëve të Kosovës, të cilët aplikonin për dokumentet e Kosovës. Gjithashtu, për të iu adresuar problemeve drejtshkrimore në dokumente siç janë certifikatat e lindjes ose pasaportat, është angazhuar një referent nga zyra komunale për komunitete për të punuar në zyrën e regjistrimit civil në qytetin e Vushtrisë/Vučitrn. Të gjitha vendbanimet serbe në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica kanë nënshkruar marrëveshje me KEK-un në vitin 2009, duke përmirësuar kështu furnizimin me rrymë të komunitetit serb në rajon. Gjithashtu, është hapur një zyre degë e KEK-ut në Priluzje/Prelluzhë, e cila e ka përmirësuar qasjen atje. Qasja e tyre në shërbimet tjera mbetet e dobët. Grumbullimi i mbeturinave mbetet sfidë në pjesën dërmuese të zonave. Vetë banorët duhet të kujdesen për hedhjen e mbeturinave. Në Priluzje/Prelluzhë, në komunën e Vushtrisë/Vučitrn, mbeturinat grumbullohen nga një kompani nga Plementin/Plementina në komunën e Obiliqit/Obilić. Gjithashtu, në komunën e Vushtrisë/Vučitrn, në Grace/Gracë nuk funksionon sistemi i kanalizimit, ndërsa në Banja/Bajë ekzistojnë kontejnerët e mbeturinave, por ato zbrazen rrallë. Pagesa për furnizimin me ujë nuk është kryer në rastin e serbëve të Kosovës nga komuna e Vushtrisë/Vučitrn dhe Skenderajit/Srbica. Komuna e Vushtrisë/Vučitrn, në përgjithësi përballet me mungesë të ujit. Ndërprerjet e ujit kanë ndikim në pagesën dhe mospagesën e zonave dhe kjo gjë është e përbashkët në të katër vendbanimet. Në Skenderaj/Srbica, përkundër mospagesës, komuniteti ka qasje në ujë

Në rajonin e Pejës/Peć, gjendja ndryshon nga komuna në komunë. Në Deçan/Dečane dhe Istog/Istok, komuniteti serb i Kosovës, në përgjithësi ka qasje në shërbime komunale, por preferon t'i shfrytëzojë shërbimet e ofruara nga institucionet e udhëhequra nga Serbia. Në komunën e Klinës/Klina, rreth 200 serb kanë marrë letërnjoftimet e Kosovës, më tepër si nevojë se sa për arsye ideologjike. Serbët e Kosovës, gjithashtu shkojnë në qendrën për regjistrim civil për të marrë dokumente e tyre zyrtare, siç janë certifikatat e lindjes. Ka shumë ankesa, që dokumentet e tilla shpesh lëshohen me gabime drejtshkrimore. Në komunën e Pejës/Peć, për shkak të shtimit të numrit të serbëve për letërnjoftime, një ekip mobil i viziton individët nëpër shtëpi për t'i ndihmuar me procedurat e regjistrimit lidhur me lëshimin e letërnjoftimeve. Ky shërbim është në dispozicion të të gjithë

komuniteteve joshumicë në komunë, si dhe të personave me nevoja të veçanta. Gjendja e rrymës për serbët e Kosovës është përmirësuar që nga vitit i kaluar. Pagesat, tani i bëhen KEK-ut dhe si rezultat, ka furnizim me rrymë në përgjithësi. Në një rast, KEK-u ka shkyqur nga furnizimi me rrymë disa fshatra të banuara me serb për shkak të mospagesës. Gjithashtu, ka pasur ndërprerje të rrymës për shkak të gabimeve teknike të pajisjeve të KEK-ut. Shërbimet tjera siç janë kanalizimi, grumbullimi i mbeturinave dhe uji, nuk janë të rregullta. Për shembull, që nga shkurti 2010, disa fshatra të komunës së Klinës/Klina, duke përfshirë tri fshatrat e përziera të Videjës/Vidanje, Jagodës/Jagoda, dhe Deiqit/Deić kanë mbetur pa ujë. Arsyeja për Shkyqje është borxhi që kap përafërsisht shumën 30,000 euro, që ndërmarrja rajonale e furnizimit me ujë i ka borxh KEK-ut. Rastet tjera të ndërprerjes së shërbimeve janë për shkak të problemeve teknike lidhur me instalimet e vjetra dhe ndonjëherë dëmtimet e qëllimshme të sistemit të furnizimit me ujë të fshatrave të banuara me serb, nga persona të panjohur. Ndërmarrjet për mbledhjen e mbeturinave nuk i shërbejnë shumë zona rurale në rajon. Mbeturinat shpesh hidhen në sipërfaqe të hapura, ose fshatrat organizojnë sistemin e tyre të mbledhjes së mbeturinave. Gjithashtu, ka zona ku nuk ekziston qasja në sistemin kanalizimit.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, qasja në shërbime komunale dhe shërbime publike për komunitetin serb të Kosovës duket të jetë përkeqësuar nga botimi i profileve në vitin 2009. Vetëm disa pjesëtarë të komunitetit serb kanë qasje në shërbime komunale përmes zyrave komunale për kthim. Furnizimi me rrymë vazhdon të jetë problematik për shumicën e serbëve të Kosovës më të cënueshëm në rajon, siç janë ata të vendosur në vendbanimet në baraka të “Voçar/Voçarit” dhe “Padalište/Padallishtës” në Gračanica/Graçanicë. Përkundër nënshkrimit të marrëveshjes për pagesë me Korporatën Energjetike të Kosovës, në qershor të vitit 2009, Shkyqjet kolektive kanë vazhduar. Pas njoftimit më të fundit për Shkyqjet e KEK-ut, në prill të vitit 2010, u bë një intervenim nga Ministria për Komunitete dhe Kthim, gjë që siguroi vazhdimin e shërbimit. Serbët e Kosovës kanë qasje në të gjitha shërbimet komunale, si dhe në shërbime publike, përkundër mosdashjes ndonjëherë nga ana e tyre, që të angazhohen në institucionet e Kosovës. Pas shkyqjes së objekteve ortodokse serbe në rajon, në shtator 2009, një marrëveshje ndërmjet kishës ortodokse serbe dhe KEK-ut, në janar 2010 shpiu në rikyçjen e kishës së “Shën Gjergjit” dhe manastirit të “Shën Arkangjelit” në Prizren dhe manastirit të “Shëruesve të shenjtë” në komunën e Rahovecit/Orahovac.

Për serbët e Kosovës në Goraždevac/Gorazhdec, në komunën e Pejës/Peć, institucionet e udhëhequra nga Serbia u sigurojnë banorëve shërbimin e grumbullimit të mbeturinave.

Të kthyerit serb gjithashtu përballen me mospasjen e ujit të pijshëm në Laplje Selo/Lapllasellë në Gračanica/Graçanicë për shkak të mungesës e pompave të ujit.

6. Qasja në shërbime dhe mirëqenie sociale

Serbët e Kosovës, në përgjithësi kanë qasje në shërbime sociale, të ofruara si nga institucionet e Kosovës, ashtu edhe të Serbisë. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, përjashtim bënë komuna e Ferizajit/Uroševac, ku serbët e Kosovës nuk kanë të drejtë në asistencë sociale të ofruar nga Kosova. Megjithatë, të moshuarit në kuadër të këtij grupi, marrin pensione nga Kosova. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti mbështetet në institucionet udhëhequra nga Serbia për ofrimin e shërbimeve sociale, siç janë ndihmat sociale për

SHPËRNDARJA E USHQIMIT NGA INSTITUCIONET E SERBISË PËR SERBËT E KOSOVËS NË HOÇË TË MADHE/VELIKA HOÇA TË KOMUNËS SË RAHOVECIT/ ORAHOVAC (NË RAJONIN E PRIZRENIT).



të papunët, përfitimet familjare dhe pensionet. Shumë serb në rajon, gjithashtu marrin paga miniMeshkuj, si punëtorë të mëparshëm të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore. Në rajonin e Pejës/Peć, ka pasur një ngritje të lehtë në numrin e serbëve të Kosovës për shfrytëzimin e shërbimeve sociale të Kosovës. Për shembull, katër të kthyer të moshuar, të cilët jetojnë në komunën e Gjakovës/Đakovica, tani janë në skemën pensionale të Kosovës. Në Istog/Istok, serbët e Kosovës marrin ndihma sociale si nga qendra për punë sociale e Kosovës, ashtu edhe nga institucionet e udhëhequra nga Serbia. Ndërsa, në Klinë/Klina, me përjashtim të disa të moshuarve serb, të cilët marrin pensione nga Kosova, pjesa dërmuese e tyre marrin ndihmë sociale, që vie nga institucionet e udhëhequra nga Serbia. Situatë e ngjashme është edhe në komunën e Pejës/Peć, ndonëse themelimi i nënzyrës komunale për komunitete në Gorazdevac/Gorazhdec, në vitin 2008 ka përmirësuar qasjen e komunitetit në shërbimet sociale të Kosovës. Në rajonin e Prishtinës/Priština, shumica e komunitetit serb mbështetet në shërbimet e siguruar nga institucionet e udhëhequra nga Serbia, ndonëse një numër i vogël i personave të moshuar marrin pensione të Kosovës gjithashtu. Në fund, në rajonin e Prizrenit, serbët e Kosovës mund të kenë qasje në shërbime sociale. Vetëm një numër i vogël i tyre marrin ndihmë sociale nga institucionet e Kosovës.

7. Qasja në pronë dhe banim

Uzurpimi i shtëpive, bizneseve dhe tokave të punueshme serbe vazhdon të pengojë kthimin e shumë personave të zhvendosur. Uzurpuesit shpeshherë dhe pandërprerë uzurpojnë pronat pas lëshimit dhe zbatimit të urdhërit për lirim të pronës. Policia e Kosovës duket e pafuqishme të ndalojë këtë gjë.

Qasja në pronë dhe banim për serbët e Kosovës vazhdon të pengohet nga uzurpimi i shtëpive, bizneseve dhe tokave të punueshme të tyre. Kjo vazhdon ta pengojë kthimin e mijëra të zhvendosurve serb. Më shumë se dhjetë vite, pas konfliktit të vitit 1999, pronat e serbëve të Kosovës kanë mbetur e uzurpuara, shpeshherë të riuzurpuara vazhdimisht pas zbatimit të urdhëresave për lirim, sipas vendimeve të Drejtorisë së OKB-së për Pronë dhe Banim (HPD) ose Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP). Policia i zbaton urdhërat për lirim, por për shkak se pronat mbeten të zbrazëta dhe të pambrojtura, me titullarin ligjor ende të zhvendosur, uzurpatorët e mëparshëm hyjnë përsëri në këto prona. Brenga tjera lidhur me qasjen në pronë, janë nevoja për rindërtim dhe mungesa e qasjes për shkak të brengave të sigurisë. Toka e punueshme shpesh është e uzurpuar ose shfrytëzohet nga komuniteti shumicë shqiptar,



RRUGA “DIMITRIJE TUCOVIĆ” NË LAGJEN POTKALAJA/NËNKALAJA TË QYTETIT TË PRIZRENIT, ZONË DIKUR E BEGATSHME E SERBËVE TË KOSOVËS KU KOMUNITETI JETONTE TRADICIONALISHT. SHUMICA E SERBËVE TË KOSOVËS IKËN PAS PËRFUNDIMIT TË KONFLIKTIT TË VITIT 1999, KURSE ATA QË MBETËN I BRAKTISËN PRONAT E TYRE GJATË TRAZIRAVE TË MARSIT TË VITIT 2004. PAS INCIDENTEVE TË PLAÇKITJES, ZJARRVËNIES DHE MOSKUDJESIT ME VITE, SHUMË NGA KËTO PRONA VAZHDOJNË TË JENË SHUMË TË DËMTUARA OSE PLOTËSISHT TË SHKATËRRUARA.

ashtu si edhe edhe prerja e paligjshme e drunjëve në zonat pyjore. Shumë persona të zhvendosur kanë dorëzuar rastet e tyre në AKP, por nuk janë në gjendje të shënojnë përparim në këtë drejtim për shkak të vendndodhjes së zhvendosjes së tyre. Agjencia nuk mund të realizojë vizita tek të zhvendosurit që janë jashtë Kosovës, meqë kjo agjenci nuk njihet nga Republika e Serbisë. Këta faktorë kanë rezultuar me kontakt të zvogëluar ndërmjet Agjencisë dhe parashtruesve të ankesës, duke penguar rëndë mundësitë e zgjidhjes së suksesshme të këtyre rasteve.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuna e Štrpce/Shtërpçës paraqet përjashtim nga problemet e përgjithshme, me të cilat përballen serbët e Kosovës lidhur me çështjet e pronës dhe banimit. Në këtë komunë, ka relativisht pak probleme lidhur me qasjen në pronë dhe tokë, meqë serbët e Kosovës gjithmonë kanë qenë popullatë shumicë në këtë zonë. Megjithatë, në zonat tjera të rajonit, qasja në tokën dhe pyjet në pronësi private mbetet problem i madh për serbët e Kosovës. Gjendja e tillë paraqet pengesë serioze për kthim të qëndrueshëm dhe riintegrim, veçanërisht duke i pasur parasysh vonesat në sistemin ligjor, nëse individët vendosin të ndjekin veprime ligjore. Trendi i shitjes së pronave të serbëve të Kosovës vazhdon ende në tërë rajonin. Në komunën e Ferizajit/Uroševac, vlerësimet e nxjerra nga transaksionet pronësore, nga gjykata komunale tregojnë, që deri në fund të vitit 2007, pothuajse gjysma e serbëve të Kosovës që kanë jetuar në qytetin e Ferizajit/Uroševac kanë shitur shtëpitë e tyre “formalisht”. Shifrat nuk i pasqyrojnë në mënyrë të mirëfilltë kontratat joforMeshkuj të shitblerjes, të cilat njihen si të zakonshme. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, situata mbetet kryesisht e pandryshuar. Serbët e Kosovës nuk kanë gjithnjë qasje në pronat e tyre ngase janë të uzurpuara, edhe pse në disa raste pronarët kanë bërë marrëveshje që të japin me qira pronën e tyre të uzurpuar përmes skemës së Agjencisë Kosovare të Pronës¹⁹. Për shkak të uzurpimit dhe frikës së sigurisë, shumë serb të cilët kanë mbetur në komunë, nuk i punojnë tokat e tyre. Për shembull, në fshatin Gojbulja/Gojbulë, në komunën e Vushtrrisë/Vucitrn, ka pasur raste ku kafshët e shqiptarëve të Kosovës, nga fshatrat fqinje kanë bërë kalim të paligjshëm në tokën e tyre. Por ky është problem më i vogël për serbët e Kosovës e dy fshatarve në komunën e Skenderajit/Srbica, meqë toka e tyre gjendet kryesisht në afërsi të fshatit.

OSBE-ja vazhdon ta ngrisë vetëdijen për mandatin e Agjencisë Kosovare të Pronës. Projekti i tyre aktual, “Të drejtat banesore dhe pronësore për të gjithë” që përfshinë vizita informimi të komuniteteve të ndikuar nga uzurpimi i uzurpatorëve të pronave në tërë Kosovën.

19 Ndër detyrat tjera, Agjencia Kosovare e Pronës ka mandat, që të mbikëqyrë qiradhënien e pronave të braktisura në Kosovë. Lidhur me këtë, Agjencia menaxhon skemën e qiradhënies për pronat, të cilat janë nën administrimin e saj. Kjo skemë ia mundëson titullarëve të pronës të marrin të ardhura të caktuara nga prona, duke e autorizuar AKP-në për qiradhënie derisa ai/ajo ta shfrytëzojë pronën në ndonjë mënyrë tjetër.

Aktivitetet e dialogut të kohës së fundit, të kryera nga OSBE-ja ndërmjet komunitetit pranues dhe të kthyerve të mundshëm serb në qytetin e Ferizajit/Uroševac ka treguar që pothuajse të gjithë të involvuarit kanë marrëveshje joforMeshkuj të shitjes me fqinjët e tyre të mëparshëm.

Në rajonin e Pejës/Peć, janë raportuar shumë raste me kërkesa pronësore të falsifikuara, përmes së cilave shqiptarët e Kosovës kanë falsifikuar shitblerjen e pronës së uzurpuar serbe. Pjesa dërmuese e transaksioneve të falsifikuara janë bërë duke përdorur kompetenca të rrjeshe të avokatit dhe dokumente të falsifikuara, të cilat janë vërtetuar në gjykatat e Malit të zi.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ka njoftuar, që përfundimi i kurrikulës në gjuhën serbe në kuadër të sistemit arsimor të Kosovës, do të jetë gati deri në shtator të vitit 2010.

20 Udhëzimi Administrativ nr. 35/2009 i Ministrisë për Arsimit, Shkencë dhe Teknologji.

Një çështje, që duket veçanërisht e përhapur në rajonin e Pejës/Peć, është ajo e kërkesave të falsifikuara të pronës, përmes së cilave shqiptarët e Kosovës kanë përdorur dokumente të falsifikuara të pronës, në mënyrë që të realizojnë shitblerje të pronave, për pronat që nuk i përkasin atyre. Shumica e transaksioneve të falsifikuara janë bërë duke shfrytëzuar autorizime të rrejshme të avokatit dhe dokumente të falsifikuara, të cilat janë vërtetuar në gjykatat e Malit të Zi. Në vitin 2010, vetëm në komunën e Klinës/Klina kanë mbetur 18 raste të pazgjidhura të transaksioneve të rrejshme pronësore. Janë zgjidhur disa raste, zgjidhja e të cilave ka marr shumë kohë. Për shembull, në vitin 2010 një serb në qytetin e Klinës/Klina ka arritur për ta rivënë të drejtën pronësore pas transaksionit pronësorë të falsifikuar, që kishte ndodhur në vitin 2002. Veç kësaj, në komunën e Pejës/Peć, rastet e transaksioneve pronësore të falsifikuara të inicuar nga personat e zhvendosur janë ende në pritje të gjykimit nga gjykata komunale. Ngjashëm me rajonet tjera, brenga kryesore lidhur me çështjet pronësore dhe banesore për serbët e Kosovës në Pejë/Peć, është qasja. Problemet përfshijnë uzurpimin e shtëpive, banesave dhe tokës bujqësore si dhe riuuzurpimin pas dëbimit. Rastet pronësore zakonisht raportohen në polici nga serbët e Kosovës, gjatë vizitës së tyre në Deçan/Dečane. Ndonëse, policia lokale fillimisht ngurronte në zbatimin e vendimeve të AKP-së për dëbim të uzurpuesve, kurse tani dëshmitë sugjerojnë që ata tani janë më të vetëdijesuar për këtë problem dhe ka më shumë gjasa t'i ndihmojnë serbët e Kosovës, të cilët bëjnë kërkesë për dëbim. Megjithatë, në komunën e Klinës/Klina, policia nuk është duke i kryer ri-dëbimet në shumicën e rasteve.

Në Prishtinë/Priština, brengat lidhur me pronën dhe banimin janë të ngjashme si çdokund tjetër. Problemi kryesor mbetet ende qasja e personave të zhvendosur në pronat e tyre, të cilat në shumicën e rasteve janë të uzupuara. Përndryshe, shtëpitë e tyre janë shkatërruar dhe akoma nuk janë rindërtuar. Ka shumë raste, ku pronat e serbëve të Kosovës të zhvendosur janë uzurpuar nga komunitetet tjera, veçanërisht në zonat urbane dhe në situata të tilla, procesi i dëbimit është problematik, sikur edhe në rajonet tjera. Në rajonin e Prizrenit, gjendja është pothuajse e njëjtë, qasja në pronë pengohet nga frika për siguri, uzurpimi dhe mos realizimi i dëbimeve. Shitblerjet ndëretnike të pronave në vazhdimësi, të cilat shpeshherë kryhen jozyrtarisht dhe nuk regjistrohen ligjërisht, mbeten brengë për komunitetin. Kjo mungesë e regjistrimit mund të jetë edhe për shkak të numrit të ultë (ndonëse është vërejtur një ngritje kohëve të fundit) të serbëve të Kosovës, të cilët posedojnë letërnjoftime të Kosovës, gjë që ia pamundëson regjistrimin e shitëblerjeve pronësore në mënyrë të ligjshme.

8. Qasja në arsim

Fëmijët dhe të rinjtë serb vazhdojnë të vijnë arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë përmes shërbimeve arsimore të financuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë. Ky mbetet i vetmi opsion për nxënësit dhe studentët e këtij komuniteti, ngase nuk është miratuar ende asnjë planprogram kosovar në gjuhën serbe nga qeveria e Kosovës. Komisioni i Pavarur për Shqyrtimin e Materialeve të Mësimdhënies në Gjuhën Serbe²⁰ (Komisioni) është themeluar në nëntor të vitit 2009 nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë me synim

të zhvillimit të kurrikulumit në gjuhën serbe deri në shtator të vitit 2010. Komisioni përbëhet prej shtatë anëtarëve: tre të emëruar nga Ministria, tre deputetë të Kuvendit të Kosovës, që mbajnë ulëse rezervë për komunitetin serb të Kosovës dhe një nga Zyra Ndërkombëtar Civile. Ndonëse, Komisioni fillimisht kishte për detyrë të zhvillojë një planprogram në gjuhën serbe, mandati i tij është kufizuar më vonë²¹ në shqyrtimin e planprogramit të Republikës së Serbisë dhe teksteve shkollore që aktualisht përdoren në shkollat kosovare të udhëhequra nga Serbia, për të identifikuar fushat që nuk janë në pajtim me kornizën ligjore të Kosovës dhe për të bërë rekomandime se si të modifikohen këto fusha për përdorim në Kosovë. Komisioni ka publikuar rekomandimet e tij, më 24 qershor 2010, pas të cilës datë ka pushur së funksionuari. Megjithatë, pjesëmarrja e komunitetit në sistemin arsimor të Kosovës nuk varet vetëm nga siguri i planprogrameve dhe teksteve shkollore në të ardhmen (duke përfshirë tekstet e importuara nga Serbia) në gjuhën serbe nga autoritetet e Kosovës, por gjithashtu edhe nga njohja e diplomave të Kosovës nga Republika e Serbisë. Cilësia e dhënies së mësimit është shkak për brengosje në rradhët e komunitetit, meqë profesionalizmi i mësimdhënësve dhe efektiviteti i metodave të tyre të mësimdhënies vihen shpeshherë në pyetje. Veç kësaj, prindërit janë të preokupuar që mjedisi mësimor i “mbyllur” i shkollave të fshatit ka ndikim negativ në procesin e mësimnxënies së fëmijëve të tyre. Vajzat vijonë arsimin e detyrueshëm rregullisht dhe nuk dihet për rastet e braktisjes së shkollës. Gjithsesi, edhe disponueshmëria e teksteve shkollore është një brengë tjetër dhe në përgjithësi duhet të blihen nga prindërit, me mbështetje të kohëpaskohshme të Ministrisë së Arsimit të Serbisë ose subjekteve tjera, siç është KFOR-i. Serbët e Kosovës duhet të udhëtojnë gjatë për në zonat me shumicë serbe për arsim të lartë në gjuhën serbe, meqë është në dispozicion vetëm në universitetin në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica ose në qytetet tjera në Serbi. Kjo i ndalon shumë serb, që ta vijojnë shkollimin pas shkollës së mesme.

Komuniteti serb i Kosovës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane ka qasje në arsimin brenda sistemit të financuar nga Serbia që ofron transportim për fëmijët dhe hapësira relativisht të mira shkollore. Në fshatrat e Cernica/Cernicës (Komuna e Gjilanit/Gnjilane), dhe Parteš/Parteshit, Donja Budriga/Budrikë e Poshtme, Pasjane/Pasjan (komuna e sapo-



Drejtori i Zyrës komunale të komuniteteve në Vushtri/Vučitrn, në Priluzje/Prelluzhë, ka shënuar numrin më të lartë, si dhe përkushtimin e vajzave serbe që të ndjekin arsimin terciar.

NXËNËSIT SERBË TË KOSOVËS DHE MËSIMDHËNËSI I TYRE NË SHKOLLËN FILLORE QË PUNON SIPAS KURRIKULËS SË SERBISË NË BANJE/BAJË TË KOMUNËS SË SKENDERAJT/SRBICA (NË RAJONIN E MITROVICËS).

21 Udhëzimi Administrativ nr. 37/2009 i Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji.

Në shtator të vitit 2009, kryetari i Fushë Kosovës/Kosovo Polje vendosi të hapë ndërrimin e mëngjesit në shkollën "Sveti Sava" në Fushë Kosovë/Kosovo Polje, edhe për nxënësit shqiptarë. Ndërrimi i mëngjesit më herët vijohej vetëm nga nxënësit serb, sipas një vendimi administrativ të UNMIK-ut që ishte marrë më 2005. sipas pohimeve, si rezultat i kësaj, prindërit e disa nxënësve serb vendosën të regjistrojnë fëmijët e tyre në shkollën e fshatit Ugljare/Uglar (komuna e Gračanica/Gračanicës).

themeluar e Parteš/Parteshit) një mini-bus që transporton nxënësit serb aktualisht funksionon nën departamentin e arsimit në komunën e Gjilanit/Gnjilane përmes zyrës komunale të komuniteteve. Në komunat tjera, nxënësit serb shfrytëzojnë transportin e siguruar nga Ministria serbe e arsimit. Studentët e universitetit udhëtojnë qoftë drejt pjesës veriore të Mitrovicës/Mitrovica, gjithashtu me transport të autobusit humanitar, ose ndjekin arsimin terciar jashtë Kosovës. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, arsimi parashkollor ofrohet vetëm në Banja/Bajë, në Skenderaj/Srbica, derisa dy dhe tri shkolla fillore ekzistojnë në vendbanimet serbe në komunën e Skenderajt/Srbica, respektivisht Vushtrrisë/Vučitrn. Fshati i përzier i Banjska/Banjskës nuk ka hapësira të shkollës fillore, ndërsa fëmijët udhëtojnë drejt shkollës në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Shkolla e mesme është e vendosur në Priluzje/Prelluzhë, fshati i dytë më i madh serb në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn. Gjithashtu që vijohej edhe nga studentët e Grace/Gracës, në të njëjtën komunë. Të rinjtë nga Gojbulja/Gojbula (komuna Vushtrri/Vučitrn) vijnë në shkollën e mesme në veri të Mitrovicës/Mitrovica për shkak të afërsisë. Suvo Grlo/Syrigana, në Skenderaj/Srbica, ka gjithashtu shkollë të mesme, në dispozicion për të rinjtë nga fshati si dhe nga Banja/Baja, gjithashtu në Vushtrri/Vučitrn. Arsimi terciar ofrohet në veri të Mitrovicës/Mitrovica si dhe në Leposavić/Leposaviq. Mjetet e transportit janë të kufizuara për fëmijët që duhet të udhëtojnë drejt zonave me shumicë serbe për të vijuar studimet. Për shembull, në shkurt të vitit 2010, komuna e Vushtrrisë/Vučitrn ndërpreu mbështetjen financiare për transportimin e nxënësve nga Gojbulja/Gojbula dhe Banjska/Banjska drejt veriut të Mitrovicës/Mitrovica. Ministria për Komunitete dhe Kthim intervenoi duke ofruar fondet deri në fund të vitit aktual shkollor në qershor të vitit 2010.

Në rajonin e Pejës/Peć, nuk ka fëmijë të moshës shkollare tek serbët e Kosovës në komunat e Gjakovës/Đakovica dhe Deçanit/Dečane. Në komunën e Istogut/Istok, shkollat fillore ekzistojnë në Osojane/Osojan dhe Cerkozë/Crkolez. Përveç këtyre, ekzistojnë dy shkolla fillore të udhëhequra nga Serbia në komunën e Klinës/Klina (Videjë/Vidanje dhe Bića/Binxhë). Në Komunën e Pejës/Peć, shkollat fillore funksionojnë në fshatrat Goraždevac/Gorazhdec dhe Sigë/Siga (shkolla të përziera me ndërrime të kundërta). Në Goraždevac/Gorazhdec, serbët e Kosovës kanë qasje në shkollën fillore që gjendet në qendër të fshatit. Një shkollë tjetër fillore është e vendosur mes fshatrave të Brestovikut dhe Sigës/Siga. Shkollat e mesme vijohen në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica dhe jashtë Kosovës. Në rajonin e Prishtinës/Priština, është shënuar një zvogëlim i numrit të fëmijëve që vijnë në shkollat fillore dhe të mesme, në zonat ku numri i komunitetit është i vogël, si në komunën e Lipjanit/Lipljan, për shkak të mungesës së lokaleve adekuate dhe mësimdhënësve. Ekzistojnë 19 objekte të shkollimit fillor dhe 15 të shkollimit të mesëm që ofrojnë arsim me planprogram të Serbisë për komunitetin në rajon, me transportim që ofrohet ose nga autoritetet e Kosovës ose nga institucionet e financuara nga Serbia. Numri i serbëve të Kosovës në rajonin e Prishtinës/Priština që ndjekin studimet universitare është i ulët, pasi që distancat e mëdha të udhëtimit janë vërtetuar të jenë të patejkalueshme, për arsye financiare dhe për shkak të brengave në lidhje me lirinë e lëvizjes. Një zyrë e vogël e Ministrisë Serbe për Kosovën dhe Metohinë në Gračanica/Gračanicë merret me çështjet e arsimit, derisa koordinatori rajonal i arsimit nga ministria serbe është

i vendosur në Mitrovicë/Mitrovica. Në rajonin e Prizrenit, arsimi fillor dhe i mesëm në gjuhën serbe ofrohet vetëm në Rahovecin/Orahovac e epërm dhe Velika Hoča/Hoçë të Madhe, përmes institucioneve të Serbisë. Janë 11 fëmijë në Velika Hoča/Hoçë të Madhe dhe nëntë në Rahovecin/Orahovac e epërm të regjistruar në arsimin parashkollor. Pesëdhjetë e tre fëmijë (prej të cilëve tre janë nga komuniteti romë) vijojnë arsimin fillor në Velika Hoča/Hoçë të Madhe, derisa 45 fëmijë (prej të cilëve pesë nga komuniteti romë) shkojnë në shkollë fillore në Rahovecin/Orahovac e epërm. Nga nxënësit e shkollës fillore dhe të mesme në Rahovecin/Orahovac e epërm, 25 janë femra. Nuk ka të dhëna krahasuese të ndara për gjini në Velika Hoča/Hoçë të Madhe. Vetëm nëntë nxënës vijojnë arsimin e mesëm në Rahovecin/Orahovac e epërm. Studentët serb nga Rahoveci/Orahovac zakonisht regjistrohen në fakultete në veri të Mitrovicës/Mitrovica ose jashtë Kosovës.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Serbët e Kosovës gati ekskluzivisht shfrytëzojnë shërbimet mjekësore të ofruara nga institucionet e Serbisë, të cilat ofrohen pa pagesë për ata që kanë librezë shëndetësore të Serbisë. Për raste urgjente dhe të rënda, pacientët transferohen kryesisht në spitale të Serbisë në veri të Mitrovicës/Mitrovica apo Gračanica/Graçanicë, apo në spitale tjera në Vranje apo Beograd, për shembull. Megjithatë, në rajonet e Pejës/Peć dhe Prizrenit, faktorët si numri i vogël i komunitetit dhe integrimi më i mirë kanë mundësuar shfrytëzimin e jashtëzakonshëm të institucioneve të Kosovës nga komuniteti. Brenda komunitetit serb të Kosovës, gratë janë më të prekura nga mungesa e strukturave të dedikuara për kujdesin riprodhues dhe shëndetin e gruas. Ata zakonisht kërkojnë shërbime në institucione mjekësore në veri të Mitrovicës/Mitrovica apo diku tjetër në Serbi për kontrollime mjekësore, kujdes riprodhues dhe lindje fëmijësh.

Në Gjilan/Gnjilane, qasja në kujdesin shëndetësor nga serbët e Kosovës është e kënaqshme dhe sigurohet gati ekskluzivisht përmes institucioneve të Serbisë. Kujdesi primar shëndetësor është në dispozicion në fshatrat/qendrat lokale. Për shembull, në Ferizaj/Uroševac, një ekip mobil nga Gušterica/Gushterica (komuna e Lipjanit/Lipljane) apo Čaglavica/Çagllavica (komuna e Prishtinës/Priština) viziton serbët e Kosovës një herë në javë. Ka disa shërbime shëndetësore sekondare në dispozicion në qendrën kryesore shëndetësore në Štrpce/Shtërpçë. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti serb i Kosovës në Vushtrri/Vučitrn dhe Skenderaj/Srbica varen vetëm nga kujdesi shëndetësor që ofrohet nga institucionet e Serbisë. Ekziston një klinikë që ofron kujdes shëndetësor primar në secilin fshat të banuar me serb, derisa rastet më serioze referohen në spitale në veri të Mitrovicës/Mitrovica apo Gračanica/Graçanicës. Në fshatin Priluzje/Prelluzhë, ekziston një auto-ambulancë për transport emergjent të individëve drejt veriut të Mitrovicës/Mitrovica. Tjetërkund, serbët e Kosovës duhet të gjejnë mënyrat e veta të transportit. Gjithashtu, në Priluzje/Prelluzhë, qendra lokale shëndetësore në mesin e stafit ka edhe një gjinekolog. Megjithatë, lindjet mund të asistohen vetëm në veri të Mitrovicës/Mitrovica. Gjendja në rajonin e Pejës/Peć është e ngjashme me rajonet tjera. Serbët e Kosovës kryesisht kanë

qasje në kujdesin shëndetësor të ofruar nga institucionet e Serbisë. Në komunën e Istogut/Istok, ekziston një qendër shëndetësore e Serbisë në fshatin e Osojane/Osojanit. Kujdesi sekondar ofrohet në spitalin e Mitrovicës/Mitrovica së veriut. Një numër i vogël i serbëve të Kosovës kanë shfrytëzuar qendrën shëndetësore komunale në komunën e Klinës/Klina, si dhe kanë shprehur kënaqësinë e tyre me kujdesin e pranuar. Në komunën e Pejës/Peć, edhe pse janë bërë përpjekje për mundësimin e qasjes në shërbime shëndetësore komunale për serbët e Kosovës, nuk ka pasur ndonjë ndikim real në terren deri më tani. Kështu, serbët e Kosovës në komunë ende varen nga shërbimet shëndetësore të Serbisë në Gorazdevac/Gorazhdevc, Ljevoša/Levoshë dhe Vitomirica/Vitomiricë.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti serb i Kosovës i qaset kujdesit shëndetësor përmes institucioneve të Serbisë. Megjithatë, qasja në kujdesin shëndetësor është përkeqësuar për komunitetin qysh prej qershorit të vitit 2009, për shkak se në shkurt të vitit 2010, qendra shëndetësore e Serbisë në qytetin e Lipjanit/Lipljan u mbyll për shkak të faturave të papaguara të qirasë dhe energjisë elektrike. Anëtarët e komunitetit serb që jetojnë në zonë tani duhet të udhëtojnë ose drejt spitalit në Gračanica/Graçanicë ose në Laplje Selo/Lapjeselle. Në fshatrat tjera, qendrat themelore të shëndetit funksionojnë në zonat ku jetojnë serbët e Kosovës. Në rajonin e Prizrenit, gjendja mbetet e pandryshuar. Serbët e Kosovës kanë qasje në objekte të kujdesit shëndetësor edhe të Kosovës edhe të Serbisë që janë në luginën e Župa/Zhupës, në fshatin e përzier të Mušnikovo/Mushnikovës, si dhe fshatin serb të Sredska/Sredskës. Serbët e Kosovës nga lugina e Župa/Zhupës udhëtojnë drejt Štrpce/Shtërpçës për kujdes sekondar, derisa serbët e Kosovës nga qyteti i Prizrenit shkojnë në spitalin rajonal të institucioneve kosovare. Në qytetin e Rahovecit/Orahovac, komuniteti serb i Kosovës vazhdon të varet në shërbimet shëndetësore që ofrohen nga Ministria kosovare e Shëndetësisë, duke përfshirë kujdesin primar shëndetësor që ofrohet nga qendra kryesore familjare në qytetin e Rahovecit/Orahovac si dhe spitalin më të afërt në qytetin e Prizrenit. Megjithatë, ekzistojnë edhe dy qendra shëndetësore të Serbisë që ofrojnë shërbime bazike shëndetësore për komunitetin serb të Kosovës që jeton në Rahovecin/Orahovac e epërm dhe Velika Hoča/Hočë të Madhe.

10. Qasja në drejtësi

Serbët e Kosovës vazhdojnë të kenë qasje në të dyja sistemet gjyqësore, të Kosovës dhe Serbisë, varësisht nga rasti dhe vendi. Ata shpesh mbështeten tek ndihma juridike pa pagesë e ofruar nga organizata joqeveritare lokale Programi për të Drejtat Civile në Kosovë.

Përgjithësisht, komuniteti serb i Kosovës vazhdon t'i qaset të dy sistemeve gjyqësore, të Kosovës dhe të Serbisë, varësisht nga rasti dhe nga vendndodhja e komunitetit në Kosovë. Një çështje e përbashkët përgjatë gjithë rajoneve është që serbët e Kosovës nuk i besojnë apo nuk kanë besim në sistemin gjyqësor të Kosovës. Disa frikësohen t'i shfrytëzojnë shërbimet për shkak të kërcënimeve reale apo të perceptuara. Tjerët kanë hasur në jo-efikasitetin, vonesat e gjata, vështirësitë në gjetjen e përfaqësuesve të licencuar serb, si dhe problemet me ekzekutimin e vendimeve. Kjo çështje është sidomos e rëndë në lidhje me rastet pronësore.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, serbët e Kosovës shfrytëzojnë të dy gjykatat, atë të Kosovës dhe atë të Serbisë. Sistemi gjyqësor i

Kosovës shfrytëzohet kryesisht në rastet ku vendimet gjyqësore kanë nevojë për ekzekutim, derisa shërbimet e gjykatës së Serbisë shfrytëzohen kryesisht për çështje administrative. Një numër i konsiderueshëm i çështjeve që dërgohen në gjykata nga serbët e Kosovës kanë të bëjnë me uzurpimet e pronave. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, shumica e serbëve të Kosovës që jetojnë në komunat e Vushtrrisë/Vučitrn dhe Skenderajt/Srbica i qasen sistemit kosovar të drejtësisë vetëm për raste në lidhje me pronën. Serbët e Kosovës kanë mundësi të ndjekin seancat gjyqësore si në gjykatat komunale ashtu edhe në gjykatat për kundërvajtje në të dy komunat pa problem. Zyra ndërlidhëse gjyqësore në fshatin Priluzhje/Prelluzhë të Vushtrrisë/Vučitrn, e cila është theksuar të jetë në funksion në Profilin e publikuar më 2009, është mbyllur për shkak të mungesës së shfrytëzimit të saj. Në rajonin e Pejës/Peć, ekzistenca e zyrës ndërlidhëse në Goraždevac/Gorazhdec e ka ndihmuar komunitetin serb të Kosovës në mundësinë për qasje në sistemin gjyqësor të Kosovës. Shumica e padive të parashtruara nga komuniteti kanë të bëjnë me kontestet pronësore. Në këtë kuptim, ata mbështeten kryesisht tek Programi i të Drejtave Civile në Kosovë (CRP/K) që t'ju ofrojë përfaqësim ligjor pa pagesë/të levërdisshëm. Edhe pse gjykata komunale ka një zyrë që ofron përfaqësim ligjor pa pagesë, komuniteti serb i Kosovës preferon shfrytëzimin e shërbimeve të CRP/K-së apo një avokati serb.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti serb i Kosovës i shfrytëzon shërbimet e gjykatës komunale të Prishtinës/Priština, si dhe një degë të saj në Gračanica/Graçanicë. Dega trajton të gjitha rastet përveç procedurave penale. Komuniteti serb i Kosovës gjithashtu shfrytëzon gjykatat e Serbisë, të cilat ofrojnë ndihmë në të gjitha rastet administrative, si në lëshimin e dokumenteve. Megjithatë, ato nuk mbajnë dëgjime apo gjykime. Qysh prej marsit 2010, komuniteti ka gëzuar edhe shërbimet e zyrës së re të Komisionit të Kosovës për Ndihmë Juridike, një agjenci publike e mbështetur nga UNDP-ja, e cila ofron ndihmë juridike pa pagesë për personat financiarisht të cenueshëm në rastet civile dhe administrative. Aktualisht ekzistojnë tre gjyqtarë serb që shërbejnë në gjykatat komunale në rajon, dy në gjykatën komunale të Prishtinës/Priština dhe një në degën e Gračanica/Graçanicës. Në rajonin e Prizrenit, serbët e Kosovës kanë qasje në sistemin kosovar të drejtësisë. Gjykata e qarkut dhe ajo komunale në Prizren publikojnë oraret e gjykimeve për çdo ditë në tri gjuhët zyrtare (shqip, serbisht dhe turqisht). Thuhet që ka një numër të mjaftueshëm dhe të kualifikuar të përkthyesve në serbisht në gjitha gjykatat e rajonit. Ekziston një zyrë ndërlidhëse e gjykatave në qytetin e Prizrenit dhe një në fshatin Velika Hoča/Hoçë e Madhe (Komuna e Rahovecit/Orahovac), funksioni i të cilave është lehtësimi i qasjes së komunitetit në drejtësi, duke ofruar këto shërbime: transportim deri në gjykata dhe zyrat e prokurorisë publike; ndihmë juridike dhe teknike; si dhe mbështetjë logjistike dhe teknike, si në nxjerrjen e dokumenteve të ndryshme nga arkivat e gjykatave, si dhe dokumente tjera ligjore. Ngjashëm me rajonin e Pejës/Peć, serbët e Kosovës në Prizren shfrytëzojnë organizatën CRP/K për ndihmë dhe këshilla juridike pa pagesë. Megjithatë, edhe Komisioni për Ndihmë Juridike në Prizren ofron ndihmë juridike pa pagesë për të gjitha palët me vështirësi ekonomike dhe për grupe të cenueshme, duke përfshirë serbët e Kosovës.

Programi për të Drejtat Civile në Kosovë është iniciativë rajonale e financuar nga Komisioni Evropian dhe implementuar nga Komisioneri i Lartë i OKB-së për Refugjatë (UNHCR).

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Themelimi i komunave me shumicë serbe të Ranilug/Ranillugut, Klokot/Kllokotit, dhe Gračanica/ Graçanicës, si dhe zgjerimi i Novo Brdo/Novobërdës ka rritur pjesëmarrjen e komunitetit në çështje publike. Megjithatë, mu e kundërta vlen për ata serb që mbesin në komuna ku banojnë në numra më të vegjël.

Pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në çështje publike është rritur me themelimin e komunave të reja ku komuniteti tani përbën shumicë. Pjesëmarrja e tij mbetet e kufizuar në ato komuna ku komuniteti përbën pakicë. Serbët e Kosovës janë relativisht mirë të përfaqësuar në nivelin qendror. Dhjetë serb, duke përfshirë dy femra, kanë ulëse në Kuvendin e Kosovës. Ata shërbejnë si Ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministër për Komunitete dhe Kthim, si dhe Zëvendës Ministër i Shëndetësisë. Për më tepër, edhe drejtori i zyrës së Kryeministrit për çështje të komuniteteve është serb. Pesë serb të Kosovës janë emëruar në Këshillin Konsultativ për Komunitete, organ këshilldhënës që funksionon në kuadër të Zyrës së Presidentit të Kosovës. Megjithatë, pjesëmarrja e komunitetit është e kufizuar për shkak të ngurrimit për t'i njohur institucionet e Kosovës, që ndodh pjesërisht për shkak të presionit nga Beogradi dhe institucionet e Serbisë, që e bën komunitetin të frikësohet nga humbja e ndihmës qenësore nga këto të fundit. Komuniteti serb i Kosovës nuk përfaqësohet as në degën legjislative e as në atë ekzekutive të asnjërës prej komunave në të cilat përbëjnë pakicë. Komuniteti mbështetet kryesisht në mekanizmat e pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë, si komitetet e komuniteteve, zyrat komunale të komuniteteve, zëvendëskryesuesi i kuvendit komunal për komunitete, si dhe zëvendëskryetari i komunës për komunitete aty ku këto institucione janë themeluar. Kjo ndodh pjesërisht për shkak të neglizhencës së institucioneve të Kosovës, por edhe për shkak të mungesës së vazhdueshme të angazhimit të komunitetit në zgjedhjet e nivelit lokal. Gjatë zgjedhjeve lokale të nëntorit 2009, edhe pse qeveria e Kosovës publikisht ka inkurajuar komunitetin që të marrë pjesë, shumë prej tyre nuk kanë dalë në zgjedhje. Megjithatë, dalja në votime ka qenë më e lartë në ato komuna të banuara me shumicë serbe. Komuniteti serb i Kosovës ka qasje relativisht të gjerë ndaj mediave të shkruara dhe elektronike. Radio-Televizioni i Kosovës (RTK) transmeton 15 minuta lajme ditore dhe një dokumentar javor një-orësh në gjuhën serbe. Komuniteti e percepton këtë si të pamjaftueshme, duke u mbështetur kryesisht tek kanalet televizive të Serbisë. Cilësia e sinjalit të kanaleve televizive nga Serbia është e mirë në shumë komuna; në tjerat, komuniteti ka qasje vetëm përmes sistemit kabllor apo satelitor. Një stacion televiziv serb mund të shihet në Gjilan/Gnjilane. Gati gjitha komunat kanë qasje në radio-stacione lokale që transmetojnë në serbisht. Gazetat, në anën tjetër, janë në dispozicion vetëm për ata serb që jetojnë në zona të populluara shumë nga komuniteti. Shumë serb ndjehen të veçuar nga ngjarjet aktuale në Kosovë dhe kanë kërkuar mbulim më të madh mediatik nga dhe për Kosovën.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, pjesëmarrja e serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës është rritur në masë të konsiderueshme qysh prej botimit të Profileve më 2009. Serbët e Kosovës kanë marrë pjesë në numër më të madh në zgjedhjet lokale të vitit 2009, sesa në ato të vitit 2007. Kjo sidomos vlen për Štrpce/Shtërpçën. Dalja është ende e ulët në Ferizaj/Uroševac, Gjilan/Gnjilane dhe Kamenicë/Kamenica. Megjithatë, komuniteti është ende i angazhuar në gjitha institucionet e

Serbisë. Në Gjilan/Gnjilane, një serb është emëruar si zëvendëskryetar për komunitete. Në Kamenicë/Kamenica, komuniteti serb i Kosovës është i vogël, si dhe vetëm disa kanë marrë pjesë në zgjedhjet lokale. Megjithatë, komuna ka emëruar një zëvendëskryesues serb për komunitete në Kuvendin Komunal. Në komunat ku banojnë serbët e Kosovës, ata janë të përfaqësuar në gjitha zyrat komunale të komuniteteve dhe komitetet e komuniteteve aty ku janë të themeluara. Komuniteti udhëheq zyrat komunale për komunitete në tri komunat e Gjilanit/Gnjilane, Kamenicës/Kamenica dhe Novo Brdo/Novobërdës. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, në tri komunat ku serbët e Kosovës përbëjnë pakicë (jug të Mitrovicës/Mitrovica, Skenderaj/Srbica dhe Vushtri/Vučitrn), pjesëmarrja në jetën publike mundësohet kryesisht përmes zyrove komunale të komuniteteve, komiteteve për komunitete, këshillave të fshatrave dhe grupeve komunale të punës për kthim. Por, afrimi me komunitetin mbetet i pamjaftueshëm. Serbët e Kosovës udhëheqin zyrat komunale të komuniteteve në të tri komunat. Në jug të Mitrovicës/Mitrovica, komiteti i komuniteteve nuk përfshin serb të Kosovës, përkundër faktit që secili komunitet që jeton në komunë duhet përfaqësuar. Pasi përfaqësimi i serbëve të Kosovës në degët ekzekutive dhe legjislative mbetet i kufizuar, forumet zyrtare të dialogut si komitetet për komunitete dhe zyrat komunale për komunitete do të vazhdojnë të kenë rol qenësor në kanalizimin e brengave të komunitetit tek institucionet gjegjëse.

zhvillimet historike dhe politike ndikojnë në pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës më tepër në rajonin e Pejës/Peć sesa tjetërkund. Komuniteti është mjaft i izoluar dhe përgjithësisht ngurron të angazhohet në dialog dhe të marrë pjesë në institucionet e Kosovës. Në mesin e pak përjashtimeve është edhe zëvendëskryetari serb për komunitete i emëruar pas zgjedhjeve lokale të nëntorit 2009, bashkë me nën-degën e zyrës komunale për komunitete në fshatin e Gorazdevac/Gorazhdecit (Komuna e Pejës/Peć), e cila vepron si ombrellë për gjithë komunitetin serb të Kosovës të mbetur në rajon. Asistentja serbe e zyrtarit komunal të komuniteteve në komunën e Deçanit/Dečane është përkushtuar vetë në mundësimin e një mjedisi më shoqëror më paqësor dhe më pak konfrontues në qytet, përmes iniciativave të dialogut ndëretnike, si dhe në përmirësimin e standardeve të jetesës për të gjitha komunitetet. Në komunën e Klinës/Klina, dy zyrtarët komunal të komuniteteve janë proaktiv në mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe në krijimin e një mjedisi që favorizon kthimin. Kryetari i Klinës/Klina në mënyrë aktive afrohet me zonat e banuara me serb. Në komunat ku banojnë serbët e Kosovës, ata janë të përfaqësuar në të gjitha zyrat komunale të komuniteteve dhe komitetet e komuniteteve. Shumica e serbëve të Kosovës në rajonin e Prishtinës/Priština banojnë në komunën e sapo-theluar të Gračanica/Graçanicës. Në ato komuna ku përbëjnë pakicë numerike, shumica e serbëve të Kosovës të punësuar janë shërbyes civilë në pozita të ulëta. Megjithatë, komuniteti përfaqësohet në të gjitha zyrat komunale të komuniteteve dhe komitetet e komuniteteve. Komuniteti serb i Kosovës nuk ka ulëse në kuvendet komunale të rajonit të Prishtinës/Priština. I vetmi serb i punësuar në degën ekzekutive është zëvendës kryetari për komunitete në komunën e Obiliqit/Obilić. Përafrimi komunal dhe konsultimet publike me komunitetin serb të Kosovës janë shumë të dobëta, bashkë me promovimin e pjesëmarrjes së shoqërisë së tyre civile.

Vetëm 15% e pozitave qendrore dhe 18% të atyre lokale që mbajnë serbët e Kosovës u takojnë grave. Këto përfshijnë dy ulëse në Kuvendin e Kosovës, si dhe dy drejtorë të zyrove komunale të komuniteteve.

Përpjekjet jo-adekuate të institucioneve të Kosovës në afrimin me dhe promovimin e pjesëmarrjes së komunitetit serb të Kosovës kontribuon në largimin e tyre nga pjesa tjetër e shoqërisë në Kosovë. Në anën tjetër, ngurrimi i shumë serbve që të angazhohen me institucionet e Kosovës vazhdon të kufizojë ndikimin e tyre në qeverisje lokale dhe jetë publike.

Në rajonin e Prizrenit, niveli dhe cilësia e pjesëmarrjes së komunitetit të moshuar serb të Kosovës nuk janë të kënaqshme, sidomos pas ikjes së shumicës së komunitetit nga qyteti i Prizrenit gjatë trazirave të marsit të vitit 2004. Aktualisht, serbët e Kosovës përfaqësohen në komunën e Prizrenit vetëm përmes zyrës komunale të komuniteteve, pasi komiteti për komunitete duhet ende të themelohet pas zgjedhjeve komunale të nëntorit 2009. Në komunën e Rahovecit/Orahovac, niveli dhe cilësia e pjesëmarrjes janë adekuate, mbështetur nga qëndrimi i moderuar i përfaqësuesve të komunitetit dhe afërsia e treguar nga zyrtarët komunal. Serbët e Kosovës përfaqësohen nga zyra komunale e komuniteteve, derisa zyrtari komunal i kthimit është serb. Komiteti i komuniteteve është themeluar, por emërimet e komuniteteve jo-shumicë ende priten të bëhen. Pozita e zëvendës kryetarit për komunitete në Rahovec/Orahovac, e cila është mbajtur nga një serb, është anuluar në maj të vitit 2010. Nuk ka pasur aktivitete në terren, në vitin 2009 e as në 2010, as në Prizren e as në Rahovec/Orahovac. Serbët e Kosovës e zhvendosur të Kosovës marrin pjesë në takimet e grupit komunal të punës për kthim në komunat Prizren, Rahovec/Orahovac, dhe Suharekë/Suva Reka.

12. Përdorimi i gjuhës

Serbët e Kosovës përgjithësisht ndjehen të lirë të përdorin gjuhën e tyre haptas në vende publike dhe i drejtohen zyrtarëve komunalë në serbisht, në pjesën më të madhe të Kosovës. Megjithatë, komuniteti ende përballet me pengesa në lidhje me përdorimin e gjuhës së tyre amtare në rastet e ngacmimit dhe rezistencës së zyrtarëve komunalë për të folur gjuhën serbe. Megjithatë, në përgjithësi, ofrohet përkthimi në takime komunale, të brendshme apo publike, derisa dokumentet përkthehen në serbisht. Në anën tjetër, përkthimet verbale dhe të shkruara shpesh kanë vonesa dhe cilësi të dobët. Komunat shpesh iu atribuojnë këto dështime ngarkesës së madhe të përkthyesve dhe/ose mungesës së tyre. Shenjat topografike rajonale janë përgjithësisht dy-gjuhëshe, por nganjëherë emrat topografikë në serbisht dëmtohen.

Serbët e Kosovës lirisht përdorin gjuhën e tyre në vende publike në të gjithë rajonin e Gjilanit/Gnjilane, duke përfshirë komunikimin me zyrtarë civilë komunalë që flasin gjuhën serbe. Megjithatë, ka ngacmime të rralla nga shqiptarët e Kosovës kundër serbëve të Kosovës që flasin serbisht në zonat me shumicë shqiptare (sidomos në qytetin e Ferizajt/Uroševac). Serbët e Kosovës në komunën e Vitisë/Vitina ndjehen të lirë të përdorin gjuhën e tyre në zonat e banuara nga ta, në qytetin e Vitisë/Vitina dhe Bincë/Binaç. Por, ata bëjnë kujdes apo thjesht përmbahen nga përdorimi i gjuhës së tyre në zonat e banuara me shqiptarë të Kosovës. Dokumentacioni në komuna zakonisht përkthehet në gjuhën serbe, por cilësia mund të jetë e dobët me gabime në drejtshkrim. Për më tepër, përkthimi verbal në takime zyrtare ofrohet në të gjitha komunat. Megjithatë, në Ferizaj/Uroševac dhe Viti/Vitina shumë tabela komunale dhe mbishkrimet e zyrave shkruhen vetëm në shqip. Në komunën e Novobërdës/Novo Brdo dhe Kamenicës/Kamenica, edhe tabelat e njoftimit edhe mbishkrimet e zyrave janë në dy gjuhët, shqip dhe serbisht. Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, shumica e mbishkrimeve të zyrave paraqiten vetëm në shqip, derisa tabelat e njoftimit



KISHA ORTODOKSE SERBE SVETI SAVA NË PJSËN JUGORE TË MITROVICËS/MITROVICA, E NDËRTUAR MES VITEVE 1896 DHE 1912, ISHTE SHKATËRRUAR GJATË TRAZIRAVE TË MARSIT TË VITIT 2004. RESTAURIMI I SAJ FILLOI NË VITIN 2007 NGA ANA KOMISIONIT TË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR IMPLEMENTIMIN E RINDËRTIMIT, QË U THEMELUA PËR T'I RINDËRTUAR OBJEKTET FETARE DHE KULTURORE TË DËMTUARA GJATË NGJARJEVE TË VITIT 2004.

janë në dyja gjuhët shqipe dhe serbe. Shenjat topografike janë përgjithësisht dy-gjuhëshe. Por, shenjat topografike në serbisht shpesh dëmtohen, sidomos në Kaçanik/Kaçanik. Shenjat e rrugëve dështojnë në përdorimin e serbishtes si gjuhë zyrtare në komuna të ndryshme të rajonit.

Serbët e Kosovës në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica ndjehen të lirë të përdorin gjuhën e tyre amtare në vendet publike, duke përfshirë ndërveprimin e tyre me institucione. Përkthimi verbal përgjithësisht ofrohet në takimet zyrtare, derisa rendi i ditës dhe procesverbalet përgatiten në shqip dhe serbisht; megjithatë, cilësia është nganjëherë e dobët. Dokumentet zyrtare përgjithësisht përkthehen në serbisht në të gjitha komunat. Drejtshkrimi i emrave personal dhe gjeografik në serbisht ende mbetet problem. Problemi është zgjidhur në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn me hapjen e një zyre vendore të regjistrimit civil në fshatin e banuar me serb të Priluzje/Prelluzhës. Megjithatë, shenjat e rrugëve shpesh përmbajnë shkrime të gabueshme të toponimeve dhe fshatrave në komunën e Vushtrrisë/Vučitrn. Përgjithësisht, shenjat e reja në fshatrat e komunave të Skenderajt/Srbica, Vushtrrisë/Vučitrn dhe Mitrovicës/Mitrovica kanë nga dy emra zyrtar. Shenjat në serbisht shpesh dëmtohen. Fatkeqësisht, nuk ka shenja në rrugët kryesore që tregojnë drejtimet drejt shumë fshatrave serbe në Skenderaj/Srbica dhe Vushtrri/Vučitrn. Në pjesën më të madhe të Pejës/Peć, komuniteti serb i Kosovës ndjehet i lirë të flasë serbisht në publik dhe me zyrtarët komunal. Ky përkthim megjithatë nuk vlen plotësisht për të gjitha komunitetet. Në komunën Gjakovës/Đakovica, për shembull, gjuha serbe nuk flitet fare në vende publike. Për më tepër, në komunën e Klinës/Klina, komuniteti përballet me vështirësi me zyrtarët komunalë, ose për shkak se nuk dëshirojnë të flasin serbisht, ose nuk mund ta flasin. Prapë, përkthimi verbal dhe me shkrim, në përgjithësi, ofrohet nga të gjitha komunat. Për më tepër, në përgjithësi, emrat e institucioneve publike, si dhe shenjat e rrugëve dhe ato topografike paraqiten në gjuhët zyrtare.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, ka ende kufizime për përdorimin e lirë të serbishtes në vende publike jashtë zonave të banuara kryesisht

me komunitet serb. Ende ka zona, si komuna e Glllogocit/Glogovac, derisa përdorimi i gjuhës serbe në publik nuk është i këshillueshëm për arsye sigurie. Në pjesën më të madhe, komunat në rajonin e Prishtinës/Priština nuk ofrojnë përkthim verbal apo të shkruar për komunitetet jo-shumicë. Këtë ato ia atribuojnë mungesës së përkthyesve. Për më tepër, jo të gjitha shenjat zyrtare të rrugëve dhe toponimeve janë në serbisht. Komuna e Fushë Kosovës/Kosovo Polje në rajonin e Prishtinës/Priština ende nuk ka miratuar emrat e rrugëve në dy gjuhët zyrtare, pasi emrat janë mbishkruar vetëm në gjuhën shqipe, sipas autoriteteve, për shkak të kufizimeve buxhetore. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti serb i Kosovës është i lirë të përdorë gjuhën e tij në hapësira publike dhe në komunikim me zyrtarët komunalë. Përkthimi me shkrim e me gojë ofrohet nga gati të gjitha komunat. Megjithatë, procesi i përkthimit ende vuan nga vonesa të konsiderueshme. Në komunën e Malishevës/Mališevo, përkthimi i dokumenteve në serbisht ofrohet vetëm në raste të veçanta. Për më tepër, mbishkrimet e rrugëve në rajon janë vetëm pjesërisht dy-gjuhëshe, derisa disa mbishkrime publike janë ose të keqshkruara ose të dëmtuara. Në komunën e Mamuşa/Mamushës/Mamuša, mbishkrimet paraqiten vetëm në shqip dhe turqisht.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Serbët e Kosovës kanë mundësi të gëzojnë trashëgiminë kulturore, si dhe shumica praktikojnë besimin e krishterë ortodoks brenda vendbanimeve dhe objekteve fetare të tyre, derisa mbesin në hezitim që të shprehin publikisht besimin apo simbolet e tyre fetare në zonat me shumicë shqiptare. KFOR-i ofron mbrojtje për një numër objektiv fetare në të gjithë Kosovën. Megjithatë, përdit e më shumë këto detyra po i barten policisë së Kosovës dha ata po bëjnë një tërheqje të organizuar. Kjo kritikohet nga komuniteti serb i Kosovës, i cili frikësohet që policia e Kosovës nuk do të ofrojë mbrojtje adekuate. Plaçkitja dhe vandalizimi i objekteve fetare serbe vazhdojnë të raportohen, si dhe ka pasur shembuj të përdhosjes së varreve (shih Pjesën 2 më lart). Në maj të vitit 2010, peshkopi i

PAMJE E JASHTME E MANASTIRIT ORTODOKS SERB VISOKI DEČANI NË KOMUNËN E DEÇANIT/DEČANE (NË RAJONIN E PEJËS/PEĆ).



Dioçezës Rashkë-Prizren, Artemije, u shkarkua nga funksioni i tij për shkak të keqpërdorimit të pohuar të pozitës së tij. Aktualisht, është vendosur një Peshkop i ri, i cili ushtron detyrën e administrimit. Vendimi përfundimtar për pozitë do të merret nga “Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Serbe”.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti serb i Kosovës është në gjendje të shprehë besimin fetar dhe kulturor, si dhe të kryejë ceremonitë fetare në pjesën më të madhe të rajonit. Liturgjitë mbahen në të gjitha vendbanimet e mëdha të banuara nga ky komunitet. Problemi kryesor është mungesa e një prifti që do të ishte gjithmonë i pranishëm në komunën e Ferizajt/Uroševac. Megjithatë, një prift nga Štrpce/Shtërpca viziton komunën gjatë festave fetare dhe mban ceremoni në një nga kishat e komunës. Në shumicën e rasteve, kishat ortodokse në rajonin e Gjilanit/Gnjilane kanë mbetur të padëmtuara gjatë konfliktit të vitit 1999 dhe trazirave të marsit të vitit 2004. Një përjashtim ndaj kësaj është ai në komunën e Ferizajt/Uroševac ku shumica e kishave ortodokse ishin shkatërruar. Ato që mbeten janë në gjendje shumë të keqe. Në komunën e Štrpce/Shtërpçës, kisha e Shën Pjetrit, në fshatin e banuar me shqiptarë të Kosovës të Brodit/Brod ka pësuar disa dëmtime nga vandalizmi. Kisha është grabitur disa herë që nga viti 1999, si dhe është përdorur edhe si ahur i improvizuar për bagëti në të kaluarën. Megjithatë, që nga viti 2008, serbët e Kosovës kanë rifilluar tubimet në Kishë, një herë në vit më 12 korrik për të festuar Petrovdanin – “festën” e Kishës. Në fshatin e Zhegrës/Žegra (Komuna e Gjilanit/Gnjilane), Kisha Ortodokse është shkatërruar në vitin 1999, si në rastin e Manastirit Ubozhac në fshatin Gornje Močare/Močar i Epërm (komuna Kamenicë/Kamenica), i cili tash mbetet rrënojë. Kisha në qendër të Vitisë/Vitina është spërkatur disa herë me grafitë.

Në Mitrovicë/Mitrovica, shumica e objekteve fetare të rajonit janë shkatërruar ose dëmtuar ose gjatë konfliktit të vitit 1999 ose gjatë trazirave të vitit 2004. Ka një numër të vogël kishash që aktualisht janë në renovim e sipër, kryesisht me financim të donatorëve ndërkombëtarë. Shembulli kryesor është kisha e Shën-Savës në jug të Mitrovicës/Mitrovica, ku më 5 prill 2010 përfaqësuesit e

Qysh prej 2007-ës, Këshilli i Evropës ka financuar, përmes Komisionit për Implementimin e Rindërtimit, riparimin e Kishës së Shën Savës në jug të Mitrovicës/Mitrovica, e cila është dëmtuar më 2004. faza e parë është përfunduar më 2010 dhe është hapur për publik për pashkët e këtij viti. Faza e dytë do të përfshijë pikturimin e freskave në bashkëpunim me dhe nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të klerit të kishës.



PAMJE NGA BRENDIA E MANASTIRIT VISOKI DEČANI NË KOMUNËN E DEČANIT/DEČANE (NË RAJONIN E PEJËS/PEĆ), NJË NGA VENDET MË TË RËNDËSISHME ORTODOKSE SERBE. AI U NDËRTUA MES VITEVE 1327 DHE 1335 DHE ËSHTË KTHYER NË SIMBOL TË TOLERANCËS FETARE PËR SHKAK TË HISTORISË SË TIJ TË MBROJTJES NGA OTOMANËT DHE PATRONAZHIT TË SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DHE KOMUNITETEVE TJERA TË KOSOVËS.

Eparkisë Rashkë-Prizren, Peshkopët Atanasije dhe Teodosije kanë mbajtur liturgjinë e të Hënës së Pashkëve. Aktualisht, policia e Kosovës ofron mbrojtje 24-orëshe për kishën e rindërtuar. Objektet madhore fetare dhe kulturore të Manastirit të Deviçit në komunën e Skenderajt/Srbica, që ishin në renovim e sipër gjatë periudhës së fundit të raportimit, tani janë plotësisht të riparuar dhe ka tetë motra nderi që banojnë aty. Manastiri është ende nën mbrojtjen e KFOR-it. Megjithatë, ka mundësi që policia e Kosovës të marrë përsipër këtë përgjegjësi, gjë që kundërshtohet fuqimisht nga motrat e nderit. Në qytetin e Vushtrrisë/Vučitrn, kisha e Shën-Eliasit, e cila është ndërtuar në vitin 1834, mbrohet nga prania statike e policisë së Kosovës. Aktualisht është duke u renovuar pas dëmtimit të shkaktuar gjatë trazirave të marsit 2004, por projekti nuk ka marrë miratimin e autoriteteve të Kishës Ortodokse Serbe. Kisha e Shën-Nikollës në fshatin Banja/Banjë (komuna e Vushtrrisë/Vučitrn) me sa duket daton nga shekulli i XIV-të. Është renovuar së voni dhe tani shfrytëzohet nga banorët e fshatit dhe fshatit të afërt të Suvo Grlo/Syriganës. Serbët e Kosovës janë të lirë të manifestojnë praktikat fetare të tyre brenda fshatrave të tyre. Gjatë festave fetare, kur serbët e Kosovës i vizitojnë kishat apo varrezat, autobusët zakonisht përcillen nga policia e Kosovës. Ka incidente apo vandalizime të rralla, apo plaçkitje të objekteve fetare.

Në rajonin e Pejës/Peć, ka një numër të objekteve fetare me rëndësi për komunitetin serb të Kosovës. Në komunën e Gjakovës/Dakovica, më e rëndësishmja është Kisha Ortodokse e Virgjëreshës së Shënjtë. Manastiri i Deçanit në komunën e Deçanit/Dečane është objekt i Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Në komunën e Istogut/Istok, Manastiri i Goriocit/Gorioq është në zonë të veçantë të mbrojtur. Në komunën e Klinës/Klina, Manastiri i Budisavci/Budisalcit, Kisha e Vetmisë Ugljarice/Ularicë dhe Manastiri i Dolac/Dollcit janë Zona të Veçanta dhe janë veçanërisht të rëndësishme për komunitetin serb në Kosovë. Përveç këtyre, varrezat ortodokse serbe në Drenovc/Drenovac, Dollc/Dolac, Drsnik/Dresnik dhe Klinë/Klina gëzojnë vëmendje të madhe nga komuniteti serb i Kosovës, dhe kanë përkujdesje të madhe. Përfundimisht, në komunën e Pejës/Peć, Patriarkana e Pejës dhe Kisha Ortodokse Mitropolitike kanë rëndësi të veçantë fetare dhe historike. Gjithashtu, ka një numër të vogël të kishave në fshatrat e rajonit që janë në shfrytëzim aktiv. Serbët e Kosovës janë gjithashtu në gjendje të marrin pjesë në organizimin dhe në ngjarje kulturore, rituale fetare dhe ceremoni në rajon. Megjithatë, ka ende prani të KFOR-it përreth disa objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore, derisa ndihma e tyre logjistike ende mundëson lirinë e lëvizjes në disa zona. Manastiri i Deçanit është i mbrojtur nga KFOR-i, derisa murgjit kanë liri të kufizuar të lëvizjes jashtë kompleksit të manastirit. Megjithatë, në komunën e Istogut/Istok, ndihma e KFOR-it nuk ofrohet më, derisa serbët e Kosovës janë të lirë të lëvizin dhe të ndjekin ngjarjet kulturore dhe fetare. Gjatë disa ngjarjeve të caktuara fetare, pjesëmarrja e komunitetit serb të Kosovës është e lartë, derisa pjesëmarrësit jashtë Kosovës shpesh ndjekin festimet. Për shembull, serbët e Kosovës rregullisht kremtojnë festën e Shën Stefanit në Manastirin e Deçanit në nëntor, kremte kjo që ndiqet nga pelegrinë dhe përfaqësues të lartë të qeverisë së Serbisë dhe institucioneve ndërkombëtare.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, gjendja mbetet e pandryshuar që nga botimi i Profileve në vitin 2009. Objekti kryesor fetar për komunitetin serb të Kosovës brenda rajonit është Manastiri i Gračanica/Graçanicës. Në komunën e Fushë Kosovës/Kosovo Polje, ekzistojnë dy kisha ortodokse, Shën-Nikola dhe Shën-Katerina. Komuna e Obiliqit/Obilić është vendi i një objekti historik mjaft të njohur, monumentit të Gazimestanit, i cili është i përfshirë në listën e zonave të mbrojtura të trashëgimisë kulturore. Objektet më të reja, por me rëndësi të barabartë janë edhe kishat ortodokse në Prishtinë/Priština dhe Podujevë/Podujevo. Qyteti i Lipjanit/Lipljan më parë ka qenë vendbanim i Dioqezës së Lipjanit, si dhe shtëpia e Kishës së Paraqitjes së Virgjëreshës, kishë kjo që daton nga shekulli i 14-të. Serbët e Kosovës gëzojnë lirinë fetare brenda zonave ku banojnë. Në shkurtin e vitit 2010, është mbajtur shërbesa e parë fetare në Kishën Ortodokse të sapo-renovuar të Shën-Nikollës në Prishtinë/Priština pas shkatërrimit të saj gjatë trazirave të marsit 2004. Dy priftërinj ortodoksë serb janë emëruar për Kishën në qershor.

Në Prizren, trashëgimia kulturore e komunitetit serb të Kosovës përfshin: lagjen Potkaljaja/Nënkajaja të qytetit të Prizrenit, Katedralen e Shën-Gjergjit, Selinë e Peshkopatës-Metropolitane, Seminarin Ortodoks të Shën-Qirilit dhe Shën-Metodit (Bogoslavia), Kishën e Virgjëreshës së Shenjtë (Bogorodica Ljeviška), Kishën Ortodokse Serbe të Shën-Nikollë Tutiqit, si dhe Manastirin e të Shenjtit Arkangjel. Rahoveci/Orahovac në veçanti është i pasur me objekte të trashëgimisë kulturore, sidomos në zonën e Velika Hoča/Hoçës së Madhe. Qysh prej mesit të vitit 2009, është emëruar një prift i përhershëm në Katedralën e Shën-Gjergjit në Prizren. Kisha është funksionale, derisa komuniteti serb i Kosovës rregullisht viziton dhe ndjek ceremoni të ndryshme fetare në të. Në fillim të vitit 2010, Peshkopi i ri i Dioqezës Rashka-Prizren shenjtëroi dy kisha në Prizren: Katedralen e Shën-Gjergjit dhe Kishën e Virgjëreshës së Shenjtë (Bogorodica Ljeviška). Përgjatë viteve 2009 dhe 2010, komuniteti serb i Kosovës ka pasur mundësi të festojë festat fetare ortodokse serbe në Prizren dhe Rahovec/Orahovac pa ndonjë incident.

14. Marrëdhëniet/dialogu nëdërmjet komuniteteve

Marrëdhëniet mes komunitetit serb të Kosovës dhe atij shqiptar të Kosovës vazhdojnë të përkufizohen nga zhvillimet historike si dhe ato aktuale politike. Ngjarjet politike të vitit 2008 kanë çuar në bojkotim të institucioneve të Kosovës nga serbët e Kosovës, që negativisht ka ndikuar në pjesëmarrjen e komunitetit në forumet komunale të dialogut, si komitetet për komunitete, këshillat komunalë të sigurisë në bashkësi, si dhe grupet komunale të punës për kthim. Shumë serb tanimë janë kthyer të punojnë për institucionet e Kosovës, kryesisht në nivelin komunal, gjë që ka pasur ndikim pozitiv tek marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Iniciativat e dialogut mes serbëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera vazhdojnë të merren kryesisht brenda ombrellës së mekanizmave komunalë të pjesëmarrjes dhe kthimit, si këshillat komunalë të sigurisë në bashkësi dhe grupet punuese komunale për kthimin. Projektet e dialogut të drejtpërdrejtë

Kisha e “Virgjëreshës së Shenjtë” (“Bogorodica Ljeviška”) në Prizren është propozuar për përfshirje në Listën e Trashëgimisë Botërore të UNESCO-s. Qysh prej vitit 2006, objekti është përfshirë në Listën e UNESCO-s për Trashëgiminë Botërore në Rrezik.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, ka këshilla fshatrash ku komuniteti serb i Kosovës dhe komunitetet tjera trajtojnë bashkërisht brengat e tyre dhe marrin vendime për të ardhmen e tyre të përbashkët.

XHAMIA DHE KISHA ORTODOKSE NË QENDËR TË QYTETIT TË FERIZAJT/UROŠEVAC, NË RAJONIN E GJILANIT/GNJILANE. PËRKUNDËR AFËRSISË SË KËTYRE DY OBJEKTEVE FETARE, MARRËDHËNIET NDËRMJET SHQIPTARËVE TË KOSOVËS DHE SERBËVE TË KOSOVËS NË QYTET MBETEN TË VËSHTIRA. VETËM DY FAMILJE JANË KTHYER NGA ZHVENDOSJA E TYRE PAS KONFLIKTIT TË VITIT 1999.



kufizohen kryesisht tek shoqëria civile. Rritja e incidenteve të sigurisë (raportuar tek pjesa 2 më lart) tregon që dialogu mes komuniteteve është më pak i mundur, por incidentet e tilla shpesh janë rezultat i mundësisë më të madhe që serbët e Kosovës të atakohen për shkak se kanë liri më të madhe të lëvizjes dhe për ndërveprim më të madh me komunitetin shumicë. Megjithatë, pasqyra në terren në Kosovë është komplekse, si dhe ekzistojnë shumë shembuj të mirë të bashkëpunimit.

Serbët e Kosovës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane vazhdojnë të gëzojnë marrëdhënie relativisht të mira me komunitetet tjera, duke përfshirë shqiptarët e Kosovës. Ka shumë raste ku njerëzit e rëndomtë nga të gjitha komunitetet ndërveprojnë si fqinjë, partnerë afaristë, apo në tregjet multi-etnike që funksionojnë në shumë qytete të rajonit. Në komunën e Ferizajt/Uroševac, kjo mund të gjendet tek pjesëmarrja e vazhdueshme e përfaqësuesve serb të Kosovës dhe shqiptarë të Kosovës në këshillat e fshatrave, ku diskutojnë çështjet e interesit të fshatit në përgjithësi. Megjithatë, ata pak serb që mbeten në zonat urbane, si qyteti i Ferizajt/Uroševac dhe Vitisë/Vitina, nuk kanë arritur të integrohen aq mirë në lagjet e tyre. Kryesisht të moshuarit janë ata që jetojnë të shpërndarë në pjesë të ndryshme të qytetit, si dhe gëzojnë liri tejet të kufizuar të lëvizjes. Dialogu ndërëtnik është i rrallë, si nga autoritetet komunale, ashtu edhe nga administratat që kanë dalë nga zgjedhjet lokale të Serbisë më 11 maj 2008. Pjesëmarrja në rritje e serbëve të Kosovës në çështje komunale ka rritur angazhimin e tyre në forumet forMeshkuj të dialogut si dhe ka përforcuar lidhjet institucionale me komunitetin shumicë. Për shembull, në komunën e Novo Brdo/Novobërdës, drejtori i departamentit komunal për komunitete dhe kthim ka ndërmjetësuar mes kryetarit të Novo Brdo/Novobërdës dhe komunitetit serb të Kosovës nga Gornje Kusce/Kufca e Epërme për të kërkuar mbështetje donatorësh në restaurimin e varrezave lokale ortodokse serbe, pasi komuna nuk kishte fonde të mjaftueshme. Në Kamenicë/Kamenica, zëvendës kryesuesi i kuvendit komunal për komunitete ka kërkuar fonde shtesë për mirëmbajtjen e varrezave ortodokse. Këshilltari special për komunitete i Kryetarit të Gjilanit/Gnjilane ka mundur me sukses dialogun ndërmjet Korporatës Energjetike të Kosovës dhe udhëheqësve fetarë të

Kishës Ortodokse të Gjilanit/Gnjilane për ta rikyçur kishën në rrjetin e energjisë. Kthimi gradual i serbëve të Kosovës në policinë e Kosovës ka pasur ndikim pozitiv në lirinë e lëvizjes dhe marrëdhëniet mes komuniteteve.

Marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica vazhdojnë të dominohen nga tensione në lidhje me qytetin e ndarë dhe komunën me të njëjtin emër. Dhuna e shpeshtë mes komuniteteve pengon përpjekjet e shoqërisë civile dhe liderëve të moderuar për të promovuar dialogun në lagjet e përziera të veriut të Mitrovicës/Mitrovica. Gjendja është më pak e tensionuar në tri komunat jugore të rajonit, ku nuk ka iniciativa të veçanta që promovojnë dialogun ndëretnik të ndërmarrë nga komunat. Në komunat e Skenderajt/Srbica dhe Vushtrisë/Vučitrn, marrëdhëniet ndëretnike kufizohen tek raportet e domosdoshme ditore ndërmjet shqiptarëve të Kosovës dhe serbëve të Kosovës. Serbët e Kosovës rrallë vizitojnë zonat e populluara nga shumica shqiptare dhe kështu ka tejet pak ndërveprim mes komuniteteve. Kur vie tek ndërveprimi ndërmjet serbëve të Kosovës dhe romëve, të cilët banojnë kryesisht në Priluzje/Prelluzhë, kontaktet janë gjithashtu të kufizuara. Serbët e Kosovës angazhohen vetëm pjesërisht në forume komunale, si grupet punuese komunale të kthimit apo këshillat komunale të sigurisë në bashkësi, ku krijohen mundësitë për dialogun ndëretnik. Ata që marrin pjesë në forumet komunale për dialog zakonisht kanë marrëdhënie të mira, e nganjëherë dukshëm miqësore me përfaqësuesit tjerë të pranishëm të komuniteteve, duke përfshirë ato shqiptare, romë dhe ashkali. Pjesëmarrësi më i rregullt ka qenë përfaqësuesi i personave të zhvendosur nga fshatrat e Dalakut/Doljak dhe Shtitaricës/Stitarica në komunën e Vushtrisë/Vučitrn. Edhe pse shumë çështje mbeten duke ndikuar në arritshmërinë dhe qëndrueshmërinë e kthimit të mundshëm të pazgjidhura, vlera e mekanizmave për mundësimin e dialogut ndërmjet komuniteteve është theksuar. Komuna e Vushtrisë/Vučitrn ka vendosur një zyrtar për dialogun ndërmjet komuniteteve i cili funksionon brenda njësisë komunale për të drejtat e njeriut. Edhe pse nuk ka qenë aq proaktiv deri më sot, themelimi i një zyre të tillë është lëvizje në drejtimin e duhur.

Marrëdhëniet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera në ato komuna ku jetojnë në rajonin e Pejës/Peć janë tejet të ndryshme. Në komunën e Deçanit/Dečane, murgjit e Manastirit Ortodoks Serb të Deçanit dhe autoritetet komunale bashkëpunojnë për çështje të rëndësishme që prekin komunitetin lokal dhe Zonën e Mbrojtjes së Veçantë, si sigurimi i ujitjes për fshatrat shqiptare përmes Zonës së Mbrojtjes së Veçantë: ndërtimi i rrugës drejt Malit të Zi që kalon përmes Zonës së Mbrojtjes së Veçantë, si dhe ngritja e një muri tradicional të gurit përreth pronës së Manastirit. Komunikimi është zakonisht pak i dukshëm, joformal dhe i përzemërt. Kjo vlen edhe për të vetmen serbe të Kosovës që është kthyer të banojë në qytetin e Deçanit/Dečane, e cila shërben si asistente për drejtorin e zyrës komunale të komuniteteve. Ajo merr pjesë në komitetin e komuniteteve dhe ka ndërtuar raporte të mira me shumë femra nga komuniteti lokal shqiptar. Në komunën e Gjakovës/Đakovica, gjendja është më e keqe. Ka pasur pak iniciativa për mundësimin dhe kthimin e serbëve të Kosovës, si dhe nuk ka pasur kontakte ndërmjet

Më 2010, murgjit e Manastirit të Deçanit në rajonin e Pejës/Peć kanë vazhduar të ndjekin mësimet e gjuhës shqipe të financuara nga OSBE-ja në kuadër të një projekti me synim rritjen e dialogut mes komuniteteve.

TREG I FREKUENTUAR NGA SHQIPTARËT E KOSOVËS NË AFËRSI TË KISHËS ORTODOKSE SVETI NIKOLA NË QYTETIN E GJILANIT/GNJILANE, KU BUJQIT SERBË TË KOSOVËS SHESIN PRODHIME NGA FSHATRRAT E AFËRTA.



katër femrave serbe të Kosovës që banojnë në Kishën Ortodokse të Virgjëreshës së Shenjtë dhe komunitetit shumicë. Në komunën e Istogut/Istok, serbët e Kosovës rregullisht vizitojnë qytetin në ditët e tregut, ku merren edhe me çështjet administrative komunale, duke ndërrvepruar haptazi me shqiptarët e Kosovës dhe komunitetet tjera. Megjithatë, incidentet e mëvonshme të sigurisë me cak të kthyerit në Zallq/Žac kanë vështirësuar marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Kryetari i Klinës/Klina është shumë aktiv në mbështetjen e ndërtimit të besimit ndërmjet komuniteteve, duke bërë shpesh vizita në vendbanime serbe. Komuniteti mban kontakte të rregullta me fqinjët e tij, sidomos femrat serbe, të cilat bëjnë vizita tek shtëpitë e fqinjeve të tyre shqiptare dhe e kundërta. Në Komunën e Pejës/Peć, afrimi me komunitetin serb të Kosovës fokusohet në trajtimin e brengave të sigurisë, e jo në promovimin e dialogut dhe tolerancës ndërmjet komuniteteve. Gjatë zgjedhjeve komunale në nëntor të vitit 2009, disa vizita janë organizuar në lidhje me aktivitetin politik të kësaj kohe. Megjithatë, emërimi së fundmi i një zëvendës kryetari të veçantë për trajtimin e brengave të komunitetit serb të Kosovës ka pasur ndikim pozitiv në raportet e komuniteteve.

Asistentja serbe e zyrtarit komunal të komuniteteve në komunën e Deçanit/Deçane është përkushtuar vetë ndaj mundësimin të një mjedisi paqësor dhe më pak konfrontues në qytet përmes iniciativave të dialogut ndëretnik dhe përmirësimit të standardeve të jetesës së gjithë komuniteteve.

Në rajonin e Prishtinës/Priştina, dialogu ndërmjet serbëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera kryesisht zë vend nën ombrellën e projekteve të mundshme apo të vazhdueshme të kthimit, si dhe mundësohet nga organet komunale që merren me çështjet e komuniteteve dhe kthimit. Zyrrat komunale të komuniteteve dhe forumet komunale, si grupet punuese për kthim dhe këshillat komunale për siguri në bashkësi, mbeten nyjet kryesore që promovojnë dialogun ndërmjet institucioneve dhe serbëve të Kosovës. Ndërveprimi ndërmjet shumicës dhe komunitetit serb të Kosovës është i ngrohtë dhe bashkëpunues. Iniciativat e shoqërisë civile që promëtojnë dialogun ndërmjet serbëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera janë: “Java e Kulturës”, ndërmarrë nga “Qendra për Paqe dhe Tolerancë” në Gračanica/Graçanicë, si dhe aktivitetet mediatike dhe tryezat e rumbullakëta të organizuara nga Qendra e Mediave në Čaglavica/Çagllavicë, një radio-program shumëetnik rinor i zbatuar nga “Komunikimi për Zhvillim Social” në Gračanica/Graçanicë, si dhe financuar nga UNICEF-i. Në rajonin e Prizrenit, raportet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe komuniteteve tjera mbeten të kënaqshme



NJË SHITËS SERB I KOSOVËS DHE FURNIZUESI I TIJ SHQIPTAR I KOSOVËS NË QYTETIN E PLEMETINIT/PLEMETINA TË KOMUNËS SË OBILIQIT/OBILIĆ (NË RAJONIN E PRISHTINËS/PRIŠTINA). NËPËR RAJONET E KOSOVËS KA SHUMË SHEMBUJ TË TILLË TË NDËRVEPRIMEVE TË PËRZEMËRTA MES SHQIPTARËVE DHE SERBËVE.

si dhe në përputhje me tolerancën shumëetnike që karakterizon rajonin. Edhe pse komuna e Prizrenit dhe Rahovecit/Orahovac në fund të vitit 2009 dhe në fillim të 2010 nuk kanë qenë aktive në organizimin e fushatave të afrimit me komunitetin serb të Kosovës, kryetarët e të dyja komunave rregullisht iu kanë drejtuar serbëve të Kosovës të zhvendosur gjatë seancave informuese të vizitave shko-e-shiko. Gjithashtu, në Suharekë/Suva Reka, ku nuk banon asnjë serb, por ka disa aktivitete të kthimit që kanë filluar të ndërmerren, kryetari ka qenë aktiv në biseda me ata që vizitojnë shtëpitë e tyre nga vendi ku janë zhvendosur. Në Rahovec/Orahovac, mekanizmi kryesor i dialogut komunal, grupi punues komunal për kthim, është duke funksionuar efektivisht me pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës. Shembujt e rinj pozitivë të bashkëpunimit janë: parashtrimi i një ankese të përbashkët tek komuna e Rahovecit/Orahovac nga Manastiri Ortodoks Serb i Zoqishtës/Zocište dhe banorët shqiptarë të Kosovës të fshatit për hapjen e një guroreje në afërsi të Manastirit. Edhe pse nuk ka pasur reagim ende nga komuna, ankesa e përbashkët ka përforcuar marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve. Pjesëmarrja e Kryepeshkopit Katolik të Prizrenit dhe disa priftërinjve katolikë në liturgjinë e Pashkëve të mbajtur në Kishën Ortodokse Serbe të Shën-Gjergjit në Prizren është gjithashtu një shembull i përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet komunitetit serb të Kosovës dhe komuniteteve tjera. Në përgjithësi, serbët e Kosovës marrin pjesë në mënyrë aktive në iniciativat në lidhje me promovimin e tolerancës dhe dialogut të komuniteteve të cilat organizohen ose nga komuna ose nga shoqëria civile në rajon.



Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit



Tabela1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti serb i Kosovës
Gjilan/Gnjilane	Ferizaj/Uroševac	Ferizaj/Uroševac, Bablak/Babljak, Plešina/Pleshinë, Srpski Babuš/Babush i Serbëve, Talinoc i Muhaxherëve/Muhadžer Talinovac
	Gjilan/Gnjilane	Gjilan/Gnjilane, Cernicë/Cernica, Donja Budriga/Budrikë e Poshtme, Livoç i Epërm/Gornji Livoç, Kmetoc/Kmetovce, Parteš/Partesh, Pasjane/Pasjan, Ponesh/Poneš, Šilovo/Shillovë
	Kamenicë/Kamenica	Berivojce/Berivojcë, Bosce/Boscë, Bratilovce/Bratilloç, Glogovce/Gillogoc, Gragjenik/Gradenik, Grizime/Grizimë, Ajnovce/Hajnoc, Kamenicë/Kamenica, Karaçevë e Epërme/Gornje Karacevo, Karaçevë e Poshtme/Donje Karacevo, Kololeç/Kolloleq, Kopërnice/Koprivnica, Koretin/Koretin, Kostadince/Kostadincë, Kranidell/Krajnidel, Kremenatë I/Kremenata I, Kremenatë II/Kremenata II, Krilevë/Kriljevo, Lajçiq/Lajcic, Leshtar/Lještar, Lisockë/Lisacka, Marocë/Marovce, Mešina/Meshinë, Moçare/Moçar, Muçivërc/Mucivrcë, Novosellë/Novo Selo, Petroc/Petrovce, Poliçkë/Policka, Qarakoc/Çarakovce, Rahovicë/Oraovica, Rogaçicë/Rogacica, Ruboc/Robovac, Sedllar/Sedlare, Shahiq/Šajic, Shipashnicë e Epërme/Gornja Šipašnica, Shipashnicë e Poshtme/Donja Šipašnica, Strelica/Strelicë, Strezoc/Strezovce, Svirçë/Svirce, Tërstenë/Trstena, Tirince/Tirincë, Topanicë/Toponica, Tugjec/Tudevce, Vaganesh/Vaganeš, Velegllavë e Epërme/Gornja Veljegllava, Velegllavë e Poshtme/Donja Veljegllava, Vriqec/Vrucevcë, Zajçec/Zajcevcë, Zhujë/Zuja.
	Viti/Vitina	Viti/Vitina, Bincë/Binaç
Mitrovicë / Mitrovica	Southern Mitrovicë / Mitrovica	Svinjarë/Svinjare
	Skenderaj/Srbica	Suvo Grlo/Syriganë, Banje/Bajë and Devič Monastery
	Vushtrri/Vučitrn	Gojbulja/Gojbulë, Priluzhje/Prelluzhë, Grace/Gracë dhe Banjskë/Banjska
Pejë/Peć	Deçan/Dečane	Deçan/Dečane dhe Manastiri i Deçani/ Visoki Dečani
	Istog/Istok	Suvi Lukavac/Llukafc i Thatë, Blagaçe/Bilagaqë, Cërkolez/Crkolez, Gorioç Manastiri Ortodoks Serb, lagja Llug/Ljug (Istog/Istok), Koš/Kosh, Osojan/Osojane, Shalinovicë/Šaljinovica, Srbobran/Srbobranë, Tuçep/Tučep, Kovragë/Kovrage Dragolevc i Eperm/Gornji Dragolevac, Zallq/Žac, Muzhevinë/Muževine dhe Polan/Poljane
	Klinë/Klina	Binxhë/Biça, Grapc/Grabac, Videjë/Vidanje, Dresnik/Drnsnik, Klinafc/Klinavac, Berkovë/Berkovo, Klinë/Klina, Leskoc/Leskovac Dolc/Dolac, Pogragjë/Pograde, Rudicë/Rudice.
	Pejë/Peć	Pejë/Peć, Belo Polje/Belopojë, Goraždevac/Gorazhdevc, Sigë/Siga, Brestovik/Brestovik, Lëvoshë/Ljevoša, Patriarkati i Pejës
	Gjakovë/Đakovica	Kisha e Shën Mërisë
Prishtinë/Priština	Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	Fushë Kosovë/Kosovo Polje, Kuzmin/Kuzmin dhe Bresje/Bresje
	Lipjan/Lipljan	Lipjan/Lipljan, Rubofc/Rabovce, Staro Gracko/Grackë e Vjeter, Novo Naselje/Lagja e Re
	Obiliq/Obilić	Obiliq/Obilić, Plemetin/Plementina, Babin Most/Baimoc, Crkvena Vodica/Caravodicë, Janjina Voda/Janina Voda dhe Miloshevë/Miloševë
	Prishtinë/ Priština	Prishtinë/Priština, Slivovo/Sllivovë, Donja Brnjica/Bërnice e Poshtme, Gornja Brnjica/Bërnice e Epërme, Devet Jugoviça/Nëntë Jugoviq dhe Lebane/Lebane
	Podujevë/Podujevo	Fshati Metergoc/Medregovac
Prizren	Prizren	Prizren, Novake/Novak, Sredska/Sredskë, Mušnikovo/Mushnikovë, Planjane/Pllanjan, Drajçici/Drajçiq, Smaç/Smaq, Gornje Selo/Gornjasellë, Bogoševce/Bogoshevc
	Rahovec/ Orahovac	Rahovec i Epërm/Gornji Orahovac, Velika Hoça/Hoçë e Madhe

Tabela2: Vlerësimi i numrit të popullsisë

Rajoni	Burimi	Numri gjithsej i popullsisë	Komuniteti	%
Gjilan/Gnjilane	Komuna Ferizaj/Uroševac			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981 ¹	81,372	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	113,668	8,314	7.3%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	160-170,000	70	0.04%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	160-170,000	70	0.04%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	160-170,000	70	0.04%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	160-170,000	60	0.036%
	Komuna Gjilan/Gnjilane			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	84,085	19,212	22.85%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	103,675	19,370	18.68%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	130,000	12,500	9.61%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	130,000	8,000	6.1%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	130,000	12,500	9.6%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	130,000	8,000	6.1%
	Komuna Kamenicë/Kamenica			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	4,8320	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	5,2152	12,762	24.48%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	49,000	4,500-5,000	-
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	49,000	5,000	10.2%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	63,000	10,710	17%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	49,000	5,000	10.2%
	Komuna Viti/Vitina			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	47,839	8,369	17%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	57,290	7,002	12%
3. Vlerësimi aktual i komunës	60,000	3,500	5.83%	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	60,000	3,500	5.83%	
5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	59,800	3,300	5.5%	
6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	57,000	300	0.52%	
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Mitrovicë/Mitrovica (southern part)			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	87,981	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	104,885	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	140,000	2	0.002%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	110,000	2	0.001%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	140,000	4	0.002%
	Komuna Skenderaj/Srbica			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	46,771	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	55,471	713	1.3%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	72,600	-	-
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	300	-
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	72,600	350	0.5%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	72,600	300	0.4%
	Komuna Vushtri/Vučitrn			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	65,512	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	80,644	5,222	6.4%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	103,000	-	-
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	3,500	-	
5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	102,600	4,000	3.9%	
6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	102,600	3,500	3.4%	
Pejë/Peç	Komuna Deçan/Deçane			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	40,640	2,500	6.1%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	49,000	-	-
	3. Vlerësimi aktual i komunës	-	-	-
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	60,000	40	0.06%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	4,000	40	0.1%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	35,000	46	0.1%

Pejë/Peć	Komuna Gjakovë/Đakovica			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	-	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	-	-	-
	3. Vlerësimi i komunës	150,800	6	0.004%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	150,000	4	0.0026%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	150,000	4	0.0026%
	Komuna Istog/Istok			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	50,104	7,736	15.4%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	57,261	5,968	10.4%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	56,000-64,000	766	1.4-1.2%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	50,000	400-850	0.8-1.7%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	56,000	800	1.4%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	56,000	1,300-1,700	2.32-3.03%
	Komuna Klinë/Klina			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	54,539	6,829	12.5%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	52,266	5,968	11.4%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	55,000-58,000	895	1.6%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	55,000	600	1.1%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	55,000	200-400	0.3-0.7%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	55,000	600	1.9%
	Komuna Pejë/Peć			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	111,071	7,995	7%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	127,796	7,815	6%
3. Vlerësimi aktual i komunës	150,000	1,000	0.6%	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	140,000	1,100	0.8%	
5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	170,000	850 ³	0.4%	
6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	140,000	1,000	0.7%	
Prishtinë/Prishtina	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	29,805	8,315	27.9%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	35,570	8,445	23.74 %
	3. Vlerësimi aktual i komunës	50,000	800	1.6%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	50,000	1,300	2.6%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	50,000	800	1.6%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	50,000	800-1,000	1.6-2%
	Komuna Lipjan/Lipljan			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	55,705	10,258	17.8%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	69,451	9,713	17.35%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	76,000	2,000	2.63%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	76,000	2,000-2,500	2.63-3%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	76,000	2,000	2.63%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	76,000	2,000	2.63%
	Komuna Obiliq/Obilić			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	26,595	5,797	21.8%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	31,627	5,490	17.35%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	31,810	4,150	13.04%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	30,000	3,500	11.66%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	30,000	3,400	11.33%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	30,000	3,000	10%
	Komuna Podujevë/Podujevo			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	75,437	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	92,946	1,118	1.2%
3. Vlerësimi aktual i komunës	130,000	7	0.005%	
4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	130,000	7	0.005%	
5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	130,000	-	-	
6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	130,000	7	0.005%	

Prishtinë/Priştina	Komuna Prishtinë/Priştina			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	148,656	26,264	17.7%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	199,654	26,893	13.4 %
	3. Vlerësimi aktual i komunës	500,000	2,000	0.4%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	500,000	2,500-3,000	0.6-0.75%
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	500,000	2,000-2,500	0.4-0.5%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	500,000	2,000-2,500	0.4-0.5%
Prizren	Komuna Prizren			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	134,526	12,139	9%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	178,723	10,911	6.1%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	196,616	234	0.12%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	185	-
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	240,000	160	0.6%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	240,000	185	0.07%
	Komuna Rahovec/Orahovac			
	1. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981	46,541	4,025	8.6%
	2. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1991	59,877	3,795	6.3%
	3. Vlerësimi aktual i komunës	73,700	1,400	1.8%
	4. Vlerësimi aktual i komuniteteve	-	-	-
	5. Vlerësimi nga Profili i Komunave, OSBE 2009	73,700	1,150	1.5%
	6. Vlerësimi aktual i Ekipeve të OSBE-së në terren	73,700	1,000	1.30%

3: Population Estimates by Category

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijë të moshës parashkollore (0-5)	Fëmijë që vijnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijë që nuk vijnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Moshë pune – të punësuar (16-65)	Moshë pune – të papunë (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë	
Gjilan/Gnjilane	Ferizaj/ Uroševac	Meshkuj				5	8	19		
		Femra				1	3	14		
		Gjithsej				6	11	33		
	Gjilan/ Gnjilane	Meshkuj	31	191						
		Femra	25	178						
		Gjithsej	56	369						
	Kamenicë/ Kamenica	Meshkuj								
		Femra								
		Gjithsej	193	866						
	Viti/Vitina	Meshkuj		12						
Femra			15							
Gjithsej			27							
Gjithsej në rajon		249	1,262							
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i sigurojë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.										
Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovicë/ Mitrovica (southern part)	Meshkuj					1			
		Femra					1			
	Skenderaj/ Srbica	Meshkuj								
		Femra								
		Gjithsej	35	40			35	170	25	
	Vushtrri/ Vuçitër	Meshkuj								
		Femra								
Gjithsej			400			300	2,800			
Gjithsej në rajon			475			335	2,972			
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i sigurojë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.										

Pejë/Peć	Deçan/ Deçani	Meshkuj				41		
		Femra			5			
		Gjithsej			5	41		
	Gjakovë/ Đakovica	Meshkuj						
		Femra				1	3	
		Gjithsej				1	3	
	Istog/ Istok	Meshkuj	8	23		2	40	120
		Femra	2	23			30	60
		Gjithsej	10	46		2	70	180
	Klinë/ Klina	Meshkuj	0	11				
		Femra	3	15				
		Gjithsej	3	26		50	400	70
	Pejë/Peć	Meshkuj	10	60		90	240	55
Femra		12	70		50	146	81	
Gjithsej		22	130		140	386	136	
Gjithsej në rajon		41	194		145	468	249	
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i sigurojë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.								
Pristinë/Priština	Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	Meshkuj	50	300		400	400	350
		Femra	50	300		200	600	350
		Gjithsej	100	600		600	1,000	700
	Lipjan/ Lipljan	Meshkuj	130	1,100		2,500	1,000	1,250
		Femra	130	1,100		800	3,500	1,250
		Gjithsej	260	2,200		3,300	4,500	2,500
	Obiliq/ Obilić	Meshkuj	100	250		200	400	500
		Femra	100	250		100	600	500
		Gjithsej	200	500		300	1,000	1,000
	Podujevë/ Podujevo	Meshkuj						4
		Femra						3
		Gjithsej						7
	Pristinë/ Priština	Meshkuj	750	1,250		2,000	2,000	3,500
Femra		750	1,250		1,000	3,000	3,500	
Gjithsej		1,500	2,500		3,000	5,000	7,000	
Gjithsej në rajon		2,060	5,800		7,200	11,500	11,207	
Koment: OSBE-ja nuk ka mundur t'i sigurojë të gjitha të dhënat përkatëse nga autoritetet.								
Prizren	Prizren	Meshkuj				6		
		Femra	1			4		
		Gjithsej	1			10	9	166
	Rahovec/ Orahovac	Meshkuj				59		
		Femra		25		44		
		Gjithsej	20	107		103	505 ³	261
	Gjithsej në rajon		21	107		113	514	427

Tabela4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.

Rajoni	Hisedarët kyçë të komunitetit
Gjilan/Gnjilane	Komuna Ferizaj/Uroševac
	1 SRS Srpska Radikalna Stranka (Partia Radikale Serbe) DS Demokratska Stranka (Partia Demokratike)
	2 Zoran Maksimović, zyra komunale për komunitete Ugrin Stefanović, anëtar i komitetit për komunitete Strukturat që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Nenad Petković, kryetar i komunës Ratko Sinadinović, nënkryetar i komunës
	3
	4 Sinjali radioteleviziv i kanaleve serbe nuk është i mirë.
	5 Ugrin Stefanović, udhëheqës serb i Kosovës, Bablak/Babljak Novica Jovanović, udhëheqës fshati, Srpski Babuš/Babush i Serbëve Milovan Jevtić, udhëheqës serb i Kosovës, Talinoc i Muhaxherëve/Muhadžer Talinovac Ati Živojin Kojić, prift ortodoks, famullia e të cilit mbulon Ferizajn/Uroševac. Gordana Ristić, Ferizaj/Uroševac, përfaqësuese e personave të zhvendosur brenda vendit
	6
	7
	Komuna Gjilan/Gnjilane
	1 SLS Samostalna Liberalna Stranka (Partia e Pavarur Liberale) SRS Srpska Radikalna Stranka (Partia Radikale Serbe) DSS Demokratska Stranka Srbije (Partia Demokratike e Serbisë) DS Demokratska Stranka (Partia Demokratike) G17 Plus NS Nova Srbija/Serbia e re SPS Socijalistička Partija Srbije (Partia Socialiste e Serbisë) Građanska inicijativa za evropsko Gnjilane, Šilovo/Shillovë (Nisma qytetare për Gjilanin evropian, Šilovo/Shillovë) Građanska inicijativa (Nisma qytetare, Pasjane/Pasjan)
	2 Milan Stojanović, këshilltar i posaçëm i kryetarit të komunës së Gjilanit/Gnjilane për çështjet e komuniteteve Miliwoje Živković, shëf i zyrës komunale për komunitete Strukturat që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Predrag Stojković, kryetar i komunës Mladen Mitrović, nënkryetar i komunës Milorad Todorović, kryetar i kuvendit Aleksandar Petrović, nënkryetar i kuvendit komunal Dragan Nikolić, koordinatori rajonal i Qendrës Koordinuese për Kosovë
	3
	4 TV Puls në Šilovo/Shillovë Radio Max në Šilovo/Shillovë Radio Laser në Pasjane/Pasjan
	5
	6 Predrag Stojković, kryetar i komunës së Gjilanit/Gnjilane, në bazë të zgjedhjeve të mbajtura më 11 maj 2008 Dragan Nikolić, shëf i komunës së Gjilanit/Gnjilane të drejtuar nga Serbia
	7
	Komuna Kamenicë/Kamenica
	1 SRS Srpska Radikalna Stranka (Partia Radikale Serbe) DSS Demokratska Stranka Srbije (Partia Demokratike e Serbisë) NS Nova Srbija/Serbia e re SPS Socijalistička Partija Srbije (Partia Socialiste e Serbisë) DS Demokratska Stranka (Partia Demokratike) G17 Plus
	2 Dragiša Savić, zëvendëskryesues i kuvendit komunal për komunitete Strukturat që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Boban Jevtić, kryetar i komunës Nebojša Simić, nënkryetar i komunës Vojislav Nojić, kryetar i kuvendit komunal Vojislav Veličković, nënkryetar i kuvendit komunal
	3 OJQ "Sveti Nikola" që merret me aktivitetet e kthimit dhe dialogut OJQ "Kosovka devojka", grup i gruas (nuk është edhe aq aktiv si më parë për shkak të sëmundjes së menaxheres së OJQ-së)
	4 Radio Kamenica, radio stacion shumetnik që transmeton programe në tri gjuhë: shqipe, serbe dhe gjuhën rome. Nuk ka media të shkruara të serbëve të Kosovës edhe pse gazetat e Serbisë janë në dispozicion.
	5
	6
	7

Gjilan/Gnjilane	Komuna Viti/Vitina	
	1	SRS Srpska Radikalna Stranka/Partia Radikale Serbe DSS Demokratska Stranka Srbije/Partia Demokratike e Serbisë Nisma qytetare "Vidovdan" DS Demokratska Stranka/Partia Demokratike) Partia Liberale – që mori pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2009
	2	Institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Srecko Spasić, kryetar i komunës ("Vidovdan") Dejan Moskić, nënkryetar i komunës (Partia Demokratike Serbe)
	3	
	4	Nuk ka media të shkruara dhe të transmetuara në komunë për komunitetin serb. Megjithatë banorët serbë të Kosovës mund të shikojnë disa kanale të Serbisë, përfshirë RTS 1 dhe TV Puls nga Šilovo/Shillova dhe Radio Klokot/Kllokot. Në përgjithësi, pjesëtarët e këtij komuniteti besojnë se janë të informuar mirë për çështjet globale dhe ato të nivelit më të lartë, por shumë pak të informuar për zhvillimet lokale për shkak të mungesës së mediave lokale në gjuhën e tyre në komunën e Vitisë/Vitina.
	5	Zoran Marinkovic, përfaqësues i fshatit Bincë/Binac dhe ish punonjës i zyrës komunale për komunitete në Vrbovac/Vërbovc.
	6	
	7	
Mitrovicë /Mitrovica	Komuna Mitrovicë/Mitrovica	
	1	
	2	Snežana Nestorović, zyrtare komunale për komunitete
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	
	Komuna Skenderaj/Srbica	
	1	Nisma qytetare "Složno za Srbicu"
	2	Nedeljko Kovačević, shef i zyrës komunale për komunitete Milutin Kovačević, kryesues i komitetit për komunitete dhe koordinator komunal për personat e zhvendosur. Institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Dejan Tomašević, kryetar i komunës Ljubiša Jokić, nënkryetar i komunës Vasilije Tomašević, kryetar i kuvendit komunal Rade Kovačević, nënkryetar i kuvendit komunal
	3	OJQ "Jovanka" e udhëhequr nga Jovanka Tomašević,
	4	Radio Stacioni në Suvo Grlo/Syrganë "Tri srca" nuk është duke funksionuar për momentin
	5	Nedeljko Kovačević, shef i zyrës komunale për komunitete Milutin Kovačević, kryesues i komitetit për komunitete
	6	
	7	
	Komuna Vushtrri/Vučitrn	
	1	Srpska Radikalna Stranka/Partia Radikale Serbe Partia Demokratike e Serbisë Partia Liberale Serbe
	2	Bojana Artonović, shef i zyrës komunale për komunitete Andrijana Dišić, kryesuese e komitetit për komunitete Institucionet që kanë dal nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Zoran Rakić, kryetar i komunës dhe person kontaktues i Ministrisë për Kosovë dhe Metohi (Partia Radikale Serbe) Goran Lazić, nënkryetar i kuvendit komunal (Partia Demokratike Serbe) Miodrag Stolić, nënkryetar i komunës Stojadin Tomić, kryetar i kuvendit komunal (Partia Liberale Serbe)
	3	OJQ "Duga" Bojana Artonović, Priluzje/Prelluzhë, përqendrohet në aktivitetet rinore. OJQ "Kameni Most" Aleksandar Stojanović, që merret me aktivitete për kthim në komunat Vushtrri/Vučitrn dhe Mitrovicë/Mitrovica OJQ "Luna", Stana Kovačević, Priluzje/Prelluzhë, që merret me aktivitete për gratë OJQ "Korak Napred", Danica Vukmirović, Grace/Gracë, që merret me aktivitete për gratë
	4	Radio Station "MIX", operates and is managed by NGO "Duga" in Priluzje/Prelluzhë
	5	Saša Andrić, udhëheqës i këshillit të fshatit Priluzje/Prelluzhë Radovan Petrović, udhëheqës i fshatit Grace/Gracë Boban Ristic, banor i Grace/Gracës, që punon në zyrën komunale për komunitet në Priluzje/Prelluzhë Goran Dancetović, udhëheqës i fshatit Banjskë/Banjska

Pejë/Peć	6	
	7	
	Komuna Deçan/Dečane	
	1	DSS, Demokratska Stranka Srbije/Partia Demokratike e Serbisë, Zoran Barović
	2	Vesna Spalević, asistent në zyrën komunale për komunitete
	3	NGO "JETA", përqendrohet në çështjet e grave në fushën e arsimit, shëndetësisë, punësimit dhe pjesëmarrjes publike.
	4	
	5	
	6	
	7	
	Komuna Gjakovë/Đakovica	
	1	
	2	
	3	
	4	
	5	
	6	
	7	
	Komuna Istog/Istok	
	1	SRS Srpska Radikalna Stranka (Partia Radikale Serbe) DSS Demokratska Stranka Srbije (Partia Demokratike e Serbisë) SPS Socijalistička Partija Srbije (Partia Socialiste e Serbisë) DS Demokratska Stranka (Partia Demokratike)
	2	Vesna Maliković, nën-zyra komunale për komunitete në Osojane/Osojane Obrad Tijanić, nën-zyra komunale për komunitete në Cerkoz/Črkolez Institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Dragoljub Repanović, kryetar i komunës Ranko Vuletić, kryesues i kuvendit komunal
	3	OJQ "Božur" nga Kraljeva ka qenë aktive në të kaluarën në fushën e kthimit dhe të projekteve për gjenerimin e të ardhurave. OJQ "Agrofokus" që merrte me ndihma bujqësore, humanitare dhe projekte tjera.
	4	Asnjë media serbe e Kosovës nuk është në dispozicion në komunën e Istogut/Istok. Pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës kanë kërkuar të kenë një radiostacion në gjuhën serbe në fshatin Osojan/Osojane dhe e kanë dorëzuar kërkesën për frekuencë në Komisionin e Pavarur për Media. Deri më sot, nuk është dhënë asnjë përgjigje.
	5	Vesna Maliković, nën-zyra komunale për komunitete në Osojan/Osojane dhe udhëheqëse e fshatit Srbobran. Dobrivoje Radovanović, komiteti komunal për komunitete Mališa Đurić, shef i Zyrës për Punësim të Serbisë, dega në Osojan/Osojane
	6	
	7	
	Komuna Klinë/Klina	
	1	SPS Socijalistička Partija Srbije (Partia Socialiste e Serbisë) Metohija DSS Demokratska Stranka Srbije (Partia Demokratike e Serbisë) DS Demokratska Stranka (Partia Demokratike)
	2	Milorad Šarković, shef i zyrës komunale për komunitete Ranko Kostić, zyrtar komunal për komunitete
	3	Kryqi i Kuq Serb siguron ndihma në artikuj dhe ndihmë për të kthyerit; organizon ekskursione dhe pushime për fëmijët e personave të kthyer. Kooperative bujqësore "Brazda", Videjë/Vidanje Kooperative bujqësore "Razvoj Drsnika", Dresnik/Drnsnik
	4	
	5	Banjac Andrea, Berkovë/Berkovo, udhëheqës fshati Dončić Igor, Binxhë/Biça, udhëheqës fshati Sjarković Božidar, Dolac/Dolac, udhëheqës fshati Čekerić Mihailo, Dresnik/Drnsnik, udhëheqës fshati Magić Radonja, Grapc/Grabac, udhëheqës fshati Krašić Đorđe, Grebniç/Grebniç, udhëheqës fshati Vučićević Lazar, Klinafç/Klinavac, udhëheqës fshati Mikić Radomir, Klinë/Klina, udhëheqës fshati Veljo Simić, Leskoc/Leskovac, udhëheqës fshati Janković Radovan, Petriq i Ultë/ Donji Petrić, udhëheqës fshati Cvetko Ivanović, Pogragjë/Pograde, udhëheqës fshati Vlasto Marusić, Shtupel/Štupelj, udhëheqës fshati Milorad Šarković, Videjë/Vidanje, udhëheqës fshati
6		
7		

Pejë/Peć	Komuna Pejë/Peć	
	1	SPS Socijalistička Partija Srbije(Partia Socialiste e Serbisë) DS Demokratska Stranka(Partia Demokratike) Koalicioni DSS Demokratska Stranka Srbije/Partia Demokratike e Serbisë dhe NS Nova Srbija/Serbia e Re
	2	Drenko Todorovic nënkryetar i komunës për komunitete Slobodan Petrović, shef i nën-zyrës komunale për komunitete Institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Miloš Dimitrijević, kryetar i kuvendit komunal (DSS-NS)
	3	OJQ lokale NGO "Briga", përqendrohet në të drejtat e grave; OJQ lokale "Metohija" merret me çështjet rinore
	4	Radio Goraždevac Shpërndarja e rregulltë e gazetës javore "Jedinstvo" në gjuhën serbe, që shtypet në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica
	5	Momcilo Savić, udhëheqës fshati në Belo Polje Miodrag Dašić, udhëheqës fshati në Brestovik dhe anëtar i komisionit për komunitete Grujo Jasović, udhëheqës fshati në Siga/Sigë Ranko Bakić, udhëheqës fshati në Levoshë/Ljevoša Rodavan Prascević, Pejë/Peć Milija Lazović, Pejë/Peć
	6	
	7	
Prishtinë/Prishtina	Komuna Fushë Kosovë/Kosovo Polje	
	1	SLS Samostalna Liberalna Stranka (Partia e Pavarur Liberale) SNS Srpska Narodna Stranka(Partia Popullore Serbe) SRS Srpska Radikalna Stranka(Partia Radikale Serbe) DS Demokratska Stranka(Partia Demokratike) SPS Socijalistička Partija Srbije(Partia Socialiste Serbe) G17 Plus PSS Pokret Snaga Srbije (Lëvizja "Fuqia e Serbisë") NS Nova Srbija (Serbia e Re)
	2	Sladana Lazić, shef i zyrës komunale për komunitete Zoran Kitić, zyrtar komunal për komunitete dhe kthim Tomislav Danić, nën-zyra komunale për kthim Radomir Mitrović, shërbyes civil komunal Institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Stevica Lazić, kryetare e komunës së Fushës Kosovë/Kosovo Polje.
	3	OJQ "Ruka Ruci", Nevenka Rikalo, që merret me barazinë gjinore/çështjet e gruas
	4	
	5	Milan Đekić, udhëheqës serb i Kosovës në Fushë Kosovë/Kosovo Polje Stevica Lazić, udhëheqës i fshatit Bresje/Bresje dhe kryetar i komunës së Fushë Kosovës/Kosovo Polje në bazë të zgjedhjeve të 11 majit 2008. Saša Zivić, udhëheqës i fshatit Kuzmin
	6	Snežana Stojković, Drejtoreshë e shkollës "Aca Marović", Kuzmin/Kuzmin
	7	
	Komuna Lipjan/Lipljan	
	1	SDS KiM Srpska demokratska stranka Kosova i Metohije(Partia Demokratike Serbe e Kosovës dhe Metohisë) SNS Srpska Narodna Stranka (Partia Popullore Serbe) SRS Srpska Radikalna Stranka (Partia Radikale Serbe) DS Demokratska Stranka (Partia Demokratike) SPS Socijalistička Partija Srbije (Partia Socialiste e Serbisë) G17 Plus PSS Pokret Snaga Srbije (Lëvizja "Fuqia e Serbisë") NS Nova Srbija (Serbia e Re)
	2	Lidija Jovanović, shefe e zyrës komunale për komunitete
3	OJQ "HERC", ndihmë humanitare dhe arsimim, OJQ "Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Drejtat e Fëmijëve", që merret me të drejtat e njeriut OJQ "Biće bolje", punon me rininë	
4		

5	Slavko Janičijević, Lipjan/Lipljan Zoran Spasić, Rubovc/Rabovce Zoran Ćirković, Staro Gracko/Grackë e Vjetër Novica Nešić, Novo Naselje/Lagja e Re
6	
7	
Komuna Obiliq/Obilić	
1	SDS KiM Srpska demokratska stranka Kosova i Metohije (Partia Demokratike Serbe e Kosovës dhe Metohisë) SNS Srpska Narodna Stranka (Partia Popullore Serbe) SRS Srpska Radikalna Stranka (Partia Radikale Serbe) DS Demokratska Stranka (Partia Demokratike) SPS Socijalistička Partija Srbije (Partia Socialiste e Serbisë) G17 Plus PSS Pokret Snaga Srbije (Lëvizja “Fuqja e Serbisë”) NS Nova Srbija (Serbia e Re) Grupi qytetar Božur
2	Slaviša Ađančić, shef i zyrës komunale për komunitete Predrag Jović, nënkryetar për komunitete Institucionet që kanë dal nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Ljubiša Bosanac, kryetar i komunës (nga fshati Plemetinë/Plementina)
3	OJQ vendore ndëretnike “Komisioni për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete”; OJQ “Për një të nesërme më të mirë”, OJQ e grave në Plemetinë/Plementina dhe Babin Most/Babimoc.
4	
5	Ljubomir Jakovljevic, fshati Plemetin/Plementina Slavisa Adjancic, shef i zyrës komunale për komunitete dhe udhëheqës i fshatit Babin Most/Babimoc Dragisa Jovic, Ljubomir Djordjevic, Crkvena Vodica/Caravodicë Radanovic Jasmina, Obiliq/Obilić Jovan Spasić, Janjina Voda/Janina Voda
6	Stevan Marković, prift në fshatin Babin Most/Babimoc
7	
Komuna Podujevë/Podujevo	
1	
2	Milomir Jovanović, zyrtar komunal për kthim
3	
4	
5	Radisav Perović, udhëheqës i komunitetit, Metergoc/Medregovac
6	
7	
Komuna Prishtinë/Priština	
1	
2	Radoljub Popović, ushtrues detyre i zyrës komunale për komunitete në Graçanicë/Gračanica Slavica Stolić, zyrtar komunal për kthim dhe kryesues i komisionit për komunitete. Institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Zvonimir Stević, Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë për Kosovë dhe Metohi Nebojša Nikolić, kryetar i komunës së Prishtinës/Priština
3	Centar za mir i toleranciju/Qendra për Paqe dhe Tolerancë (QPT)
4	“Građanski Glasnik” (Prishtinë/Priština, pronë e KOHA Media Grup)
5	Pavić Ljubinko, Slivovo/Sllivovë Đošić Branislav, Miličević Dragan., Donja Brnjica/Bërnice e Poshtme Đorđević Dragi, Gornja Brnjica/Bërnice e Epërme Vukadinović Miroslav, Devet Jugovića/Nëntë Jugoviç Tabaković Miloš, Lebane/Lebanë Rada Trajković, Drejtoreshë e Shtëpisë së Shëndetit në Graçanicë/Gračanica Randel Nojkić, Drejtor i Postës dhe Telekomunikacionit Stojan Sekulić, Drejtor i Spitalit KBC në Graçanicë/Gračanica Dragan Velić, Shef i Komisarariatit Serb për Refugjatë
6	Udhëheqësit fetar: Amfilohija Metropolitan, administrator i Dioqezës Rashkë-Prizren, Peshkopi Teodosije i Lipjanit
7	

Prizren	Komuna Prizren dhe Rahovec/Orahovac	
	1	DSS, Demokratska Stranka Srbije (Partia Demokratike e Serbisë) DS, Demokratska Stranka (Partia Demokratike) SPS Socijalistička Partija Srbije/Partia Socialiste e Serbisë , Rahovec/Orahovac
	2	Slaviša Kolašinac, shef i zyrës komunale për komunitete në komunën e Rahovecit/Orahovac. Spasa Andrijević, zyra komunale për komunitete në Prizren, përgjegjës për pjesëtarët e komunitetit serb në qytetin e Prizrenit dhe fshatrat Novake/Novak dhe Smaq/Smaç. Danka Kucani, zyra komunale për komunitete në Prizren, përgjegjëse për pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës në Luginën e Zhupës/Zhupa. Jovan Bojić, zyra komunale për komunitete në Rahovec/Orahovac, përgjegjës për Velika Hoča/Hoce e Madhe. Bojan Nakalamić, nënkryetar për komunitete (pritet të emërohet). Institucionet që kanë dalë nga zgjedhjet e mbajtura më 11 maj 2008: Miodrag Lazić, kryetar i Prizrenit, Partia Demokratike e Serbisë Marijan Šarić, kryetar i Rahovecit/Orahovac, Partia Demokratike Milorad Šorić, anëtar i SPS
	3	Zlatko Mavrić, “Sveti Spas” Shoqata e personave të zhvendosur brenda vendit në Prizren, me selinë kryesore në Beograd. Tatjana Kolašinac, OJQ “Moderna Žena” (grup i gruas) Rahovec/Orahovac Vesna Manitašević OJQ “Jefimija” (grup i gruas) Rahovec/Orahovac Rodoljub Grković, Qendra Rinore Schuler Helfen Leben, Rahovec i Epërm/Gornj Orahovac
	4	Kryesisht media në gjuhën serbe, nëpërmjet media të shkruara dhe të transmetuara dhe TV kabllor.
	5	Ati Mihajlo Tošić, Kisha Ortodokse Serbe, Prizren Ati Aleksandar Našpalic, Kisha Ortodokse Serbe – përgjegjës për Prizren dhe Suharekë/Suva Reka Ati Milenko, Kisha Ortodokse Serbe – përgjegjës për Velika Hoča/Hoce e Madhe, Rahovec/Orahovac Branko Gligorijević, udhëheqës i fshatit Novakë/Novak, Prizren Tomislav Tomić, udhëheqës i fshatit Drajcici/Drajciq, Prizren Veselin Todorović, udhëheqës i fshatit Mušnikovo/Mushnikovë, Prizren Slobodan Vučković, udhëheqës i fshatit Gornje Selo/Gornjaselle, Prizren
	6	
	7	

1 Nuk ka të dhëna të sakta nga regjistrimi i popullsisë i vitit 1981 për komunën e Ferizajt/Uroševac. Në atë kohë, Ferizaj/Uroševac dhe Štrpcë/Shtërpçë kanë qenë një komunë e vetme.

2 Vlerësimet janë të siguruara vetëm për Goraždevac/Gorazhdevcin

3 Nga ky numër, 111 janë të regjistruar si të papunë.



Profili i Komunitetit TURQIT E KOSOVËS

Shtojca

Vendbanimet e popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Hisedarët kyçë të komunitetit



Historiku

Komuniteti turk i Kosovës¹ ka qenë i pranishëm në Kosovë me shekuj dhe ka pasur ndikim të rëndësishëm, duke kontribuar në masë të konsiderueshme në larminë kulturore dhe fetare të Kosovës. Gjatë kohës së Perandorisë Osmane, komuniteti gëzonte një status relativisht të privilegjuar. Në fillim të shekullit të 20-të, turqishtja konsiderohej të ishte gjuha e elitës urbane në Kosovë dhe shumë shqiptarë të Kosovës vazhdojnë ta flasin atë edhe sot. Megjithatë, gjatë gjithë shekullit të 20-të, me rënien e ndikimit të Perandorisë Osmane, ra edhe perceptimi lokal i statusit të privilegjuar të turqve të Kosovës. Komuniteti turk në Kosovë nuk gëzonte njohje të veçantë ligjore midis viteve 1912 dhe 1951, kur ata përfitonin arsim në gjuhën turke. Kushtetuta e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë e vitit 1974 i dha disa të drejta socio-politike dhe kulturore këtij komuniteti. Turqit e Kosovës janë integruar mirë në shoqërinë e Kosovës, ku ndajnë shumë tipare kulturore dhe sociale, duke përfshirë besimin mysliman, me shumicën dërrmuese të popullsisë shqiptare të Kosovës. Prania e martesave mes komuniteteve është e lartë. Rreth 30.000 turq të Kosovës jetojnë në Kosovën e sotme, ndërsa deri në 250.000 njerëz nga komunitete të ndryshme të Kosovës flasin, ose të paktën kuptojnë gjuhën turke. Shumë shqiptarë të Kosovës flasin ose të paktën kuptojnë gjuhën turke, ndërsa shumica e turqve në Kosovë janë në gjendje të komunikojnë në gjuhën shqipe dhe serbe. Komuniteti ka kontribuar në masë të konsiderueshme në tolerancën dhe dialogun shumëtnik në Kosovë.

Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti turk i Kosovës banon kryesisht në qytetin e Gjilanit dhe në fshatrat Livoç i Epërm/Gornji Livoc dhe Dobërçan/Dobrčane, me rreth 0,9-1,1% të popullatës së përgjithshme të komunës. Komuniteti turk në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica është integruar mirë në Komunat me shumicë shqiptare në Vushtrri/Vučitrn dhe Mitrovicën/Mitrovica jugore. Në Vushtrri/Vučitrn ata përbëjnë 0,9% të popullsisë së përgjithshme, dhe në pjesën veriore dhe jugore të Mitrovicës/Mitrovica arrijnë në rreth 1,5% të popullsisë së përgjithshme. Në pjesën jugore të qytetit, turqit e Kosovës jetojnë të shpërndarë në qytet, ndërsa ata që jetojnë në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica banojnë në “Mëhallën e Boshnjakëve”, ku ndajnë çështjet dhe shqetësimet e ngjashme të sigurisë dhe lirisë së lëvizjes me të cilat ballafaqohen komunitetet tjera jo-serbe. Në Vushtrri/Vučitrn, turqit e Kosovës jetojnë të shpërndarë në të gjithë zonat urbane së bashku me shqiptarët. Në rajonin e Prishtinës/Priština, turqit e Kosovës jetojnë në mesin e popullatës shumicë shqiptare të Kosovës dhe të marrin pjesë plotësisht në jetën publike. Ata janë të përqendruar në zona urbane të qytetit të Prishtinës/Priština, duke përbërë rreth 0,4% të popullsisë së përgjithshme Komunale, dhe në vendbanimet rurale të Janjevës/Janjevo² dhe Banullës/Bandulić në komunën e Lipjanit/Lipljan, ku përbëjnë deri në 0,5% të popullsisë. Shumica e turqve të Kosovës jetojnë në rajonin e Prizrenit, ku janë plotësisht të integruar në jetën publike. Në komunën e Prizrenit, ata përbëjnë afërsisht rreth 4%. Qyteti i Prizrenit mbetet qendra historike, kulturore dhe politike e komunitetit turk në Kosovë.

Çështjet kyçe të komunitetit:

- Cilësia e dobët dhe mungesa e përkthimeve të librave shkollorë në gjuhën turke.

Turqit e Kosovës janë integruar mirë në shoqërinë e Kosovës, ku ndajnë shumë tipare kulturore dhe sociale, duke përfshirë besimin mysliman, me shumicën dërrmuese të popullsisë shqiptare të Kosovës.

Turqit e Kosovës përbëjnë shumicën në Komunën e Mamuşa/Mamushës/Mamuša, ku jetojnë bashkë me shqiptarët dhe romët e Kosovës.

Gjuha turke është shpallur gjuhë zyrtare në Komunat e Prizrenit dhe Vushtrrisë/Vučitrn.

¹ I cili përbën edhe pasardhësit e turqve nga Perandoria Osmane, si dhe pasardhësit e popullsisë autoktone të cilët kanë marrë fenë myslimane dhe kulturën e gjuhën turke.

² Ku ata jetojnë së bashku me kroatët e Kosovës. Shih profilin e kroatëve të Kosovës.

“NAMAZGAHU” NË QYTETIN E PRIZRENIT, QË BANORËT E NJOHIN EDHE SI “XHAMIA E THYER” APO “KIRIK CAMII” PËR TA THEKSUAR MUNGESËN E KULMIT TË SAJ. OBJEKTI U NDËRTUA NË VITIN 1455 DHE ËSHTË PARAPARË PËR TA FALUR NAMAZIN NË GRUPE TË MËDHA.



1. Punësimi dhe gjendja sociale-ekonomike

Turqit e Kosovës tradicionalisht banojnë në zona urbane, ku aftësia e tyre për të folur shqipen dhe shkalla e lartë e integritit iu ka siguruar një situatë relativisht të mirë socio-ekonomike dhe qasje ndaj tregut të punës.

Situata socio-ekonomike dhe mundësitë e punësimit për komunitetin turk të Kosovës është relativisht e mirë. Shumë turq të Kosovës udhëheqin ndërmarrje të suksesshme private, ndërsa një numër i konsiderueshëm sish janë të punësuar në sektorin publik. Herë pas here, njohja e dobët e gjuhës shqipe ka çuar në papunësi dhe migrim. Shumica e turqve të Kosovës në rajonin e Gjilanit/Gnjilane janë të vetë-punësuar në shitore ose mësimdhënës të punësuar në sektorin publik. Ka një numër të kufizuar të turqve të Kosovës të punësuar në komunë. Dy turq të Kosovës punojnë në zyrën e regjistrimit Komuna I në Gjilan / Gnjilane dhe fshatin Dobërçan/Dobërçane, ndërsa dy të tjerë të punojnë si shërbyes civil Komuna I në komunën e Gjilanit/Gnjilane. Ngjashëm me situatën e komuniteteve shumicë në Mitrovicë/Mitrovica, turqit e Kosovës vuajnë nga papunësia dhe jetojnë në kushte të vështira socio-ekonomike. Komuniteti ka banuar tradicionalisht në zonat urbane, prandaj ata nuk marrin pjesë në ato pak mundësi ekonomike që janë në dispozicion në sferën e bujqësisë në zonat rurale. Ata janë të angazhuar në vend në biznese të vogla dhe si tregtarë. Kështu ndodh edhe në Vushtrri/Vučitrn. Komuna është kryesisht e orientuar kah bujqësia me pak zhvillime tjera ekonomike. Turqit e Kosovës janë të angazhuar kryesisht në ndërmarrje të vogla, të tilla si dyqane në pronësi të familjes dhe restorante. Vushtrria/Vučitrn së voni është binjakëzuar me një komunë në Turqi me qëllimin e përfitimit ekonomik të Vushtrrisë/Vučitrn, si në investime të huaja dhe lidhje të tjera korporative. Deri më tani, kanë dalë përfitime të kufizuara financiare nga binjakëzimi, me disa vizita të zyrtarëve të lartë, dhe disa përmirësime të objekteve të trashëgimisë kulturore.

Në rajonin e Prishtinës/Priştina, gjendja e përgjithshme socio-ekonomike e komunitetit turk në Kosovë është stabile, pa ndonjë mangësi të rëndësishme. Përfaqësuesit e komunitetit janë të punësuar çoftë në institucione publike, organizata ndërkombëtare, ose kryejnë aktivitete të vogla dhe të mesme tregtare. Në rajon, ka 57 nëpunës civil turq të Kosovës, nga të cilët 13 janë Femra. Si

edhe në rajone të tjera, turqit e Kosovës jetojnë në zonat urbane të Prizrenit. Shumica punojnë në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ndërsa një numër punojnë në shërbimin civil Komuna I dhe sektorët e shëndetësisë. Në komunën e Prizrenit, janë aktualisht 22 punonjës (që përfaqësojnë 7.6% të numrit të përgjithshëm) në kuadër të administratës Komuna Ie, 123 të punësuar (5,07%) në sektorin e shëndetësisë, si dhe 39 të punësuar (7,7%), në sektorin e arsimit. Nuk është bërë ndarja gjinore të këtyre pozitive. Megjithatë, papunësia në mesin e turqve të Kosovës mbetet e lartë. Sipas të dhënave të ofruara nga zyra rajonale e punësimit në Prizren, 1223 turq të Kosovës (nga të cilët 531 janë Femra) nga rreth 10.000 që jetojnë në komunë dhe janë regjistruar në këtë zyrë si persona të papunë dhe punëkërkuar. Megjithatë, besohet se numri real i të papunëve është shumë më i lartë, sepse nuk janë regjistruar të gjithë. Nëntëdhjetë familjet turke (76 nga Prizreni dhe 14 nga Mamuša /Mamusha/ Mamuša) marrin ndihmë sociale, prej 40 € deri në 80 € në muaj.

Zyra rajonale e punësimit në Prizren ka ofruar më herët kurse të aftësimi profesional dhe skema të sistemimit në punë në gjuhën turke. Qysh prej vitit 1999 kurset ofrohen në shqip. Megjithatë, 13 Femra dhe 8 meshkuj nga komuniteti kanë ndjekur kurse të tilla më 2009.

2. Siguria dhe liria e lëvizjes

Siguria dhe liria e lëvizjes së turqve të Kosovës janë përgjithësisht të mira, pa incidente madhore të sigurisë të raportuara nga ana e komunitetit. 89 turq të Kosovës shërbejnë në policinë e Kosovës, nga të cilët dhjetë janë gra. Ata përbëjnë përfaqësimin e katërt më të madh që përfaqësohet në polici, pas shqiptarëve serbëve dhe boshnjakëve të Kosovës. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, komuniteti është i integruar plotësisht në shoqëri dhe ata mund të përdorin të papenguar transportin privat dhe publik. Turqit e Kosovës janë të përfaqësuar mirë në policinë e Kosovës në rajon, me 15 oficerë meshkuj (ose 2,5% të totalit rajonal). Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, një turk përfaqëson komunitetin në këshillin Komuna I të sigurisë në bashkësi. Sipas përfaqësuesit turk, perceptimi për policinë e Kosovës në mesin e turqve e Kosovës në përgjithësi është pozitiv në rajonin e Gjilanit/Gnjilane. Turqit e Kosovës në Mitrovicë mund të lëvizin lirshëm në zonat ku serbët e Kosovës nuk përbëjnë shumicën. Incidentet e rregullta ndër-etnike të sigurisë në zonat etnike të përziera të Mitrovicës Veriore/Mitrovica, të tilla si hedhja e gurëve në automjete, rrahjet dhe zënkat mes grupeve të rinjve, rrallë synojnë në mënyrë të veçantë Turqit e Kosovës, por megjithatë ndikon negativisht në perceptimet e sigurisë së komunitetit. Ka pesë meshkuj turq të Kosovës që janë oficerë të policisë në Mitrovicë/Mitrovica. Njëri punon në stacionin e veriut të Mitrovicës/Mitrovica, një në stacionin jugor, dy në Njësinë e Hetimeve Rajonale, si dhe një në Njësinë e Trafikut Rajonal. Perceptimet e policisë së Kosovës janë pozitive në mesin e turqve të Kosovës, me ndërveprim të shpeshtë dhe pa ngurrim tek komuniteti për të raportuar incidente në polici. Një turk i Kosovës mban një ulëse në këshillin Komuna I të sigurisë në bashkësi në Vushtrri/Vučitrn, ndërsa në Mitrovicë/Mitrovica dhe Skenderaj/Srbica, ku banon komuniteti, këto organe nuk janë funksionale. Një përfaqësues turk gjithashtu merr pjesë në takimet e organizuara për sigurinë në bashkësi, nikoqir i të cilëve është Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë (UAM) në veri.

Dhjetë turke të Kosovës shërbejnë si oficerë të policisë së Kosovës.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti turk nuk provon ndonjë sfidë të konsiderueshme të sigurisë apo lirisë së lëvizjes. Komuniteti

përfaqësohet në këshillat Komuna lë të sigurisë në bashkësi në Prishtinë/Priština dhe Lipjan/Lipljan, si dhe në komitetin lokal të sigurisë publike në Janjevë/Janjevo (Komuna e Lipjanit/Lipljan). Megjithatë, këshilli lokal i sigurisë publike në Janjevë/Janjevo nuk është mbledhur rregullisht në vitin e kaluar. Janë katër turq të Kosovës që punojnë në Policinë e Kosovës. Turqit e Kosovës vazhdojnë të gëzojnë liri të papenguar të lëvizjes në rajonin e Prizrenit, ku ky komunitet është relativisht mirë i integruar. Ata shfrytëzojnë transportin publik dhe privat, derisa disa shfrytëzojnë edhe shërbimin humanitar të transportit që lidh fshatrat në luginën e Župa/Zhupës me qytetin e Prizrenit. 37 oficerë policie janë turq të Kosovës (prej të cilëve 32 meshkuj dhe 5 Femra) punojnë në shërbimin policor të rajonit të Prizrenit. Ky numër paraqet rënie me tre oficerë policie në krahasim me vitin e kaluar, për shkak të transfereve të brendshme të oficerëve në rajone tjera. Asnjë nga këta oficerë policorë turq të Kosovës nuk mban ndonjë pozitë të lartë në rajon.

3. Kthimi dhe riintegrimi

UNHCR raporton që mes viteve 2008 dhe 2010, 30 turq të Kosovës janë kthyer me dhunë në Kosovë.

Nga turqit e Kosovës që jetonin në Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Prishtinë/Priština dhe Prizren më 1999, nuk ka pasur raportime të konsiderueshme të migrimit për shkak të konfliktit. Iket që kanë ndodhur që prej vitit 1999 kanë qenë rezultat kryesisht i ekonomisë së dobët. UNHCR-ja raporton që mes viteve 2008 dhe 2010, 30 turq të Kosovës janë kthyer me dhunë në Kosovë.³ Megjithatë, çështjet e zhvendosjes, kthimit dhe riintegritit përgjithësisht nuk janë brengë për komunitetin turk në Kosovë. Në Gjilan/Gnjilane, ata turq të Kosovës që kanë lënë vendin para konfliktit janë kthyer në vitin 2000. Në veri të Mitrovicës/Mitrovica, disa turq të Kosovës kanë përjetuar vështirësi të ngjashme me ato që janë përjetuar nga shqiptarët në Kosovë në kuptimin e kthimit në shtëpitë e tyre pas konfliktit, për shkak të dëmtimit të pronave të tyre. Në disa raste, turqit e Kosovës përfundimisht kanë mundur të kthehen në shtëpi, në disa raste mbeten të zhvendosur, apo kanë shitur shtëpitë e tyre dhe janë vendosur tjetërkund. Në rajonin e Prishtinës/Priština, UNHCR raporton që ka një turk të zhvendosur brenda vendit që jeton atje.⁴

4. Institucionet dhe shërbimet e financuara nga Serbia

Turqit e Kosovës shfrytëzojnë më pak institucionet dhe shërbimet e udhëhequra nga Serbia, si dhe vendosin të shfrytëzojnë shërbimet dhe mundësitë e ofruara nga institucionet e Kosovës. Kjo ndodh kryesisht për shkak të nivelit të lartë të integritit të turqve të Kosovës me shoqërinë shqiptare në Kosovë. Megjithatë, në rajonin Gjilanit/Gnjilane, disa turq të Kosovës i qasen shërbimeve të ofruara nga institucionet e Republikës së Serbisë, si nxjerrja e dokumenteve identifikuese, pasaportave, shërbimeve shëndetësore dhe marrja pensione. Këta janë kryesisht turq të moshuar të Kosovës, të cilët kanë fituar këto të drejta duke punuar për kompani e institucione serbe para vitit 1999. Në përgjithësi, komuniteti mbështetet tek shërbimet e Kosovës.

³ Zyra e Shefit të Misionit, Komisioni i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), Pasqyrë statistikore versioni në fund të prillit 2010. [Për informim: Titulli zyrtar nuk përmend emrat, dhe vetëm thotë Prishtina një herë. Gjithashtu thotë si në fund të , dhe e kam ndryshuar këtë pjesë].

⁴ Po aty.

5. Qasja në shërbimeve Komuna le dhe publike

Turqit e Kosovës përgjithësisht gëzojnë qasje të plotë dhe të papenguar ndaj shërbimeve Komuna le dhe shërbimeve publike. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, ka sistem të furnizimit me ujë dhe kanalizim që është funksional në qytetin e Gjilanit/Gnjilane dhe në fshatin e Dobërçanit/Dobrčane. Në fshatin Livoç i Epërm/Gornji Livoç, njerëzit përdorin pusët dhe gropat septike. Nuk ka pasur raporte nga komuniteti për probleme me energjinë elektrike apo shërbimet e grumbullimit të mbeturinave në rajon. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, sidomos në komunën e Mitrovicës/Mitrovica dhe Vushtrisë/Vučitrn, turqishtja është miratuar si gjuhë zyrtare, gjë që lehtëson qasjen e komunitetit ndaj shërbimeve, pasi institucionet kanë obligim ligjor që të ofrojnë shërbime dhe mbështetje në gjuhën turke. Nuk ka pasur ankesa në këtë drejtim dhe nuk janë raportuar as praktika diskriminuese. Grumbullimi i mbeturinave dhe sistemet e kanalizimit janë brenga më e madhe për turqit e Kosovës që jetojnë në Janjevë/Janjevo, në rajonin e Prishtinës/Priština. Megjithatë, këto brenga nuk janë vetëm të komunitetit turk. Përfaqësuesi turk i ka dërguar disa kërkesa komunës së Lipjanit/Lipljan për të mbulur rrjedhën e hapur të ujit që përshkon fshatin. Rrjedha ujore përdoret si deponi nga banorët, si dhe bëhet kërcënim për shëndetin sidomos në periudhën e verës. Komuna nuk i ka trajtuar këto çështje deri tani. Turqit e Kosovës në rajonin e Prizrenit kanë qasje të plotë ndaj shërbimeve Komuna le dhe ndërmarrjeve publike, duke përfshirë shërbimet e regjistrimit civil. Edhe pse turqishtja është gjuhë zyrtare në komunën e Prizrenit, komuniteti ende ballafaqohet me probleme në marrjen e certifikatave civile apo dokumentacionit në gjuhën e tyre amtare.

6. Qasja në shërbime të mirëqenies sociale

Turqit e Kosovës gëzojnë qasje në shërbimet sociale dhe të mirëqenies në gjithë Kosovën. Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, sipas kriterëve të përgjithshme të mirëqenies sociale. Përveç kësaj, një numër i vogël i turqve të Kosovës që kanë punuar nëpër kompani të institucioneve shtetërore para konfliktit më 1999, marrin një “pagë mesatare” (të ashtuquajtur “minimalac”), që është një modalitet i mbështetjes për mirëqenie sociale nga Serbia për ish-punëtorët e kompanive dhe institucioneve shtetërore në Kosovë. Ndhima financiare është forma më e shpeshtë e ndihmës e dhënë për turqit e Kosovës, duke përfshirë ndihmën sociale dhe pensionet e pleqërisë. Në Mitrovicë/Mitrovica, komuniteti ka qasje në shërbimet e mirëqenies sociale në Mitrovicë/Mitrovica të jugut dhe Vushtri/Vučitrn pa brenga. Në rajonin e Prishtinës/Priština, numri i turqve të Kosovës që marrin mirëqenie sociale është i ulët. Për shembull, në komunën e Lipjanit/Lipljan, një përfaqësues i komunitetit ka theksuar që prej 400 turqve të Kosovës që banojnë në fshatin e Janjevës/Janjevo, katër familje marrin ndihmë sociale, derisa në komunën e Prishtinës/Priština, janë dhjetë familje që marrin ndihmë sociale. Në rajonin e Prizrenit, komuniteti ka qasje të papenguar në shërbime dhe mirëqenie sociale, ku janë 90 familje turke që përfitojnë aktualisht nga ndihma sociale.

7. Qasja në pronë dhe banim

Komuniteti turk i Kosovës gëzon qasje të papenguar në pronë dhe banim në rajonet e Gjilanit/Gnjilane dhe Prizrenit. Megjithatë, turqit e Kosovës të zhvendosur nga pjesa veriore tek ajo jugore e komunës së Mitrovicës/Mitrovica ndajnë të njëjtat pengesa me fqinjët e tyre shqiptarë në rikthimin e pronave të tyre. Në Prishtinë/Priština, disa turq të Kosovës pretendojnë të kenë “tapi” të vjetra si provë e pronësisë mbi pronat që janë “nacionalizuar” nga qeveria pas Luftës së II Botërore, si dhe shpresojnë t’i rikthejnë këto të drejta në të ardhmen. Çështja është ende në gjykatë.

8. Qasja në arsim

Mungesa e librave shkollorë në gjuhën turke ndikon negativisht në gëzimin e të drejtave për arsim nga ky komunitet.

Komuniteti turk në Kosovë ka qasje në arsimin fillor, të mesëm dhe të lartë në sistemin shkollor të Kosovës. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës ofron libra shkollorë pa pagesë në gjuhën turke për edukimin e detyrueshëm. Megjithatë, ka tekste që ende nuk janë në dispozicion, si dhe duhet të blihen privatisht nga prindërit në Turqi. Gjashtëmbëdhjetë nga 86 librat shkollorë për arsim fillor mbeten të pabotuara në gjuhën turke, derisa Ministria arsyetohet që i mungojnë mjetet financiare për botimin e tyre. Gjendja e arsimit të mesëm është shumë më e keqe, ku vetëm librat për Gjuhën dhe Letërsinë Turke për klasën 10 dhe 11, si dhe një libër shkollor për Artin Turk për klasën 11 janë në dispozicion. Kjo mungesë e librave shkollorë në gjuhën amtare ndikon negativisht në qasjen e komunitetit në mësim cilësorë në gjuhën turke. Oferta e arsimit të lartë në gjuhën turke është e kufizuar, derisa shumica e studentëve zgjedhin të udhëtojnë drejt Turqisë, ku janë diku 300 studentë turq të Kosovës të regjistruar. Gjithsejt 137 studentë turq të Kosovës vijojnë mësimet në gjuhën e tyre amtare në Fakultetin e Edukimit në Prizren, derisa edhe Universiteti i Prishtinës/Priština ofron lëndën e Gjuhës dhe Letërsisë Turke, aktualisht për 80 studentë. Turqit e Kosovës që zotërojnë gjuhën shqipe mund të aplikojnë edhe për vendet e rezervuara për këtë komunitet në Universitetin e Prishtinës/Priština.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, arsimi në gjuhën turke ofrohet në shkollat fillore në qytetin e Gjilanit/Gnjilane dhe fshatin Dobërçan/Dobrčane, si

NJË NXËNËS I SHKOLLËS FILLORE “HAÇI ÖMER LÛTFI” NË KOMUNËN MAMUŠA/MAMUSHË/MAMUŠA ME SHUMICË TURKE TË KOSOVËS SHFRYTËZON LIBRAT NË GJUHËN TURKE, DISA PREJ TË CILAVE I KA SIGURUAR MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË E KOSOVËS. TEKSTET TJERA MËSIMORE, QË NUK MUND TË GJENDEN NË KOSOVË, DUHET TË SIGUROHEN NGA TURQIA.



dhe në shkollën e mesme në qytetin e Gjilanit/Gnjilane, ku studentët mund të mësojnë edhe gjuhën shqipe. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, fëmijët turq të Kosovës marrin mësim në gjuhën amtare në shkollat fillore me shumicë shqiptare brenda qytetit, derisa për arsimin e mesëm, duhet të udhëtojnë në Prishtinë/Priština. Komunës së Vushtrrisë/Vuçitrn i mungon edhe arsimit fillor edhe ai i mesëm në gjuhën amtare të fëmijëve të komunitetit turk. Nëse prindërit nuk kanë mundësi të dërgojnë fëmijët e tyre në Turqi për edukim, ata i dërgojnë fëmijët në shkollat kosovare me shumicë shqiptare, për t'i përgatitur ata për regjistrim të mëvonshëm në universitetet e vendit.

Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti ka qasje në arsim në gjuhën turke në shkollën fillore "Elena Gjika" dhe shkollën e mesme "Sami Frasheri". Ekzistojnë edhe institucione private të arsimit që ofrojnë arsim fillor dhe të mesëm në gjuhën turke, shqipe dhe angleze, si "Shkolla Ndërkombëtare e Prishtinës (International School of Prishtinë)" dhe "Kolegji Mehmet Akif". Përgjithësisht, nxënësit turq të Kosovës vijojnë mësimet në gjuhën shqipe, brenda sistemit arsimor të Kosovës. Në Janjevë/Janjevo (Komuna e Lipjanit/Lipljan), KFOR-i ka financuar kurse të gjuhës turke dy herë në javë për nxënës të fillores në komunitet nga qershori i vitit 2009 deri në dhjetor 2009. kurset janë mbajtur në fshatin Janjevë/Janjevo në objektin e Partisë Demokratike të Turqve të Kosovës (KDTP), si dhe kanë përfunduar pa ndonjë iniciativë institucionale për t'i vazhduar ato. Në rajonin e Prizrenit, arsimi në gjuhën turke në gjitha nivelet ka qenë në dispozicion qysh prej vitit 1951. Aktualisht, arsimi në gjuhën turke ofrohet në arsimin parashkollor, në shtatë shkolla fillore (me gjithsej 1,853 nxënës), dhe pesë shkolla të mesme (me 767 studentë), në komunën e Prizrenit dhe Mamuşa/Mamushës/Mamuşa. Për më tepër, turqit e Kosovës janë të integruar mjaft mirë në sistemin arsimor të Kosovës.

9. Qasja në shërbime shëndetësore

Komuniteti turk gëzon qasje të plotë dhe të papenguar në shërbimet shëndetësore të ofruara nga Kosova, përkundër asaj që në disa rajone, si dhe në raste emergjence, ata i qasen edhe objekteve shëndetësore të udhëhequra nga Serbia. Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, shumica



NJË AUTOMJET I NDIHMËS SË SHPEJTË NË QYTETIN E MAMUŞA/MAMUSHËS/MAMUŞA. QASJA NË SHËRBIME SHËNDETËSORE NË KËTË KOMUNË ME SHUMICË TURKE TË KOSOVËS ËSHTË E MIRË, DUKE PASUR PËRKRAHJE SUBSTANCIALE NGA QEVERIA E TURQISË.

Synetitë grupore të turqve në Mitrovicë/Mitrovica dhe Vushtrri/Vučitrn ofrohen një herë në vit gjatë verës, financuar nga qeveria turke.

dërmuese e turqve të Kosovës i qasen shërbimeve shëndetësore të ofruara nga institucionet e Kosovës. Një numër i vogël i turqve të Kosovës shfrytëzojnë institucionet mjekësore të Republikës së Serbisë, kryesisht ata që marrin pensione nga Serbia, apo ata që presin shërbime më të mira mjekësore nga këto institucione. Në Mitrovicë/Mitrovica, komuniteti shfrytëzon shtëpinë e shëndetit në jug të Mitrovicës/Mitrovica dhe spitalin kryesor në Vushtrri/Vučitrn, derisa për raste më serioze ata shkojnë në spitalin qendror në Prishtinë/Priština. Në rajonin e Prishtinës/Priština, komuniteti turk qaset në shërbimet shëndetësore në objektet e udhëhequra nga sistemi i Kosovës. Në Lipjan/Lipljan, fshatin Janjevë/Janjevo, për shërbime primare shëndetësore, komuniteti shkon tek qendra e mjekësisë familjare në fshat. Për shërbime sekondare ata varen nga objektet shëndetësore të vendosura në Prishtinë/Priština. Komuniteti turk që jeton në Prishtinë/Priština i qaset shërbimeve shëndetësore të qytetit, derisa turqit të Kosovës të cilët janë më të pasur në Kosovë udhëtojnë në Turqi për të marrë shërbimet shëndetësore sekondare. Turqit e Kosovës në rajonin e Prizrenit gëzojnë qasje të plotë ndaj objekteve dhe shërbimeve shëndetësore në gjithë Kosovën, edhe pse komuniteti shpesh zgjedh të udhëtojë drejt Turqisë për trajtim të rasteve më serioze.

10. Qasja në drejtësi

Komuniteti turk gëzon qasje të plotë në gjykata Komuna le dhe të qarkut, si dhe shërbime juridike në rajone si në Gjilan/Gnjilane, Prishtinë/Priština dhe Prizren. Ata që banojnë në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica vazhdojnë të preken nga mbyllja e gjykatës në veri të Mitrovicës/Mitrovica në shkurt të vitit 2008. Vetëm rastet që kanë të bëjnë me paraburgim trajtohen në gjykatën e qarkut në Mitrovicë/Mitrovica, e cila aktualisht funksionon në lokalet e gjykatës Komuna le në Vushtrri/Vučitrn. Gjykata në veri të Mitrovicës/Mitrovica aktualisht trajton vetëm rastet penale që janë nën juridiksionin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX). Kjo situatë ndikon negativisht në qasjen e turqve të Kosovës dhe komuniteteve tjera në shërbimet gjyqësore dhe juridike. Në Gjilan/Gnjilane, nuk ka turq të Kosovës që shërbejnë si gjyqtarë apo prokurorë. Në rajonin e Prishtinës/Priština, një gjyqtar nga komuniteti turk shërben në gjykatën për kundërvajtje në qytet. Në komunën e Prizrenit, një gjyqtar turk shërben në gjykatën për kundërvajtje, ndërsa një tjetër në gjykatën e qarkut.

11. Pjesëmarrja në çështje publike

Komuniteti turk ushtron një ndikim të konsiderueshëm në punët publike, në nivelin qendror dhe atë lokal, duke pasur mbështetjen më të madhe nga rajoni i Prizrenit. Turqit Kosovës janë një prej komuniteteve më të integruara dhe të përfaqësuara në institucionet e Kosovës. Aktualisht, Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zëvendës Ministri i Komuniteteve dhe Kthimit, si dhe Zëvendës Ministri i Bujqësisë, janë pozita që i përkasin komunitetit turk. Përveç këtyre, KDTP-ja përfaqëson komunitetin me tre deputetë të zgjedhur në Kuvendin e Kosovës.⁵ Tre përfaqësues janë zgjedhur në këshillin konsultativ të komuniteteve, një organ këshillëdhënës që vepron nën ombrellën e Presidentit të Kosovës, derisa një gjyqtar turk vepron në

Komuniteti turk është i përfaqësuar mjaft mirë në institucionet e nivelit qendror dhe lokal.

5 Dy ulëse në Kuvendin e Kosovës janë të rezervuara për Komunitetin Turk të Kosovës.

Gjykatën Kushtetuese. Edhe pse komuniteti përfaqësohet në të gjitha Komuna t ku jeton, ekzistojnë pak iniciativa që nxisin pjesëmarrjen e këtij komuniteti në çështjet publike. Gratë turke janë relativisht mirë të përfaqësuar në legjislativ, duke mbajtur mbi 30 përqind të ulëseve për turqit e Kosovës në Kuvendin e Kosovës dhe kuvendet Komuna le, siç kërkohet me ligj për të inkurajuar drejtpeshimin gjinor në legjislativ. Megjithatë, ky nivel përfaqësimi nuk është i barabartë në degën e ekzekutivit dhe në shërbim civil.⁶ Radio-Televizioni i Kosovës shfaq lajme të përditshme dhe emisione javore në turqisht, derisa Radio Kosova transmeton programe në turqisht. Megjithatë, mediat lokale janë në dispozicion vetëm në rajonin e Prizrenit, si dhe deri në njëfarë masë në Gjilan/Gnjilane, ku radio-stacioni komercial lokal Victoria transmeton programe të përditshme dy-orëshe.

Në rajonin e Gjilanit/Gnjilane, KDTP-ja mban një ulëse në kuvendin Komuna I si rezultat i hyrjes në koalicion me një parti shqiptare, Partinë Demokratike të Kosovës (PDK). Komuniteti është i përfaqësuar edhe në komitetin e komuniteteve. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, KDTP-ja është aktive në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica dhe në komunën e Vushtrisë/Vučitrn, edhe pse zakonisht nuk sigurojnë vota të mjaftueshme për të fituar vende në kuvendet Komuna le. Komuniteti turk është gjithashtu shumë aktiv në jetën publike në dyja Komuna t, kryesisht në aktivitete kulturore. Në komunën e Mitrovicës/Mitrovica, komuniteti është i përfaqësuar në komitetin e komuniteteve dhe grupin punues Komuna I për kthim. Zëvendës Kryetari i Komunës për komunitete dhe zëvendës kryesuesja e Kuvendit janë turq të Kosovës. Në komunën e Vushtrisë/Vučitrn, një turk është pjesë e komitetit të komuniteteve, derisa tjetri në këshillin Komuna I të sigurisë në bashkësi. Komuniteti ka një vend edhe në kuvendin Komuna I. Turqit e Kosovës janë të përfaqësuar në komitetet për komunitete në dyja Komuna t ku jetojnë. Turqit e Kosovës në komunën e Prishtinës/Priatina janë komunitet relativisht i vogël, por me ndikim, duke mbajtur pozitën e zëvendës-kryesuesit për komunitete të Kuvendit Komuna I, një ulëse në Kuvendin Komuna I, si dhe përfaqësohen në komitetin për politikë e financa dhe atë të komuniteteve në komunë. Në komunën e Lipjanit/Lipljan, komuniteti ka shumë më pak ndikim, edhe pse përfaqësohet në komitetin e komuniteteve.

Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Zëvendës Ministri i Komuniteteve dhe Kthimit, si dhe Zëvendës Ministri i Bujqësisë, janë pozita që i përkasin komunitetit turk

Vushtrria/Vučitrn së voni është binjakëzuar me një komunë në Turqi, gjë që i ka siguruar përfitime më të mëdha publike për komunitetin turk dhe atë shumicë në Kosovë, si restaurimi i hamameve turke dhe kështjella e epokës osmane në komunë.



POP-ROK GRUPI I NJOHUR I TURQVE TË KOSOVËS "AY YILDIZLAR" NGA PRIZRENI, DUKE USHTRUAR.

⁶ In the community committees there are no Femra Kosovo Turk members and in the Kosovo Turk majority Komuna Mamua/Mamushë/Mamuaa they represent a mere 19 % of the civil service.

Rajoni i Prizrenit mbetet qendra e aktiviteteve politike të turqve të Kosovës. KDTP-ja ka zyrën e vet qendrore në qytetin e Prizrenit, derisa bazën e saj e merr nga Komuna me shumicë turke e Mamu_a/Mamushës/Mamuaa. Partia ka fituar tri ulëse në kuvendin Komuna I të Prizrenit, derisa një turk është i punësuar në drejtoratin e ekonomisë dhe financave, një tjetër punon në drejtoratin për emergjencë dhe siguri. Në total, turqit e Kosovës përbëjnë mbi shtatë përqind të shërbimit civil, me 17 meshkuj dhe katër Femra. Shoqëria civile turke në rajonin e Prizrenit është mjaft e organizuar dhe dinamike, me shumë organizata që implementojnë projekte e ndërmarrin aktivitete në fushën e kulturës dhe mbrojtjes së gjuhës, kulturës dhe traditave turke. Revistat në gjuhën turke botohen sporadikisht, kryesisht për shkak të mungesave financiare.

12. Përdorimi i gjuhës

Turqishtja ka fituar statusin e gjuhës zyrtare në komunën e Gjilanit/Gnjilane, Mitrovicës/Mitrovica, Vushtrrisë/Vučitrn dhe Prizren. Edhe pse simbolikisht e rëndësishme, problemet me përkthim vazhdojnë, duke penguar kështu gëzimin e të drejtave gjuhësore nga komuniteti.

Gjykata kushtetuese së voni ka vendosur në favor të një turku dhe boshnjaku të cilët kanë parashtruar një sfidë ligjore kundër komunës së Prizrenit për shkak të përjashtimit të gjuhëve dhe identiteteve të komuniteteve nga logoja e komunës.¹

Komuniteti përdor gjuhën turke në publik pa brenga. Edhe pse janë në pakicë në kuptim numri, gjuha turke ka fituar statusin e gjuhës në përdorim zyrtar, gjegjësisht në Gjilan/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Vushtri/Vučitrn dhe Prizren.⁷ Ligji për përdorimin e gjuhëve përcakton të drejtat gjuhësore të komuniteteve dhe obligimet e veçanta të Komuna ve. Kjo gjë përfshin obligimin për të siguruar përkthim verbal dhe me shkrim në gjuhën turke sipas kërkesës, që mbetet gjerësisht i papërmbyshur.

Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, gjuha turke është shpallur gjuhë në përdorim zyrtar në vitin 2007. Megjithatë, komuniteti vazhdon të përdorë gjuhën shqipe dhe/ose serbe për të komunikuar me zyrtarët Komuna le dhe për të pasur qasje në shërbime Komuna le, si dhe prapë iu duhet të kërkojnë përkthim me gojë apo me shkrim të dokumenteve sipas të drejtës. Megjithatë, Komuna t shpesh i shkruajnë gabim emrat dhe/ose mbiemrat e turqve të Kosovës në dokumente zyrtare, duke mos përdorur alfabetin turk. Kjo ka çuar në raste ku turqit janë dashur të vërtetojnë identitetin e tyre në gjykatë, duke bërë shpenzime. Në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica, turqishtja është gjuhë në përdorim zyrtar në komunën e Mitrovicës/Mitrovica dhe Vushtrrisë/Vučitrn. Megjithatë, asnjëra prej Komuna ve nuk ka kapacitete të mjaftueshme dhe efektive të përkthimit me shkrim dhe me gojë. Edhe pse komuniteti përdor lirisht gjuhën turke, edhe në sektorin publik dhe privat, shumica flasin shqip dhe përgjithësisht e përdorin këtë gjuhë për të komunikuar me popullsinë shumicë shqiptare. Shumica e turqve të Kosovës që jetojnë në Mitrovica/Mitrovicën veriore flasin edhe serbisht. Megjithatë, kjo nuk lehtëson lirinë e lëvizjes së tyre në lagjet me shumicë serbe.

Turqit e Kosovës janë të lirë të përdorin gjuhën e tyre në vende publike në rajonin e Prishtinës/Priatina, por të drejtat gjuhësore të komunitetit vazhdojnë të nënçmohen. Përkundër përpjekjeve në angazhim të përkthyesve të kualifikuar të gjuhës turke, Komuna e Prishtinës/Priatina mbetet pa kapacitete adekuate për të shërbyer popullsinë e saj turke. Kjo pengon pjesëmarrjen e komunitetit dhe ka çuar në ankesa nga zëvendës-kryesuesi për komunitete gjatë seancave të kuvendit të komunës. Në qershor të vitit 2009, komuniteti turk parashtroi një kërkesë zyrtare për njohjen e turqishtes si gjuhë në përdorim zyrtar në zyrën Komuna le në Lipjan/Lipljan. Komuna ende nuk është përgjigjur, edhe pse

7 Siç specifikohet në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve, Neni 2.4: në Komuna t e banuara nga një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është një prej gjuhëve zyrtare të Kosovës, si dhe i cili përbën mbi tre përqind të gjithë popullsisë së komunës, gjuha e komunitetit do të ketë statusin e gjuhës në përdorim zyrtar.

1 Për më shumë informata, duke përfshirë aktgjykimin e gjykatës kushtetuese në këtë kuptim, ju lutemi t i referoheni pjesës përdorimi i gjuhës në profilin e komunitetit boshnjak të Kosovës.

kërkohet me ligj që ta bëjë këtë. Që nga janari deri në prill të vitit 2010, në bashkëpunim me KFOR-in turk, Qendra Kulturore dhe Edukative e OJQ-së turke Bahar organizoi kurse të gjuhës për 16 nxënës të shkollës së mesme të cilët kanë shprehur dëshirën për t'u regjistruar në universitete të Turqisë.

Në komunën e Prizrenit, turqishtja është gjuhë zyrtare, por kjo gjuhë jo gjithmonë trajtohet barabartë në praktikë. Ekzistojnë disa probleme, si: moslëshimi i certifikatave civile dhe letërnjoftimeve në gjuhën turke, përkthimi i pamjaftueshëm apo joadekuat i dokumenteve Komuna le, si dhe mungesa e informatave në gjuhën turke në institucione publike, si shkolla dhe institucione shëndetësore. Megjithatë, shumica e shenjave në rrugë dhe titujt e zyrave rajonale të ministrive, si zyra rajonale e punësimit dhe Qendra për Punë Sociale, janë në të tri gjuhët.

13. Trashëgimia dhe liritë kulturore/fetare

Kontributi i komunitetit turk në larminë kulturore dhe fetare të Kosovës është i konsiderueshëm, si dhe kjo gjë reflektohet në trashëgiminë e pasur që është e pranishme në ato pjesë ku ky banon komuniteti. Në Gjilan/Gnjilane, lokacioni më i rëndësishëm historik dhe fetar është Xhamia Medresa, ndërtuar në fillim të shekullit të nëntëmbëdhjetë, si dhe toka përreth, në të cilën janë varrosur edhe imamët e rëndësishëm (udhëheqësit fetarë). Komuniteti mund të paraqesë dhe praktikojë lirisht besimet fetare dhe kulturore në pjesën më të madhe të komunës. Ka një numër lokacionesh historike me interes kulturor për komunitetin turk në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica. Këto përfshijnë hamamet turke dhe kështjella e epokës osmane në Vushtrri/Vučitrn si dhe hamamin e vjetër në qytetin e Mitrovicës/Mitrovica, në vendin e të cilit tani është muzeu i qytetit. Këto lokacione kanë histori që daton nga sundimi osman në rajon. Turqit e Kosovës kanë mundësi të praktikojnë lirisht fenë e tyre, si dhe të gëzojnë traditat e tyre në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica dhe Vushtrri/Vučitrn. Rajoni i Prishtinës/Priatina gjithashtu ka një numër lokacionesh të trashëgimisë fetare dhe kulturore me rëndësi për komunitetin turk, si Tyrbja e Sulltan Muratit I (Türbe) në Mazgit/Mazgit (Komuna e Obiliqit/Obilić), Xhamia e Llapit (Lap), Xhamia e Sulltan Mehmetit II al-Fatih, Hamami i Madh, Xhamia e Jashar Pashës, Tyrbja e Bajraktarit brenda Monumentit të Gazimestanit, Xhamia e Pazarit (xhamia e çarshisë), si dhe Xhamia Pirinaz, objekte këto që janë brenda qytetit të Prishtinës/Priatina. Komuniteti turk lirisht mund të shprehë dhe praktikojë besimet fetare dhe kulturore në gjithë rajonin. Prizreni ka qenë një prej qyteteve më të rëndësishme në Perandorinë Osmane, një kryeqytet tregtar me perspektivë të vilajetit të Kosovës, apo krahinës osmane. Kjo histori reflektohet në trashëgiminë e pasur kulturore dhe fetare në rajon, e cila tani gëzohet nga turqit e Kosovës dhe komunitetet turke në Kosovë. Disa nga vendet më të njohura dhe të rëndësishme të komunitetit turk janë Xhamia e Sinan Pashës, Hamami i Mehmet Pashës (Hamami i Madh), Xhamia e Mehmet Pashës, Sozi-Xhamia, Kukli Beg Xhamia, Teqja Kadri, Teqja Halvetije në Prizren, si dhe Sahat-Kulla në Mamuşa/Mamushë/Mamuša. Komuniteti ushtron lirisht të drejtat e veta kulturore dhe fetare.

Më 2009, turqit e Kosovës filluan të festojnë 23 prillin si festë zyrtare të komunitetit turk në Kosovë.



PAMJE NGA BRENDIA E HAMAMIT "GAZI MEHMET PASHA" NË QYTETIN E PRIZRENIT, I NDËRTUAR NË SHEKULLIN XVI.

14. Marrëdhëniet/dialogu ndërmjet komuniteteve

Në një përpjekje të distancimit nga konflikti mes shqiptarëve e serbëve, komuniteti turk në Mitrovicë/Mitrovica ka filluar të regjistrohet si turk, duke rritur numrat, në vend se të regjistrohen si shqiptarë, gjë që ka ndodhur shumë shpesh para vitit 1999.



SAHAT KULLA NË QYTETIN E MAMUŞA/
MAMUSHËS/MAMUŞA, E NDËRTUAR
NGA OTOMANËT NË VITIN 1815.

Komuniteti turk angazhohet në mënyrë aktive në dialogun formal dhe joformal dhe iniciativat e nxitjes së tolerancës në ato rajone ku ai banon. Turqit e Kosovës vazhdojnë të kenë raporte të mira me komunitetet tjera në Kosovë, e sidomos me shqiptarët, me të cilët ata ndajnë lidhje të fuqishme kulturore, fetare dhe historike. Raportet e turqve me serbët në Kosovë formësohen sipas afërsisë së tyre me komunitetin shqiptar si dhe sipas trashëgimisë historike. Në komunën e Gjilanit/Gnjilane, një turk përfaqëson komunitetin në një numër forumesh Komuna le që mundësojnë dialogun mes komuniteteve. Ai në mënyrë aktive promovon dialogun dhe tolerancën mes komuniteteve përmes iniciativave si kampi shumetnik veror më 2009, intervistat në media lokale (kanali rajonal televiziv i Gjilanit/Gnjilane dhe intervista në gazeta). Ai ndërmer aktivitete të vetëdijesimit në fshatrat e përziera të Livoçit të Epërm/ Gornji Livoć dhe Dobërçanit/Dobrčane. Fakti që turqit flasin gjuhën shqipe, derisa të tjerët edhe gjuhën serbe, e lehtëson ndërveprimin me shumicën e komuniteteve tjera në rajon. Marrëdhëniet e komunitetit me serbët janë të tendosura në veri të Mitrovica/ Mitrovicës. Në jug të Ibrit, turqit e Kosovës marrin pjesë aktivisht në forumet forMeshkuj të dialogut të organizuara nga Komuna t ku banojnë, si në komitetin e komuniteteve dhe grupet punuese Komuna le për kthim.

Në rajonin e Prishtinës/Priatina, komuniteti turk gjithashtu merr pjesë në forumet Komuna le të dialogut, derisa angazhohet në iniciativa të shoqërisë civile që promovojnë tolerancën kulturore dhe multi-etnike. Për shembull, në qershor të vitit 2010, Shoqata Kulturore “Gerçek” vuri në skenë shfaqje teatrale që afrojnë të rinjtë turq dhe shqiptarë të Kosovës duke ngritur vetëdijen kundër përdorimit të drogave. OJQ-ja e grave turke “Hanimeli” shpesh bashkon Femra të etnive të ndryshme në implementim të tryezave dhe aktiviteteve tjera. Në qershor të vitit 2010, ajo ka organizuar një trajnim për të Drejtat e Grave dhe barazinë gjinore, i cili bashkoi gra shqiptare, boshnjake dhe turke të rajonit. Qendra Kulturore dhe Edukative “Bahar”, më 23 prill 2010 organizoi një shfaqje teatrale për shënimin e festës zyrtare të komunitetit. Në rajonin e Prizrenit, ku komuniteti ende gëzon një rol të theksuar në jetën politike dhe kulturore, komuniteti promovon dhe angazhohet në ngjarje e aktivitetet shumë-kulturore. Shumë organizata jo-qeveritare e shoqata kulturore turke vazhdojnë të kenë rol kryesor në promovimin e larmisë dhe tolerancës në rajon. Për shembull, shoqatat kulturo-artistike “Doru Yol” dhe “Filizler”, Shoqata Kosovare e Mësimdhënësve Turq të Kosovës, Teatri Turk “Rumeli”, Shoqata e Grave Turke “Zübeyde Hanım”, si dhe Konservatori Muzikor Turk, promovojnë kulturë, edukimin dhe traditat turke përmes aktiviteteve kulturore që afrojnë edhe komunitetet tjera në rajon.

Shtojca

Tabela 1:

Vendbanimet e popullsisë

Tabela 2:

Vlerësimi i numrit të popullsisë

Tabela 3:

Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Tabela 4:

Hisedarët kyçë të komunitetit



Tabela 1: Vendbanimet e popullsisë

Rajoni	Komuna	Vendbanimet ku jeton komuniteti turk i Kosovës
Mitrovicë/Mitrovica	Mitrovicë/ Mitrovica	“Mëhalla e Boshnjakëve” në pjesën veriore të Mitrovicës/Mitrovica, si dhe pjesën jugore të Mitrovicë/ Mitrovica ¹
	Vushtrri/ Vuçitër	Qyteti i Vushtrrisë/Vuçitër ²
Gjilan/Gnjilane	Gjilan/ Gnjilane	Qyteti i Gjilanit/Gnjilane, fshatrat Livoç i Epërm/Gornji Livoç dhe Dobërçan/Dobrçane
Prishtinë/Priština	Lipjan/ Lipljan	Qyteti i Lipjanit/Lipljan, fshati Janjevë/Janjevo, si dhe një familje në fshatin Banullë/Bandulić.
	Prishtinë/ Priština	Qyteti i Prishtinës/Priština, shpërndarë brenda dhe përreth qytetit, jeton i integruar me komunitetet tjera (kryesisht shqiptarë) në zonat urbane të qytetit të Prishtinës/Priština.
Prizren	Prizren	Qyteti i Prizrenit

Tabela 2: Vlerësimi i numrit të popullsisë³

Rajoni	Burimi	Numri gjithsej i popullsisë	Komuniteti	%
Gjilan/Gnjilane	Komuna Gjilan/Gnjilane			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	84085	960	1.14
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	103675	854	0.82
	3. Vlerësimi i komunës	130,000	1,200-1,500	0.92-1.15%
	4. Vlerësimi i komuniteteve	130,000	1,200-1,500	0.92-1.15%
	5. Vlerësimi nga profilet e Komuna ve të OSBE-së, 2009	130,000	1,300	1%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	130000	1,200-1,500	0.92-1.15%
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Mitrovicë/Mitrovica			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 ⁴	87981	N/A	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	104885	431	0.4
	3. Vlerësimi i komunës	130000	2100 (jug) 162 (veri)	1.74
	4. Vlerësimi i komuniteteve	130000	2000 (jug) 130 (veri)	1.6
	5. OSCE Municipal Profile 2009 Estimations ⁵	110000 (jug) 20000 (veri)	1900 (jug) 100 (veri)	1.5
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	130000	1900 (jug) 100 (veri)	1.5
	Komuna Vushtri/Vuçitrn			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981 ⁶	65512	N/A	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	80644	68	0.1
	3. Vlerësimi i komunës	103000	890	0.9
	4. Vlerësimi i komuniteteve	103000	1000	1
	5. Vlerësimi nga profilet e Komuna ve të OSBE-së, 2009	102600	890	0.9
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	102600	890	0.9
Prishtinë/Priština	Komuna Prishtinë/Priština⁴			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	148656	1874	1.26
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	199654	1982	0.99
	3. Vlerësimi i komunës	500000	1100	0.22
	4. Vlerësimi i komuniteteve	500000	3500	0.7
	5. Vlerësimi nga profilet e Komuna ve të OSBE-së, 2009	500000	1100	0.22
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	500000	2000	0.4
	Komuna Lipjan/Lipljan			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	56940	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991	69451	5	1.007%
	3. Vlerësimi i komunës	76000	300	0.4%
	4. Vlerësimi i komuniteteve	76000	400	0.5%
	5. Vlerësimi nga profilet e Komuna ve të OSBE-së, 2009	76000	380	0.5%
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	76000	400	0.5%
Prizren	Komuna Prizren			
	1. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1981	134526	-	-
	2. Regjistrimi i popullsisë në vitin 1991 ⁷	175413	7227	4,
	3. Vlerësimi i komunës	240000	9038	3.7
	4. Vlerësimi i komuniteteve	250000	10000	4
	5. Vlerësimi nga profilet e Komuna ve të OSBE-së, 2009	240000	9038	3.7
	6. Vlerësimi aktual i ekipeve për komunitete	240000	10000	4

Tabela 3: Vlerësimi i numrit të popullsisë sipas kategorisë

Rajoni	Komuna	Gjinia	Fëmijë të moshës para-shkollore (0-5)	Fëmijë që vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Fëmijë që nuk vijojnë arsimin e obligueshëm (6-15)	Moshë pune – të punësuar (16-65)	Moshë pune – të papunë (16-65)	Të moshuar (65+)	Tjerë	
Gjilan / Gnjilane	Gjilan/ Gnjilane	Meshkuj								
		Femra								
		Total		Rreth 100		Rreth 800	Rreth 800			
	Gjithsej rajon			Rreth 100		Rreth 800	Rreth 800			
Mitrovicë/Mitrovica ⁸	Mitrovicë/ Mitrovica jug	Meshkuj								
		Femra								
		Total								
	Mitrovica/ Mitrovicë veri	Meshkuj								
		Femra								
		Total								
	Vushtrri/ Vuçitër	Meshkuj								
		Femra								
		Total								
	Gjithsej rajon									
	Komente: OSBE-ja nuk ka qenë në gjendje të nxjerrë gjitha të dhënat nga organet gjegjëse.									
	Prishtinë/Priština	Prishtinë/ Priština	Meshkuj							
Femra										
Total				360	0	3000		60		
Lipjan/ Lipljan		Meshkuj	7	25	0	108	59	8	30	
		Femra	12	12	0	85	64	9	4	
		Total	16	37	0	163	123	17	34	
Gjithsej rajon			552		1196		50			
Komente:Të dhënat e mësipërme janë vlerësime të ofruara nga zyrtarët Komuna lë dhe përfaqësuesit e komunitetit turk. Nuk ka mundur të bëhet një ndarje e saktë në bazë të moshës, punësimit dhe papunësisë për komunën e Prishtinës/ Priština. Në komunën e Lipjanit/Lipljan, ndarja është bërë në konsultim me përfaqësuesit e komunitetit turk.										
Prizren/Prizren	Prizren	Meshkuj		516			688			
		Femra		516			516			
		Total		1032			1223			
	Gjithsej rajon			1032			1223			
Komente: OSBE-ja nuk ka qenë në gjendje të nxjerrë gjitha të dhënat nga organet gjegjëse.										

Tabela 4: Hisedarët kyçë të komunitetit

1. Partitë politike që pohojnë se përfaqësojnë komunitetin
2. Përfaqësuesit në institucione (emrat, institucionet).
3. Organizatat e shoqërisë civile (emri, fusha e aktiviteteve/çështjet kryesore, të tregohet nëse është grup i grave).
4. Mediat e komunitetit (të shtypura dhe të transmetuara).
5. Udhëheqësit/aktivistët e komunitetit (meshkuj dhe femra).
6. Të tjerët.
7. Informata shtesë

Rajoni	Komuna
Gjilan /Gnjilane	Komuna Gjilan/Gnjilane
	1 KDTP Kosovo Demokratik Türk Partisi (Partia Demokratike Turke e Kosovës)
	2 Kadri Husei, Anëtar i Kuvendit Komunal Gjilan/Gnjilane
	3 OJQ-ja "Mendimi i Ataturkut", "Yarin" dhe "Halit Gaş" – ruajnë kulturën, artin, historinë, vallet tradicionale të turqve dhe leximin e Kur'anit
	4 S'ka
	5 Kemal Şahin, udhëheqës komuniteti
Mitrovicë/Mitrovica	Komuna Mitrovicë/Mitrovica
	1 KDTP Kosovo Demokratik Türk Partisi (Partia Demokratike Turke e Kosovës)
	2 Eroll Zekeria, Zëvendës Kryetar për Komunitete Nexhat Baliqi, anëtar i komitetit të komunitetit në komunën e Mitrovicës/Mitrovica
	3 OJQ "Birlik" merret kryesisht me aspekte kulturore dhe zhvillim të komunitetit turk, si dhe ofrimin e ndihmës humanitare për komunitetin. "Birlik" merr mbështetje të konsiderueshme nga qeveria turke, duke ofruar në anën tjetër mbështetje të konsiderueshme financiare dhe logjistike për komunitetin turk në gjithë Kosovën.
	4
	5 Ergin Koroglu, anëtar i KTDP-së, përfaqësues nga jugu i Mitrovicës/Mitrovica Zymryt Pantina, anëtar i KTDP-së, përfaqësues nga Mëhalla e Boshnjakëve, veriu i Mitrovicës/Mitrovicë
	Komuna Vushtrri/Vuçitrn
	1 KDTP Kosovo Demokratik Türk Partisi (Partia Demokratike Turke e Kosovës)
2 Arif Kera, zëvendës-kryesues i komitetit të komuniteteve në komunë, anëtar i KTDP-së	
3 OJQ "Çeşme" që merret me kulturën dhe trashëgiminë kulturore turke	
4	
5	
Pristinë/Priştina	Komuna Prishtinë/Priştina
	1 KDTP – Mahir Yağcilar, Kryetar KDTP – Engin Beyoğlu, Zëvendës Kryesues për Komunitete dhe Anëtar i Komitetit për Politikë e Financa
	2 Institucione të Kosovës (nivel qendror): Mahir Yağcilar, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Resmiye Mumcu, Drejtoreshë, Departamenti i Administratës, Ministria e Energjisë dhe Minierave
	3 Shoqata kulturore "Gerçek", Dr. Zeynel Abidin Ustaibo, Kryetar OJQ "Hanimeli" Shoqata e Grave, Liriye Gaş, Kryetare Qendra Kulturore dhe Edukative "Bahar", İsa Sülçevsi, Kryetar Qendra Kulturore dhe Edukative "Dolunay", Fahri Ömer
	4 RTK-ja, transmetuesi publik, pesë minuta lajme ditore, si dhe një program një-orësh televiziv një herë në javë, transmetuar në gjuhën turke "Kent FM", radio-kanal, në baza të përditshme, në gjuhën turke
	5 Dr. Zeynel Abidin Ustaibo, Kryetar i shoqatës kulturore "Gerçek"
	6 Nuhi Mazrek, Kryesues i komitetit të komuniteteve Selim Cinci, Anëtar i komitetit për pronën Ergyl Binçe, Anëtar i komitetit për shëndetësi Abdula Birvenik, anëtar i komitetit për arsim dhe kulturë Berkant Curri, anëtar i këshillit komunal të sigurisë në bashkësi

Prizren	Komuna Lipjan/Lipljan	
	1	KDTP Kosovo Demokratik Türk Partisi (Partia Demokratike Turke e Kosovës) Skender Bikliç, kryetar i degës
	2	
	3	
	4	“Bahar” – revistë turke e botuar në Prishtinë/Priština
	5	KDTP, Enis Gaşi, udhëheqës i forumit rinor KDTP, Turkane Gaşi, udhëheqës i forumit rinor
	6	
	7	Në komunën e Lipjanit/Lipjan, të dhënat janë mbledhur në bashkëpunim me udhëheqësin e komunitetit turk në Janjevë/Janjevo
	Komuna Prizren	
	1	KDTP Kosovo Demokratik Türk Partisi (Partia Demokratike Turke e Kosovës)
	2	Institucionet e Kosovës (nivel qendror): <ul style="list-style-type: none"> • Mahir Yağcılar, anëtar i Kuvendit të Kosovës dhe Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor • Enis Kervan, anëtar i Kuvendit të Kosovës • Müfera Şinik, anëtare e Kuvendit të Kosovës • Fikrim Damka, Zëvendës Ministër i Bujqësisë • Altay Suroy, anëtar i Gjykatës Kushtetuese • Tahir Luma, anëtar i këshillit konsultativ për komunitete • Cengiz Çesko, anëtar i këshillit konsultativ për komunitete Institucionet e Kosovës (nivel lokal): <ul style="list-style-type: none"> • Mehmet Bütüç, drejtor i departamentit për ekonomi dhe financa • Sencar Karamuco, drejtori i gatishmërisë dhe emergjencave • Orhan Lopar, anëtar i kuvendit të komunës • Ergin Kala, anëtar i kuvendit të komunës • Fidan Jilta, anëtar i kuvendit të komunës • Cengiz Curcialo, zyra komunale e komuniteteve në Prizren • Fikri Şişko, Judge, gjykata e qarkut në Prizren
	3	Shoqata “Doğru Yol”, aktivitete kulturore OJQ “Shoqata e Mësimdhënësve Turq të Kosovës”, aktivitete arsimore “Rumeli”, teatri turk i Kosovës Shoqata “Esnaf”, aktivitete afarizmi OJQ “Filizler”, aktivitete kulturore Shoqata multi-etnike “MESK”, aktivitete kulturore OJQ “Zübeyde Hanım”, çështjet e grave Shoqata “Türk Muziği Konservatuari”, aktivitete kulturore OJQ “Intelektualët turq”, aktivitete kulturore
	4	“Kosovahaber”, gazetë e përditshme elektrike “Radio Prizren”, 3 orë transmetim në gjuhën turke “Mehmetçik” radio-stacioni i KFOR-it turk “Balkan TV” stacion lokal televiziv shumë-gjuhësh
	5	Mahir Yağcılar, Kryetar i KDTP-së Fikrim Damka, Sekretar i KDTP-së Müfera Şinik, Anëtar i Kuvendit të Kosovës - KDTP Ercan Şpat, ish zëvendës kryetar për komunitete në komunën e Prizrenit Enis Kervan, anëtar i Kuvendit të Kosovës Orhan Lopar, Kryetar i Degës së KDTP-së në Prizren
	6	
7		
Komuna Mamuşa/Mamushë/Mamuşa		
1	KDTP Kosovo Demokratik Türk Partisi (Partia Demokratike Turke e Kosovës)	
2	Institucionet e Kosovës (nivel qendror): <ul style="list-style-type: none"> • Rifat Krasnić – Zëvendës ministër për komunitete dhe kthim Institucionet e Kosovës (nivel lokal): <ul style="list-style-type: none"> • Arif Bütüç – kryetari i kuvendit komunal 	
3	Shoqata “Asikferki”, aktivitete kulturore Shoqata “Alperenler”, aktivitete rinore	
4	Komuniteti ka qasje në radio stacione dhe media elektronike në gjuhën turke.	
5	Rifat Krasnić, kryetar i degës lokale të KDTP Arif Bütüç, nënkryetar i degës lokale të KDTP	

- 1 Komuniteti turk në pjesën jugore të Mitrovicës/Mitrovica është i shpërndarë në gjitha zonat urbane dhe nuk banon në "lagje turke" të veçanta.
- 2 Komuniteti turk në Vushtrri/Vučitrn është i shpërndarë në gjitha zonat urbane dhe nuk banon në "lagje turke" të veçanta.
- 3 Të dhënat e popullsisë për pjesët 3, 4, 5 dhe 6 janë grumbulluar nga Ekipet e OSBE-së në Terren, në konsultim me përfaqësuesit e komuniteteve dhe zyrtarët komunalë në shtator të vitit 2008.
- 4 Të dhënat për kolonat b dhe c nuk janë në dispozicion.
- 5 Të dhënat për Mitrovicë/Mitrovica (në përgjithësi, si dhe të zbërthyerat për veri/jug) janë të vështira të grumbullohen dhe i nënshtrohen shumë kundërthënies.
- 6 Të dhënat për kolonat b dhe c nuk janë në dispozicion.
- 7 Duhet vërejtur që disa pjesë të popullsisë kanë bojkotuar këtë regjistrim, pra të dhënat e grumbulluara kontestohen nga disa komunitet.
- 8 OSBE-ja nuk ka mundur t'i qaset ndarjeve specifike të të dhënave statistikore. Derisa disa palë mund të kenë të dhëna të tilla, apo vlerësime të përafërta, ka një mundësi të përgjithshme të vullnetit për t'i paraqitur në publik më të gjerë.

